

KDU 3(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

4

2017



PRISHTINË
2018

KDU 3(05)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

SOCIAL STUDIES

4

2017

Editorial board

Muhamedin Kullashi - Editor-in-chief

Frashër Demaj - Secretary

Robert Elsie, Member

Justina Shiroka Pula, Member

Gjyljeta Mushkolaj, Member



PRISHTINA
2018

KDU 3(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

4

2017

Këshilli redaktues

Muhamedin Kullashi - Kryeredaktor

Frashër Demaj - Sekretar

Robert Elsie, Anëtar

Justina Shiroka Pula, Anëtare

Gjyljeta Mushkolaj, Anëtare



PRISHTINË
2018

Copyright © ASHAK

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës *Studime Shoqërore*
Rr. Agim Ramadani, nr. 305
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel. + 381 38 249 303
Fax. + 381 38 244 636
E-mail: ashak@ashak.org

PËRMBAJTJA

Fjala e kryetarit të ASHAK z. Hivzi Islamit dhe ajo e sekretarit permanent të Akademisë së Mbishkrimeve dhe Letërsisë të Francës z. Michel Zink me rastin e nënshkrimit të Konventës për Bashkëpunim Shkencor midis dy akademive, më 16 nëntor, në ASHAK:7

Fjala e akademik Michel Zink, sekretar permanent i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë të Francës (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), e themeluar më 1663:9

Michel Zink

LA SUBJECTIVITÉ LITTÉRAIRE AU MOYEN ÂGE (SUBJEKTIVITETI LETRAR NË MESJETË) 11

Tryezë shkencore: Për migrimet

Anton Kolë Berishaj

FJALË HYRËSE NË TRYEZËN PËR MIGRIMET29

Hivzi Islami

PUSH-PULL FAKTORËT NË MIGRIMET E JASHTME - QASJET TEORIKE DHE RASTI I KOSOVËS33

Arsim Canolli

“ME RA S’KIE KU SHKON, ME NEJTË S’KIE KU RRIN” - NJË PAMJE ETNOGRAFIKE I MIGRIMIT TË BRENDSHËM FSHAT-QYTET NË KOSOVË.....49

Lumnije Kadriu

DIASPORA SHQIPTARE E KOSOVËS BRENDA PËRKUFIZIMEVE TË DIASPORËS DHE TRANSNACIONALIZMIT..... 71

Valbon Bytyqi, Ibrahim Ramadani

ANALIZË GJEOGRAFIKE E ZONAVE MIGRUESE NË REGJIONIN LINDOR TË KOSOVËS.....87

Denis Nushi

MIGRIMI/ MOBILITETI DHE IDENTITETET HIBRIDE TË DIASPORËS.....105

Arsim Ejupi

MIGRIMET E JASHTME NGA LUGINA E PRESHEVËS - FAKTORËT PËRCAKTUES DHE EFEKTET 125

Shemsi Krasniqi

KUJTESA DHE RRËFIMET PËR EKSODIN E VITIT 1999..... 143

Tahir Latifi

MIGRIMI DHE FAMILJA TRANSNACIONALE - ROLI I REMITENCAVE NË RUAJTJEN E KOHEZIONIT SOCIAL NË FAMILJEN KOSOVARE..... 173

<i>Muhamedin Kullashi</i> LINDJA E VETËDIJES MODERNE TE MONTAIGNE DHE SHAKESPEARE	189
<i>Hivzi Islami</i> TRANSICIONI DEMOGRAFIK SI PROCES BOTËROR	201
<i>Justina Shiroka Pula, Albulena Kadriu</i> BIZNESET NË PRONËSI TË GRAVE	219
<i>Ninon Grangé</i> Zbulimi i jus post bellum: Fundi i lutës apo dalja nga lufta?	231
<i>Astrit Salihu</i> BANIMI POETIK	247
<i>Shpresë Siqeca</i> VESHJET KOMBËTARE TË VISEVE SHQIPTARE TË MAQEDONISË NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX	269
<i>Ibrahim Ramadani</i> ELEMENTET DHE MEKANIZMAT KONTROLLUES URBANISTIK NË PROCESIN E HARTIMIT TË PLANEVE HAPËSINORE	283
Tryeza shkencore: “Rruga drejt integritit ekonomik evropian e Kosovës”	297

Recensione

Edi SHUKRIU, Studime për Dardaninë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 247.	305
Emin RIZA, Arkitektura popullore e Gjakovës, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2017, f. 283.	308
Muhamedin KULLASHI, Dy gjenealogji të modernitetit evropian, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 259.	310
Blerim LATIFI, Metafizika e emancipimit. Ideja e emancipimit të njeriut në historinë e mendimit perëndimor, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 315.	313
Shemsi KRASNIQI, Besimet dhe praktikat rituale shqiptare në Kosovë. Refleksione mbi një ekokulturë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 319.	315

In memoriam

Robert Elsi (1950-2017)	319
Kristaq Prifti (1932-2017)	325

Fjala e kryetarit të ASHAK z. Hivzi Islamit dhe ajo e sekretarit permanent të Akademisë së Mbishkrimeve dhe Letërsisë të Francës z. Michel Zink me rastin e nënshkrimit të Konventës për Bashkëpunim Shkencor midis dy akademive, më 16 nëntor, në ASHAK:

Të nderuar kolegë dhe miq,

Pas ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy akademive, përfaqësuesi i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), sekretari permanent prof. Michel Zink do të mbajë një ligjëratë. Para ligjëratës, më lejoni që ta paraqes një tablo të shkurtër të biografisë dhe të punës së tij akademike, shkencore-hulumtuese dhe krijuese.

Prof. Zink, filolog dhe medievist, lindi në vitin 1945 në Issy-les-Moulineaux, afër Parisit. Është specialist i filologjisë dhe letërsisë mesjetare të Francës të shekujve XII-XV, i filologjisë dhe i letërsisë religjioze, i historiografisë dhe historisë së përgjithshme të letërsisë frënge të mesjetës.

Pasi i kreu studimet në *École Normale supérieure* më 1968, në vitet 1976-1987 ishte profesor në Universitetin e *Toulouse-it II-Le Mirail*, pastaj në vitet 1987-1994 në *Universitetin e Sorbonës IV*. Nga viti 1995 ligjëron në *Collège de France* letërsinë mesjetare franceze. Prof. Zink gjithashtu ka ligjëruar në disa universitete prestigjioze jashtë Francës, si në Yale, Berkley të Kalifornisë, në Arizona, Pensilvania, Çikago, në Sapienca të Romës, në Stanford University, në Universitetin e Cyprihut etj.

Në edicionin *Livres de poche* (Librat e xhepit) drejton koleksionin *Letërsia gotike* si dhe drejton revistën *Romania*, që merret me gjuhët dhe letërsinë romane.

Në vitin 2000 u zgjodh anëtar i Akademisë Frënge të Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), e themeluar në vitin 1663 nga Luigji XIV. Në vitin 2011 ishte kryetar i kësaj akademie, ndërsa sot është sekretar permanent i

saj. Nga viti 1996 është dhe anëtar i Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave.

Bibliografia e tij është shumë e gjerë. Janë dhjetra e dhjetra botime nga fushat e interesimit të tij shkencor e letrar, filologjia, letërsia mesjetare frënge, studime, interpretime, komente, analiza çka e bën atë njërin nga ekspertët më të shquar frëngë në këto fusha.

Për rezultatet në punën e tij mori disa shpërblime e dekorata, sikurse “Komandor i Urdhrit të Palmave Akademike” (“Commandeur dans l’Ordre de Palmes Académiques”), “Kalorës i Legjionit të Nderit” (“Chevalier de la Legion d’Honneur”), çmimin e “Asociacionit të Studimeve Franceze” (“Association des Études Françaises”) etj.

Fjala e akademik Michel Zink, sekretar permanent i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë të Francës (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), e themeluar më 1663:

Monsieur le Vice-Premier Ministre, Ministre de la culture,
 Monsieur le Ministre de l'éducation, Monsieur l'Ambassadeur
 honoraire du Kosovo en France,
 Monsieur le Président de l'Académie du Kosovo,
 Monsieur le Président honoraire de l'Académie du Kosovo,
 Mes chers confrères,
 Madame la représentante de Monsieur l'Ambassadeur de
 France, retenu par d'importantes obligations,

Je suis particulièrement heureux de la signature de cet accord aujourd'hui. Je ne le suis pas seulement en mon nom, mais au nom de tous les confrères de mon Académie, et au nom des cinq Académies de l'Institut de France. Nous sommes heureux de cet accord, pour des raisons qui sont d'abord égoïstes, pourrais-je dire. Les Académies de l'Institut de France ont vu le jour pour quatre d'entre elles au 17^e siècle, l'Institut de France lui-même a été fondé en 1795 pour les réunir. Ces Académies et cet Institut ont, je peux le dire sans aucune vanité, servi de modèle à l'organisation des Académies dans la France entière. Il en existait auparavant, l'Accademia della Crusca à Florence, l'Accademia dei Lincei à Rome, par exemple. Mais pour la plupart, les Académies européennes se sont fondées sur le modèle des Académies de France et de l'Institut de France. Chaque fois que nous pouvons approfondir et officialiser nos liens avec les différentes Académies à travers l'Europe et à travers le monde, nous en sommes heureux, à la fois pour l'enrichissement que cela nous apporte et parce que c'est comme une sorte de reconnaissance du rôle que la France a joué et qu'elle espère pouvoir continuer à jouer dans la vie intellectuelle, scientifique, littéraire, artistique du monde.

S'agissant de l'Académie des inscriptions et belles-lettres, comme l'a rappelé Monsieur le Président, elle fut fondée en 1663 par le roi Louis XIV et son ministre Colbert. Son domaine est celui des disciplines

historiques et philologiques, des civilisations, des langues, de l'archéologie dans le monde entier, en France, en Europe, au Proche-Orient, en Extrême-Orient et maintenant dans l'Amérique précolombienne en attendant l'Afrique subsaharienne. Cette Académie est, on le devine, particulièrement intéressée par un pays comme le Kosovo, qui à la fois est au cœur de l'Europe et a vécu toutes les vicissitudes de l'histoire de l'Europe depuis le néolithique, qui en a souffert, en a gardé des traces, qui est fidèle à son passé et à tous ses passés, qui est capable d'admettre tout ce qui l'a constitué et d'en vivre, qui est capable de considérer que ce passé, tout ce passé à travers tous les siècles et sous toutes ses formes culturelles et religieuses, est toujours présent, et que s'il l'oublie il se perdra lui-même. C'est avec ce pays et avec cette Académie, qui courageusement aux valeurs de la liberté, de la tolérance et du pluralisme dans ses activités intellectuelles, que, l'Académie des inscriptions et belles-lettres est fière de signer aujourd'hui un accord. J'ajoute que si cet accord est signé aujourd'hui, nous le devons à la volonté, à la ténacité, à la diplomatie, à la chaleur amicale de Monsieur l'Ambassadeur Muhamedin Kullashi, qui a admirablement joué son rôle de premier ambassadeur du Kosovo en France au regard des institutions scientifiques et intellectuelles de la France, et tout particulièrement au regard de l'Académie des inscriptions et belles-lettres. C'est pourquoi je le remercie, comme je vous remercie tous ici et particulièrement vous, Monsieur le Premier Ministre, d'assister à cette cérémonie.

Merci, Monsieur le Président, de cette présentation flatteuse. J'ai remercié Monsieur l'Ambassadeur Kullashi tout à l'heure, mais je dois le faire à nouveau, car c'est lui qui m'a pratiquement imposé le sujet de la conférence que je vais tenir maintenant. Pour une raison claire, mais qui ne rendra peut-être pas cette conférence agréable à entendre, il m'a demandé ou plutôt suggéré, car c'est un homme courtois, de traiter ce sujet en rapport avec un livre que j'ai publié il y a très longtemps, en 1985, *La Subjectivité littéraire autour du siècle de saint Louis*, titre à l'époque très légèrement provoquant et qui pour cette raison a eu un certain écho. La question de la subjectivité littéraire est une question sur laquelle je suis revenu dans plusieurs de mes livres ultérieurs: *Froissart et le temps*, *Poésie et conversion au Moyen-Âge*, *Nature et poésie au Moyen-Âge*, *Les Troubadours: une histoire poétique*. C'est une question autour de laquelle j'ai tourné jusqu'à aujourd'hui. Elle est un peu abstraite, formulée de cette manière. C'est pourquoi je ne suis pas sûr de pouvoir la traiter d'une façon qui vous évite un ennui excessif.

Michel Zink, Paris

LA SUBJECTIVITÉ LITTÉRAIRE AU MOYEN ÂGE

Abstrakti

Subjektiviteti letrar në mesjetë

Kjo ligjëratë e merr titullin dhe materjen nga një libër që e kam botuar para më se tridhjetë vitesh, *Subjektiviteti letrar rreth shekullit të Shën Luigjit* (1985), duke shtuar këtu disa shqyrtime për relacionin midis autorit dhe veprës në mesjetë.

Me subjektivitet letrar kuptojmë atë që cilëson tekstin si pikëpamje e një ndërgjegje. Ky nocion nuk është i vetkuptueshëm. Në mbarimin e shekullit XX u bë çështje edhe vetë nocioni i autorit, teksti brenda një perspektive strukturaliste e cila e prodhon veten (“Id-i flet”, “e pavetëdijshmja është e strukturuar si një ligjërim”) apo duke reflektuar përshtypjet e jashtme të cilat vetëm iluzioni i subjektit e lidhë me brendinë e tij. Letërsia e mesjetës e shikuar atëherë si një lojë e thjeshtë e formave të ligjërimit, e metrikës ose e rrëfimit dukej se e mbështeste këtë vizion. Mirëpo vetë tekstet mesjetare e thonë të kundërtën dhe athua nuk është punë e një metode të mirë të fillosh t’i dëgjosh ato? Atëherë del në shesh se letërsia mesjetare e formësuar nga krishtërimi, religjion ky i cili themelon çdo krijimtari të frymës mbi vetëdijen për veten.

Raporti i autorit ndaj veprës së tij është i përcaktuar nga ky koncept. Edhe lidhur me këtë, ideologjitë e paradokohshme e kanë shtrembëruar ndopak vizionin tonë. Romantizmi, i cili kërkonte identitetin e çdo populli te veprat e para të artit të tij dhe të poezisë së tij, supozonte se këto vepra ishin kolektive dhe spontane: karakteri anonim i një pjese të kësaj letërsie mesjetare i shërbente si argument. Nga ana tjetër, teoria letrare e mbarimit të shekullit XX e kërkonte po kështu këtë anonimitet, mirëpo me qëllim që të vë në pah se nocioni i autorit nuk ka pertinencë. Ç’është e vërteta, autorët mesjetarë e emërojnë veten dhe prezantohen shpesh në veprën e tyre. Mirëpo ata e vënë në skenë një imazh mbi veten e tyre e cila, në fakt, është shpesh një figurë e prodhuar nga vetë vepra se sa një zbulim i identitetit biografik.

Pourquoi cette formulation si abstraite, “la subjectivité littéraire”, s’était-elle imposée à moi comme l’objet possible d’un livre? Il faut, pour répondre à cette question, prendre en considération deux points.

D’abord, le fait que les courants intellectuels en France et ailleurs remettaient en cause, à cette époque, l’idée même de sujet, sous l’influence des penseurs français des années 1980. Nous étions à la fin de la grande période structuraliste. En 1966, l’article célèbre de Michel Foucault, “Qu’est-ce qu’un auteur?», concluait qu’en fait il n’y a pas d’auteur. La pensée même de Michel Foucault excluait la véritable intériorité et, si je peux utiliser cette métaphore – je parle sous le contrôle de Monsieur Kullashi qui connaît cela beaucoup mieux que moi –, il se représentait l’esprit comme une sorte de feuille de papier imprimé: l’impression marque le papier, mais ne vient pas de lui. Imaginons que la feuille est ensuite repliée sur elle-même: ce que l’on prend pour l’intériorité n’est alors qu’un retour sur soi-même des impressions extérieures. En même temps cette fin du XX^e siècle a été la grande époque du développement du structuralisme fondé sur la linguistique. La recherche d’un fonctionnement universel du langage guidait les travaux de Chomsky dans ses efforts pour définir les lois d’une grammaire générationnelle, et elle était simultanément appliquée à d’autres ordres de la vie de l’esprit. La pensée de Lévi-Strauss était une sorte d’application des lois linguistiques au fonctionnement social, en particulier aux structures de la parenté. D’autre part, cette période était la grande période de la psychanalyse, et plus précisément de l’influence lacanienne. Or la pensée de Jacques Lacan se fonde elle aussi sur une sorte d’automatisme linguistique. Le sujet n’a pas de part dans le développement ni de sa pensée ni de son inconscient. “L’inconscient est structuré comme un langage” signifie que le langage ne dépend pas du sujet. Non pas: “je parle”, mais: “ça parle”. Cette forme de pensée avait naturellement des répercussions dans l’analyse littéraire, dans l’étude de la littérature, et chaque fois pour gommer la présence du sujet. La démarche traditionnelle qui étudiait à la fois l’homme et l’œuvre faisait ricaner. L’idée même d’écrire la biographie d’un personnage historique semblait une idée saugrenue ou désuète: c’est ce que faisaient les sous-historiens, pour vendre des livres qu’on lit dans le métro, ce n’était pas sérieux. Quant à moi, j’étais jeune, je n’avais pas la tête philosophique, et j’aurais donc dû me taire. Je n’étais ni Foucault, ni Lacan, ni Lévi-Strauss. Il me semblait cependant qu’il n’est pas de bonne méthode de ne pas

prendre au sérieux les auteurs que l'on étudie et de ne pas commencer par chercher ce qu'ils disent, ce qu'ils veulent dire et pourquoi ils le disent. Ils se trompent peut-être ou ils nous trompent, mais peut-être aussi ont-ils des raisons pour cela.

Me tournant alors vers l'époque que j'étudiais, le Moyen-Âge, je constatais une sorte de distorsion. D'une part, le Moyen-Âge servait cette pensée de l'absence du sujet – ou en tout cas les médiévistes l'avaient mis à son service. D'autre part, ce qui modèle le Moyen-Âge tout entier, c'est le christianisme. C'est lui qui est le principal marqueur et le principal facteur de la rupture entre l'Antiquité, avec laquelle le Moyen-Âge se veut en continuité culturelle, et cette époque que nous appelons depuis le XVI^e siècle, de façon maladroite d'ailleurs, le Moyen-Âge. Or, le christianisme est une religion du salut individuel, qui repose sur une adhésion personnelle, sur une expérience personnelle de Dieu, sur la "conversion". Ce mot, très employé au Moyen-Âge, ne signifie pas "se convertir" d'une religion à une autre, mais, à l'intérieur, d'une religion, la sienne quelle qu'elle soit, changer de comportement ou de mode de pensée pour se tourner vers Dieu. Comment donc une culture modelée par une telle religion pouvait-elle imaginer de rejeter la notion de sujet? Qu'aurait-elle pensé de la Sainte Trinité du XX^e siècle finissant, Foucault, Lévi-Strauss, Lacan? Elle n'y aurait rien compris. Et comment l'aurait-elle pu, alors que l'un de ses grands modèles, à la fois spirituel et littéraire, ce sont les *Confessions* de saint Augustin, alors que l'on voit émerger au fil du Moyen-Âge une forme littéraire nouvelle qui est l'autobiographie et que cette forme littéraire nouvelle se fonde explicitement sur le modèle des *Confessions*?

Voici par exemple un personnage qui n'est pas une figure de proue des lettres médiévales, mais qui n'est pas non plus sans importance, Guibert de Nogent. C'est un moine qui a écrit une des premières autobiographies, en latin naturellement. Il l'intitule de façon pédante mais significative, *Monodiae*, "monodies". C'est donc un chant solitaire, où ne s'entend que sa voix seule, c'est un livre où il ne parle que de lui. Il commence en plagiant le début des *Confessions* de saint Augustin. Saint Augustin commence son livre en disant "Je confesse", non pas ses péchés, mais la gloire de Dieu. C'est une confession de louange: je confesse que Tu es grand et que, parcelle infime de la création, l'homme cherche à Te louer. Et de là, il rentre en lui-même et se met à parler de lui. Alors que la pensée médiévale – depuis cinquante ans – presque un siècle à son époque – tourne autour

de l'idée de faute, de culpabilité, de rémission de la faute, d'absolution, essaye de mesurer ce que sont les circonstances aggravantes, les circonstances atténuantes, essaye de se séparer de la lettre de la loi et de la réglementation ecclésiastique, Guibert de Nogent, au XII^e siècle, commence, lui aussi, en disant "Je confesse", mais ce qu'il confesse, ce sont ses péchés. Ce mouvement même montre à la fois l'attention au sujet et comment la pensée de son époque lie l'attention au sujet et l'attention à la faute. Dans la religion chrétienne la notion de péché, comme dans toutes les religions, est très importante. On a imposé d'abord une pénitence publique, mais dans de très rares cas seulement. Plus tard, à l'époque carolingienne, on a établi une tarification des châtiments selon les fautes. Plus tard encore, on s'est dit que si la faute était commise par quelqu'un d'éduqué, de riche, de puissant, elle était plus grave que si elle était commise par un ignorant qui sait à peine ce qu'il fait. Il y a des circonstances atténuantes et des circonstances aggravantes. Chacun doit s'examiner lui-même, se demander quelle faute il a commise et quel était son degré de gravité. C'est ce que doit faire aussi, et de façon décisive, le confesseur. Au terme de cette réflexion, le quatrième concile de Latran en 1215 impose de se confesser individuellement une fois par an à un prêtre. Cette décision n'avait pas que des raisons théologiques, morales et spirituelles. C'était aussi un moyen de contrôler les consciences. Mais elle a eu une conséquence énorme sur la vie intellectuelle de l'Occident parce qu'elle a contraint à l'introspection: s'examiner soi-même, réfléchir, revenir sur ses pensées, sur ses actions, les juger, les jauger, les comprendre. Cela a eu, même dans le domaine littéraire, un effet considérable.

Pour en revenir à ma petite personne, je me trouvais donc déchiré entre le respect que j'avais pour la pensée dominante autour de moi et ce qui me frappait dans la vie intellectuelle et morale du Moyen-Âge. Tel été le point de départ de ma réflexion sur la subjectivité littéraire.

Je vais prendre ici la question d'un point de vue particulier, avec une expression un peu paradoxale qui a été le titre de l'un de mes cours au Collège de France, où je viens de prendre ma retraite. Le Collège de France est une institution très particulière où il n'y a pas d'étudiants: on ne s'inscrit pas, l'enseignement est gratuit, l'institution ne délivre aucun diplôme, l'accès aux cours est entièrement libre, tout le monde peut venir. Mais ce ne sont pas des cours de vulgarisation, les professeurs doivent enseigner leurs recherches en cours, "la recherche en train de se faire",

comme nous disons. Ils parlent de ce qu'ils veulent, puisqu'il n'y a ni cursus ni diplôme, mais il faut que ce soit toujours nouveau. On n'a jamais le droit de répéter un cours. Je suis resté 22 ans professeur au Collège de France et à la longue je commençais à m'épuiser. Une année, revenant sur mes anciennes amours, j'ai pris comme sujet: "Quel est le nom du poète?" Cette question a l'air stupide. Elle ressemble à la vieille plaisanterie: "Quelle est la couleur du cheval blanc d'Henri IV?" Mais ce n'est pas une question stupide, je l'espère tout du moins, si on se réfère d'une part à cette sorte de problème, sinon de contradiction, auquel je m'étais trouvé confronté, et si on considère l'attitude de l'époque moderne vis-à-vis du Moyen-Âge et des auteurs du Moyen-Âge, ainsi que l'attitude du Moyen-Âge vis-à-vis de ses propres auteurs. La question se pose quand on regarde la façon dont les poètes médiévaux se nomment, ou ne se nomment pas, ce qu'ils disent d'eux-mêmes, et également lorsqu'on regarde la façon dont a été lue la littérature du Moyen-Âge.

Je commence par la façon dont a été lue la littérature du Moyen-Âge à l'époque moderne et pourquoi cette question du nom du poète s'est trouvée être une question importante, débattue, dans des sens divers selon les époques et selon les raisons pour lesquelles on s'intéressait au Moyen Âge. À l'âge classique, le Moyen-Âge et sa littérature ont été, au moins officiellement, méprisés. Au XVI^e siècle, quand la Renaissance est arrivée en France, on a considéré qu'une longue coupure séparait l'Antiquité classique de sa redécouverte, un âge intermédiaire, médian, moyen (l'expression de Moyen Âge apparaît dès la seconde moitié du XVI^e siècle) qui s'étend de la chute de l'Empire romain d'Occident à la Renaissance des Lettres. Cette définition n'est pas une définition politique, mais culturelle: la chute de l'Empire romain produit un effondrement de la culture, puis il y a un retour aux vieilles valeurs de la culture au moment de la Renaissance, qui est en fait une réaction. À partir de ce moment, la période médiévale est méprisée. On continue à lire les romans de chevalerie ou les Chroniques de Froissart, dans lesquelles les grandes familles cherchent l'illustration de leurs ancêtres. Mais ce sont des lectures dont on ne se vante pas: elles n'appartiennent pas à la culture de l'honnête homme. La littérature du Moyen-Âge a été vraiment redécouverte à l'époque romantique, ou préromantique, à la fin du XVIII^e siècle, en Angleterre et en Allemagne. Si cette littérature a été redécouverte, ce fut dans un esprit et avec une idéologie bien précis, qui lui imposaient, si je puis dire, d'être anonyme. Car la grande idée du romantisme, qui s'est imposée au XIX^e siècle avec l'essor des

nationalités, les mouvements pour l'unité italienne et l'unité allemande, la création des états dans le monde balkanique et en Grèce, c'est que chaque peuple a une identité propre et un génie propre. Ce génie se manifeste à l'état pur dans les premières manifestations de son art, de sa poésie, de sa culture, et, plus tard, dans les manifestations de cet art et de cette culture qui ne sont pas adultérées par des apports étrangers. D'autre part, on supposait que ce génie d'un peuple, et non pas d'un individu, se manifestait d'abord dans des productions collectives, spontanées, qu'on ne pouvait pas attribuer à un auteur. Des poèmes épiques qui circulaient, des balades, des chansons de danse, des chansons d'amour, etc. On admettait aussi que cette production survivait dans la culture populaire. En Allemagne, cette idée a connu un succès particulier au service de l'idéologie nationale, en réaction contre la culture savante, nourrie de l'antiquité latine et grecque, mais aussi de la littérature classique française.

Une telle conception avait besoin que la littérature du Moyen Âge fût essentiellement anonyme, puisqu'elle supposait une production poétique collective révélant l'âme du peuple. Et il est vrai que beaucoup d'œuvres du Moyen-Âge nous sont parvenues sans nom d'auteur. Mais beaucoup d'autres non seulement sont attribuées, mais s'attribuent eux-mêmes, c'est-à-dire que l'auteur se nomme et se présente à l'intérieur de l'oeuvre. Aujourd'hui, le nom de l'auteur est sur la couverture du livre, qui commence rarement par les mots: "Moi Untel, j'écris ce livre". L'époque romantique a donc pensé que la littérature du Moyen-Âge est une littérature, non seulement anonyme, mais encore sans auteurs. Elle avait idéologiquement besoin de le croire.

Plus tard, ce besoin de l'anonymat a reparu pour des raisons totalement différentes. Plus tard, c'est-à-dire à la fin du XX^e siècle, au moment où l'on disait que l'inconscient est structuré comme un langage, que "ça parle", il n'y a ni originalité ni intériorité du sujet, mais seulement les impressions du monde extérieur. Les médiévistes, qui avaient peur d'être les laissés pour compte de cette pensée tellement moderne, eux qui pataugeaient dans des poèmes vieux de huit siècles, ont alors donné de la voix. Voyez comme le Moyen Âge est moderne, ont-ils dit: ses poèmes sont anonymes; quand ils s'attribuent un auteur, ou bien il est fictif, ou bien on ne peut rien savoir de lui; et la poésie repose sur des principes qui sont des principes formels qui sont des principes de type structuraliste. Ils se fondaient sur un essai déjà ancien, de peu postérieur à la deuxième guerre mondiale, d'un philologue et poète belge, Robert Guette, *D'une poésie formelle en France au*

Moyen-Âge, qui a eu un énorme retentissement et dont les intuitions ont été développées par de nombreux médiévistes, et en particulier par un maître très illustre, dont je garde un souvenir très admiratif et très affectueux, Paul Zumthor. L'idée était que tous les poèmes du Moyen-Âge, et en particulier toutes les chansons, se ressemblent, parce que le poète ne cherche pas à exprimer des sentiments, une pensée, une sensibilité, une attitude qui auraient une originalité et porteraient sa marque propre, comme le fait un poète moderne, mais au contraire à se couler dans un moule imposé et à y introduire de très légères variations qui font le prix de son poème.

Il est vrai que, quand nous lisons cette poésie, nous avons souvent l'impression d'une certaine monotonie. Mais si nous la lisons de très près, elle n'est pas si monotone que cela. D'ailleurs, si nous lisons n'importe quelle littérature éloignée, soit venant d'un passé lointain, soit venant d'une civilisation très différente de la nôtre, au début tout nous paraît semblable. S'agissant même de la littérature française – je suis vieux et de mon temps on étudiait encore beaucoup le théâtre classique français au lycée –, on nous disait: “Corneille est un génie, mais Rotrou, auteur un peu antérieur à Corneille, un des premiers auteurs de tragédies, Rotrou, c'est vraiment très médiocre”. Mais il me semble que si aujourd'hui on lit une tragédie de Corneille, surtout une des dernières, et une tragédie de Rotrou, on trouve qu'il y a beaucoup de ressemblances. De même, si nous lisons des romans 1900, nous trouvons à tous un air de famille. Et aujourd'hui, à cinquante ans de distance seulement, en relisant les auteurs qui ont illustré en France le Nouveau Roman, nous avons l'impression que les différences entre eux, qui nous crevaient les yeux à l'époque, sont en train de s'estomper. Dire de la poésie médiévale que c'est une poésie formelle, monotone et peu variée, c'est donc s'attacher à ce qu'on voit d'abord et de loin. C'est comme si un archéologue mettait au jour le tombeau de la belle Hélène de Troie et en concluait que l'idéal de la beauté à l'époque, c'était des os. Eh bien non, il y avait de la chair autour des os. Il faut reconnaître pourtant que l'extrême fin du Moyen Âge a effectivement connu, avec ceux qu'on appelle les Grands Rhétoriciens, un engouement pour une virtuosité et des jeux poétiques purement formels. Bref, l'idée de poésie formelle a permis aux médiévistes d'apporter leur poésie au reste de la communauté littéraire en disant: “Voyez, au Moyen-Âge, ça parlait, il n'y avait pas *un* poète, on se plaisait à des jeux de langage dignes de l'Oulipo.” Ils y ont gagné une sorte d'autorité car, quelque soit le mépris dans lequel le Moyen Âge est tenu, il marque un des débuts de

la civilisation européenne, en particulier celui des langues et des littératures romanes, comme le français. Dire qu'au Moyen Âge les choses se passaient déjà ainsi a un certain poids. Il y a une forme d'explication ou de justification par le Moyen Âge. En la circonstance, on a conforté l'hypothèse d'une sorte d'anonymat universel de l'esprit en lui trouvant un fondement médiéval.

Puis est venu l'inévitable retour de balancier. Je ne prétends certes pas que mon livre sur la subjectivité littéraire a eu une quelconque influence. Mais je constate qu'après avoir éveillé un écho très modéré à sa sortie en 1985, il a été depuis lors cité de plus en plus souvent. De même, les livres suivants où je renvoyais, directement ou indirectement, à la même idée ont été bien reçus. Il s'était passé quelque chose. Ce qui s'est passé, indépendamment de la réflexion sur le Moyen-Âge et sa littérature, c'est qu'il y a eu une sorte de malaise, d'hésitation et même d'effondrement de la théorie littéraire dans le courant ou à la fin des années 1990. Il n'y avait plus qu'aux États-Unis que l'on faisait encore de la *French Theory*. On a assisté, d'abord chez les historiens, à un retour du biographique, à un retour de l'idée que les personnalités influent tout de même sur les événements; l'idée que, si on pousse trop loin les théories de l'École des Annales, on a une pensée très puissante et très structurée, mais avec, dans le détail beaucoup d'éléments qui échappent à la compréhension. Le premier qui a osé cette démarche en France, parce qu'il était intouchable – mais en prenant tout de même de grandes précautions –, ce fut Jacques Le Goff, avec un livre admirable sur saint Louis. Mais il s'en excusait presque. Il a choisi un plan qui brouillait le pur déroulement chronologique de la vie du personnage. Il a intitulé son livre Saint-Louis, avec un trait d'union, qui ne s'emploie pas en français pour la désignation d'un saint, mais d'une église placée sous son invocation: cela faisait de la désignation du personnage, non une reconnaissance de sa sainteté, mais une sorte de sobriquet entré dans l'usage. Mais, malgré toutes ses précautions, Jacques Le Goff avait tout de même écrit une biographie de saint Louis.

Vingt ans après ce livre paru en 1996, on s'aperçoit que les ouvrages récents les plus importants dans les domaines de l'histoire, de l'histoire littéraire et même de la critique littéraire sont presque tous des biographies. Que l'on songe au *François d'Assise* d'André Vauchez, au *Charles VII* de Philippe Contamine, au *Gide* de Frank Lestringant, au *Valéry* de Michel Jarrety. La forme de la pensée historique et critique a changé et la biographie est considérée comme

une herméneutique littéraire. Certaines biographies sont actuellement parmi les livres qui donnent le plus à penser.

Si nous revenons à la question de l'auteur et à la poésie du Moyen-Âge, nous nous apercevons qu'elle pose vraiment la question: quel est le nom du poète? Elle la pose sous cette forme même. Je vous le montre par une image qui n'est pas un chef d'œuvre de l'art, mais qui, pour notre propos, est bien intéressante:



On y voit un homme à cheval, en armure avec un casque et un écu, sur un cheval. Mais il est représenté de dos. On ne voit que le dos du cavalier et la queue du cheval. C'est une miniature de 4x5 cm, à

peu près, sur feuille d'or, ornant une lettrine, un L, la première lettre d'un poème copié dans un manuscrit du XIV^e siècle rassemblant des chansons des troubadours, les auteurs des plus anciens poèmes intégralement conservés dans une de ces nouvelles langues romanes, nées sur les débris du latin parlé, en l'occurrence la langue d'oc, la langue qui se parle dans le sud de la France actuelle. La grande époque des troubadours va des premières années du XII^e ou dernières années du XI^e siècle, jusque vers la fin du XIII^e siècle. Leurs poèmes ont été rassemblés plus tard à la fin du XIII^e et au milieu du XIV^e siècle, généralement en Italie, dans de grands manuscrits qui sont des anthologies. On y a vu l'exemple d'une poésie formelle, d'une poésie qui n'est pas une poésie du sujet.

Or, non seulement nous connaissons souvent leurs noms, non seulement ils font souvent allusion à des circonstances personnelles, non seulement ils s'adressent à des amis dont ils donnent le nom ou le surnom, non seulement ils se nomment parfois eux-mêmes dans leurs poèmes, mais encore dans les anthologies qui rassemblent leurs œuvres, le choix des poèmes de chaque troubadour est souvent précédé d'un récit de sa vie (*vida* en langue d'oc) et certains des poèmes sont dotés d'explications en prose expliquant les circonstances dans lesquelles le poème a été composé. Ils ont donc fait l'objet à leur époque même d'une lecture biographique. En outre le premier poème de chaque troubadour est précédé dans beaucoup de ces manuscrits d'une lettrine peinte représentant le poète. Ce n'est pas un portrait. Quand c'est un chevalier, son visage est caché par son heaume. Et ici, il est de dos. On voit là la différence entre cette époque et la nôtre. Aujourd'hui, où se produit ce retour du biographique, nous voulons voir la tête de celui ou de celle qui a écrit le livre. Sur la couverture des livres, dans les articles de presse qui lui sont consacrés, on voit la photo de l'auteur. Nous cherchons dans ses traits quelque chose que nous puissions mettre en rapport avec son livre. C'est la démarche même qui était critiquée, et à juste titre, il n'y a pas si longtemps, à ceci près que ceux qui la critiquaient étaient fort anxieux de voir leur photo sur leur livre et dans les journaux.

Mais les manuscrits des troubadours font tout autre chose. Ils font émerger du poème lui-même une figure du poète, grâce aux *vidas* et aux *razos*, qui sont de fausses biographies, grâce aux portraits des lettrines ornées, qui sont de faux portraits. Des faux qui sont pourtant si vrais! L'explication du poème est appelée *razo* (de *rationem*), parce qu'elle en rend raison. *Vidas* et *razos* comportent quelquefois des

éléments vérifiables et véridiques, mais souvent ils sont inventés de toutes pièces à partir du poème lui-même. C'est une lecture biographique, mais qui recrée une figure du poète à partir du poème. Le petit cavalier rouge qui nous montre le dos s'appelait Guillem de Cabestany et sa *vida* nous dit qu'il aimait la femme de son suzerain, Raymond de Castel Roussillon. Raymaond s'en aperçut, il l'emmena un jour chasser dans la forêt, le tua, prit son cœur, le rapporte, le fit cuire et à manger à sa femme. Il lui demanda ensuite si le mets lui avait plu et, sur sa réponse affirmative, lui révéla que c'était le cœur de son amant. La dame répondit qu'elle ne mangerait jamais rien de meilleur et elle se jeta par la fenêtre. L'histoire est entièrement fausse. Guillem de Cabestany a survécu à Raymond de Castel Roussillon. Mais sa légende, une des versions de l'histoire du cœur mangé, permet de comprendre son curieux portrait. Il est représenté de dos, parce qu'il aurait dû mieux respecter le secret de ses amours. Le début de la chanson dit: «Le doux tourment qu'amour me donne souvent». Dans cette chanson il dit qu'il ne peut pas voir sa belle autant qu'il le voudrait. Et la *vida* explique que c'est à cause de cette chanson que le mari s'est aperçu qu'il s'agissait de sa femme. Le portrait de dos signifie que, s'il est amoureux, le poète doit se dissimuler, rester anonyme. Le poème, qui tente de garder le secret, mais qui en dit trop, son commentaire, qui raconte complaisamment toute l'histoire, et le portrait, qui montre le poète en le dissimulant, disent à eux trois le paradoxe de tout poème, qui par sa seule existence divulgue ce qui est le plus intime, ce qui devait rester secret ou confidentiel.

Mais chaque fois, ce qui est révélé, ce n'est pas le poète: c'est la figure du poète telle que la modèle le poème. Dans combien de poèmes médiévaux l'auteur se nomme, plaisante sur son propre nom et donne de lui une image caricaturale dont nous ignorons si elle a le moindre rapport à la réalité. Comme Rutebeuf qui plaisante sur son sobriquet, dont il dit qu'il vient de rude et de bœuf, "parce que je suis comme un bœuf et que je rime rudement" et qui élabore à partir de lui une sorte de théorie de la poésie. Il se présente comme un misérable, donc il écrit misérablement, il est pauvre, donc il écrit une poésie pauvre et de son sobriquet, il tire une explication de son poème lui-même.

Je laisse de côté une autre approche, qui serait pourtant essentielle, celle de l'emploi que fait le Moyen Âge du mot "auteur". Il est de la même famille que "autorité". L'autorité, pour le Moyen-Âge, c'est ce qu'enseigne le passé. L'auteur renvoi au passé. Mais en

même temps on rapproche “auteur”, *auctor*, de *augere*, “augmenter”. L’auteur est celui qui recueille l’héritage du passé et qui l’augmente. Voici une citation de saint Bonaventure, maître général des franciscains et professeur de théologie, à la faculté de théologie de Paris au XIII^e siècle. Il passe insensiblement du simple fait d’écrire au fait d’être responsable, et d’être la source de ce qu’on écrit:

Il y a quatre façons de faire un livre, celui qui écrit les mots des autres sans rien ajouter ni rien changer, on l’appelle simplement scribe. Celui qui écrit les mots des autres en y ajoutant, mais non pas de son propre fond, c’est-à-dire qu’il va chercher d’autres écrits et il les rassemble, on l’appelle compilateur. Celui qui écrit les mots des autres et aussi des mots qui sont de lui, mais en laissant la part la plus importante à ceux des autres tandis que les siens propres ne sont que les annexes destinées à les éclairer (ma traduction est un peu lourde), on l’appelle commentateur, et non auteur. Celui qui écrit les mots des autres et aussi des mots qui sont de lui, mais de façon à ce que ses propres mots constituent la partie la plus importante, tandis que ceux des autres ne constituent que des annexes à titre de confirmation, on doit l’appeler auteur.

Ainsi la personnalité intellectuelle se dégage-t-elle de plus en plus jusqu’à aboutir à un auteur, mais la source, le substrat intellectuel sur lequel écrit cet auteur n’est jamais oublié. Et à juste titre. Personne n’a la science infuse qui permettrait d’écrire à partir de rien et il y a toujours un continuum. Enfin, à la fin du Moyen Âge, il se crée une confusion entre l’auteur et l’acteur, celui qui agit (*augere*). L’acteur existe: il s’agit et parle sous nos yeux. Mais il n’existe pas: il joue un personnage. Et l’auteur?

Je voudrais enfin revenir, en guise de conclusion, à l’anonymat romantique. Qu’en est-il de la figure d’auteur dans des poèmes qui généralement n’en n’ont pas, comme les chansons de geste? Elle est ambiguë, mais elle existe et il est difficile de s’en débarrasser. Le dernier vers de la *Chanson de Roland*, la plus ancienne chanson de geste, est le suivant: *Ci falt la geste que Tuoldus declinet*, “Ici se termine la geste que Tuold *décline*”. Mais que veut dire *declinet*? “Finir”? C’est une tautologie. Est-ce que Tuold est le copiste, l’auteur de la chanson qu’on vient de lire, l’auteur dont s’est inspiré l’auteur de cette chanson? On ne sait. Un autre exemple, moins connu, est assez frappant, celui du jongleur, Bertrand de Bar-sur-Aube, dans le nord-est de la France, à la limite de la Champagne et de la Lorraine. On lui attribue de façon certaine la chanson de geste de *Girart de Vienne*.

Mais d'autres chansons prétendent avoir été aussi composées par lui. Et on le cite ailleurs comme un jongleur qui connaissait beaucoup de chansons de geste. On ne dit pas qu'il les avait composées, mais qu'il les connaissait. Au début de *Girart de Vienne*, la chanson le montre en train de la chanter, comme un personnage du poème dont il est l'auteur. Cette mise en scène du jongleur est assez fréquente. L'entrée en matière de presque toutes les chansons de geste est de ce genre: "Écoutez, je vais vous chanter une chanson. Elle est vraie. Les autres jongleurs la chantent mal, mais moi, je vous raconte l'histoire comme elle s'est vraiment passée, etc.". Mais les chansons de geste sont des poèmes qui présentent de nombreuses variantes d'un manuscrit à l'autre. Et un des manuscrits de celle-ci ajoute: la preuve que la chanson dit vrai, c'est que cette histoire s'est passée il y a plusieurs siècles et que Bertrand de Bar-sur-Aube qui vous la chante, y était, qu'il était un ami du héros, etc. Il y a là, bien entendu, une impossibilité manifeste, une contradiction absolue. Si Bertrand de Bar-sur-Aube vivait à l'époque carolingienne où se passe l'histoire, il ne pouvait pas vivre à la fin du XIIe siècle, quatre siècles plus tard, quand la chanson a été composée. Mais ce que suggère cette invention naïve, c'est ce que suggèrent aussi le portrait de Guillem de Cabestany et les récits sur les troubadours. La figure du poète existe, mais elle est le produit du poème. Le poème précède le poète.

À ce propos, une conversation que j'ai eue hier avec mon cher confrère, Monsieur le Président honoraire de l'Académie Kosovar, Rexhep Ismajli, m'a donné envie de citer pour finir quelqu'un qui lui fera plaisir. C'est Cioran, dans *La Tentation d'exister* – le titre est en lui-même une invitation à l'anonymat: "Point d'œuvre qui ne se retourne contre son auteur, le poème écrasera le poète." Cette formule est citée en 1957, donc à l'aube même du structuralisme, par le poète Alain Bosquet dont nous parlions hier et que, cher confrère, vous avez si bien connu. Il la cite en épigraphe à son *Premier testament* que devait suivre, en 1959, un *Deuxième testament*. Or le premier de ces poèmes ressasse l'impossibilité de nommer et donc de trouver une adéquation entre le poème et le monde ou une vérité du monde dans le poème. Et à la suite de la citation de Cioran, il a placé en épigraphe une seconde citation, de *Textes pour rien* de Samuel Becket: "Nommer, non, rien n'est nommable. Dire, non, rien n'est dicible." Cela correspond tout à fait à l'esprit de ses poèmes, de ces deux *Testaments* qui obéissent à une versification régulière, avec un contenu très déstabilisant sur l'impossibilité de nommer: "J'ai dit

“pomme” à la pomme. Elle m’a dit “mensonge”. On voit là à la fois l’effort pour publier l’intime, qui est le propre et le paradoxe de tout poète, qui expose ce qui devrait être secret, et en même temps cette affirmation que le poème est antérieur au poète, que le poème écrasera le poète, qu’il est impossible au poète de s’approprier les mots du poème pour qu’ils lui donnent un accès au monde. S’agissant d’Alain Bosquet, on peut mettre cette impossibilité en relation avec lui-même. Alain Bosquet est un pseudonyme. Il s’appelait en réalité Anatol Bisk. Alain Bosquet était un juif d’Odessa. Je ne sais pourquoi il a pris le pseudonyme d’Alain Bosquet, mais il se trouve qu’Anatole veut dire “l’oriental”, qu’Alain est un prénom germanique, que les Alains étaient un peuple scythe, qui venait des bords de la Mer noire, pas si loin d’Odessa. Et un “bosquet” en français, c’est un petit bois, c’est-à-dire un endroit où l’on peut se cacher. Si bien que ce poète a choisi de dissimuler son nom derrière un pseudonyme qui disait la dissimulation, en révélant son origine et en le mêlant en même temps, par ce prénom germanique, à ce qu’il y avait pour lui de plus dangereux, comme la suite des événements a pu le montrer. Ce poète français – parce que c’est un poète français, qui avait choisi d’être français, un poète français “de préférence”, comme disait Aragon – sans avoir besoin de battre la campagne comme je le fais avec pédantisme en allant chercher des poèmes du Moyen-Âge, avait compris que le poème révèle le poète, qu’on ne peut pas empêcher le poème de dire le poète, que l’effort pour gommer le poète est vain, mais que c’est le poème qui construit le poète.

Je vous remercie.

LA SUBJECTIVITE LITTERAIRE AU MOYEN ÂGE

Résumé

Cette conférence reprend le titre et la matière d'un livre publié il y a plus de trente ans, *La Subjectivité littéraire autour du siècle de saint Louis* (1985), en y ajoutant des considérations sur la relation entre l'auteur et l'œuvre au Moyen Âge.

Par subjectivité littéraire, on entend ce qui marque le texte comme le point de vue d'une conscience. Cette notion ne va pas de soi. La fin du XXème siècle a vu la mise en cause de la notion même d'auteur, le texte, dans une perspective structuraliste s'engendrant lui-même ("ça parle", "l'inconscient est structuré comme un langage") ou reflétant des impressions extérieures que seule l'illusion du sujet rapporte à son intériorité. La littérature du Moyen Âge, considérée alors comme un pur jeu sur les formes du langage, de la métrique ou du récit, semblait conforter cette vision. Mais les textes médiévaux eux-mêmes disent l'inverse, et n'est-il pas de bonne méthode de commencer par les écouter ? Il apparaît alors à l'évidence que la littérature médiévale, modelée par le christianisme, religion qui exige une adhésion personnelle, appelée à cette époque "conversion", fonde toute création de l'esprit sur la conscience de soi.

La relation de l'auteur à son œuvre est commandée par cette conception. Là encore, des idéologies plus récentes ont faussé un peu notre vision. Le romantisme, qui cherchait l'identité de chaque peuple dans les premières productions de son art et de sa poésie, supposait que ces productions étaient collectives et spontanées: l'anonymat d'une partie de la littérature médiévale lui fournissait un argument. Inversement, la théorie littéraire de la fin du XXe siècle revendiquait aussi cet anonymat, mais pour montrer que la notion d'auteur n'a pas de pertinence. En réalité, les auteurs médiévaux se nomment et se présentent souvent dans leur œuvre même. Mais ils mettent en scène une image d'eux-mêmes qui, il est vrai, est souvent une figure produite par l'œuvre même plus que la révélation d'une identité biographique.

Tryezë shkencore

PËR MIGRIMET

FJALË HYRËSE NË TRYEZËN PËR MIGRIMET

Është e njohur sidomos në shkencën demografisë dhe të sociologjisë se lëvizjet e popullsisë janë fenomen i zakonshëm. Nomaditeti i paraprin sesilitetit (ngulitjes), ndërsa faktorët që ndikojnë në inicimin dhe dinamizimin e tij janë të llojllojshëm. Shikuar historikisht kosovarët dhe shqiptarët përgjithësisht janë ballafaquar me rrethanat e shumta që e kanë vënë popullatën në levizje qofshin ato politike, ekonomike apo të ndonjë natyre tjetër.

Historia na mëson se sidomos pas vdekjes së Skenderbeut, popullata shqiptare nga hapësirat e sotme gjithëshqiptare u përfshi me dyndje të mëdha të individëve dhe familjeve. Gjurmët e këtyre dyndjeve nuk janë shlyer, meqë deri në ditën e sotme gjenden vendbanime mjaft vitale shqiptare në jugun italian. Edhe gjatë dominimit osman në këto treva, por sidomos pas tërheqjes së Perëndorisë Osmane, gjatë pushtetit të Mbretërisë SKS, kosovarët ishin në shënjestër të pushtetit dhe një numër shumë i madh i tyre u shpërngulën kryesisht në Turqi.

Në ish-Jugosllavi, pas Reformës Agrare, situata disi u ndryshua, mirëpo vitet '60-70-ta pothuajse i zbrazën tri enklavat shqiptare në Mal të Zi, ndërsa pas viteve të '80-ta edhe në Kosovë u shënua një rikthim i rrethanave të presionit politik, kërcënimit me agonalitet dhe nevojë të shtuar të ikjes nga Kosova. E tëra kulmoi me spastrimin etnik të viteve të fundit të shekullit XX dhe me rikthimin bibliq të popullatës shqiptare në Kosovë.

Iluzionet se pas largimit të pushtetit serb nga Kosova do të krijohet në Kosovë shoqëri e mirëqenies shpejt u humbën. Kosovarët, nga kërcënimet politike të fundshekullit, tani ndjenin kërcënimin ekonomik. Menaxhimi i keq i procesit të privatizimit, shpërdorimi i parasë publike, korrupsioni, nepotizmi etj. jo vetëm që e zbehën perspektivën dhe e shtuan dëshpërimin në shtetin më të ri, me popullatën më të re në Evropë, por e shtuan nevojën e ikjes nga Kosova e lirë, e që kërcënon me agonalitet.

Kur gjithë kësaj t'i shtohet edhe fakti se në Kosovë vazhdojnë të mungojnë investimet e pritshme të jashtme kryesisht për shkak të resurseve dhe fuqisë së re punëtore (kryesisht nga trajtimi i Kosovës si terren i pasigurt politik për shkak të gjendjes së rëndë në Veriun e Kosovës) dhe ngecja e përkrahjes së bashkësisë ndërkombëtare përtej fazës së emërgjencës, sidomos në rivitalizimin e potencialeve dhe asetëve ekonomike kombëtare, izolimi nga bota me mosliberalizimin e vizave etj. krijuan një gjendje që për shumë individë dhe familje u përjetua si e pashpresë. Viti 2015 shënon kulmin e ikjes nga Kosova, që s'do mend se na përkujton vitet e paraluftës. Emigrimi nuk është ndalur, por intensiteti i tij oscilon dhe është më spontan.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), ashtu siç ndodh zakonisht në situata kur dukuritë e caktuara marrin përmasa shqetësuese, edhe në këtë situatë ka reflektuar me një tryezë të debatit shkencor rreth fenomenit të riaktualizimit të emigrimit nga Kosova.

Seksioni i Shkencave Shoqërore, si pjesë e ASHAK-ut, me këtë rast ftoi dhe tuboi ekspertë, kryesisht të rinj, që në kumtesat e tyre prezantuan rezultatet e hulumtimeve të veta, hulumtime dhe qasje këto të reja, me metodologji dhe fakte empirike të mbështetura në realitetin shoqëror dhe në shkencë, pa u mjaftuar që të mbesin në nivelin teorik të fenomenit.

Në vazhdim lexuesit do të kenë mundësi të njihen me përmbajtjet e kumtesave të pjesëmarrësve, që fillojnë me: *“Push” dhe “Pull” faktorët në migrimet e jashtme të Hivzi Islamit*, ku autori fokusohet në faktorët që individin apo grupin e shtyjnë të emigrojnë, por në rrethana të teknologjisë së avansuar të informimit dhe kontakteve të shpeshta me të emigruarit, edhe të sfidohet për të emigruar. Fjala është për faktorët që i paraprijnë, e inicojnë një proces të lëvizjes së popullatës. Për nga natyra e fenomenit, këta faktorë janë të shumtë dhe tepër specifike varësisht nga vendi, rrethanat qofshin ato të fatkeqësive elementare, të shterrimit apo mungesës së resurseve jetësore, politike, ekonomike, kulturore etj.

Arsim Canolli me kumtesën: *“Janë zhdjergë në shehër” – një pamje etnografike e migrimit të brendshëm fshat-qytet në Kosovë*”, ofron një qasje për lëvizjet e brendshme të shoqërisë kosovare. Dyndja e popullatës rurale në drejtim të qendrave urbane, në mënyrë spontane krijon problem të funksionimit të qendrave urbane, sidomos të kreyeqendrës për të siguruar një jetë të organizuar dhe normale. Sfidimi me qendrat urbane sa për të siguruar vendin e punës, sa për t'u

arsimuar në institucionet e arsimit të lart, sjell pasoja që manifestohen në ndryshimin e stilit të organizimit të jetës, ristrukturimit dhe shkapërderdhjes së familjeve të mëdha rurale.

Lumnije Kadriu me kumtesën “*Diaspora shqiptare e Kosovës brenda përkufizimeve të diasporës dhe transnacionalizmit*” ofron një qasje relativisht të re të konceptualizimit të diasporës në sensin e përkufizimeve të transnacionalizmit. Autorja e kumtesës hyn në trajtime moderne teorike të koncepteve, që diasporën e përkufizojnë si resurs nacional që u dëshmuar edhe me rastin e Kosovës, por edhe si kontigjent njerëzor që i nënshtrohet procesit të integritit dhe fazave që shpjen gjer te asimilimi.

Ibrahim Ramadani e Valbon Bytyci në “*Analizë gjeografike e zonave migruese në regjionin lindor të Kosovës*” përqendrohen në rrjedhat e proceseve të migrimit në regjionin lindor të Kosovës, që cilësohet si regjion kufitar, mjaft pasiv dhe me gjasa të vogla për krijimin e perspektivës së jetës në absorbimin e fuqisë së re punëtore.

Denis Nushi, “*Migrimi/mobiliteti dhe identitetet hibride të diasporës*” shquhet me interpretime të ndërthurura teorike dhe të përvojës reale të autorit. Autori, si dëshmitar i rrjedhave dhe i proceseve të migrimeve, mobilitetit të migrantëve dhe krijimit të identiteteve hibride të diasporës ofron një qasje interesante për perspektivën e diasporës në ambientet e reja emigruese.

Shemi Krasniqi në kumtesën “*Kujtesa dhe rrëfimet mbi eksodin e vitit 1999*” e ruan dhe e rikujton të gjallë situatën e krijuar të shpërnguljes masive të kosovarëve para dhe gjatë luftës në Kosovë. me një mostër imponante, të përzgjedhur sipas kritereve të metodologjisë shkencore, autori ofron rrëfimet dhe kujtimet e gjalla vetanake dhe të kujtesës kolektive.

Arsim Ejupi në “*Migrimet e jashtme në Luginën e Preshevës - faktorët përcaktues dhe efektet*” paraqet një problematikë që gjithsesi e kompletton mozaikun migrues të popullatës kosovare. Lugina e Preshevës si vis me popullatë dominuese shqiptare, shumë heret ka filluar të përballlet me situata që jetën e shtynë nën presionin e “push faktorëve”. Jo vetëm konflikti në Kosovë, por edhe fërkimet e vazhdueshme ndëretnike në ish-Jugosllavi kësaj popullate i kanë sjellë probleme të mbijetesës sidomos në aspektin e ekonomizimit, arsimimit dhe avansimit të formave të ruajtjes së identitetit etnik.

Tahir Latifi në “*Migrimi dhe familja transnacionale: roli i remitencave në ruajtjen e kohezionit social në familjen kosovare*” i

prekë motivet, esnecën dhe pasojat e fenomenit të migrimit si proces. Migrimet si dukuri qofshin ato të motivuara politikisht, ekonomikisht apo kulturalisht, në esnecë, sidomos për kosovarët, kishin dhe vazhdojnë të kenë karakter të veçantë që manifestohet edhe në kohezionin social të familjes. Vitet e 90-ta, si vite të deinstitutionalizimit të popullatës shqiptare në Kosovë, e kanë dëshmuar më së miri kuptimin dhe rëndësinë e “investimit” në strukturën familjare dhe përgjithësisht farefisnore të kosovarëve.

Anton Kolë Berishaj

Hivzi Islami, Prishtinë

PUSH-PULL FAKTORËT NË MIGRIMET E JASHTME - QASJET TEORIKE DHE RASTI I KOSOVËS

Abstrakt

Migrimet e popullsisë dhe brenda tyre migrimet e jashtme ishin përcjellëse permanente në evolucionin e përgjithshëm demografik, social, material, kulturor dhe mendor të njerëzimit dhe faktor kyç në zhvillimin e popullatave njerëzore si dhe fenomen shumë i rëndësishëm në jetën e individit, të familjes, të grupeve të ndryshme të popullsisë dhe të popujve e të qytetërimit të tyre në përgjithësi. Megjithë këtë ndikimin të madh që kanë ushtruar gjatë gjithë historisë dhe ushtrojnë edhe sot e gjithë ditën në planin lokal, rajonal dhe global, migrimet e popullsisë nuk u hulumtuan sa duhet, gjë që vërehet nga instrumentariumi shkencor, dimensionin metodologjik i studimit dhe burimet e të dhënave. Munguan veçanërisht qasjet teorike, ligjësitë dhe përgjithësimet shumë të rëndësishme për hulumtimet komparative e të tjera. Pas G. Ravenstein-it në fund të shek. XIX (1895), që përcaktoi disa “ligje” dhe “përgjithësime” përmes studimit të të dhënave për migrantët për vitin 1881 në Angli dhe më vonë në disa vende të tjera deri në vitet e 60-ta të shek. XX, kur paraqitet teoria e Pull dhe Push faktorëve kishte një vakuum të madh në shqyrtimin teorik të migrimëve.

Teoria e migrimëve dhe hulumtimet empirike të kësaj dukurie shpjegojnë se migrimet e jashtme përcaktohen nga shumë faktorë, reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar, të përmbledhur në faktorë repulsivë (Push) dhe në faktorë atraktivë (Pull) ose të karakterit ekonomik, politik, historik, fetar, racial, klasor etj., ndër të cilët në vendimin e individit për të marrë pjesë në procesin e migrimit njëri është kryesor. Meqenëse bota është hapur shumë, ka dhe shkaqe të tjera të natyrës individuale-psikologjike. Brenda hapësirës evropiane pas themelimit të Bashkësisë Ekonomike Evropiane (1957) procesin e migrimit të punëtorëve jashtë atdheut e mundësuan dallimet midis zhvillimit të hovshëm ekonomik dhe rritjes demografike, por edhe normalizimit të raporteve politike midis vendeve evropiane. Pas shembjes së sistemit komunist u intensifikuan migrimet e miliona njerëzve nga vendet e lindjes drejt vendeve të perëndimit, selektive sipas disa katakteristikave dhe të përcjella me shumë vështirësi e probleme (ksenofobia, humbjet ekonomike, demografike, sociale e të tjera) në vendet emigruese dhe vendet e ngulitjes. Tipi i “migrimëve intelektualë”, i njohur si “migrim i truve”, paraqet një humbje të konsiderueshme për vendet eksportuese të fuqisë punëtore.

Për shkak të rrethanave repulsive në Kosovë, çfarë janë moszhvillimi ekonomik, papunësia, dendësia e madhe agrare, rritja e vazhdueshme e kontingjentit

të popullsisë aktive, por edhe motivet e tjera të natyrës familjare, individuale, të prestigjit etj., edhe Kosova nga fillimi i viteve të 70-ta të shek. të kaluar u përfshi intensivisht në rrjedhat migruese brenda hapësirës evropiane, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër. Përrjashtuar eksodin masiv dhe deportimin e rreth 1 milion shqiptarëve nga regjimi i Millosheviqit në vitin 1999, nga fundi i vitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015 në Kosovë ndodhi një fenomen i paparë deri atëherë: migrimi ilegal i më se 100.000 personave! Si pjesë e shoqërive në tranzicion dhe si pjesë e krizës së migrantëve, problemi kosovar nuk dukej alarmant në raport me valët e migrimit (më se 1 milion) nga Siria, Avganistani, Iraku etj. Përveç rrethanave të përmendura repulsive, duket se janë matrapazët dhe grupet e krimit të organizuar në Kosovë-Serbi-Hungari dhe mungesa e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës në truallin evropian që ndikuan në këtë dukuri. Veprimi i këtyre grupeve ishte më i pranishëm në Prishtinë me rrethinën e gjerë e më pak p. sh. në Gjakovë me rrethinë, ku ka më shumë probleme ekonomike. Është e vërtetë se shumë vende (Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, BeH e të mos flasim për Bullgarinë, Rumaninë, Ukrainën e Gjeorgjinë) nuk e kanë plotësuar asnjë kusht për liberalizim të vizave në kuptimin çfarë e kërkon BE-ja nga Kosova. Megjithatë, ka gati dy vjet që BE-ja ka ofruar liberalizimin e vizave, duke kërkuar nga Kosova që ta zgjidhin problemin e demarkacionit me Malin e Zi si kusht kryesor, derisa lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë një proces. Këtë çështje, mjerisht individë shqiptarë, profiterë politikë dhe grupet e interesit e kanë shndërruar në agjendë politike, duke e mbajtur peng gjithë Kosovën dhe qytetarët e saj.

Fjalët çelës: migrimet e jashtme, teoria e migrimeve, faktorët repulsivë (Push), faktorët atraktivë (Pull), ksenofobia, “migrimi i truve”, migrimi ilegal, trafikantët, grupet e krimit të organizuar, liberalizimi i vizave.

Migrimet si fushë tradicionale e shkencës mbi popullsinë dhe shkencave tjera sociale kurrë nuk ishin procese spontane dhe autonome, sikundër që nuk janë as sot, ndonëse kanë ndryshuar motivet, drejtimet, distanca hapësinore, selektiviteti, efektet e tyre për zhvillimin demografik dhe jetën shoqërore-ekonomike etj. Brenda lëvizjeve hapësinore, migrimet e jashtme, të njohura si migrame ndërkombëtare (midis vendeve) kanë një historik më të gjatë dhe për shumë rrjedha dhe karakteristika janë më të ndërlikuara se migrimet e brendshme (brenda një shteti), për nga distanca territoriale më të gjata, më të shtrenjta dhe bartin pasiguri dhe rreziqe të ndryshme.¹ Ky tip i

¹ M. Sorre, *Les migrations des peuples* (Essai sur la mobilité géographique), Flammarion, Paris, 1955, pp. 9-18 e tutje; A. Sauvy, *Théorie générale de la population, Volume II, La vie des populations*, Troisième édition entièrement refondue, Presses universitaires de France, Paris, 1966, pp. 250-266; L. Dollot, *Les migrations humaines*, PUF, Que sais-je?, Paris, 1976, pp. 73-99; *Les migrations internationales*, CICRED, *Actes du séminaire sur la recherche*

migrimeve përcillet dhe nga fazat e adaptimit, integritit dhe asimilimit në mjedisin e ri natyror dhe sociokulturor, ndërsa nostalgjia e migrantëve mbetet komponent përcjellës i të gjitha fazave. Migrimet e jashtme janë intensifikuar veçanërisht pas zbulimeve të mëdha gjeografike dhe popullzimit të “Botës së re”, të përshpejtuara me revolucionin teknik dhe zhvillimin e komunikacionit, si dhe me ndryshimet e mëdha në sferën mendore dhe materiale të njerëzimit.²

I

Është tashmë fakt i njohur në shkencë se migrimet dhe veçanërisht migrimet e jashtme definitive luajtën një rol të madh pozitiv në evolucionin e përgjithshëm demografik dhe shoqëror të njerëzimit para së gjithash në ndryshimin e strukturës së popullimit dhe të zgjerimit etniko-demografik të ekumenës e të hartës populatave të botës dhe rrjedhimisht të krijimit të diasporave (përfshirë edhe diasporën shqiptare),³ pastaj në përhapjen dhe këmbimin e përvojave dhe kulturave të bashkësive të ndryshme njerëzore, duke u bërë në epokën bashkëkohore edhe determinant i fuqishëm i transformimit të lëvizjes dhe të strukturës së popullsisë e mënyrës së jetesës së njerëzve përgjithësisht. Megjithatë, pati ngecje teorike dhe empirike në hulumtimin e kësaj dukurie masive shoqërore dhe ngjarje të rëndësishme në hapësirë dhe kohë, në shumëdimensionalitetin e saj për një kohë të gjatë (vëllimi, shkaqet, pasojat, selektiviteti, adaptimi, asimilimi etj.) si në territorin emigrues, ashtu edhe në hapësirën imigruese, në të gjitha vendet, veçanërisht në ato të pazhvilluara. Kjo vërehet qartë në mungesën e instrumentariumit shkencor, dimensionit metodologjik të studimit dhe burimit të të dhënave.

démographique en liason avec les migrations internationales, 5-11 mars, Buenos Aires (Argentina), 1974.

² Më gjerë shih: M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Histoire générale de la population mondiale*, III éd., Éditions Montchrestien, Paris, 1968, pp. 9-22; A. Sauvy, *Po aty*, pp. 250-266; *Théorie générale de la population, Volume II, La vie des populations*, Troisième édition entièrement refondue, Presses universitaires de France, Paris, 1966, pp. 250-266; D. J. Bogue, *International Migration, The Study of Population*, The University of Chicago Press, Chicago, 1972, pp. 1-864; H. Islami, *Aspekti etnik i migrimeve (Shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme)*, ASHAK, 2012. ff. 17-26.

³ H. Islami, “La diasporas d’un peuple méditerranéen: le cas des Albanais”, *Peuples Méditerranéens*, No 15, Av ril-Mais 1981, pp. 73-84.

Munguan veçanërisht qasjet teorike, ligjësitë dhe përgjithësimet shumë të rëndësishme për hulumtimet komparative. Autori i parë i përcaktimit të ligjësive dhe përgjithësimeve të migrimeve në fund të shekullit XIX ishte G. Ravenstein (1895). Ai përcaktoi disa “ligje” dhe “përgjithësime” përmes studimit të të dhënave për migrantët për vitin 1881 për Angli dhe më vonë për disa vende të tjera, para së gjithash për Amerikë dhe Evropë, duke nënvizuar në radhë të parë rëndësinë midis migrimeve dhe zhvillimit ekonomik si determinant më i fuqishëm në motivimin për lëvizje në hapësirë.⁴ Sipas Ravenstein-it “ligjet” e migrimit përmbledhen në këto pika: pjesa dërmuese e migrantëve lëvizë në distanca të shkurtëra territoriale; me rritjen e distancës zvogëlohet numri i migrantëve; femrat lëvizin më shumë në distanca të shkurtëra, ndërsa meshkujt në distanca më të gjata; më shumë lëvizë popullsia rurale dhe më pak popullsia autoktone e qytetit; migrimet zhvillohen në atapa: gjatë ekspansionit ekonomik migrojnë personat që jetojnë afër vendbanimeve të mëdha, pastaj migrojnë edhe banorët nga vendet e largëta; çdo rrjedhe migruese i përgjigjen kundërrjedhat; zhvillimi teknologjik ndikon në shkallën e migrimit; pjesa më e madhe e migrantëve është e moshës së rritur, ndërsa familje të tëra rrallë migrojnë; drejtimi kryesor i migrimeve është në rajonet bujqësore – qendrat industriale dhe tregtare; qytetet e mëdha shënojnë rritje më të madhe demografike nga migrimet sesa nga shtimi natyror i popullsisë; në lëvizje migruese dominojnë motivet ekonomike etj.⁵

Nga fundi i shekullit XIX e deri në vitet e 60-ta të shekullit XX, kur paraqitet një qasje e re teorike e shqyrtimit të migrimeve të popullsisë kaloi një kohë e gjatë, ndërkaq procesi i migrimeve kishte marrë dimensione të gjera si në vëllim, ashtu edhe sa i përket kontekstit strukturor (distanca hapësinore, motivet, efektet etj.). Kjo është teoria e faktorëve të jashtëm apo ekzogjenë, pra e faktorëve tërheqës (*Pull Factors*) dhe teoria faktorëve të brendshëm, pra e faktorëve refuzues (*Push Factors*);⁶ ose në frëngjisht *les facteurs de répulsion* apo *d’expulsion* dhe *les facteurs d’attraction*.⁷ Në vitet e 60-ta e më vonë shumë autorë, që u morën me problemin e migrimeve të popullsisë, bënë

⁴ G. E. Ravenstein, “The Laws of Migration”, *Journal of the Royal Statistical Society*, 48, VI, London, 1895, pp. 167-227.

⁵ G. E. Ravenstein, *Po aty*.

⁶ D. Bogue, *Principles of Demography*, J. Willey and Sons, New York, 1969, pp. 755-756.

⁷ P. Baud, S. Bourgeat, C. Bras, *Dictionnaire de géographie*, Hatier, Paris, 1997, p. 247.

analiza dhe plotësime të teorisë së Ravenstein-it, si p. sh. E. S. Lee, i cili dalloi disa grupe të determinanteve që ndikojnë në vendimin e individit për të marrë pjesë në procesin e migrimit. Ai bëri “rindërtimin” e modelit tashmë të akceptuar të Ravenstein-it, të push – pull faktorëve të tij, duke insistuar që migrimi dhe vendimi i individit që të migrojë të vështrohen duke marrë parasysh një varg të tërë të determinanteve reciprokisht të lidhura dhe të kushtëzuara, të cilat i përmbledh në faktorë pozitivë (+), negativë (-) dhe në ata neutralë apo indiferentë. Autori këtu i jep shumë rëndësi faktorëve të ndryshëm individualë dhe vështirësive (tradita, shteti, distanca hapësinore, mundësitë e lëvizjes, kufizimi administrativ i lëvizjes etj.) që ndodhin në lëvizjen midis vendit të nisjes dhe vendit të ngulitjes definitive të migrantit.⁸

Pak më vonë doli teoria e re e “transicionit migrues” të autorit të njohur W. Zelinskit. Ky autor për migrimet e popullsisë flet si për “transicionin e mobilitetit hapësinor të popullsisë”, të marrë nga nocioni i njohur i teorisë së transicionit demografik, që e shpjegon zhvillimin e popullsisë nëpër etapa të caktuara të zhvillimit shoqëror-ekonomik. “Transicionin migrues” ky autor e shpjegon si proces historikisht të kushtëzuar, të ndikuar nga determinantet e njëjta sikurse edhe të procesit të transicionit të treguesve vitalë (lindshmërisë dhe vdekshmërisë). Autori i idesë së transicionit mbi migrimet e popullsisë dallon pesë faza: *shoqëria tradicionale*, paramoderne, cilësohej nga tipi i migriimeve kryesisht të kufizuara; *shoqëria e transicionit të hershëm*, që e karakterizon migrimin masiv në drejtim fshat – qytet; *shoqëria e transicionit të vonshëm*, ku migrimi fshat – qytet zëvendësohet me “migrimin rrethor”; *shoqëria e zhvilluar* me dominimin e tipit të migriimeve interurbane dhe *shoqëria shumë e zhvilluar* karakterizohet me migriime tipike për këtë shoqëri, ku i tërë migrimi është interurban dhe intraurban.⁹

⁸ E. S. Lee, *A theory of Migration, Demography*, 3, Chicago, 1966, pp. 47-57.

⁹ W. Zelinski, *The Hypothesis of the Mobility Transition, Geographical Review*, vol. 61, New York, 1971, pp. 219-249.

Të gjitha format dhe tipet e migriimeve të popullsisë, nga ato parahistorike dhe migrimet e epokës sonë dhe veçanërisht migrimet e kohës moderne mund të përmbliidhen në *mobilitet horizontal* ose *hapësinor*, që manifestohet në lëvizjen e popullsisë nga një territor në tjetrin dhe në *mobilitet vertikal* ose *social*, që është më kompleks dhe manifestohet në ndërrimin e veprimtarisë dhe të profesionit. Këto forma të mobilitetit të popullsisë shpeshherë gërshetohen ndërmjet vete sidomos përmes migrimit të fuqisë punëtore dhe në veçanti të lëvizjes ditore të fuqisë punëtore, karakteristikë për kohën pas revolucionit klasik industrial dhe sidomos në kohën bashkëkohore kur u krijuan mundësitë e

Nga teoria e migrimeve¹⁰ dhe hulumtimet empirike mësohet se në migrimet ndërkombëtare ndikon një varg i tërë i faktorëve të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar, ku në një anë janë, siç theksuam, push faktorët (repulsivë) dhe në anën tjetër pull faktorët (atraktivë). Skema e përgjithshme e determinanteve të këto migrime në dy drejtimet mund të përmblihet në ato të natyrës ekonomike, politike, historike, fetare, raciale, klasore etj. Në vendimin e individit për të marrë pjesë në procesin e migrimit njëri nga këta determinantë është pothuajse kryesor. Por në rrethana të hapjes së botës dalin edhe shkaqe të tjera të natyrës individuale-psikologjike, çfarë janë shkuarja pas fatit në vend të panjohur veçanërisht i të rinjve, dëshira për t'i njohur vendet e huaja dhe për udhëtime në vendet perëndimore, ëndrrat dhe shpresat për një jetë më të mirë, pastaj motivet e ndryshme familjare, aventuriere etj. Migrimet për këto motive janë veçori e të gjitha vendeve, të pazhvilluara dhe të zhvilluara, të popullatave të vendeve deri dje të izoluara në pikëpamje fizike, sociale dhe kulturore (kryesisht të vendeve ish-komuniste) dhe popullatave të vendeve të hapura tashmë një kohë të gjatë.

II

Në pjesën e dytë të shekullit XX në Evropë dhe, më gjerë, në botë ndodhën ndryshime të mëdha ekonomike, sociale, politike, kulturore etj., ku u intensifikua edhe mobiliteti hapësinor dhe social i popullsisë dhe kryesisht i pjesës së saj aktive, i fuqisë punëtore. Edhe pse lëvizja territoriale e popullsisë në kërkim të punës është relativisht e vjetër, e manifestuar në një formë të caktuar dhe në shoqërinë agrare dhe veçanërisht në vendet e zhvillimit të hershëm të kapitalizmit dhe akumulimit të kapitalit, migrimi me motiv të punës dhe vëllimi i migrantëve qenësisht dallon nga çdo mobilitet i mëparshëm. Rrjedhën e migrimit të “proletariatit” jashtë atdheut e mundësoi jo vetëm disproporcioni midis zhvillimit të hovshëm ekonomik dhe rritjes demografike, por edhe tejkalimi i mosmarrëveshjeve dhe normalizimi

lëvizjes së tillë hapësinore (infrastruktura rrugore, mjetet e transportit etj.). Shih më gjerë: J.-P. Ferrier, *Le contrat géographique ou l'habitation durable des territoires*, Antée 2, Sciences humaines, Editions, Payot Lausanne, 1998, pp. 28-29; A. Beltramone, *La mobilité géographique d'une population*, Coll. Tech. Écon. modernes, Paris, 1966; R. Pressat, *Dictionnaire de démographie*, Presses universitaires de France, Paris, 1979, pp. 118-124; P. Baud, S. Bourgeat, C. Bras, *Dictionnaire de géographie*, Hatier, Paris, 1997, pp. 240-247.

¹⁰ E. S. Lee, *A theory of Migration*, *Demography*, 3, Chicago, 1966, pp. 47-57.

i raporteve politike midis vendeve evropiane dhe integrimi i tyre në një union.

BEE-ja (Bashkësia Ekonomike Evropiane), të cilën e themeluan Franca, Italia, Gjermania Federale, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu, që nga formimi në vitin 1957 kishte paralajmëruar “qarkullimin e njerëzve, të shërbimeve dhe të kapitalit”, ndërsa në vitin 1970 kishte proklamuar “qarkullimin e lirë të punëtorëve” brenda gjashtëshes evropiane dhe jashtë saj.¹¹ Deri në vitin 1974 brenda BEE-së, përfshirë edhe Zvicrën, kishin hyrë tashmë rreth 12 milion punëtorë të huaj dhe anëtarë të familjeve të tyre.¹² Pas përfundimit të “luftës së ftoftë” dhe rënies së komunizmit u intensifikuan migrimet e miliona njerëzve nga vendet e lindjes drejt vendeve të perëndimit. Ky proces po vazhdon, por i reduktuar dhe selektiv sipas disa veçorive, duke bërë përpjekje vendet imigruese për ta vënë nën kontroll.

Përbërja sociale-demografike e migrantëve jashtë vendit të origjinës, që nga fillimi i instalimit në vendet e huaja i përkiste kontingjentit të punës (grupmoshave 19-45 vjet dhe kryesisht të gjinisë mashkullore), pastaj potencialit riprodhues, punëtorëve të kualifikuar ose të rikualifikuar për vendet e punës të shteteve imigruese. Meqenëse tregu i punës së vendeve importuese të fuqisë punëtore është më mirë i organizuar sa i përket kushteve të punës dhe fitimeve të migrantëve, në shtetet e punës vjen edhe një pjesë e fuqisë punëtore e cila është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për ekonominë dhe shoqërinë e vendeve emigruese. Gjithashtu duhet vënë në pah edhe faktin se në këto lëvizje imigruese të fuqisë së huaj punëtore në vendet importuese të këtij “proletariati”, përveç dobive të mëdha materiale e financiare shkaktohen edhe probleme e implikime të përcjella me ksenofobinë ndaj migrantëve të huaj. Duke ardhur nga një sistem shoqëror dhe kulturor në tjetrin, imigranti i punës bie në konflikt me shumëçka në mjedisin dhe universumin e ri, duke u ballafaquar me shumë të panjohura dhe probleme. Vështirësitë e para janë mosnjohja e gjuhës dhe e kulturës së vendit imigrues, tradita, strukturimi institucional i shoqërisë, normat ligjore etj. Gjithnjë ndjehet i përbuzur, inferior, i dyshimtë për gjithçka që ndodh keq aty ku ai sillet, i frikësuar se po përcillet në çdo kënd nga sigurimi e policia dhe do të burgoset, do të ndiqet nga vendi, duke mos i

¹¹ H. Çelik, Les travailleurs immigrés parlent, *Les Cahiers du Centre d'Etudes Socialistes*, No 94-95, Paris, 1969, p. 9 e tutje.

¹² *Hommes et Migrations*, Documents No 856/1974, p. 4.

ditur as të drejtat e veta për t'u mbrojtur etj.¹³ Ka qarqe politike e të tjera brenda BE-së që janë kundër migrantëve të huaj, veçanërisht kundër migrantëve ilegalë; kritikata e tyre i arsyetojnë me faktin se të huajt po i ngarkojnë fondet sociale dhe shërbimet publike, se kriminaliteti është më i madh te ata sesa te vendorët, se po u zënë vendet e punës punëtorëve të vendit etj. Pas ardhjes masive të migrantëve nga Siria, Afganistani, Irani, Iraku, vendet e Afrikës etj.,¹⁴ midis të cilëve edhe rreth 100.000 kosovarë pas vitit 2014 e këndeje u rrit ksenofobia edhe më tepër.

Humbjet dhe dobittë ekonomike, demografike, sociale e të tjera janë të ndryshme për vendet emigruese dhe vendet imigruese.¹⁵ Në kuadër të migrimit ekonomik të fuqisë punëtore, të ofertës dhe të kërkesës për punë, midis vendeve të pazhvilluara dhe vendeve të zhvilluara janë migrimet selektive si një veçori e posaçme, përkatësisht lëvizjet migruese të punëtorëve me kualifikime të larta (shkencëtarë, inxhinjerë, quadro teknike, mjekë etj.), që njihen si “migrim i truve” (anglisht “brain-drain”; frëngjisht “l'exode des cerveaux”). “Migrimet intelektuale” kanë marrë hov pas viteve të 70-ta të shekullit XX dhe për vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim si eksportues kryesor i “migrimit të truve” në vendet e zhvilluara; ky tip i migrimit paraqet një humbje të madhe të kapitalit njerëzor. Ky problem është trajtuar në hollësi në tubime shkencore ndërkombëtare dhe në raste të tjera.¹⁶ Dhe më keq: “brain drain” është një rrugë njëkahëshe, ndërsa shumë më produktive “është që të jetë rruga dykahëshe”.¹⁷

¹³ *Le travailleur étranger*, Paris, 1967; A. Girard, Attitudes des Français à l'égard de l'immigration étrangère, *Population*, No 5, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1971.

¹⁴ Vetëm në Gjermani u instaluan mbi një milion imigrantë nga këto vende brenda një viti.

¹⁵ “Në literaturën ekonomike migrimi ndërkombëtar është konsideruar përgjithësisht proces pozitiv, i cili ka mundësuar zhvillimin e shumë vendeve sot të zhvilluara, veçanërisht të vendeve përtej oqeanit dhe ka hapur mundësi të reja të punësimit dhe realizimit të fitimeve më të mëdha të miliona njerëzve në botë” (A. Wertheimer-Baletić, *Stanovništvo i razvoj*, MATE, Zagreb, 1999, f. 323).

¹⁶ *Les migrations internationales*, CICRED, Actes du séminaire sur la recherche démographique en liason avec les migrations internationales, 5-11 mars, Buenos Aires (Argentina), Mars 1974; P. Visaria, The Determinants of “Brain Drain”, Proceedings of a Seminar Demographic Research in Relation to International Migration, Buenos Aires, March, 1974; J. Bhagwati, The Reverse Transfer of Thechnology (Brain Drain): International resource floë Accounting, Compensation, Taxation, UNCTAD, Geneva, 1978.

¹⁶ J. Županov, “Gubitak ljudskih resursa i kulturnog kapitala zbog iseljavanja”, *Nacionalni program demografskog razvitka*, Ministarstvo razvitka i obnove, Zagreb, 1997, f. 104.

¹⁷ J. Županov, *Po aty*, f. 104.

III

Zgjerimi i Unionit Evropian në fillim të shekullit XXI kryesisht drejt lindjes¹⁸ përcillet nga një frikë pikërisht për shkak të imigrimit masiv të njerëzve nga vendet e Lindjes në vendet e UE, përkatësisht të destabilizimit të tregut të punës në këto të fundit.¹⁹ Qarqet politike e të tjera që janë kundër migrantëve të huaj (ksenofobia), veçanërisht migrantëve ilegalë kritikohet dhe tyre i arsyetojnë me faktin se të huajt po i ngarkojnë fondet sociale dhe shërbimet publike, se kriminaliteti është më i madh te ata sesa te vendorët, se po u zënë vendet e punës punëtorëve të vendit etj. Te procesi i zgjerimit të BE-së vërehet dhe një paradoks: në një anë hapet me tempo tepër të ngadalësuar, por në anën tjetër mbyllet! Mbyllja ndaj disa vendeve kushtëzohet kryesisht nga domosdoshmëria që rrjedhat migruese të vihen nën kontroll. Prandaj edhe kushtet dhe kriteret për integrimin e vendeve të reja në BE, veçanërisht të vendeve të Ballkanit Perëndimor gjithnjë u ashpërsuan.²⁰ Këtu më e goditur doli Kosova, të cilës i vënë kushte të posaçme, që nuk iu vunë asnjë vendi (demarkacioni me Malin e Zi etj.).

Kosova si pjesa më e pazhvilluar e Ballkanit dhe e Evropës nuk mbeti e papërfshirë në procesin e emigrimit të fuqisë punëtore në vendet e zhvilluara evropiane, edhe pse pak më vonë se njësitë e tjera të ish-Federatës. Shkaqet janë moszhvillimi ekonomik dhe shoqëror: mundësitë e kufizuara të punësimit jashtë bujqësisë (në industri), rritja e dendësisë agrare dhe presioni i madh në sipërfaqet e punëshme, tepricat e fuqisë punëtore, rritja e kontingjentit të popullsisë në periudhën e punës, por edhe motivet e tjera të natyrës familjare, individuale, të prestigjit etj. Më të goditurit ishin dhe mbetën shqiptarët, edhe pse përbëjnë shumicën dërmuese. Mirëpo vetëm Kosova sot e gjithë ditën mbeti vendi më i izoluar në Evropë, pa liberalizim të vizave dhe pa lëvizje të lirë të qytetarëve, duke u shtuar kriteret të cilat nuk ishin si detyrim për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve jashtë Ballkanit (Ukraina, Gjeorgjia).

¹⁸ Në muajin maj të vitit 2004 u bënë anëtare të BE-së 10 vende: Polonia, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Sllovenia, Lituania, Letonia, Estonia, Malta dhe Qipro.

¹⁹ A. De Tinguy, "L'élargissement à l'est de l'Union, un nouveau déficit pour l'Europe réunifiée", *Hommes et migrations*, No 1230, Paris, 2001, pp. 5-19; J. Widgren, "Les politiques de la prévention de la migration illégale et du trafic de migrants", *Hommes et migrations*, No 1230, 2001, pp. 20-31.

²⁰ Kroacia është vendi i fundit që u anëtarësua në BE (2013).

Rrethanat dhe motivet e përmendura socioekonomike ishin të pranishme edhe më parë, para 5, 10, 30 vjetëve, madje në formën më të ashpërsuar, por nuk pati emigrim të fuqisë punëtore jashtë ish-shtetit deri në fillim të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar dhe veçanërisht jo në vëllim aq masiv si në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015. Kosova ishte entiteti i fundit që u inkuadrua në migrimet e punës në botën e jashtme. Së paku ishin tre faktorë që kanë ndikuar në këtë drejtim: a) *mungesa e traditës* në mobilitetin hapësinor dhe social të popullsisë e të fuqisë punëtore të Kosovës në vendet e huaja; b). *mungesa e informatave* mbi mundësitë, përparësitë, të metat, mënyrën e punësimit dhe hollësitë e tjera lidhur me emigrimin ekonomik jashtë vendit dhe c) *inkuadrimi i vonë i shërbimeve kosovare të punësimit* si ndërmjetësuese të punësimit në botën e jashtme.²¹

Në fillim të viteve të 70-ta vendet evropiane punësonin afër 96% të punëtorëve të Kosovës (74,7% në RF të Gjermanisë, 8,6% në Austri, 5,9% në Zvicër dhe 4,2% në Francë), ndërsa pjesa tjetër i përkiste vendeve të tjera jashtë Evropës. Ndërsa në fillim të viteve të 80-ta Gjermania mbeti vendi që printe me emigrantë të punës nga Kosova (51,9%), kurse Austria dhe Franca ruajtën përafërsisht numrin e mëparshëm, por u rrit shumë numri i punëtorëve tanë në Zvicër (nga 5,9 më 1971 në 32,1% të të gjithë punëtorëve në botën e jashtme). Edhe sot në Gjermani më tepër se në çdo vend tjetër punojnë dhe jetojnë më shumë shqiptarë nga Kosova. Pa dyshim se migrimi ekonomik i shqiptarëve në këto vende kishte efekte shumë pozitive në Kosovë (sigurimi i ekzistencës së familjes, ndërtimi i shtëpive të reja, blerja e teknologjisë dhe futja e risive në përparimin e bujqësisë, pajimi i amvisërive, ngritja e standardit jetësor, investimet në shkollimin e fëmijëve, por edhe pasoja negative në radhë të parë në rrafshin demografik dhe ekonomik (mospunimi i tokës, “ugari social”, investimi në luks etj.).

Në vitet e 80-ta të shekullit XX vargut të push-determinantëve zhvillimorë u shtohen edhe presionet politike, policore dhe ushtarake që ushtroheshin mbi shqiptarët, veçanërisht mbi rininë dhe rrjedhimisht intensifikohen shpërnguljet selektive të shqiptarëve. Ndërkaq në vitet e 90-ta, për shkak të represionit të egër të regjimit të Beogradit, vala e ikjes së shqiptarëve nga Kosova u masovizua deri te tragjedia e paparë në Evropën e pas Luftës II Botërore - deportimi i hapët i afër 1 milion shqiptarëve, i përcjell me masa e mjete kriminale dhe gjenocidale. Intervenimi NATO-s pasoi për të parandaluar këtë katastrofë humanitare.

²¹ Më gjerë në: H. Islami, *Aspekti etnik i migrameve*, ASHAK, 2013, ff. 318-320.

IV

Kjo që ndodhi me migrimin ilegal të më se 100.000 personave nga fundi i vitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015 u bë një problem shqetësues për autoritetet e Kosovës dhe më shumë për vendet e BE-së. Ky migrim, edhe pse masiv për një kohë të shkurtër, nuk ishte karakteristikë vetëm për Kosovën apo vetëm për vendet e Ballkanit, por është dhe mbeti fenomen evropian dhe botëror. Si pjesë e pandalshme e shoqërive në transicion dhe si pjesë e krizës së migrantëve, problemi kosovar nuk dukej alarmant në raport me valët e migrimit nga Siria, Afganistani, Iraku etj. që pasuan menjëherë pas Kosovës, në shkallë në çfarë e kishin ngritur institucionet evropiane në Kosovë. Problemi i kësaj dukurie, që e kërkonte përfaqësuesi i BE-së në Kosovë dhe ambasadorët e vendeve të BE-së veç e veç ka shpjegime dhe zgjidhje, natyrisht jo të shpejtë, me urgjencën çfarë këta e kërkonin!

Motivet që i përmendëm më lart e që lidhen kryesisht me bazën ekonomike janë evidentë edhe sot, madje janë ashpërsuar çfarë janë mungesa e vendeve të punës dhe investimet në degët propulsive që kanë fuqi më të shpejt akumuluese dhe e rrisin normën e punësimit. Sot mund të flitet dhe për qeverisjen e keqe, për korrupsionin dhe grabitjen e pasurisë kombëtare përmes rrugëve antiligjore dhe krimin të organizuar. Këto probleme ishin edhe dje, edhe në vitet e mëparshme, por migrim ilegal sikur nuk kishte në këtë formë apo ai nuk hetohej. Të shitej një pjesë e pasurisë, deri te traktori, kafshët, madje edhe shtëpia dhe të merret rruga e kurbetit me plot pasiguri dhe rreziqe, mbeti një çështje që kërkon shpjegime.

Cilët ishin motivet e nxitjes? Kush ishin bartësit e kësaj shtytjeje? Kush e krijoi psikozën e ikjes kur dihet se vendet evropiane nuk japin më azil as politik e as ekonomik? Një psikozë të migrimit jashtë vendit e njohim nga shpërngulja e shqiptarëve në Turqi në vitet e 50-ta, por këtu nuk ka ama asnjë paralele midis asaj dhe kësaj që është krijuar sot: dallojnë koha, rrethanat, instrumentet që para 60 viteve ishin shtetërore dhe drejtimi pa kthim – përplasja në shkretëtirat e Anadollisë.

Përveç rrethanave të përmendura repulsive, sipas observimeve tona janë dy faktorë kryesorë të këtij procesi të paperspektivë, por edhe të dhimbshëm: në një anë sigurisht janë matrapazët, trafikantët dhe grupet e krimin të organizuar dhe në anën tjetër është mungesa e liberalizimit të vizave dhe e lëvizjes së lirë të qytetarëve në truallin

evropian. Me problemin e parë duhet të merren policia dhe organet e ndjekjes në përgjithësi, duke e zbuluar rrjetin e grupeve kriminale Kosovë-Serbi-Hungari e tutje dhe natyrisht duke u dhënë përgjigjen ligjore bartësve të kësaj dukurie në Kosovë. Këtë e tumirë edhe fakti se në këtë valë të migrimit, të paparë deri tash për nga dendësia dhe koha e shkurtër, nuk janë përfshirë të gjitha territoret e Kosovës as në vëllim e as në dimensionin strukturor, madje as ato që kanë shumë probleme ekonomike çfarë është p. sh. Gjakova me rrethinë. Veprimi i grupeve kriminale ishte më i pranishëm në Rrafshin e Kosovës dhe veçanërisht në Prishtinë dhe në rrethinën e gjerë metropolitane.

Megjithatë, duket se faktori me peshë të madhe në migrimin ilegal është *mbyllja e Kosovës*: bota është në Kosovë, ndërsa kosovarët sot nuk janë të pranishëm në Evropë dhe në botë! Dhe brenda Kosovës, në lëvizjen e lirë më të goditura janë popullata shqiptare si shumicë dhe grupi etnik RAE. Serbët e Kosovës, mund të marrin me lehtësi pasaporta në Serbi, turqit në Turqi, boshnjakët në Sanxhak dhe BeH, goranët në Maqedoni, madje edhe në Bullgari. Shqipëria nuk u jep shqiptarëve pasaporta, me përjashtim të ndonjë politikani apo tregtari. Nuk ka shpjegim izolimi vetëm i Kosovës dhe i shumicës së saj shqiptare si popull më properëndimor në botë dhe ky është absurdi i BE-së! Të gjitha vendet përreth nuk e kanë plotësuar ama asnjë kusht për liberalizim të vizave në kuptimin çfarë e kërkon BE-ja nga Kosova: as Maqedonia, as Shqipëria, as Mali i Zi, as Serbia dhe as Bosnja e Hercegovina. Janë të njohura arsyet politike pse Bullgaria dhe Rumania janë bërë anëtare të BE-së. Mirëpo tash e një vit e gjysmë BE-ja ka ofruar liberalizimin, duke kërkuar nga Kosova që të përmbushen disa detyra, përfshirë veçanërisht zgjidhjen e problemit të kufirit me Malin e Zi, derisa korrupsioni dhe krimi i organizuar janë proces, të pranishme më tepër në vendet e tjera të rajonit sesa në Kosovë. Në anën tjetër, mjerisht, individë të caktuar shqiptarë, në etje për pushtet, profiterë politikë dhe grupet e interesit e kanë shndërruar këtë çështje në agjendë politike, duke e mbajtur peng gjithë Kosovën dhe qytetarët e saj. Për shtatë dekada nuk është dëgjuar asnjë zë i vetëm kundërshtues për kufirin Kosovë - Mal i Zi: as nga popullata e atjeshme, as nga pushteti lokal e as nga partitë politike. Të gjithë kufijtë janë në dëm të Kosovës dhe shqiptarëve në Ballkan, por janë vënë në rrethana të caktuara, me forcë ushtarake dhe politike dhe nuk mund të ndryshohen.

Bllokimi i liberalizimit të vizave pa dyshim rrit migrimin ilegal dhe të pakontrolluar. Disa vende evropiane, veçanërisht Gjermania si

vendi më i madh imigrues, vërehet se ka një tolerancë ndaj ballkanasve dhe sidomos ndaj shqiptarëve. Nga kontaktet e mia me disa qarqe në këtë vend, p. sh., në Baden-Württemberg (me Shtutgartin si qendër) si ndër krahinat industrialisht më të zhvilluara të Gjermanisë mund të nxirret përfundimi se ekziston një tolerancë ndaj migrantëve të rinj kosovarë, të cilët shpejt po integrohen në këtë vend; vlerësohet se në këtë krahinë punojnë dhe jetojnë rreth 40.000 shqiptarë.

Pse qytetarët e këtyre vendeve, përfshirë shqiptarët e Luginës së Preshevës, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë nuk po e marrin rrugën e migrimit ilegal? Sepse i kanë pasaportat në bazë të të cilëve shkojnë, qëndrojnë deri 90 ditë, strehohen te të afërmit e tyre dhe kthehen ose një numër mbetet, punësohet apo pret ndonjë punë. Para dy-tri vjetëve edhe këta shqiptarë, pas marrjes së pasaportave, shkonin në vendet e BE-së në numër jo të vogël, por sot nuk raportohet për ndonjë shqetësim të moskthyerjes apo të kërkimit të azilit. Gati nuk ka familje shqiptare të Kosovës që nuk e ka të paktën një anëtar ose një të afërm jashtë, ku do të mund të gjenin strehim të përkohshëm migrantët po të kishin mundësi të lëviznin lirshëm në hapësirën evropiane.

Është e qartë se për shkallën e tanishme të zhvillimit shoqëror-ekonomik të Kosovës, të papunësisë ose të punësimit të pamjaftueshëm në bujqësi (tepricat latente), duhet përkrahur emigrimin ekonomik jashtë vendit, sepse shumë familje kosovare jetojnë nga ndihmat që vijnë nga mërgata jonë. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, si dhe një studimi të Programit të KB-së për Zhvillim në Kosovë (UNDP), dërgesat apo remitancat e bashkatdhetarëve tanë për familjet e tyre në Kosovë nuk janë të vogla të cilat kryesisht transferohen përmes kanaleve joformale; këto vitet e fundit remitancat mesatarisht në vit kapin shumë prej më se 500 miliona eurove, që nënkupton rreth një të tretën e buxhetit të Kosovës. Sipas BQK-së në vitin 2016 remitancat arritën shumë prej rreth 650 milion eurove, por edhe një shumë jo të vogël të mjeteve migrantët e jashtëm e shpenzojnë kur vijnë për pushime. Rreth 33% të remitancave vijnë nga Gjermania, 23% nga Zvicra, 7% nga Italia dhe po aq nga Austria dhe pjesa tjetër nga vendet e tjera dhe pjesa më e madhe e tyre shpenzohen për konsum të përgjithshëm.

Mirëpo njëkohësisht duhet menduar vazhdimisht për kthyerjen e migrantëve dhe punësimin e tyre. Një numër prej tyre e dëshiron këtë, por problemi qëndron në gjendjen shumë të rëndë në sferën e punësimit, meqë struktura e ekonomisë së Kosovës është ende e tillë që

nuk mundëson hapjen e vendeve të shumta të punës dhe atë në kushtet kur gjithnjë po rritet kontigjenti i popullsisë aktive; në vit mesatarisht hyjnë në periudhën e punës rreth 25.000 veta, ndërsa tërhiqen në pension vetëm rreth 3.000 veta, që do të thotë se aq vende të punës lirohen në sektorin publik. Kthyerjen e dëshirojnë edhe ata që janë një kohë të gjatë jashtë, sepse prej tyre një kontingjent i madh tashmë janë të pensionuar dhe mund të kthehen në shtëpitë dhe pronat e tyre në vendlindje.

Siç raportohej këto 2-3 vitet e fundit, vetëm në Gjermani numri i azilkërkuesve nga Kosova që u janë refuzuar kërkesat arrin në rreth 70.000 shtetas të saj nga afër 550.000 azilkërkues nga e gjithë bota dhe këta kryesisht i përkasin valës së fundit prej më se 100.000 personave. Ndërkaq, në mars të vitit 2016 raporti i EUROSTAT-it bën me dije se numri i azilkërkuesve nga Kosova në vendet e BE-së ishte rreth 66.885 persona. Gjatë vitit 2016, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, numri i shtetasve të Kosovës që janë kthyer është rreth 10.000 veta, ndërsa nga fillimi i vitit 2015 ky numër ka arritur shifrën në rreth 28.000 veta.

Hivzi Islami, Prishtina

PUSH-PULL FACTORS IN EXTERNAL MIGRATIONS - THEORETICAL APPROACHES AND THE CASE OF KOSOVO

Résumé

Population migrations and, within them, external migrations were permanently tagged along by the demographic, social, material, cultural and mental evolution of humanity and were a key factor in the development of human populations as well as a very important phenomenon in the life of the individual, different population groups and peoples and their civilization in general. Despite such a great impact that they have had throughout the history and that they still have at regional and global levels nowadays, population migrations were not sufficiently researched, which can be noticed in the scientific instrumentarium, the methodological dimension of the research and the sources of data. In particular, there was a lack of theoretical approaches, laws and generalizations, which are very important for comparative and others types of research. After G. Ravenstein introduced several "laws" and "generalizations" through the study of the data on migrants in 1881 in England, at the end of the 19th century (1895) and some other countries later on, up to the 60s of the 20th century, when the Pull and Push Theory has emerged, there was a big vacuum in the theoretical review of migrations.

The theory of migration and empirical research of the phenomenon explain that external migrations are determined by many interrelated and conditioned factors summed up as expulsive (push) factors and attractive (pull) factors or factors of economic, political, historical, religious and racial nature, class, nature, etc., among which individual's decision to participate in the migration process is one of the major ones. Since world has opened a lot, there are other causes of individual-psychological nature. Within the European space, after the establishment of the European Economic Community (in 1957), the process of migration of workers abroad was prompted by differences between rapid economic growth and demographic growth as well as normalization of political relations between European countries. Following the collapse of the communist system, migrations of millions of people from east to west were intensified, which were selective by some features and accompanied by many difficulties and problems (xenophobia, economic, demographic, social and other losses in migrating countries and settling countries). The type of "intellectual migration", known as "brain migration", represents a significant loss for the workforce exporting countries.

Due to the expulsive circumstances in Kosovo, such as lack of economic development, unemployment, large agrarian density, continuous growth of active population share as well as other motives of family and individual nature, prestige etc., Kosovo was, from the beginning of the 70s to the past century, heavily involved in migratory flows within the European area, mainly in Germany and Switzerland. Besides the mass exodus and deportation of about 1 million Albanians by Milosevic's regime in 1999, a phenomenon unseen till then occurred in Kosovo by the end of 2014 and beginning of 2015: illegal migration of more than 100,000 people! As part of societies in transition and as part of migration crisis, Kosovo's problem did not seem alarming compared to migration waves (more than 1 million) from Syria, Afghanistan, Iraq, etc. Dealers and organized crime groups in Kosovo-Serbia-Hungary and lack of free movement of Kosovo's citizens on the European soil add to expulsive circumstances mentioned above. These groups' operations were more present in Pristina and its wider surroundings and less, for instance, in Gjakova/Đakovica and its surroundings, where there are more economic problems. It is true that many countries (Macedonia, Albania, Montenegro, Serbia, B&H, let alone Bulgaria, Romania, Ukraine and Georgia) have not met any of liberalization requirements that the EU has set for Kosovo. However, it has been almost two years since the EU has offered visa liberalization, urging Kosovo to resolve the issue of demarcation with Montenegro and the fight against corruption and organized crime, as key preconditions to the process. Woefully, certain Albanian individuals, political profiteers and interest groups have turned this issue into a political agenda, holding the entire Kosovo and its citizens to ransom.

Key words: external migration, migration theory, expulsive (push) factors, attractive (pull) factors, xenophobia, "brain migration", illegal migration, organized crime groups, visa liberalization, demarcation with Montenegro.

Arsim Canolli, Prishtinë

**“ME RA S’KIE KU SHKON, ME NEJTË S’KIE KU RRIN”
- NJË PAMJE ETNOGRAFIKE I MIGRIMIT TË
BRENDSHËM FSHAT-QYTET NË KOSOVË**

“Me ra s’kie ku shkon, me nejtë s’kie ku rrin?”. Kjo është një prej deklarimeve më të shpeshta të dilemës së fshatarëve në zonat malore të Kosovës me të cilët kam biseduar gjatë viteve të fundit në kërkim të njohjes së sjelljes, praktikave dhe kulturës tradicionale. Edhe gjatë disa vizitave e konversacioneve specifike për migrimin, apo *“ramjen n’shehër”*,¹ e njëjta gjë është deklaruar në thënie të ndryshme si: *“as s’kie ku shkon, as s’kie ku rrin”*, *“me ra qysh me ra, me nejtë, qysh me nejtë”*, *“jemi metë qikha e s’po kem çka me ba”*, etj. Kjo dilemë e një gjendjeje të ndërmjetme vjen edhe si lëngatë nga fshatarët që janë në prag të migrimit nga fshati në qytet. Dhe kjo vërehet kryesisht te anët apo zonat rurale malore, sikurse ajo e Gollakut, Opojës, Shalës së Bajgorës, fshatrat e të cilave janë pothuajse në zbrazje e sipër. Migrimi në qytetet përreth apo *“ramja në shehër”* i ka karakterizuar këto fshatra gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX, respektivisht pas viteve 60, kur filloi industrializimi dhe modernizimi i Kosovës. Migrimi rural-urban ka vazhduar dhe është intensifikuar pas luftës së vitit 1999, kur ka pasur shkatërrime masive të fshatrave e qyteteve të tëra të Kosovës nga forcat paramilitare serbe. Sot kemi një gjendje faktike të popullatës në fshatra të këtyre zonave që duket të jetë *“alarmante”*, në sensin e shuarjes së jetës sociale të këtyre fshatrave. Në vitet e fundit institucionet shtetërore kanë zhvilluar politika të ndryshme për subvencionimin e bujqësisë e blegtorisë në mënyrë që të zbutet migrimi dhe papunësia dhe të rritet prodhimtaria vendore. Shumë informues kanë deklaruar se këto

¹ Do ta përdora fjalën *“ramje”* në vend të fjalës *“dalje”*, sepse përdoret më shpesh, ndonëse kjo varion prej fshati në fshat. Po ashtu përdoret edhe fjala *“zhdjergje”*, por ajo përdoret edhe në kontekst të udhëtimit ditor prej fshatit malor në qytet fushor. Ndërsa fjala *“ra”*, *“ramje”*, *“t’ramë”* përdoret mjaft shpesh dhe konoton pikërisht me migrimin e brendshëm prej fshati në qytet.

politika janë përvetësuar në mënyra të ndryshme dhe shpeshherë jo për çfarë janë marrë. Megjithatë, migrimi drejt qytetit nuk është ndaluar. Nga vrojtimet etnografike që kam realizuar në vise të caktuara del se shumica e atyre që jetojnë në fshat deklarohen se “kanë metë” atje, gjithnjë duke shtuar se kanë mbetur atje në pamundësi të “daljes” apo “ramjes” në qytete të përafërta apo pasi që s’kanë mund të emigrojnë direkt në vendet përëndimore. Kështu, jetesa në fshatrat malore deri së voni të paasfaltuara, duket të jetë një jetesë e përkohshme apo një situatë e përgatitjes drejt “ramjes”, “daljes”, “zhdjergies” apo migrimit drejt qytetit.

Në vazhdim do të jap disa pamje të identifikimit bazik të shkaqeve, arsyeve e motiveve të “metjes” në fshat, gjendjes së ndërmjetme apo përkohshmërisë së jetesës atje para aktit të migrimit, duke përshkruar e analizuar raste nga etnografia e realizuar në fshatra të zonës së Gollakut. Identifikimi i gjendjes sociale, kulturore e demografike të fshatit malor-rural dhe tipologjia e arsyeve të migrimit të brendshëm drejt qytetit është esenciale për njohjen e ritmit të jetës brenda kushteve të modernitetit në një shoqëri të sapohapur, të ashtuquajtur postsocialiste dhe postindependente, siç është shoqëria e Kosovës sot. “Kah po shkojnë të “ramtë n’shehër” dhe ku po mbasin “të metnit n’katun”?” është pyetje esenciale për njohjen e pulsit të sotshëm të sjelljes, traditës, kulturës dhe politikës në Kosovë. Kështu, kjo ese mëton të jetë një konversation për jetën tradicionale në kuadër të zhvillimeve, ndryshimeve e transformimeve sociale, kulturore, ekonomike e politike brenda sferës lokale dhe asaj globale për të njohur strategjitë e praktikave të “metjes” dhe “ramjes”, ashtu si ato shfaqen në shteg të vrojtimet e njohjes etnografike. Ky debat është i gjerë dhe shkencat shoqërore janë mjaft produktive në rezultatet e njohjes së kësaj teme në nivele e aspekte të ndryshme. Megjithatë, eseja synon të paraqesë një argument identifikues të gjendjes ashtu si shfaqet dhe kuptohet në sferën lokale. Pyetjet e mia kryesore janë: Cilat janë motivet, shkaqet e arsyet e “metjes” në fshat për ata që janë para aktit të migrimit dhe ata që realisht duan të mbasin në fshat? Si përjetohet, negociohet e përvetësohet “metja” në fshat e si planifikohet, negociohet e kuptohet “dalja” nga fshati apo “ramja” në shehër nga vetë fshatarët e mbetur? Cilat janë strategjitë e praktikave të “metjes” dhe “ramjes” që bëhen nga vetë fshatarët? Këto janë pyetjet të cilave iu nevojitet një hulumtim fort më i gjerë sesa ky që ofrohet këtu. Kjo ese ofron vetëm një pamje indikative.

Asgjë mëngu, kjo ese nuk pretendon të jetë e bazuar në një studim të gjatë e shterues mbi këtë temë. Si i tillë vjen si një shenjë e një pikëpamjeje antropologjike mbi migrimin, duke e parë kryesisht një aspekt specifik të migrimit të brendshëm fshat-qytet, përkatësisht mënyrën se si planifikohet, negociohet e kuptohet migrimi nga fshati në qytet në kontekst të zhvillimeve politike, ekonomike, sociale e kulturore në Kosovën e sotshme.²

Antropologjia e migrimit

Fillimisht dua të cek se antropologjia si dije mëton ta paraqesë procesin historik dhe prezentist të kulturës njerëzore duke dashur ta njoh përmes pyetjes së çfarë e bën njeriun *njeri* në kushte të përgjithshme, krahasimtare, të përveçme, historike, prezentiste, fiziologjike, kulturore, linguistike, etj.³ Kështu, mund të themi pa mëdyshje se antropologjia në esencë e njeh migrimin si proces qenësor apo variantet e diversitetit kulturor dhe e studion atë jo vetëm si dyndje të masave të njerëzve, por edhe si raporte e marrëdhënie kulturore, sociale, ekonomike, etj.⁴ Migrimi apo dyndja e njeriut a njerëzve prej një vendi në tjetrin është në esencë një prej temave kyçe të antropologjisë, por edhe e paleoantropologjisë.⁵ Nga këto studime

² Vrojtimi me pjesëmarrje dhe intervistat në formë të bashkëbisedimit të lirë kanë qenë metodat që kam përdorur për këtë studim, ndërsa studimi është fokusuar kryesisht në fshatra të Gollakut (Marec, Gllogovicë, Grexhenik, Hajkobillë, Prapashticë, Krilevë) ku kam bërë vizita, kam realizuar vrojtme me pjesëmarrje dhe kam realizuar 10 intervista të gjata me familjarë të familjeve të ndryshme gjatë viteve 2014-2016, por kryesisht gjatë vitit 2016.

³ Shih: CANOLLI, Arsim, *Premisa antropologjike*, Cuneus, Prishtinë, 2016.

⁴ Për një pamje antropologjike shih: BRETTELL, Caroline, *Anthropology and Migration: Essays on Transnationalism, Ethnicity, and Identity*, Altamira Press, Oxford, 2003. Brettell-i jep një hartë të mirë të qasjeve mikro, mezo dhe makro të studimit të migrimit nga pikëpamja antropologjike. Shih hyrjen: "Situating Anthropological Perspective: Macro, Meso, and Micro Approaches to the Study of Migration" fq. 1-8. Po ashtu, shih një pamje të gjerë të interesimit të disa studimeve antropologjike që lidhen me aspektin urban dhe migrimin: ROTH, Klaus & BRUNNBAUER, Ulf (eds) *Urban Life and Culture in Southeastern Europe. Anthropological and Historical Perspectives*, LIT Verlag, Berlin, 2006; CHING, Barbara & CREED, Gerald W. (eds.), *Knowing Your Place: Rural Identity and Cultural Hierarchy*. Routledge, New York, 1997.

⁵ Për një njohje të argumenteve për migrimet parahistorike shih këto dy vëllime: BELLWOOD, Peter red., *The Global Prehistory of Human Migration*, Willey-Blackwell, Oxford, 2015; PEREGRINE, Peter Neil, PEIROS, Ilia &

del se në kuptimin e gjerë dhe të përgjithshëm të gjithë ne si individë e popuj jemi inde të një trupi të madh shoqëror të formësuar nga gjahtarë, mbledhës, lundërtarë, bjeshkatarë, katunarë e shehërli që mësyjmë malin, fushën, detin, qytetin e hapësirën për të kërkuar vend më të mirë, më të begatë, më të lirë e më paqësor. Pra, njeriu në esencë është migrant që nga dalja e tij e supozuar nga Afrika si *homo sapiens* (më e evidentuara deri më tani) e deri te andrrat e sotshme të migrimit në planete tjera.⁶ Fjalja “*Ne të gjithë jemi migrantë*” rezonon si pohim edhe në studimet biologjike e paleoantropologjike, por është edhe titull i veprës së Gregory Feldman-it, njërit prej studiuesve të politikave të migrimeve globale.⁷ Ky pohim është jo vetëm si apologji liberale morale për të treguar empati të tipit të korrektesisë politike ndaj identitetit fluid të migrantit transnacional, që është prezente sot në studime të shkencave shoqërore, por si nuancë identitare e njeriut që nga agimi i tij. Periudha e evolucionit njerëzor shquhet nga migrimet e brendshme, apo brenda një vendi mjaft homogjen e të njofshëm dhe migrimet e jashtme, kur njeriu ka marrë në sy hapësirën, fushën e detin përballë qoftë këmbë, qoftë me barkë-kanu për të kolonizuar botën anepërtej. Arsyet e migrimit të njeriut si në parahistori gjatë fazës së tij evolutive, si në histori me krijimin e civilizimeve kufitare tashmë janë të njohura dhe të studiuara, e ato janë: politike, ekonomike, sociale e kulturore.

Çfarë risie mund të sjellë antropologjia në studimet mbi migrimin? Studimet mbi migrimin janë tashmë interdisiplinore dhe të dhënat vilen nga të gjitha këndet disiplinore. Por studimi etnografik sjell evidenca nga jeta e migrantit, nga e përditshmja e tij, nga sjelljet, negociatat, problemet dhe sfidat e përditshme të tij. Studimi etnografik e sheh jetën e migrantit, por edhe paramigranit e postmigrantit si jetë

FELDMAN, W. Marcus, *Ancient Human Migration: A Multidisciplinary Approach*, University of Utah Press, Utah, 2009; MANNING, Patrick & TRIMMER, Tiffany, *Migration in World History: Second Edition*, Routledge, London, 2004.

⁶ Shih edhe një pamje të teorive të migrimit të *homo sapiens*-it nga Africa te: TOMKINS, Stephen, *Origins of Humankind: Second Edition*, Cambridge University Press, Cambridge, 1998 dhe te CAMERON, W. David & GROVES, P. Colin, *Bones, Stones and Molecules: “Out of Africa” and Human Origins*, Elsevier, Oxford, 2004.

⁷ Shih: FELDMAN, Gregory, *We are all migrants: Political Action and the Ubiquitous Condition of Migrant-hood*, Stanford University Press, Stanford, 2015.

në kontekst të marrëdhënieve sociale specifike në jetën e tij të përditshme aty ku është, por edhe marrëdhënieve të tjera shoqërore. Siç cek Brettell-i, “politologët dhe ekonomistët kryesisht interesohen për dyndjet që ekzistojnë mes dy vendeve dhe këto dyndje si formësohen nga politika apo tregu i punës... sociologët, të cilët janë fokusuar kryesisht te caku i dyndjes apo destinacioni, i shohin çështjet e integritit. Në anën tjetër, antropologët kanë tentuar të fokusohen te të dy pikat e procesit të migrimit: te vendi i origjinës, duke pyetur se çfarë i shtynë individët të lënë komunitetet e tyre dhe pastaj te vendi i destinacionit se çfarë ndodh me ta në vendin e destinacionit të tyre, duke përfshirë edhe studimin nëse kanë mbetur dhe si kanë mbetur të lidhur me vendin e tyre të origjinës”⁸.

Studimi etnografik sjell në prozë edhe zërin e migrantit, se çfarë ai thotë e bën edhe interpretimin e thukët të antropologut si vrojtues konsistent dhe njohës i jetës së tij. Pra, ai nuk fokusohet vetëm në migrimin si proces, por edhe në shtegun social të tij, respektivisht në marrëdhëniet sociale në kontekst migrues. Antropologu, i cili është edhe etnograf, nuk bazohet vetëm në shifra të migrimit dhe nuk nxjerr përfundime në bazë të argumenteve sasiore sa u dyndën sot, sa migruan dje, sa u kthyen pardje. Studimi antropologjik mëton ta ritregojë tregimin e migrantit ashtu si ndihet, përjetohet dhe tregohet edhe prej vetë migrantit. Pra, interpretimi i antropologut nuk është vetëm interpretim i shkaqeve në shifra të mëdha, por interpretim i gjendjeve, ngjarjeve, aspiratave, dhembjeve, dëshirave, sfidave dhe gjithë sjelljeve e praktikave, kuptimeve e domethënies në kontekst e shteg migrimi si të migrantit, ashtu edhe të akterëve të tjerë në jetën e tij para, gjatë dhe pas aktit të migrimit.

Megjithatë, pyetja shtrohet: Si mund të njihet konteksti i marrëdhënieve kulturore e sociale të migrantëve në vendet e reja pa u njohur cikli i migrimit si proces dhe konteksti social e kulturor në të cilin nis e përfundon ky cikël? Nëse e shohim në plan të gjerë, ky cikël e përshkon gjendjen para aktit të migrimit, përgatitjen për migrimin, aktin e migrimit, destinacionin e migrantit përfshirë integrimin si proces postmigrues, efektet dhe reagimet që vijnë si rezultat i migrimit e po ashtu edhe kthimin e migrantit në vendin e tij të origjinës qoftë si turistë nga dëshira, qoftë si të larguar nga arsyet tjera. Pra, studimet antropologjike mëtojnë të njohin të gjitha fazat e ciklit të migrimit, të zgjidhin kuptimet nga nyjet e arsyeve, shkaqeve e

⁸ Shih: BRETTELL, Caroline, *Anthropology and Migration: Essays on Transnationalism, Ethnicity, and Identity*, Altamira Press, Oxford, 2003, fq. 1.

motiveve të migrimit, të interpretojnë akterët, agjentët dhe rrjetet që negociojnë aktin e migrimit, të analizojnë e krahasojnë raportet sociale a kulturore në jetën e përditshme të migrantëve dhe të vendësve dhe të njohin e interpretojnë praktikatat e marrëdhëniet sociale, kulturore, ekonomike e politike të migrantëve, migrantëve dhe vendësve, etj.

Studimet e migrimit të brendshëm në Kosovë

Nëse analizojmë disa nga argumentet e dala nga studimet demografike dhe ato mbi migrimin e brendshëm në Kosovë gjatë periudhës socialiste, sidomos atë rural-urban, mund të identifikojmë disa motive e shkaqe kryesore të cialt rrumbullakësohen rreth tri arsyeve të mëdha, siç janë:

- a) sistemi industrial i punësimit ka përthithur punëtorë nga viset rurale në ato urbane,
- b) sistemi i edukimit të lartë ka përthithur rininë rurale dhe
- c) ekzistojnë edhe arsyet, shkaqet dhe motivet e ndryshme kulturore e sociale.⁹

Edhe studimet etnologjike nxjerrin këto konkludime dhe japin po ashtu argumente të bazuara në evidenca statistike dhe empirike. Për shembull, etnologu Mark Krasniqi, duke studiuar aspekte demografike mbi shqiptarët në Kosovë cek se dendësia agrare në Kosovë ka qenë dyfish më e lartë në krahasim me mesataren jugosllave të viteve të 70-ta¹⁰ (në Kosovë: 163 banorë në 1 km katror, përderisa Jugosllavia kishte 72 banorë dhe 51% e popullsisë me bujqësi, përderisa Jugosllavia kishte 38.5%)¹¹, ndërsa tek në vitet 70 e tutje fillon të rritet edhe dendësia urbane në qytetet e Kosovës, përkatësisht tek pas një faze të industrializimit dhe hapjes së universitetit e institucioneve tjera të arsimit të lartë. Po ashtu, sipas tij, më 1971 vetëm 27% e popullsisë së Kosovës jetonin në qendra urbane, të cilat ishin 18 dhe po vinin

⁹ Shih: ISLAMI, Hivzi, Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural), Rilindja, Prishtinë, 1985; ISLAMI, Hivzi *Studime demografike: 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, botim i dytë i plotësuar*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2008.

¹⁰ KRASNIQI, Mark, *Gjurmë dhe gjurmime*, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Prishtinë, 1979, fq. 38.

¹¹ Po aty, fq. 51.

duke u rritur me të madhe. Statistikat tregojnë se numri i banorëve në qytete vjen duke u rritur gjatë viteve 70 dhe 80. Në anën tjetër studimet demografike evidentojnë një pamje edhe më të qartë të lëvizjes së popullësisë nga zonat rurale në ato urbane ndër vite.¹²

Por nga këto studime statistikore nuk kuptojmë shumë për domethëniet reale që kanë pasur këto migrime, për përvojat e kohës, për raportet mes njerzëve, për domethëniet dhe kuptimet e krijuara në kontekst të migrimit të brendshëm fshat-qytet, për gjithë jetën sociale të atyre që kanë migruar e atyre që kanë mbetur në fshat, për shqiptarin me sharrë në krah, me vezë në pazar, me ahër në qytete, me odë në shehër, me banesë moderne, fabrikë kolektive e universitet të ri. Pra, këto studime janë mjaft të rëndësishme, por japin kryesisht njohje të sasisë, strukturave, kategorive dhe rrallë hasim ndonjë pamje të marrëdhënieve njerëzore, sociale a kulturore në realitetin e tyre të përditshëm. Çfarë e ka karakterizuar shqiptarin e dalë nga mali e të ramë në qytete moderne të ndërтуara, si ka rastisur nga socializmi jugosllav? Si janë integruar ata në jetën e re, në sistemin e ri industrial, urban, modern në kuadër të të ashtuquajturit vëllazërim-bashkim të sistemuar nga sistemi komunist jugosllav? Për shembëll: Fjalja e fundit e esesë “*Struktura demografike në Kosovë*” e etnologut e gjeografit Mark Krasniqi thotë: “Të gjitha qytetet e Kosovës kanë lagje banorësh të rinj të ardhur nga fshati, të cilët në periferinë e qytetit ndërtojnë (pa leje të organeve komunale) shtëpitë e tyre të vogla me shumë elemente të arkitekturës popullore, në të cilat zhvillohet jeta familjare sipas traditave fshatare.”¹³ Kjo fjali është ndër të vetmet në atë kontekst të studimit etnografik që jep indicie të një gjendjeve mjaft përndjellëse për studim të thukët etnografik të përditshmërisë së tyre. Një fjali e tipit të tillë jepet edhe te shkrimi i etnologut Ukë Xhemaj në esenë e tij për dinamikën demografike dhe

¹² Shih veprat më lart në fusnotën 9. Pas luftës së vitit 1999 kjo bëhet edhe më e madhe dhe sot regjistrimi i fundit i vitit 2011 tregon se diku rreth 60% jetojnë në fshat e 40% në qytete, ndonëse edhe ky regjistrim është kontestuar për saktësinë për arsye të regjistrimeve të popullësisë si banues në vendbanime të lindjes dhe matjeve të atyre regjistrimeve e jo vendbanimeve të tanishme. Shih: ASK, *Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011*, 2016 [http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__Census%202011/?rxid=aa632159-a927-4893-8a63-f4134f0820f8, lexuar më 1 dhjetor 2016). Për një pamje të lëvizjeve prej viseve rurale në ato urbane pas luftës së vitit 1999 shih IOM (2000), *Kosovo Demographic, Socio-economic and Reproductive Health Survey*, IOM, UNFPA and SOK, May 2000.

¹³ KRASNIQI, Mark, *Gjurmë dhe gjurmime*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Prishtinë, 1979, fq. 53.

tipet e lëvizjeve në Kosovë në periudhën mes regjistrimeve 1961 dhe 1971 si: “Ndjekja e migrimëve të popullsisë, apo edhe vetë lëvizja e shkallës së shtimit natyral, nga aspekti social-ekonomik paraqesin temë më vete, shumë interesante. Andaj mbetet që kjo problematikë të studiohet më vonë”.¹⁴ Fatkeqësisht, as në këtë rast studimi nuk ka vazhduar për arsyet që s’i dijmë. Por pamja enografike e transformimit të gjendjes statusore të fshatarëve të “ramë” në zona paraurbane, pamja etnografike e sfidave të adaptimit, gjindshmërisë, ballafaqimit, bartjes së traditave, praktikave, materialitetit, etj. në jetën e tyre të përditshme do të ishte tejet e rëndësishme për njohjen historike e antropologjike të asaj periudhe në përgjithësi.

Megjithatë, te studimet si ai i antropologës amerikane Janet Reineck, e cila ka studiuar dhe interpretuar migracionin dhe gjininë në Kosovë në vitet e 80-ta, përkatësisht në rajonin e Opojës, vërehen variante të thukta të përshkrimit e interpretimit të kuptimeve të ndryshme që kanë dhe marrin aspektet e migrimit në raport me aspektet tjera brenda sferës sociale, si dallimet e hetuara mes migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Për shembull, sipas saj, ata që migronin për punë në qytete të afërta ishin më të hapur se sa ata që punojnë në “gyrbet”:

“Burri që ekspozohet ndaj ideve joopojane, por i cili ishte mjaft afër për të vëzhguar sjelljet e familjes së tij, ishte më elastik në interpretimin e kulturës lokale. Ai mund të dërgojë vajzat e tij në shkollë, sepse është mjaft afër për ta përcjellë sjelljen e tyre. Gruaja e tij mund t’i vizitojë të afërmit në Prizren, sepse ai është diku në afërsi dhe komuniteti i tij e di këtë”¹⁵ Ndërsa ata që jetonin jashtë vendit nuk prisnin ndryshime të tjera pos ndryshimeve që sillnin financat nga puna jashtë vendlindjes. Në fund të analizës së saj Reineck jep indicje se disa nga praktikat tradicionale që ishin pothuajse të patjetërsueshme në jetën tradicionale shqiptare, respektivisht në shtegun social e kulturore brenda kozmologjisë së fshatit kishin filluar të ndryshonin karshi ndryshimeve politike pas vitit 1989-1990.¹⁶

¹⁴ XHEMAJ, Ukë, *Shtresime kulturore*, IAP, Prishtinë, 2005, fq. 363.

¹⁵ REINECK, Janet, *The past as refuge: Gender, migration, and ideology among the Kosova Albanians*, (tezë doktorate), University of California, Berkeley, 1991, fq. 161.

¹⁶ Po aty, fq. 201-203.

Ndonëse synimi im këtu nuk është analiza e literaturës, duhet cekur se fryti i studimit etnologjik apo antropologjik është pikërisht njohja, përshkrimi dhe interpretimi i shtegut social e kulturor të fenomenit të migrimit qoftë në kontekstin gjinor, siç e analizon Reineck në kuadër të studimit të saj specifik të rajonit të Opojës, qoftë në kuadër të aspekteve të tjera sociale e kulturore si martesë, biznesi, shteti, etj.

Metja dhe ramja - familjet Hasani dhe Canolli

Më poshtë do të jap një përshkrim të dy familjeve të cilat kanë qenë objekt i vrojtimit dhe intervistave të mia etnografike për të identifikuar disa nga arsyet, shkaqet dhe motivet që i bëjnë fshatarët e këtyre zonave të migrojnë. Përshkrimi ka dalur si gërshetim i shënimeve gjatë vizitave të mia personale. Pastaj do të analizoj gjendjen e këtyre familjeve në kontekst të pyetjeve të shtruarë më lart.

Familja Canolli jeton në Marec, një fshat i madh malor i tipit të shpërndarë afër Prishtinës. Fehmiu dhe gruaja e tij të moshës 42 dhe 40 vjet kanë një fermë lopësh numri i të cilave silldet prej 15-30 krerësh. Nga ferma shesin qumësht, djathë edhe gjizë. Këto produkte i shesin në disa supermarkete në Prishtinë, drejt tyre Fehmiu udhëton çdo të dytën ditë e shpeshherë edhe çdo ditë. Ai ka në dispozicion pothuajse gjithë tokën e familjes së tij të gjerë dhe të kushërinjve, sepse të gjithë “janë ra” apo kanë migruar në qytet. Në lagjen e tyre jeton vetëm kjo familje, ndërsa në kodrën e dytë përballë tyre jetojnë dy familje të tjera dhe ndonjëherë gjatë fundjavëve “ngjitet” edhe një familje tjetër e cila ka pemishten me kumbulla. Mareci është fshat i madh, malor dhe pothuajse i zbrazur. Sipas Fehmiut vetëm lagjia e tyre ka pasur mbi 30 shtëpi në vitet 60-70, kujtesë kjo që i vie nga prindërit. “*Tash krejt junë ra n’shehër, s’u metë kush!*”, thotë Fehmiu. Çdo fundjavë nga Prishtina vijnë nëna e Fehmiut, motra e tij dhe dy vajzat e mëdha të tyre të cilat gjatë javës qëndrojnë në shtëpinë e tyre në Prishtinë për të ndjekur mësimin fillor. Nëna dhe motra e pamartuar e Fehmiut kujdesen për ta. Shpeshherë nëna e Fehmiut deklaron: “*Valla, tu u enë qishtu, as atje as kha. Edhe këta vetun kha... edhe na atje. Edhe naj ditë se tybe smuj e majmë ma as na*”. Gjatë fundjavës, të gjithë ndihmojnë në punët e shtëpisë dhe në përgatitjen e produkteve për të hënë, kryesisht gjizës dhe djathit. “*Me tamël tem, me produkte të mija s’ka në krejt shehrin. Junë çuditë kur e kanë mat ynyrën e tamlit tem, s’ka ma të naltë në Kosovë*”, thotë

Fehmiu. *“Me mish t’ktuhit s’ka bre! Janë kanë veterinarët, profesora-doktora, e kanë çelë lopën e e kanë studiu e kanë thanë – gjja ma të pastër e ma të shnosh s’kemi pa. As smujë, as dergjë, as sen. Jun çuditë. Nalt asht kha. K’tu asht ven për marak për gjja”* dhe qesh Fehmiu kur thotë *“për gjja”*, duke e shndërruar në humor *“edhe na që po rrimë veç me gjja jemi ba gjja se s’po rrin kush ma këtu”*. Pos shtëpisë dydhomëshe në Kolovicë të Prishtinës, ku jetojnë nëna me motrën dhe vajzat, Fehmiu ka blerë edhe një truall tjetër. Tani është duke konsideruar që t’i shes disa bagëti dhe të nis ndërtimin e shtëpisë së re. Ruzhdiu nuk dëshiron *“me ra n’shehër”*, sepse e ka të vështirë të gjejë punë në qytet si individ i moshuar mbi 40 vjet. Pos fermës, ai ka blerë mal të ri dhe ka organizuar prerjen e tij për shitje drush, ka mbjellur pemë, ka të gjitha pajisjet e bujqësisë, ka marrë subvencione nga shteti, ka rrugën e asfaltuar deri afër shtëpisë, ka ujin brenda dhe furnizohet nga dy puse e një krua. Por gjithë puna e tij duket sikur është puna e një paramigranti. Ndonjëherë më thotë: *“Ku me shkue?”*, *“Çka me ba n’shehër?”* e shpeshherë ma kthen (citoj): *“Ku me nejtë? Tash edhe këto dy të voglat kanë me hy n’shkollë. A e din që ato dyjat që janë me nanën as nuk po na dojnë ne dyve, se ma shumë rrinë në Prishtinë. S’muj tash edhe fëminë me i hup. S’ka ma... e kanë lshue krejt. S’u met kush. Qi je metë n’katun je hup. As une s’muj ma – veç edhe naj ditë sa ta baj edhe ni shpi e njanen me lshu me banesë a diçka se n’shehër s’un maj lopë, e a muj a s’muj me hi në punë...me kanë me gjetë ni punë bile!”*. Fehmiu vazhdon të jetojë në Marec, por *“ramja n’shehër”* po përgatitet. Ai është ndërmjet katuni e shehri. Në një anë rënkon për potencialin që mund ta ketë puna në fshat, e në anën tjetër rënkon nga pamundësia që ta shfrytëzojë atë potencial. Edhe bashkëshortja e tij Fazlia e mendon të njëjtën, ndonëse në raste të caktuara shfryen duke thënë *“Qysh po rruojnë krejt edhe na rruojmë në shehër. Me ni dyje!”*. Për Fazlien akumulimi i një kapitali për shpi e kushte elementare mbijetese në paralagje të Prishtinës është po ashtu i rëndësishëm. Fehmiu lëngon nga fakti që nuk ka mundur ta rrisë biznesin e fermës këto vitet e fundit. Ata thonë se e kanë të vështirë ta shndërrojnë punën e fermës në biznes solid, pavarësisht mundësive si tokat e bollshme, uji i bollshëm, shitja e garantuar, pajisjet e nevojshme, rrugës së shtruar, etj. Fehmiu më ka thënë disa herë se as punëtorë nuk mund të gjejë: *“Kam provue s’di sa herë. S’kanë nejtë ma shumë se 2 javë. Tej në 300 euro kum dashtë mej pague, me fjetje, me bukë me krejt këtu të hiqta. Po s’don kush me nejtë se larg prej shehri. Shtir, spo ja do kujt katunin. S’dojnë kësi pune kurkush. Edhe kur ta kthejsh n’tjetrën anë, njeri pa njerz smunet,*

s'i rrihet, i doket shkretihane...dikush po shkon n'Shipni pe i merr, po atje s'kum provu", thotë Fehmiu. Ai sqaron se katuni është shumë i mirë për blegtori, por për ata që investojnë shumë e jo për *"katunarin e shkretë"*, si e thotë ai. Nuk ka besim se mund t'ia dalë *"ta majë katunin"*. *"Edhe naj ditë"* thotë ai. A nuk është kjo një zgjatje e hëpërhësë, e ndërmjetzës, e parazhdjergies, por edhe dilemës hamletiane të fshatarit të sotëm të viseve malore të Kosovës: *"me ra s'kie ku shkon, me nejtë s'kie ku rrin"*?¹⁷

Familja Hasani jeton në Grexhenik, një fshat malor i thellë i anës së Gollakut në lindje të Prishtinës, në vijë kufitare mes komunës së Prishtinës dhe Kamenicës. Ata janë burrë e grua - Tefiku dhe Zelihja, të moshës 70 dhe 68 vjeç, të cilët jetojnë vetëm. Në fakt janë të vetmit banorë të regjistruar të fshatit, por edhe banorë realë të përhershëm aty. Dy djemtë e tyre kanë migruar apo *"janë ra"* në zona urbane të qytetit të Prishtinës para shumë viteve, ndërsa dy të tjerë kanë migruar në vendet perëndimore. Grexheniku ka qenë i populluar, sipas Tefikut, me shumë shpi *"50 shpi shqiptarë, 50 shpi shkie, se ka pasë edhe shkie këtu!"*. Ndërsa tani, si thotë Tefiku: *"veç u' me plaken teme rnojmë k'tu verë-dimën, e tjerët vijnë kajherë verës"*. Dhe kjo vërtetohet edhe nëse shikohen statistikat zyrtare të Kosovës për fshatin Grexhenik, ku dalin vetëm dy banorë në listë. Tefiku thotë se nuk ka pranuar të jetoj në Prishtinë dhe pas një sprove gjatë viteve të pas luftës 1998-999 është kthyer në Grexhenik. Ai nuk e konsideron kthim, sepse sipas tij, *"kurr s'jum ra n'shehër po masi ranë djelt, shkova edhe unë sa me ju nimue e smujta me nejtë e u ktheva"*. Tefiku dhe Zelihja mbajnë 2 lopë, diku rreth 30 pula dhe 30 bletë. Në pronësi kanë 15 hektarë, përfshirë tokën e punueshme, truallin dhe malin përreth. Mbjellin disa *"lehë"* qepë që janë diku më pak se gjysma e një ari dhe ka 15 ari të tjerë për fasule dhe misër. Nuk dalin jashtë fshati shpesh dhe nuk presin mysafirë sikurse kanë pritur përpara, sepse, si thonë ata, *"s'u metë kurkush"*. Gjatë dimrit

¹⁷ Me familjen Canolli kam biseduar me dhjetëra herë gjatë vitit 2010- 2016 dhe kam qëndruar në familje të tij sa që kam arritur ta njoh reativisht mirë historinë dhe aktualitetin e jetesës e mbijetesës së tyre në fshatin Marec. Në të dy rastet e përshkruara në këtë studim, emrat e informantëve dhe moshja e tyre janë ndryshuar për të evituar identifikim të menjëhershëm të informantëve (praktikë kjo e zakonshme në studime antropologjike), ndërsa emrat e fshatërave janë dhënë ashtu siç janë.

të fundit Tefiku ka jetuar kryesisht vetëm, sepse bashkëshortja e tij lëngon nga tensioni i gjakut dhe ka qëndruar te djemtë e saj në Prishtinë. Në pytjen time se a po mund të jetosh vetëm, ai më përgjigjet me “*jamë mësue, rri... kur shkoj atje smuj me nejtë hiç*”. Kur insitohet në pshin e kësaj pune, më thotë: “*Në shehër veç më pengon, me nerë me thanë prej jush, apo ngo knena, kur zhdrypi te Bunari i Hajratit, se permi prrugë e kam qaty shpinë, pasha rizenë e Zotit sikur kur a kie qef me shkue n’nevojto... burlllog e qashtu... meniherë jam smu dimnit kur jam shkue...*”. Tefiku duket se ka një lidhje organike me malin, duke qenë edhe roje e pyllit apo “shumar” (fjalë e huazuar nga gjuha serbe) si janë quajtur në të folmen e përditshme popullore. Tefiku e jep si argument kryesor për mbetjen e tij në fshat pamundësinë për t’u adaptuar me mjedisin e qytetit, qoftë edhe të periferisë së qytetit. Disa herë e kam menduar nëse kjo është vetëm një retorikë që kompenson pamundësinë e migrimit për arsye të ndryshme familjare, ekonomike e sociale. Megjithatë, vetë karakteri i tij heshtak, vetmitar dhe këmbëngulës duket të jetë arsyeja kryesore. Fakti se ka dy djem që punojnë në vende perëndimore dhe kanë mundësuar në krijimin e “kushteve” në katund, ua ka lehtësuar atyre vendimin që të rrinë në vend të tyre dhe të mos migrojnë për të jetuar me të tjerët (djemtë e tij) në qytet. Disa herë Tefiku e cek: “*Mos mu ba miftjaq i kurkujt. Këtu tana i kem, ajri a i mirë, thmija vijnë shpesh. Çka me lyp në shehër?!*” Tefiku nuk është në dilemë të rënies në shehër, sepse ka vendosur “*me nejtë*” aty së bashku me bashkëshorten e tij apo si thotë ai “*me plakën teme*”. Por ai është i vetëdijshëm që në rast se gruaja i sëmuret, i duhet edhe atij “*me menu a me ra n’shehër*”. Megjithatë, ai jeton sikurse të mos i duhet të mendojë për migrimin. Ka një kujtesë të freskët për peizazhin e katundit: “*Shpesh m’bien n’mend për ktyneheren... këtu janë kanë mi 20 mulli, në kit rekë... tash veç qiky i joni u met, edhe ky s’punon. Këtu u kanë edhe kisha, kisha e Rimit i thojshin, tash veç do gur janë metë aty. Janë kanë ardhë prej Beogradi me studjue e me pa... ka pasë gur me shkrola, me lula ... krejt n’rekë janë ra... i kemi gjue përpara me babën... e kemi çelë livadhin*”. Ai i përmend edhe “*lerthat*” si bimë të shijshme si hudhurat të cilat bëhen në afërsi, vend ku edhe quhet “*Te Lerthat*”, ku “*për Shingjergj e tanaj vonë për 1 maj u afroshin prej tana anëve ktue e lujshin, knojshin e qitshin gur e çka mos*”. Por sot Tefiku jeton pothuajse në vetmi, të cilën ai vetë nuk e ndjen fort. Ai ndihet i qetë aty ku jeton: “*Njeri knaqet n’mal... knojnë zojt, ajri i mirë e i paqtë... s’kam naj lazum... djelt vijnë ... çikat vijnë ... tana i kemi, mu tut s’tutna... uku njerin s’e han, s’kem pse mu tut... joo çfarë... s’nihna i metun hiç se vetë kum dashë!*”.

Megjithatë, kur është çështja e “*plakës*” së tij, e gjendjes së saj shëndetësore, ai rruhd krahët e ngrit vetullat duke e pëshpëritur një “*Epo, çka të bje Zoti!*”. Tefiku dhe “*plaka*” e tij duket të jenë ndër “*t’metni!*” e fundit që janë lindur, rritur dhe vazhdojnë të jetojnë në katund në viset e Gollakut. Por, si thotë Tefiku, “*sot shehri spo pret gatë*”. Tregimi për ta dhe jetën e tyre të vetmuar në katund mund të nisë me “*na ishte njëherë një plak dhe një plakë...*”¹⁸

Si ceket edhe në përshkrimet e dilemave dhe qëndrimeve të familjeve të cilat janë marrë si arketipe të familjeve të fshatrave malore të Gollakut, ekzistojnë disa shkaqe e arsye të “*metjes*” dhe të “*ramjes*” në qytet. Edhe në bashkëbisedimet që kam pasur me banorë të tjerë, shumë nga këto arsye e shkaqe më janë përsëritur. Banorët lokalë japin edhe arsyet e “*ramjes*” së të tjerëve që veçse kanë ikur nga fshati, por edhe arsyet e “*metjes*” apo përgatitjes së “*ramjes*” së tyre. Shpeshherë arsyet e zbrazjes së fshatrave janë të njëjtat që ata i potencojnë edhe për vete, ndonëse disa theksojnë edhe arsye të tjera të cilat janë relevenate kryesisht në rastet e tyre personale.

Pasi i kam analizuar intervistat dhe bashkëbisedimet me ata që kanë “*metë*” në fshat, me ata që kanë migruar në vitet e fundit në Prishtinë ose paralagjet e Prishtinës, por edhe me ata që kanë migruar më herët dhe tashmë kanë “*vnu rrëzmë n’shehër*” ose “*i kanë ba krejt kushtet*”,¹⁹ kam indentifikuar se arsyet, shkaqet dhe motivet kryesore dalin në formë të koncepteve si “*puna*”, “*kushtet*”, “*gratë*”, “*jashtja*”, “*koha*”, ndërsa “*udha*” dhe “*shkolla*” perceptohen e arsyetohen kryesisht si shkaktarë të migrimit. “*Udha*” e “*shkolla*” përdoren në kontekst të mungesës, pra ka qenë “*mungesa e udhës*” dhe “*mungesa e shkollës*” që theksohen si shkaktarë të ramjes së tyre në shehër. Në shumë raste “*shkolla*” shihet edhe si “*mungesa e cilësisë së shkollës*”

¹⁸ Me familjen Hasani kam realizuar vetëm dy takime gjatë vitit 2016. Njëri ka qenë takim njohës, ndërsa tjetri i gjatë. Nuk kam pasur mundësi të qëndroj gjatë për ta njohur e analizuar jetën dhe sjelljen e tij dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët, por vizitat dhe bisedat e mia me të dhe fshatarë të tjerë do të vazhdojnë, me shpresë se një ditë do të përfundojnë në përshkrime më të plota të atyre që kanë “*metë*” e atyre që janë “*ra*”.

¹⁹ Në Kolovicë, paralagje në lindje të Prishtinës, kam realizuar 6 intervista me familjarë të familjeve të ndryshme përnnga koha e rënies dhe struktura familjare gjatë vitit 2016 dhe kam kontekstualizuar intervistat e realizuara në kuadër të studimit mbi kulturën buknore të botuar si: CANOLLI, Arsim, ‘La culture culinaire du Kosovo: changement et continuité’ në *Ethnologie française, Avril – Juin 2017, Tome XLVII, Nr. 2.*

dhe nevoja e fëmijëve të vijojnë shkollën e mesme e fakultetin.²⁰ Po ashtu, “*puna*” apo punësimi dhe mirëqenia që krijon punësimi në qytet, pa nevojë të punës konsistente në bujqësi e blegtori, shihen si arsye e motive të rëndësishme. Kjo zakonisht matet me krijimin e të ashtuquajturave “*kushte*”. “*Kushtet*” si koncept përkthehen si mundësi, si pasuri, si mirëqenie, si siguri, si stil jete, si pushtet, etj, por në esencë ato përjetohej si një siguri i të ardhurave dhe akumulimeve materiale optimale për të jetuar mirë në qytete. Si të tilla vijnë nga koha e socializmit, respektivisht nga ideja e krijimit të “*kushteve të mira*” dhe “*jetës së mirë*” nën sistemin jugosllav. Shpeshherë kjo fjalë zëvendësohet edhe me fjalët “*senet*” në sensin që “*senet*” janë ato që ia krijojnë njeriut *habitus*-in jetësor, thënë në terma të Pierre Bourdieu-së. Kushtet e shehrit, jeta n’shehër janë destinacioni i fantazisë fshatare për të cilin edhe punohet edhe negociohet edhe taktizohet në kontekst të marrëdhënieve familjare të jetës tradicionale. “*Koha*” po ashtu del si një koncept mjaft i përmendur dhe lidhet kryesisht me mundësitë që ofron dhe nuk ofron. Shpeshherë fshatarët kanë potencuar kohën duke aluduar te ideja e gjendjes së krijuar në sensin se “*janë dalë krejt tash*”, “*s’po rri kush në kit kohë ma*”, “*e ka pasë kur e ka pasë katuni kohën e vetë*”, etj.

Mirëpo disa nga më të moshuarit që kam takuar në shumë fshatra, përfshirë edhe Tefikun nga Grexheniku që e kam cituar më lart, por edhe informatorë të tjerë, theksojnë pa hezitim se “*gratë t’qesin n’shehër*” po ashtu sikurse kanë cekur në disa raste se “*këta të jashtit na qitën se i marunë shpijat atje e thanë hajdi se s’kini ku rrini këtu*”. Kur i kam pyetur se pse gratë paskan qenë shkaktarë, shumica më janë përgjigjur se gratë nuk kanë dashur të maltretohen më me punët e fshatit dhe ndër kushtet kryesore përmendet edhe martesë. Një informator imi tregon se po të mos blinte “*trull n’ shehër*” dhe të garantonte se “*ka me dalë*” së shpejti në qytet, nuk do të mund të martohej sepse, sipas tij, edhe gjatë viteve të 90-ta, por kryesisht pas luftës, kushti kryesor i martesës në fshat ka qenë “*me pasë trull n’shehër*” ose “*me garantue diqysh që s’ka me nejtë qika në katun, me pleh e me gja tanë jetën*”. Informatorë të tjerë më kanë potencuar shpesh qëllimin e grave për t’u arratisur nga familja e madhe e përbashkët apo “*bashkallaku*” si një nga arsyet kryesore të “*ramjes n’shehër*”. Shpeshherë kam dëgjuar edhe fjalët si kjo nga nëna e

²⁰ Në shumë fshatëra të Gollakut shkollat fillore numërojnë vetëm disa dhjetëra nxënës, shpeshherë 1 nxënës për klasë, gjë që shihet si pamundësi e socializimit të fëmijëve përmes edukimit dhe i motivon prindërit për migrimin në qytet.

Fehmiut: “*Gratë të flasin në vesh qërr-qërr, sahatadakik, dej sa ta mushin menen me dalë vetë prej shtëpisë e me ra n’shehër...me ditë që thatë e hanë bukën se gajle s’e kanë veç me ikë prej kallabllaku...tybe as faj s’kanë pasë, se gratë kanë hjekë...veç sa mysafirit, hunit e t’konopit u dashtë me ju shtru bukë vakt e pa vakt...tani ujt larg, thmi shumë... ku smuja, ku shkolla, ku punët, ku fusha...kemi hjekë shumë n’atë kohë*”. Pra në një anë gratë fajësohen si shkaktare të “*ramjes n’shehër*”, e në anën tjetër atyre u bëhet apologjia si nismëtare në aspiratën për ndryshimin e gjendjes.²¹ Ndërsa ndikimi i familjarëve që jetojnë “*jashtë*” ose i “*jashtes/jashtit*” (që nënkupton ndikimi i familjarëve në diasporë) shihet si esencial, kryesisht për arsye të financimit të “*ramjes*” përmes ndërtimit të shtëpisë, intervenimit për gjetje pune, financimit të biznesit në destinacion, etj. “*Djeltë jashtë*” është koncepti kryesor i identifikimit të statusit të familjes në fshatrat e Gollakut. Zakonisht “*djeltë jashtë*” vendosin për “*ramjen n’shehër*” ashtu si vendosin për shumë gjëra brenda familjes. Shpeshherë thuhet për familje të ndryshme që “*ia kanë pa hajrin ni djali që e ka jashtë, se ata qetë si kishin hangër as kurrë s’kishin mujtë me dalë n’shehër*” ose “*e qitën djeltë që i ka në Gjermani se ish metë qatje*”.

Në rastin e Fehmiut vërehet një dilemë që mbizotëron dhe negociohet. Nëse shihet kronologjikisht, arsyeja e “*metjes*” së tij në fshat del se ka qenë pamundësia për të mbijetuar dhe gjetur veten në qytet, në një anë, dhe yshtja për të fituar kapitalin e duhur për të ndërtuar shtëpinë, në anën tjetër, pasi që e ka pasur “*trullin*” e tij. Sidoqoftë, që nga vitet 90 Fehmiu ka parashikur se “*shpejt duhet me dalë se po dalin krejt*”, por vendimin nuk e ka marrë. Kur e kam pyetur: Pse?, shpesh më është përgjigjur se një ndër arsyet kryesore është mundësia që me “*ba diçka, me ba naj shpi, do kushte para se me ra n’shehër*” dhe kur e kam pyetur: Pse?, më është përgjigjur: “*...po qysh me i ba kushtet me ni rrogë, edhe qi pe gjajshe, që boll shtirë pa naj tnjofshum?*”. Pra, Fehmiu tregon se “*metja*” apo “*neja*” e tij në

²¹ Shemsi Krasniqi cek se gratë janë parqitur si forcë modernizuese me vendosmërinë e tyre për të braktisur fshatin dhe për të përmirësuar stilin e jetesës “qoftë përmes ndërhyrjeve ndërtimore në shtëpi, qoftë përmes migrimit në qytet...”. Shih KRASNIQI, Shemsi, “Gender roles in comparative perspective” in “VUNIQI, Luljeta, (ed), *A Lecture on Gender Issues*, Prishtinë, Kosova Gender Studies Centre, 2009, fq. 123. Krasniqi përmend edhe faktin se për gratë fshati “përkujton bagëtinë e bujqësinë, kallaballëkun e fukarallëkun, mbylljen, punët e lodhshme, grindjet...për burrat fshati dhe jeta tradicionale paraqet kujtimet e të parëve, pronën e trashëguara, investimet e shumëllojshme, sakrificat për rritjen e pronës e pasurisë...” (Po aty fq. 123).

fshat është një strategji e përkohshme e akumulimit të kapitalit financiar për të krijuar “kushtet” për destinacionin ku ai do të migrojë. Këto kushte minimale janë zakonisht: ndërtimi dhe rregullimi qoftë i plotë, qoftë edhe gjysmak i shtëpisë së banimit dhe gjetja e një pune. Sikurse edhe kushërinjtë e tij dhe të afërmit e miqtë tjerë, ata që përgatiten, ose janë përgatitur në të kaluarën që të “*bien n’shehër*” kanë bërë dhe bëjnë pothuajse të njëjtat plane për mbijetesë atje. Planifikojnë që të ngrohen me dru që do të sjellin nga fshati, të kompensohen me bashqe që do ta mbjellin, në shumë raste të plotësohen me të ardhura nga remitencat, të gatujnë dhe të hanë vetëm në shtëpi, të punojnë edhe punë argatie të ndryshme për të holla shtesë, të shfrytëzojnë ndihmën sociale si të papunë e kështu me radhë. Shumë prej tyre që jetojnë në paralagje të Prishtinës sikurse Kolovica, marrin edhe bagëti me vete e të tjerët kompensohen me produkte nga fshati përmes marrëdhënieve familjare e fafëfisnore, marrëdhënie këto reciprociteti e solidariteti në sensin e borçit dhe interesit të dyanshëm. Fehmiu ka filluar që të krijojë, po ashtu, një rrjet të miqësisë me familjarë e miq që, sipas tij, mund t’i ndihmojnë potencialisht në gjetjen e një vendi të punës pasi të migrojë në qytet. Madje në disa raste më thotë se u bën favore miqve të ndryshëm që “*kanë lidhje*” të ndryshme, duke ju dërguar falas ose në raste të caktuar me çmime tejet të volitshme gjëra të ndryshme të fshatit si dru për ngrohje, pastërmë apo produkte të ndryshme ushqimore. Krjimi i “*lidhjeve*” me njerëz që mund t’i ndihmojnë në qytete është esenciale për të, sepse kjo bën të mundshëm dhe të realizueshëm migrimin e tij të plotë nga fshati në qytet. Kjo bën të mundshëm “*mu gjetë*” brenda hapësirës urbane apo suburbane.

Tefiku, në anën tjetër, është karakter i veçantë që nuk e do qytetin. Ai dhe bashkëshortja e tij dëshirojnë në esencë të jetojnë të qetë pa zhurmën e familjeve të djemve të tyre me të cilët do të duhej të jetonin, në qytete. Ata po ashtu janë të kënaqur si “*pleq që s’bahen havale për kërkan*” dhe “*me tana kushtet*” në fshat. Sipas Tefikut, atyre nuk u mungon asgjë nga aspekti material, sepse ndonëse jetojnë në grykë mali në Grexhenik, fshat i thellë malor, ata ndihen më të “*rahatum*” atje se sa në Prishtinë. Ndonëse kjo hezitohet të thuhet direkt, shpeshherë Tefiku përmend fjalën “*s’po du me ba telash kurkan*”. Kjo duket të dalë si ofshamë për mungesën e “*kushteve*” të mira të djemve të tij të cilët jetojnë në Prishtinë, që të kujdesen për ta, por edhe iritimi i tyre për të jetuar në bashkësi me djemtë e tyre. Në fshat Tefiku ka shtëpinë të ndërtuar rishtas dhe sipas tij “*më duket*

sikur me gjue njersën e djelve me ba me lanë ktuhen". Në anën tjetër, ai po ashtu arsyeton qëndrimin e tij në fshat si jetë me të cilën "*asht msue*". Në fakt nga ky aspekt nuk vërehet ndonjë bezdi nga jeta në fshat apo lakmia për të jetuar në qytet. Përkundrazi, si potencën edhe më lart, atij nuk i pëlqen të jetojë në zhurmën dhe "*ernat*" e Prishtinës. Por ku e ka shkakun kryesor kjo zgjedhje e tij personale apo familjare sikurse kjo e Tefikut? Në pamundësi të njohjes së familjes së tij të gjerë është vështirë të afirmohet ky pohim i tij me fakte apo evidencë të mjaftueshme për arsye të natyrës së shkurtër të studimit dhe mosnjohjes së gjithë historisë dhe biografisë së marrëdhënieve familjare. Në shumë raste të tjera kam dëgjuar se në fakt arsye kryesore e rasteve të tilla është vetë raporti familjar, ndërfamiljar, social e ekonomik që përcakton zgjedhjet e tilla.

Motivet dhe dilemat e "metjes" dhe "ramjes"

Fluksi i emigrimit të popullatës prej fshatrave të Gollakut në Prishtinë gjatë dekadave të fundit nuk është studiuar në hollësi nga ana demografike e fare pak nga ana sociologjike e antropologjike. Megjithatë, ekzistojnë të dhëna për numrin e popullsisë nga regjistrimi i vitit 2011. Për shembull, fshati Grexhenik në realitet numëron 2 persona në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, aq sa realisht edhe ka - Tefikun dhe Zelihën. Sidoqoftë, pa hyrë në analiza statistikore, një vrojtim i fshatrave të Gollakut, por edhe viseve të tjera malore e konfirmon faktin se ato kanë pësuar dyndje ose dalje të popullatës në një numër të madh. Nëse i viziton fshatrat sot, vëren se shumica e lagjeve apo "*mahallave*" janë të pabanuara, shtëpitë janë në shkatërrim e sipër, livadhet e ndryshme janë "*zanë me therra*", pemët janë tharë, pusët apo bunaret e ujit janë shterruar.²² Fshatarët e Gollakut kryesisht janë vendosur në paralagje të Prishtinës si Kolovica, Vranjevci, Sofalia, por edhe në fshatrat e afërta si Matican, Hajvali, Bardhosh, etj. Disa edhe kanë migruar në Fushë-Kosovë. Lagjja e Kolovicës del si lagje mjaft specifike, sepse shumica e të

²² Pos braktisjes duhet theksuar se vërehet edhe kthimi i banorëve apo trashëgimitarëve të tyre në vendet e të parëve dhe ky kthim vërehet përmes ndërtimit të vilave, shtëpive apo "*vikendicave*" (nga anglishtja "*weekend*", që do të thotë "*fundjave*", fjalë kjo që është përdorur edhe gjatë periudhës socialiste jugosllave) për pushime fundjavore e pushime më të gjata. Po ashtu edhe familjarët që kanë migruar në vende përrëndimore kanë filluar të ndërtojnë shtëpi e "*vikendshtëpia*" të tilla.

migruarëve sot kanë blerë troje të përbashkëta familjare qysh në vitet 80 të shek. të kaluar. Pos tjerash edhe kjo tregon se ka ekzistuar një vetëdije paramigruese, një pranim i daljes në shehër si cak, si fund, si destinacion i dëshirueshëm.

Shumë prej atyre që jetojnë ose sipas fjalëve të tyre ende “*kanë metë*” në fshat, në bazë të intervistave dhe analizave që kam bërë, janë në gjendje të përgatitjes për të migruar në qytet. Megjithatë, shumica janë në dilemë mes “*metjes*” së përkohshme apo shtyerjes së përkohshme dhe “*ramjes*” së përhershme. Shpeshherë burrat e konsiderojnë “*ramjen*” si sakrificë për arsye të disa shkaqeve dhe motiveve që përmendëm më herët si “*shkolla*” e “*kushtet*”, kryesisht për të krijuar mirëqenie për familjen dhe fëmijët, por gjithmonë planifikojnë të mbajnë lidhje me pronat dhe farefisin në vendin e origjinës. Shtëpia dhe puna janë kritere kryesore të integritetit në qytet. Por në raste kur shtëpia është siguruar dhe puna jo, ose është e herëpashershme e jo konsistente, banorët e paralogjeve të cilat identifikohen si “*mahalla*” kushërinjsh (si p.sh. “*te Bellevit*”, “*te Jasharevit*”, etj.) apo mëhalla fshatërash (si për shembull “*mahalla e Brainëve*”, “*mahalla e Marecve*”, etj. nga fshatrat Brainë, Marec, etj.), në bazë të numrit më të madh të një fshati, mbajnë kontakte të përhershme me fshatin si burim i mundësisë për të siguruar të ardhura për familje. Fshatarët e Marecit, të cilët janë të “*ramë*” së fundi në Kolovicë, por edhe të fshatrave të tjera, njihen për prerjen e maleve dhe shitjen e druve për zjarr/ngrohje në Prishtinë e vende të tjera. Pra, pamundësia e shumicës për t’u punësuar apo hapur biznes, e ndonjëherë edhe nevoja për të holla shtesë, i shtyn të kompensojnë të ardhurat përmes shfrytëzimit të pasurive në fshat. Këto raporte me kushërinjtë apo të afërmit farefisnorë në fshatin e origjinës mbahen në marrëdhënie reciprociteti për arsye të interesit të dyanshëm.

Në rastin e Fehmiut kam hetuar se një ndër arsyet e vazhdimet të “*metjes*” së tij në fshat është edhe shfrytëzimi sa më i madh i kohës së papunësisë së familjarëve të tij, të familjes së gjerë dhe farefisit për t’i angazhuar në prerjen e malit, që për Fehmiun sjell kapital direkt për të financuar shtëpinë e re në Prishtinë, ku dëshiron të migrojë. Duke qenë i vetëm me bashkëshorten dhe fëmijët e vegjël, ai bashkëpunon me kushërinjtë e tij të papunë në Prishtinë dhe bashkë me ta “*merr mal me pre*” nga fshatarë të tjerë, të cilët janë të interesuar ose kanë nevojë ta shesin, edhe ata kryesisht për arsye të mungesës konsistente të hollave për ngjarje familjare si dasma, ndërtimi i shtëpisë, shërimi nga sëmundjet, etj. Pastaj përfitimet nga këto të holla ndahen

dhe shfrytëzohen. Pra, vazhdimi i “metjes” është një taktikë apo strategji e mbijetesës dhe e shfrytëzimit të resurseve potenciale edhe në raport me rrethanat sociale e ekonomike të familjes së gjerë dhe rrethanave të tjera në fshat e në qytet. Po ashtu kam vërejtur në disa raste se fshatarë të shumtë kanë qenë të gatshëm të “bien” në qytet, por kanë qëndruar “edhe pak” apo “edhe naj ditë” për të shfrytëzuar politikat subvencionale bujqësore për ngritjen e ndonjë ferme me kafshë, për ngritjen e ndonjë parcele me pemë e kështu me radhë. Madje në shumë raste më është thënë, kryesisht nga të ramët e hershëm në paralagjet e Prishtinës, se fshatarët “po marrin pare, po marrin ndihma n’ tana anët”.²³

Ekziston edhe një diskurs mjaft i sofistikuar për të “metnit” dhe të “ramtë” në shehër. Në një anë, të “metnit” shihen si të gjorë, sepse nuk kanë arritur të dalin nga fshati dhe ende jetojnë të izoluar, të vetëm, me të njëjtat mentalitete, etj. Në anën tjetër, konotimet për “katunarin” kanë filluar të ndërrojnë, sidomos për ata që “kanë vyejtë” ose “janë ba të zotë” ose “kanë pasë dikan jashtë” ose “i kanë ra pantës” dhe që tani kanë krijuar të gjitha “kushter” për jetë të mirë dhe të ardhura të nevojshme në fshat. Po ashtu edhe për të ramët në shehër kanë filluar të krijohen konotime të reja. Ata më nuk shihen vetëm si “të kurtalisun”, sepse kanë dalë nga vendet e izoluar dhe janë në vend modern. Me faktin se shumë prej të “ramëve” punojnë si shërbyes me paga të vogla dhe mezi ia dalin muajit, pikëpamja e përgjithshme për “shehërlinë e ri”, si quhen shpeshherë ata që kanë migruar së fundi nga pjesëtarët e familjeve të tyre, që ende jetojnë në fshat ka filluar të ndryshojë. Për shembull, Fehmiu shpeshherë më ka thënë se po të kishte mundësi për ta zgjeruar fermën e tij ai do të rrinte vetëm në fshat dhe do t’i dërgonte vetëm fëmijët në qytet. Nga familjarët që janë të thyer në moshë ose mbi 40 vjet e sa, gjetja e një vendi pune shihet si problematike, andaj edhe fshati projektohet si vendi i tyre i punës së herëpashershme ose konsistente, varësisht prej rasteve. Fshati mund të shfrytëzohet për mbjellje të tokës, prerje të malit dhe mbajtje të fermës. Të ardhurat nga këto shfrytëzime shihen si ndihmesë kryesore për buxhetin familjar nëse edhe një person është

²³ Kam vërejtur se në përgjithësi në Kosovë edhe familjarët e familjeve të ndryshme shpenzojnë kohë të madhe duke diskutuar për ata që kanë “ra” së fundi dhe përflasin ata që kanë “metë” dhe praktikatat e tyre mbijetuese në fshat. Në këto diskutime vërehet empati, xhelozia, inat, ndjenjë inferioriteti e superioriteti, gjë që përndjellin një studim të veçantë të poetikës, etikës e politikës së marrëdhënies kulturore tradicionale shqiptare të artikuluar në diskurs apo “muhabet” të përditshëm.

në punësim apo sjell rrogë konsistente në familje, gjë që sipas tyre nevojitet për bukën e përditshme. Në një bashkëbisedim të fundit Fehmiu u shpreh kështu:

“Qyre, me pasë ni rrogë, veç ni rrogë me pasë, unë zhdërgjina qitash...se shpinë e maroj me mal e me gja e rregulloj e e ndreqi mirë, kerrin e kam, kombin e kam, traktorin po, krejt senet i kam, shpinë n’katun po...marr mal, bahna idare dej të rriten thmija me hi në punë. Po n’shehër pa ni rrogë n’shpi nuk ban se s’i dihet seneve...tash njeri sot asht, nesra s’asht. Edhe kur ta kqyrsh n’anën tjetër, mali asht i rrezikshum...”

Pra, si cek Fehmiu më lart, migrimi në qytete, sidomos në kushte të një papunësie relativisht të madhe dhe një *“shtrejtësie”* të jetës në qytet në përgjithësi është akt që duhet të planifikohet, të negociohet e ridimensionohet brenda familjes dhe deri në një masë edhe në kontekst të marrëdhënieve familjare, farefisnore e shtetërore. Kështu, edhe *“metja”* edhe *“ramja”* duhet të kuptohen në këtë kontekst social, ekonomik e politik.

Shkaqet, arsyet dhe motivet e mbetjes dhe rënies tregojnë se kemi të bëjmë me një raport të ngjeshur dhe ndërliqshëm mes tyre. As *“metja”* dhe as *“ramja”* nuk mund të kuptohen të shkoqitura nga konteksti i raporteve të gjera shoqërore. *“Metja”* e dikujt lehtëson *“ramjen”* e dikujt, e *“ramja”* e dikujt ndihmon dhe ridimensionon *“metjen”* e dikujt. Pra, janë raporte të ndërliqhme të cilat përthehen në kontekst të zhvillimeve lokale, translokale, globale, etj.

Si përmenda në fillim, si për *“metjen”* dhe si për *“ramjen”*, gjërat kryesore që preokupojnë të migruarit dhe paramigrantët janë punësimi, shkollimi, mungesa e rrugës, martesja e kështu me radhë dhe jepen si arsye kryesore të cilat i kanë shtyrë ata të migrojnë në një hapësirë ku mund të krijojnë vend sikur të tjerët para tyre. Siç theksova, fjala kushte në fakt është fjalë omnipotente, pra është gjithkund dhe e figurativizon gjithë diskutimin mbi arsyet e mbetjes në fshat dhe rënies në qytet. Të gjitha këto aspekte të jetës jepen si mungesë. Pra, thuhet se mungesa e edukimit adekuat, mungesa e punës, mungesa e rrugës, mungesa e kushteve të mira dhe të lehta të jetesës kanë shkaktuar fshatarët e këtyre zonave që të migrojnë në qytet. Pothuajse secili i moshuar që e pyet për *“ramjen”* deklarohet me një apologji.

Thëniet kryesore që kam evidentuar nga shënimet e mia janë: “U kanë jeta e shtirë”, “Kanë hjek gjinja shumë”, “Kemi punue veç për bukë”, “S’kemi pasë kushte”, “Nisën me ra krejt e tybe as mu martu s’ mujke njeri në katun”, “Ramizi e kryu ni shkollë e hini në punë n’shehër e tani ranë tanë mas tina”, “S’i dalke nja, tanaj krejt dalshin se s’kishin qef me met pa shehër: bile ka ni trull e blejshin”, “Po dalin se krejt po i dojnë me dygme”, “Udha i qiti krejt”, “Rroga i qiti krejt”, “Gratë i qitën”, etj.

Përfundim

Në esencë një nga arsyet e migrimit janë edhe motivet e ndryshme të cilat dalin nga një mimetikë apo shëmbëllim social. Shumë prej atyre që kanë migruar në qytet tregojnë se kanë ndjekur modele të atyre që kanë migruar më herët dhe kanë krijuar mirëqenie apo kushte në qytete. Lakmia, imitimi, nevoja, dëshira e yshtja janë bërë motive përndjellëse që kanë nisur fillimisht si mimetikë e mirëqenies së familjeve modele e që kanë migruar më herët në qytet. Për shembull, kam vërejtur se motivet e të qenit familje e pavarur nga gjendja e së bashkut ose bashkallakut kanë qenë përcaktuese në shumë raste. Disa informanta më kanë përshkruar si arsye edhe kur dikush nga “mahalla ka dalë n’shehër” ka krijuar precedentin dhe pastaj atë e kanë ndjekur si shembull shumë të tjerë për arsye të ndryshme të cilat shpeshherë duket se kanë qenë të tilla si ikja nga konflikti. Po ashtu, shpeshherë më është thënë se paga personale ka qenë dhe mbetet objekt i gjakimit të fshatarit/fshatares si pavarësi nga “tiranja e bashkallakut”, nëse e themi këtë në jehonën e fjalëve të Warntz-it²⁴. Shumë fshatarë, sikurse Fehmiu më herët, më kanë thanë me fjalë metaforike se ne jemi: “ku s’ban dreqi vo”, “në fund t’dyjes”, “në rrbina si me kanë n’gjungëll”, “ku sorra ashtin mos ta qoftë” e shumë të tjera. Motive të tjera janë edhe nga diaspora apo insistimi i djemve të dalë në kurbet, në vendet perëndimore për t’i nxjerrë “prej lloqi”, “prej hjekave”, “prej plehu”, “prej xhunglle”, etj.²⁵

²⁴ Shih: WARNTZ, William, ‘Global science and the tyranny of space’ në *Papers of the Regional Science Association*, 1967, 19, 7-19.

²⁵ Kjo shpeshherë më bën të mendoj se nuk është vetëm ikja nga pamundësia e negociimit me tjetrin që e bën migrantin të lë vendin, por edhe pamundësia e të qenit me tjetrin. Kur njeriu ik nga tjetri, vetmia mund të jetë liri e madhe, por kur tjetri ik nga ti, vetmia mund të jetë tirania më e madhe.

Në anën tjetër, ata që kanë mbetur e shohin veten si t'metun "edhe naj ditë". Jetesa në fshatra konsiderohet si para aktit të migrimit, si ditët e fundit, si gjendje "gati" ose në "tetik", sepse migrimi shihet si i domosdoshëm. Kur i pyet e vëren se të japin përgjigje retorike si: "As nuk jemi qi bijmë, as nuk jemi qi rrimë; me nejtë s'ki ku rrin, me shkue s'ki ku shkon" është përgjigje e shpeshtë që haset në konversatione me shumicën e fshatarëve të mbetur. Megjithatë, siç cekta, shpeshherë negocimi është taktik si nga ana e resurseve, ashtu edhe e kohës për të përfituar sa më shumë nga "metja" e përkohshme dhe "ramja" e përhershme.

Njohja edhe më e ngeshme dhe më e gjerë e arsyeve reale, arsyeve të thëna dhe të pathëna dhe njohja e interpretimit të ndryshëm të tyre nga ana e vetë banorëve do të na ndihmonte të bëjmë një interpretim të thukët, siç e potencon antropologu Clifford Geertz²⁶, të pulsit të intensitetit kulturor në kuadër të marrëdhënieve shoqërore dhe jetës së përgjithshme në Kosovë, raporteve brenda familjes, bashkësive fisnore/fshatare e të grupimeve të tjera në kontekst të strukturave, praktikave e proceseve të ndryshme si familja, gjinia, fisi, shteti e shumë të tjera. Antropologu holandez Ger Duijzing vlerëson se "një kuptim i thellë i identiteteve rustike kundërbane, identitete këto që e sfidojnë hegjemoninë kulturore të urbanes së sofistikuuar, në pikëpamjen time, është një nga kontributet më të rëndësishme që antropologjia mund t'i bëjë studimit të qyteteve të Evropës Juglindore".²⁷ Mendoj se e njëjta gjë ka të bëjë edhe me antropologjinë e migrimit, antropologjinë e fshatit të sotëm malor dhe antropologjinë e hapësirës dhe vendit rural dhe urban, sepse përshkrimi i thukët etnografik dhe njohja e hollë interpretative do të krijonte pamjen e sjelljes, kulturës, traditave dhe gjithë spektrit të praktikave të tjera shoqërore që dalin si rezultat i ndeshtrashjes së hapësirave e vendeve, fshatit e qytetit, katunarit e shehërlisë.

²⁶ Shih: GEERTZ, Clifford, *The Interpretation of Cultures: Selected Essays*, New York, Basic Books, 1973.

²⁷ DUIJZINGS, Ger, 'From Bongo Bongo to Boston via the Balkans: anthropological contributions to the study of urban transformations in southeastern Europe' në BOHN, Thomas M & CALIC, Marie Janine (eds.) *Urbanisierung und Stadtentwicklung in Südosteuropa vom 19. bis zum 21. Jahrhundert*. 47. München: Otto Sagner (Südosteuropa- Jahrbuch 37), 2010, 100.

Lumnije Kadriu, Prishtinë

DIASPORA SHQIPTARE E KOSOVËS BRENDË PËRKUFIZIMEVE TË DIASPORËS DHE TRANSNACIONALIZMIT

Abstrakt

Konceptimi i diasporës si nocion në ditët e sotme është mjaft kompleks. Për zgjerimin e kuptimeve të këtij termi në hapësirën semantike, konceptuale e disiplinore flet edhe autori Rogers Brubaker i cili këtë tendencë e shpreh që në titullin e punimit të tij ‘The “diaspora”, duke aluduar në përhapjen e termit diasporë.

Zhvillimi, e pra edhe zgjerimi i këtij koncepti bën që sot në këtë grup si kategori të numërohen një sërë njerëzish mobilë të cilët për migrim kishin arsye dhe motive të ndryshme. Ky rrugëtim shtrihet prej konceptimit klasik të diasporës ku hynin vetëm hebrenjtë, armenët e grekët shkak i lëvizjes së të cilëve ishte shpërngulja e dhunshme, deri te konceptimi bashkëkohor ku numërohen grupe apo komunitete të ndryshme që lëvizin për shkaqe dhe motive të llojllojshme siç janë: migrantët, refugjatët, punëtorët vizitorë, komunitet e dëbuara etj.

Në anën tjetër, në shkencat shoqërore nevoja për të kuptuar e analizuar sa më mirë proceset shoqërore bën që vazhdimisht të lindin qasje të reja. Një qasje e tillë është edhe qasja transnacionale e cila është e fokusuar në studimin e lidhjeve të njerëzve mobilë me një apo më shumë vende.

Çështjet e lidhura me atë se si ishte konceptuar diaspora shqiptare dhe si mund të konceptohet sot diaspora shqiptare e Kosovës dhe si mund të ndihmojnë studimet transnacionale në njohjen dhe kuptimin më të mirë të këtij komuniteti diasporik janë çështje trajtimi në këtë kumesë.

Definimi i koncepteve të diasporës

Në kohët e sotme secili studiues që merret me çështjet e diasporës e thekson numrin çdo herë e më të madh të studimeve lidhur me këtë temë. Autori Brubaker madje thekson se ‘kjo ka rezultuar në atë që mund të quhet “The ‘diaspora’ diaspora” – përhapje e kuptimeve të këtij

termi në hapësirën semantike, konceptuale dhe disiplinare.¹ Si rrjedhojë sot ekzistojnë definicione dhe shpjegime të shumta të këtij termi, të cilat varen nga perspektiva e studiuesve që merren me këtë çështje si dhe nga studimet apo disiplinat e tyre respektive, siç janë studimet e migrimit, ato transnacionale, sociologjike, etnologjike etj.

E përbashkëta për të gjitha definicionet është se diaspora ka të bëjë me një numër njerëzish, anëtarë të komunitetit të njejtë, që *për arsye të ndryshme* lëvizin nga një vend (i origjinës, i njohur zakonisht si vendlindje) për të jetuar në ndonjë vend tjetër.

Fillimisht, vetëm përvoja e popullit hebre të shpërndarë anë e mbanë botës nënkuptohej me termin diasporë. Për Safran-in madje kjo përfaqëson ‘tipin ideal’ të diasporës.² Me kohë, në këtë kategori, në kuptim të gjerë, u përfshinë anëtarët e popujve të tjerë të konceptualizuar si anëtarë të cilitdo nacionalitet apo etnicitet.

Për më tepër, klasifikimet e diasporave të ndryshme u bënë jo vetëm sipas arsyes së shpërndarjes së tyre nga vendlindja (shpërndarje që zakonisht ishte e dhunshme dhe traumatike, gjë që kontribuonte në ruajtjen e kujtimit për të, idealizimin e saj, lojalitetin ndaj saj etj.), por gjithashtu edhe sipas lidhjeve dhe raporteve të diasporasve/mërgimtarëve³ me vendin e origjinës, d.m.th. vendlindjen. Prandaj edhe ndeshim terma si: ‘diasporë klasike’ (Hebrenjtë, grekët e armenët), ‘diasporë viktimë’ (Palestinezët, hebrenjtë), ‘diasporë e tregtisë’ (Kinës, Libisë, Indisë, Gjermanisë Baltikut), etj. Disa grupe tjera të migrantëve u klasifikuan si ‘nacionalistë në distancë’

¹ Rogers Brubaker, ‘The “Diaspora” Diaspora’, *Ethnic and Racial Studies*, Vol. 28. No 1. (2005), shih gjithashtu Robin Cohen, *Global Diasporas: An introduction*, Second edition (London: Routledge, 2008).

² William Safran, ‘Diasporas in Modern Societies: Myths of Homeland and Return’, *Diaspora* 1(1) (1991) ff. 83-99, referuar në James Clifford, ‘Diasporas: Further Inflections: Toward Ethnographies of the Future.’ *Cultural Anthropology*, Vol. 9, No.3, (1994), ff. 302-338 (f.305). Më shumë për nocionin e ‘tipit ideal’ shih edhe Cohen, *Global Diasporas*,

³ Termat diasporë dhe mërgatë janë sinonime dhe në tekst mund të ndeshen në mënyrë alternative. Njëra ndër arsyet për këtë vendim është se termi diasporë për këtë kategori çdo herë e më shumë po përdoret si në rastet zyrtare, ashtu edhe në diskursin e përditshëm, pra vernakular, edhe pse për këtë kategori në gjuhën shqipe ekziston tashmë i konsoliduar termi mërgatë. Arsye tjetër është fakti se në literaturën ndërkombëtare trajtimi i këtij koncepti bëhet me këtë emërtim, të themi ndërkombëtar. Megjithatë, pjesëtarëve të kësaj kategorie në gjithë tekstin do t’u referohemi si mërgimtarë. Patjetër duhet cekur se mund të ndeshen edhe termat e ndërlidhura e shpeshherë sinonimike me këto të parat, siç janë migrantë, refugjatë etj.

(Hindusët, irlandezët, shqiptarët, kurdët, tamilët...) për shkak të angazhimit të tyre të vazhdueshëm politik me vendlindjen, përfshirë përkrahjen terroriste dhe ultranacionaliste. Si rezultat i përhapjes së mëtejme të termit diasporë gjithashtu u përfshi si kategori diaspora e punës, e cila mbante lidhje emocionale dhe sociale me vendlindjen (Filipinët, turqit, grekët, italianët, polakët dhe vietnamezët etj). Kështu, termi që fillimisht përshkruante shpërndarjen e hebrenjve, grekëve e armenëve tash kishte marrë, siç pohon Brubaker dhe pajtohen të tjerët, kuptimet nga domeni më i gjerë semantik i cili përfshinë fjalët si imigrant, emigrant, refugjat, punëtor vizitor, komunitet i shpërngulur, komunitet etnik.⁴

Robin Cohen në botimin e tij të rishikuar të librit *Global Diasporas* (Diasporat globale) sjell perspektiva interesante të konceptit të diasporës, duke elaboruar edhe perspektiva teorike edhe metodologjike në lidhje me diasporën. Ai mendon se përpjekjet për definimin e diasporës si term janë tejet të rëndësishme pikërisht për shkak të përhapjes shumë të madhe të tij dhe prandaj për lehtësimin e kategorizimit të diasporës propozon katër mjete. Mjeti i parë do të ishte ‘raporti emik/etik’, që nënkupton mënyrën se si anëtarët e diasporës si komunitet e perceptojnë veten (emik) dhe mënyrën se si të jashtëmit i perceptojnë ata (etik). Mjeti i dytë do të ishte ‘kalimi i kohës’, meqë ‘për paraqitjen e një vetëdijeje diasporike duhet të ekzistojë një lidhje e fortë dhe e ripërtërirë me të kaluarën ose një bllokim ndaj asimilimit si në të tashmen, ashtu edhe të ardhmen [...]’. Mjeti i tretë është një listë e ‘karakteristikave të përbashkëta’⁵, që

⁴ Brubaker, ‘The “Diaspora” Diaspora’, ff. 2-3.

⁵ “Karakteristikat e përbashkëta të diasporës’ sipas Cohenit janë: 1. Shpërndarja nga vendi i origjinës shpesh në mënyrë traumatike, në dy apo më shumë regjione të huaja; 2. Pëveç kësaj apo si alternativë, shpërhapja nga vendlindja në kërkim të punës, në ndjekje të tregtisë ose të ambicieve të mëtejshme koloniale; 3. Kujtesa dhe miti kolektiv për vendlindjen, përfëshirë lokacionin e saj, historinë, vuajtjet dhe të arriturat (sukseset); 4. Idealizimi i vendit real apo të imagjionuar të paraardhësve dhe angazhimi kolektiv për ruajtjen, restaurimin, sigurinë dhe prosperitetin e madje edhe krijimin e tij; 5. Hartimi i shpeshtë i lëvizjes për kthim në vendlindje i cili fiton miratim kolektiv edhe nëse shumëkush nga grupi është i/e kënaqur me vetëm një lidhje të deleguar – sa për hatër (vicarious) apo vizita të kohëpaskohshme me vendlindjen; 6. Vetëdije e fuqishme e grupit etnik të mbajtur për kohë të gjatë dhe të bazuar në kuptimin e dallueshmërisë, një historie të përbashkët, bartjes së trashëgimisë së përbashkët kulturore e fetare dhe besimin në fatin e përbashkët; 7. Marrëdhënie e trazuar me shoqëritë pritëse, duke sugjeruar mungesën e pranimit apo mundësinë që ndonjë fatkeqësi tjetër mund t’i ndodhë grupit; 8. Ndjenja e empatisë dhe

përbëhet nga karakteristikat e rishikuara të Safranit dhe shtojcave të Cohenit dhe si mjet të fundit Coheni përdor ‘tipet ideale’ të Weberit, sipas të cilave diasporat tipologjizohen dhe klasifikohen në disa grupe, si: diaspora viktimë, e punës, imperiale/perandorake, e tregtisë dhe e deterritorializuar. Ai shpjegon se “idealja” Weberiane në të vërtetë nënkupton strukturën e cila duhet të krahasohet me shembuj të ndryshëm ‘realë’, të cilat janë devijime nga idealja të formuara nga kombinimet e ndryshme të 9 karakteristikave të përbashkëta; kështu secili kombinim paraqet një lloj të veçantë.⁶ Prandaj është e kuptueshme që Cohen konkludon se secili komunitet i definuar si diasporë përbëhet nga kombinime të ndryshme të 9 karakteristikave të përbashkëta marrë nga Safrani, Weberi e Coheni, duke përfaqësuar kështu një rast unik pa marrë parasysh ngjashmëritë e mundshme me të tjerët.

Cohen argumenton se diaspora si nocion dhe fenomen i është nënshtruar disa fazave të zhvillimit, duke filluar nga e ashtuquajtura ‘Diasporë Prototipike/ Prototypical Diaspora’, pastaj ‘Koncepti i zgjeruar i diasporës/The Expanded Concept of Diaspora’, ‘Kritikat social-konstrukcioniste të diasporës/Social Constructionist Critiques of Diaspora’ dhe tash ‘Faza e konsolidimit/ Consolidation Phase’.⁷

Në vazhdim, duke përshtuar ndarjet e bëra nga autori Cohen do të mundohem të paraqes zhvillimin dhe pozitën e diasporës së shqiptarëve të Kosovës në to, duke i bazuar edhe në kategori të mëdha kohore siç janë paramoderniteti, moderniteti, postmoderniteti dhe bashkëkohësia, krejt kjo me qëllim të pasqyrimin sa më të qartë e të plotë të zhvillimit të termit diasporë dhe kontekstit të diasporës shqiptare të Kosovës në te.

Paramoderniteti. – ‘Diaspora prototipike’ e Cohenit përbëhet nga diaspora hebrije dhe armene, diasporë e cila nga disa autorë gjithashtu njihet me emrin ‘diasporë klasike’.⁸ Këto komunitete janë të veçanta, sepse vendlindjet e tyre në kohën kur kishte ndodhur shpërngulja e tyre nuk ishte e kufizuar si territor i shtetit nacional në

bshkëpërgjegjësisë në vendet e tjera të vendosjes madje edhe aty ku shtëpia (home) ka kalur në diçka rudimentare dhe 9. Mundësia për një jetë dallueshëm kreative, pasuruese në vendet e pritjes me tolerancë ndaj pluralizmit (p. 17). (Cohen, *Global Diasporas*, f. 15-18)

⁶ Për tipet ideale të diasporës, shembujt dhe shënimet shih: (Cohen, *Global Diasporas*, f. 18)

⁷ Shih Cohen, *Global Diasporas*.

⁸ Brubaker, ‘The “Diaspora” Diaspora’, ff. 2.

kuptimin modern. Të dy shtetet, Izraeli si shtet i hebrenjve dhe Armenia i armenëve u krijuan në shekullin e njëzet, derisa emrat e komuniteteve të tyre kanë lidhje me komunitete dhe identitete përkatëse religjioze ose etnike. Kështu jo vetëm diaspora hebreje e armene po edhe diasporat tjera të cilat e kishin konstruktuar identitetin e tyre rreth përkatësisë fetare apo etnike (apo racore) në një kuptim më të gjerë regional brenda mbretërive apo perandorive (apo kontinenteve) mund të përfshihen në konceptin e paramodernitetit.

Për sa u përket shqiptarëve, në paramodernitet ata pëfaqësonin një grup të caktuar etnik, me gjuhë dhe kulturë të caktuar në Gadishullin Ballkanik. Në literaturën që ka të bëjë me migrimet shqiptare, lëvizjet e arbëreshëve në vendet e tjera si në Greqi, Itali, Kroaci, Hungari, që ndodhën si rezultat i luftërave përderisa Perandoria Osmane po depërtonte në Ballkan përshkruhen si diasporë historike (e cila duket të jetë në një linjë me ‘diasporën prototipike’) dhe dallohet nga e ashtuquajtura diaspora bashkëkohore në të cilën përfshihen migrimet pas themelimit të shtetit shqiptar në vitin 1912.⁹

Moderniteti. – Në ‘Konceptin e zgjeruar të diasporës’ së Cohenit përfshihen shumica, në mos të gjitha llojet e diasporës, të cilat kanë lidhje në një mënyrë apo tjetër jo vetëm me konceptin e shtetit-komb dhe kombit, por edhe me konceptin e minoriteteve etnike. Njerëzit për shkak të luftërave dhe konflikteve jo vetëm që u shpërndanë në raste të caktuara me dhunë dhe në mënyrë traumatike, por gjithashtu u ndanë me anë të themelimit të kufijve të rinj të shteteve kombe. Bazuar në faktin se identitetet etnike ose nacionale ishin ndërtuar përgjatë një procesi të gjatë kohor, kurse kufinj të shteteve kombe ishin caktuar si rezultat i vendimeve të ndryshme politike dhe të fuqive, siç thotë edhe Brubaker, disa grupe në mënyrë aksidentale u lanë jashtë ‘vendlindjes’ së tyre etnokombëtare dhe këto, sipas tij, mund të konsiderohen si diaspora aksidentale.¹⁰ Prandaj ai e

⁹ Shih E.Çabej, ‘Ngulimet shqiptare jashtë atdheut’, *Studime Gjuhësore V*, 56-61; Islami, *Studime demografike*, f.409; Valbona Sulemani, ‘The Albanian diaspora: immigration and settlement experiences’ (Theses and dissertations. Paper 624. 2009). f. 5 <<http://digital.library.ryerson.ca>>; <<file:///C:/Users/V/Downloads/OBJ%20Datastream.pdf>> [qasur 10 shtator 2014]. Duhet vërejtur se diaspora shqiptare e Kosovës është e përfshirë në shumicën e librave që merren me diasporën shqiptare në përgjithësi. Shih edhe Schmitt, *Kosova –histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (2002), p. 219-224.

¹⁰ Për këtë shih Rogers Brubaker, ‘Accidental Diasporas and External “Homelands” in Central and Eastern Europe: Past and Present’, in *Political*

definin këtë dukuri jo vetëm si shpërndarje të njerëzve, por edhe si shpërndarje të kufijve.

Përveç kësaj, në modernitet, si rezultat i stadeve të ndryshueshme zhvillimore politike dhe ekonomike të shteteve kombe, si rezultat i industrializimit u shfaqën kategori tjera të diasporës, bazuar, siç u përmend më parë, në aktivitetet në të cilat ishin angazhuar njerëzit e shpërndarë, pra diaspora e punës, e tregtisë, e nacionalistëve në distancë etj. Është me rëndësi të vërehet se në periudhën e modernitetit, edhe pse lidhjet me vendin e origjinës janë mbajtur, intensiteti i kontakteve me njerëzit atje dhe me vetë vendin ishte konsiderueshëm më i vogël dhe shumë më i vështirë.

Moderniteti në Ballkan shpesh shënohet me rënien e Perandorisë Osmane të përcjellë me disa luftëra ballkanike dhe dy luftëra botërore, të cilat në të njëjtën kohë paraqisnin jo vetëm luftërat midis fuqive, por gjithashtu edhe luftërat për toka dhe kufij të kombeve të krijuara, që u themeluan si kufij shtetëror. Këta kufij u definuan nga ‘komisionet për kufij’ të cilat i themeluan Fuqitë e Mëdha, e të cilat e filluan punën pas rënies së Perandorisë Osmane, ndërsa e përfunduan atë në vitin 1926. Që atëherë ‘kufijtë e Shqipërisë kanë mbetur relativisht të njëjtë’.¹¹ Atë kohë një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve mbetën jashtë këtyre kufijve, një pjesë brenda asaj që atëherë quhej Mbretëri Serbo-Kroate-Slllovene dhe pas Luftës së Dytë Botërore brenda Jugosllavisë, respektivisht në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi Jugore.¹² Sidoqoftë, vetëdija e tyre tashmë e themeluar etnike e kombëtare u ruajt e madje edhe u forcua dhe shteti i Shqipërisë u referua si mëmëdhe. Pra, këtu diaspora aksidentale e Brubaker, që u përmend më herët, kishte ndodhur dhe shqiptarët e Kosovës ishin një rast i tillë.

Përveç kësaj, si rezultat i marrëveshjes së paraluftës midis Jugosllavisë së vjetër dhe Turqisë që popullata turke të shpërngulej në Turqi, një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës dhe më gjerë u trajtuan si turq dhe u detyruan të migrojnë. ‘Aksioni i armëve’ ishte vetëm një mënyrë apo një ‘mjet’ për t’i detyruar shqiptarët që të

Science Series 71 (Institute for Advanced Studies, Vienna 2000) [15 shtator 2014]. Shih gjithashtu Brubaker. The ‘diaspora’ diaspora f. 5.

¹¹ Sulemani, ‘The Albanian diaspora: immigration and settlement experiences’, ff. 7-11.

¹² Në lidhje me shqiptarët në Jugosllavi shih edhe Shmitt, *Kosova – histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (2002) f. 177; Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër* (2001).

lëshojnë vendin. Vlerësohet, siç pohon Schmitt, se midis vitit 1953 dhe 1966 një numër total prej 100.000 shqiptarëve myslimanë kishte migruar për Turqi.¹³ Prandaj, siç shihet, në këtë kohë të shkurtër nga shqiptarët e Kosovës u krijua edhe një ‘diasporë aksidentale’ e edhe një ‘diasporë viktimë’.

Kjo gjë ndryshoi vetëm pas vitit 1966 me ndryshimet kushtetuese të cilat i dhanë Kosovës më shumë të drejta krahinore. Por ky relaksim politik pas vitit 1966 krijoi diasporën e punës shqiptare të Kosovës e cila në të vërtetë rezultoi nga kontrata e bërë midis Shteteve të Perëndimit dhe Jugosllavisë për punësim të punëtorëve sezonal.¹⁴

Më vonë, në fund të viteve 1980 dhe gjatë viteve 1990 Kosova krijoi diasporë politike e ekonomike si rezultat i përkeqësimit të situatës dhe statusit të Kosovës. Ikja e djemve të rinj nga shërbimi ushtarak, mbyllja e universitetit dhe përjashtimi masiv i shqiptarëve nga vendet e punës bënë që migrimi, azilkërkimi ekonomik e politik të prodhojë dhe shtojë një valë të re të diasporës viktimë. Thënë më saktë krijohet një kombinim i diasporës viktimë për shkak të situatës politike dhe të diasporës së punës për shkak të situatës ekonomike.

Kulmi i krijimit të diasporës nga shqiptarët e Kosovës ndodhi me dëbimin masiv të tyre në vitin 1999.

Postmoderniteti. – ‘Kritikat social-konstrukcioniste të diasporës (Social Constructionist Critiques of Diaspora) përfshijnë diasporat e vjetra e të reja të interpretuara në kuadër të shpjegimeve teorike dhe kushteve postmoderniste të cilat karakterizohen, siç u tha më sipër, më shumë për nga proceset se sa format, më shumë nga formacionet se format, më shumë nga konstruktivet se sa diçka e parapërcaktuar me territor, esencë apo natyrë, më shumë me tejkufijë/transkufijë se sa kufij, më shumë nga përzierjet se sa pastërtia, pra hibridizimi, etj. Kjo, në anët tjetër, ishte si rezultat i zhvillimeve në teknologji, që bënë migrimin, d.m.th. mobilitetin të shtrihet në mënyrë domethënëse në nivel global, që ndikonte gjithashtu edhe në gjendjen shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike tek njerëzit. Prandaj për shkak të paraqitjes së këtyre fenomeneve të reja, kjo periudhë quhet gjithashtu ‘postnacionale’, duke aluduar në dobësimin e shteteve-kombe.¹⁵ Gjatë periudhës moderne

¹³ Schmitt, f. 177.

¹⁴ Shih më saktë: Muhamet Mustafa at. al ‘Diaspora dhe politikat e migracionit’ Forum 2015, Prishtinë f. 27.

¹⁵ Shih Appadurai, *Modernity at Large*; Brubaker, ‘Accidental Diasporas and External “Homelands” in Central and Eastern Europe: Past and Present’, Cohen, *Global Diasporas*, f. 174.

kombet u definuan si ‘komunitete të imagjinuara’ të kufizuara kryesisht me kufijtë e shteteve-kombe, të cilat në postmodernitet (si rezultat i mobilitetit më të madh të njerëzve rreth e përçark botës dhe zhvillimit të teknologjisë në komunikim e media që po u mundëson njerëzve dhe grupeve në lëvizje të mbajnë lidhje më të shpeshta dhe më të qëndrueshme me komunitetet e tyre religjioze apo etnike), siç pohonte Appadurai, po marrin fund, duke i lëshuar vend formimit të ‘sferave publike diasporike’ [...] në ‘rendin politik postnacional’.¹⁶

Kushtet bashkëkohore. – ‘Faza e konsolidimit’, pas asaj postmoderne, mund të thuhet të dallohet si një periudhë ku tendencat kundërthënëse jo vetëm se janë prezente dhe këmbëngulëse, por ato gjithashtu po pranohen dhe studiohen. Tendencat e ndryshme kundërthënëse në shoqëri janë marrë parasysh që nga Durkheim, por, në periudhën moderne ekzistonin supozime për një zhvillim unilinear të shoqërisë (si p. sh. ajo e Shkollës së Frankfurtit) dhe se një gjendje sociale (p. sh. tradicionale) do të zëvendësohej me një tjetër (moderne), që madje supozohej se moderniteti do të rezultonte në një unifomitet të plotë dhe përfundimtar, etj.

Sidoqoftë, sot duket krejt e qartë se zëvendësimi i një forme me një tjetër nuk mund të bëhet dhe se kompleksiteti sa vjen e shtohet, prandaj shfaqja e fenomeneve të reja të jashtëzakonshme po vazhdon posaçërisht për shkak të këmbëngulësisë së tendencave kundërthënëse. Për shembull, shumë studiues, siç u cek edhe më sipër, e kanë paraparë degradimin e shteteve-kombe, duke qenë dëshmitarë të paraqitjes së projekteve të ndryshme supranacionale, si p. sh. Bashkimi Evropian, liberalizimi i lëvizjes e i tregtisë dhe krijimit të kompanive të shumta transnacionale, etj. Si rezultat i gjendjes postmoderne, përzierja, hibriditeti dhe imagjinata theksoheshin dukshëm. Meqë komunikimi dhe ruajtja e lidhjes së mërgimtarëve me vendlindjen nuk ka qenë asnjëherë më e lehtë, gjendja postmoderne reflektohet mjaft shumë si kulturalisht, ashtu edhe ekonomikisht e politikisht. Siç e thotë Cohen:

“Ajo që dëshironin nacionalistët e shekullit nëntëmbëdhjetë ishte një hapësirë ‘për secilën racë’, një territorializim të secilit identitet shoqëror. Atë që ata fituan në vend të kësaj është një zinxhir i qyteteve kosmopolitane dhe përhapjes çdo herë e më të madhe të identiteteve subnacionale e transnacionale që nuk mundën lehtë të mbahen në sistemin e shtetit komb”¹⁷

¹⁶ Appadurai, *Modernity at Large*, f. 22.

¹⁷ Cohen, *Global Diasporas*, f. 174.

Megjithatë, prapëseprapë, derisa shumë studiues kanë presupozuar shkatërrimin e shteteve kombe, ata gjithashtu vërejnë se migrimi asnjëherë më parë nuk ka qenë më i kontrolluar.¹⁸ Prandaj në këtë fazë kemi të bëjmë me këmbënguljen-vazhdimësinë e shtetit komb, por gjithashtu edhe këmbënguljen e njerëzve për identitetet e tyre kulturore. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe me krijimin e riorganizimit supranacional nga politikat e të cilit varen jo vetëm shtetet kombe, por gjithashtu edhe fatet e njerëzve çdo herë e më mobil të cilët ndërveprojnë në mënyra të ndryshme.

Një tendencë kundërthënëse në lidhje me mërgimtarët gjithashtu vërehet edhe kur Cohen shton se ‘ata dëshirojnë jo vetëm sigurinë dhe mundësitë që janë në dispozicion në vendet e vendosjes, por gjithashtu edhe raportin e vazhdueshëm me vendin e origjinës dhe anëtarët bashketnik në vendet e tjera [...] Diasporat artikulojnë kërkesat e tyre në kuadër të të drejtave të njeriut apo “të drejtave të grupit”.¹⁹

Dhe kështu në stil të njëjtë studimet mbi diasporën theksojnë mënyrat e reja të ruajtjes së “të njëjtës së ndryshueshme”, diçka që është pafundësisht e hibridizuar dhe në proces, por vazhdimisht aty – kujtimet dhe praktiket e identitetit kolektiv të ruajtura në periudha të gjata kohore’.²⁰ E kjo ‘e njëjtë e ndryshueshme’ gjithashtu u quajt nga Cliffordi ‘taktikë e padëmshme e mbijetesës etnocentrike [...] jo qëllim absolut në vete’²¹. Koncepti i Martin Sökefeldit për ‘formimin e diasporës si një “rast i veçantë i etnicitetit”, si “komunitete të imagjinuara transnacionale që bashkojnë segmente të popujve që jetojnë në lokacione të ndara territorialisht”²² së bashku me etnopeizazhet dhe prodhimet e lokalitetit²³ të Appadurait mund të kuptohen në të njëjtën mënyrë, pra si *ruajtje e së njëjtës së ndryshueshme*.

Postmoderniteti dhe bashkëkohësia në kontekstin kosovar

Natyrisht se kufijtë ndërmjet periudhave të mëdha kohore të definuara si premodernitet, modernitet e postmodernitet asnjëherë nuk janë krejt të qarta. Një situatë e tillë sidomos është e paqartë në rastin

¹⁸ Shih Brubaker, ‘The ‘diaspora’ diaspora’, f. 9.

¹⁹ Cohen, *Global Diasporas*, f. 173.

²⁰ Clifford, ‘Diasporas’, ff. 320.

²¹ Clifford, ‘Diasporas’, f.322).

²² Cohen, *Global Diasporas*, f. 13.

²³ Shih: Appadurai, *Modernity at Large*.

e Kosovës. Në realitetin kosovar këto na vijnë si shumë të ngjeshura dhe vështirë të ndara. Për më tepër na vijnë si simultanisht të realizuara. Sot Kosova është shtet i pavarur – nuk është as pjesë e Serbisë, as e Shqipërisë, as e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Kosova është tejet e përfshirë në proceset globale ekonomike, politike e sociale. Kosova ende krijon diasporë edhe pse me intensitet më të ngadalshëm. Falë faktorëve të shumtë të brendshëm e të jashtëm dhe për shkak të kompleksitetit të situatës në përgjithësi, ndër shqiptarët e Kosovës mund të shihen se janë në zhvillim e sipër një numër trendesh dhe interesash lidhur me atë se si të identifikohen në shtetin e ri. Një gjë e tillë gjithashtu reflektohet edhe te diaspora e shqiptarëve të Kosovës. Si e perceptojnë veten dhe si i perceptojnë të tjerët? Cili është raporti i tyre me vendlindjen dhe cilat janë angazhimet e tyre ndaj vendlindjes? Cilat simbole janë të rëndësishme për ta? Është me mjaft interes të shihet se si këto identifikime reflektohen në praktikat transnacionale të diasporës shqiptare të Kosovës. Kjo sidomos është me shumë interes kur ‘sferës diasporike’ të diasporës së shqiptarëve të Kosovës, ku përfshiheshin edhe shqiptarët e trojeve tjera të ish-Jugosllavisë që nga vitet nëntëdhjetë me intensitet të madh i është shtuar edhe prania e shqiptarëve të Shqipërisë, migrimi i të cilëve gjatë kohës së komunizmit ishte i pamundur.

Krijimi i shtetit të ri imponon përkatësi dhe identifikime të caktuara. Themelimi i Kosovës si shtet i ri në periudhën postmoderne mund të interpretohet në disa mënyra. Njëra prej mënyrave të interpretimit mund të jetë në kontekstin e shprehjeve sub-nacionale. Tendencat për theksimin e identiteteve subnacionale dhe regjionale si rezultat i projekteve supranacionale dhe rëndësisë së shpërbërjes së shteteve-kombe janë të dukshme pa marrë parasysh realitetet kontraverse të vetë procesit. Në njëërën anë procesi është i përshkuar me projekte të ndryshme elitiste nga lart, rezistenca të ndryshme nga poshtë, si dhe të tjera negocijime të imponuara.²⁴ Në anën tjetër edhe nevoja për ruajtjen e së njëjtës së ndryshueshme duket shumë e theksuar.

Për të ardhur te përgjigjet dhe rezultatet më të mira hulumtuese mbi gjendjen dhe proceset brenda grupeve diasporike është aktuale për më shumë se një dekadë qasja e studimeve transnacionale.

²⁴ Më shumë për këtë shih Lumnije Kadriu, ‘Identity Construction among Albanians of Kosovo’, në *Annuario 2*, (Tiranë: The Albanian Yearbook of Historical and Anthropological Studies, Center for Historical and Anthropological Research, 2013).

Studimet dhe qasja transnacionale

Derisa në periudhën e modernitetit studimet mbi diasporën ishin të fokusuar më tepër në integrimin dhe asimilimin e këtyre grupacioneve në vendet pritëse, duke mos anashkaluar edhe qëndrimin dhe imagjinimin e tyre ndaj vendlindjes, tanimë në qendër të studimeve mbi diasporën janë lidhjet dhe raportet që këto grupe kanë jo vetëm me vendlindjen, por edhe me vendin pritës apo edhe me vende të tjera me të cilat ata si komunitet mund të kenë ndërlidhje. Këto lidhje dhe komunikime, siç u cek më sipër, sot janë mjaft të lehtësuara dhe me intensitet shumë më të madh në rastet e shteteve pa kriza lufte dhe me zhvillime demokratike.

Studimet me këtë fokus janë emëruar si studime transnacionale dhe përgjatë zhvillimit të tyre dolën edhe një sërë konceptesh.

Alejandro Portes në esenë e tij “Globalizimi prej së poshti: ngritja e komuniteteve transnacionale” shkruante:

“Si kontribut në këtë analizë unë po përpiqem që në këtë punim t’i jap një formë teorike konceptit të komuniteteve transnacionale, si kundërshti më pak e vërejtshme, por potencialisht e fuqishme ndaj formave më shumë të dukshme të globalizimit të përshkruar në literaturën e kohëve të fundit”.²⁵

Diskursi për migrantët transnacionalë filloi gjatë viteve 1990. Nina Glick Schiler kishte vërejtur se ‘transmigrantët janë ata migrantë jeta e përditshme e të cilëve varet nga ndërlidhjet e shumëfishta dhe konstante përgjatë kufijve ndërkombëtarë dhe identitetet publike të të cilëve janë të konfiguruar në raport me më shumë se një shtet-komb’ (p.48), kështu që ata gjithashtu ‘[...] mbajnë, ndërtojnë dhe përforcojnë lidhje të shumëfishta me vendet e tyre të origjinës [...] (p.52)’, derisa ‘migrimi transnacional është një proces me anë të të cilit migrantët krijojnë dhe ruajnë raporte shoqërore simultane dhe të shumëfishta që lidhin shoqëritë e tyre të origjinës dhe të vendosjes.’²⁶

²⁵ Alejandro Portes, ‘Globalization from Below: The Rise of Transnational Communities’ (Princeton University, 1997), f.3
<<http://www.transcomm.ox.ac.uk/working%20papers/portes.pdf>> [qasur 5 janar 2015].

²⁶ Glick Schiler *et al.* ‘From immigrant to Transmigrant: Theorizing Transnational Migration’ in *Anthropological Quarterly*, 68(I) (1995) ff. 48.

Edhe globalizimi edhe transnacionalizmi si studime u dëshmuar të jenë relativisht frytdhënëse, duke mundësuar teorizime dhe qasje të mëtejme nga disiplina dhe studime të ndryshme përfshirë studimet e migrimit, sociologjinë, antropologjinë dhe etnologjinë, shkencat politike të cilat, natyrisht, rezultuan jo vetëm të kenë pikëvështrime të ndryshme të përbashkëta, po gjithashtu debate që theksojnë dallimet mes tyre.²⁷ Kjo gjë i bën ato studime të elaboruara ndërdisiplinarisht, duke u mbështetur në qasje të ndryshme.

Duke pasur për objekt një dukuri komplekse të përbërë nga një numër i madh i kategorive, proceseve dhe ndërlidhjeve më të vogla, në studimet transnacionale u paraqitën edhe distinkcione a dallime të shumta me kthesa metodologjike e teorike.

Për të mos e zgjatur shumë rreth qasjes transnacionale *per se* do të dëshiroja të theksoj se me këtë qasje ngërthehet hulumtimi ndërdisiplinar i bërë në mënyrë kualitative, multilokale përfshirë vendin e origjinës, vendin e pritjes, por edhe vendet e tjera me të cilat kanë anëtarët ndërlidhje. Hulumtimi bëhet në situata dhe ngjarje private e publike e madje edhe virtuale, si p. sh. cyberspace. Proceset dhe fenomenet mund të analizohen prej së larti, duke u nisur nga perspektivat institucionale e formale të niveleve të ndryshme lokale, regjionale e shtetërore, por edhe së poshti, nisur nga përditshmëria dhe praktikat e anëtarëve të komuniteteve. E gjithë kjo e bën të mundur kuptimin më të mirë dhe më të plotë holistik si të komuniteteve, ashtu edhe të proceseve në të cilat ata përfshihen.

Por, të kthehem në kontekstin e diasporës shqiptare të Kosovës. Në fillim të punimit pamë se shqiptarët ishin numëruar në grupin e diasporës së ashtuquajtur “nacionalistë në distancë”. Gjatë leximit të kësaj të dhëne, duke qenë vetë shqiptare e Kosovës, duke e jetuar realitetin ekonomik, politik, shoqëror e kulturor në Kosovë dhe duke parë se si po zhvillohet aktualisht lidhja e migrantëve me vendlindjen, mu duk e arsyeshme shtrimi i hipotezës, se për sa i përket shqiptarëve të Kosovës ndoshta mund të vërtetohet një ndryshim në angazhimin e tyre ndaj vendlindjes e prandaj edhe një kalim nga ky klasifikim në ndonjë tjetër më të përshtatshëm do të ishte më real.

²⁷ Në lidhje me disa debate shih Faist, ‘The Transnational Turn in Migration Research: Perspectives for the Study of Politics and Polity (2004); gjithashtu Waldinger and Fitzgerald, ‘Transnationalism in Question’ (2004); dhe Andreea Lazăr, ‘Transnational migration studies. Reframing sociological imagination and research’, në *Journal of Comparative Research in Anthropology and Sociology*, Vol 2, Number 2 (2011).

Hipoteza, pra, është se për shqiptarët e Kosovës, që sipas disa analizave konsiderohen të jenë ‘nacionalistë në distancë’ (ngjashëm me hindutë, irlandezët, kurdët e tamilët etj), për shkak të angazhimit të tyre të vazhdueshëm politik me (në) vendlindjen²⁸, sot kur Kosova është bërë e pavarur, lidhjet familjare dhe gëzimi apo celebrimi kulturor i vendlindjes po bëhen çdo herë e më të rëndësishme dhe evidente si teknikë kulturore. Që të tri çështjet (angazhimi politik për vendlindje, lidhjet familjare dhe vlerat kulturore) kanë qenë dhe mbesin emocionalisht të rëndësishme, por megjithatë ekziston një kalim/ndërrim prej kontributit në vendlindje në mënyrë patriotike në kontributin për ruajtjen e lidhjeve shoqërore, kulturore dhe që është më e rëndësishmja, lidhjeve familjare si mënyrë e ruajtjes së identitetit në formë jashtëterritoriale.²⁹

Për të vërtetuar hipotezën e mësipërme gjetëm si mbështetje hulumtimin me qasje transnacionale të bërë me diasporasit shqiptarë të Kosovës. Aty ishin të përfshirë 97 persona që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës e botës. Më së shumti kishte nga Gjermania dhe Zvicra (24), por të tjerët ishin nga SHBA-ja, Suedia, Franca, Austria, Kanadaja, Belgjika, Italia, Danimarka dhe Britania e Madhe. Ata doli të jenë për nga koha e migrimit mërgimtarë të valëve (fazave) e kategorive të ndryshme të migrimit. Bazuar në këtë, si dhe në faktin që një familje e vetme mund të jetë e shpërndarë në më shumë se një vend pritës, duket e qartë se diaspora shqiptare e Kosovës paraqet me të vërtetë një komunitet kompleks transnacional.

Hipoteza del të jetë e saktë për shkak të ndryshimeve politike në Kosovë, të cilat tregojnë se: Angazhimi politik i shqiptarëve të Kosovës nuk është e nevojshme të organizohet jashtë Kosovës dhe 2. Mërgimtarët akoma nuk janë të përfshirë në Parlamentin e Shtetit të Kosovës. Edhe nëse kjo ndodh në të ardhmen, angazhimi i tyre do të ketë të bëjë me çështjet politike, ekonomike e kulturore që në përgjithësi do të harmonizohen me aktet ligjore, prandaj ndikimi i tyre në të shumtën nuk do të çojë te një nacionalizëm i nxehtë apo te veprimet ekstreme, siç është mbështetja e luftës apo luftimit ekskluzivisht nga ta.

Përveç kësaj, për shkak të zgjerimit të termit diasporë, ku pamë se përfshihen shumë terma tjera, përfshirë termin ‘diasporë e punës që

²⁸ Brubaker, ‘The “Diaspora” Diaspora’, (ff.2).

²⁹ Kjo hipotezë është hipotezë e tezës së doktoratës së autores Lumnije Kadriu, ‘Çështjet familjare gjatë pushimeve – praktikimi i pushimeve dhe mbajtja e lidhjeve familjare në diasporën Shqiptare të Kosovës’.

mbajnë lidhje emocionale dhe sociale me vendlindjen' si emër për një kategori të caktuar migrantësh, duket se shqiptarët e Kosovës tash më mirë përshtaten në këtë kategori. Ky identifikim i grupeve të caktuara etnike me kategori të caktuara mbase gjithmonë ka gjasë të ndryshojë varësisht nga situatat dhe zhvillimet globale dhe regjionale politike. Proceset janë tejet fluide dhe të ndryshueshme, por tash për tash kjo gjë duket mjaft e evidente.

Literatura

- [1] **Appadurai**, Arjun, *Modernity at Large: Cultural Dimensions of Globalization Public Worlds*, Volume 1 (London: University of Minnesota Press, 1996).
- [2] **Brubaker**, Rogers, 'The "Diaspora" Diaspora', *Ethnic and Racial Studies*, Vol. 28. No 1. (2005), 1-19.
- [3] **Brubaker**, Rogers, 'Accidental Diasporas and External "Homelands" in Central and Eastern Europe: Past and Present', in *Political Science Series 71* (Institute for Advanced Studies, Vienna 2000) [qasur 15 shtator 2014].
- [4] **Clifford**, James, 'Diasporas: Further Inflections: Toward Ethnographies of the Future.' *Cultural Anthropology*, Vol. 9, No.3, (1994), ff. 302-338.
- [5] **Cohen**, Robin, *Global Diasporas: An introduction*, Second edition (London: Routledge, 2008)
 <<http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.470.8830&rep=rep1&type=pdf>> [qasur 1 dhjetor 2015].
- [6] **Çabej**, Eqrem, 'Ngulimet shqiptare jashtë atdheut', *Studime gjuhësore V*, (Prishtinë: Rilindja, 1975) ff. 56-61.
- [7] **Faist**, Thomas, 'The Transnational Turn in Migration Research: Perspectives for the Study of Politics and Polity'. In Maja Povrzanovic Frykman, ed., *Transnational Spaces: Disciplinary Perspectives* (Malmö University IMER, 2004).
- [8] **Glick Schiller**, Nina, Linda Basch and Cristina Szanton Blanc, 'From Immigrant to Transmigrant: Theorizing Transnational Migration', in *Anthropological Quarterly*, 68(I) (1995) ff. 48-63.
- [9] **Islami**, Hivzi, *Studime demografike: 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Libri 25 (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës/ Academia Scientiarum et Artium Kosoviensis. Seksioni i Shkencave Shoqërore, 2008).
- [10] **Kadriu**, Lumnije, 'Identity Construction among Albanians of Kosovo', nw *Annuario* 2, (Tiranë: The Albanian Yearbook of Historical and Anthropological Studies, Center for Historical and Anthropological Research, 2013).

- [11] **Köstlin**, Konrad, 'Nova shvaćanja regije i kulture', në: *Narodna Umjetnost* 38/2 (Zagreb: 2001), ff. 33-49, apo Konrad Köstlin, 'Kuptimet e reja të regjionit dhe të kulturës' në *Gjurmime Albanologjike Folklor dhe Etnologji (GjAFE)* 40 (Prishtinë; Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2011), ff. 79-98.
- [12] **Lazër**, Andreea, 'Transnational migration studies. Reframing sociological imagination and research', in *Journal of Comparative Research in Anthropology and Sociology*, Vol 2, Number 2 (2011).
- [13] **Malcolm**, Noel, *Kosova - Një histori e shkurtër*, Botimi i dytë (KOHA Prishtinë & Shtëpia e librit Tiranë 2001).
- [14] **Portes**, Alejandro, 'Globalization from Below: The Rise of Transnational Communities' (Princeton University, 1997), f.3
<<http://www.transcomm.ox.ac.uk/working%20papers-/portes.pdf>> [qasur 5 janar 2015].
- [15] **Safran**, William, 'Diasporas in Modern Societies: Myths of Homeland and Return', *Diaspora* 1(1) (1991) ff. 83-99.
- [16] **Schmitt**, Jens Oliver, *Kosova –histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (Koha. Prishtinë 2012).
- [17] **Sulemani**, Valbona, 'The Albanian diaspora: immigration and settlement experiences' (Theses and dissertations. Paper 624. 2009).
<<http://digital.library.ryerson.ca>> <<file:///C:/Users/V/Downloads/OBJ%20Datastream.pdf>> [qasur 10 shtator 2014].
- [18] **Waldinger**, Roger and David Fitzgerald, 'Transnationlism in Question', in *AJS* Volume 109 Number 5 (The University of Chicago, 2004), ff.1179-95.
- [19] **Mustafa**, Muhamet at. al, 'Diaspora dhe Politikat e Migracionit', "Forum" 2015, Prishtinë
<www.riinvest.org/index.php?gjuha=en&-action=category&cid=3> [qasur 13 tetor 2014].

Valbon Bytyqi, Ibrahim Ramadani, Prishtinë

ANALIZË GJEOGRAFIKE E ZONAVE MIGRUESE NË REGJIONIN LINDOR TË KOSOVËS

Abstrakt

Me rastin e studimit urbanistik dhe hapësinor të regjioneve të ndryshme, në të shumtën e rasteve vërehet një shpërndarje dhe koncentrim i pabarabartë i popullsisë dhe vendbanimeve në hapësirë dhe kjo vjen si rrjedhojë e disa faktorëve që ndikojnë në të.¹ Ndër faktorët themelor që ndikojnë në shfaqjen e kësaj dukurie është zhvillimi i pabarabartë ekonomik i regjioneve dhe procesi i urbanizimit, të cilat përcillen me krijimin e zonave polarizuese dhe aglomerative në hapësirë.² Andaj këto dukuri përcillen nga një mori problemesh të cilat shpeshherë bëhen të pariparueshme për shoqërinë e atij vendi. Për analizimin e zonave migruese në hapësirë jemi mbështetur në potencialin demografik dhe ekonomik të vendbanimeve të Regjionit Lindor të Kosovës, përmes të cilës është bërë sintetizimi i efekteve dhe pasojave, si dhe mundësitë e zhvillimit të harmonizuar të regjionit.

Fjalët çelës: *Migrim, dinamikë, polarizim, koncentrim, harmonizim, planifikim, Regjioni Lindor i Kosovës.*

Hyrje

Regjioni Lindor i Kosovës zë sipërfaqen prej 6.561 km², i cili në aspektin administrativ është i organizuar në 25 komuna, disa prej të cilave u formuan nga procesi i decentralizimit të territorit pas shpalljes

¹ K. Doksiadis, (1982), *Covek i grad, Nolit, Beograd*, f. 71.

² A. Pushka, (2002), "Roli i objekteve ekonomike dhe joekonomike në ripërndarjen e popullsisë së Kosovës", *Buletini i FSHMN, Prishtinë, 1981*, f. 325. Shih edhe I. Ramadani et al. *AKTET*, 382 Vol. III, nr. 3 Pushka, *Aspekte gjeopullative në Kosovë, Prishtinë*, f. 44.

së pavarësisë së Kosovës, me rreth 890 vendbanime ose mesatarisht nga 35.6 vendbanime për njësi komunale.³

Vendbanimet janë të lokalizuara në lartësi të ndryshme mbidetare, nga 382 metra në komunën e Hanit të Elezit në jug e deri në 1.380 m në Shalë të Bajgores. Regjioni Lindor i Kosovës karakterizohet me kushtet të përshtatshme klimatike, gjë që dëshmon edhe prania e hershme e vendbanimeve në këtë regjion. Në aspektin morfologjik të relievit dominojnë malet me lartësi mesatare dhe të madhe, të cilat shtrihen në periferi të këtij regjioni, në njërin anë, ndërsa, në anën tjetër, në pjesën qendrore shtrihet Fusha e Kosovës, Drenica, Llapi dhe Anamorava.⁴

Numri i popullsisë së këtij regjioni ka ndryshuar me kohën, duke shënuar rritje nga regjistrimi në regjistrim, që karakterizohet me shtim të lartë të popullsisë, sidomos të asaj shqiptare. Në vitin 1948 në vendbanimet e këtij regjioni jetonin rreth 443.000 banorë, ndërsa në regjistrimin pasues (1953) ishte shënuar rritje e numrit të popullsisë në 497.399 banorë. Edhe pse kishte rritje të numrit të popullsisë, gjatë kësaj periudhe vërehen migrimet e para të cilat shënojnë edhe zvogëlimin e numrit të banorëve në disa vendbanime. Kështu, gjatë periudhës 1948-1953 gjithsej 72 vendbanime kishin rënie të numrit të popullsisë. Këto vendbanime i takonin kryesisht viseve kodrinore-malore të regjionit, por edhe atyre që ndodheshin larg nga qendrat urbane të asaj kohe. Numrin më të madh të vendbanimeve me zvogëlim të numrit të popullsisë e kishin këto komuna: Zubin Potoku, Podujeva (8 vendbanime), Kamenica (7 vendbanime), pastaj Kaçaniku, Gjilani, Lipjani, etj. Komunitet të cilat kishin numrin më të vogël të vendbanimeve me bilanc negative ishin: Obiliqi, Fushë-Kosova, Skënderaj, Gllogoci, etj.

Trendi i njëjtë i ndryshimit të numrit të popullsisë në pjesën lindore të Kosovës vazhdoi edhe më tutje. Në regjistrimet e mëvonshme, deri tek ai i fundit (2011), vendbanimet të cilat kishin rënie të numrit të popullsisë, madje deri në shpopullim, ishin kryesisht në zonat kodrinore-malore, kurse destinacioni i popullsisë ishte në drejtim të trevave fushore, duke ndikuar në mbipopullimin e tyre.

³ R. Çavolli, (1997) "Gjeografia regjionale e Kosovës" ETMMK, Prishtinë, f. 127-140.

⁴ V. Bytyqi (2017) "Regjioni Lindor i Kosovës – Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore. ASHAK, Prishtinë, 2017, ff. 254-259.

Metodologjia dhe metodat e punës

Për të përcaktuar dinamikën e migrimeve dhe koncentrimin e popullsisë dhe aktiviteteve të saj në pika të caktuara në hapësirë, jemi mbështetur në burimet statistikore të regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në nivel të vendbanimeve, ndërsa të dhënat e vendosura në programin e kompjuterizuar Excel kanë mundësuar llogaritjen e indeksit të rritjes/zvogëlimit të popullsisë dhe të vendbanimeve. Bartja e vlerave të llogaritura në programe të ndryshme kompjuterike për përpunimin e të dhënave gjeografike ka mundësuar paraqitjen vizuale të kaheve zhvillimore të vendbanimeve në hapësirë.

Rezultatet dhe diskutimi

Për të përcaktuar shpërndarjen dhe koncentrimin e pabarabartë të popullsisë dhe vendbanimeve në hapësirë, si dhe pasojat e kësaj dukurie, jemi përpjekur t'i analizojmë më hollësisht vendbanimet në aspektin demografik dhe funksional sipas shtrirjes zonale, sepse në varësi të mundësive ekonomike që ato ofrojnë bëhen po ashtu atraktive për migrimin e popullsisë rreth tyre dhe anasjelltas.⁵ Që në fillim duhet theksuar se zona e ulët karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë në të cilën dominojnë vendbanimet e kategorisë së mesme dhe të mëdha rurale prej 500 deri 3.000 banorë dhe në to janë të vendosura të gjitha qendrat urbane. Kjo pjesë regjionale në kuptimin demografik është më e qëndrueshme, sepse procesi i shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale, ndërsa, në anën tjetër, rritja popullore e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore.

Sa i përket hapësirës kodrinore-malore karakteristikat gjeoekologjike të saj kanë vlera të kundërta me ato të Rrafshit të Kosovës.⁶ Në këto hapësira dominojnë kryesisht vendbanimet e vogla

⁵ I. Cifric. (1987), *Industrijalizacija i ruralne sredine*, Sociologija sela” br. 95-98, Zagreb, f. 37-44.

⁶ M. Knežević. & R. Simonovic (1998) “Ekološki problemi Kosovske Mitrovice, Naučno istraživački projekat”, PMN, Priština, f. 69.

deri në 500 banorë dhe ato të tipit të shpërndarë, të cilat dita ditës po e humbin popullsinë deri në zbrazje të përgjithshme të tyre.

Tabela 1. Dendësia e popullsisë sipas zonave

Pjesët e regjionit	Dendësia relative	Dendësia rurale	Sipërfaqja në km ² për një vendbanim	Dendësia mesatare e vendbanimeve në km ²
Zona nën 700 m lartësi mbidetare	320.0	175.6	5.4	18.4
Hapësira kodrinore-malore	37.7	37.6	10.9	9.2
Regjioni	176.9	105.7	7.2	13.7

Në tabelën 1 janë dhënë disa nga indikatorët themelorë të hapësirës kodrinore-malore të regjionit, në të cilën hapësirë të gjitha komunat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme, disa më shumë e disa më pak, me gjithsej 3.332 km² ose 50,6% të hapësirës së regjionit. Ndërsa 7 nga këto komuna kanë mbi gjysmën e territorit të tyre në lartësi mbidetare mbi 700 metra, sikurse janë: Kaçaniku, Dardana (Kamenica), Mitrovica, Albaniku (Leposaviqi), Besiana (Podujeva), Prishtina dhe Ferizaj.

Vlerat e dhëna në tabelën 2 tregojnë se dendësia relative e popullsisë së hapësirës kodrinore-malore është mjaft e vogël në krahasim me atë të zonës së ulët si dhe në nivel të regjionit, ndërsa kohët e fundit kjo po merr përmasa shqetësuese. Tani dendësia e popullsisë së viseve kodrinore-malore është 8,5 herë më e vogël se ajo e zonës së ulët dhe 4,7 herë më e ulët se mesatarja e regjionit. Krahasuar me të dhënat e vitit 1948 këto diferenca ishin shumë më të vogla, ose vetëm 3,6 herë ndaj zonës së ulët dhe 2,3 herë më e vogël se mesatarja e regjionit. Dendësia e popullsisë rurale e zonës kodrinore-malore sot është 4,6 herë më e vogël se në zonën e ulët dhe 2,8 herë më e vogël se dendësia rurale në nivel të regjionit në fjalë.⁷

⁷ I. Ramadani et al. AKTET, 382 vol. III, nr. 3. Pushka, A., Aspekte gjeopopullative në Kosovë, Prishtinë, f. 44.

Tabela 2. Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve


Indikatorët	Dendësia	Distanca mesatare
Hapësira kodrinore-malore	9.2	3.3
Hapësira nën 700 metra lartësi mbidetare	18.4	2.3
Regjioni	13.7	2.7

Nëse e vështrojmë koncentrimin e popullsisë në raport me sipërfaqen, atëherë mund të konstatohet se përqendrimi i popullsisë, sidomos në zonën e ulët, ka arritur një shkallë mjaft të lartë, sepse derisa 49,4% e sipërfaqes së regjionit gjendet nën 700 metra të lartësisë mbidetare në këto hapësira në vitin 1991 jetonin 1.038.697 banorë ose 89,2% e popullsisë së regjionit, kurse pjesëmarrja e sipërfaqeve mbi 700 metra të lartësisë mbidetare është 50,6%, mirëpo në këto sipërfaqe jetonin vetëm 10,8% e popullsisë, që është si pasojë e kushteve të ndryshueshme natyrore ndërmjet këtyre dy hapësirave dhe aktivitetit të njeriut i cili është i lidhur kryesisht për zonat më të përshtatshme ku e zhvillon aktivitetin e tij ekonomik. Kështu, vendbanimet si qendra të aktivitetit të përgjithshëm njerëzor, krahas ndryshimeve shoqërore-ekonomike në mënyrë të vazhdueshme e ndryshojnë edhe fizionominë e tyre, madhësinë, funksionalitetin dhe ndikimin e tyre në rrethinën më të gjerë.

Tabela 1. Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike dhe ndërrimit të kategorive (1948-1991)

Kategoritë (banorë)	<99	100-499	500-999	1000-1999	2000-2999	>3000	Gjithsej
Tipi I:							53
zvogëlim i kategorisë	31	20	2				5.9%
Stagnim	82	208	51	8	2		351 39.3%
Rritje për 1 kategori		70	152	128	20	7	377 42.3%
Rritje për 2 kategori			22	49	18	8	97 10.9%
Rritje për 3 kategori				3	7	4	14 1.6%
Gjithsej	113	298	227	188	47	19	892
	12.7%	33.4%	25.4%	21.1%	5.3%	2.1%	

Burimi: Të dhënat për vitin 1948-1991 janë marrë nga Enti i Statistikës në Prishtinë dhe nga EFS




Harta 1. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1948-1953

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se vendbanimet që kanë pozitë të mirë, sidomos ato vendbanime që shtrihen në viset e rrafshëta kanë pasë rritje për një e më shumë kategori. Te vendbanimet që shtrihen në viset kodrinore-malore ndodh proces i kundërt me ato të parat.

Në vitin 1961 në këtë regjion jetonin 587,944 banorë, që ishte për 18.2% më shumë se në vitin 1953, mirëpo në anën tjetër ishin 160 vendbanime që kishin zvogëlim të numrit të popullsisë edhe përkundër ndryshimeve evidente socioekonomike në Kosovë, të cilat


patën ndikim më të shprehur se në 5-vjeçarin e mëparshëm. Gjithashtu, edhe në këtë periudhë, dallohen vendbanimet me zvogëlim të numrit të banorëve në viset kodrinore-malore dhe ato që ishin larg nga qendrat komunale. Numri më i madh i tyre ishte në komunat: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë, Kaçanik, Kamenicë, etj.

Vendbanimet të cilat kishin rënie më të madhe të numrit të banorëve ishin Stantërgu, Gjurgjedeli, Duraj, Tygjeftci, Mareftci, Novosella, Plitkoviqi, Konushetci, etj. Shumica e këtyre vendbanimeve ndodhen në lartësi mbi 800 m dhe kanë distancë të theksuar nga qendrat komunale.




Harta 2. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1953-1961

Në regjistrimin e vitit 1971, në Regjionin Lindor të Kosovës jetonin 750,070 banorë, me një rritje prej 27.6%, mirëpo, në anën tjetër, rritet numri i vendbanimeve migruese nga 160 sa ishin në vitin 1961, në 240 vendbanime në vitin 1971, të cilat kishin rënie të numrit të popullsisë. Nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve të cilat kishin rënie të numrit të popullsisë, 30 prej tyre ishin në lartësi mbi 1000 m, ndërsa 109 vendbanime tjera kishin lartësinë mbidetare 700-1000 m. Shumica e vendbanimeve me zvogëlim të numrit të popullsisë kishin shtrirje përgjatë maleve të Kopaonikut dhe të Rogoznës (komunat Laposaviq, Zveçan, Zubin Potok), por edhe komunat e tjera sikurse Kamenica, Gjilani, Kaçaniku, Lipjani, etj. Vendbanimet të cilat kishin rënie më të madhe të numrit të popullsisë ishin: Badovci, Braina, Livaxha, Vrella, Banja, Orllani, etj.




Harta 3. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1961-1971

Në vitin 1981, në Regjionin Lindor të Kosovës jetonin 945.174 banorë. Në këtë periudhë (1971 – 1981) numri i vendbanimeve me karakteristika migruese rritet nga 240 sa ishin në vitin 1971, në 329 vendbanime në vitin 1981, të cilat kishin zvogëlim të numrit të banorëve. Nga numri i përgjithshëm i këtyre vendbanimeve, 38 prej tyre ndodheshin në lartësi mbidetare mbi 1.000 m, ndërsa 57 vendbanime tjera kishin lartësi mbidetare prej 700-1.000 m. Në këtë periudhë numri më i madh i vendbanimeve të cilat kishin rënie të numrit të popullsisë ishin të ndërlidhura me zonat kodrinore-malore të komunave: Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan, Gjilan, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Podujevë, Kaçanik, etj.




Harta 4. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1971-1981

Në periudhën 1981-1991 numri i vendbanimeve të cilat kishin rënie të numrit të popullsisë ishte 255 ose gati 1/3 e të gjitha vendbanimeve të Regjionit Lindor të Kosovës. Kryesisht ishin vendbanime të cilat ndodheshin në pjesën veriore të Kosovës (Kopaonik dhe Rogoznë, ose komunat Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq), si dhe vendbanimet kodrinore të komunave Gjilan, Kamenicë, Podujevë e Mitrovicë.




Harta 5. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1981-1991

Absurdi më i madh në ndryshimin e numrit të popullsisë ishte në regjistrimin e vitit 2011. Ky regjistrim jo vetëm që doli i dështuar për mënyrën se si u realizua, por u prezantua edhe me të dhëna të pasakta, të cilat duhet të ishin vitale në fusha të ndryshme të organizimit hapësinor, social-kulturor, etj. Në bazë të regjistrimit të vitit 2011 doli që 616 vendbanime të Regjionit Lindor të Kosovës kishin rënie të numrit të popullsisë, në një vend i cili akoma ka shtim natyror pozitiv!



Harta 6. Vendbanimet që shënuan zvogëlim të numrit të popullsisë 1991-2011

Zona kryesore imigruese ishin vendbanimet e mëdha, në radhë të parë Prishtina dhe qendrat tjera regjionale: Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë. Disa vendbanime, nëse krahasohen vitet 1948-1991, edhe pse ishin vendbanime rurale, kishin shënuar rritje më të madhe se disa qendra regjionale e urbane. Të tilla ishin: Graçanica, Hajvalia, Shipoli, Gremja, Pozharani, Pleshina, Kçiqi i Madh, Zhegra, etj.



Harta 7. Vendbanimet që shënuan rritje të numrit të popullsisë 1981-1991

Në këtë rast do të ishte me rëndësi të analizohej edhe njëherë procesi i migrimit të popullsisë në drejtimin fshat-qytet.⁸ Qendrat urbane kanë qenë historikisht mjaft atraktive për popullsinë e fshatit, sidomos gjatë tërë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, e këtë e tregon më së miri rritja e numrit të popullsisë së tyre. Nga 65.378 banorë në vitin 1953, ky numër rritet për 403.339 banorë në periudhën 1953-1991, apo për 7 herë, ndërsa popullsia rurale nga 434.702 që ishte në vitin 1953, është rritur me 260.854 banorë, respektivisht në vitin 1991 arrin numrin në 695.556 banorë ose 1,6 herë me shumë se viti 1953. Kjo dukuri është pasojë e zbrazjes së viseve kodrinore-malore, deri te shuarja e plotë e vendbanimeve.

Rrjetin e vendbanimeve të regjionit e përbëjnë 890 vendbanime prej të cilave 18 janë të karakterit urban, me 468.717 banorë ose 40,2% dhe 892 vendbanime rurale me 695.556 banorë ose 59,8% të popullsisë në vitin 1991. Madhësia mesatare e vendbanimeve është 1.288 banorë (1991), ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrin në 176,9 banorë në km², por me dallime të mëdha, varësisht nga karakteristikat gjeomorfologjike të regjionit. Me rëndësi të veçantë në këtë rast do të ishte edhe analiza e dendësisë hapësinore të vendbanimeve dhe largësia mesatare e tyre, e cila përcaktohet në bazë të metodave kuantitative matematikore.

Dendësia mesatare e vendbanimeve në regjionin e Rrafshit të Kosovës është 13,7 vendbanime në 100 km² (në Kosovë 13,2 vendbanime në 100 km²). Edhe në dendësinë e rrjetit të vendbanimeve janë të dukshme dallimet, varësisht nga pozita apo gjeomorfologjia e terrenit. Në zonën mbi 700 metra të lartësisë mbidetare dendësia e vendbanimeve arrin në 9,2 vendbanime në 100 km², ndërsa në hapësirën nën 700 metra të lartësisë mbidetare dendësia e tyre arrin në 18,4 vendbanime në 100 km².

Në bazë të këtyre treguesve shfaqen edhe ligjësitë themelore të cilat janë shenjë e pazhvillueshmërisë së hapësirës kodrinore-malore, duke u shprehur me dendësi të vogël banimi për sipërfaqen dhe me intensitet të theksuar të emigrimit të popullsisë në drejtim të zonave të ulëta si rezultat i shkallës së ulët të mundësive për punë dhe paaftësisë së shoqërisë për të ndryshuar mjedisin jetësor dhe cilësinë e jetës. Në këtë mënyrë anëmbanë regjionit po shtohen kontradiktat sociale dhe vazhdon

⁸ M. Radovanović, S. Nikolić, (1973), "Disperzija kao kvantitativni parametar prostornog razmeštaja i metode za izučavanje seoskih naselja", Zbornik radova, Gl. sv.xx. Beograd, f. 104.

të rritet ndotja e mjedisit e pasuar nga ndërtimet vend e pa vend, madje në mes të arave të bukës, që rezulton me zvogëlimin e sipërfaqeve bujqësore të cilat do të sjellin pasoja të rënda në të ardhmen e afërt. Në këtë rast zgjidhja më e favorshme do të ishte lidhja racionale e vendbanimeve të vogla me qendrat e tyre, respektivisht bashkësitë lokale, të cilat do të shndërroheshin në bërthama të rëndësishme për territorin, ndërsa kjo do të shprehet pozitivisht në ristrukturimin e vendbanimeve dhe rritjen e perspektivës për të penguar largimin e popullsisë.⁹

Pasojat

Procesi i zbrazjes së territoreve kodrinore-malore në mënyrë spontane sidomos në periudhën e pasluftës dhe zgjerimi i vendbanimeve dhe koncentrimi i popullsisë në zonat e rrafshëta, të cilat edhe ashtu kanë dendësi të madhe të popullsisë, mund të ketë pasoja negative në aspektin strategjik për të ardhmen e regjionit dhe Kosovës në tërësi, sepse përveç zbrazjes së vendbanimeve shumë të vogla, një proces i ngjashëm i ka përfshirë edhe vendbanimet e kategorive të tjera: 80 vendbanime të kategorisë 100-500 banorë, 6 vendbanime të kategorisë 500-1000 banorë, ose në procesin e zbrazjes janë përfshirë gjithsej 170 vendbanime, ndërsa kanë stagnuar 80 vendbanime tjera, ose më konkretisht 82% e vendbanimeve kodrinore-malore kanë mbetur në mëshirën e kohës dhe fatit të vet. Nga kjo arsye konsiderojmë se doemos duhet gjetur forma dhe mënyra për të ndaluar këtë proces, ndërsa kjo mund të realizohet me zhvillimin e turizmit rural, stimulimin e prodhimit bujqësor (blegtorinë) me organizim dhe teknologji bashkëkohore, lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve (sepse rruga është si parakusht për ekzistencën e këtyre vendbanimeve), ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes organizimit dhe zhvillimit të qendrave të bashkësive rurale dhe pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbusheshin nevojat e përditshme të popullsisë. Me krijimin e rrethanave të tilla do të shpejtohet procesi i urbanizimit, ndërsa kushtet jetësore do të përmirësohen shumë shpejt, duke u krahasuar me kushtet e jetës në qytet, ndërsa nga disa aspekte jeta do të jetë edhe më e mirë se në shumë qendra tona. Në këso rrethana

⁹ Grup autoresh, (1971), Osnove politike urbanizma i prostornog uredjenja, Beograd, f. 68. Krahaso edhe R. Stojanovic, (1979), Planiranje u samoupravnom društvu, "Savremena administracija", Beograd, f. 276.

popullsia do të vendosë përfundimisht për të jetuar në fshat, edhe pse vendi i punës nuk do të jetë afër shtëpisë për të gjithë, kurse në anën tjetër do të zvogëlohet presioni në drejtim të qyteteve dhe evitimi i aglomeracioneve megalomane dhe joracionale, të cilat shpeshherë i përngjajnë "kokës pa gjymtyrë".¹⁰

Nga kjo rrjedh konkludimi se faktorët fiziko-gjeografikë patën ndikim të konsiderueshëm në migrimet e popullsisë, sidomos në Kosovë, në krahasim me faktorët e tjerë, sidomos socialë dhe ekonomikë, të cilët kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në migrimet e popullsisë brenda Kosovës dhe jashtë saj. Faktikisht, zonat kodrinore-malore në Kosovë ofrojnë kushte të përshtatshme klimatike (ajri i pastër, me sasi më të madhe të oksigjenit, ndotja e vogël, pasuria me ujë, vegetacion, etj.) dhe janë pikërisht këto zona të cilat kanë shënuar rënie në numrin e popullsisë së tyre. Mirëpo sipërfaqet e rrafshëta dhe luginat janë hapësirat më atraktive jo vetëm për zhvillimin e bujqësisë, por edhe për ndërtimin e rrugëve, kapaciteteve prodhuese, vendbanimeve dhe zhvillimin e veprimtarive jobujqësore.¹¹ Kjo reflektoi negativisht në shfaqjen e konflikteve në hapësirë, sepse bujqësia gjithnjë e më tepër po i humb sipërfaqet më cilësore e me pjellori natyrale të lartë.

Migrimi i popullsisë brenda zonave fushore, sidomos në periferi të qendrave regjionale e komunale, ka ndikuar negativisht në disa sektorë, sidomos atë të bujqësisë, duke rritur dendësinë agrare, humbjen e sipërfaqeve të tokës bujqësore si dhe ngarkesat në trafik, në arsim, shëndetësi etj.

Mbetet që organet vendimmarrëse në Kosovë, ato të nivelit qendror e lokal të ofrojnë zgjidhje adekuate në baraspeshën ndërmjet natyrës dhe ndikimeve antropogjene.

Përfundim

Në bazë të kësaj analize lidhur me tipologjinë e vendbanimeve u nxorën disa konkludime. Të gjitha kategoritë e vendbanimeve rurale sipas madhësisë demografike janë prezentë në regjion, por prezenca e vendbanimeve të mëdha është e vogël, ndërsa në viset kodrinore këto

¹⁰ M, Ribar., (1988) Savremeni rurizam, Edicija naseljavanje prostora, Sveska 72, Beograd, f. 35.

¹¹ R. Stojanović, (1979), Planiranje u samoupravnom društvu, "Savremena administracija", Beograd, f. 276.

mungojnë. Në anën tjetër, prezenca e vendbanimeve të vogla është shumë e madhe, ndërsa pajisja e tyre me infrastrukturë urbane paraqet problem. Nga kjo arsye, kjo kategori e vendbanimeve i nënshtrohet shpopullimit. Vendbanimet të cilat shënuan rritje të lartë dhe kalim të kategorisë kishin pozitë të mirë gjeografike dhe kishin të zhvilluara funksione të ndryshme dhe veprimtari tjera jobujqësore. Gjithashtu u vërejt se vendbanimet pranë qendrave të mëdha urbane patën rritje më të madhe, ndërsa me rritjen e distancës nga qendra ato vendbanime patën intensitet më të ulët të rritjes.

Sipas kësaj analize të bazuar në indikatorët sasiorë dhe cilësorë, mund të konkludohet se regjioni deri tani është zhvilluar në mënyrë të pabarabartë, ndërsa dallimet ndërmjet pjesëve të tij, e sidomos asaj kodrinore-malore dhe rrafshinore, gjithnjë e më tepër po thellohen. Kjo është vërejtur nga dendësia e popullsisë, madhësia e vendbanimeve, karakteristikat demografike, pajisja e vendbanimeve me infrastrukturë urbane dhe institucione administrative, arsimore dhe shëndetësore.

Derisa për vendbanimet kodrinore-malore mund të thuhet se shpopullimi dhe shuarja e tyre është në përfundim e sipër, ndërsa pasojat mund të jenë afatgjate sidomos në zonat kufitare me karakter strategjik, në anën tjetër vendbanimet e zonave të rrafshëta kanë përjetuar transformim të rëndësishëm dhe të gjithanshëm. Disa prej këtyre vendbanimeve janë shndërruar në qytete, duke marrë edhe funksione të rëndësishme urbane; të tjerat duke iu bashkangjitur qyteteve ekzistuese, ndërsa një numër prej tyre janë bashkëngjitur mes veti, duke krijuar forma aglomerative me karakter zhvillimor në hapësirë.

Në bazë të këtyre ndryshimeve dhe masave planifikuese të cilat duhet të ndërmerren, është e domosdoshme që të përcaktohen vendbanimet të cilat duhet të shuhen, të dislokohen dhe të avancohen. Në grupin e vendbanimeve të cilat duhet të avancohen funksionalisht janë ato vendbanime të cilat posedojnë zonën e ndikimit në raport me pozitën dhe karakteristikat morfologjike të terrenit, ndërsa në këtë rast përparësi duhet të kenë qendrat e bashkësive rurale dhe bashkësitë lokale. Këto dy grupe të vendbanimeve para së gjithash duhet forcohen në viset kodrinore-malore, të cilat do të kenë rolin e qendrave të rëndësishme administrative, arsimore, shëndetësore, ekonomike etj. për popullsinë përreth.

Këto qendra zhvillimore, krahas transformimit të tyre përmes vendosjes së objekteve ekonomike, shërbimeve tjera dhe infrastrukturës

urbane do të ndikojnë edhe në transformimin e vendbanimeve përreth.¹² Kjo mund të realizohet përmes planeve hapësinore të komunave, me anë të të cilave duhet të analizohet sistemi i përgjithshëm dhe rrjeti i vendbanimeve. Në bazë të këtyre parimeve duhet të përcaktohen vendbanimet të cilat mund të jenë bartëse të funksioneve qendrore dhe transformimit të përgjithshëm të regjionit.

Valbon Bytyqi, Ibrahim Ramadani, Prishtina

GEOGRAPHICAL ANALYSIS ON MIGRATION ZONES IN KOSOVO EASTERN REGION

Summary

With urban and spatial study of different regions, in most cases there is an unequal distribution and concentration of the population and the settlements in space and this is due to several factors that affect it. Among the underlying factors influencing the emergence of this phenomenon is the uneven economic development of the regions and the urbanization process, which are followed by the creation of polarization and agglomeration zones in area. Therefore, these phenomena are followed by a number of problems which often become irreparable for the society of that country. For the analysis of migration zones, we have relied on the demographic and economic potential of the settlements of the Eastern Region of Kosovo, through which are synthesized the consequences, and the possibilities of harmonized development.

In this article are analyzed the changes of number of inhabitants in settlements of Eastern Region of Kosova. As a result of socio-economic factors, the settlements of hilly-mountainous areas are decreasing the number of inhabitants besides the good natural conditions for living. In the first twenty years after the World War Two, the number of settlements with decreasing of population was very low because of the lack of industrialization in Kosovo. After the 70's the number of settlements with decreasing of population in hilly-mountainous areas was larger. And, the settlements with increase of population were mostly in the plain and near large urban centers, mainly the regional centers. With migration and extension of settlements, the fragmentation of land has been made, there is a lack of infrastructure, etc.

It remains that the decision-making bodies, local and central level, to provide adequate solutions for the balance between nature and anthropogenic influences.

¹² I. Crkvencic, Centralna naselja i gradovi SR Hrvatske, Školska Knjiga, Zagreb, 1976. Krahaso: I. Vrišer, Centralna naselja, VIII, kongres geografije, Skopje, 1968.

Bibliografia

- [1] Cifric, I., (1987), Industrijalizacija i ruralne sredine, "Sociologija sela" br. 95-98, Zagreb.
- [2] Crkvencic, I; (1976) Centralna naselja i gradovi SR Hrvatske, "Školska knjiga", Zagreb.
- [3] E. Qershkov, (1973), Romakët në Kosovë, Prishtinë.
- [4] Grup autorësh, (1971), Osnove politike urbanizma i prostornog uredjenja, Beograd.
- [5] K. Doksiadis, (1982), Čovek i grad, Nolit, Beograd.
- [6] Kneževic, M., (1998) & R. Simonovic, "Ekološki problemi Kosovske Mitrovice, Naučnoistraživački projekat", PMN, Priština.
- [7] Perišić, D; (1978) Razvoj, struktura i tipologija naselja, IAUPP, Sarajevo.
- [8] Pushka, A., (2002), Roli i objekteve ekonomike dhe joekonomike në ripërndarjen e popullsisë së Kosovës, "Buletini i FSHMN, Prishtinë,1981.
- [9] Pushka, A., Aspekte gjeopopullative në Kosovë, Prishtinë.
- [10] R. Çavolli, (1997), Gjeografia regjionale e Kosovës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë.
- [11] Radovanovic, M., Nikolic, S., (1973), Disperzija kao kvantitativni parametar prostornog razmeštaja i metode za izučavanje seoskih naselja, "Zbornik radova", GI. sv.xx, Beograd.
- [12] Ramadani, I., (2003), Zhvillimi rural, "Dukagjini", Pejë.
- [13] Ribar, M; (1988) Savremeni rurizam, Edicija naseljavanje prostora, "Sveska 72", Beograd.
- [14] Stojanović, R., (1979), Planiranje u samoupravnom društvu, Savremena aministracija", Beograd.
- [15] Vrišer, I; (1968) Centralna naselja, VIII kongres geografije, Skopje.

Denis Nushi

MIGRIMI/ MOBILITETI DHE IDENTITETET HIBRIDE TË DIASPORËS

“I am a part of all that I have met”

(Alfred Lord Tennyson, poet nga Anglia, 1809-1892)

“Unë jam pjesë e të gjithë asaj që kam përjetuar” (njerëzve që kam takuar, shijes që kam shijuar, muzikës që kam dëgjuar, ushqimit që kam ngrënë, emocioneve që kam ndjerë, etj.). Përkthyer nga autori nga gjuha angleze.

Abstrakt

Ky artikull me një qasje aplikative sqaron fillimisht fenomenin e identiteteve hibride, duke iu referuar shembullit shqiptaro-kosovar në diasporë. Rezultati në shembullin konkret të marrëdhënies midis identiteteve “cocktail”, “fluide” apo “transformuese” të fëmijëve të lindur jashtë vendlindjes dhe formimit të identiteteve të duhura varet po ashtu nga fakti se sa kohë efektive prindërit janë të gatshëm dhe kanë mundësi t’u përkushtojnë fëmijëve të tyre veçanërisht gjatë periudhës kognitivo-zhvillimore. Sidomos ndikimin e rrethit shoqëror, dhe të ashtuquajturin “peer pressure” tek adoleshentët në diasporë duhet ndjekur me vëmendje të posaçme. Në fund të artikullit sqarohen mundësitë e krijimit të identiteteve të “shkrira njëra me tjetrën”, ku vetëm tiparet/ vetitë “e mira” e të dy “botërave” internalizohen deri te formimi final i personalitetit.

Hyrje

Inspirimi për të shkruar lidhur me fenomenin e identitetit hibrid në kontekstin shqiptaro-kosovar rrjedh kryesisht nga dy arsye:

Së pari, nga fakti që fenomeni i identitetit hibrid përshkruhet në literaturë si dukuri që lindi me kohën e globalizimit të filluar në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe fillim të shekullit njëzet. Dy vepra me famë botërore janë novelat: “Anne ici Sélima là bas” (1978) (Anë këtu Selima (atje) mbrapa, përkthyer nga gjuha frënge) nga Marie Féraud dhe “mörderische Identitäten” (2000) (identitetet vrasëse, përkthyer nga gjuha gjermane) nga shkrimtari francez me origjinë libaneze me

renome botërore Amin Maalouf. Një nga qëllimet e këtij artikulli është poashtu inkurajimi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në Prishtinë për të “kapur hapin” dhe të planifikoj studimin më të detajuar të këtij fenomeni, si dhe njëkohësisht të shkëmbej praktika profesionale dhe punime shkencore me akademitë e shkencave dhe arteve të shteteve tjera. Takimet dhe konferencat e përbashkëta pretendojnë t’u trajtojnë këtë temë më hollësisht – posaçërisht në kontekstin gjeografik të ballkanit dhe t’u fuqizojnë bashkëpunimin dhe studimin e këtij fenomeni në fushën e shkencave humane dhe sociale, më saktësisht në atë të sociologjisë.

Së dyti, duhet marrë parasysh që Kosova ka një diasporë të konsiderueshme. Supozohet se përafërsisht 703’978 individë me origjinë kosovare jetojnë dhe veprojnë jashtë vendlindjes së tyre (UNDP, 2014). Ndër ta duhet konsideruar një numër të madh të shqiptaro-kosovarëve që vetëm se kanë formuar të ashtuquajturit identitete hibride. Këta persona vazhdojnë të jetojnë midis “dy botërave”, në botën e vendit nikoqir, si dhe në atë të familjeve shqiptaro-kosovare, që ekzistojnë mbrenda mureve të shtëpisë së tyre, ku ende flitet gjuha shqipe dhe praktikohen traditat shqiptare.¹

Sociologjia si degë e shkencave humane dhe sociale interesohet për konstruktimin e identiteteve. Rrjedhimisht, kjo disiplinë trajton çështje si: Kush jemi ne? Si e perceptojmë ne vetën dhe si perceptohemi nga të tjerët? Këto pyetje kanë shtyrë shumë shkencëtarë dhe sociologë të përshkruajnë dhe analizojnë identitetet e sotme.

Në sociologjinë publike (përkthyer nga gjuha angleze) Germov, Poole, Allen dhe Unwin (2011) përshkruajnë faktin se që nga shekulli nëntëmbëdhjetë proceset e globalizimit dhe lëvizja e kapitalit dhe e njerëzve kanë ngritur nivelin e përzierjes së kulturave dhe identiteteve. Individët me identitete hibride kanë formuar lidhje transnacionale midis shoqërive të tyre në diasporë dhe atyre me origjinë shqiptaro-kosovare (në vendin amë).

Sipas autorëve të lartpërmendur termi *hibrid* rrjedh nga biologjia dhe përshkruan kultivimin selektiv të bimëve për prodhimin e

¹ Sipas Dahinden (2005: 192) edhe ideja e transnacionalizimit ka lindur nga fakti se migrantët mbajnë lidhjet me vendet e origjinës së tyre, duke shëndëruar shoqërinë e origjinës dhe asaj nikoqire arenën e jetës së përditshme sociale. Duke lëvizur nëpërmjet kufijve internacional dhe nëpërmjet kulturave si dhe sistemeve sociale të ndryshme dhe duke shfrytëzuar marrëdhënjet transnacionale si një formë të kapitalit social për strategjitë e tyre të jetesës.

varieteteve të reja me cilësi të përmirësuara siç janë performanca, shija dhe qëndrueshmëria (f. 190).

Në kontekstin e këtij artikulli pretendohet të sqarohet lidhja mes identitetit hibrid dhe migrimit si dhe përfshirja e aspekteve pozitive dhe negative në krijimin e po këtyre identiteve. Fillimisht, duhet definuar terminologjinë dhe konceptet e duhura në mënyrë që të arrihet deri te format aplikative për t'u marrë parasysh posaçërisht nga familjet shqiptaro-kosovare në diasporë.

Përkufizimet/ definicionet dhe problemet

Fillimisht (nga perspektiva e lexuesit) duhet sqaruar definicionin e “*kulturës*” i cili përdoret në këtë artikull, si dhe konstruktin e “*personalitetit*”. Këtë para se të elaborohen identitetet hibride të cilat me zhvillimin e tyre mund të kenë ndikim te niveli individual me procesin e zgjedhjes së duhur të komponentëve përbërës në bazë vullnetare deri te zhvillimi final i personalitetit dhe mundësisë së një kontributi në një nivel kolektiv shoqëror.

Kultura:

“(a): Model i integruar i dijes njerëzore, besimit dhe sjelljes të cilat varen nga kapaciteti për të mësuar dhe transmetuar njohuritë për gjeneratat pasuese. (b): Besimet lidhur me zakonet, format sociale dhe komponentet materiale të një grupi racor, fetar ose shoqëror; gjithashtu komponentet karakteristike të ekzistencës së përditshme (si diversionet ose një mënyrë e jetesës) që i ndajnë njerëzit në një vend apo në një kohë (...). (c): Grup i përbashkët i qëndrimeve, vlerave, qëllimeve dhe praktikave që karakterizojnë një institucion apo organizatë (...). (d): Grup i vlerave, konventave ose praktikave sociale të asociuara me një fushë, aktivitet apo karakteristikë shoqërore të caktuar.” (O'mara, 2002)

Personaliteti:

“Gjurmët e qëndrueshme të një individi që në bazë të vazhdueshme qëndrojnë nëpër një sërë situatash. Personaliteti përbëhet nga modelet relativisht të qëndrueshme të veprimit shpesh të referuara si “*Traits*” (tipare, veti) tendenca dispozicionale, motive, qëndrime dhe besime të cilat janë të kombinuara në një strukturë pak ose shumë të integruar. Personaliteti përfshin karakteristika dhe attribute që e dallojnë individin nga të tjerët. Edhe pse perspektivat e ndryshme teorike të personalitetit caktojnë nivele të ndryshme të

rëndësishme të gjenetika, të procesit të mësuarit social apo elementet më të gjëra sociokulturale, shumë pikëpamje konsiderojnë secilin nga këta faktorë të rëndësishëm kauzal gjatë zhvillimit të attributeve të personalitetit. Në përgjithësi, shumica e teorive bashkëkohore lidhur me personalitetin konsiderojnë si gjenet, ashtu edhe mjedisin si ndikime të rëndësishme për formimin e personalitetit. Teoritë e personalitetit ndryshojnë në bazë të rëndësise së vendosur njëherësh tek procesi qendror i organizimit (p.sh. vetvetja ose egoja) dhe së dyti tek elementet strukturore të caktuara (p.sh. tipare, veti, motive) të karakteristikave të personalitetit.” (The Encyclopedic Dictionary of Psychology, 1983)

Identiteti: Në këtë artikull do të përdoret përkufizimi në identitetin social krahasuar me atë personal. Identiteti social i referohet mënyrës tonë së të menduarit në lidhje me ne dhe rrethit tonë shoqëror bazuar në të ashtuquajturin proces të “social grouping” (grupimit social, përkthyer nga gjuha angleze). Identiteti social përfshin komponentet e identitetit të një personi të cilat kanë origjinën për të qenë pjesë e një grupi të caktuar. Ky definim distancohet nga identiteti personal ose elementet e identitetit me origjinë nga vetitë (tiparet) e identitetit dhe lidhjeve inter-personale.

Identiteti kombëtar: Përbrenda identitetit social do të përqendrohemi tek identiteti kombëtar i cili shpjegon ndjenjën e një personi që i përket një shteti ose një kombi. Bëhet fjalë për një ndjenjë që një individ ndan me një grup njerëzish të tjerë. Ky identitet karakterizohet me komponentët që shohim në jetën e përditshme si: gjuha, historia, lidhjet familjare, tradita dhe zakonet, muzika, ushqimi tradicional, etj.

Identiteti hibrid: Homi Bhabha, i cili nga shumë shkenctarë konsiderohet si babai i teorisë hibride, krijon një gjuhë të re dhe model të ri duke përshkruar identitetin e vetes dhe të tjerëve përreth tij, kështu:

“Është bërë e domosdoshme të diferencohet midis pamjes dhe ngjashmërisë së simboleve tek eksperiencat e ndryshme kulturore – letërsia, arti, muzika, ritualet, jeta, vdekja – dhe specifikat sociale e të gjitha prodhimeve të kuptueshmërisë në veçanti gjatë cirkulimit të tyre si indikatorë brenda një konteksti specifik të lokacioneve dhe vlerave të sistemeve sociale. Dimenzioni transnacional i transformimeve të kulturës – migrimi, diaspora, zhvendosja fizike nga vendlindja, rilokimi i vendbanimit – e bëjnë procesin e përkthimit kulturor një formë komplekse me kuptim të veçantë. Diskursi i natyralizuar, i

unifikuar i kombit, i njerëzve, ose traditat autentike popullore, mitet e përmbledhura të veçantisë kulturore nuk kanë referenca të gatshme. Avantazhi i madh (por jo i mbaruar) i këtij qëndrimi është ai se ngritet vetëdija në lidhje me krijimin e kulturës dhe shpikjen e traditës” (përkthyer nga gjuha angleze, Bhabha, 1994).

Pikërisht te migrimi dhe diaspora Bhabha tregon se kultura duhet të definohet në kontekstin e vetëkrijimit të saj. Për më tepër, autori konsideron se hibriditetin duhet shikuar si instrument për “çlirim” nga dominimi i imponuar i definicioneve, siç janë “raca”, “gjuha” dhe “kombi”.

Feddema (1992) sheh hibriditetin si *mélange* (përzierje, përkthyer nga gjuha frengjishte) të migrimit. Sipas tij një observim kolektiv është se migrantët e gjeneratës së dytë tregojnë tipare, veti të përziera kulturore (një distancim nga përzierja e kulturës dhe gjuhës të përvetësuar në shtëpi, kompatibël me kulturën e origjinës) kundrejt kulturës të përvetësuar jashtë shtëpisë (kompatibël me kulturën e vendit nikoqir). Për të përshkruar këtë fenomen ai përdor shembullin e një “myslimani” gjatë kohës së ditës dhe shkuarjes në diskotekë në orët e vonshme.

Në këtë artikull do të përqendrohemi te po ky fenomen i migrimit dhe i identiteteve hibride të formuara nga diaspora shqiptaro-kosovare.

Identiteti gjinor (te femrat dhe gratë brenda familjeve të migrantëve shqiptaro-kosovare):

Dahinden (2005) konstaton se këto femra dhe gra distancohen nga stereotipi i femrës tradicionale shqiptare. Ato kanë krijuar një identitet gjinor “të ri” bazuar në simbolet kulturore globale. Prandaj femrat që janë kthyer në vendlindje kanë ndarë në dysh (në gjuhën angleze “dichotomized”) përfaqësimin e gjinisë midis “emancipimit evropian” dhe “traditave shqiptare”. Ato shohin vetvetën dhe rolin e tyre gjinor si të transformuar prej një poli – të “traditës” – te poli tjetër – të (kohës) moderne (“modernity”) me konotacion negativ tek tradita dhe konotacion pozitiv te modernja.²

Identitetet cocktail:

“Sfida e të ‘konfrontuarit me identitete multiple’ bëhet gjithnjë e më komplekse dhe e rëndësishme me faktin që bota bëhet gjithnjë e më e vogël për shkak të mundësisë të migrimit dhe mobilitetit, si në

² Dahinden 2005: 204.

mënyrën virtuale ashtu edhe në atë reale, mund të jetë se njerëzit dhe grupet do ta shprehin vetën gjithnjë e më tepër nëpërmjet një perspektive multiple e jo nëpërmjet një perspektive të vetme të identitetit, kështu që do të jenë komponentët e “cocktailidentiteteve” (kombinimi i personave dhe konsekuencave) ato të cilat do të jenë më të rëndësishme. Pytja shtrohet se si do t’i mbrojmë dhe respektojmë identitetet kontradiktore dhe multiple? A do të ndodh kjo nëpërmjet identitetit të personave të ndryshëm, apo do t’i definojmë ne vet ato? Apo kjo do të ndodhë nën një set, grup të integruar të vlerave?” (Përkthyer nga gjuha angleze, Hardy, 2009).

Profesor Mike Hardy nga British Council përveç se pasuron terminologjinë në fushën e hibriditetit me të ashtuquajturit identitetet “cocktail”, ai konsideron konfrontimin me identitetin hibrid më kompleks. Për më tepër, ai mendon se njerëzit mund të fillojnë t’a shprehin vetën përmes personaliteteve të shumta dhe jo nëpërmjet vetëm atij personaliteti njëjës. Problematike e sheh autori mbrojtjen dhe respektin e shumë identiteteve, sidomos atyre që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Pytjet e shtruara nga ai i drejtohen posaçërisht hulumtuesve të cilët do të merren me fenomenin e identitetit hibrid në të ardhmën.

Globalizimi sipas Albrow (1990) i referohet të gjitha atyre proceseve nëpërmjet të cilave njerëzit nga e gjithë bota përfshihen në një shoqëri të vetme botërore, të ashtuquajturën “shoqërinë globale”.

Në sociologji konsiderohet si dukuri problematike shumimi social global. Në studimet e kulturave, fokusi përqendrohet te komunikimet globale dhe një stadardizim kulturor botëror, si p.sh. (Coca) Cola- kolonizimi dhe Mc donaldizimi, si dhe kultura postkoloniale (Pieterse, 1994).

Sipas Pieterse, modernizimi është një term kyç në reflektimet lidhur me globalizimin në sociologji. Sipas autorit globalizimi në një kontekst më të gjerë i referohet formimit të një fushe globale historike dhe përfshin krijimin e një kujtese (memorje) globale që rezulton nga eksperiencat globale që i ndajmë ne të gjithë.

Globalizimi dhe hibriditeti:

“Kontakti i shpeshtuar me njerëz të kulturave të ndryshme ka mbërritur deri tek përzierja kulturore, njëra mbi tjetrën dhe tek format e reja të një përkatësie. Sociologët lidhin konceptin e hibriditetit me atë të globalizimit dhe migrimit në përmasa të mëdha dhe tregojnë

dallimet gjithmonë e më të mëdha në traditat dhe format kulturore.” (Përkthyer nga gjuha angleze, Giddens, 2001).

Pieterse (1994) vjen në përfundim se proceset e globalizimit – si ato të së kaluarës, ashtu edhe ato tash – mund të përshkruhen në bazë ekuivalente me proceset e hibridizimit.

Më poshtë do të identifikohen disa nga problemet lidhur me konceptin e identiteteve hibride. Para konkluzionit do përdorën sqarimet e poshtëpërmendura për t’u aplikuar në shembullin e diasporës shqiptaro-kosovare dhe formimin e identiteteve hibride.

Problemet me hibriditetin: Profesoresha Floya Anthias (1999) kundërshton literaturën e përkohshme lidhur me hibriditetin e cila, sipas saj, mbivlerëson rolin ndërmjetësues në krijimin e identiteteve. Sipas saj hibriditeti nënkupton më shumë se një akter të lirë (të pavarur) i cili në bazë vullnetare vendos midis identitetit dhe pozicioneve; duke përfaqësuar personin hibrid si vetëm një ndër shumë kombinimeve të mundshme të tjera. Anthias (2002) bashkë me Noble dhe Tabar (2002) ndajnë mendimin se hibridin e pavarur të lirë (në gjuhën angleze “free-floating hybrid”) duhet kuptuar brenda një sistemi të përkufizimeve sociale dhe strukturore. Anthias (1999) po ashtu kritikon se formimi i identiteteve hibride nuk nënkupton automatikisht fundin e solidaritetit në baza etnike dhe reduktimin e etnocentrizmit dhe racizmit. Me fjalë të tjera, të qenit hibrid nuk qon domosdosmërisht deri te “hapja” e personave. Individët e kulturës dominante poashtu mund ta formojnë hibriditetin duke përvetësuar praktikatat kulturore në baza selektive, si simbolet dhe idetë nga minoriteti. Pa marrë parasysh, ky proces nuk shpie deri te “hapja” kundrejt personave tjerë dhe braktisjes së disa prej praktikave, vlerave dhe simboleve të kulturës dominante.

Identitetet hibride të diasporës

Identiteti i gjeneratave të reja në diasporë nuk bazohet në të qenit shqiptaro-kosovar si para dhe gjatë luftës (1989-1999), kur familjet ikën nga Kosova me mendimin se do jenë larg vendlindjes vetëm deri sa të mbarojë lufta. Gjatë kësaj periudhe kohore identiteti shqiptaro-kosovar madje u forcua për shkak të ndjenjës mizore në bazë kolektive që ndante një popull i cili vuante nga lufta dhe që u desh ta braktisë vendin e vet sa më shpejt që ishte e mundur.

Sot e ashtuquajtura “krizë” e identitetit sipas Ardian Vehbiut (2004) përqendrohet në faktin që gjeneratat e reja duhet të integrohen tërësisht në strukturat e vendit dhe shoqërisë në të cilën ato jetojnë. Ky fenomen mund të quhet evolim i gjeneratave të reja dhe të raportit të tyre me Kosovën e sotme si vend të origjinës. Por shtrohet pytja se a kemi të drejtë t’i paragjykojmë dhe “fajësojmë” këta të rinjë me origjinë kosovare që po “distancohen” për çdo ditë e më tepër nga identiteti i tyre me origjinë nga vendlindja? Me fjalë tjera, a është më mirë të jesh “shqiptaro-Kosovar” në një vend në të cilin me një probabilitet të lartë do ngelësh prapa – në rastin se nuk asimilohesh dhe integrohesh - apo t’a dobësosh, madje t’a “humbësh” identitetin paraprak dhe të jesh i “barabartë” me gjeneratat e njëjta te kombeve të ndryshme në vendin ku jeton?

Reduktimi i remitencave dhe vizitat gjithnjë e më të reduktuara të bashkatdhetarëve në vendlindje (pa marr parasysh turizmin në bregdetin shqiptar gjatë kohës së verës), si dhe zhgënjimi me mënyren e qeverisjes të shtetit kosovar që reflektohet në media lokale dhe ndërkombëtare, të cilat ndjekën edhe më tepër se vendasit, ndikojnë negativisht në përkrahjen e identitetit shqiptaro-kosovar dhe në një vendimmarrje potenciale për t’u kthyer dhe vazhduar jetën në vendlindje. Mosofrimi i kushteve minimale për një jetë me dinjitet nga shteti kosovar (për cfarëdo arsye të mundshme) fuqizon vendimin për të vazhduar jetën jashtë vendit amë. Ndonëse, në vendet ku ata jetojnë momentalisht, vetëm se gëzojnë një jetë me standard më të lartë (krahaso indekset e zhvillimit njerëzor ku Kosova ka më të ultin në Evropë dhe rajon IZhNj = 0.713)³ për të cilin standard Kosova momentalisht nuk posedon kapacitete të mjaftueshme ekonomiko-sociale si dhe politiko-menaxhuese në mënyrë që t’i ofroj diasporës së saj kthimin në vendlindje. Këtu bëhet fjalë, për shembull, sa i përket shërbimeve dinjitoze shëndetësore, përfshirë funksionimin e një mekanizmi të sigurimit shëndetësor, dhe një niveli kualitativ të arsimit për këto dhe gjeneratat e ardhshme.

Lidhur me mënyrën e jetës në vendet më të avancuara nikoqire duhet marrë parasysh perspektivën në vijim: një pikëpamje është procesi i izolimit ose “ghetoizimit”. Si fizikisht, me vendbanim në zonat ku jetojnë vetëm shqiptarët dhe përfaqësuesit e kombeve tjera që kanë braktisur vendlindjet e tyre për shkaqe të ngjashme të një konflikti të armatosur/ luftës, të problemeve me thelb politik ose

³ Raporti i zhvillimit njerëzor, UNDP (2012)

socio-ekonomik, ashtu edhe në aspektin ideologjik me një moto të një kryefamiljarit me origjinë nga Kosova rurale (ESI (2006), Denich (1974)⁴ dhe Dahinden (2005)⁵, i cili në radhë të parë nënkupton një lloj injorance dhe mosrespekt për vendin nikoqir. Dhe së dyti, perceptohet si një “pajtim” me një jetë në kushte minimale, që nënkupton izolim dhe regres - duke folur vetëm gjuhën amtare të degraduar dhe duke preferuar ambiente ku flitet vetëm ky lloj i gjuhës për një arsye kryesore se në ato rrethana ku ata jetojnë aplikimi i gjuhës nikoqire nuk është i domosdoshëm. Këtu duhet cekur se shumica e diasporës shqiptare janë të punësuar në vendet ku nevojiten aftësitë bazike ose elementare të gjuhës vendase, si p.sh. në sektorin e ndërtimitarisë, prodhimtarisë, amvisërisë etj. Me fjalë të tjera, njeriu mëson të jetojë në kushte bazike ose elementare që sado pak t’i përmirësohet gjendja socio-ekonomike, të jetë i kënaqur dhe të hezitohet me ndërmarrë masa jashtë një kornize që tejkalon “të domosdosshmën” e të jetuarit. Një kufizim i tillë i mundësive në një botë që çdo ditë e më tepër po përparon (shih progresin enorm në fushën e teknologjisë, posaçërisht në fushën e komunikimit) mund të ketë pasoja fatale për gjeneratat e ardhshme me origjinë shqiptare në Kosovë dhe jashtë kufijve të saj.

Një mendim përfaqësuar nga Ministria e Diasporës të Republikës së Kosovës është se të ashtuquajturat “klube kulturore” shqiptare duhet promovuar në shtetet ku ka diasporë shqiptarokosovare për arsye se familjet dhe rinia mbledhet, e flet gjuhen amtare dhe kalon kohë në një ambient të “një Kosove të vogël”. Me keqardhje duhet kundërshtuar këtë mendim për arsyet e lartpërmendura. Shkurtimisht, për të evituar ghezoizimin fizik dhe ideologjik si dhe me faktin e “nxënjes” së hapit të kohës që ka një dinamikë të jashtëzakonshme dhe e cila paraqet sfidë të madhe për gjeneratat e sotme dhe të së ardhmes.

Por, çfarë zgjidhje alternative kemi si opSION?

Si zgjidhje alternative mund të konsiderohet integrimi gjithëpërfshirës në strukturat lokale në diasporë i cili zgjeron diapazonin intelektual dhe atë profesional të gjeneratave të reja jashtë vendit amë. Me perfeksionimin e shkrimit dhe leximit të gjuhës në

⁴ Denich (1974) përshkruan shoqërinë shqiptare si strikt patriarkale, patrilokale dhe patrilineare. (Shih Dahinden 2005: 204).

⁵ “Migrimi dhe remitencat (...) kanë ndihmuar për të ruajtur një ndër institucionet më të vjetra dhe më konzervative të evropës: familjën tradicionale, patriarkale” (ESI, 2006: II).

vendin nikoqir – i cili nga gjuhëtarët konsiderohet si parakusht i mësimit të “pastër” të çdo gjuhe tjetër - me “grabitjen” e praktikave në fushën e arsimimit dhe atë profesionale, zanatit formohet një “aset” ose “fuqi” e jashtëzakonshme për Kosovën. Me sportistë, aktorë dhe këngëtarë të profiluar jashtë vendit Kosova vetëm se ka marrë (dhe merr) çdo ditë famë dhe popullaritet pozitiv në mbarë botën. Të gjithë këta individë kanë të përbashkët integrimin e tyre në shtetin nikoqir, në të njëjtën kohë duke mos mohuar asnjëherë origjinën dhe dashurinë ndaj vendlindjës së tyre. Ky fakt është i rëndësishëm posaçërisht në këtë fazë sensitive ku njohja e shtetit të ri, Kosovës, luan një rol të veçantë. Në këtë drejtim duhet punuar që poashtu personeli akademik, si studentët dhe profesorët, dhe ai profesional në fushat e politikës, ekonomisë, medicinës, arkitekturës, inxhinierisë e kështu me radhë, së pari të profilohej në vendet ku ata jetojnë. Si hap i dytë, duhet konsideruar kontributin e tyre për atdheun, ku Ministria e Diasporës mund të inkuadrohet dhe t’i analizojë mënyrat e përdorimit të kësaj fuqie për interesat e shtetit “brain gain” (përkthyer nga gjuha angleze, kthimi i “trurit”) dhe “brain circulation” (përkthyer nga gjuha angleze, “qarkullimi i trurit”).

Për shembull, me kontaktimin dhe ofrimin e një pune sfiduse për karrierën e këtyre personave (përfshirë këtu një rrogë të dinjitetshme) strukturat qeveritare mund të kenë sukses në kthimin e ekspertëve dhe profesionistëve që tashmë vetëm se kanë dëshmuar që kanë cilësi të jashtëzakonshme në vendet nikoqire. Edhe nëse pagat ju ofrohen jashtë normës kosovare dhe rajonale në bazë të kualifikimeve dhe suksesit të arritur në pozita vendimmarrëse si në arenën politike, por edhe në sektorin publik dhe privat, shteti dhe qytetarët kosovarë vetëm se do të përfitojnë. Është me rëndësi të sqarohet këtu fakti se nuk bëhet fjalë për kapacitetet dhe potencialet humane, por për sistemet e arsimit (të lartë) të cilat kanë avancuar ndjeshëm sa i përket kualitetit në krahasim me ato në Kosovë.⁶

Në fakt, shtetet të cilat kanë investuar në kthimin e profesionistëve kanë përfituar ekonomikisht nga ata. Si shembull,

⁶ Një raport për t’u veçuar sa i përket cilësisë së arsimit të lartë është publikuar nga instituti GAP me titullin “Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë”, ku janë përdorur indikatorë si: Hapësira e mjaftueshme në bazë të standardeve ndërkombëtare; Bibliotekë me inventar dhe numër të pasur të librave të fushave të ndryshme; Kabinete të pajisura me kompjuterë; Ambient të përshtatshëm të punës; Laboratorë dhe pajisje të nevojshme për punë; Sigurimi i cilësisë së studimeve, etj. (GAP, 2007:6).

programi shtetëror ‘brain gain’ i Kinës ka rikthyer me sukses personelin akademik, duke iu ofruar dyfishin e pagës mujore në krahasim me fakultetet në vendet ku ata veprojnë dhe punojnë. Shteti i Kinës ka momentalisht një ndër rritjet më të mëdha ekonomike në botë.⁷

Kthimi i trurit profesional në kontekstin e Kosovës është i rëndësishëm edhe duke marrur parasysh faktin që gjatë periudhës 1996-1999 kualiteti i arsimit nuk ka arrit nivelin e duhur kryesisht për shkak të regjimit dhe represionit fashist të shtetit serb dhe liderit të tij Slllobodan Millosheviqit. Për shembull, një numër i konsiderueshëm i studentëve vijuan ligjeratat në shtëpi të ndryshme private. Fakti se studentët e dalur nga po ajo gjeneratë sot ndodhen në pozita vendimmarrëse në Kosovë duhet fuqizuar vullnetin që shteti i ri të përfitojë nga “truri i kthyer” sa më shpejt që të jetë e mundur. Nevoja e personelit të ri profesional reflektohet edhe në krizën e re politike dhe të mospajtimit aktual pothuajse në të gjitha fushat midis pozitës dhe opozitës në parlament, por edhe jashtë tij. Gjendja socioekonomike si edhe ajo politike varet në bazë substanciale nga personat me kualifikimet e duhura të përvetësuar në universitetet me renome botërore dhe angazhimit të tyre në baza proaktive për përmirësimin e situatës në vendlindje.

Megjithatë, ekzistojnë edhe mënyra të tjera të përfitimit nga kuadri profesional i diasporës. Programet e “qarkullimit” të trurit janë të njohura posaçrisht në vendet më të zhvilluara të Bashkimit Evropian, si për shembull në Suedi.⁸ Nuk do të thotë se kontributi ndaj vendlindjes mund të ipet vetëm me të qenit fizikisht në pozita të punës së rregullt. Teknologjia e sotme, sidomos ajo informative është në zhvillim e sipër dhe komunikimi me tërë botën është lehtësuar në atë mënyrë që këshillat dhe dokumentet e një konzulenti profesional mund të barten (shkëmbehen) me shpejtësi të jashtëzakonshme te klienti. Në fushën e arkitekturës për shembull ka hapësirë që edhe në mospraninë fizike të ekspertëve të komunikohen idetë, përmirësimet dhe korrigjimet e një projekti ndërtimor para realizimit konkret të tij.

Ky adaptim që përshkruhet me integrimin e diasporës konform ligjeve, rregullave dhe profesionalizmit lokal mbështetet edhe nga fakti që evitohen automatikisht situatat dhe ambientet ku rinia me origjinë shqiptaro-kosovare shoqërohet me një grup njerëzish (‘peers’)

⁷ Shiko edhe Hendey, E. dhe Lemberg, T. (2012) “China’s Brain Gain”.

⁸ EMN (2010).

të dekurajuar nga sistemi dhe mekanizmat ku ata jetojnë - për vetë shkakun e mosintegritit të tyre - Kjo situatë mund të rezultojë në papunësi, mosinteresim për arsimim, madje edhe në vepra ilegale ku përfshihet edhe krimi.

Në një takim publik në kuadër të të ashtuquajturit “salloni i së martës” të organizuar nga “demokracia për zhvillim” me temën “*identiteti i gjeneratave të reja të diasporës dhe evoluimi i raportit të tyre me Kosovën*”⁹ të mbajtur në Prishtinë, pjesëmarrësit fillimisht u provokuan me probleme familjare potenciale me të cilat përballet diaspora shqiptaro-kosovare në ditën e sotme:

*“Prindërit me një anë shprehin dëshirën që fëmijët e tyre të flasin shqip (gjuhën amë), të mbajnë traditat dhe zakonet në shtëpi, dhe në anën tjetër të kenë sukses në shkollë dhe në jetën e përditshme ku flitet gjuha e huaj në një vend dhe kulturë që janë plotësisht të reja edhe për prindërit e tyre.”*¹⁰ Gjatë debatit rezultuan pyetje si këto që vijnë:

Mos po kërkohet shumë nga gjeneratat e reja në diasporë me origjinë shqiptaro-kosovare? Me një anë integrimi gjithëpërfshirës në strukturat lokale, në anën tjetër vazhdimësia e praktikave tradicionale, kulturore? A kanë prindërit të drejtë të kërkojnë “aq shumë” nga fëmijët e tyre? Ku duhet vënë prioritetet, tek adaptimi në vendet/strukturat nikoqire apo praktikat tradicionale-kulturore? A ekziston një mënyrë ku mund të përfshihen që të dy aspektet “për së miri”?

Në literaturën e “identitetit” dhe “kulturës”, identiteti hibrid përshkruhet si një miks apo cocktail i dy apo më shumë kulturave. Për shembull, në debatin e zhvilluar një pjesëmarrës tha: *“unë jam edhe suedez, edhe shqiptar. Unë mendoj se i përkas që të dy ‘botërave’”*.

Është me rëndësi që tiparet e mira nga që të dy kulturat të “absorbohen” dhe të internalizohen deri te formimi final i personalitetit, posaçërisht te rinia shqiptaro-kosovare në diasporë. Roli i prindërve është kyç, duke u interesuar vazhdimisht për zhvillimin e fëmijëve të tyre, si në aspektin kognitivo-zhvillimor, ashtu edhe për ambientin dhe rrethin shoqëror në të cilin fëmijët e tyre kalojnë kohën.

⁹ Shih editorialin e plotë te <http://d4d-ks.org/editorialet/identiteti-i-gjeneratave-te-reja-te-diaspores-dhe-evoluimi-i-raportit-te-tyre-me-kosoven-3/> (Shtator 2016).

¹⁰ Ky mendim mbështetet edhe nga ESI (2006).

Pytja socio-psikologjike dhe diskursi ‘*nature*’ (përkthyer nga gjuha angleze, natyra) vs. ‘*nurture*’ (përkthyer nga gjuha angleze, ambienti, rethi social, jetësor) që nënkupton gjenetikën dhe formim/zhvillimin “natyral” të njeriut kundrejt ndikimit të ambientit dhe ndikimeve eksternale (nga jashtë) ende konsiderohet si një pyetje aktuale jo tërësisht e zbërthyer. Shkencëtarët deri sot nuk kanë arritur të vinë në një përfundim se cili ndikim është më i madh (më i rëndësishëm) në zhvillimin e fëmijës, adoleshentit deri te formimi përfundimtar i personalitetit dhe maturitetit (pjekurisë). Por është vërtetuar se që të dy ndikime - përfshirë interagimin e tyre – luajnë rol esencial.

Më konkretisht, te shembulli ynë, prindërit duhet përkushtuar kujdes më të madh fëmijëve të tyre gjatë periudhës kognitivo-zhvillimore. Sidomos ndikimi i shoqërisë “peer pressure” (përkthyer nga gjuha angleze, presioni i bashkëmohatarëve) në diasporë duhet ndjekur me vëmendje të posaçme.

Për shembull, vet fakti që në Holandë konsumi i *Canabis Sativa*/Hashashit është legal¹¹, i jep hapësirë rinisë, adoleshentëve të familjeve të diasporës të eksperimentojë me atë edhe pse është vërtetuar se konsumi i kësaj droge mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në tru, që mund të rezultojë deri te një psikozë. Ekspozimi dhe konfrontimi me konsumin e drogës nga qytetarët dhe bashkëmohatarët lokal paraqet rrezik potencial.

Te adoleshentët është shumë me rëndësi fakti që ata të kenë ndjenjën që i përkasin një rrethi të caktuar shoqëror, kështu që në një shoqëri ku konsumohet kjo drogë të gjithë pjesëmarrësit janë të rrezikuar që fillimisht të provojnë dhe më vonë të konsumojnë këtë drogë në bazë të rregulltë. Më vonë, si reagim zinxhiror mund të vijë edhe deri tek konsumi i drogave më të rrezikshme, të cilat mund të krijojnë varësi tek adoleshentët e caktuar.

Pa marrë parasysh, prindërit shqiptaro-kosovarë duhet maksimalisht t’ua perkushtojnë kohën fëmijëve të tyre, normalisht duke konsideruar realitetin se shumica prej tyre kanë punë të vështira fizike dhe një kohë të limituar në dispozicion. Megjithatë duhet biseduar dhe informuar vazhdimisht për situatën e tyre gjatë kohës kur ata gjenden në shkollë ose gjatë aktiviteteve të tjera në kohën e lirë me

¹¹ Shih politikat tolerante sa i përket drogave të lehta në Holandë <https://www.government.nl/topics/drugs/contents/toleration-policy-regarding-soft-drugs-and-coffee-shops> (Korrik 2016).

bashkëmohatarët e tyre. Poashtu duhet treguar interesim se kush saktësisht janë shokët dhe shoqet e fëmijëve të tyre, duke i njohur ata në bazë personale. Përshkallëzimi deri te një devijim potencial në moshën adoleshente është shumë i ndjeshëm dhe mund të ndodhë shumë shpejtë. Posaçërisht fëmijët e familjeve shqiptare janë më të rrezikuara, duke marrë parasysh një lloj injorimi dhe diskriminimi institucional – mospërfillja perfekte e gjuhës nikoqire ndikon në një lloj jopërfshirjeje sociale në shkollë, në punë, te shërbimet publike - dhe individual te bashkëmohatarët. Ky diskriminim mund të rezultojë në një zhgënjim apo dëshpërim, përfshirë edhe depresionin (këtu bëhet fjalë më shumë për diasporën në Evropën Perëndimore, posaçërisht atë gjermanofolëse, ku imazhi i shqiptaro-kosovarëve është degraduar dhe ka humbur në vlerë nga praktikat ilegale të disa individëve kriminel me origjinë shqiptare.)

Shumë fëmijë të “çrrënjosur” nga vendlindja e tyre e kanë problem t’i adaptohen jetës në shtëpi dhe jashtë saj në diasporë. Mbi të gjitha vështirësitë e tyre të lartpërmendura, tashmë është i njohur edhe i ashtuquajtimi “konflikt i gjeneratave”. Ky konflikt paraqitet për shkak të ndryshimit të dinamikës së jetës së përditshme krahasuar me kohën kur prindërit kanë qenë vet adoleshentë - shumica prej tyre në vendlindje të tyre, në shtetin jugosllav - varësisht për cilën gjeneratë bëhet fjalë. Ky konflikt mund të manifestohet deri te përçarja dhe shpërbërja e një familjeje, ku fëmija ose prindërit distancohen tërësisht nga njëri-tjetri.

Në kulturën zvicerane për shembull në moshën 18-vjeçare fëmija është paraprakisht i informuar dhe obligohet nga ana e prindërve të lëshoj shtëpinë me një cak që të pavarësohet dhe ndër të tjerat të mos jetë “barrë” e mëtutjeshme (financiare) e familjes në fjalë.¹² Me aplikimin e kësaj praktike lehtë vjen deri te praktika dhe zbatimi, përfshirë familjet shqiptaro-kosovare, ku një fenomen i tillë kurrë nuk do merrej parasysh, ndonëse ai thjesht kurrë nuk ka qenë pjesë e kulturës sonë.

Nëse diaspora shqiptaro-kosovare është në gjendje me një anë të absorboj të mirat e shtetit nikoqir, si për shembull arsimimin kualitativ, profesionalizmin, zanatin në fusha të ndryshme, shprehinë e punës, saktësinë kohore, etj., dhe në anën tjetër të kultivojë dhe aplikojë “të mirat” që ndërliken me kulturën, si p.sh. përkushtimin për familje dhe lidhjet e forta të saj, ngrohtësinë shtëpiake që i ofrohet

¹² P.sh. <https://aspectfoundation.org/host/switzerland.html> (Dhjetor 2016).

çdo mysafiri, aftësitë për t'iu adaptuar çdo rrethi shoqëror të mundshëm, çdo gjuhe, shkolle, pune si dhe çdo lokacionit në botë, atëherë këta individë me një probabilitet të lartë do të arrijnë sukses si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kombëtar, ku përfiton edhe vendi amë.

Te shembulli ynë konkret sa i përket diasporës shqiptaro-kosovare dhe identiteteve të krijuara, zgjedhja për formimin e këtyre identiteteve ndodh në bazë vullnetare dhe individuale. Identitetet hibride janë vetëm një kombinim i mundshëm, i cili me një probabilitet të caktuar mund të formohen, por jo në bazë automatike. Ndonse p.sh. shqiptaro-kosovarët mund të përqëndrohen vetëm te një identitet, atë të krijuar në shtetin nikoqir apo atë të formuar nga origjina shqiptare dhe nuk janë të interesuar t'i ndryshojnë pozicionet e tyre sa i përket zgjedhjes së identitetit të tyre të preferuar, ky proces ndodh normalisht në përkufizimet e rrethit social ku ata jetojnë.

Si p.sh. traditat për kërsëndella që manifestohen në festa te popullata vendëse shumica e të cilës përbëhet nga katolikët apo feve tjera në Evropën Perëndimore, të cilat respektohen por nuk praktikohen tek shqiptaro-kosovarët, shumica e të cilëve i përkasin fesë myslimane, si dhe tek përkufizimet strukturore, p.sh. ligjet, rregulloret, etj. që ka shteti nikoqir.

Kritikat e lartpërmendura rreth identiteteve hibride dhe solidaritetit në baza etnike, si dhe reduktimit të etnocentrizmit, duke përjashtuar ideologjinë e racizmit, qëndrojnë me përmasa të mëdha kur flasim në kontekstin shqiptaro-kosovar. Diaspora pretendon të tregoj solidaritet më të madh krahasuar me bashkëkombasit në vendlindje, duke treguar këtë p.sh. me dërgimin e rregullt të remitencave te familjet e tyre, apo me vizita të shpeshta (UNDP, 2014).

Edhe aspekti humanitar, si p.sh. investimet për ndërtimin e shtëpive në Kosovë (posaçrisht për familjet më të varfura) bëhen më shumë nga bashkëkombasit nga diaspora. Diaspora për më tepër pretendon ende të praktikoj traditat kombëtare dhe fetare, si dhe të adhuroj më tepër simbolet si flamurin kombëtar edhe pse gjenden fizikisht jashtë vendlindjes krahasuar me bashkëkombësit në atdhe. Madje mendohet – ndonse nuk është bërë një studim i tillë ende - se diaspora përcjell në bazë edhe më intenzive mediat lidhur me gjendjen politike dhe socioekonomike në Kosovë, se sa familjet shqiptaro-kosovare që jetojnë në vendlindje. Interesimi i pandalshëm mund të

rrjedhë edhe nga fakti se një masë e madhe e diasporës ende mendon të kthehet në vendlindje për të vazhduar dhe mbaruar jetën e tyre.

Konkluzioni

Literatura që shpjegon identitetet hibride është e mjaftueshme, por jo edhe në kontekstin shqiptaro-kosovar. Domosdosshmëria e studimit të identiteteve hibride në këtë kontekst mund të arsyetohet me faktin e avancimit të literaturës lidhur me identitetet hibride dhe globalizimin në mbarë botën, por edhe me faktin që diaspora shqiptaro-kosovare përbën një masë prej gati gjysmës së popullatës që jeton aktualisht në territorin e Kosovës.

Edhe pse procesi i mospërfshirjes sociale dhe e izolimit në disa vende nikoqire mbetin sfida për t'u tejkaluar nga familjet shqiptaro-kosovare në diasporë, identitetet e formuara hibride që depërtojnë në sistemet e avancuara arsimore dhe profesionale duhet konsideruar si asetë të mëdha për vendin amë.

Forma e shfytëzimit të tyre mund të jetë njëherësh kthim i trurit si dhe qarkullimi i tij në botën fizike dhe atë virtuale. Ministria e Diasporës në Kosovë mund ta konsiderojë ushtrimin e një roli ndërmjetësues në këto procese.

Edhe pse ende nuk dihet saktësisht se cili faktor - natyra, gjenetika apo rrethi jetësor social, luajnë rol më të rëndësishëm gjatë procesit të zhvillimit të trurit dhe krijimit të identiteteve hibride, fusha humano-sociale, posaçrisht ajo e psikologjisë dhe e sociologjisë ka vërtetuar se që të dy ndikimet ekzistojnë dhe bashkëveprojnë.

Te rrethi jetësor social, prindërit duhet perkushtuar kujdes të veçantë fëmijëve të tyre sidomos te koha që kalon adoleshenti jashtë shtëpisë në një rreth shoqëror ku ai/ajo është i/e ekspozuar një lloj presioni social i nisur nga bashkëmoshatarët e tyre.

Sa i përket fenomenit të një konflikti potencial të gjeneratave brenda një familjeje, duhet konsideruar se familjet shqiptaro-kosovare në diasporë janë më të rrezikuara krahasuar me ato në Kosovë - ndonse avancimi i teknologjisë dhe ndikimi i globalizimit është më i thelluar në shtetet më të zhvilluara. Prindërit nuk duhet referuar kohës kur ata kanë qenë të ri (adoleshentë), por duhet formuar një relacion fitimprurës (WIN-WIN) me fëmijun, ku që të dy palet, si prindi ashtu edhe fëmija, në bazë reciproke ofrojnë hapësirë dhe gatishmëri që të mësojnë nga njëri-tjetri, duke shkëmbyer dijen dhe eksperiencat e

përfituara si dhe duke iu përshtatur zbulimeve aktuale, inovative posaçrisht në fushën e teknologjisë informative, si p.sh. sa i përket telefonave të mençur.

Te problemet e evidentuara lidhur me identitetet hibride te diaspora shqiptaro-kosovare mund të theksohet fakti se edhe pse ekziston mundësia e zgjedhjes së “një” identiteti të preferuar, diaspora jonë njihet për asimilimin/ integrimin e shpejtë dhe të suksesshëm në strukturat dhe mekanizmat shtetrorë të vendeve të tjera, kështu që edhe përvetësimi i vetëm një identiteti – atij të shtetit nikoqir, por jo vetëm të atij shqiptaro-kosovar – mund të konsiderohet si i suksesshëm nëse individi në fjalë arrin të depërtoj deri te shtresat më elitare intelektuale, profesionale në vendin ku ai ose ajo jeton. Edhe pse në këtë drejtim me një anë kontributi për shtetin amë mund të rrezikohet, por në anën tjetër imazhi i diasporës shqiptaro-kosovare në shtetin nikoqir mund të përmirësohet në baza substanciale.

Solidariteti me bashkëkombësit në Kosovë në baza etnike si dhe i simboleve perkatëse mund të paraqet pengesë potenciale në formimin pozitiv të identiteteve hibride, por jo edhe domosdosshmërisht. Vetëm përmasat radikale të një përkushtimi etnocentrik (të njëanshem) mund të paraqesin rrezik për t’u konsideruar gjatë formimit të identiteteve në fjalë.

Sa i përket aspektit humanitar, kjo do të varet nga intenziteti i lidhshmërisë dhe ndjeshmërisë së diasporës në raport me vendin amë. Mund të supozohet se gjeneratat e reja të diasporës mund ta dobësojnë këtë lidhshmëri, p.sh. duke u martuar me partnerë të përkatësive etnike, nacionaliteteve tjera, e cila mund të rezultoj deri te shkëputja totale nga vendi/ lokacioni i origjinës dhe njerëzve të cilët jetojnë atje.

Por, derisa diaspora ende është aktive në blerje të pasurisë së patundshme, në ndërtimin e shtëpive, në hapjen e bizneseve të reja dhe investimeve të tjera në vendlindje dhe informohet rregullisht për gjendjen socioekonomike si dhe atë politike, shkëputja emocionale dhe ajo fizike e familjeve në diasporë kundrejt vendit amë ka një probabilitet shumë të ulët për t’u realizuar.

Referencat

- [1] Aspect Foundation: Switzerland. Në:
<https://aspectfoundation.org/host/switzerland.html> (Dhjetor 2016)
- [2] CNN (1999) "Desperate refugees flee Kosovo, accuse Serbs of atrocities".
Shikoje linkun në vijim:
<http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/29/refugees.04/> (Djetor 2016)
- [3] Dahinden, Janine (2005) "Contesting transnationalism? Lessons from the study of Albanian migration networks from former Yugoslavia". In *Global Networks* 5, 2 (2005) p. 191-208. ISSN 1470-2266.
- [4] European Stability Initiative ESI (2006) "Cutting the lifeline: Migration, Families and the Future of Kosovo". Në ESI, f. 1-39, te:
http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_80.pdf (Korrik 2016)
- [5] European Migration Network EMI (2010) "Temporary and circular migration: empirical evidence, current policy practice and future options in EU member states". Në
http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/european_migration_network/reports/docs/emn-studies/circular-migration/26a._sweden_national_report_circular_migration_final_version_9_dec2010_en.pdf (Korrik 2016).
- [6] Féraud, Marie (1978) "Anne ici-Sélima là-bas", Duculot: Gembloux, Paris.
- [7] GAP Instituti për studime të avancuara (2007) "Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë".Në
http://www.institutigap.org/documents/43587_Pasqyre_e_Arsimit_C3AB_LartCAB_nC3AB_KosovC3AB.pdf (Korrik 2016).
- [8] Hardy, Tom (2009) "Future of Identity - Presentation". Në British Council te:
<http://www.slideshare.net/FutureAgenda/future-agenda-future-of-identity> (Janar 2016)
- [9] Haslam, Alexander S. (2001) "Psychology in Organizations - The Social Identity Approach", Sage Publications Ltd, London. Chapter 2: The Social Identity Approach, p. 26-57.
- [10] Hendey, E. dhe Lemberg, T. (2012) "China's Brain Gain".
Në <http://harvardpolitics.com/covers/chinas-brain-gain/> (Korrik 2016).
- [11] Kohli, Martin (2000) "The Battlegrounds of European Identity". Në University of Berlin tek:
https://www.academia.edu/3715591/The_battlegrounds_of_European_identity (Janar 2016)
- [12] Maalouf, Amin (2000) "Mörderische Identitäten", Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main.
- [13] Marotta, Vince (2008). Në "Social Identities: The hybrid self and the ambivalence of boundaries", f. 295-312 tek:
- [14] Marotta, Vince "Hybrid Identities in a Globalized World", f. 188-203 tek:
https://www.academia.edu/2588660/Hybrid_Identities_in_a_Globalised_Wor

- Id (Janar 2016). Në “The Encyclopedic dictionary of psychology / edituar nga Harré, Rom dhe Lamb, Roger; bordi editorial, R.D. Attenborough (et al.)” (1983), f. 458-461.
- [15] Nushi, Denis (2012) “Identiteti i gjeneratave të reja të diasporës dhe evoluimi i raportit të tyre me Kosovën”, Demokraci për zhvillim. Në <http://d4d-ks.org/editorialet/identiteti-i-gjeneratave-te-reja-te-diaspores-dhe-evoluimi-i-raportit-te-tyre-me-kosoven-3/> (Korrik, 2016)
- [16] O'mara, Peggy (2002) tek: <http://www.merriam-webster.com/dictionary/culture> (Janar 2016).
- [17] Pieterse, Jan Nederveen (1994). Në “International Sociology: Globalization as Hybridization”, f. 658-680.
- [18] Sandset, Tony (2011). Në “New Narratives: Some Thoughts on Hybrid Identity. Hybrid Identity: Dictionaires, Identities and “Are we all hybrids”?”. Në University of Oslo tek: <https://newnarratives.wordpress.com/issue-1-hybrid-identity/some-thoughts-on-hybrid-identity/> (Janar 2016)
- [19] Smith, Keri and Leavy, Patricia (2008) “Hybrid Identities: Theoretical and Empirical Examinations”, Brill Leiden Boston. Chapter 6: Bridging the Theoretical Gap: The Diasporized Hybrid in Sociological Theory, f. 101-116.
- [20] “Social Identity Theory”. Në University of Twente tek: <http://www.utwente.nl/cw/theorieenoverzicht> (15.12.2015)
- [21] Zogaj, Veton (2014) “Krijimi i identitetit individual dhe identitetit kolektiv”. Tek: <http://www.telegrafi.com/lajme/krijimi-identitetit-individual-dhe-identitetit-kolektiv-26-6986.html> (Janar 2016). <http://dro.deakin.edu.au/view/DU:30018002> (Janar 2016)
- [22] Yazdiha, Haj (2010) Në “Formations: Vol.I, No.I. Conceptualizing Hybridity: Deconstructing Boundaries through the Hybrid”, f. 31-38.

Një biografi e shkurtë e autorit

Denis Nushi posedon titullin e doktorit në shkencë humane dhe sociale nga Atlantic International University në Honolulu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Programin e Licentiatit philosophicae (lic.phil.), i cili është ekuivalent me atë të Masterit (MA) në shkencat sociale me fokus në politikë dhe konflikt (antropologji sociale), psikologji sociale dhe kriminologji, ai e përfundoi me sukses në Universitetin e Çirihut në Zvicër. Shumica e punimeve të tij janë përqendruar në kontekstin e vendlindjes së tij. Praktikën profesionale gjashtëmujore ai e mbaroi te Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC) në Vjenë, Austri. Që nga shkurti 2010 ai është pjesë e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Prishtinë në rolin e specialistit për zhvillim njerëzor brenda departamentit për hulumtime dhe politikbërje. Në vitin 2011 ai është certifikuar nga Universiteti i Evropës Qendrore në Budapest (HUN) për përfundimin e suksesshëm

të trajnimit lidhur me "Zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor: Nga kornizat ndërkombëtare deri te politikat rajonale", ndërsa në maj të vitit 2015 ai u certifikua nga Kolegji i Bashkimit Evropian për Siguri lidhur me praktikat në nivelin global për "Paqëndërtim dhe ruajtje". Në rolin e specialistit për zhvillim njerëzor ai ushtron edhe detyrën e menaxherit organizativ dhe operacional për raportet e zhvillimit njerëzor në Kosovë dhe është një nga bashkautorët e raportit të zhvillimit njerëzor 2014 të titulluar "Migrimi si një forcë për zhvillim". Së fundmi, ai ka qenë pjesë e ekipit ndërkombëtar i cili ka përpiluar dhe shkruar raportin ndër-rajonal të zhvillimit njerëzor 2016, të titulluar: "Fuqizimi i njerëzve në parandalimin e fatkeqësive". Pavarësisht aktiviteteve të tij mësimdhënëse dhe ligjëratave të mbajtura mbi temën e migrimit dhe zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës, ai shkruan rregullisht artikuj dhe editoriale. Me poshtë janë disa nga punimet e tij, si dhe disa kontribute cilësore:

- "Kontributi i mobilitetit të fuqisë punëtore në zhvillimin njerëzor dhe atë ekonomik" (Demokraci për Zhvillim, 2016)
- "Raporti ndër-rajonal i zhvillimit njerëzor 2016: Fuqizimi i njerëzve në parandalimin e fatkeqësive" (UNDP, 2016)
- "Raporti i zhvillimit njerëzor i Kosovës: Migrimi si një forcë për zhvillim" (UNDP, 2014)
- "Identiteti i gjeneratave të reja të diasporës dhe evoluimi i raportit të tyre me Kosovën" (Demokraci për Zhvillim, 2012)
- "Shqyrtimi i hipotezës, prognozës së Samuel Hantington-it: Përplasja e qytetërimeve (1993) në shembullin e konfliktit ndëretnik në Kosovë", përkthyer nga gjuha gjermane (Univerziteti i Cyrihut, 2006)
- "Krijimi i identitetit përmes historisë të shqiptarët dhe serbët në Kosovë", përkthyer nga gjuha gjermane (Univerziteti i Cyrihut, 2005)
- "Perceptimi i studentëve të Cyrihut për pjesëmarrjen e të huajve (jovendasve) në tregun zvicran të trafikimit ilegal të substancave narkotike", përkthyer nga gjuha gjermane (Univerziteti i Cyrihut, 2004/ 2005)
- "Rrezikshmëria për të konsumuar drogë ilegale në shembullin e adoleshentëve të familjeve shqiptare të cilat kanë migruar dhe jetojnë në Zvicër", përkthyer nga gjuha gjermane (Univerziteti i Cyrihut, 2003)
- "Sundimi i ligjit dhe jurisprudenca në Kosovën e sotme: një studim i sistemit gjyqësor prej perspektivës së akterëve internacionalë dhe vendës mbështetur në shembujt konkretë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Kosovë", përkthyer nga gjuha gjermane (Univerziteti i Cyrihut, 2003)

Kontributi cilësor:

- "Fjalor shpjegues i psikanalizës" (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2012).
- "Perceptimet mbi drejtësinë tranzicionale në Kosovë" (UNDP, 2012).
- "Vizioni 2050. Një hartë e re politike dhe ekonomike e botës" (Instituti global i postkonflikteve, 2013).

Arsim Ejupi, Prishtinë

MIGRIMET E JASHTME NGA LUGINA E PRESHEVËS - FAKTORËT PËRCAKTUES DHE EFEKTET

Abstrakt

Shteti jugosllav pas Luftës II Botërore ndjek rrugën e socializmit më të moderuar dhe më liberal në raport me shteteve e tjera socialiste të lindjes, gjë që mundësoi lëvizjen më të lirë të mallrave dhe njerëzve me vendet kapitaliste të Europës Perëndimore. Në anën tjetër, në shumë vende të Europës Perëndimore rriten nevojat për fuqi punëtore për të realizuar projektet në infrastrukturë, në industri dhe në ndërtimin e banesave. Kjo bën që kah fundi i viteve të 60-ta dhe fillimi i viteve të 70-ta popullsia e moshës së re të migrojë si fuqi punëtore në shumë vende të Europës Perëndimore. Nga të dhënat që disponohet nga regjistrimet e popullsisë dhe dokumentacioni i komunave të Luginës vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve (rreth 24.000 veta) punon dhe jeton në botën e jashtme. Në verën e vitit 2014 është bërë një hulumtim anketues për migrantët e jashtëm me qëllim që të shihej rrjedha dhe veçoritë kryesore të migrimeve të jashtme nga Lugina, çfarë janë shkaqet e emigrimit, statusi i migrantit, adaptimi dhe asimilimi, lidhja me familjen dhe vendlindjen, investimet, çështja e kthimit, pasojat e emigrimit për familjen, bashkësinë rajonale e lokale dhe shoqërinë etj.

Fjalët çelës: migrimet, popullsia, fuqia punëtore, asimilimi, integrimi, Lugina e Preshevës.

Hyrje

Rritja e vazhdueshme absolute dhe relative e numrit të popullsisë në Luginën e Preshevës, në njërën anë, dhe mungesa e investimeve për një zhvillimin ekonomik të rajonit sjell me vete probleme të shumta social-ekonomike, të cilat në radhë të parë shprehen me rritjen e numrit të popullsisë bujqësore, fragmentimin edhe ashtu të madh të tokave, rritjen e çmimit të tyre, duke e bërë


gjithnjë e më të vështirë jetën në Luginën e Preshevës. Kjo situatë e vështirë bën që popullsia e Luginës së Preshevës të kërkojë punë në vendet e ndryshme të Evropës. Kjo ka të bëjë me periudhën e fundit të viteve të 60-ta dhe fillimit të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, kur popullsia, kryesisht e moshës së re, fillon të emigrojë në vendet e ndryshme, si në Gjermani, Zvicër, Austri, Francë si fuqi punëtore për kryerjen e punëve të vështira në ndërtimtari dhe industri. Për shkak të përkeqësimit të rrethanave ekonomike-sociale dhe politike në Luginën e Preshevës emigrimi i popullsisë jo vetëm që vazhdon, por edhe intensifikohet në dekadat në vijim, andaj tani sipas të dhënave të organeve komunale në vitin 2002 kjo popullsi kapë shifrën prej 23.900 banorëve ose 21,2% e numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Metodologjia e punës

Anketimi është realizuar përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të anketuarit, duke marrë informata të besueshme dhe në një mënyrë të pritshme për pasqyrimin e drejtë të shumë aspekteve për migrimet e jashtme nga Lugina. Për realizimin e suksesshëm të anketës është përcaktuar madhësia e mostrës e cila përfshinë 10% të ekonomive familjare që ndodhen në botën e jashtme. Shumica e të anketuarve kanë qenë kryefamiljarë, por nevoja për të ndriçuar aspekte të ndryshme të migrimeve të jashtme, që kryesisht kanë të bëjnë me nivelin e shkollimit, integritimit, asimilimit dhe të ngjashme kanë kushtëzuar që në anketim të përfshiheshin edhe migrantë të cilët sipas moshës që kanë dhe periudhës kur kanë migruar i takojnë brezit të mesëm. Pyetësi përmban gjithsej 32 pyetje hulumtuese (indikatore) dhe është i ndarë në 6 pjesë. *Pjesa e parë* e pyetësorit përmban pyetje të karakterit të përgjithshëm, çfarë janë viti dhe vendi i lindjes, moshë e migrantëve, niveli i shkollimit dhe statusi martesor. *Pjesa e dytë* përmban pyetjet që kanë të bëjnë me vitin dhe vendin e migrimit, ndërrimin e vendit emigrues, mënyrën e migrimit, numrin e anëtarëve të familjes, mënyrën (gjuhën) e komunikimit në familje etj. *Pjesa e tretë* e pyetësorit është e fokusuar në shkaqet e migrimeve, *pjesa e katërt* ka të bëjë me statusin e migrantëve; *pjesa e pestë* lidhet me adaptimin, integrimin dhe asimilimin në rrethin e ri shoqëror; *pjesa e gjashtë* përqendrohet të marrë përgjigje mbi kontaktet dhe lidhjet që i mbajnë migrantët me vendlindjen dhe përgjigjen mbi kthimin ose jo të migrantëve në vendlindje.

Rezultatet dhe diskutimi

Nga përpunimi i të dhënave të anketimit, në pyetjen mbi vendin e migrimit del që 60% e popullsisë shqiptare të Luginës kanë emigruar në Zvicër, prandaj edhe sot e gjithë ditën në këtë shtet ndodhet pjesa më e madhe e popullsisë migruese nga Lugina. Vendi i dytë me numrin më të madh të migrantëve të jashtëm është Gjermania me 17% të popullsisë së migruar. Pastaj vijnë me radhë Austria me 8%, Suedia me 4%, Norvegjia me 2%, Franca dhe SHBA me nga 1% dhe vendet e tjera me 1%.




Graf. 1. Drejtimit e migrameve të jashtme nga Lugina

Duke analizuar vendin e migrameve me periudhën e migrameve rezulton që në shtetet si Zvicra, Gjermania dhe Austria migrimet janë më të hershme dhe përkrijnë me periudhën e fundit të viteve të 60-ta dhe fillimit të viteve të 70-ta për të vazhduar edhe më vonë. Ndërsa në shtetet skandinave, në Belgjikë, në Francë dhe në shtetet tjera, me ndonjë përjashtim eventual, migrimet janë të periudhës pas viteve të 90-ta të shekullit të kaluar dhe dekadës së parë të këtij shekulli.

Në pamundësi të vjeljes së të dhënave për migrimet e mëhershme nga Lugina dhe duke pasur si objektiv parësor studimin dhe ndriçimin e trendeve bashkëkohore të popullsisë dhe vendbanimeve të territorit, në hulumtimin e realizuar përmes anketimit është vënë theksi vetëm në migrimet e zhvilluara pas Luftës II Botërore në drejtim të vendeve të zhvilluara të Europës Perëndimore.

Nga përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes anketimit shihet që brenda periudhës 1965-1970 në botën e jashtme kanë migruar 2% e popullsisë. Kjo njëherësh paraqet periudhën initiale të migrimeve, kur për herë të parë entet e punësimit ofronin mundësinë e shkuarjes dhe gjetjen e punës në botën e jashtme (shih grafikun nr. 2).



Graf. 2. Periudha e migrimeve nga Lugina e Preshevës

Punësimi i shpejtë, çmimi i lartë i punës dhe benefitet e tjera sociale e shëndetësore nga të cilat përfitojnë migrantët e parë shpejt joshin shumë të rinj të cilët fillojnë më intensivisht të migrojnë në shtetet e Europës Perëndimore. Prandaj gjatë periudhës 1971-1981 migrojnë rreth 14% e migrantëve nga Lugina, ndërsa periudha 1981-1990 shënon numrin më të madh të atyre që emigrojnë nga rajoni (39%). Gjatë periudhës së parë dhe të dytë migrojnë vetëm kryefamiljarët, ndërsa në fund të viteve të 80-ta dukuria e migrimeve merr dimension tjetër, kur fillon migrimi i familjeve të tëra ose formave të ndryshme të bashkimit familjar. Në periudhën deri në fund të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar shkaqet e migrimeve kanë qenë kryesisht ekonomike, ndërsa nga viti 1981 e këndej, përveç shkaqeve ekonomike, migrimet nxiten edhe për shkaqe politike, andaj kjo rezulton në përqindjen më të lartë të popullsisë që migron në botën e jashtme. Kjo është periudha e fillimit të shturjes së ish-Jugosllavisë që nisë pikërisht në Kosovë.

Me intensitet të ngjashëm dhe për shkaqe të njëjta, si në periudhën paraprake, emigrimi i popullsisë vazhdon edhe gjatë periudhës 1991-2000, kur nga Lugina në drejtim të shteteve të Europës Perëndimore emigrojnë 33% e migrantëve. Procesi i

shkatërrimit të Jugosllavisë së Titos sjell deri te konfliktet dhe luftërat e përgjakshme në Kroaci, BeH dhe së fundi në Kosovë. Shumë të rinj shqiptarë migrojnë kryesisht në formë ilegale, duke dezertuar nga ushtria jugosllave, ku pa vullnetin e tyre ishin angazhuar në luftë kundër kroatëve dhe boshnjakëve, sikundër edhe shumë të tjerë, të cilët të frikësuar nga propaganda nacionaliste serbe dhe thirrjet për kryerjen e shërbimit ushtarak deri në mobilizimin e dhunshëm të të rinjve gjatë luftës së Kosovës përmes formave të ndryshme ilegale emigrojnë në shtetet e Europës Perëndimore. Një moment i rëndësishëm i kësaj periudhe është lufta e vitit 1999, kur shumë të rinj së bashku me familjet e tyre nga kampet e refugjatëve në Maqedoni shkojnë në shumë shtete të Europës Perëndimore dhe më larg.


Emigrimi i popullsisë nga Lugina në botën e jashtme vazhdon edhe pas vitit 2000. Kështu në periudhën prej 2001-2010 nga ajo kanë emigruar 12% e numrit të përgjithshëm të migrantëve. Gjatë kësaj periudhe migrimit i kontribuon edhe liberalizimi i regjimit të vizave që Serbia arrin të realizojë me shumicën e vendeve të BE-së. Gjatë kësaj periudhe kemi emigrimin e familjeve të tëra nga komuna e Preshevës dhe Bujanocit, kryesisht për në Belgjikë, Suedi, Francë, Holandë etj. Shumica dërmuese e popullsisë që ka migruar (92%) ndodhet në të njëjtin vend ku ka emigruar për herë të parë, ndërsa vetëm 8% e kanë ndërruar vendin e migrimit. Pjesa më e madhe e migrantëve kanë shkuar si fuqi punëtore (61%), ndërsa të tjerët (39%) kanë shkuar për shkak të bashkimit familjar. Kategoria e parë e migrantëve i takon periudhave të mëhershme të migrimit deri në fund të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, ndërsa më pas dominon numri i atyre që kanë shkuar për t'u bashkuar me bashkëshortët dhe prindërit e tyre që kanë emigruar më herët. Në periudhën më të re shprehet më shumë migrimi si formë e bashkimit familjar përmes martesave ndërmjet të rinjve që ndodhen në botën e jashtme dhe atyre që janë në vendlindje.

Deri në vitin 1991 popullsia e ish-Jugosllavisë, ku bënte pjesë edhe Lugina e Preshevës, ka pasur mundësinë e qarkullimit të lirë, pa pasur nevojë për viza dhe dokumente shtesë për udhëtim. Kjo ka bërë që me përjashtime të rralla shkuarja e popullsisë të bëhet në mënyrë legale. Nga viti 1991 e më vonë sanksionet ekonomike dhe politike të vendosura nga bashkësia ndërkombëtare ndaj ish-Jugosllavisë së mbetur (Serbia dhe Mali i Zi) prekin edhe sferën e lëvizjes së lirë të njerëzve. Prandaj shumica e shteteve evropiane vendosin regjimin e vizave për qytetarët e Serbojugosllavisë. Në rastin e shqiptarëve të

Luginës nuk ka ndërprerje të procesit, por vetëm ndryshon mënyra e migrimit. Prandaj pas të 90-tave e këtej fillon të rritet numri i atyre që emigrojnë ilegalisht. Këtë e dëshmojnë edhe rezultatet e anketimit nga të cilat del se 74% e popullsisë ka emigruar në mënyrë legale, ndërsa 26% e saj në mënyrë ilegale.

Lidhur me kontekstin historiko-politik të lëvizjeve migruese nga Lugina u bë fjalë më herët. Lugina e Preshevës edhe pse me bazë të volitshme gjeografike-natyrore dhe pozitë të volitshme gjeokomunikative ngeci në zhvillimin ekonomik, që ishte edhe motivi kryesor që popullata aktive e saj në kërkim të punës mori rrugën e kurbetit drejt vendeve evropiane. Nga përpunimi i të dhënave të anketimit për migrimet e realizuara pas viteve të 60-ta, në pyetjen mbi shkaqet e migrimeve rezultoi që 52% e popullsisë kanë emigruar për të siguruar kushte më të mira për jetesë (shih grafikun nr. 3). Punësimi dhe pagat e larta u kanë mundësuar migrantëve që të sigurojnë ekzistencën dhe mirëqenien sociale dhe ekonomike të familjeve në vendlindje.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 8% janë përgjigjur se qëllimi i emigrimit ka qenë ndërtimi i shtëpisë së re në vendlindje. Lufta dhe pasojat kanë qenë shkak kryesor për emigrimin e 16% të migrantëve nga Lugina. Duke analizuar dhe krahasuar shkaqet e migrimeve me periudhën e migrimeve del që kjo kategori e migrantëve i përket periudhës prej vitit 1991-2000. Kjo është periudha e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, ku zhvillohen disa luftëra të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte kanë për pasojë emigrimin e popullsisë shqiptare, kryesisht të moshës së re. Derisa shkaqet e migrimeve në fillim të kësaj periudhe lidhen me pasojat indirekte prej luftërave dhe konflikteve siç janë përfshirja e të rinjve shqiptarë pa vullnetin e tyre në luftërat në Kroaci e BeH, të cilat shkaktojnë dezertimin dhe emigrimin ilegal të tyre në shtetet e Europës e deri te propagandimi dhe thirrjet e herëpashershme për kryerjen e shërbimit ushtarak dhe për mobilizim. Pasojat e drejtpërdrejta nga lufta hasen gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës, kur të rinjtë shqiptarë, por edhe familje të tëra shqiptare gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake serbe kalojnë ilegalisht kufirin me Maqedoninë dhe pastaj shkojnë në shumë shtete të Europës dhe më gjerë.



Graf. 3. Shkaqet e migrimeve nga Lugina e Preshevës

Nga rezultatet e anketimit del që 22% e migrantëve nga Lugina kanë migruar për shkaqe të bashkimit familjar. Kjo kategori e të anketuarve në aspektin e moshës përfshinë kryesisht migrantë të brezit të mesëm të cilët kanë migruar për t'u bashkuar me prindërit (babai ka tërhequr gruan dhe fëmijët), ndërsa kohën e fundit bashkimi familjar më së shumti bëhet përmes martesave ndërmjet të rinjve që jetojnë në botën e jashtme dhe atyre që jetojnë në vendlindje. Ky migrim selektiv sjell dëme kryesisht në kontingjentet e reja të popullsisë të cilat mbajnë barrën kryesore të riprodhimin biologjik të popullsisë. Vetëm 1% e migrantëve si shkak për migrimin e tyre kanë deklaruar shkollimin. Sa i përket moshës këta migrantë janë të brezit të mesëm dhe të ri.

Niveli i shkollimit është një ndër faktorët kryesorë që përcakton mobilitetin social dhe hapësinor të popullsisë. Sipas rregullit, popullsia me nivel të ulët të arsimimit është më shumë e lidhur për shtëpi, suaza të familjare dhe bashkësi lokale, andaj kjo paraqitet si pengesë në transformimin më të shpejtë social të tyre. Përveç mobilitetit social edhe mobiliteti hapësinor i popullsisë kushtëzohet nga niveli i shkollimit të popullsisë. Në shoqëritë e zhvilluara industriale të Europës dhe më gjerë niveli i lartë i shkollimit rritë nivelin e migrimeve të popullsisë, meqenëse popullsia e arsimuar, me mirëqenie më të mirë ekonomike është më mobile në aspektin hapësinor. Kjo është evidente sidomos në dekadat e fundit, ku zhvillimi dhe përsosja e komunikacionit tokësor dhe ajror e ka bërë popullsinë e këtyre vendeve mjaft mobile. Në vendet dhe shoqëritë në zhvillim është një situatë tjetër, ku migrimet e jashtme si formë e lëvizjes hapësinore dallojnë për nga shkaqet, drejtimet, niveli arsimor

dhe mirëqenia ekonomike prej atyre që zhvillohen në vendet dhe shoqëritë e industrializuara.

Lugina e Preshevës si hapësirë e lënë pas dore në pikëpamje ekonomike, me dominim të bujqësisë ekstensive në strukturën e aktivitetit ekonomik, me nivel të ulët të përgatitjes shkollore është hapësirë tradicionalisht emigruese. Në migrimet e jashtme janë përfshirë popullsia me nivel të ulët të përgatitjes shkollore, e cila si fuqi punëtore e pakualifikuar ka migruar në botën e jashtme duke bërë punë të rënda fizike me qëllim të sigurimit të ekzistencës së familjes. Nga përpunimi i të dhënave të anketimit vërehet se 3% e migrantëve nuk e kanë përfunduar as shkollën fillore

Rezultatet e anketimit tregojnë se pjesa më e madhe e migrantëve kanë të mbaruar vetëm shkollimin fillor (40%) dhe atë të mesëm (44%). Vetëm 8% e tyre kanë të mbaruar shkollimin e lartë dhe 5% kanë nivel superior të shkollimit. Në këtë kategori bëjnë pjesë migrantët të cilët pasi kanë përfunduar shkollimin nuk kanë arritur të gjejnë punë e disa prej tyre janë të përjashtuar nga puna për shkaqe politike në periudhën e diferencimeve ideopolitike në fund të viteve '80 dhe fillimit të viteve '90 të shekullit të kaluar.

Siç pamë më lartë, përqindja më e madhe e migrantëve ka emigruar me qëllim të sigurimit dhe përmirësimit të kushteve jetësore. Këtë e kanë bërë në saxe të punësimit të tyre kryesisht në ndërtimtari e cila në atë kohë ka pasur nevojë për fuqi punëtore jo të kualifikuar, pastaj në industrinë e rëndë e kështu me radhë. Në pyetjen mbi punësimin e migrantëve, 91% e tyre janë deklaruar që punojnë, ndërsa 9% e tyre janë deklaruar si të papunë. Kategoria e fundit e të anketuarve përfshinë kryesisht personat e moshuar që janë pensionuar, meqenëse në pyetjen mbi vështirësitë me të cilat ballafaqohen migrantët në botën e jashtme vetëm 4% e tyre thonë se ballafaqohen me mungesë të punësimit.

Struktura e veprimtarive që ushtrojnë migrantët në botën e jashtme është ngushtë e lidhur me nivelin e shkollimit të tyre dhe shkathtësitë e tjera organizative, komunikuese e menaxhuese. Dominimi i migrantëve me shkollim fillor dhe të mesëm për të cilët u fol më lart lë të kuptohet se pjesa dërmuese e migrantëve është e angazhuar në veprimtaritë që absorbojnë fuqi punëtore të pakualifikuar dhe me kualifikim të mesëm.

Nga përpunimi i të dhënave të anketimit, në pyetjen mbi veprimtarinë që ushtrojnë migrantët 38% e tyre deklarohen që punojnë në industri, 34% në ndërtimtari, 6% në trafik, 5% në hoteleri, 4% në

tregti, 2% në shëndetësi, 1% ndjekin studimet universitare dhe 1% ushtrojnë profesione të tjera.

Derisa në vitet e para të migrimit pjesa dërmuese e migrantëve ka qenë e punësuar në ndërtimtari, me kalimin e kohës rritet edhe numri i atyre që fillojnë të punojnë në industri. Pjesëmarrja e lartë e të punësuarve në industri është rezultat i kualifikimeve dhe rikualifikimeve të rinjve përmes kryerjes së shkollave profesionale, që paraqesin forma të përsosjes profesionale, duke ndjekur mësimet teorike të kombinuara me punë praktike. Por duhet përmendur faktin që me përjashtime të rralla numri më i madh i të punësuarve është në ato degë të industrisë që nuk kërkojnë përgatitje të lartë profesionale. Të ardhurat që i fitojnë migrantët nga puna që bëjnë u mundësojnë që përveç mirëqenies së mirë sociale dhe ekonomike në vendin emigrues të arrijnë të përmirësojnë edhe kushtet e përgjithshme të jetesës në vendlindje si për vete, ashtu edhe për anëtarët e familjes përmes dërgimit të remitancave.

Nga të dhënat e anketimit del që 51% e migrantëve kanë të ardhura mujore mbi 3.000 euro, 22% fitojnë mesatarisht mbi 2.000 euro, 26% kanë të ardhura mesatare mujore prej 1.000 deri 2.000 euro dhe 1% kanë të ardhura mujore më pak se 1.000 euro. Lartësia e të ardhurave që marrin migrantët varet nga vendi i emigrimit të tyre. Përqindja e lartë e migrantëve që kanë të ardhura mesatare mbi 3.000 euro është për shkak se pjesa dërmuese (mbi 60%) e popullsisë kanë emigruar në Zvicër, ku çmimi i punës është më i lartë se në shumicën e vendeve evropiane.

Papunësia, kushtet e rënda jetësore, vështirësitë për të siguruar mbijetesën dhe plotësimin e nevojave elementare në një shoqëri tradicionale dhe autarkike agrare, me ekonomi familjare shumanëtarëshe, siç u vë në pah edhe më lart, ishin shkaktarët kryesorë të migrimëve. Pjesa dërmuese e migrantëve para emigrimit kanë qenë të angazhuar në bujqësi (49% e tyre). Pjesëmarrja e lartë e bujqësisë në veprimtari ekonomike dhe bujqësia ekstensive ishin dhe mbetën forma dominante e aktivitetit njerëzor në Luginë. Mungesa e investimeve në industri dhe në sektorët e tjerë të veprimtarive si një synim i qëllimshëm i politikës së Serbisë vazhdon ta karakterizojë hapësirën e Luginës.

Dominimi i bujqësisë në mesin e veprimtarive që kanë ushtruar migrantët para emigrimit është në korrelacion të ngushtë me nivelin e shkollimit të tyre, që, siç u pa te përgatitja shkollore e migrantëve, 40% e tyre kanë të mbaruar vetëm shkollimin fillor, ndërsa 44%

shkollimin e mesëm. Në industri kanë qenë të angazhuar vetëm 6% e migrantëve. Këta migrantë kanë qenë të punësuar në ato pak ndërmarrje industriale të cilat për shkak të përkeqësimit të situatës së përgjithshme politike dhe ekonomike ose mbyllen, ose i zvogëlojnë maksimalisht kapacitetet e veta prodhuese. 8% e migrantëve të anketuar, para emigrimit kanë ushtruar zeje të ndryshme, ndërsa 7% të tjerë janë marrë me tregti. Nga përpunimi i të dhënave të anketimit vërehet pjesëmarrja e konsiderueshme e atyre që para migrimit kanë ndjekur shkollimin nga ai fillor deri në atë universitar. Kjo kategori përfshinë kryesisht migrantët pas viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, kur përkeqësimi dhe destabilizimi i situatës politike dhe ekonomike drejtpërsëdrejti prekë të gjitha nivelet e arsimit. Vështirësitë për gjetjen e punës pas përfundimit të studimeve në një mjedis të pazhvilluar dhe gjithnjë e më jostabil dhe të pasigurt i detyrojnë plot studentë të ndërpresin studimet dhe të emigrojnë jashtë. Madje shkaqet e migrimit të disave prej tyre janë edhe të natyrës ideologjike dhe politike, meqenëse kanë qenë të përfshirë në iniciativat dhe organizimet që bëheshin në vitet e 80-ta dhe 90-ta për të shprehur revoltën mbi gjendjen e vështirë të popullit shqiptar në Kosovë dhe trojet e tjera etnike shqiptar në ish-Jugosllavi. Përqindja e lartë e kësaj kategorie të migrantëve vjen për shkak të intensifikimit të dukurisë së bashkimit familjar, ku prindërit që ndodhen në botën e jashtme fillojnë të tërheqin familjet e veta. Pjesë dërmuese e migrantëve të punës që shkojnë për t'u bashkuar me prindërit e tyre detyrohen që të ndërpresin shkollimin fillor dhe të mesëm.

Një numër i vogël i migrantëve, 6% e tyre para emigrimit kanë qenë të punësuar në arsim. Zvogëlimi i pagave dhe normat e larta të inflacionit të cilat zhvlerësojnë valutën e dinarit e përkeqësojnë tej mase mirëqenien ekonomike dhe sociale të punëtorëve të arsimit. Disa prej tyre që nuk kanë pasur burime tjera të të ardhurave dhe ndihmave nuk arrijnë që me pagën e tyre të plotësojnë kushtet minimale jetësore për familjet e tyre, prandaj detyrohen të migrojnë jashtë vendit. Pjesa dërmuese e anëtarëve të familjeve të migrantëve, 59% e tyre janë të angazhuar në punë. Prej tyre në industri janë të punësuar 44,1%, në tregti 22%, në ndërtimtari 8,5%, në hoteleri 8,5%, në komunal 6,8%, në shëndetësi 2,4% dhe të tjera 1%. Anëtarët e familjeve të migrantëve, janë në të shumtën e rasteve fëmijët e tyre, të cilët me të shkuar i janë nënshtruar procesit të kualifikimeve dhe rikualifikimeve profesionale, andaj numri më i madh i tyre punon në industri dhe tregti, ndërsa më pak në ndërtimtari, që ishte veprimtaria kryesore me

të cilën janë marrë migrantët e periudhave të para të migrimit. Përveç punësimit, një numër i madh i anëtarëve të familjeve të migrantëve (fëmijët e tyre) ndjekin edhe shkollimin, 30% e tyre, ndërsa 11% e fëmijëve të migrantëve, për shkak të moshës së vogël, nuk ndjekin ende shkollimin.

Dallimet evidente në kuadër të kompleksit të normave sociale në mes vendlindjes dhe vendit imigrues sjellin probleme dhe vështirësi të mëdha në procesin e adaptimit në mjedisin e ri shoqëror. Mosnjohja e gjuhës dhe shkathtësive të tjera komunikuese, dallimet kulturore, fetare etj. paraqiten si pengesë serioze në adaptimin dhe integrimin më të shpejtë të migrantëve në rrethin e ri shoqëror. Me këto vështirësi janë ballafaquar sidomos migrantët e periudhave të para të migrimit, por që kjo dukuri vazhdon të jetë e pranishme edhe në ditët e sotme.

Në pyetjen mbi kohën e nevojshme për adaptim në vendin emigrues, 48% e migrantëve thonë se për t'u adaptuar iu është dashur të kalojnë 2 deri 4 vjet, 33% e tyre janë adaptuar vetëm pasi kanë bërë 2 vjet në vendin emigrues, ndërsa 19% e migrantëve u është dashur 4 e më tepër vjet për t'u adaptuar në vendin imigrues. Tempoja e adaptimit është e kushtëzuar nga mosha e migrantëve, andaj migrantët të cilëve iu është dashur një kohë më e gjatë për t'u adaptuar janë kryesisht migrantët e vjetër në moshë.

Në pyetjen mbi integrimin ose jo të tyre në mjedisin e ri shoqëror, 52% e migrantëve thonë se janë integruar plotësisht, ndërsa 48% e tyre thonë se nuk janë integruar ende. Pjesëmarrja e lartë e migrantëve që janë integruar është për shkak të faktit se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve i takojnë brezit të mesëm dhe të ri të migrantëve të cilët më shpejt kanë pranuar modelet dhe normat e reja kulturore e sociale të vendeve imigruese. Shumë prej migrantëve të brezit të mesëm dhe të ri kanë emigruar në fëmijërinë e hershme, ndërsa plot prej tyre kanë lindur atje, andaj ata janë rritur dhe edukuar në frymën e mentalitetit shoqëror të vendit imigrues. Kjo shpeshherë ka për pasojë edhe paraqitjen e dualiteteve dhe kundërshtive në interpretimin dhe mënyrën e perceptimit të problemeve dhe normave kulturore e sociale ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre. Pavarësimi i hershëm ekonomik nga prindërit, nevoja për një jetë të ndarë dhe individuale, udhëtimet e shpeshta, shkurorëzimet, shtyrja e moshës së martesës janë disa segmente të jetës sociale që bien ndesh me normat tradicionale të cilat ende mundohen t'i praktikojnë prindërit e tyre në vendin imigrues.

Nga numri i përgjithshëm i migrantëve që janë deklaruar se kanë vështirësi për t'u integruar, 77,1% e tyre si shkak të mosintegritimit e

kanë deklaruar kulturën, 14,1% e migrantëve mësimin e gjuhës, 4,3% shkollimin e fëmijëve, 2,1% mënyrën e ushqimit dhe 2% përballen me vështirësi të tjera në procesin e integritimit në rrethin e ri shoqëror. Gjetja e shpejtë e vendit të punës, pagat e larta, kushtet e mira të banimit dhe mbrojtja e mirë shëndetësore e sociale, mirëqenia ekonomike etj. bëjnë që shumica e migrantëve të mos ballafaqohen me vështirësi në jetën e përditshme, andaj 74% e tyre deklarohen se nuk ballafaqohen me asnjë vështirësi në jetën e përditshme. Një numër i caktuar i migrantëve, 12% e tyre ballafaqohen me probleme shëndetësore. Puna e rëndë fizike, oraret e gjata të punës, madje edhe mbajtja e dy vendeve të punës, lëndimet në punë etj. janë shkaktarë kryesorë për paraqitjen e problemeve shëndetësore, veçanërisht te migrantët e brezit të vjetër, të cilët kanë edhe më shumë vite përvojë pune.

Problemet shëndetësore të migrantëve në plot raste sjellin edhe deri te vështirësitë për realizimin e të drejtave sociale, siç janë pensionimi i parakohshëm, përgjysmimi i orarit të punës, nevoja për pagë (pension) të mjaftueshme për të plotësuar nevojat dhe kërkesat në mjediset me mirëqenie të lartë sociale e shëndetësore, pastaj sigurimet fizike, shëndetësore, pronësore etj. Me këto probleme sociale dhe plot të tjera që nuk u zunë në gojë, thonë se ballafaqohen 6% e migrantëve. Lidhjet e shpeshta me familjen dhe vendlindjen ngadalësojnë procesin e asimilimit të migrantëve, ndërsa kanë efekt pozitiv ekonomik për vendin emigrues. Vajtje-ardhjet më të shpeshta të migrantëve, komunikimi dhe kontaktet me anëtarët e tjerë të familjes dhe rrethit më të gjerë shoqëror kontribuojnë në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, normave kulturore, ndjenjave farefisnore e kombëtare të cilat gjithnjë e më tepër po bëhen të cenueshme në vendet imigruese. Në pyetjen se sa shpesh e vizitojnë vendlindjen, të gjithë të anketuarit deklarojnë se e vizitojnë rregullisht atë, ndërsa në pyetjen se sa herë e vizitojnë vendlindjen, pjesa më e madhe, 57% e tyre thonë se brenda vitit e vizitojnë vendlindjen 2 deri 3 herë, 13% e migrantëve e vizitojnë mesatarisht një herë vendlindjen, 24% e tyre 3 deri 4 herë dhe 6% më shumë se 4 herë.

Vizitat realizohen kryesisht gjatë periudhave kohore korrik-gusht gjatë verës dhe dhjetor-janar gjatë dimrit kur migrantët i shfrytëzojnë pushimet e tyre vjetore. Vizitat ndërmjet këtyre periudhave janë më të rralla dhe bëhen kryesisht për festa fetare, pastaj vizita të të sëmurëve ose me rastin e vdekjeve të anëtarëve të familjes në vendlindje. Përmirësimi i kushteve dhe kostoja më e lirë e transportit, pastaj situata më stabile politike në rajon kanë bërë që në vitet e fundit migrantët të vizitojnë më shpesh vendlindjen.

Derisa në dekadat e para të migrimit mbajtja e kontakteve me vendlindjen realizohej kryesisht përmes postës (dërgimit të letrave) dhe telefonisë fikse, sot zhvillimi i teknologjisë informative ka sjellë risi dhe diversitet të mënyrave të komunikimit. Programet dhe rrjetet e ndryshme sociale në internet si *skype, viber, facebook, twitter, messenger, tango, instagram* etj. mundësojnë komunikimin audiovizuel mes njerëzve. Kjo formë e komunikimit është mjaft prezente edhe tek migrantët e Luginës së Preshevës, prandaj 45% e migrantëve janë deklaruar se e shfrytëzojnë internetin për të mbajtur kontaktet me vendlindjen.

Shumica e rrjeteve sociale që shërbejnë për komunikim, sot mund të shfrytëzohen nga aparatet telefonike moderne të njohur si “telefona të mençur” (ang. *smartphone*), të cilët janë bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë së shumicës së njerëzve. Telefoninë, më pak fikse, e gjithnjë e më shumë mobile, për të mbajtur kontaktet e përdorin 51% e migrantëve të Luginës.

Të gjithë të anketuarit janë deklaruar se posedojnë pasuri të patundshme në vendlindje. Mirëpo të dhënat e përpunuara mbi gjendjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të pasurisë në vendlindje nxjerrin në shesh efektet negative të shkaktuara nga migrimi i popullsisë në botën e jashtme.

Në fund të viteve të 80-ta dhe në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar fillon të masivizohet dukuria e bashkimit familjar, me ç’rast prindërit (etërit) që kanë migruar më herët fillojnë t’i marrin familjet e tyre për shkaqet të cilat u përmendën më lartë. Kjo sjell mbylljen e shumë shtëpive dhe rritjen e sipërfaqeve të tokave të papunuara (ugari social). Dukuria e pronave të pashfrytëzuara konstatohet edhe nga rezultatet e dala prej anketimit, me ç’rast 38,4% e migrantëve thonë se prona e tyre ka mbetur e pashfrytëzuar. Në çdo vendbanim shqiptar të Luginës ka disa dhjetëra shtëpi të migrantëve që janë të mbyllura dhe hapen vetëm gjatë vizitave të cilat këta të fundit ia bëjnë vendlindjes, kryesisht gjatë pushimeve verore dhe dimërore.

Një pjesë e konsiderueshme e migrantëve (57,5% e tyre) kanë anëtarë të familjes së ngushtë, qoftë vëllanë, nipin a kushërinin të cilët shfrytëzojnë pronën bujqësore, ndërsa pastrojnë dhe mirëmbajnë shtëpitë e banimit. Pasurinë e patundshme të migrantëve e shfrytëzojnë 4,1% e bashkëfshatarëve, kryesisht përmes shfrytëzimit të pronave bujqësore.

Remitancat që i sjellin migrantët nga bota e jashtme kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten një burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonominë e prapambetur të Luginës. Në pamundësi të realizimit të

suksesshëm të pjesës së hulumtimit mbi vlerën mesatare të mjeteve financiare të cilat migrantët brenda vitit i sjellin në vendlindje, kemi vënë theksin për të parë destinimin e të hollave që sjellin migrantët dhe mënyrën se si shfrytëzohen ato nga familjarët në vendlindje. Pjesa dërmuese e migrantëve i ndihmojnë anëtarët e familjes në vendlindje. Prej tyre 47% i ndihmojnë rregullisht, 48% i ndihmojnë në rast nevojë, ndërsa 5% nuk i ndihmojnë familjet e tyre në vendlindje.

Më se gjysma e migrantëve, 58% e tyre, thonë se ndihmat financiare që u dërgojnë familjarëve shfrytëzohen për plotësimin e nevojave elementare jetësore. Edhe sot e gjithë ditën shumë familje të Luginës arrijnë të mbijetojnë dhe të sigurojnë kushtet elementare për jetesë vetëm falë këtyre ndihmave. Të hollat që i sjellin migrantët shfrytëzohen edhe për shpenzimet shëndetësore, zakonisht për të sëmurët, shërimi i të cilëve kërkon trajtim të posaçëm mjekësor dhe bëhet në qendrat e mëdha si Prishtina, Tirana, Shkupi e Beogradi. Për këtë qëllim ndihmat i dërgojnë gjithsej 12% e migrantëve. Për martesë e funerale shpenzohen 8% e dërgesave, për ndërtimin e shtëpisë 9% e të hollave, për shkollim 9%, për investime në amvisëri 2% dhe investime në bujqësi 2%. Përveç ndihmave që sjellin, një pjesë e migrantëve kanë investuar kapitalin e tyre në vendlindje për hapjen e biznesit, pastaj në ndërtimtari, infrastrukturë ose duke dhënë kontribute të ndryshme kombëtare. Nga të anketuarit gjatë hulumtimit u pa se 62% e tyre kanë investuar në vendlindje, ndërsa 38% nuk e kanë bërë këtë.

Mënyra më e shpeshtë e investimit të kapitalit është dhënia e kontributeve të ndryshme kombëtare, të cilat si në Kosovë, ashtu edhe në trojet e tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm për sensibilizimin e pozitës së rëndë të shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe për përballimin e kushteve ekstreme të varfërisë. Migrantët janë anëtarësuar nëpër shoqatat dhe fondet e ndryshme të themeluara nëpër shumë vende të Europës, duke ndarë një shumë të caktuar nga të ardhurat mujore për të ndihmuar popullsinë shqiptare në vendlindje. Këto ndihma në të shumtën e rasteve janë destinuar për ndihmë familjeve me varfëri të skajshme, për ndërtimin e shtëpive dhe realizimin e projekteve infrastrukturore, ndërsa me shpërthimin e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës, nga migrantët fillojnë të mbledhen shuma të mëdha të të hollave të cilat dërgohen për të ndihmuar në forma të ndryshme luftën në Kosovë dhe në Luginë. Për këtë qëllim e kanë investuar kapitalin e tyre 71,1% të migrantëve. Për dallim prej pjesës dërmuese të migrantëve që kanë investuar kapitalin përmes formave të

ndryshme të mbështetjes së çështjes kombëtare, numri i migrantëve të cilët kanë investuar kapitalin në hapjen e ndonjë biznesi është shumë më i vogël, vetëm 12,8% e tyre, ndërsa në ndërtimtari kanë investuar 16,1% e migrantëve.

Nga vështrimi mbi format e investimit të kapitalit në vendlindje mund të vërehet se deri tani potenciali ekonomik i emigracionit të Luginës nuk ka arritur as për së afërmi të valorizohet. Kontributet e ndryshme kombëtare si forma më e shpeshtë e investimit të kapitalit kanë pasur për qëllim të ndihmojnë përballimin e gjendjes së vështirë ekonomike, por nuk kanë arritur të krijojnë vende pune dhe të gjenerojnë zhvillim ekonomik.

Në mesin e migrantëve që ndodhen në botën e jashtme sot ka pronarë të ndërmarrjeve ndërtimore dhe bizneseve të vogla të cilët dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre, por mungesa e stabilitetit politik dhe ekonomik, korrupsioni, burokracia e skajshme në administratë dhe barrierat e tjera që paraqiten për hapjen e ndonjë biznesi ose minireparti industrial e kanë shndërruar rajonin në një mjedis jo të volitshëm për investime. Për një situatë të tillë fajin duhet kërkuar edhe te organet e pushteteve lokale në Preshevë dhe Bujanoc, të cilët përveç afisheve me të cilat u urojnë mirëseardhje bashkatdhetarëve nuk ndërmarrin asnjë iniciativë, së paku për t'i takuar migrantët dhe për t'u ofruar informacione elementare mbi mundësitë dhe përparësitë e investimit të kapitalit të tyre në vendlindje.

Përkundër të gjitha vështirësive që u përmendën, prapëseprapë në mesin e shumicës së migrantëve ekziston vullneti dhe dëshira për të investuar në të ardhmen në vendlindje. Kështu janë deklaruar 82% e migrantëve, ndërsa 18% e tyre thonë se nuk planifikojnë në të ardhmen të investojnë në vendlindje. Koha e gjatë e kaluar jashtë familjes, adaptimi dhe integrimi në mjediset sociokulturore ku jetojnë bëjnë që dalëngadalë te një numër i caktuar i migrantëve të venitet ndjenja dhe dëshira për t'u kthyer në vendlindje. Se nuk planifikojnë të kthehen në të ardhmen janë deklaruar 37% e të anketuarve, ndërsa 63% e tyre mendojnë që në të ardhmen do të kthehen në vendlindje. Duke analizuar moshën e të anketuarve në rastin e pyetjes mbi kthimin ose jo në vendlindje të migrantëve, vërehet se ata që deklarohen se nuk do të kthehen janë migrantë që i takojnë brezit të mesëm dhe të ri. Në anën tjetër, shumica e migrantëve të cilët mendojnë se do të kthehen në vendlindje, këtë e arsyetojnë me lidhshmërinë emotive për vendlindjen dhe familjen.

Përfundim

Efektet që kanë pasur dhe që do të ketë ky migrimet për zhvillimin e jetës shoqërore dhe familjare janë të shumëfishta dhe për nga karakteri të drejtpërdrejta apo indirekte, të pandërprera apo të kohëpaskohshme, afatshkurta apo afatgjata, pozitive apo negative. Efektet pozitive janë vërejtur kryesisht përmes përmirësimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale të popullsisë në Luginën e Preshevës e cila ka pasur ndonjë anëtar të familjes me punë të përkohshme në botën e jashtme. Të ardhurat e fituara në botën e jashtme i kanë investuar për ndërtimin e shtëpive, blerjen e pronave tokësore, aparateve për amvisëri dhe bujqësi dhe kjo ka bërë që këto familje të kenë një standard më të lartë jetësor dhe prestigj në shoqëri. Përmes aksioneve të koordinuara të bashkatdhetarëve dhe bashkësive lokale të fshatrave, në Luginën e Preshevës janë realizuar projekte të ndryshme infrastrukturore, duke përmirësuar kushtet e jetës në fshatrat e Luginës së Preshevës. Në situatën e rëndë ekonomike dhe sociale që ka mbretëruar në Serbi dhe në Luginën e Preshevës pas viteve të 90-ta, të ardhurat nga popullsia e punësuar në botën e jashtme kanë qenë një burim i rëndësishëm për mbijetesën e shumë familjeve në Luginën e Preshevës. Kjo mërgatë e fuqishme në Evropë e ka mbështetur gjithashtu financiarisht luftën e Kosovës dhe atë të Luginës së Preshevës, si dhe shumë familje të dëshmorëve të luftës dhe të pastrehëve.

Efektet negative gjithashtu kanë qenë dhe janë të llojllojshme. Me gjithë dendësinë e madhe agrare dhe urinë për tokë punuese, vërehet dukuria e “ugarit social”, e mospunimit të sipërfaqeve të punëshme dhe e krijimit të aspiratave se në fshat dhe në bujqësi nuk ka perspektivë dhe se këto duhet braktisur sa më parë. Andaj ekziston një bindje e fuqishme në mesin e popullsisë së re që emigrimi në botën e jashtme është çelës i vetëm për përmirësimin e mirëqenës ekonomike dhe sociale, çka i bënë ata të jenë shumë inferiorë dhe të mos shfaqin interesim për shkollim dhe punësim, bile edhe për krijimin e familjeve në vendin e lindjes.

Integrimi i fuqishëm i gjeneratave të reja të emigrantëve në vende të ndryshme të Evropës bën që tek ata dalëngadalë të venitet ndjenja e origjinës, si dhe të shfaqen shenjat e para të asimilimit. Shumë fëmijë të lindur atje me vështirësi flasin gjuhën shqipe, ndërsa duke përqafuar stilin e jetës të shoqërive të industrializuara evropiane ata më me dëshirë zgjedhin që pushimet e tyre t'i kalojnë në pushimoret mondene të Evropës Mesdhetare, Azisë e Amerikës Jugore se sa t'i kalojnë ato në vendlindjen e tyre. Kjo i kontribuon

edhe më tepër ndarjes fizike dhe shpirtërore me vendlindjen dhe rritë rrezikun nga asimilimi më i shpejtë.

Aplikimi i konceptionit të popullsisë së pranishme që nga regjistrimi i vitit 2002 bën që popullsia e punësuar në botën e jashtme të mos përfshihet në regjistrim. Sipas të dhënave nga komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për vitin 2002, rreth 21% e popullsisë ishte në punë të përkohshme në botën e jashtme ku pjesën dërmuese të tyre e përbëjnë shqiptarët. Nga kjo kuptojmë që të dhënat zyrtare të regjistrimit të vitit 2002 janë të mangëta përreth 24.000 shqiptarë, e kjo rezulton me një kompozicion të ri dhe artificial etniko-demografik dhe një rrudhje të etnikumit shqiptarë në rajon. E gjithë kjo ka pasur reperkusionet e veta në rrafshin politik, ekonomik e social, sepse përmes këtij transformimi “kozmetik” të strukturës etnike është tentuar deri-diku me sukses të relativizohen dhe marginalizohen kërkesat e shqiptarëve për realizimin e të drejtave të tyre qytetare dhe kombëtare në kuadër të një rajoni të posaçëm.

Shemsi Krasniqi, Prishtinë

KUJTESA DHE RRËFIMET PËR EKSODIN E VITIT 1999

Hyrje

Eksodi i vitit 1999, kur një milion shqiptarë të Kosovës u dëbuan dhunshëm nga vendi¹ për shkak të luftës gjenocidale dhe politikës fashiste të Millosheviqit, pa dyshim se është ngjarja më dramatike në historinë e re të Kosovës dhe ndër ngjarjet më të bujshme botërore të fundit të shekullit njëzet. Eksodi masiv i kosovarëve që krahasuar me eksodin e njohur biblik si për nga përmasat, ashtu edhe për nga vuajtjet e shkaktuara. Por në anën tjetër, edhe kthimi i shpejtë dhe masiv i tyre pati habitur mbarë opinionin botëror dhe që konsideruar si shembull unik i kthimit vullnetar të refugjatëve në atdhe.² Masakrat mbi civilët dhe pastrimi etnik i shkaktuar nga policia dhe ushtria serbe bënë që Aleanca Veriatlantike (NATO) të ndërhyjë ushtarakisht kundër caqeve serbe me fushatën ajrore të bombardimeve 78 ditë.

Kjo kumtesë paraqet një pasqyrë të kujtesës dhe rrëfimeve mbi përvojat dhe përjetimet njerëzore gjatë eksodit kosovar të vitit 1999, të mbledhura në kuadër të hulumtimit "*Kujtesa përballë harresës*" dhe i realizuar në kuadër të lëndës Praktikumi sociologjik. Rrëfimet kanë të bëjnë me kujtimin e atyre ditëve të vështira dhe iu referohen gjendjeve, situatave, ngjarjeve, përvojave dhe përjetimeve personale dhe familjare të gjithë atyre që kanë qenë të detyruar ta lëshojnë shtëpinë, të lëshojnë vendin dhe të bëhen refugjatë. Intervistat janë bërë me persona që e kanë përjetuar vetë këtë ngjarje, domethënë janë

¹ Astri Suhrke, Michael Barutciski, Peta Sandison, Rick Garlock, *The Kosovo refugee crisis An independent evaluation of UNHCR's emergency preparedness and response*, UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR REFUGEES EVALUATION AND POLICY ANALYSIS UNIT, February 2000, <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/search?page=search&docid=3ba0bb4&query=Kosovo>

² <http://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/etc/facts.html>

dëbuar dhunshëm nga shtëpia, janë detyruar të zhvendosen diku tjetër ose ta lëshojnë Kosovën.

Deri më tash hulumtimi është bërë dy here: herën e parë në vitin 2009 me rastin e dhjetëvjetorit të eksodit, kurse herën e dytë në vitin 2014 me rastin e pesëmbëdhjetëvjetorit. Mbledhjen e të dhënave në terren e kanë bërë studentët e Departamentit të Sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Metoda e punës ka qenë intervista e thellë dhe diskutimi në fokus-grup, e në disa raste është përdorur edhe metoda e videografisë, përmesë të cilës janë mbledhë dhe analizuar pamje, fotografi, videomateriale, dokumentarë, madje edhe sende personale që i përmendin respondentët dhe që kanë kuptim në jetën e tyre. Me qëllim të njohjes më të mirë të kujtesës, kemi vizituar edhe disa monumente të pasluftës dhe kemi marrë pjesë në disa manifestime përkujtimore të cilat i kushtohen kësaj ngjarjeje.³

Qëllimi i hulumtimit ka qenë mbledhja e rrëfimeve dhe arkivimi i kujtesës për dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve të Kosovës nga trojet e tyre, si dhe krahasimi i rrëfimeve të mbledhura në intervalin kohor pesëvjeçar për të parë trendin e harresës dhe kujtesës lidhur me atë periudhë. Po ashtu për këtë qëllim janë mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi përvojat personale dhe familjare të kohës para daljes nga shtëpia, të momentit të daljes dhe ecjes në kolonë, të jetës si refugjat, pastaj të kthimit në shtëpi, si dhe të rifillimit të jetës së re në periudhën e pasluftës. Domethënë një pjesë e të dhënave kanë të bëjnë edhe me vlerësimin e realitetit kosovar të periudhës së pasluftës, me sfidat dhe vështirësitë me të cilat janë ballafaquar, me pritjet, por edhe zhgënjimet e një pjese të popullatës e cila nuk ka arritur të sigurojë mirëqenien as në kohën e lirisë dhe të shtetndërtimit.

Ajo që e karakterizon këtë hulumtim është fakti se merret veçanërisht me kujtesën dhe rrëfimin e përvojave dhe përjetimeve

³ Në fshatin Xërxë të Gjakovës dhe në Kukës të Shqipërisë pas luftës janë ndërtuar dy monumente që quhen ‘Kulla e Mikëpritjes’ dhe janë bërë në shenjë të përkujtimit të mikëpritjes dhe strehimit të personave që kishin qenë të detyruar për të braktisur shtëpitë e veta, e pastaj edhe vendin. Lidhur me këtë, Shoqata “Eksodi 1999” nga Mitrovica thuaja se çdo vjet ka organizuar marshe në relacionin Mitrovicë – Xërxë – Kukës, me qëllim të përkujtimit të eksodit masiv të vitit 1999. Në vitin 2014 këtij aktiviteti i është bashkëngjitur edhe Qeveria e Kosovës, ku disa ministra së bashku me aktivistët e shoqatës dhe qindra qytetarë të tjerë të Kosovës kaluan këmbë pikën kufitare në Vermicë për të vazhduar në Kukës dhe për t’u pritur nga drejtuesit e Bashkisë së Kukësit me grupe të ndryshme muzikore dhe qytetarë të shumtë.

personale, pra vë theksin mbi përvojat në jetën e përditshme të njerëzve të zakonshëm, të gjendur në rrethana të jashtëzakonshme siç ishte lufta; domethënë hulumtimi përqendrohet në disa fenomene mikrosociale, por që janë të lidhura me kontekstin makrosocial dhe historik.

Hulumtimi paraqet rrëfimet mbi përvojat dhe përjetimet individuale dhe familjare gjatë luftës, përfshirë edhe përshkrimin e gjendjes së paraluftës si edhe rrethanat e reja në vitet e pasluftës. Nuk ka të bëjë as me të dhëna statistikore dhe faktografi historike e politike, as me përshkrime ose analiza të zhvillimeve a të situatave të luftës, të rolit e strukturave dhe personaliteteve ushtarake, as me organizatat e pasluftës që merren me evidentimin e viktimave dhe pasojave të luftës.

Veçanti tjetër e këtij hulumtimi është se përveç lidhjes së fortë me vendin, familjen dhe njëri-tjetrin, pra përveç ndjenjave të forta patriotike, familjare dhe solidariste që janë dëshmuar gjatë luftës, ky hulumtim nxjerr në pah edhe lidhjen e njerëzve me sendet ose gjërat simbolike. Hulumtimi dëshmon se lidhja me sendet ose gjërat e shtëpisë, veglat e punës, fotografitë, librat ose bibliotekat familjare, instrumentet muzikore, lodrat e fëmijëve, artefaktet tradicionale apo kujtimet tjera që kanë të bëjnë me të kaluarën e familjes është shumë e fortë dhe shkatërrimi ose humbja e atyre gjërave ose kujtimeve ka shkaktuar dhimbje e cila vazhdon të mbesë akoma në kujtesë.

Hulumtimi përmban rrëfime të shumta për përvoja unike, dramatike dhe tragjike, individuale dhe kolektive. Kujtesa për ato ngjarje është e kthjellët dhe vullneti për t'i evokuar nuk mungon.

Rrethanat para daljes nga shtëpia

Në përshkrimin e situatës që mbretëronte në vendbanimet e tyre para daljes nga shtëpia, respondentët theksojnë kushtet e rënda që dominonin gjatë ditëve të luftës. Ankthi dhe pasiguria e madhe për jetë, ndjenja e rrethimit nga çdo anë dhe paralizimi i jetës, shqetësimet e përditshme që buronin nga frika e vrasjes, dhunimit ose masakrimit i karakterizon rrëfimet e burrave dhe grave që kanë përjetuar eksodin e vitit 1999. Luftimet në afërsi, krismat e vazhdueshme, djegiet e shtëpive, rrahjet, maltretimet dhe vrasjet janë disa nga gjërat të cilat e karakterizojnë përshkrimin e rrethanave të atyre ditëve. Ja se si i kujtojnë ato ditë një qytetar nga Prishtina dhe një tjetër nga Mitrovica:

- “Qyteti ishte i mbushur me militarë serbë. Nuk mund të dilnim nga shtëpia për të blerë gjëra ushqimore që na nevojiteshin. Dëgjonim për vrasjet që ndodhnin krejt afër nesh. Frigohesha se mos ne ishim viktimat e radhës.” (F. Berisha, m., 49 vj., Prishtinë).

- “Para se të lëshonim shtëpinë, në vendbanimin tonë mbretëronte frika dhe paniku. Kundërmonte erë lufte dhe katastrofe. Njerëzit ishin të kufizuar të lëviznin. Ata rraheshin, torturoheshin, e në disa raste edhe vriteshin. Atmosfera ishte e zyrtë.” (L. Behrami, m., 28 vj., Mitrovicë).



Foto 1. Refugjatë shqiptarë të Kosovës që kalojnë kufirin dhe hyjnë në Shqipëri, 1999

Tom Stoddart—Hulton Archive/Getty Images

Burimi: <https://www.britannica.com/event/Kosovo-conflict>

Në ato kushte të pasigurisë dhe rrezikut të lartë, njerëzit provonin të mbledhnin informata dhe të kuptonin më mirë se çka ndodhte dhe në ç’drejtim po shkonin proceset. Radiot dhe TV-të e huaja si: BBC, CNN, DW, RFI, Zëri i Amerikës, Evropa e Lirë⁴, por edhe ato shqiptare si

⁴ Duke qenë se në vitet e 90-ta të shekullit 20 regjimi serb pat mbyllur mediat shqiptare në Kosovë, shqiptarët qenë të detyruar të blejnë antena satelitore për të pasur mundësi të informohen nga mediat e huaja. Pjesa dërmuese e ballkoneve

TVSH dhe Radio Tirana, pastaj Kosova e Lirë, qenë bërë burimet kryesore të informacionit. Veç kësaj, informatat që qarkullonin nga vetë ushtarët e UÇK-së, aktivistët partiakë ose politikë, si edhe informatat që qarkullonin prej njëri-tjetrit konsideroheshin mjaft të rëndësishme. Krahas informatave, gjatë atyre ditëve qarkullonin edhe shumë dezinformata të cilat ose ishin pjesë e luftës speciale për të krijuar panik te popullata ose përhapeshin vetvetiu nga persona të papërgjegjshëm.



Foto 2. Refugjatë kosovarë në Bllacë, 1999

Burimi:

https://www.charterforcompassion.org/images/menus/Peace_non_violence/TSF_Kosovo_1999_1.jpg

Pjesë e përshkrimit të situatës së para daljes nga shtëpia është edhe gjendja e mungesës së ushqimit dhe problemeve të strehimit të zhvendosurve. Gati secila familje, së paku për një kohë të shkurtër ka pasur persona të afërm të strehuar. Nga një llogaritje e përafërt e numrit të të zhvendosurve që respondentët tanë pohojnë se i kanë pasur në shtëpi gjatë kohës së luftës, del se secila familje mesatarisht i ka pasur rreth dhjetë persona të strehuar. Ka raste kur respondentët tregojnë se në shtëpinë e tyre përkohësisht kanë qenë të strehuar deri pesëdhjetë apo

të banesave, por edhe të kulmeve të shtëpive si nëpër qytete, ashtu edhe në fshatra qenë pajisur me antena satelitore.

edhe njëqind persona. Prandaj, krahas shqetësimit për jetën, ka pasur edhe shqetësime lidhur me mungesën e ushqimit, kushtet dhe hapsirën e banimit, pastaj lidhur me kushtet higjienike, sepse kishte mungesë uji, rryme elektrike etj. Në fakt gjithsej 90 për qind e shqiptarëve të Kosovës u arratisën nga shtëpitë e tyre ose u dëbuan.⁵



Foto 3. Kolonë refugjatësh nga Kaçaniku. Foto: Damir Segolj, Reuters, 1999
<https://s-media-cache-ak0.pinimg.com/originals/45/6e/8f/456e8fa6834798bb109d2c3348065ec3.jpg>

Por cila ishte shpresa dhe a kishte fare shpresë gjatë atyre ditëve? Në pyetësin tonë e kemi pasur një pyetje në lidhje me këtë dhe përgjigjet e respondentëve tregojnë se përkundër gjendjes së tmerrshme që dominonte, përkundër rrezikut të madh dhe përkundër faktit se ishin krejtësisht të pambrojtur, njerëzit nuk ishin krejtësisht të pashpresë. Shpresa e tyre kryesore ishte NATO, Amerika, Evropa dhe Bashkësia Ndërkombtare. Ushtria Çlirimtare e Kosovës po ashtu ishte faktor shpresëdhënës për popullatën e pambrojtur. Në anën tjetër, besimi në Zot, besimi se drejtësia do të fitojë, se liria do të vjen dhe e keqja do të merr fund ishte e pranishme në mendjen e të intervistuarve. Ja si shprehen:

⁵ Oliver Jens Schmitt, Kosova. *Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, “Koha”, Prishtinë 2012, f.260-261.

- *“Po shpresat ishin tek forcat e NATO-s, vetëm që filluan bombardimet, por në anën tjetër dihet se në formë hakmarrje forcat serbe filluan të djegin të demolojnë, por edhe të vrasin si shenjë hakmarrje ndaj sulmeve të NATO-s. Shpresat normalisht se ishin te NATO”. (M. Maloku, m., 26 vj., Podujevë.*

- *“Ne shpresonim, u gëzuam që NATO intervenoi në Kosovë, menduam se shpejt do të përfundojë ky sulm dhe serbët do të tërhiqen nga Kosova. Por ndodhi pak më ndryshe, d.m.th. u zgjat shumë dhe filluan shpresat me u zbeh, me humbë. Na mendonim se kryhet për dy-tri ditë bombardimi dhe do të tërhiqen shumë lehtë serbët prej Kosove, mirëpo u pa se ata nuk lëvizshin për qato ditë, d.m.th. e pamë që zgjidhje nuk kish tjetër veç me lëshu shtëpinë dhe me dalë prej vendit.” (I. Gashi, m., 36 vj., Prishtinë).*

- *“Shpresa e vetme ka qenë në Zotin, pastaj në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkësinë Evropiane.” (A. Sheqiri, m., 51 vj., Prishtinë).*

Vetëm dy respondentë në hulumtimin e parë dhe tre të tjerë në të dytin kanë pohuar se kanë qenë krejtësisht të pashpresë. Ja si shprehet njëri prej tyre:

“Derisa ka qenë ajo situatë, kurrfarë shprese nuk kemi pasë! Veç kemi pritë tortura, burgime, aq! Kurrëgjjo tjetër!” (R. Hasani, m., 70 vj., Prishtinë).

Një prej elementeve më të veçanta që e përmendin bashkëbiseduesit tanë kur rrëfejnë për rrethanat në të cilat qenë të detyruar ta braktisin shtëpinë ka qenë ultimatumit i dhënë nga forcat serbe. Shumë familje i kanë braktisur shtëpinë duke parë rrezikun e drejtpërdrejtë nga të shtënat, djegiet dhe granatimet që janë bërë në afërsi, apo edhe për shkak të dëbimit të popullatës, por shumë të tjera kanë dalë për shkak të ultimatumit që kanë marrë nga militarët apo paramilitarët serbë. Siç pohojnë bashkëbiseduesit tanë, ultimatumet kanë qenë zakonisht afatshkurta. Më afatshkurtër kanë qenë vetëm pesë minuta (Podujevë, Lipjan), dhjetë minuta (Podujevë), pesëmbëdhjetë minuta (Prishtinë), e më afatgjatët kanë qenë një ditë (Vushtrri). Afatet tjera ultimative janë matur me orë (një-dy apo tri orë). Ja disa shembuj se si tregojnë bashkëbiseduesit tanë për ultimatumin që e kanë pasur për të braktisur shtëpinë:

- *“Kanë ardhë në shtatë të mëngjesit, kanë cakatë n’derë të shtëpisë edhe kanë thanë: “Zgjonu! Kur të bëhet pesë minuta me dalë prej shtëpisë! Veq fëmijët veshë i kam pasë. Natën i kam lanë veshë. Veq i kom qu prej gjumit, i kam kapë çantën që e kam pas plot rroba edhe jena dalë para shkollës. Te shkolla na kanë thënë: kush ka traktora, kerre, veturë, kerr me kali e çka t’kini hipni edhe nisuni për Shqipëri.” (Xh. Bajrami, f., 55 vj., Lipjan).*

- *“...kanë ardhë forca të shumta të maskuar, që të gjithë të maskuar dhe njëri prej tyre ka shiku. Kemi pas afat vetëm dhjetë minuta që të dalim në rrugë, sepse ai që gjindet brenda në shtëpi do të ekzekutohej!” (S. Zeneli, m., 55 vj., Podujevë).*

- *“Kemi pasur ultimatum prej policisë dhe paramilitarve serbë. Ultimatum që të nesërmen në ora shtatë me u shpërngulë prej fshatit.” (S. Hetemi, m. 65 vj., Vushtrri).*

Ultimatimet kaq të shpejta dhe në shumë raste të shoqëruara me sharje dhe kërcënime për vrasje, nuk mund të jenë bërë për tjetër përveç se për zbrazjen sa më të shpejtë të Kosovës nga banorët e saj shqiptarë, pra për qëllime të realizimit sa më të shpejtë të projektit të pastrimit etnik.

Momentet në kujtesë nga dita e daljes nga shtëpia

Dita e largimit nga shtëpia është dita e cila ka mbetur e pashlyer në kujtesën e respondentëve. Disa prej tyre thonë se ishte e paimagjinueshme se do të vinte dita kur edhe pa i pasur borxh askujt do të detyroheshe ta braktisësh shtëpinë tënde, pronën, vendin dhe të nisesh pa e ditur se ku po shkon, a do të mbijetosh dhe se a do të kthehesh më në shtëpi. Janë shumë prekëse rrëfimet për momentet të cilat i përshkruajnë se si kanë qarë nga dhimbja e braktisjes së shtëpisë, por edhe nga dhimbja e ndarjes me njëri-tjetrin (ka pasur raste kur disa nuk kanë pranuar të dalin nga shtëpia). Fjalët, si: vaj, lot, dhimbje, tmerr, trishtim, janë fjalët të cilat më së shumti i përdorin respondentët për t’i përshkruar ndjenjat dhe përvojat e atyre ditëve. Më poshtë po japim disa rrëfime të shkurta që shprehin momentet të cilat i kanë fiksuar në kujtesë disa prej respondentëve të intervistuar:

- *“Po natyrisht se me kujtohet. Ishte dita më e vështirë në jetën time! Ajo ditë ishte kur të gjitha shpresat ranë në ujë dhe shansa që*

situata të përmisohej ishte zero. Rreth vendimit nuk kemi humbur shumë kohë kur kemi pa se disa shtëpive afër nesh po iu delte tymi nga kulmi. Atëherë nuk mendova shumë edhe për shkak se anetarët tjerë të familjes ishin të pajtimit për mu largu... nuk kemi marr shumë nga sende e shtëpisë. Vetëm ato më kryesore, si: pak rroba, ushqim që na ka mbetur, disa albume të fotografive. Më kujtohet mirë kur nana plakë më tha: “Bir merri fotografitë, merri se të gjitha kujtimet e këti vendi i ki n’to!” Kemi marrë gjithashtu edhe dokumentet ma t’rëndësishme, kurse të gjitha tjera sende i kemi lanë aty për shkak se nuk kemi pasur as kohën e duhur e as vend në automjet. Hmm... nëse diçka s’e kam marrë me vete, e që më dhimsej shumë, atëherë është ajo sharrë dore e që ishte e babait tem dhe e vjetër përmbi 20 vjet. Ndoshta po çuditeni pse bash sharrë dore! Ja po ju përgjigjem: me atë sharrë babai jem ka shku për çdo ditë në Prizren e gjithkund tjetër, vetëm e vetëm që t’na siguroj një copë buke. ... Një kujtim që sot e kësaj dite po më kujtohet ishte biçikleta e fëmijëve, që e pata larguar nga oborri në banjo. Dhe fjalët e fëmijëve... “babi pse p’e qetë bicikllën në banjo?” Iu thash me një zë pak të çuditshem: shiko nëse ata e djegin shtëpinë, ndoshta do të mbetët diçka prej bicikllës, ashtu që kur të kthehemi prap do t’mund ta vozitni. Dhe duke dalë nga oborri i shpisë, e mbylla derën, po ashtu edhe një herë e shikova shtëpinë, lagjen dhe pemët në bashqë që sa po patën filluar të lulëzonin... Ishte një moment i vështirë kur u nisa prej shtëpisë e deri te qyteti sikur se ta kisha një gurë mbrenda meje! Me të vërtetë ishte momenti më i vështirë.” (Q. Bashini, m., 53 vj., Lubizhdë, Prizren).

- “Më kujtohet qeni im që më pat përcjellë deri te treni. Ne hipëm e ai na shikonte i mërzhitur, sikur e kuptonte se çfarë po ndodhte me neve. Ishte hidhëruar me ne që s’mund ta merrnim me vete, e kjo ka qenë një gjë shumë e vështirë për ne!” (H. Avdiu, f., 24 vj., Ferizaj).

- “Momenti i largimit nga shtëpia ka qenë një ndër momentet më të vështira, që edhe sot kur e kujtoj rrënqethem. Asnjëherë nuk e kam menduar ta lë shtëpinë të cilën e kisha ndërtuar me aq mund... Unë nuk e kisha pas ditur vlerën e vërtetë të asaj foleje të bukur. Vetëm atëherë kur nuk shihja më tjetër zgjidhje, vendosa ta lë shtëpinë. Por sinqerisht, së bashku me të kishte mbetur edhe një pjesë e zemrës sime dhe kjo është gjëja që më është dhimbsur më së shumti, sepse vetëm rrobat dhe disa gjëra higjenike kishim me vete... Fatkeqsisht, edhe tani kur jam duke folur më vjen të qajë si dikur kur unë e braktisa shtëpinë. Kam qëndruar shumë kohë në oborr të

shtëpësisë dhe e shikoj sikur të ishte e fundit herë që e shihja. Nuk e kam paramenduar që aq shumë do të më prekte braktisja e shtëpësisë. (F. Mustafa, m., 45 vj., Prishtinë).

- "S'ë kam paramendu që e lëshoj shpinë pa kurrfarë zori, pa i pas kujt borxh...!" (Xh. Avdijaj, m., mbi 61 vj., Malishevë).

- "Përjetova ndjenjën e përshkrimit të natyrës së njeriut sipas Hobsit "Njeriu për njeriun është ujë... E humba ndjenjën e të qenit njeri!" (L. Ahmeti, m., 41-50 vj., Dragash).

"Ka qenë një kohë tepër e vështirë, një kohë që populli mendonte se edhe Zoti ishte kundër neve. Shtrëngatë nga gjitha anët, borë, skllotë, shi, vërshime, mjegull dhe skëterrë!" (Sh. Goçaj, m., mbi 61 vj., Prizren).

- "Me kujtohet lagjia jonë, kur i kemi lëshuar shtëpitë dhe i kam pa njerëzit të gjithë me kokë mbrapa, duke qajtur se po largoheshin nga shtëpitë e tyre!" (R. Berisha, m., 30-40 vj., Pejë).

"Më kujtohet kur dolën babai e nëna, e në fytyrat e tyre lexohej se ishim nisë në një rrugë që askush nuk e dinte fundin e saj!" (F. Velia, m., 30-40 vj., Skënderaj).

- "Po fakti se duhet t'ia kthesh shpinën një jete të tërë, pasurie materiale e shpirtërore, shumë dashuri prapa, shumë punë intelektuale, shumë patriotizëm prapa; asaj që kemi krijuar, si dhe vetë vendit dhe përnjëherë duhet t'ia kthejmë shpinën shtëpësisë, e as vet nuk e di se ku do të shkosh... ka qenë diçka jashtëzakonisht tmerruese, për neve e pashpjeguar! D.m.th. nisemi në qiellin e hapur, pa kurrfarë plani në kokë!" (V. Belegu, f., 51 vj., Prishtinë).

- "... më kujtohet momenti kur e harruam çikën e vëllaut n'djep...! Unë shkova e vajza kish qenë ashtu si e kishim lënë n'djep, s'kishte dëgjuar gjë, ishte e vogël. Atëherë e morra vajzën. Ka qenë trishtuese! U bëm bashkë të gjithë...!" (H. Shterbani, f., 30-40 vj., Rahovec).

- "M'kujtohet kur jemi dalë herën e tretë, u kanë rast shumë i randë! Na i kanë marrë burrat na i kane lidhë, i kanë rreh e më nuk i kena pa t'gjallë sot e asaj dite deri sa i gjetëm kufomat...! I morën 7 burra, vjehrrin, kunetët me axhallarë e të shtatit na i kanë vra!" (F. Gashi, f., 41-50 vj., Klinë).

Momentet në kujtesë nga udhëtimi në kolonë

Siç e thamë në fillim, rreth një milion kosovarë u detyruan t'i braktisin shtëpitë e veta nën tryshninë e djegieve, granatimeve dhe përndjekjeve të popullsisë nga forcat policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe. Si pasojë e kësaj, në pranverën e vitit 1999 kolona të tëra refugjatësh u shfaqën nëpër rrugët e Kosovës. Në shumicën e rasteve kolonat ishin të drejtuara kah Shqipëria dhe Maqedonia, e në disa raste edhe kah Mali i Zi. Njerëzit e të gjitha moshave dhe gjinive ecnin këmbë, me qerre kuajsh, me traktorë, me kamioneta dhe vetura, pa ditur se ku do të përfundojnë. Stacionet e trenit si Prishtina, Fushë-Kosova, Ferizaj prej fundit të marsit deri në fillim të qershorit ishin të stërmbrushur me njerëz. Deri te stacionet e trenit njerëzit po ashtu shkonin në kolonë.



Foto 4. Grupi i qytetarëve të Kosovës të prirë nga përfaqësuesit e Qeverisë kalojnë pikën doganore në Vërmicë dhe shkojnë në Kukës në shenjë përkujtimin të eksodit të vitit 1999, 16 prill 2016

Kur respondentët i përshkruajnë pamjet e kolonës, zakonisht e përmendin gjatësinë e saj, për të cilën thonë se as nuk i shihej fundi, as fillimi. Sa i përket pamjes së njerëzve, ata e përshkruajnë vuajtjen dhe lemerinë e tyre, lodhjen, molisjen, leckosjen, urinë, provokimin,

torturimin dhe nënçmimin e vazhdueshëm nga forcat policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe. Një kësi përshkrimi bën edhe një kronikë e Radio Tiranës e datës 7 prill 1999. “Pika e kalimit të kufinit në Morin të Kukësit ka një pamje dramatike, mijëra njerëz të vumë në rresht janë të detyruem me ecë nën shi ... Mijëra njerëz dëshmojnë se një karvan i gjatë këmbësorësh po vdesin në shi”.⁶

Torturat, kërcënimet, maltretimet dhe provokimet ishin të vazhdueshme nga ana e forcave ushtarake serbe, por ka pasur raste kur provokimet kanë ardhur edhe prej civilëve. Kështu, një qytetar i Prishtinës tregon rastin kur në kolonë, duke ecur nëpër qendër të qytetit, një fqinj serb i cili e kishte njohur, i ka thënë shko në Shqipëri, sepse ti këtu nuk ke vend. Megjithatë, kur është fjala për civilë, ka pasur raste kur kanë vërejtur edhe keqardhjen e tyre. Ja disa rrëfime për përjetimet e ecjes në kolonë, ku dy të parët përshkruajnë reagimin e civilëve serbë - njëri negativ, kurse tjetri pozitiv:

- *“Po prej shpisë kambë kemi shku nëpër kolonë, kemi shku deri në qendër. Në kolonë kemi pa torturime, i kanë gju, i kanë rrahë, i kanë plaçkitë, iu kanë marrë të holla njerëzve. Mu në qendër një prej serbëve që e kam njoftë edhe më përpara më ka thirrë në emër edhe më tha: „Ku po shkon, për Shqipëri a? Hajt se atje e ki venin ti! Nuk ki vend këtu!” (R. Hasani, 70 vj., m., Prishtinë, 2009).*

- *“Derisa po kalonim kah trekëndëshi i kohës së komunizmit, aty te komuna e Prishtinës, domethënë po këputnim aty për të kaluar kah Qafa, kishin dalë disa gra serbe dhe po shiqonin kolonën. Por kolona qarkullonte shumë shumë ngadalë, sepse kishte shumë njerëz. E tash një grua nga kolona po thotë: "shifi ato shkinat atje kah qajnë!" Edhe ne as që i shikuam, domethënë vazhduam, por për një moment një grua serbe erdhi drejt kolonës. Shumë e çuditshme, u shkëput prej tyre, prej ati grupit të grave që ishin te trekëndëshi dhe erdhi me një qese përplot ushqim! Kishte bukë, kishte do gjana, nuk e di çka dhe përqafohej atje me një grua tjetër. I përqafonte do fëmijë, domethënë kishin qenë fqinjë dhe kishte dalë me i pa kur të vijnë ata në rend me u përshendet. E thërriste në emër atë gruan... nuk më kujtohet tash emri i saj. "Po kah po shkoni?!" Nuk e di çka i thoshte ajo, por bërtiste me të madhe. "Ooo ju kenë me shëptu, po çka bojme na këtu!" Shante në mënyrën ma banale shtetin e vet, e shante Serbinë, Millosheviqin, deri*

⁶ Sulejman Dida, *Dëbimi i shqiptarëve prej Kosove në vitin 99. Dëshmi, përjetime, refleksione*, Mirgeeralb, Tiranë, 2014, f.138.

sa e morën ato gratë tjera. Domethënë ka qenë një moment pak i çuditshëm!”. (S. Zeneli, m., 55 vj., Podujevë).

- “Ishte sikur një ëndërr ose një film kur e shikojmë. Shumë njerëz të zbathur, të palarë, të paushqyer, të frikësuar, të hidhëruar! S’di si me përshkru ndryshe, kolonës nuk i shihej as fundi as fillimi. Rrugës mbetshin pleqë, fëmijë, të vrarë, të plagosur, sepse forcat serbe gjuanin nga larg vazhdimisht. Sa njeriu, sa fytyra të lodhura, të trishtuara kam parë unë! Zoti mos më provoftë kurr në jetë me pa aq shumë njerëz të vuajtur, të trishtuar! Në momente të caktuara gjatë kolonës ka pas shumë raste kur jemi ndihmuar nga të tjerët. Por ka pas raste kur forcat serbe kanë gjuajtur në turmën e njerëzve në kolonë dhe në ato momente edhe nëna e ka lëshu fëmijën nga dora dhe ka ikë. Mua në veçanti më ka ndihmuar një ushtar i UÇK-së në një grykë. I kisha dy vajzat e vogla dhe gjatë sulmeve që na bënin ushtria serbe nga larg, burri me vajzën e madhe shkuan përpara, unë mbeta mbrapa, u rrëzova pastaj vajza nuk mund të ecte. Njerëzit e tjerë vraponin mbi mua dhe vajzat. Menzi jam qu prej aty dhe një ushtar i UÇK-së kishte pasur të veshur një gujë të zezë të gjatë e i armatosur, ma mori vajzën e deri sa kemi kalu atë grykë më ka ndihmuar ai. Tani kemi kalu afër një mali dhe andej nuk ka pasur të shtëna derisa kemi ardhë në hyrje të Prishtinës.” (N. Haziri, 38 vj., f., Prishtinë, 2009).

- “Dua ta specifikoj një detaj. Te statcioni i trenit filloi një shi i imtë, e në gjith atë zhurmë, piskamë, hallakamë, njerëzit vraponin sa këndeje sa andej, rrëzoheshin, shkileshin. Bashkëshortja ime e mori Brikenën dhe e futi në qantë, si bebe që ishte e futi në qantë, e la pak qelë sa për frymëmarrje. Dhe tash, duke u shtyrë do gra, njëra prej tyre shkon e ulet në qantë, e lodhur e rraskapitur, një plakë shumë e mirë, s’i sot m’kujtohet pamja e saj, një gjyshe e mrekullueshme. Dhe në moment gruaja shikon edhe tmerrohet! I humbi zëri! E ajo i thotë çke mori ti, çka po don?! Ja more ku e kam bebën! Për këtë ka shkruar edhe një gazetë angeleze.” (S. Zeneli, m., 55 vj., Podujevë).

Në shumë raste braktisja e shtëpisë u bë në mënyrë të papritur dhe të paplanifikuar, por ka pasur raste kur momenti i braktisjes së shtëpisë ka qenë i pritshëm, sepse luftimet dhe granatimet janë zhvilluar në afërsi të fshatit ose vendbanimit. Në rastin e parë popullata ka qenë e papërgatitur dhe nuk kanë arritur të marrin gjëra të rëndësishme me vete, përveç disa gjërave personale. Në rastin e dytë janë përgatitur pjesërisht, kanë marrë tesha, ushqime, barna dhe gjëra tjera të rëndësishme. Në pyetjen se a ishit të përgatitur për udhëtim,

shumica e të intervistuarve pohojnë se nuk kanë qenë të përgatitur. Ndërsa sa u përket ndjenjave dhe mendimeve gjatë udhëtimit ka përgjigje të ndryshme, por shqetësimi kryesor ka qenë se ku do të përfundojnë, a do të mund të mbijetojnë, a do t'i shpëtojnë vrasjes, torturës, masakrës, dhunimit... Krahas frikës dhe shqetësimit për fatin jetësor, gjithë kohën i ka shoqëruar dhimbja për braktisjen e vendit. Ja se ç'thotë një banor i Prishtinës, si është ndier duke ecur këmbë për te stacioni i trenit në Fushë-Kosovë dhe kur i ka parë fushat pjellore të rrafshit të Kosovës:

“Bëmë një rrugëtim këmbë deri në Fushë-Kosovë. U nisëm diku kah ora 4.00 e mëngjesit. Kishte aq shumë njerëz, sa që fitohej përshtypja se tërë Kosova ishte tubuar aty. Shumë më vështirë e kam përjetuar kur e shihja Rrafshin e Kosovës, e thosha me vete: medet kujt po ia lëmë këtë vend! Udhëtuam me tren për pesë orë deri në kufi me Maqedoninë. Ishte një përpjekje për jetë a vdekje!” (J. Krasniqi, 40 vj., m., Prishtinë, 2009).

Kur flasin për përvojat dhe përjetimet gjatë udhëtimit në kolonë, ata përmendin rrahjet, torturat, vrasjet, provokimet, plaçkitjet, kërcënimet, rrëmbimet, shqyerjen e dokumenteve identifikuese, deri te shfrytëzimi i tyre si mur mbrojtës nga ana e forcave ushtarake serbe. Rrëfimet për përvojat janë shumë të dhimbshme dhe prekëse. Një nënë nga një fshat i Klinës tregon se si paramilitarët e kanë provokuar dhe iu kanë kërcënuar vajzës së saj:

“Po, ata na dërguan në drejtim të Gjakovës. Gjatë rrugës na ndalën katër-pesë orë dhe çdo herë më fjalë fyese na pyetshin se ku po shkojmë. A po ju pret Albania? Me kujtohet si sot se iu afrua vajzës time Servetit e cila ishte katërmëdhjetë vjet e i tha: “Ku e ke burrin? Nëse e ke në UÇK e të vdesë, hajt se të marrim ne”. Kurse vajza u alivanos nga frika edhe pse nuk e kuptonte çfarë po flisnin, por unë kur e pashë tentova t'i ndihmoja, mirëpo ata nuk më lanë, më rrahën e më larguan.” (D. Hajdari, f., 51 vj., Gremnik, Klinë).

Një tjetër tregon se si e ka shpëtuar jetën duke dhënë para. Ka edhe shumë rrëfime për përvoja tjera tepër të dhimbshme dhe unike. Njëri nga ta ja si shprehet:

”Gjatë udhëtimit ka ndodhur shumëçka, por unë po nisem nga përvoja më e hidhur e imja gjatë atij udhëtimit. Kishim hipur në një traktor për të arritur në një fshat dhe gjatë rrugës për atje ushtria paramilitare serbe na ndali për të na maltretuar apo vranë, sigurisht. Na zbritën të gjithëve në tokë, duke na shtyrë e rrahur, madje disa edhe i vranë në sy të të afërmëve të tyre. Mua dhe familjen time mund të them se na shpëtoi Zoti, sepse përveç disa të goditurave nuk pësuam diçka më tepër. Ndoshta nuk ishte e shkruar që të vdisja aty sikur disa të tjerë. Isha nga ata që e pagova lirinë time me të holla. Unë të gjitha parat që i kisha me vete i lash aty, por megjithatë unë shpëtova. Ishte e tmerrshme se si kishte mundësi të trajtoheshin ashtu njerëzit! Vërtet aty u bë gjenocid në atë rast.” (F. Mustafa, m., 41 vj., Prishtinë)

Shumica e të intervistuarve thonë se kanë ecur në kolonë pa e ditur se ku po shkojnë. Në disa raste forcat militare serbe e kanë drejtuar kolonën drejt Maqedonisë ose Shqipërisë dhe në ato raste njerëzit e kanë ditur se ku po shkojnë, por asnjëherë nuk e kanë ditur se a do të mbijetojnë, a do të arrijnë të dalin përtej kufirit e të shpëtojnë.



Foto 5. Kulla e Mikpritjes, Xërxë, Kosovë; **Foto 6.** Kulla e Mikpritjes, Kukës, Shqipëri

Jeta si refugjat – kujtesa dhe rrëfime

Jeta si refugjat në vend të huaj fillon prej momentit kur kalon kufirin. Çastet e kalimit të kufirit kanë mbetur të paharruara në kujtesën e kosovarëve. Duke i përshkruar ato çaste, dikush thotë se iu ka zgjuar ndjenja e nostalgjisë për shtëpinë dhe vendlindjen, sepse nuk kanë ditur se a do të kthehen më. Disa të tjerë në momentin kur shkelin në vendin e huaj e kanë ndier veten si të humbur, por ka të tjerë që e theksojnë edhe ndjenjën e fajit dhe të pendimit pse nuk kanë qëndruar në shtëpi, madje edhe me kusht se do të vdisnin. N. Haziri kështu thotë:

“Ah... shumë e vështirë, vërtet shumë e vështirë ka qenë, nuk di si me përshkru. Nuk kam mendu se kam me u kthy ma kurrë. Prej atij momenti kam mendu se e kemi humb këtë vend përgjithmonë dhe kur e kam kalu kufirin jam pendu shumë. Kam thanë me veti pse nuk nejta atje e le të më vrasim me fëmijë e me vet, veç le të vdes në vendin tim! Kurrë nuk kam mendu që kam me u kthy ma.” (N. Haziri, 38 vj., f., Prishtinë, 2009).

Jeta si refugjat zgjon shumë ndjenja negative. Dikush ndjehet në mërzë të vazhdueshme, madje në prag të vajit. Disa thonë se kanë ndjerë shumë monotoni, pastaj ndjenja të këqia, ankthe etj. Në njërën anë janë mërziur për familjarët e mbetur në Kosovë, në anën tjetër janë mërziur për veten se çka do të bëhet me ta, kur do të kthehen dhe a do t'i gjejnë të dashurit e tyre për të cilët nuk kanë pasur informata se a janë gjallë apo jo. Dy gra kësoj shprehen:

- *“Valla ma rëndë se me dalë prej vendit tënd nuk kish! Më është duk që krejt bota ra mbi mu. Thojsha me vete tani na erdhi fundi. Momentet e para të largimit gjithmonë i kujtoj me emocione, sepse ishte shumë e vështirë. Bile-bile nuk kam qef hiq ta kujtoj atë ditë të zezë kur shkelëm ne tokën e huaj, në Maqedoni. Më dukej vetja si njeri i humbur. Me vete kisha dy djemtë dhe dy vajzat, ndërsa djali dhe bashkëshorti kishin mbetë në Kosovë.” (M. Musliu, f., 56 vj., Prishtinë).*

- *„Ah... shumë e vështirë, vërtet shumë e vështirë ka qenë, nuk di si me përshkru. Nuk kam mendu se kam me u kthy ma kurrë. Prej atij momenti kam mendu se e kemi humb këtë vend përgjithmonë dhe kur e*

kam kalu kufirin jam pendu shumë. Kam thanë me veti pse nuk nejta atje e le të më vrasim me fëmijë e me vet, veç le të vdes në vendin tim, se kurrë nuk kam mendu që kam me u kthy ma.” (N. Haziri, f., 38 vj., Podujevë).

Për sa i përket marrëdhënieve me vendasit, sidomos me shqiptarët e Maqedonisë dhe ata të Shqipërisë, kosovarët ruajnë kujtimet, respektin dhe falënderimet më të mira për ta dhe për mikpritjen e tyre. Përkundër faktit se në Shqipëri, në shumë raste familjet mikpritëse ishin të varfra, nuk kishin as ushqim dhe as hapësirë të mjaftueshme në shtëpi, ishin mjaft bujare.

- *“Pritja ka qenë shumë e mirë, shteti shqiptar u kujdes shumë për refugjatët e Kosovës, edhe organizatat humanitare po ashtu. Por edhe qytetarët e thjeshtë janë kujdes edhe na kanë ndihmu. Gjithmonë ku kemi shku si te mjeku, si kudo na kanë dhënë përparësi edhe respekti ka qenë shumë i madh nga ana e tyre.” (R. Hasani, m., 70 vj., Prishtinë). Tre nga refugjatët ja si shprehen:*

- *“Mikëpritja e vendasve ka qenë shumë e mirë edhe pse kishte njerëz të varfër të cilët i hapën dyert për të na strehuar dhe askush nuk nguronte për të na marrë në shtëpi.” (E. Kukaj, 30-40 vj. m., Gelancë, Suharekë, 2014).*

- *“Mikëpritja e shqiptarëve të Maqedonisë u kanë shumë e mirë,... shumë të afërm si vllazni na kanë dashtë, na kanë ndihmu, na kanë dhanë kurajo, na kanë dhanë shpresa se do të kthehemi prapë në vendin tonë.” (N. Osmani, 51-60 vj., f., Suharekë, 2014).*

- *„Mikëpritje shumë të madhe kemi pas prej shqiptarëve të Maqedonisë. Na kanë respektu jashtë mase... na kanë dhanë ushqim, na kanë ndihmu në maksimum, aq sa kanë pasur mundësi. Kemi pasë mikpritje shumë të madhe. (I.Gashi, m., 36 vj., Prishtinë).*

Njëra ndër momentet më të paharruara të jetës si refugjat është momenti i kthimit në shtëpi. Shumë respondentë atë moment e kujtojnë si shumë të ndjeshëm, sidomos për shkak të ndarjes nga mikpritësit. Momentet e ndarjes me mikpritësit nuk i kishin paramenduar se do të jenë aq të ndjeshme. Shumë veta thonë se kemi qajtur prej gëzimit që po kthehemi në shtëpi, por janë ndjerë shumë keq në momentin e ndarjes me mikpritësit. Përqaftimet e ndarjes me nikoqirët kanë mbetur në kujtesë të ish-refugjatëve kosovarë. Ja si e përshkruan një respondent ndarjen nga mikpritësit në Poroj të Tetovës:

“Po nga ajo ditë, momenti më i vështirë, më i ranë e më i dhimshëm ka qenë momenti kur u ndamë prej atyne të shtëpisë që na kanë pritë. Aty janë derdhë lot gëzimi edhe hidhërimi, se kemi nejtë tre mujë të plotë me ta. E kemi nda të mirën e të keqën me ta, kështu që ato kanë qenë momente të rana. Një përqaqim i plakut 67-68-vjeçar me fëmijën të 9-vjeçar... Edhe ai ka metë pa frymë prej vajit! Deri atëherë s'kam mujtë me marrë me mend se ajo ndamje midis atyne edhe neve do të jetë aq e dhimbshme. (B. Gashi, f., 51 vj., Prishtinë).

Siç dihet një pjesë e madhe e kosovarëve kishin gjetur strehim në vendet e treta, në shtetet evropiane, në Britani të Madhe, në vendet skandinave, në Amerikë, në Australi, në Izrael, në Turqi etj. Vlerësimet për mikpritjen e vendeve të treta po ashtu janë superlative. Njëri prej të intervistuarve shpjegon pse kishte zgjedhur Francën për strehim:

Siç e thashë, meqenëse isha profesor i frëngjishtes, më përgjigjej shkuarja në atë vend, sepse Francën e kisha vizituar edhe më herët dhe e dija mirë mikpritjen dhe bujarinë e popullit francez. (J. Krasniqi, m., 48 vj., Prishtinë).



Foto 7. Manifestime në Kukës me rastin e 17-vjetorit të eksodit, 16 prill 2016

Momente në kujtesë nga kthimi në shtëpi

Sikurse që ishte dëbimi masiv, ashtu ishte edhe kthimi. Kthimi i shpejtë dhe masiv i kosovarëve në vendin e tyre e pat çuditur edhe opinionin botëror. Vetëm në gjashtë muajt e parë pas çlirimit mbi 800 mijë kosovarë u kthyen në shtëpi.⁷ Ndoshta edhe nuk ishte e habitshme për ata që ishin strehuar në Maqedoni ose Shqipëri, por kthimi nga vendet perëndimore, Evropa dhe Amerika ishte vërtet e habitshme. Si ishte e mundur që të lihen të gjitha ato kushte dhe mundësi të cilat i kishin siguruar vendet mikpritëse për refugjatët kosovarë e të kthehen në vendin e vet, ku përveç djegieve dhe shkatërrimeve të mëdha të vendbanimeve kishte edhe pasiguri nga minat dhe mjetet shpërthyes?! Sidoqoftë, kthimi i shumicës së refugjatëve kishte ndodhur në ditët e para pas çlirimit dhe kishte vazhduar gjatë muajve në vijim.

Sipas përgjigjeve që japin respondentët në lidhje me kthimin, shihet se në përgjithësi ka pasur një konsensus familjar për kthimin në atdhe. Vetëm pak raste pohojnë mungesën e konsensusit. Dhe jo vetëm se kishte pajtueshmëri në lidhje me kthimin, por edhe pas dhjetë, përkatësisht pesëmbëdhjetë viteve pjesa më e madhe e respondentëve pohojnë se vendimi për kthim ka qenë i drejtë dhe përkundër vështirësive me të cilat aktualisht ballafaqohet Kosova ata nuk janë penduar për kthimin. Dy prej tyre ja si shprehen:

- *“Kur vendosa me u kthy, gjithë natën nuk kam fjetë prej gëzimi. Po ashtu edhe anëtarët e familjes për të ardhur në Kosovë... Të gjithë mezi që kanë pritë me ardhë... jena kënaq kur ka ardhë momenti i vendimarrjes për kthim. Po shumë i drejtë dhe nuk jam pishman kurrë.”* (M. Qarraj, 55 vj., m., Grajqevc, Suharekë, 2009).

- *“Të gjithë ishim të pajtimit për kthim. Vendimi për kthim ka qenë i lehtë. Po mendoj se vendimi për t’u kthyer ka qenë shumë i drejtë.”* (I. Halimi, 40 vj., m., Keqekollë, Prishtinë, 2009).

Kur rrëfejnë momentet e hyrjes në Kosovë, vërehet se sa emocionale kanë qenë ato çaste. Disave iu kujtohet çasti i hyrjes në pikën kufitare, kur ushtarët e KFOR-it i kanë përshëndetur dhe ua kanë uruar çlirimin e Kosovës. Njëri prej të intervistuarve bën një

⁷ <http://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/etc/facts.html>

përshkrim interesant të situatës dhe thotë se “çdo gjë ishte e heshtur, e trishtuar dhe e shkatërruar, por këto i doja më shumë se pallatet ku jetoja si refugjat” (F. Mustafa, 45 vj., m., Prishtinë, 2009). Një tjetër thotë se “përkundër pamjeve trishtuese, kur hyra përsëri në Kosovë, m’u duk se u rilinda përsëri”. (A. Sheqiri, 51 vj., m., Prishtinë, 2009).

Moment tjetër i paharruar është çasti i hyrjes në shtëpi. Përshkrimet e këtij çasti zakonisht fillojnë me pamjet e dyerve dhe të oborrit të cilat i gjejnë të hapura; pastaj bari i rritur mbi një metër dhe gjërat e hedhura nëpër tokë janë elementet që janë ngulitur në kujtesë. Më tutje vërejnë se gjërat e ndryshme simbolike, si djepi dhe sofa, muret e shtëpisë dhe gjërat tjera të amvisërisë i gjejnë të shpuara nga plumbat, të shkatërruara, me mbishkrime të ndryshme provokative apo edhe të nxira nga tymi dhe të djegura nga flakët. Të gjitha këto përjetime të këqia ndodhin në të njëjtën kohë me përjetimin e mirë të kthimit në shtëpi. Pra, ekziston një lloj ambiguiteti ndërmjet gëzimit për kthimin në shtëpi dhe mërziisë për vuajtjet, humbjet dhe dëmet e pakompenzueshme.

“Po, më kujtohen dyert e oborrit ishin kanë hapur. Edhe në ato momente u ndjeva shumë keq, mu duk sikur Zoti na ka mallku që ky vend me mbetë shkretë. Tani, kur kemi hyrë në oborr ka qenë katastrofë. Oborri kish marrë pamje krejt tjetër, ish rrit bari, pastaj bërlllog gjithkund, tessa, enë, libra e shumë gjëra të tjera që sigurisht forcat serbe i kishin gjuajtur nga shtëpia në oborr. E ma së shumti më ka plas zemra kur e kam gjetur djepin e vajzave të shpuem me plumba, edhe sofrën kur e kemi gjet në mes të kuzhinës ashtu qysh e kemi lanë ditën kur jemi dalë. Shumë kam bërtitë e kam qajtë, po njeriu nuk po mujke me ndreq asgja tu qajtë e tu bërtitë”, thotë refugjati. (N. Haziri, 38 vj., f., Prishtinë, 2009).

Pjesë e kujtesës së atyre çasteve janë edhe mungesat e gjërave të dashura ose gjërave me vlerë që iu kanë humbur, plaçkitur ose djegur, e ato janë: librat, fotografitë, paja ose teshat e nusërisë, lodrat e fëmijëve, instrumentet muzikore, veglat e punës, teknika dhe makineritë, por edhe gjëra të tjera me vlerë, që i kanë poseduar ose mbajtur kujtim nga e kaluara. Prej të dy hulumtimeve del e dhëna se dhimbja për gjërat e humbura i ka përcjellë gjatë respondentët, e për disa ajo dhimbje vazhdon akoma. Nga kjo mund të konstatohet se një lidhje e fortë emocionale ekziston edhe ndaj gjërave ose sendeve materiale, pra jo vetëm ndaj njerëzve, shtëpisë, vendbanimit dhe vendit në përgjithësi.

Kthimi në shtëpi padyshim se ishte moment gëzimi, por fillimi i jetës së re përcillet me vështirësi të mëdha. Të intervistuarit përmendin shumë probleme me të cilat janë ballafaquar qysh në ditët e para të jetës në liri. Prej problemeve më të rënda padyshim se kanë qenë gjetja e personave të zhdukur. Fatkeqësisht, për një numër të madh familjesh ky problem ka mbetur akoma.⁸ Problem tjetër të madh dhe shumë të ndjeshëm paraqiste humbja e jetëve në luftë e shumë familjarëve dhe rivarrimi i viktimave. Shpërndarja e familjarëve gjithandej po ashtu paraqiste problem; disa ishin kthyer, disa jo. Problemet që kanë të bëjnë me aspekte tjera si: strehimi dhe rindërtimi i shtëpive të djegura ishin ndër më kryesorët. Në pamundësi për të rindërtuar shtëpitë, shumë familje jetonin në tenda, disa nëpër objekte ndihmëse si stalla, garazha, shupa apo podrume gjysmë të rrënuara; disa të tjerë kishin bërë zgjidhje duke u shpërngulur në qytet. Pastaj përmenden problemet me shërbimet publike dhe infrastrukturën, si mungesa e rrymës, mungesa e ujit, mungesa e rrugëve. Disa e përmendin edhe mungesën e gjërave elementare për jetë, si ushqimi, uji i pastër, enët, pastaj shtrojat, mbulojat, dhomat për fjetje etj.



Foto 8. Familje shqiptare që kthehet nga kampi në shtëpi, 1999.

Foto: Fehim Demir - AFP/Getty Images

Burimi: <https://www.britannica.com/event/Kosovo-conflict>

⁸ 17 vjet pas luftës së fundit në Kosovë, ende 1.666 persona figurojnë të zhdukur.
Burimi: <http://aa.com.tr/sq/jeta/kosovë-shënohet-dita-ndërkombëtare-e-personave-të-zhdukur/637803>

Një problem që ka ndikuar shumë atmosferën e pasluftës ka qenë shpopullzimi i fshatrave dhe stërpopullzimi i qyteteve. Banorët e fshatrave, duke u ballafaquar me vështirësi të mëdha sidomos në strehim, i braktisën fshatrat dhe u vendosën nëpër banesat e braktisura nga serbët. Kësisoj, blloqet e banesave në qytet u mbushën me banorë të ri, kurse fshatrat, sidomos ato malore, u zbrazën thuaja se krejtësisht. Ky problem pastaj reflektohej edhe në raportet ndërfqinjësore në qytet, por edhe në ndjenjën e sigurisë dhe izolimit në fshat, gjë që paraqiste problem të veçantë sidomos për banorët e paktë që kishin mbetur atje.

Sado që problemet e përditshme në vitet e para të pasluftës ishin mjaft të theksuara, kujtesa për të kaluarën rëndonte në mendjet e njerëzve. Në pyetjen se a i keni vizituar vendet ku keni ecur në kolonë, apo ku keni qëndruar si refugjatë, shumica e të intervistuarve përgjigjen pozitivisht. Madje disa thonë se i kanë vizituar disa herë. Njëri prej tyre thotë:

“Momenti i fundit ka qenë vitin e kaluar. E kam vizituar krejt atë rrugën Sfeqël, Shajkofc, Surdull, Drazhnje, Turuqicë, Bllatë. Ka qenë një përkujtim, por kanë ndodhë atje disa intervenime, disa gjëra që i kanë ndryshu ato vendbanime. Mirëpo prapëseprapë i kujtojmë.” (M. Maloku, 26 vj., m., Podujevë, 2009).

Krahas kësaj, të intervistuarit përgjigjen pozitivisht edhe në pyetjen se a mbajnë kontakte me familjet mikpritëse që i kanë strehuar gjatë luftës. Një numër i konsideruar vazhdojnë të mbajnë kontakte edhe pas pesëmbëdhjet vjetëve. Madje shumë syresh kanë krijuar edhe lidhje kumbarie, lidhje martesore dhe miqësore me mikpritësit. Ata vizitohen reciprokisht dhe zakonisht thirren në dasma ose në funerale të njëri-tjetrit. Dy prej tyre kësisoj shprehen:

“Po, kontaktet i mbajmë sot e asaj dite. Ata vijnë e ne shkojmë. Jemi shumë miq të mirë... Unë isha edhe i ftuar në ahengje familjare. Gjithashtu edhe ata vijnë te ne. Por prap po e theksoj se ne kurrë nuk mujmë me ua kthyer të mirat e tyre, atë çka kanë ba për neve. Janë një popull shumë zemërgjerë.” (A. Hoxha, 52 vj., m., Damanek, Drenas, 2009).

“Kontaktet më të rregullta ndoshta edhe në baza ditore, javore e mujore janë edhe përmes telefonit dhe asnjëherë nuk harrojmë që t'i urojmë njëri-tjetrit për festat familjare e ato kombëtare. Nuk mund ta

lë pa e cekur se pavarësisht çmimit të lartë që pagoi populli për luftën që u bë, familja jonë është me fat që jeta na e mundësoi, në rrugëtim e sipër, ta njoh familjen e Xhevdet Rexhepit nga Tetova e të cilën e falënderoj përjetësisht me urimet më të sinqerta!” (I. Govori, m., 41-50vj., Prishtinë).

Jeta në liri ka sjellë shumë të mira dhe benefite. Vetë liria si vlerë supreme, prej të cilës shqiptarët kanë qenë të privuar një kohë të gjatë, ofron mundësi për progres dhe zhvillim të shumanshëm. Rindërtimi i shtëpive dhe i vendit, hapja e vendeve të reja të punës sidomos me ardhjen e organizatave ndërkombëtare, pastaj zgjedhjet e lira dhe ndjenja se më nuk jemi nën okupim, hapja e shkollave, mediave, siguria e lëvizjes së lirë, e mbi të gjitha krijimi i institucioneve dhe shpallja e pavarësisë së vendit janë vlerat më të çmueshme të lirisë së Kosovës.

Krahas gjithë këtyre vlerave dhe proceseve pozitive, të intervistuarit kanë theksuar edhe aspekte negative që janë shfaqur në Kosovën e çliruar. Vështirësitë personale dhe familjare për t’u kyçur në procesin e punës, ekonomisë dhe tregut gjithsesi kanë qenë evidente, por edhe çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e shtetit dhe institucioneve, të shërbimeve publike, madje edhe të sigurisë njerëzore janë theksuar si probleme që e kanë karakterizuar jetën e pasluftës. Krahas krizave politike dhe sociale përmenden shumë edhe krizat morale, sidomos ndryshimi i sistemit të vlerave, si: egoizmi i rritur, materializmi i tepruar, solidariteti në rënie etj. Pastaj përmenden edhe shkalla e lartë e korrupsionit, vrasjet e pasluftës, kriminaliteti në rritje, droga, varfëria, papunësia, mungesa e zhvillimit ekonomik, mungesa e sistemit të drejtësisë, mosfunksionimi i mirë i sistemit shëndetësor, mungesa e liberalizimit të vizave dhe kryeproblemi për të gjithë qytetarët e Kosovës – ndarja e qytetit të Mitrovicës.

Porositë e respondentëve

Në fund të intervistës prej secilit respondent është kërkuar të jep ndonjë mesazh ose porosi për rininë dhe qytetarët e Kosovës. Në përgjithësi porositë e dhëna kanë të bëjnë me nevojën për ta kujtuar ose për të mos e harruar luftën, vuajtjet nëpër të cilat kemi kaluar, për t’i kujtuar dëshmorët e rënë, por gjithsesi për të mos e harruar edhe ndihmën e miqve ndërkombëtarë, sidomos NATO-n, SHBA-në dhe

vendet evropiane që kanë dhënë për çlirimin e vendit tonë dhe rindërtimin e tij pas luftës.

Porosia ime është: *“Të mos e harrojmë kurrë ndihmën që na e dha bota demokratike dhe miqësinë e përhershme me Amerikën. Ta falënderojmë NATO-n! Lavdi ju qoftë dëshmorëve tanë që derdhën gjakun për lirinë e Kosovës!”* (B. Blakqori, 47vj., m., Podujevë, 2009).

Shumë porosi kanë të bëjnë me nevojën për vetëdijësim, për të punuar dhe për t'i kontribuar vendit tonë me punë, dashuri dhe me përkushtim, sepse, siç thonë ata, vetëm me punë mund ta bëjmë vendin tonë sikurse vendet tjera.

Porosia ime do të ishte: *“Të punojmë sa ma shumë e të rregullojmë vendin tonë e mos të lakmojmë vetëm në vendet tjera, pasi me punë të drejtë i arrijmë të gjitha.”* (A.B. 30vj. F, Prishtinë, 2009).

Një tjetër thotë: *“Mbasi i kemi kaluar 15 vjet prej gjenocidit të Millosheviqit, sot jemi te lirë, sot nuk është e drejtë prej gjakut e prej sakrificave të popullit, të dëshmorëve ta lëshojmë Kosovën. Përkundrazi, duhet me punu shumë, shumë me punu, me iu tregu fëmijëve sakrificën edhe vuajtjet e këtij populli për me mbërri ku jemi sot, për me marrë frymë sh lirë...”* (L. Zenuni, m., 30-40 vj., Gjakovë).

Porosi të tjera kanë të bëjnë me forcimin e dashurisë, respektit dhe solidaritetit me njëri-tjetrin, por edhe me të tjerët. Po e përfundojmë me porosinë e respondentit më të vjetër, plakut nëntëdhjetëvjeçar nga Isniqi, i cili rininë kosovare e porosinë:

“Mësoni shumë, punoni shumë, zbuloni gjana t'reja, se veç kështu Kosova shkon përpara. E di që e kemi një rini shumë të mirë, veç duhet me punu më shumë e mos me flejtë. Kjo është porosia jeme, edhe le t'përcjellat n'krejt Kosovën.” (S. Osmani, m., 90 vj., Isniq, Deçan).

Kujtesa dhe porosinë e studentëve

Në vitin akademik 2014/15, me rastin e pesëmbëdhjetë vjetorit të eksodit, në kuadër të lëndës *Praktikumi sociologjik* kemi mbajtur dy diskutime në fokus-grup me studentët e sociologjisë. Përveç qëllimit pedagogjik që të mësojnë për fokus-grupet, pasurimi i hulumtimit për pesëmbëdhjetë vjetorin e eksodit duke bërë një refleksion mbi

vetveten edhe vetë mbledhësit e të dhënave, në këtë rast studentët, ishte qëllim tjetër. Në atë kohë ata kanë qenë fëmijë katër-pesëvjeçarë dhe disa momente i mbajnë mend shumë mirë, por disa të tjera i kanë harruar, ndonëse duke qenë të vegjël atëbotë, nuk e kanë kuptuar drejt se çka ishte duke ndodhur. Kujtesa e tyre në lidhje me ngjarjen është episodike, por disa momente të veçanta i përshkruajnë dhe i rrëfejnë në mënyrë shumë interesante. Disave prej tyre iu kujtohet ultimatumi i dhënë nga forcat serbe për ta lëshuar shtëpinë, disa të tjerëve iu kujtohen granatimet, disa tjerë e kujtojnë kujdesin e prindërve ndaj tyre e disave të tjerë i ruajnë imazhet e refugjatëve të pastrehë, të pangrënë, të përbaltur dhe të përgjakur. Këtu do t'i paraqesim shkurtimisht kujtimet e tyre të ruajtura në formë fragmentare, sidomos momentet të cilat kanë mbetur të pashlyeshme në memorien e studentëve.

Kujtesa:

- *“Edhe pse isha katër vjet e gjysmë, unë i kujtoj ato momente me episode të shkurta. Isha e vogël e kisha rol të shikoja më shumë se sa të veproja ... Familjes time i ka ardhë ultimatumi. Axha im ka qenë te dera dhe ka ardhë ai paralimitari, më kujtohet, unë kam qenë pas derës edhe ata kanë folë serbisht edhe janë grindë shumë, sepse axha nuk ka dashtë me lëshu shtëpinë...”*(B. Prebreza).

- *“Pasi kemi dalë prej shtëpisë, nja njëqind metra larg e kam ndie një krismë të madhe. Ka qenë krismë shumë e madhe, me siguri granatë, ka qenë për afërsisht në vendin kah është shkolla sot. Kam nisë me u frikësu se po e prishin shkollën, e kur të rritem ku do të mësoj!* (E. Rexhepi).

- *“Po edhe unë e kujtoj një moment të veçantë, që mu ka pas ba iri. Kur donim me ra me fjetë, n'vend se me u vesh me pixhame, u dashke me u vesh deri në patika për me ra në gjumë. Kjo ka qenë e tmerrshme.”* (V. Sallova).

- *“Kam qenë e vogël, i mbaj mend granatimet e fshatit dhe njerëzit duke u fshetur nëpër strehë të shtëpive... Mami ka qenë duke i pjekur bukët dhe prej granatimeve ka filluar me u shembë shtëpia dhe krejt dheu ka ra mbi bukë. Ato bukë nuk kemi mund t'i hamë më...”*(A. Beqa).

- *“Momenti kur para se me dalë kanë ardhë forcat serbe edhe kanë trokitë në derë, në atë moment u dalë gjyshi, se ne fëmijëve s'na*

kanë lanë me dalë, por unë për dritare i kam pa që kanë dhënë ultimatium me dalë.” (A. Hasani)

- “Unë momentet e daljes nga shtëpia i kujtoj, edhe me thenë të drejtën goxha u gëzua, sepse veçfamilja jonë dhe e axhës kanë pasë mbetë në fshat. ...Një moment i veçantë që më kujtohet ka qenë 27 marsi kur kanë ardhë prej fshatrave tjera në Fushë të Madhe e na kanë thanë këta të shtëpisë me shku me iu qu batanie e jorgana ose veshmbathje, sepse janë në qiell të hapur. Kur kam shku i kam pa të deshur, dathur, të vramë kambët. Më kujtohet se i kam pa njerëzit e përgjakur, ajo më kujtohet më së shumti.” (R. Kajtazi).

- “Edhe unë gjatë luftës kam qenë e vogël edhe i mbaj mend momentet para se me dalë prej shtëpisë. Krejt familja diqysh u bëmë tubë edhe tash filluan me i marrë sendet Më kujtohet edhe një rast, para se me dalë prej shtëpisë, kur kanë fillu serbët me gjuajtë, mami na ka marrë një nga një neve fëmijëve dhe na ka qu te axhi im, te shtëpia e fundit. Ai moment më kujtohet gjithmonë...” (A. Ibishi).

- “Kam qenë në moshën 6-vjeçare në kohën e luftës. Kanë ardhë forcat serbe kanë trokitë në derën e shtëpisë, ka dalë babi prej shpisë, pastaj ata e kanë lajmëru babin që duhet me u largu sa më shpejt, nëse nuk gaboj ultimatumi ka qenë një orë...Më kujtohet edhe momenti kur kemi dashtë me dalë, gjyshja ka qenë e sëmurë edhe ka thënë: “Shkoni ju e lemëni mua. Veç shpëtoni ju, kjo është me rëndësi”. Ne normal që nuk e kemi lënë, i kemi ndihmu dhe bashkë kemi dalë prej shtëpisë. (B. Shala).

Porositë:

- “Ndoshta ekziston një rrugë për ndryshim. Tani po thonë po shiten diplomat, atëerëpse po i blejmë! Ose nese falin nota, atëherë pse po i pranojmë! Nëse jemi fëmijët e baballarëve qe kanë luftuar, pse mos me ua zbardhë fytirën!” (E. Rexhepi).

- “Mesazhi im është puna, sepse mbi të gjitha është puna, motivimi. Për mendimin tim nëse punojmë vendosmërisht edhe motivohemi, e mundohemi edhe të tjerët t’i motivojmë, atëherë kemi me arritë aty ku synojmë.” (B. Prebreza).

- “Mendimi im është mosdurimi i kësaj gjendje. Mesazhi im është mos me duru këtë gjendje hiq, sepse s’i kemi borxh askujt me na e bë kështu.” (R.Kajtazi).

- *“Mesazhi im është se ne duhet me qenë të vetëdijshëm në mënyrën më të lartë të mundshme, e me punu sa më shumë. Normal se pas punës ka me pasë edhe sukses.”* (B. Shala).

- *“Edhe unë kisha me thënë se ne jemi e ardhmja e këtij vendi edhe na duhet me e çu vendin përpara me punë.”* (A. Ibishi).

- *“Mendoj që me punë arrihet krejt. Tash jo me këqyrë veç interesin individual, sepse po mendoj se interesi individual, qëllimet personale na kanë sjellë në këtë gjendje. Kisha porositë: punë shumë, sa më shumë punë.”* (A. Hasani).

- *“Mesazhi im është mos me ia bë askujt çka nuk don me ta ba dikush, në mënyrë që me ec përpara.”* (V. Sallova).

- *“Ne që e kemi përjetu atë që ka ndodh, me vazhdu me reflektu për të dhe me mbajtë në kujtesë edhe me e vlerësu atë si një sprovë të madhe për neve personalisht dhe për neve si komb. Ne si studentë dhe si rini duhet me ndejtë në këtë vend dhe me i kontribu zhvillimit të vendit tonë.”* (R. Sokoli).

- *“Te mesojmë e ta çojmë këtë vend përpara. Shumë kam qejf me e çu këtë vend përpara ...”* (A. Beqa).

Përfundimi

Hulumtimi *“Kujtesa përballë harresës”* është mjaft kompleks për nga qasja metodologjike dhe për nga lloji e cilësia e të dhënave të mbledhura në terren. Ky hulumtim tregon se njerëzit nuk i kanë harruar momentet e rënda të përjetuara dhe se janë në gjendje t'i rrëfejnë në detaje përvojat e luftës, të dëbimit masiv dhe kthimit po ashtu masiv. Rrëfimet e tyre janë mjaft prekëse dhe zakonisht gjatë rrëfimit respondentët emocionohen, sepse iu rikthehet kujtesa e ngjarjeve tragjike dhe dramatike. Për secilën fazë, si për atë të paraluftës, si për atë të luftës, ashtu edhe për atë të pasluftës, ata flasin në imtësi, tregojnë momente dhe skena unike.

Kur bëjnë krahasim me gjendjen aktuale respondentët theksojnë se ndjenja e solidaritetit gjatë luftës ka qenë kulmore, por tash ka ra në nivel shumë të ulët dhe njëra prej shqetësimeve të tyre është pikërisht egoizmi, individualizmi dhe mungesa e solidaritetit pas luftës. Ndryshimet në sistemin vleror, si edhe ato në mënyrën e jetesës krijojnë paqartësi dhe shqetësime te respondentët, sidomos për faktin

se biseda bëhet në kontekst të shpalosjes së kujtimeve për luftën, tragjeditë, vuajtjet, rreziqet dhe shkatërrimet e saj.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se sikurse që është e rëndësishme dhe e fuqishme lidhja me njerëzit dhe me vendin, ashtu është e rëndësishme edhe lidhja me gjërat ose sendet simbolike. Për gjërat e ndryshme simbolike, të humbura ose të shkatërruara, të intervistuarit kanë ndjerë dhimbje me vite të tëra, e për disa dhimbja mbetet përgjithmonë. Pra, të dhënat e mbledhura nuk kanë vetëm funksionin e shpjegimit të një ngjarjeje historike, ose të evokimit të përvojave të luftës, të vuajtjeve dhe shkatërrimeve që kanë ndodhur, por edhe të kuptuarit e lidhjeve ose raporteve njerëzore, të sjelljeve në situata skajshmërisht të rrezikshme, të natyrës njerëzore, domethënë janë të rëndësishme për t'u analizuar edhe nga aspekti i sociologjisë, antropologjisë dhe psikologjisë. Natyrisht se këto të dhëna janë mjaft të rëndësishme edhe për fushat tjera studimore si drejtësia, sidomos ajo tranzicionale, politika, të drejtat e njeriut, demografia etj.

Disa prej të intervistuarve kanë shfaqur shqetësim se lufta dhe dëbimi i dhunshëm i vitit 1999 është duke u harruar. Shumë syresh kanë shfaqur kënaqësinë që iu ka dhënë rasti t'i rrëfejnë përvojat dhe përjetimet e tyre, si dhe t'i shprehin qëndrimet dhe vlerësimet për jetën në Kosovën e pasluftës. Prej tyre kuptohet se sa me rëndësi është të bëhen hulumtime të tilla dhe të arkivohet kujtesa në mënyrë që t'u përcillet brezave të ardhshëm, por edhe të bëhen studime e botime edhe në gjuhë tjera në mënyrë që tregimi për eksodin kosovar të vitit bibliq 1999, kur nën presionin ushtarak dhe policor të regjimit serb dhe me qëllim të pastrimit etnik rreth një milion shqiptarë u detyruan ta braktisin Kosovën, të bëhet pjesë e literaturës botërore.

Pjesë e këtij tregimi unik është edhe kthimi masiv dhe i menjëhershëm i popullatës që në ditët e para të çlirimit, sikurse që është edhe ruajtja e kontakteve me familjet mikpritëse, sidomos me ato në Maqedoni dhe Shqipëri. Vizitat familjare për raste të ceremonive martesore, mortore, ngjarje apo festa të ndryshme familjare vazhdojnë të bëhen.

Një gjë tjetër po ashtu e rëndësishme që nxjerr në pah hulumtimi është se përkundër varfërisë, krizës ekonomike, sociale dhe politike që mbretëron në Kosovë, të kthyerit deklarojnë se vendimi për t'u kthyer ka qenë i drejtë dhe për këtë nuk janë penduar.

Burimet dhe literatura**Intervistat e cituara**

1. A. B. 30 vj., f., Prishtinë, 2009.
2. A. Hoxha, 52 vj., m., Damanek, Drenas, 2009.
3. A. Sheqiri, 51 vj., m., Prishtinë, 2009.
4. B. Blakqori, 47 vj., m., Podujevë, 2009.
5. B. Gashi, f., 51 vj., Prishtinë, 2009.
6. D. Hajdari, f., 51 vj., Gremnik, Klinë, 2009.
7. E. Kukaj, 30-40 vj., m., Gelancë, Suharekë, 2014.
8. F. Berisha, m., 49 vj., Prishtinë, 2009.
9. F. Gashi, f, 41-50 vj., Klinë, 2014.
10. F. Mustafa, 45 vj., m., Prishtinë, 2009.
11. F. Velia, m, 30-40 vj., Skënderaj, 2014.
12. Gj. Kelmendi, 50 vj., m., Pejë, 2009.
13. H. Avdiu, f., 24 vj, Ferizaj, 2009.
14. H. Shterbani, f., 30-40 vj., Rahovec, 2014.
15. I. Gashi, m., 36 vj., Prishtinë, 2009.
16. I. Govori, m., 40-51 vj., Prishtinë, 2014.
17. I. Halimi, 40 vj., m., Keqekollë, Prishtinë, 2009.
18. J. Krasniqi, 40 vj., m., Prishtinë, 2009.
19. L. Ahmeti, 41-50 vj., m, Zaplluxhë, Dragash, 2014.
20. L. Behrami, m., 28 vj., Mitrovicë, 2009.
21. L. Zenuni, m., 30-40 vj., Gjakovë, 2014.
22. M. Maloku, 26 vj., m., Podujevë, 2009.
23. M. Musliu, f., 56 vj., Prishtinë, 2009.
24. M. Qarraj, 55 vj., m., Grajqevc, Suharekë, 2009.
25. N. Haziri, 38 vj., f., Prishtinë, 2009.
26. N. Osmani, 51-60 vj., f., Suharekë, 2014.
27. Q. Bashini, m., 53 vj., Lubizhdë, Prizren, 2009.
28. R. Berisha, m., 30-40 vj., Peje, 2014.
29. R. Hasani. 70 vj., m., Prishtinë, 2009.
30. S. Hetemi, m., 65 vj., Vushtrri, 2009.
31. S. Osmani. 90 vj., m., Isniq, Deçan, 2.009.
32. S. Zeneli, 51-60 vj., f., Podujevë, 2014.
33. Sh. Goçaj, m., mbi 61 vj., Prizren, 2014.
34. V. Belegu, f., 51 vj., Prishtinë, 2014.
35. Xh. Bajrami, 51-60 vj., f., Lipjan, 2014.
36. Xh. Avdijaj, m., mbi 61 vj., Malishevë, 2014.

Studentët pjesëmarrës në fokus-grup

1. B. Prebreza, studente, BA Sociologji.
2. E. Rexhepi, student, BA Sociologji.
3. V. Sallova, studente, BA Sociologji.
4. A. Hasani, student, BA Sociologji.
5. R. Kajtazi, student, BA Sociologji.
6. A. Ibishi, studente, BA Sociologji.
7. B. Shala, studente, BA Sociologji.
8. D. Seferi, studente, BA Sociologji.
9. A. Imeri, studente, BA Sociologji.
10. A. Imeri, studente, BA Sociologji.
11. R. Sokoli, student, BA Sociologji.
12. A. Beqa, studente, BA Sociologji.

Literatura

- [1] Oliver Jens Schmitt, Kosova. *Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, “Koha”, Prishtinë, 2012.
- [2] Shemi Krasniqi, *Dokumentimi i kujtesës mbi eksodin e vitit 1999*, Biblioteka Kombëtare “Pjetër Bogdani”, Prishtinë, 2017.
- [3] Sulejman Dida, *Dëbimi i shqiptarëve prej Kosove në vitin 99. Dëshmi, përjetime, refleksione*, “Mirgeeralb”, Tiranë, 2014.

Burime interneti

- [1] Astri Suhrke, Michael Barutciski, Peta Sandison, Rick Garlock, *The Kosovo refugee crisis An independent evaluation of UNHCR's emergency preparedness and response*, UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR REFUGEES EVALUATION AND POLICY ANALYSIS UNIT, February 2000,
- [2] <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/search?page=search&docid=3ba0bbeb4&query=Kosovo>
- [3] <http://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/etc/facts.html>
- [4] <http://aa.com.tr/sq/jeta/kosovë-shënohet-dita-ndërkombëtare-e-personave-të-zhdukur/637803>
- [5] <https://www.britannica.com/event/Kosovo-conflict>
- [6] https://www.charterforcompassion.org/images/menus/Peace_non_violence/TSF_Kosovo_1999_1.jpg

Tahir Latifi, Prishtinë

MIGRIMI DHE FAMILJA TRANSNACIONALE - ROLI I REMITENCAVE NË RUAJTJEN E KOHEZIONIT SOCIAL NË FAMILJEN KOSOVARE

Hyrje

Fundi i viteve 1990, për shqiptarët e Kosovës nuk shënoi thjeshtë vetëm fundin e një mileniumi, për më tepër, fundi kësaj i epoke është shoqëruar me fundin e aparteidit dhe me lirinë e Kosovës. Mileniumi i ri, në anën tjetër, solli sfida të reja – fillimin e një faze emergjente dhe rehabilitimin pas dhunës dhe shkatërrimeve të mëdha të shkaktuara nga lufta, si dhe formimin e institucioneve të reja të administruara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Si një vend i sapodalë nga lufta, për shumicën e popullsisë ishte pothuajse i pamundur rindërtimi i shtëpive të reja, të cilat ishin djegur e rrënuar nga forcat ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe. Ndërtimi, respektivisht rindërtimi i tyre ishte bërë i mundshëm nga ndihma e organizatave ndërkombëtare dhe nga paratë e dërguar nga migrantët, të cilët punonin dhe punojnë jashtë vendit. Në këto kondita, derisa ndihma e organizatave ndërkombëtare shumë shpejt ishte ndërprerë, meqë konsiderohej se situata emergjente kishte përfunduar, remitencat vazhduan të mbajnë gjallë ekonominë familjare.

Rëndësia e remitencave nuk është e kufizuar vetëm në ekonominë familjare dhe rrjedhimisht mirëqenien e tyre ekonomike, për më tepër ato kanë ndikim edhe në zhvillimin makroekonomik të Kosovës (UNDP and Swiss Cooperation Office Kosovo 2014). Shikuar në perspektivë të profitit të shumanshëm që sjellin, kuptohet që, nëse remitencat kanë ndikim pozitiv në të hyra, me këtë rast këto dërgesa kanë efekt të shumëfishtë, duke përfshirë të hyrat familjare, punësimin dhe prodhimin. Në këtë kontekst flasim për ndikimet direkte, kuptohet me paratë e dërguara familjes, ndërsa indirekte përmes këtyre dërgesave ndikohet në ngritjen e kapaciteteve

biznesore. Nga një gjendje e tillë “familjet dhe firmat lidhen së bashku përmes tregtisë. Lidhjet e shpenzimeve përcjellin ndikimin e remitencave nga shtëpitë që pranojnë remitenca të shtëpitë tjera dhe të firmave prodhuese në ekonomi” (Taylor 1999: 70).

Migrimi dhe transnacionalizmi janë shndërruar në njërin nga faktorët më të rëndësishëm në aspektin e ekonomisë dhe mirëqenies. Si rrjedhojë, në grupin e këtyre faktorëve, përveç ndikimeve që sjellin në raport me mirëqenien dhe zhvillimin ekonomik, një vend me rëndësi zënë edhe faktorët politikë dhe socialë (shih po ashtu Vertovec, 2009: 101). Për më tepër, përveç remitencave me bazë dërgimin e të hollave dhe të mirave të tjera materiale, “lëvizja e njerëzve dhe remitencave sociale (ideve, normave, praktikave dhe identiteteve) ndërmjet vendeve dhe shteteve në shumë regjione është bërë shumë e shpeshtë dhe shumë e përhapur, sa që po ashtu ndikon shumë edhe në jetët e atyre të cilët nuk migrojnë.” Kështu, jeta e migrantëve është e ndikuar shumë nga komuniteti në atdhe dhe anasjelltas – duke ndërtuar rrjete transterritoriale (Leutloff-Grandits and Pichler 2014: 174-178), rrjete të cilat në mënyrë të vazhduar i mbajnë njëri-tjetrin të lidhur.

Duke u bazuar në hulumtimin empirik, ky punim nxjerr në sipërfaqe përvojën time hulumtuese të realizuar në kuadër të projektit *Familja kosovare e rishikuar* nga Universiteti i Graz-it në periudhën 2010-2015. Projekti u financua nga Fondi Austriak për Shkencë dhe ishte zbatuar nga Universiteti i Graz-it. Nën mbikëqyrjen e prof. Karl Kaser, pjesë e projektit ishte edhe Carolin Leutloff-Grandits, Elife Krasniqi dhe Tahir Latifi. Metodologjia e hulumtimit të këtij projekti, rrjedhimisht edhe e projektit tim të doktoratës, ka qenë *teoria e bazuar (grounded theory)* (Glaser and Strauss 1967), që do të thotë një teori e krijuar përmes mbledhjes sistematike të të dhënave nga hulumtimi empirik, duke involvuar krijimin e teorive dhe hipotezave përmes analizës së të dhënave kryesisht me metodën kualitative të hulumtimit. Kështu, në fokus ka qenë mbledhja e të dhënave nga terreni – etnografi, duke realizuar intervista të thella, si dhe vëzhgim me pjesëmarrje në jetën e fshatit, respektivisht të Isniqit.

Bazuar në të dhënat empirike nga ky hulumtim, të dhënat statistikore, si dhe në literaturën relevante që trajton rolin e migrimit dhe remitencave në mirëqenien ekonomike të familjes, në këtë punim do të trajtoj rolin e remitencave në ruajtën e kohezionit social të familjes në Kosovë – niveli *makro* dhe *mikro*, respektivisht me fokus në Isniq të Deçanit. Ky studim ka për qëllim të nxjerr në sipërfaqe

ndikimin direkt të remitencave në reduktimin e varfërisë dhe në të njëjtën kohë roli i tyre në relacion me mirëqenien ekonomike. Punimi është i ndarë në tre seksione. I pari, ka për fokus faktorët ekonomikë dhe demografikë në Kosovë, duke parë rolin që kanë këta faktorë në jetën e qytetarëve. Në seksionin e dytë trajtoj rolin e remitencave në ruajtjen e kohezionit social. Ndërsa në të tretin, në perspektivë *mikro* janë marrë katër shembuj si raste studimi.

Mungesa e shtetit të mirëqenies: faktorët ekonomikë dhe demografikë në raport me mirëqenien

Në përgjithësi, vendet si Kosova, ku shteti i mirëqenies është i dobët, ekziston një shkallë e ulët e aktiviteteve ekonomike, duke përfshirë shkallë të ulët të punësimit, ku rreth 61.3% e popullsisë aktive për punë (15-64 vjet) janë joaktive, që do të thotë ata as nuk punojnë dhe as nuk kërkojnë punë. Në anën tjetër, nga 38.7% e popullsisë së moshës së punës, e cila është ekonomikisht aktive, 27.5% janë të papunë. Si rezultat, 72.% e personave ekonomikisht aktivë punojnë. Kështu, nga popullsia në moshë pune, vetëm 28% janë të punësuar (ASK 2017b). Si pasojë, ekziston një shkallë e lartë e papunësisë (afatgjate) 27%; përqindje e lartë e varfërisë së përgjithshme rreth 17.6% dhe asaj ekstreme rreth 5.2% (ASK 2017a).

Sidoqoftë, pjesëmarrja e ulët në tregun e punës në Kosovë nuk është karakteristikë vetëm e viteve të fundit. Shikuar në statistikat që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore (LDB) e deri në vitet 1990, numri i të punësuarve në Kosovë tradicionalisht ka qenë shumë i ulët. Numri i të punësuarve asnjëherë nuk ka arritur të jetë 50%. Në periudhën pas LDB-së pjesëmarrja në tregun e punës nganjëherë ka shkuar në drejtim negativ. Si shembull, në vitin 1953 pjesëmarrja nga 32.9% bie në vitin 1975 në 26% (Krasniqi 1979: 46). Kjo rënie, megjithatë, nuk ka qenë për shkak të reduktimit apo zvogëlimit të vendeve të punës. Kjo më shumë ishte e lidhur me shpërpjesëtimin në raport me vendet e reja të punës dhe me rritjen konstante të popullsisë, që natyrisht ishte shumë e lartë.

Të dhënat statistikore tregojnë se në fund të Luftës së Dytë Botërore 80% e popullsisë në Kosovë ka qenë rurale. Kjo përqindje,

në vitin 1991 bie në 63%¹ (ESK 2002: 10). Veçanërisht në zonat shumë fertile të Rrafshit të Dukagjinit popullsia preferonte prodhimin bujqësor, në vend të kalimit në punë industriale. Ndërsa sa i përket aktivitetëve ekonomike, para LDB-së, rreth 80-90% e popullsisë në Kosovë ishte popullsi agrare. Në dekadat pasuese kjo përqindje bie: në vitin 1975 ishte 72.4%, më 1961 ishte 64.2%, më 1971 ishte 51.5% (derisa mesatarja jugosllave ishte 38.5%) (Krasniqi 1979: 46).

Shikuar në aspektin demografik, Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, ku mosha mesatare e popullsisë është 30.2 vite (ASK 2016). Nisur nga premisa demografike dhe më pas, duke konsideruar trendet ekonomike negative, shpresat për një ulje të nivelit të varfërisë duken të jenë vetëm një pasqyrim optimist. Të gjithë faktorët socioekonomikë të përmendur përbëjnë njëërën nga arsyet më të mëdha për të emigruar, pavarësisht në rrugë legale apo ilegale (Latifi 2016: 257). Të pashpresë për një të ardhme më të mirë, në mungesë të perspektivës dhe pritjeve dëshpëruese për të gjetur një vend pune, një numër i madh i të rinjve të vetmen mundësi për prosperitet dhe mirëqenie e shohin emigrimin në vendet e Evropës Perëndimore. Që nga koha e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, arsyet kryesore për migrim janë identifikuar rrethanat ekonomike, pra varfëria (37.9%) dhe bashkimi familjar (48.9%). Kështu, një numër i madh i njerëzve ende e konsiderojnë migrimin si rrugën më të mirë për t'i ikur varfërisë (UNDP 2014: 26). Si rrjedhojë, kohëve të fundit “janë shumë, nëse jo më shumë njerëz të varfër në Kosovë sesa në kohën nga fundi i luftës më 1999 (UNDP 2012: 2).

Sipas të dhënave statistikore për vitin 2016, remitencat në Kosovë kanë arritur shifrën prej 691 milion eurosh (BQK 2017: 22). Kjo është shuma e llogaritur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si shifër totale e remitencave të transferuara në Kosovë për vitin kalendarik 2016. Ndërsa sa i përket përqindjes së qytetarëve të cilët kanë anëtarë të familjes në mërgatë, të dhënat tregojnë se në vitin 2012, 43% e qytetarëve kanë anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit. E në anën tjetër, 22.4% e familjeve kosovare pranonin remitenca (ASK 2013: 11). Në atë vit transferet e migrantëve ishin rreth 470 milion euro, që përbënte 9.3% të prodhimit të brendshëm bruto: shkurt PBB (ASK 2013: 13). Në vitin 2014, në një studim të bërë nga UNDP në Kosovë, *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë*

¹ Në vitin 1991 në Kosovë nuk ka pasur regjistrim të popullsisë, por vetëm vlerësim. Për shkak të rrethanave politike, pushtetit represiv të Serbisë, shqiptarët e Kosovës e kanë bojkotuar pjesëmarrjen në regjistrim.

2014 (UNDP 2014) është evidentuar se përafërsisht 15% e PBB-së së Kosovës përbëhet nga remitencat. Sa i përket PBB-së, në vitin 2016 Kosova kishte diku rreth 6.65 miliard dollarë, derisa PBB për të hyra për kokë banori ishte rreth 3.880 dollarë (Banka Botërore).²

Sidoqoftë, edhe pse ekzistojnë të dhëna të cilat tregojnë për vlerën vjetore të parave nga remitencat në Kosovë, prapëseprapë këto të dhëna nuk japin një pasqyrë reale, gjithëpërfshirëse. Institucionet relevante që merren me të dhënat (statistikat) rreth remitencave nuk kanë një mekanizëm apo instrument matës, që regjistron apo kontrollon edhe sasinë e dërgesave, të cilat në Kosovë hyjnë përmes kanaleve *joformale*. Pra, paratë që në Kosovë nuk transferohen përmes bankave apo institucioneve tjera financiare si *Western Union* apo *Moneygram*. Në të kaluarën, për shkak se shumë shqiptarë të Kosovës kanë humbur shuma të konsiderueshme të parave dhe të kursimeve nëpër banka të ndryshme në ish-Jugosllavi, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se në vitet 1990 policia serbe në Kosovë, ndër shumë metoda të represionit bënte edhe konfiskimin e parave (*devizave*) – rrjedhimisht edhe atyre të cilët ktheheshin për vizitë nga mërgata. Si rezultat, është krijuar një praktikë e dërgimit të parave në kanale të tjera, pothuajse në mënyrë absolute përmes familjarëve, të afërmeve, shokëve dhe personave tjerë të cilët në kohë të ndryshme kanë shkuar për vizitë në familjet e tyre në Kosovë. Megjithatë, praktika e dërgimit të parave përmes kanaleve *joformale* ka ekzistuar edhe më parë, të paktën në kohën kur Janet Reineck ka bërë hulumtimin në Opojë, fundi i viteve 1980 dhe fillimi i viteve 1990. Reineck në studimin e saj, që ishte punim i doktoratës, përmend se është vështirë të përcaktohet shuma dhe rëndësia e remitencave për shkak se migrantët dërgojnë paratë përmes shokëve apo kur vijnë vetë në familje (Reineck 1991: 114). Bazuar në këto, sigurisht që vlera e remitencave është shumë më e madhe në krahasim me të dhënat zyrtare.

Roli i remitencave në ruajtjen e kohezionit social

Që nga vitet e 60-ta dhe të 70-ta, ekonomitë familjare në Kosovë në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë të varura nga remitencat (dërgesat e mërgimtarëve) e anëtarëve të familjes të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Kjo nuk do të thotë se para kësaj kohe nuk ka pasur emigrim. Përkundrazi. Janet Reineck (1991: 116-117) në kontekst të Opojës, migrimin për punë e ndanë në pesë faza: 1)

² World Bank Data, Kosovo, <http://data.worldbank.org/country/kosovo>.

Periudha e Perandorisë Osmane (1500-1900) – migrimi ka ndodhur brenda territoreve të perandorisë. Migrantët kanë qenë si barinj, shitës ose si gjellëbërës. 2) Periudha ndërmjet dy luftërave botërore, shtim i punëve si barinj profesionalë në vise malore të Greqisë, Maqedonisë, Shqipërisë, si dhe si gjellëbërës nëpër vende tjera të ish-Jugosllavisë. 3) Periudha pas Luftës së Dytë Botërore, nga vitet 1950, si punëtorë fizikë nëpër qytete veriore të ish-Jugosllavisë. 4. Migrimi “zyrtar” jashtë Jugosllavisë, vitet 1964-1973, duke emigruar në Evropën Perëndimore përmes kontratave me kompani të ndryshme. 5) Emigrimi i jashtëm ilegal nga 1975 deri në vitet 1990. Kjo fazë karakterizohet nga emigrimi pa dokumente, si punëtorë fizik.

Megjithatë, në këtë studim, fokusi është në emigrimet që nga vitet 1960, me destinacion vendet e Evropës Perëndimore. Një nga arsytet është se nëse para kësaj kohe ishte vetëm regjioni i Opojës i varur në të shumtën nga remitencat, periudha pas Luftës së Dytë Botërore, respektivisht nga vitet 1960, emigrimi në vendet perëndimore shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Kështu, për shkak të diskriminimit politik dhe ekonomik nga shteti jugosllav, për shqiptarët migrimi konsiderohej faktor jetik për mbijetesë. Jugosllavia socialiste nuk investoi si dhe sa duhet në ngritjen e kapaciteteve industriale dhe kështu Kosova nuk filloi procesin e industrializimit deri më 1957. Në këtë mënyrë, shteti “në vend se të promovonte format e zhvillimit të duhur për territorin me potencial më të shpejtë në rritje të forcës punëtore, ajo [Jugosllavia] u koncentrua në industritë për furnizim me lëndë të parë ose energji për përdorim tjetërkund në Jugosllavi” (Clark 2000: 37, shih gjithashtu Malcolm 1998: 323). Ndërsa sa i përket elitave politike dhe atyre që mbanin poste të larta publike, deri më 1978 asnjë shqiptarë nuk ishte në hierarkinë e lartë të Byrosë Politike dhe natyrisht nuk kishte një zgjedhje për një integrim të plotë të shqiptarëve në Jugosllavinë socialiste (Clark 2000: 37).

Deri diku dukej se gjatë viteve 70-ta shqiptarët do të përfitonin nga industrializimi, e që rrjedhimisht do të shfrytëzohej si alternativë për migrimin (ESI 2015: 4). Në këtë kohë arsimit, sidomos ai i lartë, filloi të shihej si një rrugë e mirë drejt një jete më të mirë dhe garanci për të ardhme të mirë ekonomike. Gjithashtu, me rritjen e kapaciteteve industriale dhe ekonomike në përgjithësi filluan të hapen vende të reja, ku edhe shqiptarët përfaqësoheshin deri-diku. Por kjo periudhë ishte afatshkurtër (ESI 2015: 4), fundi i viteve të 80-ta, ardhja e Millosheviqit në pushtet ndikoi që situata deri-diku të kthehej në atë pikë siç ishte para se të fillonte industrializimi. Madje të

përshkallëzohej deri në atë masë, që solli edhe largimin masiv nga vendet e punës në fillim të viteve 1990, e më pas edhe në luftë të armatosur në fund të po asaj dekade.

Shikuar në perspektivë të zhvillimeve socioekonomike dhe politike, përpara luftës së fundit (1998-99) dhe tërheqjes së forcave jugosllave (serbe) nga Kosova, një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës nuk e konsideronin shtetin ku jetonin si shtet i tyre. Natyrshëm mund të thuhet se edhe vetë shteti jugosllav i shihte shqiptarët 'me një sy tjetër', duke i trajtuar si qytetarë të dorës së dytë e të tretë. Edhe pse modernizimi socialist dhe industrializimi kanë pasur një ndikim në familje, megjithatë shqiptarët nuk janë ndikuar me të njëjtin intensitet nga ndryshimet socioekonomike ashtu si popullsitë tjera të ish-Jugosllavisë. Kjo nuk ishte si rezultat i rrënjës së thellë të patriarkalizmit dhe konservatizmit (Kaser 2008: 175), por për shkak të mungesës së entuziazmit të duhur për t'u integruar në institucionet e shtetit socialist. Në vend të punës në industri, shqiptarët e Kosovës më shumë preferonin emigrimin në vendet e Evropës Perëndimore ose për të punuar në bujqësi e blegtori.

Jo vetëm konditat politike dhe ekonomike ishin të veçanta për shqiptarët, por edhe arsyet e migrimit deri-diku kanë qenë të ndryshme në krahasim me ato të popullsive tjera brenda ish-Jugosllavisë. Janet Reineck (1991: 127), duke u bazuar në një studim të Dentich (1970) për arsyet e migrimit të popullsive në ish-Jugosllavi³ përmend se, për dallim nga të tjerat grupe, të cilat kanë qenë të motivuara jo thjeshtë nga nevojat ekonomike, por për të qenë pjesë e jetës urbane në rastin e shqiptarëve, migrimi pothuajse gjithmonë ka qenë për arsye ekonomike.

Sipas Reineck (1991: 143-144) në familjet tradicionale shqiptare (të Kosovës), strukturalisht komplekse, ku zakonisht jetonin në bashkësi të mëdha (shumë çifte jetonin në një kulm) kur dikush shkonte jashtë për të punuar, ai zakonisht konsiderohej se nuk shkonte për vetveten. Qëllimi ishte që përmes punës së tij dhe remitencave që sillte në Kosovë, të ndikonte në përmirësimin e kushteve dhe ngritjen e mirëqenies për kolektivin familjar. Jo vetëm në atë kohë, por edhe sot migrimi konsiderohet faktor i rëndësishëm në mbijetesën dhe ngritjen e mirëqenies së familjeve kosovare. Bazuar në të dhënat

³ Bette Denitch, Migration and network manipulation in Yugoslavia, in *Migration and Anthropology*, Robert Spencer (ed.), Proceedings of the Annual Meeting of the American Ethnological Society, Seattle: University of Washington Press, 1970.

empirike të mbledhura gjatë hulumtimit tim, pothuajse gati secila familje në Isniq, njëjtë siç mund të jetë edhe në vende të tjera, ka një apo më shumë anëtarë të familjes të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Në shumë raste komplet familjet jetojnë jashtë dhe kthehen vetëm një herë apo dy herë në vjet. Migrantët investojnë në ndërtimin e shtëpive të reja dhe në të shumtën e rasteve ata mbështesin rregullisht familjarët e tyre me financa.

Në anën tjetër, politikëbërësit në Kosovë që nga përfundimi i luftës nuk kanë hartuar politika favorizuese për të ngritur kapacitetet ekonomike në vend, kështu që ata në një farë mënyrë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë “të kënaqur me idenë e parave të dërguara nga emigrantet kosovarë nga diaspora, të cilat kanë mbajtur gjallë Kosovën rurale, me gjithë mungesën e politikave të besueshme bujqësore apo zhvillimore” (ESI 2006: 2). Për më tepër, remitencat e dërguara në dekadat e fundit “nuk kanë ndikuar në zhvillimin rural të Kosovës. Përkundrazi, ato thjesht kanë mbajtur *Status Quo*-në, duke ndikuar kështu në konservimin e institucionit më të vjetër dhe konservativ të Evropës: familjen ballkanase patriarkale” (ESI 2006: 2). Gjithashtu, nuk ka politika favorizuese për zhvillimin dhe rritjen e tregut të punës, respektivisht për investime në krijimin e bizneseve të reja, të cilat jo vetëm për anëtarët e familjeve të tyre, por në perspektivë të zbutjes së shkallës së lartë të papunësisë do të krijojnë edhe vende të reja të punës. Në anën tjetër, në vendet ku dërgohen remitencat mund të çojnë në një pabarazi në të hyra, e si pasojë rrit gjasat për migrim nga anëtarët e familjes të cilat deri në ato momente nuk kanë qenë të lidhur me emigrimin (Taylor 1999: 79-80). Një ndikim i tillë ka qenë edhe në rastin e shqiptarëve të Kosovës. Gjatë punës time hulumtuese në shumë raste është parë se si pasojë e pabarazisë në të hyra, të ndodhura si rezultat i remitencave, ka pasur një nxitje për migrim edhe nga të afërmit, në familje tjera të cilat deri në ato momente nuk kanë pasur askënd në emigracion (shih po ashtu Reineck 1991).

Në mungesë të shtetit të mirëqenies, rrjedhimisht lidhjet familjare dhe fafëfisnore janë të forta dhe në të njëjtën kohë përfshijnë një shkallë të lartë të solidaritetit familjar. Siguria sociale në Kosovë konsiderohet jo vetëm si çështje private (familjare), por gjithashtu edhe një obligim moral i anëtarëve të familjes. Indikatorët e tanishëm social dhe ekonomik në Kosovë ndikojnë që të ketë (ndër)varësi të secilit/secilës anëtarë/e të familjes dhe si pasojë kujdesi *brenda* dhe *ndërmjet gjeneratave* e mban familjen të pacenuar, duke ruajtur lidhjen ndërmjet gjeneratave dhe, në të njëjtën kohë, kohezionin e saj social. Për më

tepër, për shkak të dështimit të shtetit për të ofruar kujdes dhe siguri sociale e mirëqenie të mjaftueshme, kujdesi *brenda* dhe *ndërmjet gjeneratave* në të dyja drejtimet është elementi bazë që mban ekuilibrin e familjes dhe në të njëjtën kohë është njëri nga faktorët që i ‘detyron’ njerëzit të jetojnë në bashkësi (‘familje të mëdha’) (Latifi,2016).

Solidariteti brenda anëtarëve të familjes, vëllezërve, farefisit është shumë i organizuar dhe lidhja e gjakut në vetvete tregon se njerëzit janë shumë solidarë, thoshte Imeri (Isniq). Ai tregon se “ndihmë e pakompenzueshme para lufte e tash shumë më pak. P.sh. para lufte unë kur e kam mbaru shtëpinë, para lufte kur e kam qit plloqen, krejt argatë i kam pasur pa pare. Nuk i kam pasur vetëm të gjakut edhe shokë ka pas.” Megjithatë, shihet se ka raste kur ndihma brenda farefisit (në këtë rast vëllezërve) ende ekziston. Gjatë punës time hulumtuese në Isniq, një dukuri e ndihmës së tillë ishte edhe ajo ndërmjet vëllezërve, edhe pse ata ishin të ndarë. Agroni, një veteran i luftës së fundit (1998-99) kishte mbjellë një parcelë të madhe me molla. Në lidhje me mënyrën se si i ka mbjellë dhe nga i ka marrë financat, Agroni tregonte: “I kam mbjell 940 trupa pemë, krejt janë molla. Tash është viti i tretë, vitin e kaluar kanë prodhuar pak, por sivjet me shumicë. Më ka financu vëllai. Vëllezërit i kam në Zvicër. Jemi të ndarë me vëllezërit qe 10 vjet”. Këtë parcelë të mollëve ai nuk e kishte larg. “Mollat i kam të mbjellura te shpia, i kam të mbjellura edhe në tokë të vëllezërve. Si parcelë është 75 ari. Te shpia i kam vetëm 9 ari, e shfrytëzoj të 4 vëllezërve. Ne e kemi karakteristikë të vllaznit, se kush punon le ta mbajë.” Ky shembull tregon se ndihma e pakompenzueshme (altruiste) ndërmjet farefisit të ngushtë ende mbetet e fuqishme. Në të njëjtën kohë, ky shembull tregon për rolin e migrantëve në perspektivë të ngritjes së kapaciteteve biznesore familjare, që është edhe një faktor qenësor në ruajtjen e kohezionit social.

Kështu, marrëdhëniet familjare dhe farefisnore janë kryesore në përkatësinë e njeriut në një grup të caktuar dhe identitetit të tij social. Në këtë kontekst, “të dyja, altruizmi dhe reciprociteti luajnë rol të rëndësishëm në motivimin për ndihmë ndërmjet të afërmeve” (Heady, Kohli 2010: 21). Këta dy autorë thonë se reciprociteti nuk është kuptuar në një ndjenjë të thjeshtë “*tit-for-tat*”, “por më tepër si një obligim për të ndihmuar, nëse dikush mundet kur lypet nevoja.” Përtej kësaj, solidariteti duhet parë jo vetëm për sa i përket kontaktit dhe sa shpesh ai ndodh, por mbështetja praktike (direkte dhe indirekte) dhe mënyra e ndihmës luajnë një rol të ndryshëm, meqë aty ekzistojnë elemente që e formësojnë solidaritetin si të tillë.

Një analizë nga perspektiven *mikro* - katër shembuj si raste studimi

Me qëllim për të parë ndikimin direkt të remitencave në mirëqenien ekonomike në familjen shqiptare në Kosovë, tani do të analizoj katër raste, në katër familje në Isniq. Jo vetëm këto katër raste, por edhe tjetri më lart janë me emra anonim. Secili rast parqet modele të ndryshme të pranimit dhe shfrytëzimit të remitencave. Diku remitencat mund të konsiderohen si burime primare, diku suplementare. Kjo shpesh ndodh për shkak se jo vetëm që ka shkallë të lartë të papunësisë, por varësisht nga sektorët, sidomos në atë privat, pagat janë shumë të ulëta. Përveç sektorit privat, deri vonë edhe ai i arsimit ka qenë në gjendje jo të mirë, kështu që njerëzit gjithnjë janë në kërkim të burimeve shtesë. Për shembull, ka raste kur të punësuarit plotësojnë të hyrat e tyre me aktivitete të tjera ekonomike – bujqësore dhe blegtorale. Një rast i tillë është edhe ai i Muratit, mësues, të cilin e kam intervistuar në verë të vitit 2011. Deri një vit para vizitës time, ai jetonte në bashkësi familjare me vëllezërit e tij. Vëllezërit e tij jetonin jashtë dhe kështu ata nga kjo kohë kishin ndërprerë mbështetjen direkte financiare. Murati, përveç punës primare si mësues, punonte edhe në bujqësi. Në lidhje me punët suplementare që bënte, Murati ndër të tjera thotë: “Rrogat nuk kanë qenë të mira këtu. Vllaznit mi kanë ble do maqina, këtu me punu: kosë, grabuja, lidhëse të sanës (prese).” Ky shembull tregon se falë ndihmës dhe investimit nga vëllezërit e tij në makineri bujqësore, familja përdor burime të ndryshme të financave, në këtë rast edhe në bujqësi, madje edhe pasi familja në bashkësi të jetë ndarë.

Një tjetër shembull është ai i Ramës. Rama, një pensionist rreth të 70-ve, kishte pasur një karrierë të gjatë si mësues. Ai i kishte tre djem dhe katër vajza. Gjatë kohës sa kam bërë intervistën, viti 2011, ata ishin gjithsej 16 anëtarë të familjes. Gjysma e familjes së tij jetonin jashtë Kosovës. Dy djemtë e tij të martuar, së bashku me gratë dhe fëmijët e tyre jetonin dhe punonin jashtë Kosovës dhe praktikisht ata kishin dy familje nukleare atje. Djali i madh me familjen e tij të ngushtë jetonte me Ramën në Isniq. Këta të cilët jetonin në Kosovë përsëri kanë qenë të shpërndarë – pesë persona jetonin në Prishtinë, dy ishin studentë dhe një nxënës. Ky shembull tregonte për një model të familjes të shpërndarë në shumë lokacione, por që ende jetonin në një familje komplekse (bashkësi familjare). Edhe pse dy djemtë që jetonin në migracion kishin blerë edhe shtëpi atje, ata qëndronin të kontakt të vazhdueshëm me familjen e tyre në Isniq. Rama, ndër të tjera,

deklaronte se ata të cilët jetonin në Prishtinë “financiarisht janë të varur nga djemtë e mi që jetojnë jashtë.” Pavarësisht se ata ende pranonin remitenca, djali i tij, i cili jetonte me të në Isniq, punonte në bujqësi dhe po ashtu kishin tri lopë.

Si rast i tretë në këtë studim, për dallim nga tre të tjerët, ka të bëjë me një grua. Fetija, një grua gati në moshë të pensionit, në verë të vitit 2012 (në kohën e intervistës) ishte 64-vjeçare. Ajo jetonte në Isniq vetëm me mbesën e saj 12-vjeçare. Të gjithë fëmijët e saj jetonin në mërgatë, përveç Hysës (45), e cila ishte duke punuar si mësuese në shkollën e fshatit. Hysa ishte e martuar dhe ishte duke jetuar në një qytet jo larg Isniqit. Edhe burri i saj jetonte dhe punonte në mërgatë. Duke qenë se Hysa punonte në shkollë të Isniqit, mandej për shkak se burri i saj jetonte jashtë, ajo shumë shpesh vizitonte nënën e saj. Për më tepër, ajo thoshte se shumë shpesh qëndron te nëna. Meqë Fetija ishte 64-vjeçe, asaj i duhej edhe një vit për të arritur moshën e pensionit. Ajo thoshte se janë pikërisht vajzat e saj, të martuara e të pamartuara, që e mbështesin atë financiarisht. “Mua me mbajnë çikat më shumë. Ky i vogli është i harxhueshëm pak. Sa herë e merr rrogën çika [Hysa] mi jep 100 euro. Çikat tana më çojnë pare. Djemtë nuk më çojnë shumë.” Kjo situatë tregon se kujdesi ndërmjet gjeneratave në Kosovës është një element shumë i rëndësishëm në mirëqenien e familjes jo vetëm nga remitencat, por edhe nga të hyrat brenda Kosovës.

Për dallim nga të gjithë këta shembujt e trajtuar, rasti i katër, i fundit, është pak më ndryshe. Nëse në rastet e mësipërme, në të parin mësuesi punonte dhe me mbështetjen e dërgesave nga jashtë kishte blerë makineri bujqësore, që i ndihmonin të krijonte të hyra shtesë; mandej në rastin e dytë Remi, një pensionist, ku përveç një pensioni të vogël të tij, ai dhe familja ishin të varur në remitenca; rasti i tretë, Fetija komplet varej nga dërgesat e fëmijëve të saj nga mërgata, por edhe vajzës së saj mësuese; në rastin e fundit Masari, një i ri 36-vjeçar, me profesion jurist, për shkak të pamundësisë për të gjetur punë profesionale, ai jetonte i varur nga remitencat. Pra, në kohën kur e kam intervistuar (verë 2012), ai ishte i papunë. Ai, ndër të tjera, tregoi eksperiencën e tij dhe ndjenjën e të qenit i varur nga vëllezërit e tij të cilët punonin jashtë vendit: “Të gjitha burimet financiare janë ato të dërguara nga vëllezërit e mi. Ne e kemi po ashtu një lokal në Pejë, që e kemi leshu me qira. Kur mi dërgojnë të hollat, nuk e ndiej veten mirë që në këtë gjendje me i pranu t’hollat. Ndoshta do te duhej unë me i dërgu në familje të hollat. Baba është marrë me bujqësi. Për mua

nuk është gjendje e mirë me qenë pa pune, e me t'ndihmu dikush.” Masari nuk është se nuk e donte punën apo nuk kërkonte punë në profesionin e tij. Ai thoshte se vazhdimisht ishte në kërkim dhe kishte plotë raste që kishte aplikuar për punë në Pejë, në Deçan, në Gjakovë dhe Prishtinë, por deri atëherë nuk kishte asnjë rezultat. Një fakt interesant është se, siç edhe vetë e thoshte: “Kam qenë disa herë në intervista për pune, por kanë qenë vetëm formale. Diku në 16 vende kam konkurruar.” Kjo shprehje e tij tregonte për gjendjen reale në tregun e punës. Ai e kishte fjalën për atë se si pozitën ku konkurronte dhe thirrej në intervistë tashmë ishin të zëna, të paracaktuara për personat që kanë lidhje. Shfrytëzimi i lidhjeve për vend pune, nepotizmi dhe korrupsioni janë ndër faktorët kryesorë që e sfidojnë situatën aktuale sociale, ekonomike dhe politike në Kosovë. Një fat si të Masarit e ndajnë shumë njerëz në Isniq, sidomos të rinjtë.

Në anën tjetër, sipas një studimi të bërë nga UNDP rreth migrimin në raport me zhvillimin në Kosovë, shihet se çdo i katërti kosovar jeton jashtë vendit. Derisa në perspektivën *mikro*, në bazë të të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, shumica e popullsisë në Isniq është e varur financiarisht nga persona të tjerë. Nga kjo, 8.5% janë të varur direkt nga remitencat, derisa 54.8% në burime të tjera dhe remitenca. Në total, 63.3% janë financiarisht të varur nga të tjerët. Prej 54.8% që ishin të mbështetur nga persona të tjerë (duke përfshirë remitencat), 31.2% ishin gra, ndërsa vetëm 23.7% ishin burra. Në anën tjetër, në kategorinë e atyre të cilët pranojnë remitenca nga jashtë (8.5%), 4.8% janë gra dhe 3.9% burra. Bazuar në të dhënat për këto dy grupe e më pas duke krahasuar në aspektin gjinor, një dallim i madh qendron në të parin. Meqenëse numri i të punësuarve⁴ ishte shumë i ulët, ngjashëm si në tërë Kosovën, të gjitha familjet, pavarësisht gjinisë, normalisht se do të jetë i varur nga të tjerët, respektivisht nga remitenca. Në një shoqëri ku sfera publike është e dominuar nga burrat dhe ku numri i grave të punësuar është shumë i ulët, gratë do të jenë në masë të madhe të varura nga burime të tjera ekonomike, në remitencat e dërguara nga burrat.

⁴ Nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 në Isniq 742 persona ishin të punësuar, ndërsa numri i përgjithshëm i banorëve ishte 3.871.

Përfundimi

Nëse shikojmë në retrospektivë, nga vitet 1960, kohë kur shqiptarët për shkak të gjendjes së vështirë politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë filluan ta shohin migrimin si një alternativë për një jetë më të mirë, shohim se nga atëherë shumë gjëra kanë ndryshuar. Në kuadër të këtyre ndryshimeve duhet futur shumë faktorë të cilët në një formë apo tjetër kanë qenë të lidhur me njëri-tjetrin, por edhe ka raste kur një faktor apo ngjarje ka determinuar ndryshimin e tjetrit. Secila fazë e migrimit ka qenë e ndikuar nga ndryshimet jo vetëm në politikat e migrimit të shteteve të cilat kanë qenë destinacion për emigrantë, por edhe arsyet e migrimit të shqiptarëve të Kosovës janë ndikuar nga situata politike në Kosovë.

Ajo që nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë (vitet 1960) është se migrimi dhe remitencat vazhdojnë të jenë një element i paevitueshëm i sigurisë sociale dhe një faktor i rëndësishëm për të ruajtur kohezionin social. Remitencat luajnë një rol të rëndësishëm në uljen e shkallës së varfërisë, ruajtjen e ekuilibrit ekonomik dhe social, si dhe në një nivel të caktuar ofrimin e sigurisë dhe mirëqenies sociale. Në këtë mënyrë, migrimi dhe remitencat mbajnë familjen tradicionale të pacenuar. Indikatorët socialë dhe ekonomikë tregojnë se pritjet për një përmirësim të gjendjes aktuale socioekonomike janë pothuajse të kota. Normalisht, ekzistojnë shumë faktorë që e determinojnë një situatë kaq të pashpresë në aspektin ekonomik dhe të mirëqenies. Përveç nivelit të paaftësisë dhe neglizhencës politike dhe ekonomike të qeverive të Kosovës së pasluftës, një mori faktorësh të tjerë duhen konsideruar. Kjo gjendje e rëndë ekonomike dhe sociale i ka rrënjët e saj po ashtu në konditat politike dhe socio-ekonomike të ambientit mbizotërues patriarkal në familjen dhe shoqërinë shqiptare të Kosovës, por edhe si rezultat i diskriminimit të gjatë ekonomik dhe politik në ish-Jugosllavi.

Për shkak të paaftësisë së shtetit për të siguruar mirëqenie sociale për qytetarët e tij, së pari është familja dhe të afërmit që ofrojnë sigurinë sociale, veçanërisht për të moshuarit dhe të sëmurët, për ata të cilët janë të paaftë të krijojnë të hyra, si dhe për anëtarët e familjes që janë të papunë. Ky dështim në anën e shtetit i detyron njerëzit të ruajnë relacione të forta farefisnore dhe të kenë solidaritet reciprok brenda dhe ndërmjet gjeneratave. Me këtë rast reciprociteti nënkupton që prindërit kujdesen për fëmijët e tyre dhe mbështesin ata

në shkollim, për martesë dhe derisa të gjejnë një punë. Në anën tjetër, pasi prindërit të pensionohen, fëmijët e tyre ndihen të obliguar të kujdesen për ta.

Në fund, ky punim është vetëm një kontribut modest për rolin e remitencave në ruajtjen e kohezionit social. Kjo është në temë mjaft komplekse dhe rrjedhimisht mbetet shumë për t'u thënë e për t'u bërë, por në ndonjë studim tjetër, ndër të tjera, do të bëhej ftesë për diskutim dhe do të shtroheshin pyetje të tilla si: Çka do të ndodhte nëse në ndonjë kohë apo rrethanë do të ndaleshin remitencat? Dhe në rast se remitencat do të ndaleshin, a do të mbetet familja dhe kohezioni i saj social i pacenuar?

Bibliografia

- [1] Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) 2017b: *Anketa e fuqisë punëtore 2016*. <http://ask.rks-gov.net/media/3229/afp-2016.pdf> (shikuar korrik 2017).
- [2] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) 2013: *Studimi mbi remitencat në Kosovë*. <http://ask.rks-gov.net/media/1711/remitenat-2013.pdf>.
- [3] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) 2016: *Gratë dhe burrat në Kosovë 2014-2015*. <http://ask.rks-gov.net/media/2581/grate-dhe-burra-shqip-2014-2015.pdf> (shikuar në korrik 2017).
- [4] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) 2017a: *Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015*. <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf> (shikuar korrik 2017).
- [5] Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) 2017: *Raporti vjetor 2016*. http://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK-RV-2016_shqip.pdf (shikur në korrik 2017).
- [6] Clark, Howard 2010: *Civil resistance in Kosovo*, London, Pluto Press.
- [7] Enti i Statistikave të Kosovës (ESK) 2002: *Statistikat e bujqësisë në Kosovë 2001*. <http://ask.rks-gov.net/media/3141/statistikat-e-bujqesise-2001.pdf> (shikuar korrik 2017).
- [8] Glaser, Barney G. and Strauss, Anselm L. 1967: *The discovery of grounded theory. Strategies for qualitative research*, New York, Aldine.
- [9] Heady, Patrick and Kohli, Martin 2010: 'Introduction: towards a political economy of kinship and welfare', in Patrik Heady and Martin Kohli (eds.), *Family, kinship and state in contemporary Europe. Perspectives on theory and policy*, vol. 3, Frankfurt M.-New York, Campus, p. 15-30.
- [10] Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) 2006: *Prerja e kordonit të jetës. Emigrimi, familjet dhe e ardhmja e Kosovës*. Berlin – Stamboll.
- [11] Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) 2015: *Pse Kosovës i nevojitet migrimi?*, Berlin – Prishtinë.

-
- [12] Kaser, Karl 2008: *Patriarchy after patriarchy. Gender relations in Turkey and in the Balkans, 1500-2000*, Vienna, LIT.
- [13] Krasniqi, Mark 1979: 'Familja e madhe patriarkale shqiptare në Kosovë' [Large Albanian patriarchal family in Kosovo], in Mark Krasniqi (ed.), *Gjurmë e gjurmime. Studime etnografike*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, p. 197-237.
- [14] Latifi, Tahir 2016: 'Poverty and social security from the perspective of post-war political, societal and family transformations in Kosovo: Macro- and Micro-Level points of view', *Ethnologia Balkanica*, vol. 18, 249-268.
- [15] Leutloff-Grandits, Carolin and Pichler, Robert 2014: 'Areas blurred: Albanian migration and the establishment of translocal spaces', in Christian Promitzer, Siegfried Gruber and Harald Heppner (eds.), *Southeast European studies in a globalizing world*, vol. 16, Vienna, LIT-Verlag, p. 173-187.
- [16] Malcolm, Noel 1998: *Kosovo. A short history*, London, Macmillan.
- [17] Reineck, Janet 1991: *The past as refuge. Gender, migration, and ideology among the Kosova Albanians*, Berkeley, University of California, PhD-thesis.
- [18] Taylor, J. Edward 1999: 'The new economics of labour migration and the role of remittances in the migration process', *International Migration*, vol. 37/1, 63-88.
- [19] UNDP 2012: *Kosovo human development report 2012. Private sector and employment*. <http://hdr.undp.org/sites/default/files/khdr2012-eng.pdf> (shikuar në korrik 2017).
- [20] UNDP 2014: *Kosovo human development report 2014. Migration as a force for development*, Prishtine, UNDP and Swiss Cooperation Office Kosovo, <http://hdr.undp.org/sites/default/files/khdr2014english.pdf> (shikuar në korrik 2017).
- [21] Vertovec, Steven 2009: *Transnationalism*, Routledge, London and New Yourk.

Muhamedin Kullashi, Prishtinë

LINDJA E VETËDIJES MODERNE TE MONTAIGNE DHE SHAKESPEARE

Abstrakti

Disa kritikë letrarë bashkëkohorë, francezë e anglezë, origjinën dhe evoluimin e vetëdijes mbi vete moderne e kanë hetuar të zhvillohet në shkrimet sa letrare, aq edhe filozofike të Michel de Montaigne (1533-1592), si dhe brenda poetikës së Shakespeare-it (1564-1616) në kohën e Rilidjes (Renesancës), kohë e quajtur nga anglosaksonët early modern. Problematizimi i “vetes” shpalolet përmes ndriçimit të anëve të ndryshme të saj brenda lëvizshmërisë së tyre në dimensionin kohor. Montaigne me shikimin e vet vrojtues mbi veten synon të depërtojë te thellësitë e errëta të shtresave të saj të brendshme, të ndriçojë veten të kapërthyer nga të gjitha kundërthëniet, si dhe mospërputhjen e vetes me vetveten. Refleksiviteti për individualitetin empirik dhe identitetin personal ndriçon si një skenë të teatrit ku zhvillohet një fluks i ideve dhe mbresave, ku perceptimet e ndryshme hyjnë njëra pas tjetrës, kalojnë, rikalojnë, ikin dhe përzihen brenda një varieteti të pafund të figurave dhe situatave. Montaigne, duke ndriçuar transformimet e vetes shkruante: “Unë tremem dhe i iki vetes”. Nietzsche, sipas Brendan Donellan, në tekstin e tij Nietzsche dhe Montaigne, shkruante se Montaigne ishte “iniciator i një lëvizjeje për çlirimin e mendimit, kurse Shakespeare vetëm ishte frymëzuar prej tij me një qasje artistike.” Në këtë kumesë do të orvatemi të vëmë në pah edhe originalitetin e pikëpamjes së Shakespeare mbi veten në poetikën e tij, në disa sonete dhe tragjedi.

Zbulimi i ndërlikueshmërisë dhe ndryshimësive të vetes te Montaigne dhe Shakespeare do të ndikojë te rryma letrare e filozofike të mëvonshme. Disa prej tyre, që e zhvillojnë edhe më thellë “rrjedhën e vetëdijes”, do të shpiejnë te tema e zhdukjes së subjektit.

Në shkrimet e Montaigne (Montenjiti) dhe Shakespeare (Shekspirin), Ellrodt vë në pah paralajmërimin e problematizimit të identitetit personal nga rrymat filozofike e letrare, refleksivitet ky që e bën çështje natyrën e madje edhe vetë ekzistencës e një «vete»¹.

¹ Robert Ellrodt, *Montaigne et Shakespeare. L'émergence de la conscience moderne*, Editions José Corti, Paris, 2011, f.13.

Në esenë mbi «paqëndrueshmërinë e aksioneve tona», ku njeriu del i kapërthyer nga të gjitha kundërthëniet, Montaigne e përshkruan veten kështu: «I turpshëm, i pafytyrë; i pastër, i shfrenuar; llafazan, heshtak;...inteligjent, i trashë; i dijsëm, injorant, gjeneroz e koprrac...; çdonjëri që e hulumton veten e vet me kujdes heton brenda vetes e madje edhe te gjykimet e veta këtë lëvizshmëri dhe këtë mospërputhje. Asgjë nuk mund të them për veten time në tërësi, thjeshtas, të qëndrueshme, pa konfuzion e pa përzierje, asgjë me një fjalë»².

Në një ese tjetër, «Vaniteti», Montaigne shkruan: «Unë në këtë moment dhe unë më vonë jemi qartazi dy». Ellrodt vë në pah se Montaigne në këtë shkrim kap me të njëjtin shikim aspekte të ndryshme të vetes thujse këto lëvizje të shpirtit ishin po aq mundësi që i paraqiten vetëdijes në të njëjtin moment»³.

Montaigne, me shikimin e vet vrojtues mbi veten, që synon të depërtojë te thellësitë e errëta të palëve të veta të brendshme, arrin në një fazë të parë të ndriçojë “shpërbërjen e vetes”⁴. “Në çdo minutë më duket se i iki vetes». Ai shfaq kështu ndjesinë se është i bartur kah shpërbërja e qenies së vet të vetëdijshme. Vizioni heraklitian fiton këtu një kuptim të ri nëpërmjet përshkrimit të peizazhit të brendshëm. Montaigne nxjerr në shesh se ai nuk është i shpërqendruar vetëm nga ndodhitë e jashtme, por edhe nga ndryshimësitë e vetes. «Jam i kapluar edhe nga aksidentet e brendshme, të ndryshme e të lëvizshme dhe të përfytyrimeve të paqarta e të kundërta: qoftë pse jam tjetër nga që jam, qoftë pse i kapi çështjet brenda rrethanave dhe pikëshikimeve të tjera...» (*Ese*, III, I). Ellrodt nënvizon se Montaigne na ofron kuptimin e thellë të titullit që ka zgjedhur: *Ese*-të, janë vetë Montaigne i cili provon veten, i cili provon (vë në sprovë) mundësitë e veta në mënyrë që ta zbulojë veten në këtë “regjistër të eseve të jetës së vet” (III, XIII). Të cekim këtu se Kanti në “Ide e një historie universale” e definon mendjen përmes aktit të *provimit* dhe *ushtrimit*; ajo bëhet përmes këtyre akteve, duke u ngritur nga një nivel te tjetri.

Ndërkaq, Montaigne këtë kërkim të “vetes» të pasigurt dhe që i ikën vetes synonte ta ndjek deri te çastet e fundit “thujse shpresonte ta kapë sërish identitetin e vet brenda vetë vdekjes”⁵. Vetëdija mbi veten (*angl. Self-consciousness*, *fr. conscience de soi*), ka këtu një kuptim të veçantë për të emërtuar një aftësi për të menduar dhe ndjerë

² Michel de Montaigne, *Essais*, Gallimard, Paris, f.414.

³ Po aty.

⁴ Ellrodt, f.14.

⁵ Po aty, f.15.

gjithnjë duke u vënë njëherazi në distancë nga vetja ime⁶.” Ne jemi, shkruan Montaigne, të dyfisht brenda vetes sonë, gjë që bën se kur ne besojmë diçka, në fakt nuk e besojmë këtë”(II, XVI).

Për Ellrodt-in vështrimi i Montaigne-it për fluksin e ideve dhe mbresave paralajmëron konceptimin e teatrit të frymës, i paraqitur nga Hume në *Shqyrtimin mbi natyrën e njeriut*: “Fryma është një lloj teatri, ku perceptimet e ndryshme hyjnë njëra pas tjetrës, kalojnë, rikalojnë, ikin dhe përzihen brenda një varieteti të pafund të pozicioneve dhe situatave. Brenda frymës nuk ka në fakt *thjeshtësi* në një moment të caktuar e as identitet në momente të ndryshme, çfarëdo tendence të natyrsme që ne mund të kemi për të imagjinuar këtë thjeshtësi dhe identitet⁷”.

Kjo analizë e shpie Hume-in te përfundimin se “vetja” është një iluzion.

Ndërkaq, Bernard Brugière (Bryzhier), kritik letrar francez, në artikullin “Aspekte të vetëdijes mbi veten në romantizëm”, vë në pah se “egocentrizmi romantik, duke u shpalosur përmes formave dhe manifestimeve të ndryshme, përgatitë rrugën “e këtij destrukurimi të subjektit që do ta realizojnë Nietzsche dhe psikanaliza, e që tani i takojnë modernitetit.” Ky autor shton se një personazh romantik, i brejtur nga melankolia, përjeton “pamundësinë gati sartriane të koincidencës me veten”. Ellrodt mendon se një “irritim i thellë i vetërefleksionit e kishin shtyrë, më vonë, Lacan-in dhe Derrida-n të mohojnë ekzistimin e një “vete”⁸.

Mirëpo këtë tendencë Ellrodt-i e dikton më parë te shkrimtari zviceran Amiel, në *Ditarin* e tij intim (sh. XIX). Derisa disa kritikë kanë vlerësuar se këtu bëhet fjalë për triumfin e vetes, Amiel shkruan “Gjendjet e mia të mëparshme shpirtërore, konfigurimet dhe metamorfozat më ikin si aksidente kalimtare. Këto më janë bërë të huaja, objekte kureshtjeje, të soditjes apo të studimit;[...] unë jam një fleksibilitet që bëhet më fleksibël, një mohim i mohimit dhe një refleksion që reflektohet si dy pasqyra njëra përballë tjetrës”. Këtij fleksibiliteti, që e hetoi Montaigne, i shtohet tani metafora e pasqyrave që ia përcjellin njëra-tjetrës të njëjtin imazh, metaforë kjo që do të përdoret nga poeti Valéry, por edhe nga shkrimtari e filozofi Sartre për të cilësuar *vetreleksivitetin*. Kësisoj, Amielit vetja i duket “si një vend

⁶ Po aty, f. 17.

⁷ Po aty, f.18.

⁸ Po aty, f.19.

i vizionit dhe preceptimit, si person jopersonal, si një subjekt pa individualitet të caktuar...”⁹. Kjo “zhdukje, siç shkruan ai, e të gjitha fenomeneve brenda substancës (sic?) së vetes dhe uni-t brenda zbrazëtisë” e shpie te një përfundim i ngjashëm me atë të Valéry-së: “Një hiç (mosqenie) që e heton veten, ky është mendimi i pastër”.¹⁰

Romansierët bashkëkohorë, sipas Ellrodt-it, sikurse Montaigne më heret, në saje të vrojtimit të brendshëm e bëjnë çështje unitetin dhe qëndrueshmërinë e vetes nga çasti kur romani do të kapë një “miliard mbresash që e sulmojnë frymën (mendjen) nga të gjitha anët si një shi i pareshtur i atomeve të panumërta”, siç shkruante Virginia Wolf (te *Dhoma e Jakobit* apo edhe te *Valët*.); personazhet e paqarta në romanet e saj kanë ndijmësinë se realiteti i vetes reduktohet në një shumësi difuze të mbresave.¹¹

Elrodt-i cek po kështu se Nietzsche, i cili kishte një admirim për *Ese*-të e Montaigne-it dhe një vizon të përbashkët heraklitian mbi botën, pati vënë theksin te *shumësia* e vetes: “Ne përmbajmë në vete, shkuan Nietzsche (Niçe), *projektin* e shumë personave. Rrethanat janë ato që nxjerrin prej tij *një* figurë të vetme. [...] ky “karakter” që ne besojmë se është i patjetërsueshëm, konstant, [...] s’është veçse njëri nga personazhet që janë po aq të mundshme sa edhe të huaja; njëra nga maskat që ne do të mund të përdornim”¹². Ndërkaq kritikë letrar Brendan Donellan, në tekstin e tij *Nietzsche dhe Montaigne*, thekson se për Nietzsche Montaigne ishte iniciator i një lëvizjeje për çlirimin e mendimit, kurse Shakespeare vetëm është frymëzuar prej tij me një qasje artistike¹³.

Elrodt mendon se Montaigne në *Ese* e ka hapur rrugën e shpërbërjes, por kjo shpërbërje ishte vetëm fillestare, sepse në tekste të tjera në *Ese* krahas jostabilitetit të vetes ai njëherësh afirmon edhe permanencën e tij. Kësisoj Elrodt do të bëjë përpjekje të nxjerrë në shesh sa tretjen, aq edhe *qëndrueshmërinë* dhe koherencën e “vetes”.

Ndonëse ndonjëherë e ka vënë në pikëpyetje stabilitetin dhe unitetin e vetes, Montaigne, sipas Ellrodt-t, megjithatë nuk e ka shpallur mosqenien e tij apo shpërbërjen e tij. Shkrimtari André Gide (Zhid) pati theksuar se Montaigne në *Ese* nuk absorbohet brenda vetes si Amiel-i në *Ditarin* e vet, ngase i pari komunikon me botën e

⁹ Po aty, f.20.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, f.21.

¹² Po aty, f.21.

¹³ Po aty, f.38.

jashtme dhe njerëzit tjerë, kurse te i dyti, subjekti, i ndarë nga realiteti objektiv, humbaset brenda një loje të pasqyrimeve¹⁴. Gerard Nakam, kritik letrar, pati vënë në pah se për Montaigne Komuna e Bordosë ishte vend i çmuar në *Ese*; ai shkruante se “Montaigne zbuloi veten e vet përmes aksionit politik (si dhe gjetiu)”; për Ellrod-in këtë vete ai e zbuloi më thellësisht përmes shkrimit. Ndoshta mund të themi edhe ndërveprimi i këtyre dyjave si dhe refleksionet për to. Me përshkrimin e trupit të vet, vëmendjen për të, në situata të ndryshme Montaigne po kështu mban lidhjen e vetes me objektivitetin, ai realizon lidhjen midis subjektives dhe objektives dhe kësaj arrin të sajoi identitetin e personit të vet. Jean Starobinski, autor bashkëkohor, e paraqiste Montaigne-in si “një trup i tërë i angazhuar ta dëgjojë veten si jeton, i ndryshëm nga vetja, por i tendosur kah vetvetja»¹⁵. Ndërkaq, si shihet nga *Ese*-të, Montaigne e shikon “veten” si e diç e paqëndrueshme, e pakapshme, si një rrjetë me kundërthënie.

Pikërisht në çastet kur ai orvatet ta shkoqisë veten “drejtpërsëdrejti”, “vetja» i duket e shumëfishtë apo e ndryshueshme. Paqëndrueshmërinë brenda shpirtit të vet, ai e shpjegon me një përzierje të “disponimeve të kundërta”. Mirëpo Montaigne njëherësh nënvizon domosdonë që t’i zotërojë shtytjet e veta, t’u japë kahje tjetër (III, iii), gjë që supozon ndërhyrjen e vullnetit, “Pasi që nuk mund t’i rregulloj ngjarjet, e rregulloj vetveten”(II, XVI), prandaj del në shesh dallimi midis “vetes” (*moi*) dhe “unit”. Është uni (*je*) ai që thotë: “Une s’kam veç veten si cak i mendimeve të mia” (II,VI)¹⁶. Ky un nuk është vetëm uni i të shprehurit (enonciation), uni i Benvenistit i cili e redukton subjektin në një “komoditet te sintaksës”. Ellrodt thekson se te Montaigne “je” (uni) është njëherazi vetëdije dhe pushtet (fuqi), pushtet për të drejtuar vëmendjen e tij, për të zgjedhur pikëshikimin e tij, për ta ndërruar një tendencë, të modifikojë një emocion.

Donald Frame ka analizuar “dialogun e Montaigne-it me aftësishtë e tij, duke theksuar se çdonjëra prej tyre, sikurse edhe shpirti në tërësi, janë qartazi të dalluara nga “je” dhe i nënshtrohen këtij”. Ellrodt përkujton se për Castoriadis-in, *Ich*, Uni (*Je*) i vetëdijshëm, është i cilësuar me një fuqi të vetërefleksivitetit i cili ndryshon aktivitetin e subjektit në objekt; vetëm subjekti i vetëdijshëm mund të thotë “unë e bëjë veten të veproj si aktivitet veprues”.¹⁷

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty, f. 23.

¹⁶ Po aty, f.25.

¹⁷ Po aty, f.26.

Sipas kritikut Geoffrey Miles, Montaigne ka ditur të bashkojë “një ideal të koherencës së vetes» me pranimin e diversitetit dhe ndryshimit”.¹⁸

Ellrodt shoshitë fragmente nga *Ese*-të, ku Montaigne pasi kishte zhvilluar hollësisht konceptin për “paqëndrueshmërinë e aksioneve tona”, merr në shqyrtim tekste ku brenda vetes shpërfaqet një qëndrueshmëri, në saje të përpjekjeve të vullnetit, qëndrueshmëri e shtytjeve natyrore, me gjithë presionet që mund të vijnë nga institucionet. Ai pohon se individi ka aftësi të luajë role të ndryshme në jetën shoqërore, por kjo nuk implikon mosqenien e personalitetit, që ka tiparet e veta të mëvetësishme.¹⁹

Nakam, ndërkaq, vë në pah se si Montaigne projektohej në shkrimet e veta te personazhe të tjera, te ato nga kultura greko-romake, sidomos te Pironi, Alkibiadi, Sokrati, por pa e harruar mëvetësinë e vetes së vet, të personalitetit të vet. Në anën tjetër Starobinski përshkruan “transferin progresiv kah shkrimi, kah libri, imazhi për ta fiksuar identitetin e vet” personal, detyrë kjo për të sa morale, aq edhe artistike.²⁰

Në saje të krahasimit të teksteve nga *Ese*-të, Ellrodt vë në pah se Montaigne, ndonëse zbulon brenda vetes rrjedhën heraklitiane, njëherazi përkujton ekzistimin e formave fikse të vetes, veten e cila nuk reduktohet, megjithë ndryshimet në “zhdukjen e formave fenomenale”²¹.

Kur Montaigne thekson se ai dëshiron të kultivojë “një formë të jetesës së lirë dhe krejt të kundërt me atë që disa duan t’ia imponojnë dikujt”, e ka fjalën për “format e vetë të të jetuarit qoftë në gjendje të sëmurë, qoftë në gjendje të shëndetit të mirë”.²² Ai theksonte edhe se “unë jam vetë materia e librit tim”, duke pasur parasysh një formë individuale të të jetuarit, e cila i reziston presioneve të “institucionit”, do të thotë edukimit (modeleve të paracaktuara) dhe shoqërisë.

Montaigne cek po ashtu se “çdo njeri, nëse e dëgjon vetveten doemos do të zbulojë brenda vetes një formë të veten kryesore, e cila lufton kundër institucionit dhe kundër shtrëngatës së pasioneve që i ka

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, f.27.

²⁰ Po aty, f.29.

²¹ Po aty, f.30.

²² Po aty, f. 31.

të kundërta. Vetën time nuk e ndjej të tronditur nga goditjet, e gjej veten gati çdo herë në vendin tim...” (III, II).²³

Ellrodt vë në pah se Montaigne në shkrimet e veta kishte insistuar te karakteri unik i çdo individit. Në një ese ai shkruante: “Kurrë nuk pati në botë dy opinione të njëjta e as dy qime të njëjta apo dy fara të njëjta. Cilësia e tyre më universale ishte diversiteti»; kurse gjetiu: “Shpirtërat më të bukur janë ato që kanë më shumë llojshmëri dhe elasticitet». Më pastaj në një fjali të njohur, e të cituar shpesh, ai thotë: “Çdo njeri bart në vete tërë formën e gjendjes njerëzore” (III, ii), pra kjo gjendje përmban në vete të gjitha mundësitë që i ofrohen çdo njeriu.²⁴

Ellrodt mendon se kritiku E.J. Lowe ka të drejtë kur thekson se vetja nuk është vetëm një tufë e perceptimeve të ndryshme, apo se subjekti s’është veçse një iluzion. Ai përfundon këtë pjesë të shqyrtimeve të veta duke gjetur mbështetje edhe te koncepti i Paul Ricoeur në *Koha dhe rrëfimi*: “Historia e rrëfyer tregon atë *kush* të aksionit”, pra një identitet narrativ. Pa ndihmën e narracionit problemi i identitetit personal mbetet në fakt i kapluar nga antinomia pa zgjedhje: ose shtrajmë subjektin si identik me vetën në diversitetin e gjendjeve të veta, ose konsiderojmë, në vijimësi me Hume dhe Nietzsche, se ky subjekt s’është veçse një iluzion substancialit [...]. Dilema hiqet nëse identitetin e kuptuar si një i njëjtë (*idem*) e zëvendësojmë me identitetin e kuptuar si një vet-vete (*soi-même, ipse*); dallimi midis *idem* dhe *ipse* s’është veçse dallimi midis një identiteti substancial apo formal dhe identitetit narrativ”.²⁵

Ky interpretim i Ricoeur-it sipas Ellrodt-it është i afërt me konceptin e Montaigne-it për “subjektin”, me të cilin konstituimi i vetes nëpërmjet shkrimit dhe me modifikime të njëpasnjëshme kuptohet si një operacion narrativ që ka mund të sugjerojë një *ipse* që ka një “unë”(je) pak a shumë konstant.²⁶

Këto shqyrtime mbi Montaigne-in dhe Shakespeare-in, Ellrodt-i i vendos brenda një projekti më të gjerë, ku ka synuar të gjurmojë evoluimin e subjektivitetit në botën perëndimore.²⁷

²³ Po aty.

²⁴ Po aty, f.32.

²⁵ Po aty, f.33.

²⁶ Po aty, f. 33.

²⁷ Po aty, f. 34.

Aspekte të reja të subjektivitetit të Shakespeare-i

Për evoluimin e subjektivitetit para Montaigne-it dhe Shakespeare-s, Ellrodt është skeptik dhe këtë qëndrim të vet e mbështet te pikëpamjet e disa kritikëve letrarë anglezë e francezë që merren me mesjetën. Qëndimin e vet për veten dhe subjektivitetin ai e ndërton edhe nëpërmjet analizave të autorëve të tjerë. Kësisoj, në shqyrtimet e André Crépin-it në *Gjeneza e vetëdijes moderne* ai dikton se vetëdija për vete në *Beowulf*, *legjenda vikinge* (një film për këtë temë në vitin 2005) reduktohet në një vetëdije heroike, e drejtuar kah aksioni, ose imitimi i një modeli, ku mungon introspeksioni. Kurse nga fundi i shekullit XVI hetohet në shkrimet letrare kërkimi i një origjinaliteti individual, një afirmim i vetes, “self-assertion”.

Kësisoj, Joel Finneman, lakonian e fukaldian në një analizë për veten (*moi, self*) të *Sonetet* të Shakespeare-it gjen “manifestimin e një ndryshimi të *epistemes* (si formë e dijes dhe e kulturës, që cilëson një epokë: rilindjen, kohën klasike dhe atë moderne) dhe paraqitjen e një forme të re të subjektivitetit”, madje para Saussure-it “një shkëputje midis ligjërit dhe botës”. Këto sonete për të janë një ligjërim i gjuhës e jo i syrit: ndryshe nga imazhi, fjalët aty janë thelbësisht në *shpërputhje* me atë për çka flasin, prandaj mospërputhja midis shenjuesit dhe referentit (të shenjuarës) gjen shprehje edhe te loja e fjalëve që bën Shakespeare në njërin nga sonetet (nr. 152) midis “I”uni dhe “eye” syri. Për Finneman vetëdija për këtë shpërputhje ka hapur rrugën kah “subjektiviteti poetik modern”.²⁸ Refleksiviteti ironik gjen shprehje edhe në disa sonete tjera me temën e vetëmashtrimit (*self-deception*, në forma të ndryshme), vetëdija se vetë folësi e mashtron veten.²⁹

Ellrodt në këtë hulumtim vë në pah se introspeksioni të Shakespear-i paraqitet së pari në disa monologë, në komeditë e para si *Dy fisnikët e Veronës* dhe *Komedia e gabimeve* (1590). Mirëpo sidomos tragjeditë janë vepra ku shpërfaqet më thellësisht evoluimi i subjektivitetit. Kësisoj të Riçardi III vërehet një distancim që merr trajtën e një projekcioni të vetes e jo të kthimit kah vetvetja³⁰. Në monologun e tij të fundit, i mallkuar në një ëndërr nga fantomët e viktimave të veta, Riçardi, pasi të jetë zgjuar, duket se së pari shpreh

²⁸ Po aty, f.96.

²⁹ Po aty, f. 97.

³⁰ Po aty, f. 117.

ankthet e veta përmes një vargu të persiatjeve spontane, përmes një përvoje përbrendësisht të përjetuar që shpie te alegoria e “një vetëdije me një mijë gjuhë të ndryshme”.³¹

Ellrodt megjithatë mendon se thellimi i jetës së brendshme nuk arrihet as te tragjedia Riçardi II (1595).

Ndryshe nga John Dryden, vijues i Shakespeare-it, i cili mendonte se “Shakespeare u ka siguruar personazheve të veta një konformitet konstant me vetveten, që nga fillimi i pjesës teatrale e deri te përfundimi i saj”, dhe ndryshe nga filozofi Colin McGinn, i cili në veprën *Filozofia e Shakespeare-it* (2006, New York) cek se personazhet e Shakespeare-it s’kanë veçse “identitete fluide”, Ellrodt orvatet që në analizat e veprave të poetit të madh anglez të vë në pah sa kompleksitetin e personazheve kryesore, ndryshimësinë e diversitetin e tyre, aq edhe tiparet e qëndrueshme të çdonjëri prej tyre.³²

Tragjedia *Hamleti*, sipas tij, është vepër ku shpërfaqet më shumë e me thellë kompleksiteti dhe kundërthëniet e brendshme të personazheve. Brian Vickers gjen te Hamleti “praninë e elementeve të papajtueshme³³». Ndërkaq, Alastair Fowler zhvillon interpretimin se “gjithnjë duke pranuar aspekte të shkapërderdhura të karakterit të tij, larg asaj që të dezintegrojnë individualitetin e Hamletit, ato nuk pengojnë sintetizimin e subjektiviteti i tij si njeri i Renesansës”. Kurse për kritikun letrar Harold Bloom enigma e Hamletit është emblematike për enigmën e madhe që është vetë Shakespeare, një individ i cili sikur është (sipas *Borgës-it*) gjithkushi dhe askush”.³⁴

Pikëshikimi kritik e ironik mbi veten, sa nën ndikimin e melankolisë, aq edhe të prirjes për introspeksion dhe për vërtetësi, është për Ellrodt-in njera nga pikat e përbashkëta midis Montaigne-it dhe Shakespeare-it³⁵.

Ellrodt merr në shqyrtim edhe analizat e kritikëve letrarë për personazhet e *Mbretit Lear*, për relacionet përherë reverzibile midis mençurisë dhe çmendurisë. Në shtrëngatën që e kaplon (në aktin III), mbreti Lear bëhet i vetëdijshëm se “mendjet fillojnë t’i sillen vërdallë”, duke cekur se “kaosi kozmik nuk është asgjë” në krahasim

³¹ Po aty, f.118.

³² Po aty, f. 151.

³³ Po aty, f. 151.

³⁴ Po aty, f.152.

³⁵ Po aty, 154.

me “shtrëngatën në mendjen e tij”.³⁶ Këto janë shprehje të fuqishme që vënë në spikamë mëvetësinë e asaj që tronditë mendjen e vetes.

Në shqyrtimet mbi kohën subjektive te Montaigne dhe Shakespeare, Ellrodt, veç tjerash, bën të ditur se prania e tematikës së vdekjes te Montaigne është e theksuar, ngase identiteti i personit afirmohet edhe në çastet e përballjes me vdekjen. Montaigne vë theksin më së shumti te çastet e së tashmes (e jo aq të së kaluarës apo të ardhmes), e ndryshme nga përjetësia që i ikën ndryshimit, si pika ku realizohet individi, vetpërbushet nëpërmjet ndryshimësive, transformimeve te vetes.³⁷ Shakespeare, ndërkaq, i cili e ndjen veten vazhdimisht të bartur nga rrjedha e kohës, nuk e kërkon strehimin te çastet e tashme, por e kupton kohësinë e vet si të përjetshme brenda dashurisë dhe poezisë.³⁸

Mirëpo pikë e përbashkët e këtyre dy autorëve është edhe prirja që përmes ekzaltimit të poezisë të kërkojnë mundësitë e shmangies së vorbullës së kohës si zhdukje e fanitje.

Montaigne është shquar në bashkëkohësi edhe për faktin se refleksionet e tij për shkapërderdhjen e vetes, brenda veprimeve, në çaste të ndryshme të ekzistencës si dhe për hetimin e formave të “shpërbërjes” së vetes, duke paralajmëruar kësisoj në agun e modernitetit disa elemente për veten e unin, që do të thellohen te disa mendimtarë të postmodernitetit si Jacques Derrida e Jean-François Lyotard, fjala vjen.

Bibliografia

- [1] Colin McGinn, *Shakespeare's philosophy*, Harper Collins, 2009.
- [2] Henri Frédéric Amiel, *Journal intime*, l'Age d'homme, Lausanne, 1992.
- [3] Joel Fineman, *Shakespeare's Perjured Eye: The invention of Poetic Subjectivity in the Sonnets*, University of California Press, 1985.
- [4] Michel de Montaigne, *Essais*, Gallimard, Paris, 2009.
- [5] Paul Ricoeur, *Temps et récit*, I-II, Seuil, Paris, 1991.

³⁶ Po aty, 171.

³⁷ Po aty, f.188.

³⁸ Po aty, f. 144.

- [6] Robert Ellrodt, *Montaigne et Shakespeare. L'émergence de la conscience moderne*, José Corti, Paris, 2011.
- [7] Wiliam James, *Abrégé de psychologie* (perkthimi fr.), l'Harmattan, Paris, 2003
- [8] William Shakespeare, *Œuvres complètes, Tragédies I-II*, Robert Lafont, Paris, 1995.

Résumé

Dans cet article nous nous sommes proposé d'analyser un certain nombre de textes des philosophes et des écrivains qui ont abordé la question de l'évolution de la conscience moderne. Dans cette littérature, nous avons accordé une place particulière au livre de Robert Ellrodt *Montaigne et Shakespeare. L'émergence de la conscience moderne*. (2011). Les analyses sur les conceptions de Montaigne et celles de Shakespeare sur la diversité des formes que prends *le moi*, la conscience de soi, leurs transformations dans leur temporalité, sont précédées, d'un riche parcours de l'évolution de la subjectivité de l'Antiquité aux Temps modernes, du monde hellénique au monde romain et à la spiritualité chrétienne, notamment les réflexions de Saint-Augustin, mais également de la Renaissance italienne et française. Ellrodt déploie une exploration profonde des textes de Montaigne e de ceux de Shakespeare sur le fond de ce passé qui précède la vigueur et la complexité de la conscience de soi moderne.

Les réflexions intenses de Montaigne, qui problématise la nature et l'existence même d'un moi, sur "l'inconstance de nos actions", éclairent les contradictions qui traversent le moi, ses effritements et ses transformations.

La conscience de soi chez Montaigne suit et déchiffre les ambiguïtés et les dualités du moi tandis que l'écriture restitue les transformations du moi, le flux des idées et des impressions à travers l'essai comme épreuve. Dans les réflexions de Davide Hume sur la nature humaine on retrouve le caractère éphémère du flux des impressions qui le pousse à percevoir *le moi* comme une *illusion*. D'un autre côté, le concept d'autoréflexion chez Kant permet de penser le sujet et sa relation à lui-même comme fondement de ses certitudes.

Ellrodt fait une analyse des recherches de Bernard Brugière sur la conscience de soi dans le romantisme, qui ouvre la voie à la “destruction du sujet, réalisé ultérieurement par Nietzsche et la psychanalyse”. Si Nietzsche voit Montaigne comme penseur qui a donné l’impulsion au mouvement pour l’émancipation de la pensée, ce qui implique la destruction du sujet, Ellrodt montre l’autre versant dans les réflexions de Montaigne: la permanence du moi et la cohérence du moi. Geofroi Miles souligne que Montaigne, par la complexité de ses recherches a su tenir un lien entre la cohérence de soi et la diversité et les transformations du moi.

Ellrodt introduit ici les analyses pénétrantes de Paul Ricoeur sur la différence entre l’identité du sujet comme *idem*, une illusion substantialiste pour Nietzsche, et l’identité narrative du soi-même comme *ipse*.

Ellrodt déploie des recherches fructueuses sur l’évolution de la subjectivité chez Shakespeare, depuis les *Sonets* et ses premières comédies jusqu’aux tragédies Richard III et Le Roi Leare. L’approche critique et ironique sur le soi-même, autant sous l’influence de la mélancolie que de la capacité à sonder les méandres changeantes du sujet, apparaissent comme un des points communs des réflexions de Montaigne et celles de Shakespeare. L’influence de ces réflexions dans les lettres des temps modernes mais également dans celles de la période contemporaine a été relevé dans les recherches de plusieurs auteurs d’aujourd’hui, dont ceux de Robert Ellrodt.

Hivzi Islami, Prishtinë

TRANSICIONI DEMOGRAFIK SI PROCES BOTËROR

Abstrakt

Me zhvillimin material, social dhe mendor të njerëzimit, nga stagnimi i gjatë i evolucionit sasior dhe cilësor demografik, bota shënon një progres kolosal në ritmin popullativ, ku dallohen shek. 18 dhe 19 dhe veçanërisht shek. 20. Historia demografike e vendeve të zhvilluara perëndimore të Evropës i demanton në themel pikëpamjet pesimiste të maltusianistëve dhe neomaltusianistëve. Në pjesën dërmuese të këtyre vendeve, për shkak të ndryshimeve të mëdha sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore, të komunikacionit etj. dhe rrjedhimisht të rënies, së pari të mortalitetit dhe pastaj të natalitetit, procesi i transicionit demografik tashmë ka përfunduar ose në stadi të ndryshme të tij gjenden gati të gjitha vendet e botës, prandaj për transicionin demografik sot mund të flitet si për një proces botëror.

Deri në fund të shek. 19 procesi i lindshmërisë (fertiliteti) në këto vende sot të zhvilluara i përkiste tipit “natyror”, për t’u racionalizuar pastaj nga ndryshimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike në kuptim të gjerë si: rënia e normës së mortalitetit dhe natalitetit, hyrja e vonshme në bashkësi martesore, rritja e celibatit, përqafimi i normave sociale mbi familjen e vogël, përmirësimi i pozitës së femrës në familje dhe në shoqëri, humanizmi i raporteve midis gjinive, socializmi i aspekteve e kyçe të jetës, zgjerimi i aspiratave individuale, rritja e investimit ekonomik dhe psikologjik te fëmijët, reduktimi i funksionit biologjik të femrës dhe rritja e funksionit të kohës së punës dhe të funksionit të kohës së lirë, ndërprerja e nevojës së angazhimit të fëmijëve në jetën ekonomike dhe sociale etj. Pikëpamjet dhe sjelljet ndaj riprodhimit biologjik të popullsisë, ashtu siç u krijuan në sistemin e caktuar socioekonomik, gjithashtu edhe u transformuan nga modernizimi i këtij sistemi. Mbi bazën e një sistemi të tillë të ndryshuar u krijuan pikëpamjet dhe normat e reja sociale mbi martesën dhe kohën e hyrjes në të, numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor midis lindjeve dhe mëdhësisë së familjes dhe rrjedhimisht të përqafimit të kontrollit të lindjes në martesë si “stil” të jetës. Për shkak të zhvillimit të vonshëm dhe të ngadalshëm ekonomik, social, arsimor, shëndetësor etj., Kosova dhe popullata shqiptare shquhen edhe sot si transicion i fundit demografik në Evropë, me të gjitha pasojat demografike dhe shoqërore që bart ky proces.

Fjalët çelës: transicioni demografik, rritja demografike, progresi material dhe social, ekuilibri demografik, riprodhimi i popullsisë, qasjet maltusianiste dhe neomaltusianiste, shtimi negativ natyror, Kosova si transicion i fundit demografik.

Hulumtimet e qarqeve të ndryshme shkencore dëshmojnë se deri në zbulimet e mëdha gjeografike botën e karakterizonte një stagnim i gjatë demografik, që për 10 shekuj popullsia e saj shënon rritje nga rreth 260 milion banorë në fillim të epokës sonë në 280 milion rreth vitit 1000. Ndërkaq, në vitin 1650 vlerësohet se në planetin tonë jetonin rreth gjysmë miliardi njerëz.¹ Derisa prej vitit 1800-1900 popullsia e botës rritet përrreth 80%, në periudhën prej vitit 1800-2000 ajo shtohet për afër 600%.² Ndërkaq, në këto 100 vjetët e fundit dinamika demografike në nivel planetar ka treguar një tendencë edhe më të dukshme pozitive: popullsia e botës është shtuar gati për katër herë; nga 1,6 miliard në vitin 1900 në rreth 7,5 miliard banorë sot, duke u rritur diferencat në vëllimin, lëvizjen dhe përbërjen e popullsisë sipas kontinenteve, regjioneve, vendeve dhe shtresave sociale, ku rreth 80% e popullsisë së botës sot është e përqendruar në rajonet më pak të zhvilluara.

Shekulli XX si shekull i kthesave të mëdha populative

Shumë studiues dhe qarqe shkencore shekullin XX e cilësuan si shekull të kthesave dhe proceseve të mëdha progresive të njerëzimit si rezultat të zhvillimit material, social e mendor, të paparë deri atëherë, pastaj i të arriturave shkencore, i industrializimit të shoqërisë, i modernizimit të teknologjisë, i ekspansionit mjekësor e sanitar. Një studiues dhe teoricien i njohur francez në fushën e ekonomisë dhe të sociologjisë, shekullin XX e quajti shekull të shpresave të mëdha për njerëzimin.³ Me këto kthesa dhe këtë zhvillim, tërthorazi a drejtpërdrejt, lidhet evolucioni demografik i botës si vazhdim i ndryshimeve të mëdha në sferën e popullsisë në shekujt XVIII dhe XIX, me shkaqe dhe pasoja të shumënduarshme si në nivel botëror, ashtu edhe në atë rajonal e kombëtar. Por shekulli XX njihej njëkohësisht edhe si shekull i brutaliteteve e barbarive deri te

¹ C. Clarc, *Population Growth and land Use*, MacMilan, New York, 1967, p. 64.

² Prej fillimit të shekullit XIX e deri në përfundim të shekullit XX pasqyra demografike e botës do të tregojë një tendencë të papritur për shumë qarqe: në vitin 1804 bota kishte rreth 1 miliard banorë, në vitin 1927 rreth 2 miliard, në vitin 1960 rreth 3 miliard, në vitin 1974 rreth 4, në vitin 1987 rreth 5, në vitin 1999 rreth 6 miliard dhe në gjysmën e qershorit 2017 rreth 7.509.000 miliard (World Population Clock, OUN, New York, 2017).

³ Më hollësisht shih studimet: J. Fourastié, *Le grand espoir du XX^{ème} siècle*, Presses Universitaires de France, Paris, 1953; i njëjti, "De la vie traditionnelle à la vie tertiaire", *Population*, No 3, Institut National d'Études Démographiques (INED), Paris, 1959.

ndërmarrjet gjenocidale në përmasa botërore, çfarë ishin Dy Luftëra Botërore, me humbje të mëdha demografike, të drejtpërdrejta dhe indirekte; pastaj shumë konflikte e luftëra në nivel rajonal midis vendeve e popujve; në rrafshin demografiko-territorial ndodhën deportime dhe spastrime etnike në përmasa të mëdha; ndarje të dhunshme të gjeografive etnike nga historitë etnike e kombëtare përmes forcës ushtarake dhe politikës së “spastrimeve etnike” etj.; rënia e shkallës së lindshmërisë në vitet e 20-ta e të 30-ta si pasojë e krizës së madhe ekonomike; periudha e kompensimit demografik pas Luftës II Botërore për shkak të humbjeve demografike; rritja e shpejtë e popullsisë ose “eksplozioni demografik”⁴ në vendet e pazhvilluara dhe deri vonë të nënshtruara, të njohura edhe si vende të “Botës së Tretë”,⁵ për çka u shfaq një brengosje e madhe te qarqet e deridjeshme kolonialiste a të neokolonializmit modern dhe ideologjive neomaltusianiste; ndryshimet në dy komponentët riprodhues (rënia e natalitetit dhe rritja e mortalitetit të përgjithshëm dhe rrjedhimisht mosshënimi i popullsisë së tyre) si në vendet perëndimore, ashtu edhe në ish-vendet socialiste të lindjes, në vendbanimet urbane dhe rurale etj.

Sot, përkatësisht më 31 dhjetor 2014 (të merret gjendja e 2015...!), sipas vlerësimeve të shërbimeve të specializuara të OKB-së bota ka 7.284.810.000 banorë. Sa i përket parashikimeve, sipas këtyre shërbimeve të OKB-së, në vitin 2024 në botë do të jetonin 8 miliard banorë, në vitin 2040 9, në vitin 2062 10 dhe në fund të shekullit XXI 10,8 miliard banorë.⁶ Dyfishimi i popullsisë botërore sot ndodh për 41 vjet, në vendet e pazhvilluara për 33 vjet, në vendet e zhvilluara për 139 vjet, ndërkaq në Kosovë si tërësi përreth 35 vjet dhe shqiptarët e Kosovës përreth 33 vjet.⁷

⁴ Nocioni “eksplozion demografik” është përdorur për vendet dhe popujt në zhvillim; i përket periudhës së neokolonializmit modern dhe ideologjive neomaltusianiste të pas Luftës II Botërore. Qarqet neokolonialiste dhe neomaltusianiste i përdornin, por edhe sot e gjithë ditën i përdornin për t’i justifikuar politikën e tyre të sundimit kolonialist mbi vendet dhe popujt e pazhvilluar dhe deri dje të robëruar në formën më klasike.

⁵ Për gjendjen demografike dhe tendencën e rritjes së shtimit natyror për shkak të normës së lartë të natalitetit dhe rënies së shpejtë të mortalitetit në këto vende, shih: A. Sauvy, “Baisse de la natalité dans Tiers Monde”, *Population*, No 5, Institut National d’Études Démographiques, Paris, 1968, pp. 921-926.

⁶ World Population Clock, OUN, New York, 31.12.2014.

⁷ Në fund të viteve të 60-ta, pra, para “Klubit të Romës” (1968) dhe publikimit të projektit “Kufijtë e rritjes” (1972) raportohej nga shërbimet e specializuara të OKB-së se popullsia e botës dyfishohej përreth 37 vjet, mirëpo popullsia e vendeve në zhvillim dyfishohej edhe më shpejt, si p. sh. për 31 vjet në Indonezi,

Në shek. XX, në rënien e vdekshmërisë dhe në progresin demografik në vendet dhe rajonet e pazhvilluara rol edhe më të rëndësishëm do të luajnë të arriturat e shkencës së mjekësisë, rritja e sasisë së ushqimit dhe zhvillimi i komunikacionit. Përveç kësaj, në ndryshimet e mëdha demografike e sociale do të paraqitet një faktor i ri, *solidariteti i njerëzimit*. Pas Luftës II Botërore OKB-ja dhe organizatat e saj të specializuara, sikurse Organizata e KB-së për Ushqim dhe Bujqësi (FAO),⁸ Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë (WHO),⁹ Fondi Ndërkombëtar i Fëmijëve për Nevoja Urgjente (UNICEF),¹⁰ Organizata e OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO)¹¹ etj. bëhen bartëse të solidaritetit ndërkombëtar, duke iu ndihmuar vendeve dhe popujve të rrezikuar nga uria, sëmundjet e ndryshme, mosarsimimi etj. Mirëpo procesi i shpejtuar i transicionit demografik në sferën e mortalitetit në shumë vende dhe popullata nuk përcillej edhe me transformimin ekonomik dhe shoqëror, por më tepër ishte i kushtëzuar nga zgjerimi i mjeteve moderne mjekësore dhe sanitare.¹²

Në qarqe shkencore, ekonomike, politike e të tjera si në rrafshin nacional e rajonal, ashtu edhe në atë global u shtruan dilema të ndryshme dhe u shfaqën brengosje të shumta për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit. Ndër preokupimet dhe sfidat e civilizimit bashkëkohor sot dhe në perspektivë janë bërë rrjedhat demografike, përkatësisht ndryshimet sasiore e cilësore të popullsisë, prodhimi i ushqimit, resurset natyrore, mjedisi dhe ndotja e tij, industrializimi dhe urbanizimi intensiv, terrorizmi ndërkombëtar etj. Në fillim të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar doli një supozim se planeti ynë do të jetë i kufizuar nëse vazhdon rritja e popullsisë dhe e prodhimit industrial me tempo të deritanishme dhe se në gjysmën e shekullit XXI do të vijë deri te çrregullimi i ekuilibrit global dhe rrjedhimisht do të pasojë një krizë me përmasa katastrofave.

Ky supozim në formë të një shqetësimi zgjoi interesim të madh në qarqe të ndryshme, me orientime *contra* a *pro* rritjes demografike dhe industriale. Nuk vonoi shumë dhe nga fundi i viteve të 60-ta,

për 24 vjet në Keni e Turqi, për 22 vjet në Brazil, për 21 vjet në Filipine, Kosta-Rikë, El Salvador etj. (Më gjerë shih: R. Supek, *Ova jedina zemlja*, Naprijed, Zagreb, 1973, f. 42 e tutje).

⁸ FAO (Food and Agriculture Organisation).

⁹ WHO (world Health Organisation).

¹⁰ UNICEF (United Nations International Children Emergency Found).

¹¹ *UNESCO* (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization).

¹² United Nations, *Population Bulletin*, No 6, NeW York, 1963, pp. 16-18.

përkatësisht më 1968 u organizua në Romë një debat në kuadër të të ashtuquajturit "Klub i Romës" i rreth 30 dijetarëve (ekonomistë, industrialistë, filozofë, humanistë etj.) nga vende të ndryshme të botës. Pas "Klubit të Romës" takimet rreth dilemave të atëhershme dhe të ardhme të njerëzimit vazhduan në Bern, Kembrixh dhe Masaçuset (1970), nga të cilat në vitin 1972 në Nju-Jork u paraqit projekti "Kufijtë e rritjes".¹³ Projekti jehoi si një "bombë", me vlerësime mjaft kontroverse dhe ekstreme. Neomaltusianistëve, të cilët natyrisht gjithnjë ishin dhe mbetën në anën e priftit dhe ekonomistit anglez, T. R. Maltusit (1766-1834), ky projekt u përgjigjej, sepse inkuadrohej plotësisht në bindjet e tyre pesimiste se "Botës po i afrohej fundi" (!), ndërkaq kundërshtarët e tyre e cilësuan projektin si çmendi, verbësi apo utopi. Shkenca demografike, shkencat e tjera sociale dhe disiplinat e planifikimit të zhvillimit shoqëror u gjendën para një sfide dhe detyre serioze dhe me përgjegjësi: si ta shpjegojnë evolucionin demografik, shkaqet dhe konsekuencat e tij, si dhe dilemat lidhur me të ardhmen e njerëzimit.

Qasjet maltusianiste dhe neomaltusianiste të pathemel

Nga teoria demografike dhe eksperiencia e zhvillimit material, social dhe mendor të vendeve sot të zhvilluara të Evropës, të cilat e kanë kaluar etapën e transicionit të plotë demografik, mësohet se ligjësitë e zhvillimit të popullsisë nuk janë të përhershme, por varen nga ndryshimi i kushteve shoqërore në kohë dhe hapësirë të caktuar. Rënia e mortalitetit dhe e natalitetit në këto vende është zhvilluar në përputhmëni me transformimet radikale të bazës ekonomike të shoqërisë dhe me ndryshimin e rrethanave social-ekonomike të popullsisë në kuptim të gjerë. Prandaj historia demografike e këtyre vendeve dhe prosperiteti i tyre ekonomik e shoqëror¹⁴ i demantuan në themel pikëpamjet pesimiste të Maltusit¹⁵ dhe ithtarëve të tij, si dhe të

¹³ D. H. Meadows et. al., *The Limits to Growth*, Universe Books, New York, 1972, pp. 1-205; përkthimi freng: *Halte à la croissance*, Fayard, Paris, 1972; përkthimi kroatisht: *Granice rasta*, "Stvarnost", Zagreb, 1972.

¹⁴ J-P. Bardet et J. Dupâquier (dir.), *Histoire des populations de l'Europe*, tome I et tome II, Fayard, Paris, 1997 et 1998; J-P. Bardet et J. Dupâquier, *Histoire des populations de l'Europe, III, Les temps incertains, 1914-1998*, Fayard, Paris, 1999; Massimo L.-Bacci, *La population dans l'histoire de l'Europe*, Editions du Seuil, Paris, 1999.

¹⁵ Tomas Robert Malthus-i (1766-1834) lindshmërinë dhe popullsinë në përgjithësi i konsideronte madhësi të pandryshuar në hapësirë dhe kohë. Popullsia dhe

neomaltusianistëve¹⁶ të shekullit njëzet lidhur me zhvillimin e popullsisë dhe të mirave materiale në të ardhmen. Përparimi shkencor dhe teknik ndikuan si në përmirësimin e kushteve për jetesë, ashtu edhe në transformimin e regjimit demografik në drejtim të zvogëlimit së pari të vdekshmërisë e pastaj edhe lindshmërisë dhe të rritjes së popullsisë. Në këto vende filloi zhvillimi intensiv i marrëdhënieve kapitaliste, i industrializimit dhe urbanizimit të jetës, i arsimit, i komunikacionit, i shëndetësisë etj. Të gjitha këto rrethana krijuan mundësi të mëdha dhe hapën perspektiva të reja për zhvillimin e njerëzimit.

varfërimi i saj, sipas tij, nuk varehin nga kushtet shoqëro-historike dhe institucionet sociale, por nga të ashtuquajturat ligje konstante natyrore. Sipas tij, meqenëse do të ndodhte kufizimi i mjeteve për ekzistencë, gjë që nuk e vërtetoi zhvillimi i mëvonshëm material e mendor i njerëzimit, duhej ndërmarrë një varg masash të karakterit preventiv dhe pozitiv për zvogëlimin e lindjeve. Preferonte që numri i lindjeve të kufizohej me abstenim moral dhe ngurrim seksual, me shtyrjen e martesave dhe me moshyrje në martesë (celibati), si *pengesa preventive* dhe me epidemi, uri e luftëra, si *pengesa pozitive*. Teoria e Maltusit dhe ithtarëve të tij ishte thellësisht antishkencore dhe antihumane. Maltusi ishte i popullarizuar me veprën e tij *Essay on the Principle of Population* (“Mbi parimin e popullatës”), të botuar në Londër në vitin 1798. Shih edhe versionin në gjuhën frënge: Thomas R. Malthus, *Essai sur le principe de population*, Institut National d’Études Démographiques, Paris, 1980, pp. 1-166). Ky libër së fundi u përkthye në shqip nga Alfred Cako dhe u botua në Tiranë. Shih: Thomas Robert Malthus, *Ese mbi parimin e popullsisë*, Helga’s Secret, Tiranë, ff. 1-173. Mjerisht nuk është shënuar askund viti i botimit. Në bazë të përcjelljes së literaturës duket se botimi doli në këto 5 vjetët e fundit.

Maltusianizmi si doktrinë lindi në Angli, por, për shumë arsye, më së gjati gjeti shprehje në praktikë në Francë. Shih për këtë në: A. Armengaud, *Le français et Malthus*, PUF, Paris, 1975, pp. 1-142; A. Sauvy, *La prévention des naissances*, PUF, col. “Que sais-je?”, No 988, 3^{me} éd., Paris, 1967, pp. 1-128.

¹⁶ Pas Maltusit dhe teorisë së tij paraqitet doktrina tjetër, gjithashtu pa mbështetje shkencore e humane, *neomaltusianizmi*, që del në formë të neomaltusianizmit të hershëm dhe zgjatë nga vdekja e Maltusit e deri në Luftën II Botërore dhe të neomaltusianizmit bashkëkohor, që paraqitet pas kësaj lufte në disa vende perëndimore.

Dallimet midis doktrinës maltusianiste dhe pikëpamjes neomaltusianiste qëndrojnë vetëm në mjetet e ndërmarra, ndërsa qëllimet janë të njëjta. Neomaltusianistët insistojnë që problemet ekzistuese social-ekonomike të zgjidhen me kufizimin e lindjeve dhe pengimin e rritjes së numrit të popullsisë, duke zbatuar mjetet kontraceptive, abortimet, madje edhe sterilizimin (R. Pressat, *Dictionnaire de démographie*, PUF, Paris, 1979, pp. 138-139; A. Roussel, *Histoire des doctrines démographiques illustrée par les textes*, Nathan, Paris, 1979, pp. 162-178; shih edhe në: United Nations, *Višejezički demografski rečnik, srpskohrvatska verzija*, CDI, IDN, Beograd, 1971, pika 90).

Siç është tashmë e njohur, në truallin e vendeve sot të zhvilluara të Evropës u paraqit revolucioni industrial dhe së bashku me të edhe kthesat sociale, shkencore-teknike dhe medicinale-sanitare. Edhe procesi i transicionit, përkatësisht i revolucionit demografik,¹⁷ së pari i përfshiu këto vende të Evropës, si djepi i revolucionit klasik industrial. Fillimi i transicionit demografik¹⁸ lidhet me rënien graduale të mortalitetit të popullsisë, proces ky që do t'i paraprijë transicionit edhe në sferën e natalitetit. Ky proces, së pari, qysh në fillim të shek. XVIII nis në Francë,¹⁹

¹⁷ A. Landry, *La révolution démographique*, Librairie Sirey, Paris, 1934.

¹⁸ Sipas teorisë së transicionit demografik, transicioni demografik nënkupton së pari rënien e mortalitetit nën 30 promilë dhe, më vonë, edhe rënien e natalitetit gjithashtu nën 30 promilë, me ç'rast së pari rritet shkalla e shtimit natyror e pastaj zvogëlohet deri te niveli i stabilizimit demografik në tërësi. Mirëpo transicioni demografik, sipas kësaj teorie nuk nënkupton vetëm transformimin e regjimit të riprodhimit biologjik prej tipit tradicional në tip bashkëkohor, por edhe ndryshimet në komponentët dhe strukturat e tjera të popullsisë. Kjo teori shqyrton procesin e evolucionit të popullsisë nëpër etapa të caktuara të zhvillimit shoqëror-ekonomik, duke u mbështetur në përgjithësimin e fakteve empirike të ndryshimit të komponenteve të lëvizjes natyrore të popullsisë të vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Sipas teorisë së transicionit demografik, nataliteti dhe mortaliteti zvogëlohen nga niveli i lartë në nivelin e ulët, gjë që, sipas rregullit, lidhen me ndryshimet ekonomike-sociale dhe kulturore që ndodhin gjatë procesit të industrializimit dhe urbanizmit të jetës. Gjatë transicionit, norma e mortalitetit bie më shpejt se ajo e natalitetit dhe prandaj, në rrethanat e normës së lartë të lindshmërisë rritet shtimi natyror, që shënon dhe një lloj "bumi demografik".

Megjithatë, teoria e transicionit demografik paraqet vetëm kornizën e përgjithshme të shqyrtimit të procesit të zhvillimit demografik. Në shpjegimin e këtij procesi, veçanërisht të përtëritjes biologjike dhe, në këtë kuadër, të fertilitetit, duhet hulumtuar një varg shkaqesh specifike, që dalin jashtë skemës së përgjithësimin të transformimit të komponentëve vitalë të popullsisë, siç i parashihte teoria e transicionit demografik. Kësaj teorie sot, me gjithë përparësitë e mëdha që ka në shpjegimin e evolucionit demografik në rrafshin teorik, mund t'i bëhen edhe shumë vërejtje (Për format, heterogjenitetin dhe shumëdimensionalitetin e transicionit demografik shih: J.-C. Chesnais, "L'effet multiplicatif de la transition démographique", *Population*, No 6, Institut national d'études démographiques, Paris, 1979, pp. 1138-1144; D. Noin, *La transition démographique dans le monde*, PUF, Paris, 1983; J.-C. Chesnais, *La transition démographique (étapes, formes, implications économiques)*, Études de séries temporelles relatives à 67 pays, PUF, Paris, 1986).

¹⁹ J. B.-Pichat, "Évolution générale de la population française depuis le 18^{ème} siècle", *Population*, INED, No 4, Paris, 1951, pp. 635-672; Y. Blayo, "Mouvement naturel de la population française de 1740 à 1829", *Population* (Numéro spécial), INED, Paris, 1975, pp. 15-64; M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Histoire générale de la population mondiale*, III éd., Paris, 1968, p. 126; J. Dupâquier (dir.), *Histoire de population française*, 4 volumes, PUF, Paris, 1988.

për t'u zgjeruar më vonë nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX në vendet nordike (Suedia, Norvegjia) dhe perëndimore të Evropës,²⁰ pastaj në SHBA, Kanada, Australi, Zelandë të Re dhe në Evropën Lindore. Në shumicën e këtyre vendeve procesi i transicionit tashmë është kryer, ndërsa në stadi të ndryshme të tij gjenden pothuajse të gjitha vendet e botës,²¹ prandaj për të sot mund të flitet si për një proces botëror.²² Të arriturat në këto sfera, para së gjithash ato në shkencën mjekësore, zbulimit të medikamenteve të reja dhe efikasitetit të zbatimit të tyre (vaksinat, antibiotikët, insekticidet etj.), si dhe zhvillimit të shëndetësisë dhe higjienës publike, me ç'rast u eliminuan shumë sëmundje epidemike dhe endemike si përcjellës shekullorë të shëndetit dhe jetës së njerëzve.

Në anën tjetër, në rënien e vdekshmërisë dhe rrjedhimisht në rritjen demografike rëndësi të veçantë në disa vende luajtën zbatimi i risive në bujqësi dhe mekanizimi i saj dhe rritja e prodhimtarisë agrare në saje dhe të zgjerimit të kulturave të reja në vendet atëherë të zhvilluara dhe sigurimi i ushqimit, ku në shumë rajone të botës uria si dukuri u eliminua ose u reduktua maksimalisht, por nuk duhet lënë anash as zhvillimin e komunikacionit, që mundësoi distribuimin e ushqimit në vendet që kërcënoheshin nga uria dhe sëmundjet infektive.²³ Këta faktorë ndikuan drejtpërdrejt në zvogëlimin e mortalitetit, veçanërisht mortalitetit të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe racionalizimin e përtëritjes biologjike.²⁴ Në shekullin XIX dhe më tepër në shekullin XIX, siç theksuam edhe më parë, në vendet sot të zhvilluara të Evropës nisi zvogëlimi edhe më i fuqishëm i nivelit të dy komponentëve reprodiktivë, së pari të vdekshmërisë dhe pastaj edhe të lindshmërisë,²⁵ duke pësuar ndryshime harta demografike e kësaj pjese të kontinentit të vjetër.²⁶ Deri nga fundi i shekullit XIX procesi

²⁰ J.-P. Bardet et J. Dupâquier (dir.), *Histoire des populations de l'Europe*, tome I et tome II, Fayard, Paris, 1997 et 1998.

²¹ Poursin J.- M., *La population mondiale*, Éditions du Seuil, Paris, 1976, pp. 81-91.

²² D. Tabutin-T. Eggerickx-C.Gourbin, *Transitions démographiques et sociétés*, Actes de la Chaire Quetelet 1992, Academia-L'Harmattan, Louvain-la-neuve, 1995, pp. 1-694.

²³ A. Armengaud, *Démographie et sociétés*, Stock, Paris, 1966, pp. 45-68.

²⁴ A. Armengaud, *Po aty*, pp. 45-68.

²⁵ Burimi: C. Cipolla, *The Economic History of World Population*, Penguin Books, 1962, pp. 84-85; A. W.-Baletić, *Po aty*, f. 93; UN: *World Population 1992*, New York, 1992; Ž. Šifrer, "Razvitak stanovništva Slovenije u poslednjih sto godina", *Stanovništvo*, br. 3, CDI, IDN, Beograd, 1963, f. 362; *Statistički godišnjak Jugoslavije* (vite të ndryshme), SZS, Beograd; *Recent demographic developments in Europe 2000*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000, pp. 70, 86.

²⁶ F. de Singly, *Sociologie de la famille contemporaine*, Sociologie 128, Nathan Université, Paris, 1993.

i lindshmërisë në këto vende nuk ishte “i dirigjuar”, por i përkiste të ashtuquajturit tip “natyror të fertilitetit”.²⁷

Zvogëlimin e natalitetit dhe racionalitetin e riprodhimit të popullsisë në këto vende e diktonin dhe e shpejtonin proceset e industrializimit e të zgjerimit të strukturave urbane dhe lidhur me to edhe zgjerimi i shkrimleximit, ngritja e nivelit kulturo-arsimor, përmirësimi i pozitës materiale-sociale e qeverisëse të femrës në familje dhe në shoqëri, moshyrja në martesë e një kontingjenti të femrave apo hyrja e vonshme në bashkësi martesore e një numri tjetër të tyre, kur aftësia prokreative e femrës nis të zvogëlohej, pastaj zvogëlimi i mortalitetit të foshnjave, mobiliteti më i madh hapësinor e social, shkatërrimi i familjes tradicionale dhe ndryshimi i funksioneve të saj, socializimi i aspekteve kyçe të jetës, barazia e gjinive, rritja e lirisë personale, zgjerimi i individualizmit si konsideratë e rëndësishme në vendosje në procesin e lindjes, etj.²⁸

Edhe në Slloveni, sot shtet i ri, për shumëçka vend evropian, që doli pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë (1992), nga të njëjtat arsye ka pasuar përqafimi i normave sociale mbi familjen e vogël dhe natalitetin e ulët deri nga fundi i shek. XIX; u përqafua qëndrimi i hyrjes së vonshme në martesë, për çka zvogëlohej periudha e përtëritjes biologjike, por edhe i moshyrjes fare në martesë (celibati) i një numri të konsiderueshëm të femrave.²⁹ Edhe këtu shkalla e natalitetit ishte mjaft e lartë, sidomos te shtresa fshatare dhe punëtore.³⁰ Në vitet 1880-1900 shkalla e natalitetit në Slloveni sillej rreth 35 promilë, prej fillimit të shekullit XX e deri në gjysmën e tij kjo shkallë sillej midis 30 e 23 promilë,³¹ ndërsa prej atëherë rënia

²⁷ H. Leridon et J. Menken (sous la dir. de) *Natural fertility/ Fécondité naturelle. Niveaux et déterminants de la fécondité naturelle*, Liège, Ordina, 1979, pp. XV-556; P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970*, Institut National d'Études Démographiques, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979, pp. 7-47.

²⁸ P. Festy, *Po aty*, pp. 7-47; A. Armengaud, *Po aty*, pp. 45-68; F. Marchal – O. Rabut, “Évolution récente de la fécondité en Europe occidentale”, *Population*, No 4-5, INED, Paris, 1972, pp. 838-850.

²⁹ B. Breznik, “Natalitet i fertilitet stanovništva Jugoslavije”, në studimin *Fertilitet stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd, 1980, ff. 63-65.

³⁰ Gjyshi i Ivan Cankarit, shkrimtarit më të madh slloven, midis viteve 1823 dhe 1859 i ka pasur 21 fëmijë nga dy martesë (F. Gertnir-V. Melik, *Slovenska zgodovina od konca osamnajstega stoljetja do 1918*, Ljubljana, 1966, f. 74).

³¹ Më gjerë në: Ž. Šifrer, “Razvitek stanovništva Slovenije u poslednjih sto godina”, *Stanovništvo*, br. 3, CDI, IDN, Beograd, 1963, f. 362 e tutje; D. Vogelink, “Razvoj prebivalstva Slovenije zadnjih dvesto let z jugoslovanske in evropske perspektive”, *Ekonomski zbornik*, VII, Letnik, Ljubljana, 1965; D. Breznik (redaktor), *Fertilitet*

është konstante, kështu që në vitin 1990 nataliteti ishte 11,5, mortaliteti 9,5 dhe shtimi natyror 2,0 promilë. Kjo gjendje e përshkon këtë vend edhe sot. Edhe në Kroaci dhe Sllavoni, deri në fund të dekadës së parë të shekullit XX nataliteti ishte mbi 40 promilë.³²

Nga analiza shkencore e evolucionit të lindshmërisë, si dhe nga eksperiencia e ecurisë së këtij komponenti në vendet që e kanë kaluar fazën e transicionit demografik rezulton se zvogëlimi i tij nuk ka pasuar për arsye të zgjerimit të zbatimit masiv të mjeteve kontraceptive a të aplikimit të ndonjë politike populative të konceptuar qartë, por për shkak të ndryshimeve të thella në tipin e ekonomizimit dhe në kushtet e tjera jetësore dhe kulturore. Vetëm kompleksi i determinanteve të fundit ka mundur të ndikonte te faktorët e parë. Në Britaninë e Madhe, në Francë, në Suedi etj. në gjysmën e shekullit XVIII shkalla e natalitetit ishte mbi 35 promilë, në gjysmën e shekullit XIX (përveç Francës, për arsye të njohura) mbi 30 promilë dhe në fillim të shekullit XX mbi 25 promilë.³³ Dhe këto rrethana pikërisht ndikuan që individët dhe çiftët bashkëshortorë t'i ndryshonin fuqimisht normat, qëndrimet dhe sistemin e vlerave që e përcaktojnë nivelin e përtëritjes biosociale të popullsisë dhe formojnë qëndrime krejtësisht të reja ndaj numrit të fëmijëve dhe madhësisë së familjes. Në këto vende faktori më i rëndësishëm i transformimit të regjimit të riprodhimit duket se ishte përvetësimi i të ashtuquajturit kontroll i lindjes mbi bazë të këtyre ndryshimeve.³⁴

Tendenca e rënies së nivelit të natalitetit gjeti shprehje në kohën e depresionit të madh ekonomik në vitet e 30-ta të shekullit XX dhe atë në Angli, Francë, Gjermani, Austri, Zvicër, në vendet nordike etj.³⁵

stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji, CDI, IDN, Beograd, 1980, ff. 66-67; *Statistički godišnjak Jugoslavije 1992*, SZS, Beograd, 1992, f. 424.

³² *Statistički godišnjak Kraljevine Hrvatske i Slavonije 1906-1910*, Zemaljski statistički ured, Zagreb, 1917, f. 114; sipas M. Rašević, *Determinante fertiliteta stanovništva Jugoslavije*, Centar za demografska istraživanja (CDI), Institut društvenih nauka (IDN), Beograd, 1971, f. 70.

³³ Burimi: C. Cipolla, *The Economic History of World Population*, Pengu in Books, 1962, pp. 84-85; A. W.-Baletić, *Po aty*, f. 93; UN: *World Population 1992*, New York, 1992; *Recent demographic developments in Europe 2000*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000, pp. 70, 86.

³⁴ F. Marchal – O. Rabut, “Évolution récente de la fécondité en Europe occidentale”, *Population*, No 4-5, INED, Paris, 1972, pp. 838-850.

³⁵ Në gjysmën e këtyre viteve fertiliteti bie nën nivelin që siguron përtëritjen afatgjate të popullsisë në Francë, Angli, Gjermani, Austri, Zvicër, vendet nordike etj. Pas periudhës së kompensimit demografik në vitet e 50-ta, në këto vende përsëri pason rënia e fertilitetit nën nivelin e riprodhimit të brezave (Shih të dhënat në revistën *Population*, No 2, INED, Paris, 1983, pp. 386-387).

Ndonëse disa elemente të kontrollit të lindjes i gjejmë qysh në shoqëritë e pazhvilluara dhe në bashkësitë primitive,³⁶ megjithatë ky faktor do të luajë rol të madh në zvogëlimin e natalitetit në vendet evropiane pas revolucionit industrial, kur edhe nis të formohet një sistem modern demografik, ku nataliteti i lartë dhe familja e tipit të zgjeruar do të humbin funksionin e tyre ekonomik dhe shoqëror, ndërsa me përparimin industrial dhe teknologjik dhe me krijimin e kushteve të reja të punësimit intensiv-produktiv mbi këtë bazë do të ndërpritet nevoja e angazhimit të fëmijëve në jetën ekonomike.

Harta demografike e kontinenti plak karakterizohet me kontraste të mëdha në pikëpamje të dinamikës së rritjes së popullsisë dhe shtimit natyror, lindshmërisë dhe fertilitetit, mortalitetit të përgjithshëm dhe atij specifik, strukturës sipas moshës etj., në një anë, dhe dallimeve etnike dhe kulturore, në anën tjetër. Mirëpo, përkundër këtyre dallimeve, në pjesën e dytë të shekullit XX trendi demografik në indikatorët e përmendur shkoi drejt homogjenizimit, veçanërisht kur është fjala për normat e ulëta të përtëritjes natyrore dhe zvogëlimit të vdekshmërisë. Në vitet 1950-1955 brenda kontinentit evropian kishte dallime të mëdha në nivelin e natalitetit dhe shtimit natyror (Evropa P. 17,5‰ dhe 6,5‰; Evropa J. 29,0‰ dhe 17,0‰; dhe Evropa L. 24,5‰ dhe 19,6‰), por në vitet 1985-1990 këto norma u homogjenizuan në nivel mjaft të ulët: e para, 12,2‰ dhe 1,1‰; e dyta, 12,0‰ dhe 2,5‰ dhe e treta, 13,7‰ dhe 2,9‰).³⁷

Sot Evropa në përgjithësi ballafaqohet me probleme të mëdha në zhvillimin demografik, sidomos disa vende në perëndim dhe ish-vendet komuniste, në lindje të tij. Që nga vitet e 70-ta të shek. XX vështirësitë dhe çrregullimet e kanë kapluar veçanërisht sferën e riprodhimit të popullsisë dhe atë si në fshat, ku shtimi natyror është pothuajse në të gjitha negativ, ashtu edhe në qytet, ku ka një riprodhim tejet të reduktuar (Gjermania në fshat dhe në qytet; Austria në qytet; Franca në fshat etj.).³⁸ Ka shumë vjet që në disa vende shtimi natyror ka tashmë tendencë negative, me mundësi që të hyjë në një fazë edhe më të thellë të shpopullimit.³⁹ Popullsia e Evropës e moshës së vjetër, mbi 60 vjet, këto 65 vjetët e fundit kishte këtë trend: në vitin 1950 12,1%, më 1975 16,4%,

³⁶ Planifikimin e familjes me elemente pro dhe kundër lindshmërisë e hasim edhe në Evropën Antike. Hulumtimet tregonin se si metodë më efektive për kufizimin e lindjeve qysh herët është shfrytëzuar dështimi (aborti). Aborti edhe në fillim të fazës së transicionit demografik ishte mjet kryesor i planifikimit të familjes, ndërsa nga fundi i kësaj faze do të dominojë zbatimi masiv i mjeteve kontraceptive.

³⁷ Burimi: United Nations, *World Population Prospects 1990*, New York, 1991.

³⁸ Burimi: United Nations, *Demographic Yearbook 1984*, New York, 1986.

³⁹ A. Sauvy, *L'Europe et sa population*, Les éditions internationales, Paris, 1970, p. 47.

në vitin 2000 20,3%, në vitin 2005 28,8% (rreth 200 milion banorë) dhe nga mesi i shek. XXI kjo moshë parashihet të arrijë në 36,6% (rreth 225 milionë banorë) të popullsisë së përgjithshme.⁴⁰ Shumë vendeve dhe rajoneve dhe popullatave të tyre u kërcënohet rreziku nga zgjerimi i denatalitetit si fenomeni më i pavolitshëm në zhvillimin e popullsisë.⁴¹ Rreth dy të tretat e vendeve të këtij kontinenti ka kohë që kanë normën e riprodhimit neto nën një, që nuk siguron pra as riprodhimin e thjeshtë të popullsisë së tyre. Dhe tendenca është negative: në vitin 1970 në Evropën Perëndimore një grua kishte lindur 2,4 fëmijë,⁴² në vitin 2002 ky numër kishte rënë në 1,5 fëmijë.⁴³ Ndërkaq, për t'u mbajtur një gjendje stabile demografike një grua duhet të lind së paku 2,1 fëmijë.

Në fund të shekullit XX p. sh. Gjermania, Suedia, Italia dhe Austria kishin shtim negativ natyror, vendet baltike (Estonia, Letonia dhe Lituania) gjithashtu, Franca, Anglia, Belgjika, Finlanda, Danimarka dhe Holanda gati zero shtim natyror, ndërsa në shumë vende të Evropës JL shtimi natyror ishte negativ, sikurse Federata Ruse, Bjellorusia, Rumania, Bullgaria, Hungaria, Moldavia, Çekia, Kroacia dhe Sllovenia.⁴⁴ Rreth dy të tretat e vendeve të këtij kontinenti këto 3-4 dekadat e fundit ka normën e riprodhimit neto nën një.⁴⁵ Në fund të shekullit XX (1999) në të gjitha vendet e zhvilluara të Evropës dhe në vendet e Evropës JL norma neto e riprodhimit ishte nën një, madje edhe nën 0,65 (Austria, Bullgaria, Çekia, Sllovakia, Hungaria, Letonia, Lituania, Estonia, Rumania, Federata Ruse, Sllovenia etj.).⁴⁶

⁴⁰ J. Dupâquier, *Le vieillissement de la population dans le monde*, Paris, 2005, p. 18. Në demografi konsiderohet se një popullatë ka hyrë në procesin e mosshënimit demografik kur në numrin e përgjithshëm të popullsisë kontingjenti mbi 65 vjet është mbi 12%.

⁴¹ Fenomeni i denatalitetit nënkupton shtimin negativ natyror, rënien e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe shpopullimin si pasojë e zvogëlimit të natalitetit dhe rritjen relative dhe absolute të numrit të vdekjeve në një popullatë (R. Pressat, *Dictionnaire de démographie*, PUF, Paris, 1979, pp. 46-47; UN, *Višejezički demografski rečnik*, f. 83 (pika 930).

⁴² Në vitet 1970-1975 norma neto e përtëritjes biologjike në vendet e Evropës Perëndimore ishte një, e mjaftueshme për një gjendje stabile demografike (United Nations, *Concise Report on the Population Situation in 1970-1975 and its long-rang implications*, New York, 1974, p. 70).

⁴³ Më gjerë në: Conseil de l'Europe, *Évolution démographique récente en Europe 2005*, Strasbourg, 2005, pp. 1-334.

⁴⁴ *Recent Demographic developments in Europe 2000*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, December 2000, p. 31.

⁴⁵ J. Bourgeois-Pichat, "La baisse actuelle de la fécondité en Europe s'inscrit-elle dans le modèle de la transition démographique", *Population*, no 2, INED, Paris, 1979, pp. 267-301.

⁴⁶ *Recent Demographic developments in Europe 2000*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, December 2000, p. 81; *Recent Demographic*

Po të mos ishte imigrimi i fuqisë punëtore dhe i popullsisë nga vendet e tjera të pazhvilluara, shumë shtete të Evropës do të ballafaqoheshin me një krizë edhe më të thellë demografike, me implikime të mëdha afatgjata për zhvillimin e tyre shoqëror, ekonomik dhe politik. Shumë vende evropiane me masa të ndryshme stimulative sot po bëjnë përpjekje për rehabilitimin e procesit të riprodhimit, por rezultatet nuk janë inkurajuese. Procesi i mosshënimit demografik do të jetë një brengë e madhe për Evropën në qoftë se nuk arrihet që familjet të kenë më shumë se dy fëmijë, gjë që është pak e besueshme. Parashihet që në vendet e Bashkimit Evropian, duke përfshirë Bullgarinë dhe Rumaninë si anëtare të reja, numri i popullsisë të zvogëlohet nga 482 milionë banor sa kishte më 2004 në rreth 450 milion banorë në vitin 2010. Ose nëse vazhdon trendi i sotëm demografik në Gjermani, ky vend mund të ketë rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë nga 82 milion në vitin 2004 në 24 milion në fund të shekullit XXI! Dhe këto parashikime të zymta mbështeten në hapjen e tyre ndaj imigrantëve të vendeve të tjera të botës, ku një pjesë e të ardhurve kanë parakushte për normë më të lartë të lindshmërisë. Vala masive e imigrantëve jo vetëm në Gjermani, por edhe në tërë Evropën e zhvilluar vjen pikërisht nga vendet e lindjes së afërt dhe të mesme me këto parakushte demografike, pra me shkallë të lartë të lindshmërisë. Por procesi i ksenofobisë gjithashtu është i fortë te shumë qarqe të vendeve evropiane, gjë që sjell pengesa të mëdha në dhënien e azilit.

Kosova dhe popullata shqiptare - transicioni i fundit demografik në Evropë

Nga eksperiencia e zënë në gojë e zhvillimit të popullsisë dhe e rrjedhave të transicionit demografik në vendet perëndimore u pa se determinantet kyçe të ndryshimeve rënjësore sociodemografike e të tjera ishin proceset intensive të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në kuptim më të gjerë. Kosova dhe popullata shqiptare edhe sot e gjithë ditën mbetën transicioni i fundit demografik në Evropë, me të gjitha konsekuencat që dalin nga ky

proces.⁴⁷ Deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, por në disa territore edhe më vonë, ishin shembuj tipikë të shoqërive paratransicionale dhe paraindustriale, ku zhvillimi demografik i bartte me vete të gjitha veçoritë e jetës klasike shoqërore dhe në të gjitha sferat e jetës familjare, sociale dhe prodhuese ruheshin mbeturinat e marrëdhënieve gjysmëfeudale, madje edhe feudale dhe të cilat në mjediset rurale gjallisin deri vonë pas Luftës II Botërore. Në rrethana të rënda ekonomike, sociale, kulturore dhe shëndetësore popullata shqiptare ishte gjeografikisht e izoluar, homogjene në pikëpamje sociale dhe me "pjellori natyrore", sikurse te popullatat jokontraceptive të vendeve të Evropës Perëndimore deri në vitet e 70-ta të shekullit XIX.⁴⁸ Në Kosovë dhe në trojet shqiptare përqindja e popullsisë rurale dhe e popullsisë agrare arrinin nivelin mbi 90%, ndërsa shkalla e analfabetizmit mbi 80% dhe te popullata femërore mbi 90%.

Në rrethana të tilla, riprodhimi i popullsisë shqiptare zhvillohej përgjithësisht shumë joracionalisht, ngase ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish, ku shtimi natyror formohej përgjithësisht në mënyrë stihike e joracionale. Prandaj shkalla e lartë e lindshmërisë ishte domosdoshmëri, sepse te prindërit ishte rrënjësor vetëdija dhe qëndrimi se për të mbetur në jetë bile një numër i fëmijëve duhet të lindnin sa më shumë fëmijë. Hyrja në martesë ishte shumë e hershme, me ç'rast zgjatej periudha e riprodhimit biologjik; gruaja shqiptare lindte numër aq të madh të fëmijëve sa që e konsumonte gjithë kapacitetin prokreativ (fekonditeti),⁴⁹ ashtu siç ndodhi me popullatat e përmendura të vendeve sot të zhvilluara të Evropës para një shekulli e gjysmë.⁵⁰

Me gjithë defektet si në përfshirje (vëllimi), ashtu edhe në cilësi të të dhënave të ngjarjeve themelore vitale të popullsisë (nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror) nga viti 1911 e këndej shihet qartë se popullsia e Kosovës dhe ajo shqiptare gjendeshin në fazën e paratransicionit demografik. Shkallët e natalitetit të popullatës sonë në

⁴⁷ Për shkaqet e transicionit të vonuar demografik shih: H. Islami, "Zakasnjela demografska tranzicija na Kosovu u okviru demografskog prelaznog razdoblja u Jugoslaviji i Evropi", *Sociologija*, nr. 3, Beograd, 1985, ff. 372-374; H. Islami, "Zadnja demografska tranzicija v Evropi: primer Kosova", *Časopis za kritiko znanosti*, št. 79-80, Ljubljana, 1985, ff. 29-45; H. Islami, *Studime demografike (100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës)*, Botim i dyë i plotësuar, ASHAK, 2008, ff. 69-105.

⁴⁸ P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970*, INED, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979, pp. 7-47.

⁴⁹ H. Islami, "Problem nataliteta pri Albancih", *Časopis za kritiko znanosti*, št. 89-90, Ljubljana, 1986, ff.37-67; H. Islami, "Zakasnjela demografska tranzicija na Kosovu u okviru demografskog prelaznog razdoblja u Jugoslaviji i Evropi", *Sociologija*, nr. 3, Beograd, 1985, ff. 372-374.

⁵⁰ P. Festy, *Po aty*.

pikëpamje kohore ishin mjaft variabile, ndërsa në aspektin territorial dhe social mjaft homogjene, por në nivel shumë të lartë. Në periudhën prej kur disponohet me të dhëna, nga fillimi i shekullit XX dhe para tij e deri në gjysmën e këtij shekulli norma e nataliteti në Kosovë sillej midis 35,0 dhe 50,0 promilë,⁵¹ ndërsa mortaliteti i përgjithshëm midis 38,0 e 20,0 promilë dhe vdekshmëria e foshnjave mbi 200 promilë mesatarisht në vit, që në shkencën demografike dhe mjekësore konsiderohet vlerë ekstreme.⁵²

Vetëm pas fillimit të viteve të 60-ta nis të zvogëlohet mortaliteti i përgjithshëm, kur norma e tij bie nën 14 promilë edhe pse mortaliteti i foshnjave mbetet shumë i lartë (rreth 133 promilë), ndërkaq shkalla e natalitetit fillon të reduktohet nga viti 1965, kur zvogëlohet nën nivelin prej 40 promilësh, që nënkupton se ende është në nivel mjaft të lartë. Mbrojtja e dobët shëndetësore, standardit shumë i ulët jetësor dhe minimumi ekzistencial jetësor si dukuri përcjellëse, kushtet e rënda higjienike, niveli i ulët i arsimit dhe i kulturës shëndetësore etj. ishin shkaqet kryesore të nivelit të lartë të këtyre komponentëve riprodhues, midis të cilëve gjithnjë ka ekzistuar një shkallë e lartë e paralelizmit, ku vdekshmëria e lartë ka kushtëzuar lindshmërinë e lartë dhe e kundërta.⁵³ Shumë më vonë, në vitet e 50-ta ushqimi ishte aq i njëtrajtshëm dhe i pamjaftueshëm sa që ekspertët konstatuan se "në pjesën dërmuese të popullsisë ushqimi është në atë masë larg parimeve themelore të fiziologjisë sa që mund të thuhet se ai i kundërvihet ligjeve të fiziologjisë së ushqimit dhe është për t'u habitur se si mund të mbahet organizmi me këtë ushqim".⁵⁴

⁵¹ Norma e natalitetit midis 32, 0 dhe 35, 0 promilë në fund të viteve të 30-ta të shekullit XX duket se është vlerësuar tepër ulët. Këtë nivel të lindshmërisë, p. sh., popullsia e Kosovës e kishte në fund viteve të 70-ta, ndërsa popullsia shqiptare e saj madje gjatë gjithë viteve të 80-ta (Kr. B. Breznik, "Natalitet i fertilitet stanovništva Jugoslavije", *Stanovništvo*, 3-4/1976 – 1-4/1977, CDI, IDN, Beograd, 1977, f. 69.

⁵² *Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954. godine, Prikazi 20*, Zavod za statistiku Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 68-71.

⁵³ A. Sauvy, *Théorie générale de la population (La vie des populations)*, Vol. II, Presses Universitaires de France, Paris, 1966, pp. 73-100, 128-158.

⁵⁴ K. Šnajder, "Ishrana i njen uticaj na biološku snagu stanovništva u Autonomnoj Kosovsko-Metohijskoj Oblasti", *Zbornik radova SAN*, XXVII, Institut za izučavanje ishrane naroda, knj. 2, Beograd 1953; *Stanje i mogućnosti razvoja privrede Kosova i Metohije*, Priština, 1957, f. 27.

Tabela 1. Lëvizja e numrit absolut dhe e normës së lindjeve në Kosovë prej vitit 1911-1940⁵⁵

Viti	Numri i të lindurve gjallë	Në 1.000	Viti	Numri i të lindurve gjallë	Në 1.000 banorë
191	19.691	45,0	1926	22.528	44,9
191	18.445	41,7	1927	22.798	44,4
191	17.600	39,2	1928	22.584	44,9
191	15.975	35,5	1929	22.531	42,0
191	12.166	27,7	1930	22.003	40,0
191	14.437	32,9	1931	22.446	40,4
191	13.995	32,1	1932	22.927	40,5
191	13.351	31,4	1933	22.696	39,4
191	19.173	44,6	1934	23.198	39,5
192	21.555	49,9	1935	22.315	37,3
192	23.412	52,1	1936	22.119	36,4
192	22.857	50,0	1937	22.004	35,4
192	21.126	49,9	1938	22.565	35,9
192	23.378	48,7	1939	20.735	32,4
192	23.049	46,9	1940	21.254	32,7

Tabela 2. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës prej 1911-1940 sipas periudhave pesëvjeçare (në promilë)⁵⁶

Periudha	Nataliteti	Mortaliteti	Shtimi natyror	Mortaliteti i foshnjave
1911-1915	38,0	34,0	4,0	-
1916-1920	39,0	38,0	1,0	-
1921-1925	49,0	30,0	19,0	-
1926-1930	43,0	25,0	18,0	-
1931-1935	39,0	21,0	18,0	198,2
1936-1940	35,0	18,0	17,0	161,8

⁵⁵ Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva Srbije od 1863. do 1954. godine*, Prikazi 20, Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 68-71.

⁵⁶ Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954. godine*, Prikazi 20, Zavod za statistiku Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 68-71; *The Population of Yugoslavia*, Demographic Research Center, Institut of Social Sciences, Belgrade, 1974, p. 14; H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 37; *Statistički godšnjak Jugoslavije* (vitet përkatëse), SZS, Beograd, 1991-1994; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku*, br. 024, Beograd, 30.01.1997, ff. 10-12.

Në vdekshmërinë tepër të lartë (te foshnjat, fëmijët e vegjël, femrat në të gjitha grupmoshat, veçanërisht në vitet e para të jetës dhe në periudhën e riprodhimit biologjik) kanë ndikuar natyrisht faktorët ekzogjenë, sidomos luftërat, që shihet qartë nga numri i madh i vdekjeve midis viteve 1914-1918, kur kanë ndodhur Luftërat Ballkanike dhe Lufta I Botërore. Prandaj deri në fund të gjysmës së parë të këtij shekulli, ndërsa në shumë mjedise rurale edhe më vonë, shtimi natyror ishte i ulët dhe përgjithësisht me rrjedha ciklike dhe përparimi demografik i ngadalshëm. Deri në vitet e 50-ta shkalla e mortalitetit në Kosovë mund të krahasohej me vlerat ekstreme në botë, me vendet më të pazhvilluara të botës.⁵⁷ Nga ky trend i këtyre dy komponentëve të lëvizjes natyrore ndryshonin shumë normat e shtimit natyror, që rezultonte me një fluktuim të madh edhe lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Lëvizjet ciklike dhe ritmet e ndryshme të evolucionit demografik vareshin nga sigurimi i kushteve ekzistenciale, që lidhej me sasinë e prodhimtarisë bujqësore, me intensitetin e sëmundjeve epidemike (mortaja, kolera, lia, malaria, tuberkulozi, tifoja etj.) dhe faktorët e tjerë të jashtëm. Këto dhe janë arsyet kryesore pse është vonuar kaq shumë procesi i transicionit demografik në Kosovë, në trojet e tjera dhe te shqiptarët në përgjithësi.

⁵⁷ P.sh. në gjysmën e viteve të 50-ta me Egjiptin (21 promilë), Sudanin (19 promilë) etj. Shih: F. Gendreau, *La population de l'Afrique. Manual de démographie*, Khartala, CEPED, Paris, 1993, pp. 1-463.

Hivzi Islami, Prishtina

DEMOGRAPHIC TRANSITION AS GLOBAL PROCESS

Résumé

With the material, social and mental development of humanity and the long stagnation of quantitative and qualitative demographic evolution, the world marks a colossal progress in the population rhythm, where 18th and 19th centuries and the 20th century in particular stand out. The demographic history of the developed Western European countries proves the pessimistic views of the malthusians and neo-malthusians entirely wrong. In the vast majority of these countries, due to major social, economic, educational, health and traffic changes and, consequently, of the first drop in first mortality and then natality, the process of demographic transition has already ended or almost all countries of the world have reached different stages thereof. Therefore, one can speak of demographic transition a global process now.

By the end of the 19th century, the fertility process in these developed countries belonged to the "natural" type, which was rationalized then by major social and economic changes in broad terms: the drop of death and birth rates, late entry into marital union, growth of celibacy, embracement of social norms of small family, improvement of the position of women in family and society, humanism in relations between the genders, socialism of key aspects of life, expansion of individual aspirations, increase of financial and psychological investment in children, reduction of women's biological role and increase of the roles of working time and leisure time, no more need to engage children in economic and social life, etc. Views and behaviours toward population's biological reproduction, as created in the given socioeconomic system, were also transformed by the modernization of the system. It was on the basis of such an altered system that new social views and norms on marriage and time of entry into it, number of children and time intervals between births and family size and, hence, embracing birth control in marriage as a "lifestyle" were created. Due to the late and slow economic, social, educational and health growth, etc., Kosovo and Albanian population are still considered today as the last demographic transition in Europe, with all demographic and social consequences that the process entails.

Justina Shiroka Pula, Albulena Kadriu, Prishitë

BIZNESET NË PRONËSI TË GRAVE

(Bazuar në faktorin e edukimit, moshës dhe lokacionit ku vepron firma)

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim që të tregojë relacionin ndërmjet BVM-ve në pronësi të grave dhe faktorëve siç është moshë, edukimi dhe lokacioni ku operon firma. Bizneset gjithnjë e më shumë po konsiderohen motor i zhvillimit ekonomik si nga akademikët, ashtu edhe nga politikëbërësit, prandaj interesimi për hulumtimin e faktorëve që përcaktojnë dhe nxisin hapjen dhe suksesin e ndërmarrësisë është aktualizuar. Përkundër kësaj rëndësie të madhe, ekziston një zbrastëritje në literaturën e vendeve në tranzicion, e sidomos në Kosovë, sa i përket hulumtimit të faktorëve që përcaktojnë dhe ndikojnë në fillimin dhe në zhvillimin e firmës.

Rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim kanë për qëllim të japin një pasqyrë sa më të qartë të pjesëmarrjes së grave në fushën e biznesit, duke marrë parasysh jo vetëm edukimin dhe moshën, por dhe lokacionin ku vepron firma. Duke i analizuar këta faktorë, do të japim një pasqyrë sa më të qartë të pjesëmarrjes së gruas në fushën e biznesit, duke u bazuar në anketën me 500 biznese.

Fjalët kyçe: BVM-të, gjinia, lokacioni, edukimi dhe moshë e grave në biznes, financat.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi është që të jep kontribut në fushën e biznesit dhe ndërmarrësisë, duke i identifikuar faktorët që përcaktojnë mundësinë e fillimit dhe zhvillimin e biznesit, si dhe sfidat e grave në fushën e biznesit. Suksesi i këtyre bizneseve nënkupton edhe krijim të punësimit dhe të rritjes ekonomike. Shumëherë është argumentuar nga

shkencëtarët e ekonomisë, se bizneset e vogla dhe të mesme janë motorë të rritjes ekonomike, përmes vendeve të reja të punës.¹

Kontributi i biznesit të vogël dhe të mesëm në ekonomi ka zgjuar interesimin e shumë njohësve të ekonomisë dhe politikëbërësve në ekonomitë në zhvillim, duke aluduar gjithmonë se rritja e biznesit të vogël ndikon në rritjen e zhvillimit ekonomik.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të bëjë analizimin e pjesëmarrjes së gruas në fushën e biznesit të vogël dhe të mesëm, varësisht prej lokacionit ku operon firma, moshës dhe edukimit të pronares. Të dhënat që janë kryqëzuar për këtë hulumtim janë marrë nga anketa e zhvilluar nga Business Support Center of Kosovo (BSCK).²

Korniza teorike

Duke pasur parasysh se ndërmarrjet-bizneset e vogla dhe të mesme (BVM) punësojnë një numër të madh punëtorësh dhe janë përgjegjëse për inovacion dhe produktivitet, është e rëndësishme që politikëbërësit dhe vendimmarrësit të jenë të informuar mirë për përcaktuesit e rritjes së BVM-ve dhe çështjet e tjera që ndikojnë në sigurimin e financimit të rritjes dhe të zhvillimit të këtij sektori.³

Gjatë viteve të tetëdhjeta, kontributi i grave në sektorin e biznesit, si pronare e biznesit apo si ofruese e punës në pronësi të biznesit familjar, ishte jo shumë atraktiv për politikëbërësit, por edhe për akademikët. Rritja e interesimit në sektorin e biznesit të vogël u manifestua me rritjen e numrit të grave në vetëpunësim. Orientimi i grave kryesisht në fushën e biznesit të vogël u përqendrua mbi motivin për fillimin e biznesit, pasi që në këtë fazë edhe barrierat gjinore ishin në një masë më të vogla për bizneset në pronësi të grave.

Në Evropë hulumtimet përqendrojnë vëmendjen e tyre, duke u përpjekur për të krijuar lidhjet midis motivit të femrave për vetëpunësim dhe pozicionit të përgjithshëm të gruas në tregun e

¹ Smallbone, D and F Welter (2003). Institutional development and entrepreneurship in transition *Strategy Development*. Bulgaria: US Agency for International Development, transition economies. *Journal of East-West Business*, 6(2), 59–94.

² Qendra për Mbështetje të Biznesit Kosovë –BSCK.

³ Becchetti, & L. and Trovato, G. (2002). The determinants of growth for small and medium sized firms: the role of the availability of external finance. *Small Business Economics*.

punës. Nga këto është theksuar se, megjithatë, qëllimi i shumicës së studimeve ishte 'kryesisht për të bërë krahasime me sipërmarrësit burra dhe për t'i bërë sipërmarrëset gra të dukshme'.⁴

Disa studime kanë shqyrtuar se çështja e menaxhimit të bizneseve në pronësi të grave është shumë më e sofistikuar, më e përkushtuar, prandaj ka filluar një fokus i studimeve për t'u përqendruar në efektin e gjinisë në fushën e biznesit. Përvojat e grave të vetëpunësuarra pjesërisht pasqyrojnë përvojat e tyre individuale, si dhe qëndrimin e përgjithshëm të grave në tregun e punës.

Disa autorë, Goffe and Scase,⁵ si dhe Carter and Cannon⁶ kanë sugjeruar se vetëpunësimi për gratë është edhe një veprim dhe një mjet për të ikur nga pabarazitë e vazhdueshme dhe kufizimet profesionale në tregun e punës. Nisja e një biznesi shpesh shihet qartë, do të thotë anashkalohet 'tavani i qelqtë' i përjetuar nga shumë gra.⁷

Disa hulumtime tregojnë se përvoja para hapjes së biznesit në tregun e punës ka të bëjë me aftësinë e individëve për të mobilizuar burimet e duhura për fillimin e biznesit. Në krahasim me burrat, gratë e fillojnë biznesin me më pak mjete financiare, me më pak eksperiencë në menaxhim.⁸

Mungesa e kapitalit fillestar mund të jetë pengesë për të rritur dhe zhvilluar biznesin, pra mjetet e pamjaftueshme apo të kufizuara i vënë gratë në disavantazh me ambientin konkurrues.

Mungesa e mjeteve financiare për biznes është megjithatë pengesë si për burrat, ashtu edhe për gratë. Winborg dhe Landstrom⁹ argumentojnë se problemet financiare (mungesa e fondeve të

⁴ Carter, S. (2000), "Improving the numbers and performance of women-owned business: some implications for training and advisory services, Emerald Insight, Education+Training Vol42, Iss4/5, f.328-329.

⁵ Goffee, R. and Scase, R. (1985), *Women in Charge: The Experience of Female Entrepreneurs*, Allen & Unwin, London

⁶ Carter, S. and Cannon, T. (1992), *Women as Entrepreneurs*, Academic Press, London.

⁷ Buttner, E.H. and Moore, D.P. (1997), "Women's Organizational Exodus to Entrepreneurship: self-reported motivations and correlates with success", *Journal of Small Business Management*, January, pp. 34-47.

⁸ Carter, S. (2000), "Improving the numbers and performance of women-owned business: some implications for training and advisory services, Emerald Insight, Education+Training Vol42, Iss4/5, f.328-329.

⁹ Winborg, J., & Landstrom, H. (2001). Financial bootstrapping in small businesses: examining small business managers' resource acquisition behaviors. *Journal of Business Venturing*, 235 – 254.

kufizuara) ndikojnë në zhvillimin dhe në rritjen e BVM-ve, për shkak se shumë BVM nuk janë në gjendje të kenë qasje në fondet e njëjta financiare, në të cilat ka qasje rrjeti i kompanive të mëdha.

Nocioni i "hendekut financiar" brenda sektorit të BVM-ve është mbështetur nga një numër i studiuesve - autorëve, si: Berger dhe Udell;¹⁰ Pissarides;¹¹ Becchetti dhe Trovato¹² dhe Carter et al.¹³

Gjithashtu është potencuar se hendeku financiar është edhe më i madh për bizneset në pronësi të grave. Studiuesit Riding dhe Swift;¹⁴ Breen et al.;¹⁵ Brush et al.,¹⁶ Riding dhe Swift¹⁷ kanë potencuar se punimet e mëhershme kanë mbështetur idenë se është duke u bërë një diskriminim i thellë nga bankierët ndaj grave që janë sipërmarrëse, konkludim që është i bazuar në perceptimin subjektiv nga shumë gra, por që nuk është i bazuar në të dhëna statistikore.

Studimet e mëhershme rreth financimit të bizneseve që janë në pronësi të grave kanë rezultuar se janë jashtëzakonisht të limituara dhe ka shumë pak informacione rreth lidhjes së financimit të bizneseve në

¹⁰ Berger, A. N. and Udell, G. F. (1998) The economics of small business finance: the roles of private equity and debt markets in the financial growth cycle, *Journal of Banking and Finance*, 22(6 – 8), pp. 613 – 673.

¹¹ Pissarides, F. (1999) Is lack of funds the main obstacle to growth? EBRD's experience with small- and medium-sized businesses in Central and Eastern Europe, *Journal of Business Venturing*, 14(5 – 6), pp. 519 – 539.

¹² Becchetti, & L. and Trovato, G. (2002). The determinants of growth for small and medium sized firms: the role of the availability of external finance. *Small Business Economics*.

¹³ Carter, N. M., Brush, C. G., Gatewood, E. J., Greene, P. G. and Hart, M. M. (2003) Financing high growth enterprise: is gender an issue?, in: *Critical Junctures in Women's Economic Lives: A Collection of Symposium Papers*, pp. 45 – 51 (Minneapolis: The Center for Economic Progress).

¹⁴ Riding, A. and Swift, C. S. (1990) Women business owners and terms of credit: some empirical findings of the Canadian experience, *Journal of Business Venturing*, 5(5), pp. 327 – 340.

¹⁵ Breen, J., Calvert, C. and Oliver, J. (1995) Female entrepreneurs in Australia: an investigation of financial and family issues, *Journal of Enterprising Culture*, 3(4), pp. 445 – 461.

¹⁶ Brush, C. G., Carter, N., Gatewood, E., Greene, P. G. and Hart, M. M. (2001) An Investigation of WomenledFirms and Venture Capital Investment: A Report for the U.S. Small Business Administration, Office of Advocacy, and the National Women's Business Council (Washington, DC: CB Associates)

¹⁷ Riding, A. and Swift, C. S. (1990) Women business owners and terms of credit: some empirical findings of the Canadian experience, *Journal of Business Venturing*, 5(5), pp. 327 – 340.

pronësi të grave dhe rritjes e zhvillimit të tyre, prandaj hulumtimet e shumë studiuesve kanë theksuar se ka rezultate dhe prova kontradiktore rreth asaj që mjetet financiare mund të paraqesin problem për gratë që fillojnë dhe drejtojnë biznesin.

Për këtë arsye, në këtë punim është analizuar një qasje tjetër për faktorët që përcaktojnë mundësitë e fillimit dhe zhvillimit të bizneseve në pronësi të grave. Kjo analizë bazohet në relacionin, përkatësisht në të dhënat që janë kryqëzuar ndërmjet BVM-ve në pronësi të grave dhe faktorëve siç janë moshja, edukimi dhe lokacioni ku operon firma.

Metodologjia

Punimi do të bazohet në literaturë shkencore dhe profesionale nga fusha e ndërmarrësisë dhe biznesit, duke shpjeguar rolin e grave në fushën e biznesit. Në fillim është shqyrtuar literatura që ka të bëjë me objektin e studimit, pastaj mbledhja e të dhënave primare që janë nxjerrë nga hulumtimi përmes një veprimtarie praktike që bëhet me burime të kufizuara kohore dhe burimore.

Të dhënat janë grumbulluar përmes hulumtimit, duke u bazuar në të dhëna të strukturuar dhe si mjet hulumtimi ishte pyetësori. Ky punim është i bazuar në analizat statistikore të të dhënave të mbledhura, si pjesë e një hulumtimi të gjerë – i kryer nga Qendra për Mbështetje të Biznesit në Kosovë (BSCK), e që përfshin 500 kompani në vend. Procesi i hartimit të pyetësorit anketues dhe përzgjedhja e mostrës është mbështetur nga ekspertët e shumtë. Përveç kësaj, diskutimet janë mbajtur me palët e interesuara, ku është zhvilluar edhe një pilotim i pyetësorit. Intervistat janë kryer ballëpërballë me njerëzit kyç në çdo ndërmarrje, ku të intervistuarit kanë qenë kryesisht pronarë/drejtuues financiarë ose menaxherë. Pyetësori përmban nëntë seksione, duke mbuluar aspekte kryesore të ndërmarrësisë dhe zhvillimit të BVM-ve në Kosovë, por për këtë hulumtim janë përdorur vetëm pyetjet që kanë pasur të bëjnë me lokacionin e firmës, moshën dhe edukimin e pronares - drejtueses, financiarese ose menaxheres. Përgjigjet në këto pyetje janë kryqëzuar me përgjigjet në pyetjen e gjinisë dhe janë përdorur për të vërtetuar tri hipotezat e mëposhtme.

Parashtrimi i hipotezave

Duke u bazuar në njohuritë e fituara nga rishikimi i literaturës përkatëse rreth pjesëmarrjes së grave në botën e biznesit të vogël dhe të mesëm, gjithashtu duke u bazuar në njohuritë nga përvoja dhe kontakti me shumë persona të dy gjinive që janë pjesë e sferës së biznesit, kemi ardhur në përfundim që duhet të parashtrihen hipotezat në vijim:

H 1, 2, 3 = hipotezat alternative; H 0 = hipoteza 0

Hipoteza 1: Gratë kanë pasur iniciativë për të hapur firmë më shumë në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës, siç janë Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjlani, Ferizaj dhe Mitrovica sesa në qytet e tjera.

Hipoteza 0: Gratë nuk kanë pasur iniciativë për të hapur firmë më shumë në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës, siç janë Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjlani, Ferizaj dhe Mitrovica, sesa në qytet e tjera.

Hipoteza 2: Gratë e moshës njëzet dhe tridhjetë vjet kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë mbi moshën dyzetvjeçare.


Hipoteza 0: Gratë e moshës njëzet dhe tridhjetë vjet nuk kanë numër më të vogël të bizneseve sesa gratë mbi moshën dyzetvjeçare.

Hipoteza 3: Gratë e moshës me edukim universitar kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë vetëm me shkollë të mesme.

Hipoteza 0: Gratë e moshës me edukim universitar nuk kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë vetëm me shkollë të mesme.

Rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi

Në figurën në vijim është bërë kryqëzimi i të dhënave nga pyetësi, i cili është realizuar për bizneset e vogla dhe të mesme. Qëllimi i këtij kryqëzimi ka qenë që të kuptohet si qëndron raporti apo ndërlidhja ndërmjet qyteteve më të mëdha në Kosovë dhe gjinisë së pronarëve. Rezultatet e këtij kryqëzimi po arrijnë ta vërtetojnë edhe hipotezën e parë, e cila thotë se gratë kanë pasur iniciativë për të hapur firmë më shumë në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës, siç janë: Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjlani, Ferizaj dhe Mitrovica sesa në qytet e tjera.




Nga kjo figurë shihet se hapja e firmave nga gratë në zonën urbane është dukshëm më e lartë se në zonat e tjera më pak urbane. Në këtë rast shihet se qyteti i Gjakovës dhe ai i Gjilanit dukshëm prijnë me përqindjen më të lartë të hapjes së firmave nga gratë, me 33 për qind. Në vend të dytë vijnë Prishtina dhe Prizreni, që kanë një përqindje prej përafërsisht 22 për qind. Kjo tregon se 22 për qind të bizneseve që janë të hapura në këto qytete i kanë pronare gratë, ndërsa 78 për qind e biznesit udhëhiqen nga burrat. Në vend të tretë paraqitet qyteti i Mitrovicës, ku 14 për qind të bizneseve në këtë qytet i përkasin pronareve gra, përderisa 86 për qind udhëhiqen nga burrat.

Ky kryqëzim i të dhënave na jep një gjetje shumë interesante, duke treguar se Ferizaj dhe Peja kanë një përqindje mjaft të ulët të firmave me pronare gra, se në Ferizaj pjesëmarrja e grave në botën e biznesit si pronare është vetëm 8 për qind, ndërsa në Pejë vetëm 4 për qind.

Në vendet e tjera të cilat janë më pak urbane, pjesëmarrja e grave si pronare të firmave në botën e biznesit është rreth 11 për qind, çka do të thotë se në këto rajone 90 për qind e biznesit udhëhiqet nga burrat.

Në përgjithësi ky kryqëzim na tregon se në tërë Kosovën vetëm 15 për qind e biznesit të vogël dhe të mesëm udhëhiqet nga gratë, ndërsa 84 për qind nga burrat.




Krahasuar me vendet e tjera në rajon, pjesëmarrja e grave në botën e biznesit në Kosovë lë shumë për t'u dëshiruar.

Hipoteza e dytë:

Hipoteza 2: Gratë e moshës njëzet dhe tridhjetë vjet kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë mbi moshën dyzetvjeçare.

Hipoteza 0: Gratë e moshës njëzet dhe tridhjetë vjet kanë numër më të vogël të bizneseve sesa gratë mbi moshën dyzetvjeçare.

Në figurën në vijim është bërë kryqëzimi i të dhënave ndërmjet moshës dhe gjinisë. Nga këto të dhëna shihet se gratë që kanë pjesëmarrjen më të madhe në biznes janë ato që i përkasin moshës 30 deri në 40 vjet, e pjesëmarrja në total është rreth 21 për qind. Në grupin e dytë janë gratë të cilat janë nën moshën 20-vjeçare, me 18 për qind (por duke pasur parasysh që mostra është shumë e vogël për këtë grup, mund edhe të mos përfshihet si e dhënë e saktë, megjithatë mund të merret si e dhënë krahasuese për hulumtimet e tjera që bëhen në këtë fushë). Pjesëmarrja e grave si pronare të biznesit, të cilat i përkasin moshës 20 deri 30 vjet dhe 40 deri 50 vjet paraqitet me 13 për qind. Në tërë këtë, gratë që kanë moshë mbi 50 vjet paraqiten me një pjesëmarrje prej 11 për qind.



Në tabelën e radhës paraqiten të dhënat e njëjta si numra normalë, për të kuptuar më lehtë se në çfarë totali e paraqet secila përqindje.

Mosha	Gratë	Burrat	(blank)	Grand Total	Gratë	Burrat	(blank)	Grand Total
-20	18.18%	81.82%	0.00%	100.00%	6	27		33
20-30	13.04%	86.96%	0.00%	100.00%	18	120		138
30-40	20.77%	79.23%	0.00%	100.00%	27	103		130
40-50	13.60%	85.60%	0.80%	100.00%	17	107	1	125
5+	10.81%	89.19%	0.00%	100.00%	8	66		74
Grand Total	15.20%	84.60%	0.20%	100.00%	76	423	1	500


Në bazë të këtyre analizave mund të themi se është bërë vërtetimi i hipotezës së dytë. Pasi që gratë e moshës njëzet dhe tridhjetë vjet, e sidomos ato të moshës 30-40 vjet kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë mbi moshën dyzetvjeçare.

Pra, në sektorin e biznesit privat, gratë e moshave të ndryshme kanë entuziazëm për punë, ide inovative dhe kreativitet. Ato ballafaqohen me dëshirën për të qenë ndërmarrëse, kanë vullnet për të kontribuar në shoqëri dhe në familje dhe shkathtësi për t'u ballafaquar me konkurrencën. Gratë e moshës 30-40 vjet kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë e kategorive të tjera. Kjo grupmoshë paraqet moshën e pjekurisë, stabilitet në familje dhe në karrierë.

Hipoteza e tretë:

Hipoteza 3: Gratë e moshës me edukim universitar kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë vetëm me shkollë të mesme.

Hipoteza 0: Gratë e moshës me edukim universitar nuk kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë vetëm me shkollë të mesme.



Duke i kryqëzuar të dhënat e edukimit dhe grave që posedojnë biznese, shihet se gratë që kanë diplomë pasuniversitare dhe ato me shkollim fillor kanë përqindjen më të lartë të bizneseve. Më saktësisht, marrin pjesë me rreth 30 për qind. Në grupin e dytë hyjnë gratë që kanë shkollim të mesëm, përqindja e të cilave është 17 për qind, ndërsa me numrin më të vogël paraqiten gratë me shkollim universitar, të cilat marrin pjesë me 11 për qind.

Të dhënat e mësipërme nuk arrijnë ta vërtetojnë hipotezën e tretë, andaj mund të themi se është vërtetuar hipoteza zero, e cila thotë se gratë e moshës me edukim universitar nuk kanë numër më të madh të bizneseve sesa gratë vetëm me shkollë të mesme.

Për shumicën e grave me të ardhura të kufizuara, pa shpresë për punë, me nivel të arsimimit dhe pa ndonjë nivel të lartë edukativ, nxit idenë apo mundësinë e zgjidhjes për të filluar - hapur bizneset e tyre. Të gjitha këto gra që orientohen në këtë sferë të biznesit fillojnë ta menaxhojnë rolin e tyre sa më mirë, për të pasur sukses, mirëpo duke shpresuar se do ta kenë mbështetjen e familjes dhe të rrethit të tyre.

Autorët Mainiero dhe Sullivan¹⁸ dhe O'Neil dhe Bilimoria¹⁹ në veprat e tyre kanë potencuar: “Jeta dhe karriera e grave duhet të ndryshojë gjatë rrjedhës së jetës së tyre dhe gratë duhet të kërkojnë mbështetje institucionale për këto nevoja, duhet të kërkojnë mjete financiare, duhet të sigurojnë se ato gjithmonë do të jenë në gjendje të ofrojnë talentin e tyre, aftësitë dhe idetë për familjet e tyre, organizatat dhe shoqërinë”.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Duke u bazuar nga hulumtimet e mëhershme dhe në të dhëna bazike statistikore, vërehet se bizneset në Kosovë menaxhohen kryesisht nga burrat (edhe ky hulumtim tregon se në tërë Kosovën vetëm 15.20 për qind e bizneseve të vogla dhe të mesme udhëhiqen nga gratë, ndërsa 84.60 për qind nga burrat). Krahasuar me vendet e tjera në rajon, pjesëmarrja e grave në botën e biznesit në Kosovë lë shumë për t’u dëshiruar.

Mirëpo mund të thuhet që gratë në kohën e fundit po avancohen në aspektin profesional, po krijojnë karrierë dhe po arrijnë sukses. Gratë në biznes po tregojnë një performancë të mirë, ato kanë aftësi, vullnet dhe po e përforcojnë autoritetin për ta menaxhuar firmën.

Në punim është hulumtuar relacioni ndërmjet BVM-ve në pronësi të grave dhe faktorëve, siç janë moshë, edukimi dhe lokacioni ku operon firma. Në bazë të këtij hulumtimi, ku është bërë kryqëzimi i të dhënave nga 500 firma të vogla dhe të mesme, jepen rekomandimet e mëposhtme:

Rekomandohet që të bëhen analiza më të thella dhe të gjinden arsyet që ndikojnë që gratë me shkollim universitar kanë numër më të vogël të bizneseve se çdo kategori tjetër e cila ka shkollim më të theksuar apo më të mangët.

Rekomandohet që të zhvillohen fonde dhe ndihma financiare, të cilat si target kanë gratë e moshës 20-vjeçare, të cilat shprehin vullnet dhe gatishmëri për të qenë sipërmarrëse. Po ashtu sugjerohet që të

¹⁸ Mainiero, L.A. and S.E. Sullivan (2005), ‘Kaleidoscope careers: An alternate explanation for the “opt-out” revolution’, *Academy of Management Executive*, 19, 106–23.

¹⁹ O’Neil, D.A. and D. Bilimoria (2005a), ‘Women’s career development phases: idealism, endurance, and reinvention’, *Career Development International*, 10(3), 168–89.

krijohet një qendër, ku këto gra mund të drejtohen nëse kanë nevojë për informata rreth hapjes së bizneseve të vogla dhe të mesme.

Meqenëse hulumtimi ka treguar se gratë në vende më pak urbane kanë numër më të vogël të bizneseve, atëherë rekomandohet që të krijohen qendra të vogla për këshillime biznesore në këto rajone, në mënyrë që të gjitha femrat që dëshirojnë të hapin biznes të kenë mundësi të barabarta.

Ninon Grangé, Paris

ZBULIMI I JUS POST BELLUM: FUNDI I LUTËS APO DALJA NGA LUFTA?

Abstrakti

Ius post bellum në të drejtën romake antike nuk ekziston. Hulumtues bashkëkohorë, ndoshta për hir të përtëritjes efemere të teorive të luftës së drejtë e kanë plotësuar kësajsoj, *more Romano*, *ius ad bellum* dhe *ius in bello*, që përbëjnë të drejtën për të bërë luftë. Teoritë e traditës së luftës së drejtë kishin një përmbajtje doktrimore dhe një përmbajtje morale; ato bënë që brenda elaborimeve të sotme të paraqitet një seri e kriterëve të domosdoshme dhe të mjaftueshme për ta bërë një luftë të drejtë, megjithatë më pak rigorozë se te sistemet e Grotius, Pufendorf apo Vattel. I integruar brenda kësaj tradite të gjerë, *ius post bellum* është një nocion ambivalent. Më së shpeshti ajo shërben për ta ripërtërirë idenë e të drejtës ndërkombëtare për luftë, duke ia shtuar idenë për konventa për kohën e pasluftës, duke pasur parasysh përgjegjësinë e fituesve dhe mbrojtjen e të mundurve. Një pikëpamje tjetër e *ius post bellum* bën që kjo të bëhet një emër tjetër për drejtësinë tranzicionale, alternativë kolektive dhe e menduar mirë, mundësisht ndërkombëtare ndaj drejtësisë retributive (ndëshkuese). Në këtë artikull propozoj një qasje tjetër ndaj *ius post bellum*, jo të kundërtshme me ato të mëparshmet, e cila mbështetet mbi dallimin të cilin e bën të mundur anglishtja midis “end of war” dhe “ending of war”. Kjo qasje është pra një pikëpamje e kohësisë politike të pasluftës gjatë së cilës dalja dhe fundi i luftës nuk përputhen doemos. Kjo nënkupton së pari braktisjen e vizionit thjeshtëzues, linear, i cili i referohet hapësirës, pastaj kohën kronologjike dhe atë të historisë mbi të cilën mbështetet shumë shpesh filozofia politike, pastaj të rishqyrtohet kohësia (bërja e luftës dhe dalja nga lufta) brenda së cilës mendohet lufta. Dhe atëherë shpejtësia dhe ritmi i ngjarjes, duke u nisur nga politikja në perceptimin dhe prodhimin e saj dalin të domosdoshme për të kuptuarit e kësaj kohësie të veçantë e cila zbulohet nga *ius post bellum*.

Fjalët çelës: *ius post bellum*, kohësia politike, lufta e drejtë.

Hyrje

Do të doja, në suazë të problematikës se këtij simpoziumi, ta shtroj këtë pyetje: ajo që quhet *ius post bellum* a e ndryshon natyrën e

luftës apo ndoshta perceptimin tonë të luftës? Nuk jam fare e sigurt që ka një modifikim të natyrës së luftës në histori. Ndoshta evoluime teknike, evoluime historike gjithsesi, por këto ndryshime nuk e modifikojnë në thellësi perceptimin tonë se jemi në luftë. Këtë e kam vënë në pah më parë, tani nuk do t'i kthehem kësaj¹. Do të propozoja një mënyrë të re filozofike për ta menduar luftën dhe për ta regjistruar brenda shkencave shoqërore. Kështu do të bëhet fjalë më shumë për rregullsinë se sa për të drejtën, më shumë për referencën se sa për instanca juridike apo politike në mënyrë që të mund të na bëjë të mundur të mendojmë çdo fenomen luftarak, çdo dhunë sistematike midis disa entiteteve kolektive të formuara, ky është definicioni im i luftës. Kategoritë e intervenimit, të ingerencës, të konfliktit me intensitet të ulët apo të lartë, etj., janë nga ky pikëshikim kategori që nuk janë drejtpërsëdrejti filozofike, ato nuk zëvendësojnë një elaborim konceptual, ato janë përshkrime e jo qasje për natyrën e luftës.

Ta përkufizosh luftën si një dhunë sistematike që implikon disa entitete kolektive i ridistribucion aksionet dhe aktorët ndryshe nga kundëvëniet e njohura midis luftës së brendshme dhe asaj të jashtmes, civile dhe ndërshtetërore, duale apo vendore. Së paku ky është pikëshikimi që kam përvetësuar, me idenë se në një luftë marrin pjesë njëherazi më shumë nga këto kategori.

Ius post bellum është një shprehje konceptuale e cila është sajuar duke u nisur nga traditat e luftës së drejtë, që shkurtazi nis me Ciceronin, shkon deri te Emmerich de Vattel, duke kaluar kah Shën Augustini, shën Toma i Akuitit, Vitoria dhe jusnatyralistët Grotius et Pufendorf. Ajo është formuar nga dy shprehjet ekzistuese: *ius ad bellum* (e drejta për luftë) dhe *ius in bello* (e drejta brenda luftës), që shpesh përdoren sot për të përshkruar një të drejtë për të bërë luftë. Si e tillë ajo është reduktuese dhe deformuese, sepse, do t'i kthehem kësaj, kjo do të thotë ta bartësh një doktrinë të së drejtës natyrore brenda një doktrine të së drejtës pozitive. Është interesante se ne nuk kemi asgjë tjetër, dhe se përdorimi e mohon zbulimin e vetë konceptit.

Sot dëshiroj t'i jap një kuptim të vërtetë kësaj shprehje, në pajtim me origjinën e saj, do të thotë se do të ndalem krejt shkurtazi te origjina e luftës së drejtë për të parë se në ç'mënyrë arrihet te *ius post bellum*. Pastaj do të vë në pah se pikëpamjet e tashme të *ius post*

¹ Më lejoni të përmend këtu librin tim *Mbi luftën civile (De la guerre civile)*, Paris, Armand Colin, (*L'Inspiration philosophique*), 2009.

bellum nuk janë në fakt të lidhur me teoritë e luftës së drejtë, prandaj do t'i largoj disa domethënie të *ius post bellum*. Më në fund, para se të propozoj pikëpamjen time për *ius post bellum* dhe duke mbetur brenda sferës antike dhe duke e futur nocionin e harruar nga romakët, atë të *stasis*. Teza ime është se *ius post bellum* mund të ndihmojë në ndriçimin e kohësisë së daljes nga lufta.

Origjina: Teoritë e luftës së drejtë

Mund të identifikohen dy përmbajtje të shprehja lufta e drejtë: një përmbajtje doktrinale e cila ka ushqyer të gjitha refleksionet mbi luftën bashkë me nxjerrjen e kriterëve dhe një përmbajtje morale, ndonjëherë ideologjike, që varet nga rastësitë historike dhe ligjërimet politike. (Ajo u përdor sërish pas disa dekadave të rënies në harresë gjatë luftës së Gollit, e më pastaj asaj në Afganistan. Mund të thuhet se ky ripërdorim ideologjik, ndonjëherë i mbështetur filozofikisht, nuk zgjati shumë). Nga këto dy përmbajtje lind një ambivalencë midis asaj që është e lejuar të bësh (*licet*) dhe atë që kemi të drejtë ta bëjmë (e drejta pozitive ndërkombëtare); dhe midis asaj që është e lejuar të bësh dhe asaj që duhet të bësh. Atëherë kundërthëniet shumëfishohen: mbi mbrojtjen legjitime², mbi agresorin³, mbi diskriminimin e armikut⁴, mbi proporcionalitetin⁵ apo edhe për imunitetin e personave të pafajshëm⁶. Të gjitha këto janë ndriçime të një aspekti të teorive mbi luftën e drejtë, por kjo nuk është një përvetësim besnik. Natyrisht, këto kundërthënie ishin tanimë të pranishme brenda teorive të luftës së drejtë, fjala vjen: tri definicionet e kundërthënshme të luftës së drejtë, shembuj: tri definicionet e kundërthënshme të luftës së drejtë të Ciceroni⁷; vazhdimësia midis definicionit të luftës së drejtë dhe

² David Rodin, *War and Self-Defense*, Oxford, Oxford University Press, 2005.

³ Kjo çështje ishte e koklavitur sa për Shoqatën e Kombeve, aq edhe për momentin kur u definuan aktakuzat në Gjyqin e Nurembergut.

⁴ Kjo ishte baza e kritikës së Carl Schmitt karshi teorive të luftës së drejtë dhe latencës së tyre, veçanërisht në Shoqatën e Kombeve.

⁵ Kjo është çështja më e diskutueshme lidhur me rifillimet e luftës së drejtë të filozofët bashkëkohorë amerikanë.

⁶ Nocion gati i shpikur nga Emer de Vattel dhe që i përshkon të gjitha angazhimet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

⁷ - *Rep*, II, 31: Është e padrejtë lufta e cila nuk i është shpallur apo theksuar armikut, « *quod denuntiatum indictumque non esset* ».

legjitimimi i Kryqëzatave nga Shën Tomas i Akuinit⁸; arsyetimi i luftë gjashtëditore nga Michael Walzer, që e shpie te legjitimimi i luftës preventive në kundërtënie me gjithë atë që shkruan në librin e tij *Lufta të drejta dhe të padrejta*.⁹

Nga kjo mund të zgjedhim një përfundim të përkohshëm: teoritë e luftës së drejtë janë elaborime që i shtrohen vërejtjeve dhe diskutimit, madje edhe gjatë shekujve. Pa hyrë në diskutim, më duket se është kriteri moral i cili del si mbizotërues për të gjykuar nëse një luftë e dekolonizimit është një luftë e drejtë, a ishte legjitime të bombardohet Drezdeni etj. Teoritë e luftës së drejtë janë një pjesë e filozofisë morale e jo mënyrë e përdorimit të luftës së përsosur. Madje edhe ata që sot merren seriozisht me luftën e drejtë, ata që thirren në këtë teori¹⁰ mendojnë se nuk ka pasur luftë të drejtë ekzistuese. Mirëpo përdorimi i keq i luftës së drejtë nuk e zhvlerëson teorinë. Teoritë e luftës së drejtë janë një refleksion për ta kufizuar luftën, për të nxjerrë rregulla të cilat nuk ngatërrohen doemos me të drejtën, ato i drejtohen sa nga individi, aq edhe një entiteti kolektiv. Ato reflektojnë që të marrin parasysh aktorin dhe statusin e tij (personin), me një parim drejtues të reciprocitetit, pikërisht parimi i cili fut vështirësinë: si të vendoset një drejtpeshim reciprok aty ku lufta nuk mund të jetë e drejtë për të dy palët?; i këtillë është formulimi i thjeshtësuar i paradoksit, i cili është i pranishëm në traditat e luftës së drejtë dhe historinë e doktrinave të saj. Këto teori, pasi të jenë riaktualizuar, insistojnë te kondicionaliteti dhe serialiteti. Më të mirat, ripërvetësimet më besnike i shtrojnë edhe vetë kriteret e tyre. Fjala vjen Michael Quinlan prodhon serinë e vet të kushteve.¹¹ Kjo është kështu një përfitim. Mirëpo unë do të doja të evitoj pikërisht një zbatim modern të teorive mbi luftën e drejtë, madje edhe po të jetë ajo

- *Rep*, III, 37: Është e padrejtë luftë e cila nuk është paralmëruar formalisht dhe nuk është cekur dhe nëse nuk i takon një kërkesë për ndonjë pasuri, « *nullum bellum iustum habetur nisi denuntiatum nisi indictum nisi de repetitis rebus* ».

- *Off.*, I, 36: Nuk ka luftë të drejtë veç asaj që ka të bëjë me kërkesën e ndonjë pasurie, apo ajo që është e shtruar dhe e deklaruar « *nullum bellum esse iustum nisi quod aut rebus repetitis geratur aut denuntiatum ante sit et indictum* ».

⁸ Thomas d'Aquin, *Somme Théologique*, IIa, IIae, qu. 40 à 44.

⁹ Michael Walzer, *Guerres justes et injustes*, Paris, Belin, 1999.

¹⁰ Larry May, *War Crimes and Just Wars*, Cambridge, Cambridge University Press, 2007, fjala vjen.

¹¹ *Jus ad bellum: Just cause, proportionate cause, right intention, right authority, prospect of success, last resort. jus in bello: discrimination, proportionality.* cf. Charles Guthrie & Michael Quinlan, *Just war: The just war tradition: Ethics in modern warfare*, New York, Walker, 2007.

shumë inteligjente dhe që konsiston fundja me futjen e një pragmatizmi në serinë e kushteve për ta kufizuar luftën. Ky transformim është i rrezikshëm: Pragmatizmi nuk mund të ngatërrohet me shpresën e arsyeshme për sukses, ngase kjo e minon frymën e teorive jusnatyraliste. Dëshira për të modernizuar, për ta përshtatur teorinë e luftës së drejtë shpie te rrënim i frymës universaliste të saj¹². Më duket se është më shumë në pajtim me frymën e luftës së drejtë të mendohet me terma të përgjegjësive sesa në mbështetje të të drejtës ndërkombëtare. Kjo nuk bën që ajo të përjashtohet, por i ndanë ato: Përgjegjësia nuk është e njëjta gjë si e drejta në luftë.

Domethëniet e ndryshme (konfuze) të *ius post bellum*

Në traditat e luftës së drejtë *ius post bellum* nuk ekziston. Ai nuk është i shqyrtuar nga teorikët e luftës së drejtë, që i përmenda. Porsa lufta të ketë përfunduar, nuk ka më *ius belli*. Kalohet menjëherë te paqja. Fenomeni i luftës është shuar, nuk ka më arsye që të bëhet çështje. Në fakt, Ciceroni, Augustini apo Grociusi mendojnë se çështja është mbyllur. *Ius post bellum* që përdoret sot është diçka artificiale, një krijim, një zbulim i vonshëm i cili pak a shumë frymëzohet nga teoritë e luftës së drejtë. Prandaj e konsideroj si jobesnik shumicën e përdorimeve të nocionit *ius post bellum*, të cilat vijnë si një lehtësi për ta emëruar një të drejtë të pasluftës. (E megjithatë po insistoj: E mbështes një të drejtë të pasluftës, mendoj se ajo është e domosdoshme, por nuk dua që një nocion të përdoret për të thënë diçka tjetër nga ajo që ai mundet apo duhet ta thotë). Të kuptohet vetëm me terma juridike ajo që ka vetëm përmbajtje morale është e paarsyeshme. Të mbahet dallimi është e vetmja qasje rigoroze që mund të merret parasysh. Për hir të efikasitetit, megjithatë, mund të pranojmë një moskuptim të teorive të luftës së drejtë, me qëllim që t'i nxjerrim në dritë disa preokupime që deri më tani kanë mbetur të heshtura. Kësisoj po orvatem t'i mënjanoj të gjitha konceptet jo gjegjëse të këtij nocioni të sajuar, e pastaj ta propozoj interpretimin tim. T'i shqyrtojmë shkurtazi këto deformime të teorive të luftës së drejtë duke përzgjedhur elaborimet më interesante. Ekzistojnë disa mishërime të mundshme e konfuze të *ius post bellum*, që shkojnë prej më shumë juridike deri te ato më pak juridike. Do t'i përmend tri prej

¹² Nga ky aspekt, vetëm vazhdimi i debatit mbi rezistencën dhe të drejtën për t'iu kundërvënë një pushteti tiranik më duket pertinent dhe koherent me këtë traditë.

tyre: 1) Mishërimi në të drejtën ndërkombëtare, 2. Drejtësia e quajtur tranzicionale dhe 3. Aktiviteti nacional i komisioneve.

Brian Orend¹³, i cili ka njohuri të mirëfillta të teorive të luftës së drejtë, dhe e vë atë në shërbim të “*ius post bellum* të “tij”. Sipas tij, ne kemi nevojë për një Konventë të re të Gjenevës e cila do t’i kushtojë kryekëput *ius post bellum*. Është një kohë që e cilëson pasluftën dhe e cila i takon ende luftës deri në atë masë sa do të duhej të paramendohej një e drejtë ndërkombëtare e pasluftës, një e drejtë e cila i obligon fituesit të jenë të paanshëm dhe t’i mbrojnë të mundurit. Dhe në mënyrë shumë ortodokse, në vazhden e teorive të moçme, ai bën listën e asaj që do të duhej të ishte në krye të elaborimit të ligjeve të reja. Në qendër të refleksioneve të tij: Drejtësia e transformuar në të drejtë¹⁴. Ai mbështetet mbi dy modele të ndryshme, ai i hakmarrjes (i zbatuar në bazë të ligjit), i cili i imponon sanksione agresorit dhe ai i rehabilitimit, i cili i harron reparacionet e luftës në dobi të rindërtimit, i cili po kështu ka çmim të lartë. Nga kjo teori ai nxjerr një praktikë universaliste të bazuar mbi të drejtat e njeriut dhe ai mbështet kondicionalitetin dhe serialitetin si terma të drejtësisë ndërkombëtare e cila mbetet si përfundim i tërë refleksionit të tij. Kalimthi, ai shton se perspektiva për të pasur një të drejtë të pasluftës do të mund ta lehtësonte përfundimin e saj të mundurit e dinë (fjala vjen, nëse të mundurit do ta dinin se do të jenë të mbrojtur, se nuk do të ketë reparacione, etj.). Vlen të peshohet e tërë vlera e kësaj ideje. Do t’i kthehem kësaj çështjeje.

2) Nëse hiqet preokupimi për të zbuluar një të drejtë të re ndërkombëtare, një konventë të re të Gjenevës, dhe nëse i përkushtohemi menaxhimit të kësaj kohe të pasluftës, atëherë dalim te një pikëshikim tjetër i *ius post bellum*. E shihni se po orvatem t’i lë anash të gjitha pikëpamjet e mundshme të këtij nocioni të formuar në mënyrë që pastaj t’ua propozoj pikëpamjen time.

Atëherë *ius post bellum* ngatërohet me një program, me një proces. Kësisoj *ius post bellum* do të mund të kuptohej si një emër tjetër i drejtësisë tranzicionale. Këtu luhet me disa domethënie të drejtësisë deri në atë masë sa Jon Elster e shikon si të domosdoshme

¹³ Brian Orend, *The Morality of War*, Peterborough, Broadview Press, 2006; « Justice after War », *Ethics & International Affairs*, volume 16.1, pranverë 2006.

¹⁴ Ai flet vetëm për drejtësinë, por pikërisht duke luajtur me ambiguitetin jusnaturalist.

që ta dalloj drejtësinë politike dhe drejtësinë juridike (*legal* e dhe *political justice*) në këto elaborime¹⁵.

Mirëpo thelbësisht dhe pa hyrë në hollësi, drejtësia tranzicionale është më parë një mënyrë për ta kuptuar një alternativë ndaj drejtësisë retributive dhe jo vetëm në kohën e pasluftës, ajo zbatohet si te shoqëritë në krizë, në mbarim të diktaturave, të apartheideve, etj. Drejtësia – sociale, globale, ndërkombëtare – nuk ngatërrohet me *ius post bellum*, ajo mund ta ushqejë, por s’ mund të themi më shumë.

3. Pikëpamja e tretë e mundshme – por siç po shihni po largohemi gjithnjë e më shumë nga origjina dhe kuptimi – lidhet me shoqëritë në konflikt, atë mund ta quanim jo pasluftë, por paskonflikt. Këto janë zbulime të komisioneve për të vërtetën, pajtimin, drejtësinë, ashtu si janë paraqitur në Afrikën e Jugut, në Kolumbi, etj. Në këto raste nuk kërkohet aq drejtësia, por vlerat mbi të cilat mund të rithemelohet një shoqëri jokonfliktuale ose më pak konfliktuale, do të thotë më pak të padrejta se sa më të drejta. Atëherë bëhet reduktimi i kundërthënieve midis këtyre vlerave: midis lirisë, barazisë, vëllazërisë; midis të vërtetës dhe pajtimit, etj¹⁶.

Sa u takon aktorëve kolektivë, prej Konventës së re të Gjenevës deri te komisionet, intervenimi i jashtëm nuk është aq i pranishëm dhe se është një nivel ndërkombëtar dhe një nivel kombëtar, me zhdukjen e palës së tretë. Mirëpo thelbësisht drejtësia tranzicionale dhe komisionet e paskonfliktit bëjnë pjesë te ajo që quhet “rindërtim” dhe që mund të merr, përmes programeve, të gjitha llojet e aspekteve: urbanistike, ekonomike, gjyqësore, etj. Ajo që këto konceptione i përvetësojnë nga teoritë e luftës së drejtë është ideja e përgjegjësisë, madje e një detyre e cila lidhet vetëm me pasluftën¹⁷. Përgjegjësia dhe detyra janë shndërruar pak a shumë në të drejtë ndërkombëtare. Ç’është e vërteta mund të flitet për një gërshetim midis *legal justice* dhe *political justice*, me një theks të veçantë te aspekti, megjithatë, penal. Është një rrezik që të ndodhë të zhduket rrënjosja morale e

¹⁵ Jon Elster, *Closing the Books: Transitional Justice in Historical Perspective*, Cambridge, Cambridge University Press, 2004.

¹⁶ Fjala vjen te John Elster., « Justice, Truth, Peace », *Nomos*, vol. 51, *Transitional Justice*, 2012, p. 78-97.

¹⁷ Për le *ius post bellum* si « detyrë » shih, cf. Gary Bass, « Jus Post Bellum », *Philosophy & Public Affairs*, 32, n°4, 2004, p. 384-412. Kurse për një sintezë kolektive mbi çështjen shih: Carsten Stahn et Jann K. Kleffner (dir.), *Jus Post Bellum Towards a Law of Transition. From Conflict to Peace*, La Haye, TMC Asser Press, 2008.

teorive të luftës së drejtë përderisa zbatojmë në të drejtën ndërkombëtare dhe atë kombëtare, në programe dhe vendime politike, i asaj që në fillim ishte një refleksion (sërisht them për këtë aspekt të dobishëm dhe produktiv për zgjidhjet). Adaptimet e teorive të luftës së drejtë që e shndërrojnë “*ius post bellum*” në një emë tjetër për të drejtën ndërkombëtare penale, konsiderojnë se lufta ka mbaruar dhe se *ius post bellum* ka të bëjë me *pasojat* e luftës. Do të thotë se *ius post bellum* do të merret me rrjedhojat e një ngjarje të kaluar. Në rastin më të mirë *ius post bellum* lidhet me *ius ad bellum* ose me *ius in bello*, por ai është megjithatë një relacion midis ish-ndërluftuesve dhe bëhet shpesh shprehje e termave të obligimeve të fituesve ndaj të mundurve, në frymën e një rindërtimi.

Kjo përmbajtje më intereson më pak, e cila është gjithsesi e domosdoshme, por ajo që është përreth saj, kështu që ajo që duhet sqaruar nuk është më “fog of war” (“mjegulla e luftës”), por “fog of victory” (“mjegulla e fitores”).¹⁸ Do të thotë se duhet menduar kohën si një gjendje dhe të futet aty ajo që tejkalon “in bello-n”.

End dhe ending: Dalja e pagjeshme e luftës

Është një nuancë në gjuhën angleze që nuk ekziston në frëngjishte dhe që fut nocionin e progresit. Anglishtja e bën të mundur dallimin midis “fundi i luftës” dhe “*end of war*” et “*ending of war*”, i cili e fut një kohëzgjatje, një proces, një veprim mbi atë kohë. Pikërisht kjo po kështu më bën të mundur ta ruaj domethënien e *ius*. *Ius* nuk mund të kuptohet si drejtësi e thjeshtë e as si e drejtë e thjeshtë (ndërkombëtare).

Për ta zbuluar konceptin e *ius post bellum* duke e ruajtur shtrengesën referenciale dhe synimin konceptual, duhet të kthehemi te domethënia burimore dhe te pikëpamja latine e këtij termi i cili pengon përkthimet e sipërfaqshme dhe të gabuara. Kësisoj duhet rivendosur lidhjen midis *ius post bellum* dhe *ius in bello*.

Kufizimi i luftës, çështja e përgjegjësisë, statusi i aktorëve dhe entiteteve kolektive, të gjitha këto duhet të kuptohen me të drejtën natyrore. Nuk e kam ndërmend ta modernizoj të drejtën natyrore,

¹⁸ Shprehja «*fog of war*» është e Robert McNamara-s, kur fliste për përvpjen e vet. Gabriella Blum, të cilën e përvetëson Brian Orend, e zëvendëson me studimin e «*fog of victory*», cf. Gabriella Blum, «*The Fog of War*», *The European Journal of International Law*, vol. 24 no. 1, 2013.

ngase kjo do ishte absurde, mirëpo dëshiroj të theksoj dimensionin kohor i cili humbet në përkthimet moderne të një nocioni antik dhe i cili, sipas mendimit tim, përbën vlerën e këtij kthimi dhe të përtëritjes së *ius post bellum*.

Është fjala që së pari të thyhet imazhi kohor që ne kemi për luftën me një fillim, zhvillim dhe fund, do të thotë të thyhet imazhi i kohës i paraqitur si një shigjetë, që është koncepti ynë modern i historisë¹⁹. Shpërpjesëtimi midis hyrjes në luftë – një çast i shpejt, ndonjëherë i shënuar me një deklaratë lufte, por jo çdo herë -, zhvillimi dhe fundi i luftës na shpie në gabim. Ndonëse një traktat i paqes i jap fund një lufte, kjo nuk do të thotë se ajo ka përfunduar me të vërtetë. E drejta private dhe ajo administrative e shprehin këtë. Traktati e mbyll juridikisht një luftë (edhe fundi i Luftës së Dytë Botërore është shumë konfuz, madje edhe në këtë aspekt), një proces mund ta ketë këtë. Disa e kanë pasur parasysh këtë, prandaj dhe dihet se ata nuk e mbajnë si të sigurt konceptin tonë kronologjik mbi historinë. E kam fjalën për Hobbesin, i cili fliste për intervale të paqes midis dy luftërave, duke e përmbysur idenë që ne kemi për kohën e rëndomtë²⁰. Sipas tij, koha e rëndomtë është koha e luftës. E kam parasysh edhe praktikën në Greqinë e moçme, pseudojuridike, e cila për ta shënuar përfundimin e luftës nënshkruante një *armëpushim për njëqind vite*, duke cekur në këtë mënyrë se paqja nuk ishte e garantuar (e dhënë), se ajo ishte vetëm një kohëzgjatje e caktuar e jo një pikëmbërritje. Ka shumëçka për t'u thënë për këto koncepte; është vështirë, fundja, të diktohet fundi i luftës, luftën e përfunduar; të cekë po kështu se megjithë një *end* (fund) mund të ndodhemi në një *ending* (duke përfunduar), funksion dhe dihet se proceset zgjasin (si fjala vjen Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë), riparaqiten (proceset e nacistëve, Nuremberg, Mynih, etj.). Mirëpo këto janë ende elemente të dukshme, pikorientime në linearitetin e kohës, në shigjetën e kohës.

Vështirësia e *ius post bellum*, e kuptuar si riparaqitje e teorive të luftës së drejtë, lidhe me faktin se ajo luan në dy plane: atë të udhëheqjes së luftës dhe atë të pasluftës, e cila mund të ketë një

¹⁹ Christian Nadeau e ka parë mirë këtë dhe i ka identifikuar dy horizonte historike që bëjnë të mundur të kuptohet dretësia tranzicionale (e lidhur me teoritë e pranimit). Quentin Skinner ou Reinhard Koselleck, cf. Christian Nadeau, « Conflits de reconnaissance et justice transitionnelle », *Politique et Sociétés*, vol. 28, n°3, 2009, p. 191-210.

²⁰ Hobbes, *Léviathan*, ch. XIII et XXIX.

kohëzgjatje të madhe, pak të përcaktuar, të pashënuar. Ciceroni e ka parasysh këtë në planin e udhëheqjes së luftës, kur thotë se duhet bërë luftën në atë mënyrë që të mendohet se ajo do të përfundojë dhe se armiqtë e djeshëm do të jenë miq të së nesërme²¹. *Ius post bellum* hipotetik nuk do ishte veçse një anticipim dhe në këtë rast kemi të drejtë ta paraqesim *ius post bellum* si një degë e *ius ad bellum*. Plani i dytë, ai i pasluftës, është shumë i përshkruar me gjithë atë që përmenda me emërtimin drejtësia tranzicionale, e cila zhvillohet në mënyrë jokohore, kohë e pallogaritur, e padimensionuar mbi të cilën ndërthurren rindërtimet juridike, sociale e politike.

Mbetet, pra, kjo ngjarje e cila nuk është e identifikueshme: *dalja* nga lufta (e jo përfundimi). Flitet lehtëzi për një hyrje në luftë juridikisht dhe historikisht, por fare jo për daljen. Një paqartësi e cila reflektohet fjala vjen te hezitimi ynë që të flitet vetëm për një luftë të Çeçenisë ose për dy luftëra të ndara²² dhe të cilin do ta sqaronte një analizë e kohësive të ndryshme të këtyre ngjarjeve luftarake në Çeçeni. Mirëpo dilet nga një kohë e luftës më shumë se sa që dilet nga një gjendje, gjë që do të thotë se gjendja e luftës mund të vazhdojë në kohën e pasluftës. Ja problemi i identifikuar dhe konfuzioni kohor ndopak i ndriçuar. Një traktat paqeje mund edhe të nënshkruhet, mirëpo kjo nuk do të thotë se kemi dalë nga lufta dhe proceset, komemorimet, janë pikorientime kronologjike, shenjues social, por nuk janë dalje nga lufta. Kësisoj, del e domosdoshme një kohësi e injoruar më parë brenda kohës së pasluftës. Në këtë kuptim kohësia e luftës nuk mat vetëm fillimin dhe fundin e saj (kronologjikisht dhe me deformime apo thjeshtësime), ajo pra e përkthen dhe e shpreh hyrjen dhe daljen, dendësinë e një lufte, një gjendje më shumë se një segment kronologjik. Tani problemi është identifikuar e konfuzioni kohor ndopak i sqaruar. Një traktat paqeje mund të nënshkruhet, por kjo nuk do të thotë se kjo është një dalje nga lufta dhe nga proceset, komemorimet janë repera kronologjike dhe shenjues social, por këto nuk janë dalje nga lufta. Në kohën e pasluftës imponohet një kohë e cila ishte e injoruar deri atëherë.

Për ta ndriçuar këtë problem të kohës dhe të daljes së pagjetshme të luftës, duhet të kalojë kah ajo që e konsideroj se është

²¹ Ciceron, *Des Devoirs (Mbi detyrat)*, livre I.

²² Cf. Aude Merlin, Fabienne le Houérou, Amandine Regamey, Silvia Serrano, *Tchéchénie, une affaire intérieure?*, Paris, Autrement, 2005.

koncepti i luftës: *stasis*. Sepse, sipas mendimit tim, ajo që anashkalohet te lufta e cila nuk kuptohet si *stapis*, si dhe te *ius post bellum* është një kohësi e caktuar politike.

Stasis-i

Stasis është koncept i vërtetë i luftës. Shumë shpesh e kundërvënë ndaj *polemos* sikurse që lufta civile është ndaj luftës si të tillë, ky përkthim i keq e thjeshtëzues i shumëfishon ambiguitet. Kam dëshmuar se *stasis* nuk ishte përkthim i luftës civile, sintagmë kjo e bartur nga latinishtja *bellum civile*, e cila injoron, harron, zëvendëson për një kohë të gjatë *stasis-in*. Mirëpo ky nocion është thelbësor për ta kuptuar më mirë esencën e luftës gjithnjë duke ruajtur një pjesë të paqartësisë²³. Vazhdoj të merrem me nocionet antike për t'u orvatur të rigjejë një kyptim të luftës të cilin kategoritë tona dhe leksiku ynë e kanë harruar. E kam fjalën për gjuhët latine të ndikuara nga sintagma romake, e cila lidh *civile* me *bellum* si një zgjerim monstruoz, por e njëjta strukturë është ripërvetësuar në gjuhën shqipe (lufta/lufta civile) deri te greqishtja moderne. Propozoj pra një kthim te nocioni *stasis* për ta kuptuar esencën e luftës, të cilën *ius* dhe veçanërisht *ius fetiale* kanë ndikuar që të fshihet.

Koncepti *stasis* sjell dy elemente themelore për ta përkufizuar luftën: një mënyrë tjetër të të kuptuarit të kohësisë dhe idenë se çdo luftë e brendshme përmban në vete një element të luftës së jashtme. Sepse Tukiditi e vë në spikamë mirë sa i takon Luftës së Peloponezit, se luftërat e brendshme të një shteti midis oligarkëve dhe demokratëve nuk mund të kuptohen pa i marrë parasysh aleancat me spartanët apo me athinasit, pa i marrë parasysh oligarkët dhe demokratët tjerë; dhe anasjelltas, se një luftë për hegjemoni midis Athinës dhe Spartës nuk mund të kuptohet pa vargun e luftërave të brendshme dhe të jashtme që ajo i shkakton.

Së dyti, pika kryesore për çështjen tonë mund të shpie në përkufizimin tim të *stapis-it*, pra vlen të pyesim se çka sjell ai për analizën e kohësisë së pasluftës. Keni hetuar se si kaloi nëpërmjet nocioneve antike për t'u orvatur të rigjejë një domethënie të luftës që kategoritë tona dhe leksiku ynë e ka harruar. E kam fjalën për gjuhët

²³ I lejoj vetes t'i referohem librit tim, Ninon Grangé, *Oublier la guerre civile? Stasis, chronique d'une disparition*, Paris, Vrin-EHESS, 2015.

latine, të ndikuara me sintagma romake, e njëherësh siç kam verifikuar, në gjuhën shqipe del e njëjta strukturë dhe i njëjti përvetësim (luftë/luftë civile), përderisa greqishtja ka dy fjalë që nuk i takojnë të njëjtës fushë të definicionit. Prandaj mbështes kthimin te nocioni *stasis* për ta kuptuar më mirë esencën e luftës.

Dhe në këtë term *stasis* është i pranishëm qartazi një element kohor, më saktësisht i kohëzgjatjes dhe shpejtësisë, një përcaktim i cili i mungon gjuhës sonë të mbyllur me shigjetën lineare të kohës. *Stasis* shënon një ndërprerje, ndalje përballë një akselerimi. Sipas mendimit tim, këtu kemi një dimension kohor të politikës të cilin nuk e hetojmë brenda kategorive tona politike të rëndomta.

Është interesante se përmbajtja kohore e fjalës *stasis* ka hyrë në gjuhën franceze, por fare jo për ta përshkruar luftën. Gjejmë fjalën “*stase*” brenda një vokabulari shumë teknik: në gjuhësi dhe në psikanalizë. *Stase* shënon një ndalje brenda rrëfimit para një rinisje me një ritëm të ri. Në psikanalizë ajo shënon një moment të ndërprerjes para rifillimit të një terapie me një cilësi tjetër. Dhe këtu, ndonëse është teknike, kemi të bëjmë me një përkthim të mirë. *Stase* është, pra, një ndërprerje para një rifillimi, para një akselerimi, para një ndryshimi.

Këtë dimension kohor ne e kemi harruar njëherësh, që e kemi harruar *stasis* dhe ne e injorojmë brenda të kuptuarit tonë të luftës. Atë që e presim në pjesë (sekuenca), duke u nisur nga një leksik romak dhe brenda një të drejte natyrore keq të interpretuar, është shënuar mirë dhe e përqendruar brenda fjalës *stasis* dhe kjo te një botë greke e cila nuk e mbiçmon të drejtën, që nuk i kushton shumë vëmendje fillimit dhe mbarimit të luftës juridikisht të përkufizuar (fillimi dhe mbarimi mund të korrespondojnë po ashtu me sezonet që ndryshojnë).

Për ta zbuluar dimensionin kohor, shumë më pak i dukshëm se cilido element hapësinor i luftës në përgjithësi, do ta marr një shembull qëllimisht shumë të largët nga konteksti grek, dhe që bën nga elementi kohor një element themelor, ndonëse demonstrimi ka të bëjë me këtë aspekt.

John Stuart Mill kishte preokupime të tjera më urgjente dhe më politike për t'i zhvilluar këto mbi luftërat me të cilat merrej. Dimensioi kohor i analizës së tij del edhe më mirë në shesh. John Stuart Mill përfshinë luftën civile, e cila menjëherë angazhon shtete të tjera, për një detyrë apo një obligim: atë të çlirimit. Një luftë civile mund të jetë *kohë* e një çlirimi.

Duke e trajtuar luftën civile, e cila që në fillim angazhon shtete të tjera me një detyrë apo një kuptim - atë të çlirimit. Një luftë civile mund të jetë një *kohë* e çlirimit. Nëse një luftë civile mund të jetë rast për çlirim duke angazhuar disa popuj, kjo është po ashtu e lidhur me një kohësi. Për të lufta civile e ka përkufizimin e vet, analizën e vet brenda perceptimin që ne kemi për te. Ajo që është shumë interesante te Mill është se gjithnjë duke menduar se një luftë e brendshme duke angazhuar popuj të tjerë, nga jashtë, ai mbështet mosintervenimin i cili nuk është fare neutral. Atë që mbaj nga kjo për fjalën time është se lufta civile është e menduar nga Mill-i brenda një kohësie e cila është krejt e definuar, jo me shigjetën kronologjike, por me realizimin e lirisë.

Sipas mendimit tim, mu këtë përpiket ta bëjë John Stuart Mill-i, duke e trajtuar luftën civile e cila që në fillim angazhon shtete të tjera me një detyrë apo një kuptim: atë të çlirimit. Një luftë civile mund të jetë një *kohë* e çlirimit. Nëse një luftë civile mund të jetë rast për çlirim duke angazhuar disa popuj, kjo është po ashtu e lidhur me një kohësi. Për të lufta civile e ka përkufizimin e vet, analizën e vet, brenda perceptimin që ne kemi për të. Ajo që është shumë interesante te Mill-i është se gjithnjë duke menduar se një luftë e brendshme duke angazhuar popuj të tjerë nga jashtë, ai mbështet mosintervenimin i cili nuk është fare neutral²⁴. Atë që mbaj nga kjo për fjalën time është se lufta civile është e menduar nga Mill-i brenda një kohësie e cila është krejt e definuar, jo me shigjetën kronologjike, por me realizimin e lirisë. Është një cilësi kohore e luftës civile për çlirim të cilin Mill-i e rezymon me terma të kohës dhe kohëzgjatjes: 1. Zgjidhja e intervenimit, e ardhmja e tij; 2. Aftësia për liri do të thotë një aftësi e cila shikohet në zhvillim e sipër; 3. Kontinuiteti dhe kohëzgjatja e luftës civile (e cila bën të mundur të matet aftësia për liri); 4. Liria vetë e menduar si një proces. Natyrisht, Millëi ka parasysh një çlirim që është i vetëdijshëm për veten e vet dhe që dëshmon për dëshirën dhe aftësinë për të shkuar nga demokracia, kundër tiranisë dhe despotizmit (sa do të flitej për një proces tranzicional). Ai mendon po kështu për vendosjen e kushteve për një intervenim eventual. Mirëpo më duket shumë interesant, se argumentimi i tij mbështetet në një

²⁴ J. S. Mill, « A Few Words on Non-Intervention » (1859), in *Essays on Equality, Law and Education, Collected Works*, vol. XXI, p. 111-124. Ky artikull është i kundërt, për mosintervenimin artikullin që e kishte shkruar dhjetë vjet më parë: « Vindication of the French Revolution of February 1848 » (1849), in *Essays on French History and historians, Collected Works*, vol. XX, p. 319-363.

përshkrim kohor të momentit të luftës. Për më tepër, ai e konsideron kohëzgjatjen e saj si diçka që mund të prodhojë një cilësi: gjatësia e luftës mund të jetë çlirimtare (vetëdijësim, aftësi, etj.), por ajo mund të jetë edhe zhytje. Liria dhe dhuna janë vazhdimet e mundshme të një lufte të kësaj natyre. Prandaj për ta përfunduar mirë luftën duhet të gjykohet cila është koha e mirë për këtë përfundim, të anticipohet rrugëdalja e saj, por edhe kohëzgjatja e çlirimit në krahasim me atë të mizorisë²⁵. Kjo do të thotë se Mill-i e bën në një mënyrë krejt tjetër nga teoritë e luftës së drejtë një definicion të moralizimit të luftës (këtë herë duke pasur parasysh demokracinë).

E kam marrë shembullin e Mill-it për të vënë në pah se refleksioni mbi kohën e luftës dhe mbi *ius post bellum* i tejkalon shqyrtimet e doktrinaeve të ritrajuara mbi luftën e drejtë. Kam mundur të marr shembuj të tjerë, nga sociologjia fjala vjen, duke u mbështetur te punimet e Stathis Kalyvas. Ajo që është e rëndësishme para së gjithash këtu për mua është ta shtroj këtë cilësi kohore të luftës – si dhe të politikës në përgjithësi – për të cilën ne nuk jemi ende të vetëdijshëm sidomos në traditën filozofike moderne.

Kthimi te *ius post bellum* i ngarkuar me peshën kohore të luftës

Po kthehem te *ius post bellum*, pas shqyrtimit të konceptit *stasis* dhe një pikëpamje midis të tjerave, duke u nisur nga John Stuart Mill. *Ius post bellum* është një rast konceptual për të futur nocionin kohor të luftës brenda një refleksioni moral, juridik e politik. Thënë ndryshe, me kusht që të merret si duhet dhe duke ia ruajtur rrënjosjen e moçme, zbulimi i *ius post bellum* mund të jetë një rast për ta nxjerrë në shesh dimensionin e veçantë kohor të luftës. Kësisoj është e mundshme të kuptohet lufta me shpejtësi të ndryshme, e në veçanti me ndërprerjen, madje një shtyrje afati, madje një zhagitje në zhvillimin e kohës politike. Kundërthënien midis kohës së luftës dhe gjendjes së luftës e kuptoj kësodore bashkë me luftën e cila vazhdon të veprojë brenda shoqërisë, ndonëse një traktat është lidhur, se procese janë zhvilluar, etj. Duhet marrë me mend se lufta është po kështu brenda kësaj “post”, që është një kohë e pritjes të cilën duhet pasur parasysh si të

²⁵ I referohem dhe jam e frymëzuar shumë nga Aurélie Knüfer, në « Temps de la guerre civile, temps de l'intervention, selon John Stuart Mill », *Philonsorbonne*, [en ligne], 6, 2012.

tillë. Nuk po them se *ius post bellum* është një zgjidhje konkrete, por se së paku ka në vete mundësi për zgjidhje konkrete. Them se zgjidhjet juridike, politike e sociale duhet të konsiderohen brenda horizontit të *ius post bellum* e jo brenda një kohe keq të kuptuar të një lufte e cila nuk mbaron së mbaruari. Ky është një hap i parë për të provuar të mendohet e tërë lufta jo vetëm brenda një hapësire, por edhe brenda një kohe.

Problemet e hapësirës janë trajtuar gjerësisht (lidhur me kufijtë, përcaktimet e sovranitetit), ndërkaq problemet e kohës jo aq. Kësisoj në Palestinë është marrë në shqyrtim çështja e urbanizmit të cilën e tronditë struktura e kampeve të refugjatëve dhe strategjive ushtarake të Izraelit. Apo edhe te republikat e reja të Ballkanit, çështja e fqinjësisë dhe infrastrukturave urbane është shtruar në horizontin e rindërtimpajtimimit. Lufta shkatërron, rindërtimi është një gjurmë e saj, madje një prani. Hapësira e kuptuar si dimension për t'u përvetësuar është e pranishme, e njohur dhe e çmuar. Edhe me të drejtën po kështu, brenda dialektikës midis të drejtës penale vendore dhe asaj ndërkombëtare. Vetë ndërhyrjet e palëve të treta gjithnjë shikohen të kenë okupuar një hapësirë të caktuar të cilën duhet përkufizuar. Përkufizimi hapësinor është përkufizim legal, social, etj. Dua të them se e kemi zakon ta mendojmë shoqërinë, të drejtën, politikën me terma hapësinore.

Mirëpo do të duhej t'i shtojmë dimensionet kohore, gjë e cila është qartazi më e vështirë: në fakt, hapësira përfytyrohet në formë të imazheve, ne kemi pra mjete të përfytyrimit për të ndërtuar teori dhe praktika, por ne nuk kemi asgjë të tillë për kohën, përveç kësaj shigjete e cila është shumë e papërsosur. *Ius post bellum* bën të mundur kështu të zbulohet dimensionin kohor i luftës, duke e marrë parasysh një "pas" paradoksal, një gjendje që duhet kuptuar kohësisht e jo kronologjikisht. Lajthitemi nëse atë "pas" e shikojmë vetëm në kuptimin linear, si një shkakësi e cila shpaloset vetëm si suksesion. Është thjeshtëzuese dhe sigurisht e gabuar që ky koncept të shikohet si një koncept juridik, e as *ius ad bellum* dhe *ius in bello* në fillimin e tyre ku *ius* ishte një e drejtë po aq sa edhe një dimension i së shenjtës. Kësisoj, si zbulim, ai është më shumë se një persiatje morale. Nëse kujdesemi t'ia ruajmë *ius post bellum* dimensionin e tij jusnatyralist, atëherë kemi të bëjmë me një koncept i cili nxjerr në shesh një kohësi e cila del e pahetueshme brenda kategorive që përdoren. *Ad, in* kishin të bëjnë vetëm me një funksion, i dobishëm juridikisht *post* nuk janë etapa të një shigjete lineare të kohës së historisë moderne, por

shënojnë kohëzgjatje dhe shpejtësi. *Ad* dhe *in*, i shigjetës kohore. Post nuk është një moment i shigjetës lineare të kohës së historisë moderne, por emërton zgjatje dhe shpejtësi (prandaj unë sugjerova të dëgjohet mbrapa kësaj shprehje një *ius* dhe *bello*). Në këtë kuptim, kohësia e *ius post bellum* është e vetmja që është krejt e hapur, ajo që duhet të mbushet me juridiken, penalen, urbanizmin, ekonomiken, etj., por duke pasur parasysh gjendjen e cila vazhdon të veprojë brenda entiteteve kolektive dhe individëve,

Pra, nuk po propozoj këtu një aparat apo një dispozitiv, por një përmbysje (ndërrim) filozofike të shikimit mbi luftën, e cila do të na bëjë të mundur një thellësi tjetër të kësaj gjendje.

(Nga frëngjishtja përktheu M. Kullashi)

Résumé

Le *ius post bellum*, dans le droit romain antique, n'existe pas. Des chercheurs récents, peut-être à la faveur du renouveau éphémère des théories de la guerre juste, ont ainsi complété, *more Romano*, le *ius ad bellum* et le *ius in bello* qui constituent le droit de la guerre. Les théories et la tradition de la guerre juste avaient un contenu doctrinal et un contenu moral; elles ont donné lieu, dans les élaborations d'aujourd'hui, à une série de critères nécessaires et suffisants pour mener une guerre juste, moins rigoureux cependant que dans les systèmes de Grotius, Pufendorf ou Vattel. Inséré dans cette tradition large, le *ius post bellum* est une notion ambiguë. Le plus souvent elle sert à renouveler l'idée de droit international de la guerre en lui adjoignant l'idée de conventions pour l'après-guerre, visant la responsabilité des vainqueurs et la protection des vaincus. Une autre compréhension du *ius post bellum* en fait un autre nom de la justice transitionnelle, alternative collective et réfléchie, possiblement internationale, à la justice rétributive. Dans cet article, je propose une autre approche du *ius post bellum*, non contradictoire des précédentes, qui s'appuie sur la différence que permet l'anglais entre "*end of war*" et "*ending of war*". Cette approche est donc une compréhension de la temporalité politique d'après-guerre, pendant laquelle la sortie et la fin de la guerre ne coïncident pas forcément. Cela implique d'abord de se débarrasser de la vision simpliste, linéaire, référencée à l'espace, du temps chronologique et de l'histoire, sur laquelle repose trop souvent la philosophie politique, ensuite de reconsidérer la temporalité (conduite de la guerre et sortie de guerre) dans laquelle penser la guerre. L'*état* de guerre peut se poursuivre dans le *temps* de l'après-guerre. Ainsi le *ius post bellum* comme notion philosophique est une occasion de découvrir la dimension temporelle de la guerre dans une réflexion à la fois morale, juridique et politique. C'est alors que la vitesse et le rythme de l'événement, et partant du politique dans sa perception et sa production, s'avèrent nécessaires à la compréhension de cette temporalité spéciale révélée par le *ius post bellum*.

Astrit Salihu, Prishtinë

BANIMI POETIK

Abstrakt

“Banimi poetik”

(Heidegger ose të menduarit e arkitektures përmes të qenit)

Martin Heidegger, siç njihet ndryshe edhe si mendimtar i qenies, nuk shquhet me ndonjë studim të thelluar të arkitekturës. Të gjitha mendimet e tij rreth arkitekturës ose edhe çështjes së banimit janë shtruar në dy ligjërata të tij në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, në kohën kur atij i lejohet sërish të ligjëruarit pas Luftës së Dytë Botërore, pas këtyre ligjeratave të Heidegger-it kemi një kthesë sinjifikative në diskursin e arkitekturës, një kthesë që mund të quhet edhe si kthesa fenomenologjike në arkitekturë (*Phenomenological turn in architecture*). Bredhja e zbërthimit të esencës së banimit është themeli ontologjiko-fenomenologjik i hulumtimit të Heideggerit në arkitekturë. Këtu Heidegger duket që zbërthen nocionin e të-qenit-në-botë përmes banimit, në lirinë e të cilit është kursyer esenca e qenies. Kjo ngase të vdekshmit me të-qenit-në-botë përfshihen në banimin ‘në sensin e ndjenjës mbi tokë të vdekshmëve’. Koncepti Heidegger-ian i hapësirës nuk mund shihet përbrenda skemës gjeometriko-matematikore të modernitetit. Për ta konkretizuar dallimin ndërmjet hapësirës së matshme dhe hapësirës së vendit, ai na ofron një argument se ‘përmasat numerike nuk janë bazë dhe themel të qenies së hapësirave’. Edhe pse, sipas shumë interpretuesve të Heidegger-it, konceptet e tij mbi banimin nuk mund të aplikohen në zhvillimet teknologjike aktuale të urbanizmit, prapëseprapë konceptet e tij mbi arkitekturën kanë hapur shtigje të reja në shikimin e arkitekturës jashtë skemave funksionaliste-gjeometrike të modernitetit.

Fjalët kyçe: Arkitektura, hapësira, vendi, jovendi.

Heidegger-i ose të menduarit e arkitektures përmes të qenit

Martin Heidegger-i, siç njihet ndryshe edhe si mendimtar i qenies, nuk shquhet me ndonjë studim të thelluar të arkitekturës. Të gjitha mendimet e tij rreth arkitekturës ose edhe çështjes së banimit janë shtruar në dy ligjërata të tij në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, në kohën kur atij i lejohet sërish të ligjëruarit pas Luftës së Dytë Botërore. Nisur nga kjo, vetiu imponohet edhe pyetja për ç‘arsye Heidegger-i dhe mendimet e tij

lidhen aq shpesh me diskursin e arkitekturës? Prej nga kjo prani e zhurmshme e tij në debatin për arkitekturën, sidomos atë moderne? Përse teoria e arkitekturës është aq e preokupuar me mendimet e tij herë duke e aprovuar ose përvetësuar krejtësisht qasjen e tij, herë duke e hedhur si një pikëpamje konservative e cila nuk përkon fare me realitetin e ri të mobilitetit të përgjithshëm social? Cilat kanë qenë mendimet e tij të shpalosura në këto ligjerata që kanë krijuar këtë vorbull interpretimesh rreth arkitekturës? Fundja, për çka mund të merret apo edhe a mund të merret si instruktiv mendimi i Heidegger-it për të menduarit e arkitekturës? Apo mos ndoshta mendimi i tij mbetet vetëm finesë mendore që nuk përkon me praktikën arkitektonike të kontekstit aktual?

Këto janë pyetje, që duket se intrigojnë shumë nga teorikët e arkitekturës. Arsyet mund të jenë të shumëfishta, por mbase ajo më kryesorja është se pas këtyre ligjeratave të Heidegger-it kemi një kthesë sinjifikative në diskursin e arkitekturës, një kthesë që mund të quhet edhe si kthesa fenomenologjike në arkitekturë (*Phenomenological turn in architecture*). Arkitektura moderne ishte shqitur krejtësisht në variacione abstrakte e gjeometrike të gjetjes së zgjidhjeve arkitekturore duke mënjanuar aspekte relevante të raportit me njeriun. Ajo kishte abstraktuar aq shumë nga qenia njerëzore sa që atë e kishte futur tashmë në kallëpet e prerjeve ideale sipas modelit të Njeriut Vitruvian të Leonardo da Vinçit (modulori i Le Corbusier). Arkitektura moderne në vrullin e optimizmit shkencor, arritjeve teknologjike, mundësive të pamatshme të projektimit të strukturave komplekse kishte afirmuar aspekte herë strukturale e herë formale të projektimit arkitektonik. Brenda kësaj vije të zhvillimit të arkitekturës Michel Foucault, ta zëmë, disa dekada më vonë nuk sheh asgjë tjetër vetëm inskribime të pushtetit në kodifikimin e hapësirave për mekanizmat e disiplinimit si teknologji e re e pushtetit në modernitet. Kur Sullivan i ekzaltuar thërriste 'Forma e përcjellë funksionin', sipas Foucaultsë, vetëm sa artikulonte veprimin e pushtetit përmes zvarritjeve të tij të padukshme kapilarizuese. Fundja, funksionet tashmë ishin përpunuar nën pushtetin anatomo-politik. Nga kjo shohim se si diskursi modernist në arkitekturë mbetej larg premtimeve të tij për çfarëdo misionarizmi të arkitekturës për ndryshimet eventuale në shoqëri; për çfarëdo fuqie eventuale të arkitekturës në modelimin e hapësirës konform synimeve të saj. Në kontekstin e krijuar në diskursin e arkitekturës deri në gjysmën e parë të shek XX hyn Heidegger-i me ligjeratat e tij. Prej atëherë kemi njëfarë riorientimi të diskursit, një kthesë të madhe në trajtimin e sërishëm të diskursit arkitektonik, filluar nga aspekte të harruara të përfshirjes së njeriut, ekzistencës, qeniesimit dhe jetës në përgjithësi.

Ndërtimi, banimi, qenësimi

Në ligjeratën e tij, me të cilën i drejtohet kryesisht arkitektëve në vitin 1951, në kuadër të bisedave të Darmstadt-it për 'Njeriun dhe hapësirën' (Mensch und Raum), Heidegger niset nga të menduarit e ndërtimit dhe banimit jo nga aspektet e ngushta inxhinierike e as arkitektonike, por nga ajo që të pyetet për atë 'domenin të cilit i përket çdo gjë që është'. Heidegger-i fillimisht shtron pyetjet: 'Çka është banimi? Dhe si mundet të ndërtuarit t'i përkasë banimit?'. Edhe pse fillimisht konstatimi na shpie kah ajo që banimi gjithëherë është i kushtëzuar nga ndërtimi, megjithatë nuk është çdo ndërtim banim. Pavarësisht se në fushën e banimit tonë na dalin edhe ndërtime që nuk i takojnë banimit (si ura, stadiumi, centrali elektrik etj.), por edhe këto ndërtime mendon Heidegger-i janë të përcaktuara në raport me banimin, ngase ai i 'banon ato, por nuk banon në to'. Heidegger qëllimshëm bën këto diferencime elementare për të shkundur fillimisht vetëshpjegueshmërinë dhe vetëkuptueshmërinë e përfytyrimeve tona për ndërtimin dhe banimin. Ai kështu e bën përshtetjen adekuat të banesave aktuale, bazuar në referencat e të arriturave të arkitektëve modernë; 'banesat të renditura mirë, të ndritshme, të ajrosura, të lehta për mirëmbajtje'. Një përshtetje krejtësisht i përputhshëm me atë të Le Corbusier-it për banesën ideale – harmoninë dhe ekuilibrin e së cilës e shihte si makinë banimi. Por Heidegger-i, në atë që tashmë ishte arritur njëfarë, të themi, konsenzusi në diskursin modern arkitektonik për formën ideale të banesës moderne, shtron një pyetje të thjeshtë: A garantojnë këto banesa 'se në to mund të zhvillohet banimi?' Me këtë pyetje Heidegger-i lëkund entuziazmin modernist për gjetjet adekuate të zgjidhjeve të banimit, si zgjidhje kryesore e problemeve të përgjithshme të shoqërive moderne – së paku kështu pohonte Le Corbusier, duke potencuar se ç'ekuilibrimi i shoqërisë sot është i kushtëzuar nga problemi i banimit. Duke e potencuar banimin në raport me ndërtimin, ai këto i sheh në një ndërlidhje të pandashme. Ai ndërtimin nuk e sheh nën prizmin e formave të konstruksioneve inxhinierike, por nën prizmin e banimit si të tillë. Sepse, sipas Heidegger-t, ndërtimi nuk është vetëm rrugë deri te banimi, por 'ai tashmë në vetvete është banim'. Heidegger-i këtë qëndrim e mbështet në të dëgjuarit e gjuhës, duke e gjetur në gjuhë 'masën' përmes së cilës do ta masim 'esencën e banimit dhe ndërtimit'. Përfytyrimi i gabuar i njeriut për gjuhën si zotërues i saj, duke vendosur një raport

të dominimit të tij mbi gjuhën ka bërë që esenca e tij të shqitet në të ‘qenit e huaj’; që njeriu në njëfarë mënyre të humbë shtëpizimin e tij. Për të ardhur deri tek esenca e ndërtimit dhe banimit, por edhe tek ndryshimet esenciale në kuptimet gjuhësore të ndërtimit dhe banimit duhet përcjellë gjuhën që na flet. Duke u nisur nga ajo që gjuha na flet përmes asaj që është e folur dhe jo përmes shprehjes njerëzore, Heidegger do të nxjerrë kuptimin e ndërtimit dhe banimit. Heidegger nisët nga shprehja e thjeshtë e fjalës *bauen* (ndërtoj). Kjo fjalë që tanimë është struktur brenda një kuptimi të fiksuar të shprehjes njerëzore për ndërtimin, në të folurit e gjuhës ka shumëçka për të thënë. Heidegger-i shkruan: “Fjala e gjermanishtes së lartë (si edhe e anglishtes së vjetër) për ndërtoj, *buan*, do të thotë *banoj*, çka nënkupton: të rrish, të qëndrosh në një vend. Ndaj duket se ne kemi humbur pikërisht domethënien e vërtetë të vetë foljes *bauen* (ndërtoj), d.m.th. *banoj*. Ndërkohë që një gjurmë, por e mbuluar e saj është ruajtur edhe në fjalën gjermane *Nachbar* (fqinj) (...) kështu *Nachbar* është *Nachgebur*, *Nachgebauer*, pra ai që banon pranë. Foljet *buri*, *büren*, *beuren*, *beuron* duan të gjitha të thonë, *banoj*, *banesë*, vend *banimi* (pra përshkruajnë vendbanimin)¹”. Shpalosja e shtresëzimeve kuptimore të fjalës *bauen* Heidegger-in e shpiejnë edhe më tutje jo vetëm në njëkuptimësinë e ndërtimit dhe banimit, por shumë më thellë, në atë që fjalët ‘*bauen*, *buan*, *bhu*, *beo* janë të njëjta me *bin-in tonë* (*jam*)’. Dhe ai shtron pyetjen: ‘Çfarë do të thotë atëherë *ich bin* (unë *jam*)? Na përgjigjet fjala e vjetër *bauen*, së cilës i përket *bin-i*: *unë jam*, *ti je*, duan të thonë: *unë banoj*, *ti banon*. Mënyra më të cilën *ti je* e *unë jam*, mënyra më të cilën ne njerëzit e tjerë jemi mbi tokë është *Buan-i*, *banimi*”². Pavarësisht se të qenit e njeriut në botë tanimë te Heidegger-i lidhet me *banimin*, ai po ashtu *banimin* nuk e merr në kuptimin e ngushtë të prezencës së zbrazët në botë. Pohimi se njeriu është në botë përmes *banimit* tërheq edhe shumëçka tjetër në të kuptuarit e thellë të *banimit*. Të qenit përmes *banimit* sipas Heidegger-it tërheq pas vete kuptime të tjera të cilat na mundësojnë përfshirjen e plotë në *banimin* si mënyrë e të qenit. Duke zbrërthyer dy mënyra të të kuptuarit të *bauen* si *kultivim*, *ruajtje* dhe *shqetësim* (si p. sh. kur kemi të bëjmë me *kultivimin* e tokës) dhe në anën tjetër si *prodhim* (*prodhimi* ose *ndërtimi* i anijeve dhe tempujve). Heideggeri shkruan se “*Dy mënyrat e bauen-bauen në kuptimin kultivoj, në latinisht colere, cultura dhe bauen në kuptimin e ngritjes së ndërtesave, latinisht*

¹ Martin Heidegger, Leksione dhe konferenca, Plejad/Tiranë/2003, fq.145.

² Martin Heidegger, po aty, fq. 146.

aedificare - janë të dyja të përfshira në kuptimin e vërtetë të bauen-it, të të ndërtuarit, d.m.th. të banuarit”³. Në të folurit e gjuhës na shpaloset esenca e ndërtimit dhe banimit, si të qenit tonë. Sado të duket qasje reduktive për të nxjerrë kompleksitetin e asaj që projekton arkitektura përmes ndërtimit për të ardhur deri tek banimi, del që qenësia e banimit të jetë harruar mbi bazën e harrimit të kuptimit burimor gjuhësor të banimit. Ky nuk është një qëndrim që duhet shpërfillur, ngase për Heidegger-in, fundja, qenia është e shtëpizuar në gjuhë, ai gjuhën e sheh si shtëpi të qenies. Për rëndësinë e ndryshimeve kuptimore në përdorimin e harruar të fjalëve na flet edhe ajo që këto ndryshime nuk janë pa rrjedhoja përcaktuese në të qenit tonë. Për këtë shkruan Heidegger-i se “...kjo ngjarje duket fillimisht të mos jetë asgjë tjetër veçse një fakt i historisë së semantikës, i atyre fakteve që nuk prekin asgjë më shumë se kuptimin e fjalëve. Por, në të vërtetë, aty fshihet diçka vendimtare: tashmë banimin ne nuk e përjetojmë si qenie (Sein) të njeriut dhe akoma më pak banimin s’e mendojmë kurrë si karakterin bazë të qenies njerëzore”⁴.

Heidegger-i nuk shtjerr gjithë problemin e banimit dhe kuptimin e tij vetëm mbi faktin e përkufizimit të deritashëm: se ndërtimi është banimi; se përmes banimit të vdekshimit ekzitojnë në tokë dhe në atë të ndërtimit si kultivim dhe ndërtimit që ngrit ndërtesa. Heidegger-i vazhdon të shpalosë edhe më tutje esencën e banimit. Natyrisht, duke iu referuar gjithnjë gjuhës ai fton për të shkuar tutje në të dëgjuarit e saj për esencën e banimit. Ai thërret në ndihmë kuptimin e fjalës së vjetër saksone wunon, si dhe të asaj gotike wunian. Për këtë ai shkruan: “wunian nënkupton jam i kënaqur, i vënë në paqe, rri në paqe. Fjala paqe (Freide) do të thotë atë që është e lirë (das Freie, das Frye), ndërkohë që fry do të thotë të jesh i ruajtur nga dëmtimet dhe kërcënimet, i ruajtur nga diçka, pra i kursyer nga ato”⁵. Këtu Heidegger-i duket që zbërthen nocionin e të-qenit-në-botë përmes banimit, në lirinë e së cilit është kursyer esenca e qenies. Kjo ngase të vdekshmit me të-qenit-në-botë përfshihen në banimin ‘në sensin e ndenjes mbi tokë të vdekshmëve’. Të vdekshmit për Heidegger-in nuk paraqesin një entitet të izoluar dëshpërues, ngase ai ata i vë në ndërlidhje të ngushtë me aspektet tjera që konstituojnë përvojën mbi botën në katërsinë e pandashme. Në momentin që flet për të vdekshimit mbi tokë, Heidegger e derivon po ashtu qiellin si të

³ Martin Heidegger, po aty, fq. 146.

⁴ Martin Heidegger, po aty, fq. 147.

⁵ Martin Heidegger, po aty, fq. 148.

vetëkuptueshëm, ngase në tokë jemi nën qiell. E kjo njëherësh nënkupton se jemi ‘para hyjnorëve’, që gjithashtu nënkupton ‘përkitjen në komunitetin njerëzor’. Kjo katërsi është gjithëherë në një ‘unitet’ të pandashëm. Kjo njëherësh për Heidegger-in përbën edhe strukturën bazë të përvojës tonë të botës – ose botësisë së botës. Kjo është ndoshta pjesa kryesore në të cilën është i përfshirë i gjithë mendimi i vonshëm i Heidegger-it. Katërsinë si strukturë bazë të përvojës tonë të botës e gjejmë në të gjitha ligjeratat e viteve të pesëdhjeta – prej asaj ‘Sendi’, ‘Ndërtimi, Banimi, Mendimi’ dhe ‘Poetikisht ku banon njeriu’. Është e vërtetë se një përshkrim i tillë i përvojës bazike ekzistenciale mbi botën ka lëkundur krejtësisht interpretimet e etabluara në mendimin perëndimor, që nisen nga konstruksionet racionale, modelet shkencore si dhe mendimet logjike për botën. Sado i ndërlidhur ky qëndrim me aspekte ‘mistike’ të interpretimit të Heidegger-it, megjithatë kjo është një konsekuencë e refuzimit fenomenologjik të tij për t’iu nënshtruar skematizmave scientiste në interpretimin e botës. Madje Georg Steiner-i pohon se katërsia të Heideggeri i përket një ‘idiolekti, gjuhe personale që na ofrohet si universale’.⁶ Përgjigjen për këtë mendim të Heidegger-it e gjejmë në ligjëratën e tij të pare, të lejuar pas luftës, të emërtuar ‘Sendi’. Arritja e tij të esenca e sendit është ajo që do të përcaktojë edhe mendimin e tij mbi ndërtimin dhe banimin. Ai asnjëherë nuk do të del nga koherenca e mendimit të tij fenomenologjik për ta shpalosur botësinë e botës. Konsekuencat e të kuptuarit shkencor të sendit ai do t’i vë në raport të drejtpërdrejtë me potencialet e shkatërrimit masiv të bombës atomike dhe hidrogjenike. Të shkatërruarit e sendit përmes të kuptuarit shkencor të tij është tmerrri që ka ndodhë qysh para shpërthimit të bombës atomike sipas Heidegger-it. Por çka nënkupton sendi për Heideggerin? Cila është mënyra e të kuptuarit të drejtë të sendit? Çka nënkupton dhe cilat janë rrjedhojat e moskuptimit të drejtë të sendit sipas Heidegger-it? Ku dhe në çka korrespondon sendi me të ndërtuarit në arkitekturë? Në ligjëratën e tij ‘Ndërtimi, banimi, mendimi’ ai do t’i referohet gjithë këtyre në përpjekjen e tij për të ardhur deri tek esenca e banimit. Për të kuptuar më thellësisht strukturimin e mendimit të Heidegger-it duhet gjithsesi t’i kthehemi sendit dhe të kuptuarit Heidegger-ian të sendit.

⁶ Edhe Adam Sharr e vendos mendimin e Heideggerit nën ndikimet mistike të Master Eikhartit, mendimtarit nga Lindja Lao Tse, si dhe Holderlinin. Shih për këtë Adam Sharr, *Heidegger for Architects*, Routledge/London-New York/2007, fq. 33.

Afria, sendi, bota

Heidegger-i ligjeratën e tij mbi sendin e fillon duke i numëruar të arriturat e fundme të shkencës dhe teknologjisë, që kanë mundësuar zvogëlimin e distancave në kohë dhe hapësirë. Ai përmend shfrytëzimin e aeroplanave që zvogëlojnë distancat, radios që mundëson arritjen e shpejtë të informacionit, filmit që mundëson komunikimin me kulturat e largëta, por po ashtu edhe televizionin si pikë kulmore në të cilën zhduken distancat. Por ajo që konstaton Heidegger-i është ajo që ‘flakja e ngutshme e distancave nuk sjell afërsinë, ngase ajo nuk gjendet në distancën e shkurtuar’. Dhe këtu Heidegger-i e shtron çështjen e afërsisë, duke u nisur në përkufizimin e saj, në esencën e asaj që është afërsia. Për të ardhur deri te përkufizimi i afërsisë, ose të kuptuarit e afërsisë si të tillë, ne duhet të nisemi nga ajo që është e afërt, nga ajo që e kemi afër – e ai është sendi. Heidegger-i këtu nisët nga sendi, nga përvoja primare jetësore e njeriut me sendin. Për këtë arsye ai në analizën e tij nuk hyn në ndonjë abstraksion shkencor, por në shpalosjen e përvojës së drejtpërdrejtë me sendin. Për këtë ai edhe si referencë të tij e merr shtambën – një enë të thjeshtë prej dheu për të shpjeguar afërsinë dhe njëherësh sendin si të tillë. Këtu Heidegger-i favorizon përvojën e drejtpërdrejtë ekzistenciale njerëzore me sendin në raport me mënyrën shkencore të interpretimit të tij, të cilën ai e sheh si joadekuate. Ai për shtambën shkruan se ‘ajo është një enë; diçka e tillë që në vete kap diçka tjetër’, ose që përmban diçka tjetër. Heidegger pohon se shtamba është ‘e pavarur’, me çka fillon diferencimin bazë mes sendit dhe objektit: “si pavarësi e diçkaje të pavarur, shtamba dallon nga objekti. Diçka e pavarur mund të shndërrohet në objekt nëse e vendosim para vetes qoftë në perceptimin e drejtpërdrejtë, qoftë në të tashmen e perceptimeve nga kujtesa. Mirëpo ajo që është e vërtetë në sendet nuk fillon as në atë që ato janë objekte të prezantuara e as që në përgjithësi do të mund – që nga pozita e objektësisë së objektit – të përcaktohen”⁷. Pavarësia e sendit është ende e mjegullt në të menduarit e sendit për arsye se pavarësia e tij vazhdon të kuptohet përmes ‘objektësisë edhe pse përkundërsia e të prodhuarës tashmë nuk fillon në vetë perceptimin’. Kjo ngase shtamba është ‘e pavarur’. Kjo edhe për arsye se esenca e shtambës në asnjë mënyrë nuk ‘është e kryer me të prodhuarit e saj’. Njëherësh, siç shkruan Heidegger-i, ‘ajo realja që është tipike për enën assesi nuk fillon në materialin prej së

⁷ Martin Heidegger, Mišljenje i pevanje, “Nolit”, Beograd, 1982, fq. 106.

cilës përbëhet ajo, por fillon në zbrazëtinë të cilën e kapë’, kjo sepse ‘zbrazëtia ose asgjëja e shtambës është ajo që shtamba është enë që kapë’. Dhe mbase ky është momenti i cili i ik vështimit dhe të kuptuarit shkencor mbi sendin, sepse shkenca në asnjë mënyrë nuk mund që ta kapë asgjënë e enës, zbrazëtinë e saj, dhe për këtë nuk mund të kapë as esencën e shtambës. Dhe Heidegger-i këtu i referohet sidomos fizikës dhe interpretimit të saj kur shkruan se “në vijën efektive të shtambës, atë të sajën që kapë, zbrazëtinë, e paraqesim si një boshllëk të mbushur me ajër. E paramenduar në mënyrë fizike, ajo edhe është ajo që është zbrazëtia; por kjo nuk është zbrazëtia e shtambës. Ne nuk e kemi lejuar që zbrazëtia e shtambës të jetë zbrazëtia e saj”⁸. Esenca e zbrazëtisë që kap është ajo që njëherësh edhe jep. Ajo që ajo jep nuk është një derdhje e thjeshtë sipas Heidegger-it. Të dhënit në derdhje po ashtu përmbledhë edhe të dhuruarit, ngase pija që ofrohet është ajo e dhuruar për të vdekshmit. Por në atë të dhuruar janë të përfshirë njëherësh të gjithë: toka, qielli, hyjnorët dhe të vdekshmit, ngase atë që na dhuron shtamba, ta zëmë ujin, Heidegger-i e shpreh në këtë mënyrë: ‘në ujin e burimit e kemi kurorëzimin solemn të qiellit dhe tokës. Ky solemnitët banon në verën që na jep fruti i hardhisë në të cilin janë bashkuar ushqimi tokësor dhe dielli qiellor.’⁹ Mundësia që të dhuruarit e shtambës të jetë po ashtu edhe pjesë e procesionit religjioz me çka kemi të ftuar edhe hyjnorët; ‘në dhuratën e derdhur banon thejshtësia e të katërtes’. Pra ajo që është karakteristikë e sendit është se ai mbledh katërsinë në një. Dhe këtu Heidegger-i sërish i kthehet gjuhës. Pavarësisht se ai pohon që mund të duket në shikim se ‘po merret me paparashikueshmërinë e lojës etimologjike’, ai vazhdon që në të folurit burimor të gjuhës të nxjerrë domethënien e ‘të mbledhurit’. Të mbledhurit në gjuhën e vjetër gjermane quhet *thing*. Heidegger-i në ekspozueun e tij elaboron edhe kuptimin e *thing* dhe *dinc*, për ta kontekstualizuar në etimologjinë latine të res (në të cilën gjenë njëherësh edhe kuptimin e një çështjeje që ka të bëjë me njeriun). Heidegger-i së fundmi vjen te konstatimi se “shtamba nuk është send as në kuptimin e res-it romak e as në të paramenduarit mesjetar të ens-it, por as në prezantimin e kohës së re të objektit. Shtamba është send nëse sendëson. Nga sendësimi i sendit ndodh dhe përcaktohet prania e asaj që është e pranishme si shtambë”¹⁰. Në njëfarë deduktimi kuptimor të zbrërthimit

⁸ Martin Heidegger, po aty, fq. 110.

⁹ Martin Heidegger, po aty, fq. 113.

¹⁰ Martin Heidegger, po aty, fq.119.

etimologjik të fjalës send, Heidegger nxjerr esencën e afërsisë me sendin, si ai që mbledh katërsinë në të cilën shpaloset botësia e botës. Për këtë ai shkruan se “sendi është i pranishëm si katërsi. Sendi sendëson botën. Çdo send është si katërsi, duke hyrë në atë që gjithnjë është në thjeshtësinë e botës”¹¹. Afërsia me sendin është jashtë reduktimit ose shkurtimeve të distancave të thjeshta – siç e kemi në kalkulimet numerike matematikore. Heidegger-i shkruan se ‘sendi nuk është ‘në’ afërsi, thuajse ajo është ndonjë kontejner. Afërsia është në të afuarit si sendësim i sendit’. Në të qenit afër sendit nënkupton shumë më shumë nga mënyra e të kuptuarit tashmë tradicional shkencor të sendit që ka çuar kah shkatërrimi i tij. Për këtë Heidegger-i pohon se tmerri i shpërthimit nuklear ka ndodhur para eksplodimit të bombës atomike dhe kjo falë shkatërrimit të sendit, ose raportit primar, të drejtpërdrejtë ekzistencial me sendin, por edhe botën. Të menduarit e afërsisë si afërsi së këndeji për Heidegger-in ka një domethënie të posaçme jo si zhatje semantike në lojën etimologjike, por si përcaktuese e raportit të domosdoshëm me botën. Afërsia me sendin vetvetiu na shpjen kah afërsia me botën e cila është e përmbledhur në sendësimin e sendit, sepse siç pohon Heidegger-i ‘vetëm ajo që është e përbërë nga bota bëhet send’. Heidegger-i me analizën e tij gjuhësore dhe etimologjike të rezervuar krejtësisht nga aspektet e modeleve numerike dhe prezantimeve racionale scientiste përpiqet të identifikojë parakushtet ekzistenciale në të cilën janë gjendur qeniet e vdekshme, si të afta për vdekje. Në momentin kur Heidegger-i flet për sendin, botën që është e përmbledhur në katërsinë e saj si tokë, qiell, hyjni dhe të vdekshëm, si duket ka të drejtë Hofstadter-i kur shkruan se ‘kjo nuk është teorizim abstrakt për problemin e njohjes, vlerës ose realitetit; ky është të folurit dhe mendimi më konkret për qenien, të dalluarit e qenies nga qeniet tjera si dhe njësinë e identitetit të tyre në dallime dhe me të gjitha dallimet’¹². Së këndeji të qenit, pra edhe banimi është gjithherë në një raport drejtpërdrejtshmërie me sendet, afër sendeve, me sendet e jo në kundërshtim me sendet. Jo në asnjë mënyrë në ndonjë abstraktim në të cilin raporti krejtësisht reduktohet në fuqinë e prezantimit të sendit. Ky raport me sendin, ky të kuptuar burimor i raportit me

¹¹ Martin Heidegger, po aty, fq.123.

¹² Albert Hofstadter, ‘Introduction in Heidegger’, Poetry, Language, Thought, Harper&Row/London, 1971, pp.ix-xxi, cit sip. Adam Sharr, Heidegger for Architects, fq. 32. Adam Sharr po ashtu shkruan se ‘katërsia është ofruar, ashtu siç ka gjykuar ai, si kushtet më primare të ekzistencës, prerekuizitë e pashmangshme e botës në të cilën njerëzit janë ‘hedhur’ pa pëlqim’, po aty, fq. 33.

sendin ka për rrjedhojë diferencimin bazë hapësinor mes, ta zëmë, pranisë së ujit në gotë dhe atij të raportit të Dasein-it me botën. Këtë aspekt e vëren shumë mirë de Beistegui kur pohon se “ky është dallim mes dy kuptimeve të hapësirës: përderisa e para na shpie kah kuptimi i hapësirës që zakonisht është i pranueshëm si mbyllje fizike në të cilën sendet janë të përmbajtura ose të gjetura a si një set koordinatash përmes të cilave një trup material ose sistem dinamik mund të lokohet, kjo e dyta korrespondon me një fenomen shumë më burimor dhe përkon me të kuptuarit ontologjik të hapësirës”.¹³ Abstraktimi i konceptimit burimor të hapësirës mbi bazën ontologjike-ekzistenciale, së këndejmi në asnjë mënyrë nuk na shpjen kah të kuptuarit e esencës së ndërtimit dhe banimit. Reduktimi i të kuptuarit të hapësirës vetëm mbi bazën e përkufizimit të ‘perimetrave fizike që shënojnë dallimin mes të brendshmes dhe të jashtmes’, sipas Heidegger-it nuk na mundëson të kuptojmë esencën e banimit. Fundja, arkitektura gjithëherë ka presupozuar qysh në fillet e saj diçka të tillë. Andaj edhe Heidegger-i, jo rastësisht, pohon se çështja e të kuptuarit të ndërtimit dhe banimit më së paku i takon arkitekturës. Pikëpamja e Heidegger-it këtu shpalos një konceptim reduktues të hapësirës me të cilën operon arkitektura, ndoshta edhe domosdoshmërisht, por ajo aplikon një konceptim ekskluzivisht objektiv, gjeometrik dhe matematikor në të cilën zhbëhet krejtësisht dimensionin ontologjik dhe ekzistencial i saj. Ky dimension është shumë i rëndësishëm, sepse mbi të është konstruktuar diferenca bazë e Dasein-it me qeniet tjera si dhe me sendet tjera, ngase, siç pohon de Beistegui “Dasein-i esencialisht nuk është një send brenda bote edhe përkundër faktit se është ‘në’ botë. Kuptimi ‘në’ në rastin e sendeve brenda botës dhe në rastin e të-qenit-në-botë të Dasein-it dallojnë rrënjësisht”.¹⁴ Ky distinkcion i konstatuar qysh në veprën e tij *Sein und Zeit* do të jetë i pranishëm në një formë më koncize, madje mund të thuhet edhe më të konkretizuar në saje të disa nocioneve të përdorura që shpalosin tërësinë e mendimit të tij në ligjeratat e tij të viteve të 50-ta të shek. XX. Në të menduarit e ndërtimit dhe banimit Heidegger-i në ligjeratën e tij shtron në mënyrë të prerë edhe çështjen e raportit mes hapësirës dhe vendit si dhe raportit të njeriut me hapësirën.

¹³ Miguel de Beistegui, *Thinking with Heidegger, Displacements*, Indiana University Press/Bloomington & Indiana, 2003, fq. 142.

¹⁴ Miguel de Beistegui, po aty, fq.145.

Ngjarja, vendi, hapësira

Nocioni i vendit dhe të kuptuarit e tij nga Heidegger-i do të jetë ndoshta momenti më intrigues në debatin arkitektonik të modernizmit. Kjo do të nxitë afirmimin e një aspekti në të shumtën të neglizhuar në diskursin arkitektonik të modernizmit. Thellimi i Heidegger-it në të menduarit e qenies dhe të qenit e qenies e shpjen për ta menduar atë në aspektin burimor. Një qasje e këtille, me të angazhuarit e tij në dy ligjërata të themi kushtimisht për arkitekturën, e bën që të shtrijë tutje interpretimin e tij për qenien dhe të qenit. E natyrisht se ai këtë do ta shtrijë deri te banimi, ku banimin do ta identifikojë me qenien. Ky identifikim ose njëjtësim nuk mbetet edhe pa konsekuenca, sidomos për mënyrën e përhapur të menduarit e banimit, njëherësh edhe në të menduarit e hapësirës, ngase banimi është menduar kryesisht mbi bazën e konstruksionit të thjeshtë inxhinierik apo aspektit analitik, ndërsa hapësira është trajtuar kryesisht në aspektin matematikor dhe gjeometrik, me çka vendi mbetet krejtësisht në hijen e modelimeve arbitrare konstruktive. Me Heidegger-in kjo qasje përmbysët krejtësisht, ngase atje ku na shpjen të menduarit e qenies tejkalon të gjitha aspektet modeluese arkitektonike dhe konstruktive, sepse atje jemi në pastërtinë e të qenit. Ndoshta për këtë arsye të menduarit e Heidegger-it në mënyrë konsekuente zhvendoset në rajonet e qenies, në topologjinë e saj ose në topos-in e saj.

Para se të trajtojmë çështjen e vendit dhe të hapësirës në mënyrë të shkëputur nga konteksti topologjik i qenies, duket se duhet shtjelluar disa koncepte me të cilat na shpaloset koherenca e mendimit të tij dhe qartësimin të nocionit të vendit dhe të hapësirës në filozofinë e vonshme të tij. Fokusi i izoluar në vendin dhe hapësirën mbase është edhe arsyeja që janë nxitur debatet e mëdha rreth mendimit të Heidegger-it për vendin dhe hapësirën. Analiza e veçuar e vendit te disa interpretë ka krijuar bindjen se mendimi i Heidegger-it është plot me intonime mistike, provinciale dhe romantike. Ndërkaq, në anën tjetër, kemi edhe mendimtarë të tjerë që mendimet e tij i shohin në konsekuencë dhe koherencë në shpalosjen transcendentale të konceptit të vendit dhe hapësirës, duke dalur nga rrafshi i ngushtë i asaj Da të Dasein për të ardhur deri te hapja ose çelja e qenies. Hapja ose çelja e qenies është ngjarje ose të ndodhur që në të mbledhurit mundëson manifestimin e katërpjesëshit, që nuk është të mbledhur të elementeve të ndryshme, por manifestim i secilës në saje të të mbledhurit.

Këtu më duket se ka plotësisht të drejtë Malpas, i cili mendon se me të kthyerit kah nocioni i ‘ngjarjes’ te Heidegger-i hapim rrugën për të ardhur te kuptimi koherent i shpalosjes së konceptimit të vendit dhe hapësirës. Cili është nocioni i ngjarjes? Çka përfshin në kuptimin e tij ky nocion te Heidegger-i? A do të thotë kjo se ngjarja i prinë vendit dhe hapësirës? Apo ndoshta diçka si vendi dhe hapësira janë ngjarje? Nëse i kthehemi Heidegger-it, ne do të shohim se kemi të bëjmë me një moment të rëndësishëm në të cilin na shpaloset një moment esencial në mendimin e tij për të arritur deri te të kuptuarit e tij për vendin dhe hapësirën. Në shkrimin e tij “Parimi i identitetit” (*Der Satz der Identität* – 1957) Heidegger-i pohon se me këtë ‘të bashkuar’ dhe ‘të ndarë për’, ku e gjejmë njeriun dhe qenien që i jepen njëri-tjetrit, ‘duhet të futemi në atë që e quajmë ngjarje (*Ereignis*)’. Sërish në thellësitë kuptimore të gjuhës arrijmë në përvojat burimore në *Ereignis*. Heidegger-i shkruan se: “të ndodhë” burimisht (er-eignen) do të thotë: përfytyrim (er-augen), pra diçka të shikosh, me të shikuar ta thërrasësh tek vetja. Fjala ‘ngjarje’ për të cilën mendohet nga pozita e përmbajtjes më herët të treguar, duhet tash të na flasë si fjalë kyçe në shërbim të mendimit. Si e këtillë ajo është e papërkthyeshme sikurse *logosi* grek dhe *tao* kinez¹⁵. Këtu na dalin edhe vështirësitë e përkthimit të *Ereignis*-it jo vetëm në gjuhën shqipe, ngase edhe në atë angleze kemi përpjekje të shumta që të arrihet deri te një kuptim më përfshirës i këtij nocioni. Ne këtë mund ta përkthejmë edhe si ngjarje, por edhe si të ndodhur që po ashtu në gjuhën shqipe tërheq kuptimet e ndodhemi, pra gjendemi në ndonjë vend, gjë që nuk është pa konsekuenca të caktuara në konceptimin e vendit. Ne shohim se si edhe në konceptin e *Ereignis*-it (‘ngjarjes’) sërish nga gjuha po flet qenia edhe në kuptimin e vendit dhe hapësirës. Për shembull Malpas mendon se te Heidegger-i janë përfshirë tri kuptimet e fjalës *Ereignis*. Ai shkruan se ‘ideja e ngjarjes/të ndodhurit, mbledhjes/përkitjes, hapjes/zbulimit, përmes këtyre tri elementeve e kemi persistente temën e unitetit, nga uniteti i të ndodhurit, tek uniteti i përkitjes, tek uniteti i hapjes. Mbi të gjitha, atëherë *Ereignis* është emër për një lloj të veçantë të unifikimit dhe diferencimit që ndodh dhe me të cilën sendet vijnë në prani, me të cilën ato vijnë të jenë’.¹⁶ Këtu e shohim se nocioni i *Ereignis* është i një rëndësie të veçantë dhe si i tillë nuk duhet të kuptohet si ngjarje e thjeshtë për arsye se ajo nuk është një

¹⁵ Martin Heidegger, *Miçljenje i pevanje*, fq. 52.

¹⁶ Jeff Malpas, *Heidegger's Topology, Being, Place, World/* Massachusetts Institute for Technology/ Cambridge- Massachusstes/2006. fq. 216.

ngjarje në mesin e ngjarjeve të tjera. Kjo sepse ngjarja, siç pohon Malpas, ‘është të ndodhurit unik të botës përmes të mbledhurit të elementeve bazike që janë konstitutive për të’. Në të gjitha përdorimet dhe shterimet e mundshme kuptimore të këtij nocioni gjejmë një pamundësi reduktimi si njëfarë sugjerimi për të hapur mendimin për thirrjen e qenies përmes gjuhës, ngase të ardhurit e qenies në prani ka të bëjë me të ndodhurit e hapjes, zbulimit, çeljes së qenies. Më duket se Malpas ka të drejtë kur pohon se ‘këtu atëherë na dalin dy kuptime të ngjarjes (të ndodhurit): si të ndodhur origjinal të çeljes dhe si çelje e këtij të ndodhuri origjinal’. Pra ne shohim se ‘ngjarja’ është një nocion bazik i cili duhet të përshkruaj hapjen, çeljen në të cilën jemi gjetur të mbledhur dhe në përkatësi me njerëzit tjerë dhe sendet në botë. Në sendësinë e sendit, por edhe botësinë e botës. Siç pohon tutje Malpas, “si i tillë të ndodhurit për të cilën është fjala është esencialisht ‘atje-ja’, e ‘afër-ta’, ‘vend-osja’ – kjo është të ndodhurit e këtij rajoni të hapur në të cilin e gjejmë veten së bashku me njerëzit tjerë dhe sendet dhe të cilit tashmë i përkasim”¹⁷. Tanimë në këtë të hapur të qenies dhe botës, si ‘ngjarje e të qenit’ shpërfaqemi në tërësi në saje të përkatësisë dhe të mbledhurit. Me këtë mbase shfaqet vendi, por jo si i tillë që do të ishte shenjues të themi i fiksuar i ndonjë pike të lokalizuar, por si vend-osje në të përkulturit dhe të mbledhurit. Vetëm në këtë ‘ngjarje të të qenit’, në këtë ngjarje të themi burimore, më pastaj shfaqet vendi dhe hapësira. Në këtë hapje burimore në ‘ngjarjen e të qenit’ na shkëndijon njëherësh edhe të ndodhurit.

Duket se me këtë ne tashmë mundemi t’i kthehemi mendimit të Heidegger-it në të trajtuarit e vendit dhe hapësirës. Për arsye se me ‘ngjarjen’ tashmë është shpalosur të hapurit e qenies në ‘të mbledhur’ si dhe në ‘të ndodhurit’ të saj si topos i qenies. Të kuptuarit e sendit, dhe sendësisë së sendit, ku sendësia shpreh esencën ose qenësinë e sendit dhe ku sendësia konsiston në ‘të mbledhurit’, na shpien gradualisht edhe kah raporti i vendit me hapësirën. Në ligjëratën “Ndërtimi, banimi, mendimi”, ai e trajton urën si send. Pra më shumë se urë ajo për të është një send. Heidegger-i mendon se të kuptuarit e urës, thjeshtë si një urë, nuk depërton në të kuptuarit e esencës së urës. Madje ai as aspektin simbolik të urës nuk e merr si qenësor për të kapë qenësinë e saj. Madje për më shumë pohon se ‘mendimi ynë është mësuar të vlerësojë si tepër të varfër qenien e sendit’. Për të kuptuar urën si send në sendësinë e vet, pra në të mbledhurit, atëherë, mendon Heidegger, ajo është send ‘që mbledhë katërpjesëshin në mënyrë të

¹⁷ Jeff Malpas, po aty, fq. 221.

atillë që të arrijë t'i lejojë edhe atij vend. Sepse vetëm ai që është vetë një vend (Ort) mund t'ia lirojë hapësirën një vendi¹⁸. Ura nuk është e vendosur në ndonjë vend, përkundrazi, vendi është bërë me urën. Ura nuk zë vendin, sepse vendi bëhet me të bërit e urës. Gjatë lumit ne kemi edhe pjesë dhe kënde të tjera të cilat vetëm në saje të sendeve shndërrohen në vende. Edhe raportin mes vendit dhe hapësirës, ose të kuptuarit e vendit dhe të hapësirës Heidegger-i e nxjerr sërish nga gjuha dhe kuptimin që ajo i jep qenësisë së sendeve, apo ndoshta të themi, qenies së sendeve, e në këtë rast edhe vendit dhe hapësirës. Këtu Heidegger-i në mënyrë të përmbledhur jep njëfarë përkufizimi, por edhe dallimin mes vendit dhe hapësirës bazuar në gjuhë. Heidegger pohon: “Se çfarë përshkruan fjala Raum, këtë do të na e thotë kuptimi i saj i vjetër. Raum, Rum një shesh të kthyer të lirë për një vendosje kolonash apo për një kamp. Një hapësirë (Raum) është diçka që është ‘trajtuar’, është kthyer e lirë – Brenda një kufiri, në greqisht *peras*. E kufiri nuk është ai ku diçka pushon, por siç e kishin vrojtuar grekët është pikërisht ai i nisur nga i cili diçka fillon të ketë prezencë. Ja pse koncepti i kufirit është quajtur *horismos*, pra horizonti, limiti... Rrjedhimisht mund të themi se hapësirat e marrin qenien e tyre nga vendet dhe jo nga ‘hapësirat’ (e menduar në tërësinë e vet)”¹⁹. Pra, hapësira nuk i prinë vendit, por vendi hapësirës, kjo në saje të krijimit të kufirit që sjellë diçka në prezencë. Kjo ngase grekët e vjetër, e këtë Heidegger-i me siguri e vetëkupton, p.sh. te Anaximandri atë që nuk ka kufi ose cak, pra ajo që është e pakufishme dhe e papërcaktuar është quajtur *apeiron*. E njëjta vlen edhe për mendimin e hapësirës, ngase ajo si e tillë është e papërcaktuar dhe e papërkufizuar, andaj mbetet ende një asgjë dhe së këndejmë nuk ka mundësi të manifestimit. Vetëm në momentin e përkufizimit të saj, në momentin ‘që është lejuar të hyjë në kufijtë e vet’ është shndërruar në hapësirë, pra në momentin që i është bërë vend ose i është ‘lejuar vend’. Duke u nisur nga përvoja njerëzore dhe duke hyrë në zbrëthimin ontologjik-ekzistencial të hapësirës, Heidegger-i aspektet matematikore dhe algjebrike të analizës i sheh vetëm si të derivuara nga qenësia e vendit dhe hapësirës. Kjo qenësi është krejtësisht në të ‘mbledhurit’ e sendit, pra në sendësinë e tij. Për këtë edhe ndërtimet duhet trajtuar si sende, si ato që krijojnë vend, hapin ose lirojnë vend për katërpjesëshin. Për ta konkretizuar dallimin mes hapësirës së matshme, distancës, trajktores dhe përllogaritjes e hapësirës si vend,

¹⁸ Martin Heidegger, Leksione dhe konferenca, fq. 154.

¹⁹ Martin Heidegger, po aty, fq. 154.

ai mendon se në asnjë rast kjo ose ‘përmasat numerike nuk janë bazë, themel të qenies së hapësirave’. Heidegger-i, duke iu kthyer sërish urës, shpalos qenësinë e hapësirës, me atë që zbërthen diferencën e sipërpërmendur nisur nga përvoja bazë njerëzore për hapësirën, që shkon përtej aspekteve matematikore dhe të matshme të hapësirës. Këtu do ta japim një citat paksa më të gjatë të mendimit të Heidegger-it për këtë dallim, përmes të cilit e vë në pah raportin vend-hapësirë. Heidegger-i shkruan: “Hapësira e zënë nga ura përfshin në vetvete një larmi sheshesh, ku më shumë e ku më pak të largëta apo të afërta prej saj. Këto sheshe, nga ana tjetër, mund të trajtohen edhe si pozicione midis të cilave gjendet një distancë e matshme; një distancë, që në greqisht quhet *stadion*, e që është gjithnjë e vendosur në një hapësirë (eingeraumt) nëpërmjet pozicioneve më se të thejshta. Mirëpo ajo që është e vendosur kështu në hapësirë me anë pozicioneve nuk është një hapësirë e thjeshtë, por e një natyre të veçantë. Si distancë, si *stadion*, ajo është ajo që vetë fjala *stadion* na e thotë në latinisht: një *spatium*, një interval. Në këtë sens afërsia dhe largësia ndërmjet gjërave dhe njeriut mund të kthehen edhe në intervale të një hapësire të intervalueshme²⁰. Mbi bazën e hapësirës si interval bëhet edhe abstraktimi i tri dimensioneve hapësinore si gjatësia, gjerësia dhe thellësia. Duke pohuar se në këtë po ashtu e ‘përshkruajmë si larmi tre dimensionesh’ Heidegger-i vazhdon: “Megjithatë ajo që sistemon në hapësirë (einraumt) këtë larmi nuk është përcaktuar nga distancat, ajo nuk është më një *spatium*, por veçse një *extensio* – një shtrirje. Aq më tepër që këtë hapësirë si *extensio* në mundemi ta reduktojmë edhe njëherë akoma me anë të abstraksionit që lidhet me raportet analitiko-algjebrike. Ndërkohë që ajo çka lejojnë këto raporte është thjesht mundësia e një ndërtimi shumëplanësh, me një numër arbitrar dimensionesh. E atë hapësirë që sistemohet kështu në mënyrë pastërtisht matematike, në mund ta quajmë ‘hapësirë’, ‘e vetmja’ si një hapësirë në vetvete. Mirëpo ‘hapësira’ (nënkupto në tërësi) në këtë sens nuk përmban as hapësira, as sheshe. Në të në nuk do të gjejmë kurrë vende, d.m.th. gjëra të llojit të urës”.²¹ Pra radhitja e manifestimit të hapësirës të Heidegger-i na vjen sipas një radhe të atillë në të cilën e shohim se si vendi ka prioritetin e vet, ngase në saje të vendit na shfaqen radhazi mbi bazën e shpalosjeve edhe hapësira si interval, por edhe ajo që mbi bazën e kësaj na shpaloset edhe hapësira si shtrirje – *spatium* dhe *extensio*. Në përimtësimin e këtillë të të

²⁰ Martin Heidegger, po aty, fq. 156.

²¹ Martin Heidegger, po aty, fq. 156.

kuptuarit të drejtpërdrejtë të hapësirës, nga përvoja e drejtpërdrejtë, nga qenësia e saj e shohim se tashmë mund ta shpalosim edhe raportin e hapësirës me njeriun. Ky raport nuk nënkupton atë që njeriu dhe hapësira janë të ndarë, ‘thujse kemi hapësirën në njërin anë dhe njeriun në anën tjetër’. Por, po ashtu, Heidegger-i mendon se hapësira nuk është as përvojë e brendshme e tij dhe kështu sërish na rikthen në konceptimin primar të saj mbi bazën e sendit, sendësisë së tij dhe afërsisë së njeriut me sendin, ngase të vdekshmit, pra njeriu, sipas Heidegger-it, është si i vdekshëm brenda katërpjesëshit dhe pranë sendeve. Për këtë pohon Heidegger se njeriu, pra të vdekshmit ‘duke banuar, ata mbahen nga njëri skaj i hapësirave në tjetrin në saje të faktit që ata qëndrojnë midis sendeve dhe vendeve’.

Të kuptuarit e vendit këtu na del si të kuptuar burimor dhe primordial, i bazuar në përvojën primare njerëzore dhe duke tejkaluar ngushticën e interpretimit matematikor mbi të cilën nuk mund të mbështetet të kuptuarit burimor të vendit dhe hapësirës ose qenësisë së tyre. Heidegger-i me elaborimin e tij fenomenologjik ka mundësuar atë që në fillim e quajtmë ‘kthesa fenomenologjike’, e cila ka mundësuar një të menduar më të avancuar të konceptit të vendit si dhe rikthimin e tij të sërishëm në diskursin arkitektonik. Të rikthyerit e vendit në diskursin arkitektonik ka bërë që të fillojë një debat i përhapur për konsekuencat e mendimit të Heidegger-it. Këto debate në të shumtën shquhen për nga rezerva, dyshimi, por edhe mundësia e ngarkesës ideologjike dhe politike me lidhjen për vendin si një kërkesë romantike për vendosjen e njeriut në lidhjet e tij primare të përkatësisë. Kritikët radikalë të Heidegger-it e shohin këtë si lidhje primare me ‘tokën dhe gjakun’ si njëfarë jehone e thirrjes ideologjike të nazizmit gjerman.

Teknologjia, mobiliteti, jovendi

Përveç kritikës së ashpër që e kontekstualizon mendimin e Heideggerit kryesisht mbi premisa ideologjike dhe politike, kemi edhe qasjen e cila në zhvillimet aktuale të mobilitetit të përgjithshëm social mendon se nocioni i vendit është zhbërë si lokalizim, ngase tashmë jemi të vendosur në rrjete çlokalizuese dhe mobilizuese në të cilat vendi e humb primatin, me çka hapen perspektivat për përvojat e reja të mobilizimit të përgjithshëm. Mbase ka shumëçka sfiduese në këto qasje që japin përgjigje për transformimet e mëdha të kontekstit të ri të asaj që mund ta quajmë edhe si hipermodernitet ose supermodernitet,

nëse do të shërbeheshim këtu me nocion e Augesë. Konteksti i ri i krijuar mbi bazën e zhvillimeve teknologjike na ka futur në të shumtën në vorbullin marramendës të mobilitetit, shpejtësisë, komunikimit përmes rrjeteve të dendura me funksionin e njëkohësisë, lëvizjeve dhe pranisë gjithnjë e më të madhe nëpër jovende. Mbi këto premisa këto qasje mendojnë se pikëpamjet e Heideggerit nuk mund të kontekstualizohen ose për më shumë se janë krejtësisht të dekontekstualizuara dhe nuk mund të gjejnë aplikimin e dëshirueshëm në epokën aktuale të zhvillimeve teknologjike.

Njëri nga autorët që e sheh pikëpamjen e Heidegger-it nën këtë prizëm të pamundësisë së kthimit të vendit është edhe De Beistegui. Ai nisat prej qëndrimit se banimi nuk mund të vështrohet ekskluzivisht nga aspekti i qenies ose ai ontologjik për arsye se aspekti ontologjik është e pamundur të ekspikohet vetëm ontologjikisht, duke abstraktuar aspektet tjera përmes të cilave mund të ekspikohet nisur nga ai historik, kulturor, socioekonomik, shkencor, por edhe ai artistik. Analiza e banimit vetëm përmes qenies dhe të qenit, nuk mund të jetë e mjaftueshme jashtë konteksteve të sipërpërmendura. Nëse do të niseshim edhe nga këto aspekte për të interpretuar banimin, na shfaqet një kontekst i ri dhe i ndryshëm historik, konfigurime krejtësisht të mëvetësishme historike të epokës aktuale teknologjike. De Beistegui nisat edhe prej një kontekstualizimi historik të mënyrave të banimit në perëndim, duke i vështuar në dallimet mes atyre të Greqisë antike, të mesjetës dhe banimit bashkëkohor. Ai madje mendon se ‘analiza neutrale’ e Heidegger-it, e ‘ngjarjes së qenies’ asnjëherë nuk mund të jetë jashtë ‘konfigurimeve historike’, ngase sipas tij edhe ‘ngjarja e qenies’ është gjithnjë e manifestuar në kontekste konkrete brenda konfigurimeve të caktuara të një epoke. Për këtë edhe banimin sot, sipas tij, duhet ta mendojmë në konfigurimet e sotme të arritjeve të zhvillimeve teknologjike, shkencore, socioekonomike.

De Beistegui në kontekstin aktual bashkëkohor sheh një transformim të rëndësishëm. Kjo ndodh edhe ngase ‘ngjarja’ ose ‘të ndodhurit’, përveç se vendos në saje të hapjes praninë e qenies, ai këtë dimension të ngjarjes nuk e sheh vetëm në aspektin hapësinor në të cilin të ndodhurit ndodhet ose vendoset, por edhe në atë kohor në të cilin ngjarja ose të ndodhurit është në saje të pranisë së qenies, pra edhe në të tashmen. Andaj duke e vështuar në këtë aspekt ‘ngjarjen’ dhe ‘të ndodhurit’, pra neve na shfaqet edhe rikonfigurimi historik në saje të të cilit kemi edhe praninë përmes ndryshimit të të kaluares, me çka hapemi për të tashmen dhe aktualitetin.

Duke e kontekstualizuar tashmë ngjarjen dhe të ndodhurit në konfigurimet e epokës teknologjike De Beistegui shkruan: ‘modeli Heidegger-ian i banimit, pavarësisht nga aspektet e dëshirueshme apo të padëshirueshme, duket i papajtueshëm me kërkesat e jetës teknologjike, të industrializuar dhe urbane’²². Ai mendon se në kontekstin aktual të zhvillimeve teknoshkencore, në mënyrën aktuale të banimit të qyteteve të zhvilluara kemi vështirësitë e mbështetjes në katërpjesëshin, siç janë toka, qielli, të vdekshmit dhe hyjnorët. Toka sipas tij është nën kontroll dhe e nënshtruar, hyjnorët nuk priten, qielli tashmë tejkalon përfytyrimet religjioze duke udhëtuar në thellësitë e gjithësisë së pakufishme. Dhe këto janë konfigurime të reja të epokës teknologjike të cilat reflektojnë edhe në konceptin e vendit ose më mirë të afirmimit gjithnjë e më të sforcuar të hapësirave të jovendit, për të cilën do të flasim më vonë. De Beistegui mendon se teknologjitë e reja kanë mundësuar, në sajë të të arriturave inxhinierike dhe teknologjike, edhe pavarësinë e arkitekturës nga toka, ose të themeluarit në tokë. Ai madje i referohet edhe të arriturave të arkitektëve modernistë si ato të Le Corbusier, Mies van der Rohe, Gropiusit etj, të cilat ‘nga perspektiva Heidegger-iane vetëm sa dëshmojnë për pamundësinë e banimit në epokën teknologjike’. De Beistegui, pavarësisht se i vetëdijshëm për qëndrimin e Heideggerit rreth teknikës dhe teknologjisë, megjithatë, këtë zgjedhë (Gestell – që në anglishte përkthehet me Enframing dhe Frammework) e sheh nën prizmin e motos së van der Rohes si vullnet të epokës. Për këtë ai pohon: “Nëse epoka është vërtet ajo teknologjike, dhe kjo nënkupton zgjedhë (Gestell) që udhëheq mënyrën me të cilën sendet dhe natyra si tërësi na paraqitet sot, atëherë arkitektura moderniste pohon se vetë ndërtesat dhe raporti ynë ndaj hapësirës si të tillë duhet të pasqyrojnë dhe organizojnë spacialisht këtë kapje teknologjike të botës, këtë ‘vullnet të epokës’”.²³ Një interpretim i tillë sado të duket të jetë mjaft reduktues, ai megjithatë shpreh ‘tensionet e pareduktueshme’ të kërkesës së Heideggerit dhe realitetit të kohës tonë. Heideggeri kur flet për imperativat teknologjike, ai e vëren se ato gjithçka e kanë shndërruar në vlerë, kalkulim të matshëm dhe se me këtë kemi arritur në pikën e

²² Miguel De Beistegui, *Thinking with Heidegger, Displacement*, fq. 157.

²³ Miguel de Beistegui, po aty.fq.158-159. Këtu duhet potencuar edhe atë që Gestell është një mënyrë e prezantimit dhe e hapjes së caktuar. Për këtë arsye edhe në gjuhën angleze përdoret si framework, si kornizë, ndërkaq në gjuhën shqipe më duket më e qëlluar shprehja zgjedhë, që është kornizim që fut kokat e qeve në to për të caktuar drejtimin e tyre. Por ajo që duket interesante këtu është edhe një formulim i Jeff Malpas-it kur shkruan se “Korniza (Zgjedha) nuk është mjet e as mekanizëm, por si e tillë një mënyrë e të pranishmes dhe çelnajës/hapjes’ fq. 281.

‘harresës së qenies’ ose edhe tek ‘nata e botës’. Pavarësisht konotimeve poetike të vlerësimeve Heidegger-iane ai këto i nxjerr nga një analizë e thellë fenomenologjike e përvojës burimore njerëzore që duhet përmes mendimit të na hapë qenien. Madje ai imperativat teknologjike i sheh si pjesë e pandashme e një të kuptuarit shkencor të hapësirës, një të kuptuari të atillë, siç pohon Malpas ‘sipas të cilit hapësira na shfaqet si homogjene, si shtrirje e matshme që shpesh artikullohet përmes nocionit të sistemit të koordinatës... hapësira është një kontejner neutral, gjithkund e njëjtë në të cilën trupat dhe elementet e trupave lëvizin dhe ndërveprojnë në pajtim me modelet uniforme gjeometrike dhe matematike’²⁴. Ndërkaq, ne më lart e pamë se Heidegger-i kundërshton mu këtë mënyrë të konceptimit të hapësirës, mu këtë aspekt universalisht të aplikueshëm matematikor dhe gjeometrik të hapësirës në përvojën burimore të njeriut me vendin, sendin, afërsinë dhe botën. Ne sot përjetojmë flakjen dramatike të distancave në saje të teknologjive të reja, por edhe kjo është pikërisht ajo që Heidegger e kishte vërejtur në teknikën dhe teknologjinë e cila na zhvendos nga përvoja jonë burimore dhe primare e raportit me sendet dhe afërsinë e sendeve në botë. Në epokën e kompjutorëve dhe net-it tashmë kemi flakur distancat, por po ashtu edhe raportin ndaj sendit, për çka na fliste edhe vetë Heidegger-i. Duket që Malpas e kapë këtë moment dhe këtë ndryshim dramatik të raportit ynë me sendin, duke shkruar: ‘Një mënyrë e përshkrimit të zhdukjes së sendit që na shfaqet këtu është të themi ajo që sendi në mënyrë të pandalshme është zëvendësuar me reprezentimin (Vorstellung) e sendit (pra me sendet që janë zhvendosur nga vendi i tyre burimor – të transformuara dhe të reprezentuara nga një ‘kornizë’ e veçantë), përveç me atë që edhe ideja e reprezentimit ende i referohet diçkaje të reprezentuar’²⁵. Këto mjete teknologjike (kompjutori, interneti, telefoni, aeroplani, automobili) në njërin anë kanë pasur një konsekuencë evidente të një ndërhyrjeje në ‘rregullimin hapësinor dhe topologjik’, që ka shpënë në ndërhyrjen ‘në sensin tonë të lokimit – sensin tonë për vendin ‘. Por në anën tjetër edhe ‘përmes teknologjisë të asociuar me modet e reja të organizimit dhe konfigurimit hapësinor’ kemi arritur tek ajo që e quajmë jövend, si hapësira të zhveshura nga identifikimi, siç janë shopping mall-et, aeroportet, hotelet apo edhe autobanet.

Por shtrohet pyetja a janë këto mode të organizimit dhe konfigurimit hapësinor bazuar në imperativat teknologjike si rrjedhojë e identifikimit dhe reduktimit të çdo gjëje në të e vetmja mënyrë e banimit të njeriut? Apo ndoshta duhet përvetësuar edhe këtë aspekt të

²⁴ Jeff Malpas, Heidegger’s Topology, fq. 294.

²⁵ Jeff Malpas, Heidegger’s Topology, fq. 296.

potencuar te Heidegger-i për të gjetur një ndërthurje të këtij aspekti me të arriturat teknologjike që i kemi në dispozicion? Mos ndoshta mënyra e trajtimit të vendit te Heidegger-i nënkupton ndonjë prapakhim romantik në të shkuarën?

Mbi këto aspekte të konstatuara ngrihet edhe çështja dhe hamendësimet për shpërputhjen e konceptit të vendit në kuptimin Heidegger-ian me kontekstin aktual të zhvillimit në epokën teknologjike. Këto hamendësime e shpiejnë De Beisteguin kah përpjekja e gjetjes së modalitetit të banimit mbi bazën e referencave mitologjike që e kanë përcaktuar mënyrën tonë perëndimore të banimit. Ai shtron pyetjen se “a e vulos arkitektura bashkëkohore teknologjiken, fatin makinik të një banimi të reduktuar në kërkesat makroekonomike të kapitalizmit të vonshëm, apo mos ndoshta në disa instanca hap hapësira edhe përtej kësaj ekonomie ende jo thjeshtë të kthimit të konstruktimit në kuptimin e vendit që e ka zhvilluar Heidegger-i?”²⁶ Duke u nisur nga kjo pyetje, ai shqyrton aludimet ‘topografike’ dhe ‘konfigurimet kozmopolitike’ si konfigurime që kanë përcaktuar mënyrën e të jetuarit jo vetëm greke, por nga i cili rikonfigurim nuk kemi dalë ende. Mbi dy figura mitologjike mund të përkufizohen edhe mënyrat e banimit tonë. Këto De Beistegui i nxjerr nga disa analiza të bëra në kontekstin arkitektonik të Edward Casey dhe Paola Pirandellit, që po ashtu janë analizuar tek Jean Pjer Vernant në veprën ‘Origjina e mendimit grek’. Këto dy modalitete të banimit identifikohen me dy hyjni mitologjike; Hestia dhe Hermesi. Mbi bazën e këtyre dy figurave mitike, madje edhe të dy modaliteteve të banimit duket që kemi fërkimet ose edhe tensionet në përkufizimin e banimit në kuptimin Heidegger-ian dhe atij teknologjik të aktualitetit. Hestia është e bija e Reas (Tokës) dhe Kronosit (Kohës). Hestia është perëndesha e votrës rreth së cilës është qendëruar banimi në ngrohtësinë e shtëpisë. Ajo në të gjitha shtëpitë greke ka qenë në qendër të shtëpisë dhe ka udhëhequr me të gjitha gjërat dhe ekonominë shtëpiake. Jo vetëm kaq, ajo ka qenë njëfarë figure referente për modalitetin e organizimit të jetës jo vetëm në shtëpi, por edhe në kontekstin më të gjerë, atë të polisit grek, që ka qendëruar çdo gjë në agora ose në sheshin qendror. Zjarri i Hestias është gjetur edhe nëpër tempuj të shumtë profetik në qendër të tyre. Kjo si duket ka përcaktuar edhe strukturën e tempujve, ngase “të dyja, votra dhe tempulli ishin cirkulare në strukturë, një formë që paraqet shembull të vetëmbylljes dhe orienton vëmendjen kah qendra, duke i sjellë të gjitha

²⁶ Miguel de Beistegui, po aty.fq.160

brenda vetes, në të mbledhurit”²⁷. Së këndejmi në figurën e Hestias e shohim përpykjen e pandalshme qendërzuese dhe mbajtjen afër ose të mbledhurit në kuptimin Heidegger-ian, ngase ajo mbledh tokën dhe qiellin në një vend. Kjo mënyrë e banimit është mënyra hestiale me çka në arkitekturë shndërrohet në arkitekturën hestiale. Figura tjetër mitike ajo e Hermesit është e kundërta e Hestias, ajo është figura e rrugëtimit dhe e shtegtit, e lëvizjes dhe komunikimit sidomos në sferën publike për çka edhe merret si ‘zot par excellence politik’. Nëse aspekti hestial nënkupton të mbledhurit, aspekti hermetik nënkupton lëvizjen e pandalshme. Për këtë, siç pohon De Beistegui, ‘nën shenjën e Hermesit kon-centrikja bëhet ek-centrike’. Si të tilla këto figura nuk përjashtohen me njëra tjetrën, këtu nuk kemi të bëjmë me modalitete përjashtuese, por përshkuese. Mbase edhe për atë që Hermes gjendet gjithnjë jashtë nëpër hapësirat publike, dhe është ai që i drejton udhëtarët që janë jashtë dhe larg nga ngrohtësia e zjarrit të Hestias. Me të drejtuarit e tyre Hermes njëherësh kujdeset për ta, por edhe i vendos ata.

Ndonëse aktualisht duket që kemi në veprim hermetizimin e pandalshëm në humbjen e shtëpisë dhe humbjen e vendit, megjithatë ende mbetet e pranishme nevoja hestiale e të ndjerit në shtëpi dhe gjetjes së vendit të cilin e kuptimësojmë dhe që njëherësh i jep kuptim pranisë tonë. Nëse e transponojmë këtë në arkitekturë, ne duhet gjetur ekuilibrin mes hermetikes dhe hestiales, si dy dimensione në të cilat zhvillohet banimi jonë aktual.

Prej kësaj del që tematizimi i vendit dhe hapësirës nga prizmi i përvojës burimore, te Heidegger-i nuk duhet vështruar nga prizmi i ngushtë i refuzimit të kësaj përvoje njerëzore në favor të hapësirave abstrakte dhe të shfytyruara për njeriun. Ndoshta kjo nismë e Heidegger-it është mu ajo që ka rikthyer në debatin arkitektonik nevojën e rimendimit të premisave reduktuese abstrakte të hapësirave në rrjete të shfytyruara gjeometrike. Kjo nuk nënkupton përcaktimin rigjid mbi premisën ose-ose, atë që përjashton njërin nga tjetra, siç mund të duket në shikim të parë. Mbase edhe De Beistegui është i vetëdijshëm për këtë, ngase ai mendon se aspekti i përvojës burimore nuk mund të përjashtojë edhe mundësitë teknologjike të afirmimit të modeleve dhe modaliteteve të tjetra të organizimit të ekzistencës tonë. Duket që kjo edhe është e manifestuar në tendencat në arkitekturë, për arsye se, siç shkruan edhe De Beistegui: “Nëse i kthehemi arkitekturës dhe mënyrës më të cilën ajo mund t’i adresojë këto çështje në rrafshin molekular, ne shohim se,

²⁷ Miguel de Beistegui, po aty.fq.161.

përderisa arkitektura hestiale tenton të jetë e vijës së lakueshme dhe koncentrike, e kthyer nga brenda kah qendra, dhe vertikale e kthyer nga lart kah qielli, duke mbledhur kështu tokën dhe qiellin, arkitektura hermetike tenton të jetë ek-centrike dhe drejtvizore, e kthyer nga jashtë drejt horizontit – e drejt dhe horizontale”²⁸. Pavarësisht nga përcaktimet për këto modalitete të shprehjes në arkitekturë, megjithatë, të dyja janë të pranishme në atë që e njohim si ngjarje e arkitekturës, si shprehje e pandalshme arkitekturore si ajo që transponon rrënjësisht përvojat burimore njerëzore që përmbahen në fabulat mitike – që kanë shtresëzuar kuptimet e të qenit tonë në botë, ngase asnjëra nga këto fabula nuk ka kuptim si e veçuar dhe e izoluar, por vetëm në ndërthurjen e tyre që hapë horizontin për të kuptuarit kompleks të përvijimeve arkitekturore që shpërfaqin kuptimin e të qenit tonë në botë.

Martin Heidegger ‘Poetical Dwelling’

Abstract

Martin Heidegger, also known as the Thinker of Being, is not distinguished for in-depth studies in architecture. All his thoughts about architecture or issues of dwelling are presented in his lectures in the 50’s of last century, when he was allowed again to lecture after World War II. After this lectures we have a significant turn on the discourse of architecture, turn that can be called as *phenomenological turn in architecture*. The wandering analysis of the essence of dwelling is the ontological-phenomenological ground of Heidegger’s research on architecture. Here Heidegger seems to break down the notion of the being-in-the-world, through dwelling, in the freedom of which the essence of being is spared. This is because the mortals and being-in-the-world are involved in dwelling ‘in the sense of staying in the earth of mortals’. Heidegger’s conception of space doesn’t fit within the geometrical schema of modern architecture. To concretize his distinctions between the measurable space and the space of the place, he offers us an argument that ‘numerical sizes are not basis, for the essence of being of spaces’. Although, according to many of Heidegger’s interpreters, his conception on dwelling can’t be applied within the actual technological developments off urbanism; yet his conception on architecture opened new grounds on looking architecture beyond the functionalist-geometrical schema of modernity.

Key Words: Dwelling, Being, Think, *Ereignis*, Event, Dasein, Architecture, Phenomenology, Ontology.

²⁸ Miguel De Beistegui, po aty, fq. 163-164.

Shpresë Siqeca, Prishtinë

VESHJET KOMBËTARE TË VISEVE SHQIPTARE TË MAQEDONISË NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

Abstrakt

Në punimin “Veshjet kombëtare të viseve shqiptare të Maqedonisë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX” bëhet fjalë për disa veshje kombëtare shqiptare të meshkujve dhe të femrave nga viset shqiptare të Maqedonisë të punuara në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Punimi u hartua duke u bazuar në hulumtimet nëpër Maqedoni, ekzemplarët e veshjeve kombëtare të vendosura në Sektorin Etnogjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, koleksionet private, të dhënat gojore, fotografitë familjare etj.

Veshjet kombëtare të meshkujve të viseve shqiptare të Maqedonisë kryesisht i takojnë tipit të veshjes më tirq, ndërkaq veshjet e femrave tipit të veshjes me këmishë dhe një përparëse dhe tipit të veshjes me dimi.

Veshjet kombëtare dhe stolitë e viseve shqiptare të Maqedonisë janë punuar prej leshi, pambuku, cohe, lëkure dhe bakri. Ato janë punuar me teknikën e derdhjes, të endjes, të qepjes, të thurjes, të qëndisjes dhe të punimit me grep. Dekorimet në veshje dhe stoli kanë motive florale, gjeometrike dhe kozmike. Veshjet janë punuar në kuadër të artizanatit shtëpiak, nga terzinjtë, argjendarët, plisaxhinjtë, opingarët, shamixhinjtë, etj. Ndonjë ekzemplarë është prodhim industrial i importuar nga jashtë.

Sot veshjet kombëtare të viseve shqiptare të Maqedonisë të punuara në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX rrallë përdoren dhe vështirë mund të gjinden.

Fjalët çelës: Veshjet, Maqedoni, muze, tirqit, xhamadani, hërka, përparëse.

VESHJET KOMBËTARE TË MESHKUJVE

Veshjet kombëtare të burrave në Malësinë e Tetovës

Në Sektorin Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit /"KMLSHP"/ në Prizren është e ekspozuar një veshje kombëtare e burrave, e cila është blerë në fshatrat Shipkovicë dhe Gajre të Malësisë së Tetovës /Fot. 1/. Është veshje e përditshme e burrave të besimit fetar mysliman. Pjesët e veshjes janë: tirqit,¹ shoka, këmisha, xhamadani,² lurka,³ çorapët, opingat, plisi⁴ dhe shamia rreth plisit.

Në jetën e përditshme burrat veshin tirq e xhamadan prej zhguni të bardhë të zbukuruar me gajtanë të zinj /Fot. 2/. Shoka endet prej leshi, me ornamente katrore ose me vija. Ai mbahet drejt dhe nuk dredhet.

Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë. Ka mëngë të gjata, që mblidhen në kapakë. Kur vishet, ngrihet pak mbi brez e lëshohet mbi shokë.

Mbi këmishë e xhamadan burrat veshin lurkë të zezë. Kaçakët e këtyre trevave si dhe gjetkë veshin tirq, xhamadan e lurkë të zezë.

Burrat mbathin çorapë leshi me ngjyrë të zezë, me zbukurime shumëngjyreshe në formë të rombit të stilizuar, që i quajnë "me rrahtë"/Fot. 3/. Ata mbathin opinga lëkure me dredha leshi apo sixhimi. Burrat në kokë vënë plisin në formë të rrumbullakët, rreth të cilit e mbështjellin shaminë. Shamia është ngjyrë kafeje dhe ka pak zbukurime.⁵

Veshja kombëtare e burrave të rajonit të Tetovës është e ngjashme (me disa dallime lokale) me veshjen kombëtare të burrave të rajonit të Opojës në Kosovë.

¹ Nr. i inv. 1070.

² Nr. i inv. 1072.

³ Nr. i inv. 1071.

⁴ Nr. i inv. 1076.

⁵ SIQECA, Shpresë: **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 23-24.



Foto 1. Veshja kombëtare e burrave



Foto 2. Tirqit



Foto 3. Çorapët

Veshjet kombëtare të burrave të rajonit të Kumanovës

Veshjet kombëtare të burrave i përkasin tipit të veshjes më tirq. Pjesët e veshjes janë: tirqit,⁶ brekët,⁷ këmisha,⁸ shoka,⁹ xhamadani,¹⁰ lurka,¹¹ çorapët,¹² opingat,¹³ plisi, shamitë rreth plisit,¹⁴ ora e xhepit dhe çibuku.¹⁵

Tirqit janë të qepur prej zhguni me ngjyrë të zezë. Ata janë të zbukuruar me gajtanë të zinj. Brekët janë të qepura prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Ato janë të gjata e të gjera. Janë të thjeshta dhe pa zbukurime.

Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Ajo është e gjatë gjer përfundi brezit. Ka mëngë të gjata që mbarojnë me kapakë. Këmisha ka jakën e vogël në formë të një rripi të ngushtë dhe mbërthehet me një pullë të vogël.

Shoka është endur në vek prej lëshi me vija me ngjyrë të kuqe, të kuqe të mbyllët, të verdhë e të bardhë /Fot. 4/.

Mbi këmishë vishet xhamadani i cili qepet prej pëlhure ose cohe. Xhamadani qepet prej pëlhure me ngjyrë të zezë. Ai është i gjatë gjer në brez. Në pjesën e përparme mbërthehet me pulla të vegjël. Në kapakun e djathtë, xhamadani ka një xhep të vogël. Rreth jakës, në pjesën e përparme, në shpinë dhe rreth xhepit, xhamadani zbukurohet me gajtan me ngjyrë të kuqërremtë. Xhamadani prej cohe qepet te terzinjtë. Rreth jakës, në pjesën e përparme dhe në shpinë, xhamadani zbukurohet me gajtan të zi, me ornamente gjeometrike. Dy kapakët e tij mbërthehen me sumbulla.

Mbi xhamadan e mitan vishet lurka e qepur prej zhguni me ngjyrë të zezë. Është e gjatë gjer nën brez. Ka mëngë të shkurtra gjer në bërryla dhe kapolen. Ka pak zbukurime me gajtan të zi.

Çorapët thuren prej leshi me ngjyrë të zezë /Fot. 5/. Ato zbukurohen me ornamente gjeometrike me shumë ngjyra. Burrat

⁶ Nr. i inv. 1135.

⁷ Nr. i inv. 1141.

⁸ Nr. i inv. 1140.

⁹ Nr. i inv. 1138.

¹⁰ Nr. i inv. 1137.

¹¹ Nr. i inv. 1134.

¹² Nr. i inv. 1136.

¹³ Nr. i inv. 661.

¹⁴ Në Sektor ndodhen dy shami rreth plisit /nr. i inv. 1139/.

¹⁵ Nr. i inv. 1142.

mbathin opinga të punuara prej lëkure. Burrat në kokë vënë plis të rrumbullakët. Rreth plisit e mbështjellin shaminë prej pambuku, i cili është i zbukuruar me motive florale.

Prej aksesorëve të veshjes, burrat përdorin unaza, çibukë dhe orë xhepi të prodhimit industrial dhe të importuar nga jashtë.



Foto 4. Shoka




Foto 5. Çorapët

Veshjet kombëtare të meshkujve në Dibër - Maqedoni

Nga Dibra, në Sektorin Etnologjik të /"KMLSHP"/ ndodhen dy veshje kombëtare: 1. Veshja kombëtare e djemve dhe 2. Veshja kombëtare e burrave.

1. Veshja kombëtare e djemve

Veshja kombëtare e djemve është punuar në vitin 1980. Përbëhet prej këtyre pjesëve: tirqit,¹⁶ brekët, shoka, këmisha,¹⁷ xhamadani, çorapët dhe opingat.¹⁸

Veshja kombëtare e djemve të Dibrës është punuar prej lesi, pambuku dhe lëkure. Ajo është punuar me teknikën e endjes dhe të

¹⁶ Nr. i inv. 1073.

¹⁷ Në koleksionin e Sektorit ndodhen dy këmisha.

¹⁸ Në koleksionin e Sektorit ndodhen dy palë opinga.

qepjes. Dekorimet në veshje janë punuar me grep. Veshja është punuar në kuadër të artizanatit shtëpiak, nga terzinjtë dhe opingarët.

2. Veshja kombëtare e burrave

Veshja kombëtare e burrave është punuar në fillim të shekullit XX. Përbëhet prej këtyre pjesëve: tirqit, brekët, shoka, këmisha,¹⁹ xhamadani,²⁰ çorapët,²¹ opingat²² dhe plisi.²³

Tirqit janë të qepur prej zhguni të bardhë. Në vija të prerjeve, rreth shkekave e këmbëzave dhe në pjesën e përparme kanë zbukurime me gajtanë të zinj. Brekët janë të qepura prej pëlhure të bardhë. Shoka është prej leshi me vija për së gjati.

Këmisha është prej pëlhure të bardhë, me gjatësi gjer nën brez.

Mbi këmishë vishet xhamadani prej zhguni me ngjyrë të bardhë, i zbukuruar me gajtanë të zinj /Foto 6/. Burrat veshin edhe xhamadan prej cohe me ngjyrë të kuqe të mbyllët. Janë të qëndisur me fije ari.

Burrat mbathin çorapë të bardha leshi dhe opinga lëkure. Ata vënë në kokë plisin në formë të rrafshët²⁴ /Foto 7/.



Foto 6. Xhamadani




Foto 7. Plisi

¹⁹ Nr. i inv. 1196.

²⁰ Nr. i inv. 1074.

²¹ Nr. i inv. 105.

²² Nr. i inv. 1158.

²³ Nr. i inv. 1075.

²⁴ SIQECA, Shpresë: **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 24.

VESHJET KOMBËTARE TË FEMRAVE

Veshjet kombëtare të vajzave në Malësi të Tetovës

Veshjet kombëtare të vajzave përdoren në fshatrat Pirok të Rrëzës së Sharrit, Sellcë, Shipkovicë, Lisec e Bozovcë të Malësisë së Tetovës të anës së Sharrit dhe fshatrat e fushës së Pollogut. Ajo i takon tipit të veshjes me dimi. Pjesët e veshjes janë: dimitë, këmisha, përparësja, çorapët, opingat, shamia e kokës etj.

Vajzat veshin dimi “çintjane” me ngjyrë të kaltër të thellë. Dimitë kanë këmbëza të ngushta, punuar me grep. Këmisha endet prej pambuku me ngjyrë të bardhë. Është e gjatë gjer në brez. Mbi dimi vënë përparësen “skutaqen”, endur prej pëlhure pambuku. Përparësja përbëhet prej dy fletëve pëlhure. Trualli i përparëses zbukurohet me vija të gjera vertikale zakonisht me ngjyrë të bardhë e të kuqe. Bordurat janë gjithashtu të zbukuruara. Vajzat mbathin çorapë dhe opinga (opinga). Ato në kokë vënë shami të bardhë.²⁵

Veshjet kombëtare të grave nga rajoni i Kumanovës

Veshjet kombëtare të grave i takojnë tipit të veshjes me këmishë dhe një përparëse. Pjesët e veshjes janë: këmisha,²⁶ nënkëmisha, brekët,²⁷ përparësja,²⁸ shamia e përparëses,²⁹ xhamadani,³⁰ mitani,³¹ çorapët³² dhe shamia e kokës.³³

Gratë veshin këmishë të qepur prej pambuku me ngjyrë të bardhë, të endur në vek. Këmisha është e gjatë dhe ka mëngë të gjata e të gjera. Pjesa e përparme është e hapur në formë të germës T. Rreth jakës, kraharorit dhe mëngëve, qëndisen me gjilpërë ornamente me

²⁵ SIQECA, Shpresë /1998/: **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, “Libri shkollor”, Prishtinë, f.47.

²⁶ Në Sektor ndodhen dy këmisha /nr. inv. 1148 dhe 1146/.

²⁷ Nr. i inv. 1147.

²⁸ Përmasat: 80x60 cm. /nr. i inv. 1154/.

²⁹ Nr. i inv. 1153.

³⁰ Në Sektor ndodhen tre xhamadanë /nr. i inv. 1143, 1145 dhe 1144/.

³¹ Nr. i inv. 1152.

³² Nr. i inv. 1151.

³³ Në Sektor ndodhen dy shami koke /nr. i inv. 1149 dhe 1150/.

ngjyrë të kuqe.³⁴ Nën këmishë veshin nënkëmishën të qepur po ashtu prej pambuku me ngjyrë të bardhë, të endur në vek. Ajo është e thjeshtë dhe pa dekorime.

Gratë veshin brekë të qepura prej pambuku me ngjyrë të bardhë. Këmbëzat e brekëve qëndisen me motive florale, me penj me ngjyra të ndryshme.

Përparësja “mushallak-u” endet prej leshi me dy fletë pëlhure, me sfond me ngjyrë të kuqe. Zbukurohet me motive gjeometrike në formë të rombeve dhe rombeve të dhëmbëzuara, si në qilima /Foto 8, 9/. Përparësja lidhet me një rrip të gjerë të endur në vek, me vija me lloj-lloj ngjyra, me dominimin e ngjyrës së gjelbër të mbyllët. Mbi përparëse, në një skaj të saj, vëhet shamia e përparësës “mindili mbi mushallak“. Ajo është e punuar prej pëlhure të fabrikuar. Qëndiset me penj me fije ari.

Mbi këmishë vishet xhamadani dhe mitani. Xhamadani qepet prej materialeve të ndryshme. Në koleksionin e Sektorit Etnologjik ndodhen tre xhamadanë të qepur prej pëlhure, kadifesë dhe zhgunit. Xhamadani prej pëlhure është i shkurtër dhe i hapur në pjesën e përparme. Rreth jakës, hapjes së kraharorit, në fund të kapakëve e të shpinës, rrethohet me një dantellë të punuar me grep, me penj me ngjyrë të zezë. Xhamadi prej kadifesë është i zbukuruar në tërë truallin me gajtan të zi me motive spiraloide. Xhamadani prej zhguni është me ngjyrë të bardhë /Foto 10/. Ai është i gjatë gjer përfundi brezit. Ornamentet janë kryesisht me ngjyrë të kuqe. Ato kanë motive gjeometrike /në formë të rrumbullakët, të trekëndëshit etj./ Mitani qepet prej kadifesë me ngjyrë të zezë. Ai është i shkurtër gjer përfundi kraharorit. Mëngët i ka të gjata e të ngushta. Rreth hapjes së kraharorit, në fund të kapakëve e të shpinës dhe në fund të mëngëve, mitani rrethohet me një gajtan të verdhë.

Gratë mbathin çorapë të thurura prej leshi me ngjyrë të bardhë. Ato qëndisen në pjesën e përparme me motive gjeometrike. Gratë mbathin opinga të mbaruara prej lëkure. Ato në kokë vënë shami me thekë.

Në fshatrat malore të Kumanovës më shumë përdoret veshja e grave e tipit me këmishë dhe një përparëse, ndërsa në fshatrat më afër Kumanovës përdoret veshja e tipit me dimi.

³⁴ SIQECA, Shpresë: **Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 35.



Foto 8



Foto 9. Përparësja



Foto 10. Xhamadani

Veshjet kombëtare të femrave të rajonit të Kërçovës

Hulumtimet për veshjet kombëtare të femrave të rajonit të Kërçovës janë bërë në fshatin Zajaz. Veshjet i takojnë tipit të veshjes me këmishë dhe një përparëse dhe janë punuar në fillim të shekullit XX. Nga ky rajon, në Sektorin Etnologjik të /"KMLSHP"/ ndodhen dy veshje kombëtare: 1. Veshja kombëtare e nuseve dhe 2. Veshja kombëtare e grave.

1. Veshja kombëtare e nuseve

Veshja kombëtare e nuseve përbëhet prej këtyre pjesëve: këmisha, brekët, përparësja, brezi, shamia e brezit,³⁵ pafta e brezit,³⁶ xhamadani³⁷, mitani,³⁸ dollama,³⁹ çorapët,⁴⁰ tepellëku,⁴¹ zbukurimi i kokës⁴² dhe velloja.

Këmisha qepet prej pëlhere mëndafshi të endur në vek. Ajo është e gjatë gjer në fund të këmbëve. Mëngët i ka të gjata e të gjera. Këmishës i shtohet jaka dhe gryka të qëndisura me rruaza me ngjyrë të bardhë e ngjyra të tjera. Ornamentet janë në formë të rombeve të vogla etj. Nuset veshin brekë të bardha të qepura prej pambuku.

Brekët kanë këmbëza "nogajca" të endura prej leshi dhe të zbukuruara me motive të imëta florale e gjeometrike. Përfundi këmishës shihen vetëm këmbëzat e brekëve.

Nuset veshin përparësen "peshterka" të endur prej leshi me dy fletë pëlhere /Foto 11/. Përparësja është me ngjyrë të kuqe dhe me pala. Rreth brezit ajo lidhet me rripin e përparësës "dizgën" të endur në vek me penj leshi, pambuku e teli shumëngjyrësh, të zbukuruar me motive gjeometrike.

Brezi endet në vek me dy liq. Ai është mjaft i gjerë. Një pjesë është i zi, ndërsa pjesa tjetër i bardhë, me zbukurime shumëngjyrëshe në formë të rombeve e luleve të imëta.⁴³ Shamia e brezit punohet prej

³⁵ Nr. i inv. 1128.

³⁶ Nr. i inv. 1129.

³⁷ Nr. i inv. 1125.

³⁸ Nr. i inv. 1126 dhe 1122.

³⁹ Nr. i inv. 1127.

⁴⁰ Nr. i inv. 1059.

⁴¹ Nr. i inv. 1131.

⁴² Nr. i inv. 1130 dhe 1132.

⁴³ SIQECA, Shpresë /1998/: vep. e cit., f. 36.

materiali të fabrikuar. Ai zbukurohet me rruaza, me motive florale. Pafta e brezit punohet prej bakri, me teknikën e derdhjes. Ajo është e përbërë prej dy pjesëve në formë të rumbullakët dhe prej kapëses në formë rombi. Zbukurohet me motive florale, të radhitura simetrikisht brenda rrrathëve me madhësi të ndryshme.⁴⁴

Mbi këmishë vishet xhamadani, mitani dhe dollama. Xhamadani është i qepur te terzinjtë. Në kapakë dhe shpinë zbukurohet me monedha.⁴⁵ Mitani qepet prej pëlhere të shamit.⁴⁶ Rreth hapjes dhe mëngëve zbukurohet me gajtanë. Nuset veshin dollamë të qepur prej cohe të kuqe dhe të zbukuruar me fije ari.⁴⁷

Nuset mbathin çorapë të thurura prej leshi me ngjyra të ndryshme.⁴⁸ /Foto 12/. Çorapët kanë ornamente të pasura në formë rombesh, katrorësh e lulesh të punuara kryesisht me ngjyrë të verdhë e ngjyra të tjera.

Zbukurimi i kokës “tepellëku” është në formë të rumbullakët /Foto 13/. Ai është i punuar prej metali me teknikën e derdhjes. Është i zbukuruar me ornamente florale. Në pjesën e përparme i varen disa monedha me madhësi të ndryshme dhe disa zinxhirë të shkurtër me varëse të vogla, të rumbullakëta.⁴⁹ Nuset në kokë vënë edhe zbukurimet “kollbashin” dhe një copë pëlhere të shamit “llatica“, mbi të cilën janë të qepura monedhat. Mbi të vënë vellon e kuqe.⁵⁰



Foto 11. Përparësja



Foto 12. Çorapët



Foto 13. Tepellëku

⁴⁴ SIQECA, Shpresë /2006/: **Koleksioni i armëve dhe i stolive në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, “Studime”, nr. 12, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, f. 200.

⁴⁵ SIQECA, Shpresë, **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 36.

⁴⁶ Në koleksionin e Sektorit ndodhen dy mitanë.

⁴⁷ SIQECA, Shpresë, vep. e cit., f. 36.

⁴⁸ Në koleksionin e Sektorit ndodhen tri palë çorapë.

⁴⁹ SIQECA, Shpresë: **Koleksioni i armëve dhe i stolive në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 200.

⁵⁰ SIQECA, Shpresë: **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, f. 36.

2. Veshja kombëtare e grave

Veshja kombëtare e grave përbëhet prej këtyre pjesëve: këmishës,⁵¹ brekëve,⁵² përparëses,⁵³ rripit të përparëses,⁵⁴ brezit,⁵⁵ shamisë së brezit, xhamadani,⁵⁶ hërkës,⁵⁷ çorapëve,⁵⁸ shamisë së kokës⁵⁹ etj.

Këmisha qepet prej pëlhere pambuku të endur në vek. Përparësja është e endur në vek dhe lidhet me një rrip të zbukuruar.

Mbi këmishë vishet xhamadani dhe hërka. Xhamadani qepet prej cohe me ngjyrë të kuqe.⁶⁰ Në kapakë ka sumbulla të bardha e të zeza. Në tërë truallin, xhamadani qëndiset me gajtanë shumëngjyrësh. Zbukurimet kanë ornamente florale, kozmike dhe gjeometrike - në formë të rrumbullakët e të trekëndëshit. Xhamadane të tjera qëndisen me fije argjendi.

Mbi këmishë vishet hërka “hyrka” e qepur te terzinjtë. Ajo qepet prej kadifesë me ngjyrë vishnje të mbyllët. Zbukurohet me gajtanë, me motive gjeometrike dhe florale. Gratë e moshuara veshin hërka me ngjyra të mbyllura dhe me më pak ornamente. Ato mbathin çorapë, meste dhe opinga.

Edhe sot e kësaj dite fshati Zajaz është një prej fshatrave më të njohura shqiptare në trevën e Maqedonisë për punimin e veshjeve kombëtare dhe të artizanateve.

Bibliografi

- [1] Siqeca Sh, **Veshje kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, “Libri shkollor”, Prishtinë, 1998.
- [2] Siqeca Sh, **Koleksioni i armëve dhe i stolive në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, “Studime”, nr. 12, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2006.

⁵¹ Nr. i inv. 1066.

⁵² Nr. i inv. 1062.

⁵³ Nr. i inv. 1063.

⁵⁴ Nr. i inv. 1065.

⁵⁵ Nr. i inv. 1064.

⁵⁶ Nr. i inv. 1067.

⁵⁷ Nr. i inv. 1060.

⁵⁸ Nr. i inv. 1061.

⁵⁹ Nr. i inv. 1068.

⁶⁰ Nr. i inv. 1067.

Shpresë Siqeca

**ALBANIAN NATIONAL COSTUME FROM MACEDONIA AT THE END
OF THE XIX AND BEGINNING OF THE XX CENTURY**

Summary

The paper “Albanian national costume from Macedonia at the end of the XIX and beginning of the XX century” deals with some of Albanian male and female national costume from Macedonia at the end of the XIX and the beginning of the XX century”.

Men’s national costume are of “tirq” /woolen tight trousers/ type, whereas the women’s of costume will long shirt and one apron and the costume with buggy trousers “dimi”.

The Albanian national costumes and jewelry from Macedonia are made of wool, cotton, fabrics, leather and cooper. They are made by melting, weaving, sewing, knitting, embroidery and needlework techniques with floral, geometrical and astral motives.

The costumes and jewelry are homemade work or are made by tailors, silversmiths, woolen cap /plis/ makers, shoe /opinga/ makers, handkerchief makers etc. Some of the exemplars are industrial work brought from abroad.

Ibrahim Ramadani, Prishtinë

ELEMENTET DHE MEKANIZMAT KONTROLLUES URBANISTIK NË PROCESIN E HARTIMIT TË PLANEVE HAPËSINORE

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi konsiston në gjetjen e mënyrës së qasjes dhe aplikimit të disa elementeve dhe veçorive themelore të planifikimit me rastin e hartimit të planit zhvillimor urban, duke e konsideruar atë si një proces zhvillimor që realizohet në disa faza, sikurse analiza e gjendjes ekzistuese, vizioni dhe dispozitat për zbatim, si dhe zbatimi i tij për periudhën e caktuar. Mirëpo ajo më qenësore në këtë proces është ofrimi i programit zhvillimor, i cili paraqet bazën e hartimit të planit zhvillimor të qytetit. Në bazë të programit zhvillimor përcaktohen funksionet e ardhshme të qytetit, rritja e tij në fund të periudhës së paraparë projektuese dhe plotësimi me elemente të reja materiale të qytetit. Të gjitha këto parashikime në planin zhvillimor urban duhet të realizohen në periudhën e paraparë. Për këtë arsye është e nevojshme që programi të mbështetet në testime paraprake, analiza dhe në buxhet. Kështu pra, në bazë të kësaj, hartimi i programit zhvillimor për PZHU mund të konsiderohet si etapa e parë e projektimit urbanistik. Meqenëse programi zhvillimor bazohet në njohuri të thella rreth jetesës dhe nevojave të qytetarëve dhe të qytetit, atëherë te projektuesi krijohet koncepti bazë shoqëror-ekonomik dhe kulturor për qytetin e ardhshëm.

Fjalët kyçe: Plan, program, funksion, shfrytëzim i tokës, koeficient i ndërtimit.

Hyrje

Plani zhvillimor urban (PZHU) mbështetet në tre komponentë kryesorë të planifikimit: organizimin themelor hapësinor, mbrojtjen e natyrës dhe vlerat kulturore historike të territorit të caktuar. Kjo, në radhë të parë, nënkupton vlerësimin e territorit dhe mënyrën e përdorimit të tokës në kuadër të vendbanimit, duke filluar nga kryeqendra e vendit e deri te vendbanimi më i vogël me karakteristika funksionale.

PZHU-në si dokument e harton zyra projektuese e regjistruar për hartimin e planeve hapësinore, ndërsa këtë dokument e miraton kuvendi komunal për një periudhë prej së paku 5 vjet dhe më së shumti 20 vjet.

Dokumenti përbëhet nga pjesa grafike e cila është nxjerrë nga harta themelore e shtetit me shkallë prej 1:5.000 ose 1:10.000, ndërsa sot përdoren ortofotot më të reja në bazë të të cilave bëhet digjitalizimi i objekteve dhe të gjitha hapësirave të nevojshme për vlerësim, si dhe pjesa tekstuale që përmban hyrjen, objektivat e planit dhe dispozitat për zbatim.¹

Programi, elementet dhe mekanizmat kontrollues

Që në fillim u cek se ajo më qenësore në këtë proces është ofrimi i programit zhvillimor të qytetit, i cili paraqet bazën e hartimit të planit zhvillimor urban. Programi lidhur me planin zhvillimor urban duhet të përmbajë këto elemente:²

- Analizën e kushteve natyrore dhe konkluzat për përshtatshmërinë e terrenit për pjesët e banuara nga pikëpamja higjienike dhe teknike;

- Llogaritjen e numrit të popullsisë që parashihet në fund të periudhës së planifikuar, me analizën e strukturës së saj;

- Tablon (pasqyrën) e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të qytetit, veçanërisht vëllimin e industrisë së re, lidhjet e ardhshme me trafikun e jashtëm;

- Analizën e gjendjes ekzistuese të qytetit, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mundësitë e shfrytëzimit të mëtejme të tij dhe nevojat për rikonstruktim;

- Vëllimin e ndërtesave të banimit dhe të atyre shoqërore me funksione të veçanta dhe me karakter të përgjithshëm;

- Objektet dhe hapësirat për shërbime komunale të qytetit, me përshkrim të kapaciteteve dhe kushtet e pozicionimit të tyre, si: depot, frigoriferët, siloset, thertoret, bukëpjekësit, autolarjet, zjarrfikësit, garazhet e mëdha dhe vendparkimet për transport publik;

¹ B. Piha, *Prostorno planiranje*, Beograd, 1980, f. 32. Krahaso; D. Tošković, *Uvod u prostorno i urbanističko planiranje*, Zagreb, 2006, f. 44.

² A. Marinović-Uzelac, *Prostorno planiranje*, Zagreb, 2001, f. 55.

- Komplekset me funksione të veçanta të cilat kërkojnë kushte të posaçme të vendosjes në qytet ose jashtë tij (ente shëndetësore, shkencore, të ekspoziturës, shkollore, të gjimnastikës etj;

- Rikonstruktimin e rrugëve, zgjerimin dhe hapjen e rrugëve të reja;

- Hapësirat për pushim, rekreacion, sport dhe argëtim brenda dhe jashtë qytetit, duke përfshi rikonstruktimin e hapësirave të gjelbra.

Plani zhvillimor urban përbëhet nga pjesa e përgjithshme, vizioni urbanistik dhe nga shumë skema grafike plotësuese të cilat shpjegojnë ecurinë e zgjidhjes së problemeve.

Plani zhvillimor urban hartohet, varësisht nga madhësia e territorit të qytetit, në planin gjeodezik me përmasa 1:10.000 deri 1:2.500. Plani zhvillimor urban përmban të gjitha elementet kryesore aktuale dhe ato të cilat do të realizohen gjatë periudhës së projektimit. Përmes planit zhvillimor paraqiten këto elemente themelore:

- Sipërfaqet e parashikuara për industrinë, e cila konsiderohet si zonë e veçantë, jashtë vendbanimit, me simbolin e llojit të prodhimit, me lidhjet e saj me vijën hekurudhore dhe me rrjetin rrugor, sidomos me autostradën jashtë qytetit;

- Sipërfaqet e projektuara për komunikacion hekurudhor, pozicionet e stacioneve të pasagjerëve, stacionet e ngarkesave, stacionet teknike etj;

- Sipërfaqet e projektuara dhe objektet e transportit ujor, vijat e rregulluara ujore si porte të baseneve, depot dhe vijat hekurudhore që i shërbejnë portit etj;

- Sipërfaqet e specifikuara për depo dhe ndërmarrje komunale, të materialit ndërtimor, parku i automjeteve të higjienoteknikës, depot me frigoriferë, thertoret, ngrohtorja e qytetit etj.;

- Sipërfaqet ekzistuese dhe ato të planifikuara për vendosjen e stabilimenteve komunale: të ujësjellësit të qytetit me zonën e burimit, rezervuarët, kanalizimi i qytetit me impiantet e pastrimit, stacionet e pompimit, centrali energjetik etj.;

- Zonat e banimit të ndara në rajone banimi dhe bashkësi ose komunitete banimi, me qendrat e tyre shoqërore, me shenjën e stilit të ndërtimit dhe dendësinë e banimit, ashtu që nga plani mund të shihet qartë struktura e ardhshme ndërtimore e pjesëve të qytetit dhe numri i parashikuar i banorëve;

- Qendrat shoqërore - të komunitetit me pozitën e objekteve shoqërore dhe shenjën e funksioneve të tyre. Veçanërisht duhet shënjuar sipërfaqet e parapara për objekte shëndetësore, kopshtet e fëmijëve dhe objektet shkollore;

- Sipërfaqet e gjelbra ekzistuese dhe të planifikuara, të cilat kategorizohen në malore, parqet, pikniqet pranëqytetëse me rrugë të rregulluara drejt tyre, parqet e qytetit, shëtitoret, komplekset sportive, zonat e gjelbra mbrojtëse nga era, industria, autostradat, gjelbërimi mbrojtës nga erozioni etj.;

- Rrjeti i rrugëve kryesore të qytetit, me ura të projektuara, viadukte dhe nyje komunikative në dy nivele, me kyçjet në autostradë dhe ndërlidhjet e tyre;

- Rrjeti i linjave urbane dhe pranëqytetëse të trafikut - ekzistuese dhe të planifikuara (tramvajet, autobusët, trolejbusët);

- Plani i organizimit të zonës pranëqytetëse dhe

- Hapësira e rezervuar për zgjerim të qytetit pas periudhës së projektuar.




Figura 1. Plani i shfrytëzimit të tokës
Burimi: Plani zhvillimor urban - Podujevë, 2011

Skemat plotësuese lidhur me sqarimin e propozimeve të ndryshme të planit mund të jenë:

- rrjeti i ujësjellësit me stabilimente;
- rrjeti i kanalizimit me stabilimente;
- rrjeti elektrik, ngrohoret dhe rrjeti i gypave dhe i stabilimenteve ngrohëse të qytetit;
- rrjeti i objekteve shoqërore, çerdhet, shkollat, objektet shëndetësore dhe sociale me zonat e tyre gravituese.

Me rastin e hartimit të planeve zhvillimore urbane rëndësi të veçantë kanë mekanizmat kontrollues si: llogaritja e dendësisë së popullsisë, llogaritja e numrit të popullsisë në fund të periudhës së projektuar, mënyra e shfrytëzimit të tokës, koeficienti i ndërtimit etj.³

Për hartimin e planit zhvillimor urban nevojitet llogaritja e numrit të banorëve në fund të periudhës së planifikuar. Periudha kohore e kësaj llogaritjeje mund të jetë 20 vjet. Planet urbane mund të hartohen për periudha edhe më të shkurta, mirëpo për disa probleme të sigurta urbanistike kërkohen zgjidhje të cilat mundësojnë zhvillim afatgjatë të qytetit; ujësjellësi me stabilimentet përcjellëse, kanalizimi, rrjeti rrugor etj.

Numri i popullsisë vërtetohet përmes llogaritjes së të dhënave për periudhën e planifikuar. Kuptohet se numri i llogaritur i popullsisë ka vlera të përafërta, sepse gjatë këtyre dy dekadave paraqiten ndryshime të cilat vështirë parashikohen me saktësi.

Llogaritja bëhet sipas këtij barazimi:

$$N = \frac{K \times 100}{P}$$

N- numri i parashikuar i popullsisë;

K- numri i kuadrove të punësuar në industri, në trafik dhe në të gjitha entet me karakter ndërrurban: entet administrative dhe

³ American Planning Association, *Planning and Urban Design Standards*, New Jersey, 2007. Krahaso; M. Čuković, *Gradski Centri*, Sarajevo, 1985. A. Marinović-Uzelac, *Prostorno planiranje*, Zagreb, 2001, f. 83.

ekonomike, shkollat e larta, universitetet, spitalet etj. Numri i kuadrove merret në bazë të vëllimit të ndërmarrjeve dhe enteve të planifikuara;

P- Sasia e këtyre kuadrove shprehet në përqindje nga numri i përgjithshëm i popullsisë;

Në bazë të standardeve urbanistike, madhësia *P* është;⁴

Për qytete të vogla 35%,

Për qytete të mesme 32-33% dhe

Për qytete të mëdha 30%.

Pjesa tjetër e popullsisë përbëhet nga të punësuarit në ndërmarrje dhe ente ose institucione të karakterit lokal (rreth 20% në qytetet e vogla dhe 25% në qytetet e mëdha) dhe nga popullsia e papunësuar, fëmijët, nxënësit, amviset, të moshuarit (rreth 45-50%).

Për qytetin me madhësi të mesme, p.sh. për numrin e dhënë të kuadrove të ardhshme $K= 19.000$ fitohet numri i ardhshëm i popullsisë së përgjithshme:

$$N = \frac{19.000 \times 100}{32} = 60.000$$

Për ato vendbanime ku nuk mund të përcaktohet madhësia e ardhshme e grupeve themelore të punës, atëherë përdoret metoda statistike e llogaritjes së numrit të popullsisë. Kjo llogaritje bazohet në supozimin se popullsia urbane ka shtimin natyror si në periudhën e mëparshme. Numri i ardhshëm i popullsisë llogaritet në këtë mënyrë: shtimi vjetor i shprehur në % gjatë dekadës së fundit, numri aktual i popullsisë dhe periudha e paraparë në projekt:

$$N_n = N_o \left(1 + \frac{P}{100} \right)^n$$

⁴ D. Prinz, *URBANIZAM 1 - Urbanističko planiranje*, Zagreb, 2006, f. 56.

N_n = Numri i llogaritur i popullsisë përgjatë n viteve,

N_o = Numri aktual i popullsisë,

P = norma e më hershme e rritjes vjetore të popullsisë dhe

n = numri i viteve të periudhës së planifikuar.

Një llogaritje e tillë e numrit të popullsisë për periudhën e planifikuar mund të bëhet edhe për territorin e komunës dhe të shtetit. Si shembull në këtë rast është marrë komuna e Kaçanikut, ku është bërë llogaritja e numrit të popullsisë për periudhën kohore 2009-2020. Mbështetur në elementet bazë të zhvillimit demografik, janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit të numrit të popullsisë në Komunën e Kaçanikut. Gjatë vlerësimit të numrit të popullsisë për komunën dhe qytetin e Kaçanikut deri në vitin 2020 janë llogaritur dy komponentët themelorë, që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike, siç janë: shtimi natyror dhe migrimi:

$$P_a = P_o \times \left[(S_n + S_m) \times V/100 \right] + 1;$$

P_a = parashikimi i popullsisë për vitin 2020;

P_o = vlerësimi i popullsisë për vitin 2009;

S_n = shkalla vjetore e shtimit natyror;

S_m = shtimi vjetorë nga migrimi;

V = vitet e llogaritura deri në vitin 2020.

Parashikimi i numrit të popullsisë për qytetin e Kaçanikut për vitin 2020:⁵

$$P_a = P_o \times \left[(S_n + S_m) \times V/100 \right] + 1;$$

$$P_a = 13.450 \times \left[(1.7 + 0.45) \times 12/100 \right] + 1 =$$

$$= 13.450 \times 1.25 = 16.812.$$

Sipas këtyre llogaritjeve del se në vitin 2020 numri i popullsisë për qytetin e Kaçanikut do të jetë 16.812 banorë.

Ndërsa parashikimi i numrit të popullsisë për komunën e Kaçanikut pa qytetin në vitin 2020 duket kështu:

⁵ Plani zhvillimor urban i Kaçanikut, Kaçanik, 2010.

$$P_a = P_o \times \ddot{s} (S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

$$P_a = 24.724 \times \ddot{s} (1.7 - 0.35) \times 12/100] + 1 =$$

$$= 24.724 \times 1.162 = 28.729.$$

Sipas këtyre llogaritjeve, Komuna e Kaçanikut në vitin 2020 do t'i ketë gjithsej 45.541 banorë, nga e cila 28.729 banorë do të jetojnë në vendbanimet rurale, ndërsa rreth 16.800 banorë (37%) do të jetojnë në qytetin e Kaçanikut, që është vetëm 2% më shumë se para 10 vitesh.

Sipërfaqja e territorit të populluar caktohet në bazë të llogaritjeve të përafërta që në fazën e parë, ose me rastin e hartimit të planit ideor urbanistik, ndërsa madhësia definitive dhe forma e territorit të populluar do të përcaktohet në fazat e mëtejme të planit të përgjithshëm të qytetit.

Sipërfaqja e territorit të populluar fitohet në bazë të numrit të parashikuar të popullsisë dhe nga dendësia mesatare e popullsisë që parashihet për territorin e populluar në vijim, e që njihet si dendësia bruto e banimit.

Madhësia e dendësisë bruto shprehet me numrin e banorëve në 1 hektar të territorit të populluar të qytetit. Kjo dendësi varet nga madhësia dhe karakteri i qytetit, nga struktura e trashëguar e cila do të ruhet sipas planit, nga kushtet natyrore që ndikojnë në mënyrën e ndërtimit, nga numri i ndërtesave shoqërore dhe komerciale që janë të parapara me plan etj.

Dendësia bruto rritet krahas madhësisë së qytetit. Kështu pra është e njohur se për qytetet e vogla dendësia bruto e banimit arrin 100-120 banorë/ha, për qytetet e mesme 120-140 banorë/ha, kurse për qytetet e mëdha 140-150 banorë/ha.

Nëse kushtet natyrore ose karakteri i vendbanimit kërkojnë sipërfaqe më të mëdha të gjelbërimit, ndërtesa më të ulëta banimi, komplekse të mëdha shëndetësor si në rastin e banjave, atëherë propozohet dendësi më e vogël e banimit që mund të sillt rreth 50-60 banorë/ha. Këto masa mund të shërbejnë vetëm si orientim i përafërt me rastin e llogaritjes së sipërfaqes së nevojshme për popullim. Vlerat reale të dendësisë së banimit fitohen vetëm mbi bazën e projektimit përfundimtar, me aprovimin e tipit të caktuar të ndërtesave të banimit, normën e hapësirës së banimit për një banorë, por në këtë rast duhet pasur kujdes edhe në madhësinë e familjeve që dallojnë për nga numri i anëtarëve.

Dendësia që ka të bëjë me zonat e banuara ose lagjet e qytetit quhet dendësi neto. Për llogaritjen e dendësisë neto merren zonat e komplekseve banesore, së bashku me sipërfaqet e karakterit shoqëror dhe rrjetin e brendshëm të trafikut në kuadër të zonës së banimit.

Vlera (madhësia) e dendësisë neto në radhë të parë varet nga lartësia ose numri i kateve të ndërtesave dhe nga dendësia dhe mënyra e ndërtimit. Me rritjen e numrit të kateve rritet edhe distanca ndërmjet ndërtesave për shkak të ndriçimit, por megjithatë rritet edhe dendësia neto. Kështu, p.sh., dendësia neto për kompleksin e ndërtesave familjare përdhese, në parcelat prej 400 m², me mesataren prej 5 banorë për një njësi ndërtimore do të ofrojë këtë rezultat:

$$D_n = 25 \times 5/1.0 = 125 \text{ ban/ha.}$$

Në kompleksin e njëjtë, me rastin e ngritjes së ndërtesave shumëkatëshe me gjatësi prej 50 m, në distancë prej 20 metra ndërmjet tyre, që është distancë e mjaftueshme për ndriçim, mund të fitohet sipërfaqja e përgjithshme e kateve prej 7.000 m². Nëse për kokë banori aprovohet norma mesatare e sipërfaqes bruto të kateve prej 20 m², atëherë rezultati do të jetë:

$D_n = \frac{7000}{20} = 350 \text{ ban/ha}$
--

Dendësia neto nuk varet vetëm nga faktorët e lartpërmendur, por edhe nga mënyra e grupimit të ndërtesave, rrjetit të objekteve arsimore si: kopshtet e fëmijëve, shkollat dhe objektet shoqërore, nga madhësia e sipërfaqeve të gjelbra dhe rrjeti i rrugëve.

Në planet hapësinore shfrytëzimi i hapësirës paraqitet me numra për dendësinë e banimit dhe dendësinë e popullsisë. Kështu që:⁶

D_{bsn} (neto)= tregon raportin e numrit të banorëve dhe numrit të sipërfaqes së ndërtuar për banim,

D_{bsnb} (gjithsej neto)= tregon raportin e numrit të banorëve me sipërfaqen e ndërtuar për banim dhe funksionet përcjellëse (si rrugët parkingjet, sipërfaqet e gjelbra dhe këndet për lojëra fëmijësh),

⁶ D. Prinz, *URBANIZAM 1 - Urbanističko planiranje*, Zagreb, 2006, f. 83.

Dbsnp (bruto) = tregon raportin ndërmjet numrit të banorëve dhe sipërfaqet e ndërtuara me banesa dhe funksionet e gjera si: të gjitha rrugët, parqet, shkollat fillore, sipërfaqet për rekreacion,

Dbsppl= tregon raportin e numrit të banorëve me sipërfaqen e përgjithshme të planit hapësinor.

Treguesi i dendësisë së banimit e përcakton numrin e kateve, kurse përmes kësaj bëhet tipizimi i mundshëm i ndërtimit banesor:⁷

- 100-200 banorë/ha është parametër për objekte përdhese dhe ndërtim të ulët 2-3 kate;

- 300-350 banorë/ ha është parametër për ndërtim deri në 5 kate.

Si orientim i përafërt për fazën e parë të projektimit mund të merren këto pjesë funksionale të territorit të populluar në përqindje:⁸

- komplekse banimi----- 40-50%

- ndërtesa shoqërore----- 15-20%

- hapësira të gjelbra----- 15-25%

- rrjeti i rrugëve, stacionet, sheshet----- 15-20%.

Në planifikimin hapësinor, mënyra e shfrytëzimit dhe e rregullimit të hapësirës paraqiten me tregues numerik si:

1. Koeficienti i ndërtimit (Knd)
2. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (Ksh)
3. Dendësia e ndërtimit (Dnd).

Koeficienti i ndërtimit paraqitet në këtë mënyrë:⁹

⁷ D. Prinz, *URBANIZAM 2 - Urbanističko planiranje*, Zagreb, 2008, f. 56.

⁸ American Planning Association, *Planning and Urban Design Standards*, New Jersey, 2007, f. 85.

⁹ D. Prinz, *URBANIZAM 1 - Urbanističko planiranje*, Zagreb, 2006, f. 98.




Figura 2. Parametrat e zonimit

Koeficienti i ndërtimit është raporti i sipërfaqes së përgjithshme bruto të ndërtuar i të gjitha objekteve (banesore e publike) dhe sipërfaqes së përgjithshme të kompleksit të qytetit.

Krahas kësaj mund të llogaritet koeficienti i ndërtimit vetëm për objektet e banimit ose objektet publike, bruto (sipërfaqen e përgjithshme të vendbanimit) ose neto (sipërfaqen e banimit ose të punës).

$$K_{nu} = \frac{B_{sn}}{S_p}$$

K_{nu} = koeficienti i ndërtimit të qytetit,

B_{sn} = Bruto sipërfaqja e ndërtuar (banesa, objekte publike, ekonomike),

S_p = Sipërfaqja e përgjithshme e kompleksit të qytetit.

P. sh. në qytezën e Shtimes, në bazë të digjitalizimit të të gjitha objekteve të ndërtuara, del se sipërfaqja e përgjithshme e objekteve ishte 28 ha, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e qytetit ishte 177 ha. Nga kjo u fitua koeficienti i ndërtimit, që është 0.158

$$Kq = \frac{28}{177} = 0.158$$

Kështu mund të llogaritet edhe përqindja e sipërfaqes së ndërtuar (banesat dhe të gjitha objektet përcjellëse) në raport me sipërfaqen e përgjithshme të qytetit, si në vijim:

$$Pn = \frac{Sn}{Sq} \times 100$$

Pn = përqindja e sipërfaqe së ndërtuar,

Sn = sipërfaqja me ndërtesa në ha,

Sq = sipërfaqja e kompleksit të qytetit në ha.




Figura 3. Parametrat e shfrytëzimit dhe ndërtimit të tokës

Koeficienti i shfrytëzimit të tokës është vlerë reciproke e koeficientit të ndërtimit dhe tregon sa sipërfaqe neto të tokës nevojitet për $1m^2$ të sipërfaqes bruto të ndërtuar:

$$\text{Ksh} = \frac{1 \text{ Sku}}{\text{Knu Sbn}}$$

Ksh= Koficienti i shfrytëzimit të tokës,

Knu= Koficienti i ndërtimit të kompleksit të qytetit,

Sku= Sipërfaqja e kompleksit të qytetit,

Sbn= Sipërfaqja bruto e ndërtuar (objekte banimi, publike dhe infrastrukturë përcjellëse).

Shembull: qyteza e Shtimes:

$$\text{Ksh} = \frac{1 \ 177}{0.158 \ 28} = 6.3$$

Në bazë të kësaj mund të konstatohet se koficienti i shfrytëzimit të tokës në qytezën e Shtimes ka një shkallë të ulët, çka tregon se zhvillimet e ardhshme mundësojnë rritjen e intensitetit në këtë proces.

Literatura

- [1] Ćuković M; *Gradski Centri*, “Svjetlost”, Sarajevo, 1985.
- [2] Marinović A.- Uzelac; *Prostorno planiranje*, “Dom i Svijet”, Zagreb, 2001.
- [3] Perišić D; *O prostornom planiranju*, IAUS, Beograd, 1985.
- [4] Piha B; *Prostorno planiranje*, SA, Beograd, 1980.
- [5] Plani zhvillimor urban i Kaçanikut, Kaçanik, 2010.
- [6] Plani zhvillimor urban i Shtimes, Shtime, 2009.
- [7] Prinz D; *URBANIZAM 1. - Urbanističko planiranje*, “Tehnička knjiga”, Zagreb, 2006.
- [8] Prinz D; *URBANIZAM 2. - Urbanističko oblikovanje*, “Tehnička knjiga”, Zagreb, 2008.
- [9] Ramadani I; *Vendbanimet e Kosovës*, “Libri shkollor”, Prishtinë, 2016.
- [10] Steiner F. & Butler K; *Planning and Urban Design Standards*, John Wiley & Sons, INC, New Jersey, 2007.
- [11] Tošković D; *Uvod u prostorno i urbanističko planiranje*, “Tehnička knjiga”, Zagreb, 2006.

Përfundim

Nga analiza e procesit të hartimit të PZHU-së u vërtetua se plani zhvillimor urban përfshin organizimin themelor hapësinor, mbrojtjen e natyrës dhe vlerat kulturore historike të territorit apo vendbanimit të caktuar. Kjo, në radhë të parë, nënkupton vlerësimin e territorit dhe mënyrën e përdorimit të tokës në kuadër të vendbanimit, duke filluar nga kryeqendra e vendit, e deri te vendbanimi më i vogël me karakteristika funksionale. Objektivi i këtij punimi ishte njohja e disa veçorive themelore të planit zhvillimor urban, mënyra e hartimit, duke e konsideruar atë si një proces që zhvillohet në disa faza, sikurse analiza e gjendjes ekzistuese, vizioni dhe dispozitat për zbatim, si dhe implementimi i tij brenda periudhës së caktuar kohore. Gjithashtu u konstatua se ajo më qenësore në këtë proces ishte ofrimi i programit zhvillimor të qytetit i cili paraqet bazën e hartimit të planit zhvillimor urban. Në bazë të këtij programi përcaktohen funksionet e ardhshme të qytetit, rritja e tij në fund të periudhës së paraparë projektuese dhe plotësimi me elementet e reja materiale të qytetit. Të gjitha këto parashikime në planin zhvillimor urban duhet të realizohen në periudhën e paraparë kohore. Për këtë arsye është e nevojshme që programi të mbështetet në testime paraprake dhe në analizë të mirëfilltë të gjendjes ekzistuese. Kështu pra, hartimi i programit për PZHU mund të konsiderohet si etapa e parë e projektimit urbanistik. Meqenëse programi zhvillimor bazohet në njohuri të thella rreth mënyrës së jetesës dhe nevojave të qytetarëve dhe të qytetit, atëherë të projektuesi krijohet koncepti bazë zhvillimor shoqëror-ekonomik dhe kulturor për qytetin e ardhshëm.

Ibrahim Ramadani, Prishtinë

URBAN ELEMENTS AND CONTROL MECHANISMS IN THE PROCESS OF DRAFTING THE URBAN DEVELOPMENT PLAN (UDP)

Abstract

The aim of this paper consists in finding a way to access and implement certain elements, and basic characteristics of planning during the drafting of the urban development plan, considering it, as a development process that is carried out in several stages, such as the analysis of the existing situation, vision and provisions for implementation and its implementation for the given period. But the most crucial aspect of this process is; to provide development program, which is the basis of the development plan of the city. On the basis of the development program, future function of the city is determined, its growth at the end of the foreseen period and the completion design of new materials with elements of the city. All these projections into urban development plan should be implemented within the foreseen period. Due to this reason, it is necessary that the program is based on preliminary testing, analysis and budget. Thus, based on this, the design of the development program for UDP, can be considered as the first stage of urban design. Since the development program is based on a deep knowledge of the lifestyle and needs of the citizens and the city, the designer creates the basic socio-economic and cultural concept of the future cities.

Tryeza shkencore

“RRUGA DREJT INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN E KOSOVËS”

Tryeza shkencore *“Rruga drejt integrimit ekonomik evropian e Kosovës”* u mbajt me 29 nëntor 2017 në mjediset e Akademisë, nga Seksioni i Shkencave Shoqërore. Në këtë tryezë u trajtuan tema nga shumë dimensione, duke ofruan analiza të të dhënave dhe dokumenteve zyrtare e profesionale, vlerësimin e sistemit aktual, përvojat nga vendet e tjera, krahasimin e Kosovës me shtetet tjera në Ballkan, pasojat, implikimet politike si dhe mundësinë apo rrugën drejt integrimit ekonomik evropian.

Kosova në faza të ndryshme të ndërtimit është ballafaquar me procese sfiduese, të cilat kanë ndikuar në ndryshime strukturore në ekonominë e saj, prandaj qëllimi i kësaj tryeze shkencore ishte të analizohen proceset kryesore të integrimit dhe ndryshimet strukturore nga procesi i integrimit, nga pikëpamja e ekonomisë. Kosova që nga themelimi i institucioneve të saj është orientuar kah ekonomia e hapur dhe integrimi ekonomik. Koncepti teorik dhe praktik për ekonomi të hapur është orientuar si model i vendeve të zhvilluara dhe demokratike.

Tryeza u zhvillua në dy sesione dhe me kumtesa u paraqitën dhjetë studiuat të fushave përkatëse. Kumtesat ishin të mbështetura në hulumtime dhe në literaturë shkencore. Tryeza shkencore u mbajt nën organizimin e Këshillit organizues në përbërje prej akademik Isa Mustafa, akademik Jusuf Bajraktari, anëtare korrespondente Justina Shiroka - Pula dhe prof. dr. Valentin Toci.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik **Jusuf Bajraktari**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, i cili theksoi se tryeza ka për objekt trajtimin e një teme shumë të rëndësishme si për kah aktualiteti, ashtu edhe për ardhmërinë e Kosovës. Gjithashtu Akademik Bajraktari vlerësoi pjesëmarrjen e një përbërjeje profesionistësh intelektualë ndër më kompetentët për këtë lëmi, si dhe e vlerësoi përkushtimin e

posaçëm nga akademik Isa Mustafa, i cili deri pak kohë më parë ishte kryeministëri i vendit dhe ekspert i shquar i kësaj disipline shkencore. Ai në veçanti theksoi se elaborimet dhe kumtesat që do të prezantohen do të hapin shtigje për ecjen më të guximshme të ekonomisë kosovare drejt integritimit evropian.

Referuesit e parë - **Isa Mustafa dhe Sokol Havolli** (*Procesi i Berlinit I vendeve të Ballkanit Perëndimor*), analizuan Procesin e Berlinit, si rezultat i nevojave për të pasur stabilitet në Bashkimin Evropian. Vendet kyçe të BE-së inicuan të ashtuquajturin Proces të Berlinit, i cili u konsideruar si instrument i dialogut multilateral dhe reformues. Ky Proces ka kontribuar në relaksim të marrëdhënieve dhe të proceseve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Procesi i Berlinit ka dëshmuar njohjen e plotë të sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh se në këtë proces Kosova është trajtuar krejtësisht e barabartë me vendet tjera.

Në këtë tryezë shkencore gjithashtu është theksuar se Kosova ka shënuar hapa të konsiderueshëm në kuadër të procesit të Berlinit, proces ky që ka pasur për qëllim të nxisë aktivitetin investiv nga sektori publik në vendet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë të koordinuar.

Gjithashtu gjatë diskutimeve u potencua se procesi i Berlinit ka shërbyer pozitivisht në përshpejtimin e reformave infrastrukture, ekonomike, të tregut energjetik, bashkëpunimit kulturor dhe të rinisë, në aspektin e sigurisë si dhe në intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.

Referuesit e dytë - **Justina Shiroka Pula dhe Adhurim Haxhimusa** (*Levizja e tregut energjetik të Kosovës drejt tregut rajonal dhe e ardhmja e tij në tregun evropian*) trajtojnë temën mbi përpjekjet për harmonizimin e politikave energjetike të kërkuara nga direktiva e Komisionit Evropian (KE), me qëllim të integritimit në tregun energjetik rajonal dhe evropian.

Në Samitin e Vjenës, Austria, Gjermania, Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe gjashtë vendet e WB6 (Shqipëria, B&H, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), në bashkëpunim me KE-në dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë kanë vendosur të risin kapacitetet e transmissioinit dhe interkoneksioinit, themelimin e bursës së energjisë dhe tregun e përbashkët të balancimit të sistemit të energjisë elektrike në WB6.

Tryeza gjithashtu kishte në fokus përparimin që ka bërë Kosova për të integruar në tregun rajonal dhe të Evropës. Më tej për këtë fushë është theksuar se tregjet e energjisë elektrike të vendeve të WB6, posaçërisht Kosova dhe Shqipëria kanë relativisht diversitet të ulët të miksit të teknologjive të gjenerimit, volatilitet të lartë të ngarkesës e cila ka edhe karakteristika të larta sezonale. Duke e pasur parasysh volatilitetin e madh në ngarkesë, është thënë se integrimi në tregun rajonal, e sidomos me atë shqiptarë, sjellë përfitime të mëdha në sigurinë me furnizim stabil me energji elektrike dhe në stabilizimin e sistemit elektroenergjetik në Kosovë.

Referuesi i tretë - **Petrit Gashi** (*Tregu i përbashkët ballkanik*), diskuton për një treg të përbashkët ballkanik për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe e potencon se ky treg shihet si një mekanizëm përmes të cilit mund të aktivizohen potenciale të reja të rritjes ekonomike. Prandaj ky treg duhet të marre për bazë iniciativat e deritashme të rajonit për të qenë pjesë e tregut nëpërmjet CEFTA-së, harmonizimit të legjislacionit dhe strukturave të tyre institucionale me ato të BE-së që tani do të reflektohen në MSA.

Tregu i përbashkët ballkanik nënkupton marrëveshjen apo iniciativën ndërmjet CEFTA-s dhe MSA-së. Kjo iniciativë nënkupton lëvizjen e lirë të njerëzve, krijimin e tregut të përbashkët digjital, si dhe krijimin e një hapësirë të integruar investive.

Referuesit e katërt - **Drita Konxheli dhe Kadri Kadriu** (*Integrimi i tregut të energjisë së Kosovës me rajonin dhe Evropën*), diskutojnë mbi vendet e Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të jenë anëtare të bashkimit evropian. Një prej fushave për të cilën Bashkimi Evropian ka vënë kriter për anëtarësim është edhe fusha e energjisë. Më tej për fushën e energjisë është diskutuar rreth veprimeve që ka ndërmarrë Kosova për t'i plotësuar këto kriterë, sfidat me të cilat përballlet si dhe barrierat që e presin në të ardhmen.

Fatkeqësisht, KOSTT nuk po mund të anëtarësohet në ENTSO-E, si pasojë e bllokadës që po i bëhet nga operatori i transmisionit të Serbisë. Si rrjedhojë, KOSTT nuk e bën alokimin e resurseve të interkoneksionit dhe arkëtimin e të hyrave përkatëse. Po ashtu investimi në linjën e re (400KV) të interkoneksionit midis Kosovës dhe Shqipërisë nuk është futur ende në funksion.

Referuesit e pestë - **Hykmete Bajrami dhe Lulzim Krasniqi** (*Kosova dhe Marrëveshja për stabilizim asocijiv me BE-në*), në trajtimin e temës për MSA, potencuan që MSA është njëri nga komponentët e rëndësishëm të procesit të stabilizim-asocimit për

Ballkanin Perëndimor, i cili proces përfshin katër shtyllat bazike: Marrëdhënjet kontraktuale ndërmjet BE-së dhe vendeve aspiruese; Marrëdhëniet për stabilizim-asocim; Asistencën financiare (IPA); Bashkëpunimin rajonal dhe Marrëdhëniet e mira fqinjësore (European Commission, URL).

Gjithashtu është potencuar se qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës varet nga integrimi i saj ekonomik me botën si: në tregti, në investime si dhe në lëvizjen e njerëzve, prandaj dinamikat brenda ekonomisë së Kosovës duhet të ndryshojnë me qëllim që integrimi ekonomik të nxitë prodhimin në vend.

Referuesi i gjashtë - **Fatmir Besimi** (*Reformat strukturore dhe konvergjenca ekonomike e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian*) shtjellon përvojat si dhe trajton procesin e zgjatur të zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu theksohet se procesi i stërzgatur për Ballkanin Perëndimor dhe skepticizmi i ngritur brenda anëtarëve të BE-së po e ngacmon kredibilitetin e procesit, kështu që po kërkohet mbështetje më e fortë nga BE dhe angazhim serioz nga vendet candidate për t'iu kthyer Ballkanit Perëndimor, si dhe për të propozuar rrugë më të shpejtë për integrimin në BE.

Referuesi i shtatë - **Abdullah Hoti** (*Përshtatshmëria e legjislacionit të Kosovës me Acquis-Communitaire të Bashkimit Evropian*), në trajtimin e temës për legjislacionin ka potencuar se Kosova vazhdimisht ka punuar që sistemi legjislativ i vendit të jetë në përputhje me direktivat e BE-së. Në këtë drejtim të gjitha mekanizmat janë të definuara mirë në vend për sigurimin e përshtatshmërisë së ligjeve me Acquis-Communitaire me BE-në.

Referuesi i tetë - **Gazmend Qorraj** (*Integrimi tregtar në Ballkanin Përendimor - CEFTA 2006*), në trajtimin e temës për CEFTA-n u potencua që **CEFTA 2006** konsiderohet si një ndër marrëveshjet e para multilaterale, që testojnë marrëdhëniet rajonale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos vendet e rajonit që kanë tensione politike dhe raporte jo të mira ndërfqinjësore. Anëtarësimi në CEFTA nuk nënkupton që vendet duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret, por të zotohen që këto kriteri do t'i plotësojnë në vazhdimësi. Kjo është kërkesë e BE-së, pasi që anëtarësimi në CEFTA paraqet një mekanizëm transitor drejt Bashkimit Evropian.

Referuesja e nëntë - **Justina Shiroka - Pula** (*Infrastruktura ligjore dhe rregullatore në sektorin e energjisë në Kosovë - ana ligjore*) analizon hartimin e politikave, organizimin, rregullimin dhe

menaxhimin e sektorit të energjisë nëpërmjet infrastrukturës ligjore. Infrastruktura ligjore dhe rregullatore në Kosovë është në përputhje me *Acquis Communitare* të BE-së për energjinë. Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), që është një hap i rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionit të Kosovës në sektorin e energjisë me atë të BE-së. Nënshkrimi i këtij traktati është detyrim i Kosovës për t'iu përmbajtur obligimeve që vijnë nga direktivat e KE-së.

Gjithashtu gjatë prezantimit u potencuar se hartimi dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore në fushën e energjisë në Kosovë është një ndër përparësitë më të mëdha në zhvillimin e politikave energjetike.

Referuesit e dhjetë ishin **Valentin Toci dhe Arben Mustafa** (*Euroizimi i Kosovës*), të cilët në punimin e tyre diskutuan për integrimin ekonomik të Kosovës. Pra, ata potencuan që fillet e para të integritit ekonomik të Kosovës kanë filluar që nga fillimi i përdorimit të valutës euro, valutë kjo e unionit më të madh ekonomik dhe monetar - Bashkimit Evropian. Përdorimi i euros në Kosovë dhe mungesa e politikës së drejtpërdrejtë monetare në vend ka pasur refleksionet e saj edhe në vetë ekonominë e Kosovës.

Gjithashtu është theksuar se stabiliteti monetar i imponuar nga valuta e fuqishme EURO ka bërë efektin e saj mjaft pozitiv.

Tryeza përfundoi punimet me sukses. Gjithashtu pati edhe pyetje dhe diskutime nga një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve.

Justina Shiroka PULA, anëtare korrespondente

RECENSIONE

Edi SHUKRIU, Studime për Dardaninë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 247.

Libri *Studime të Dardanisë* sjell rishikim dhe analiza të reja për arkeologjinë dhe historinë dardane, të mbështetur në burimet arkeologjike, burimet e shkruara antike, qasjet e studiuesve të ndryshëm dhe konkluzionet e autores. Përmes nëntitullit të librit “Kulti i diellit, Përkrenarja ilire, Monumentet epigrafike, shandanet paleokristiane dhe aspekte të zhvillimeve etnolitike, arkeologjike, letrare dhe të antropologjisë fizike” janë paralajmëruar trajtesat e përfshira për çështjet të cilat lidhen me zhvillimet parahistorike dhe antike dardane në Kosovë dhe në rajon. Në të trajtohen proceset e zhvilluara, si dhe studimi i lokaliteteve dhe i objekteve të veçanta, gjithnjë në relacion me hapësirën dhe kohën e krijimit dhe të vazhdimësisë.

Studimi nis me trajtesën “Aspekte të zhvillimeve etnolitike në Kosovë”, e cila në mënyrë të argumentuar paraqet zhvillimin e proceseve etnolitike në Kosovë, duke sjell sintezën e zhvillimeve nga parahistoria e hershme, krijimi dhe zhvillimi i dardanëve, themelimi dhe fuqizimi i shtetit dardan, pushtimet e llojllojshme që nga periudha romake, koha e vendosjes së sllavëve dhe konotacionet e mëvonshme.

Trajtesa “Faza paraqytetare dardane e Kosovës” merret me jetën dhe rritjen e vendbanimeve dardane. që përcjell në përgjithësi proceset e zhvilluara në hapësirat e tjera, nga vendbanimet parahistorike, ato paraqytetare e deri te qendrat qytetare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit protoqytetar në protohistorinë dardane, mbështetur në të dhënat e mëhershme dhe në gjetjet e reja arkeologjike dhe konstatohet se nga shek. VI p. K. ngjanë ndryshime të rëndësishme në jetën ekonomike dhe shoqërore dardane, të cilat sollën një kualitet më të përparuar të jetës. Një prej treguesve të drejtpërdrejtë të këtyre ndryshimeve është qeramika, me vlerat e saj polivalente, me teknikat e prodhimit, me trajtat dhe funksionet e ndryshme, me frymën vendore dhe ndikimet helene, që dëshmon se dardanët njohën qarkun e poçarit 200 vjet para dyndjeve kelte.

“Kulti i diellit te dardanët” dëshmon se kulti i diellit ishte i fuqishëm te dardanët dhe se imazhi i diellit u përcoll nga dukja fizike dhe rrugëtimi i tij në parahistori e deri te konceptualizimi në antikë, duke kaluar nga kulti animistik në atë antropomorf. Duke konstatuar

se disqet diellore, jo si varëse apo aplikacione, janë vendosur në varre vetëm në territorin dardan, autorja i quan disqe dardane (më parë shiheshin si “pulla”). Ajo konstaton dhe ekzistimin e qiellvrotuesve dardanë, traditën e hershme të kultit dhe të ritualeve të zhvilluara, duke sjellë dëshmi arkeologjike të observatorit parahistorik dhe, mbi të gjitha, të labirintit dardan rrethor të qarkut të mbyllur, si fazë më e zhvilluar religjioze filozofike dardane.

“Trajtesa arkeologjike e toponimit Gradinë” merret me trajtimin e toponimit Gradinë përmes dëshmive arkeologjike dhe konstaton se në lokalitetet që mbajnë këtë toponim gjenden shtresat e para të epokës eneolitike, se janë rrethuar me gardh dhe se emri ka bazë në gjuhën indoeuroipane.

“Përkrenarja ilire e Denjit: - Zhvillimi i përkrenareve ilire” sjell për herë të parë të dhëna dhe analizën e të gjitha përkrenareve ilire të konstatuara në Kosovë. Njëkohësisht sillen dhe të dhëna për historinë e studimeve të përkrenareve ilire në përgjithësi, emërtimet e ndryshme që nga nisma e studimit të tyre e deri te fazat e ndryshme të zhvillimit të këtyre përkrenareve ndër ilirë.

“Monumenti mortor pararomak i Dardanës” trajton monumentin e parë figurativ të zbuluar në Dardani, unik deri më sot dhe ndër monumentet e pakta pararomake të fazës helenenistike dardane. Duke e analizuar në detaje, autorja konstaton se relievi me ritin mortor zë sferat transhendentale dhe përcjell qasjet kozmogonike dardane, botë kjo e panjohur deri vonë. Këtë e sugjeron bartja e shpirtit të të ndjerit përmes prekjes së arkës, valles mortore dhe veprimeve të tjera përcjellëse, si dhe monumentet e mëvonshme të periudhës romake të cilat shprehin vazhdimësinë dhe zhvillimin e botëkuptimeve të mëhershme kozmologjike dhe kozmogonike dardane, të papranuara më parë. Lidhur me trajtesën paraprake konstatohet dhe mbajtja e përkrenares ilire nga komandanti i vdekur dhe doriforët ushtarakë.

“Pesë monumente epigrafike nga Smira” përbëhet nga analiza e secilit monument epigrafik të evidentuar nga autorja në Smirë dhe sjell si përfundim të gjitha elementet e reja që ofrojnë monumentet nga aspekti arkitekturor, onomastik, teogonik e deri te prezenca e një municipiumi me banorë vendës dhe të huaj.

“Shandanet paleokristiane me kryq nga Dardania” prezanton dhe analizon dy shandane të krishterizmit të hershëm me kryq nga territori dardan (Tërnoc i Madh). Për shkak të kualitetit të lartë, këto shandane kanë rëndësi për vjeljen e të dhënave të reja lidhur me

zhvillimin e krishterimit të hershëm dhe, në veçanti, për konstatimin e relacioneve dardane me territoret fqinje dhe ato më të largëta.

Në “Dardanët në komeditë antike” paraqiten komeditë që kanë si titull dhe personazh imazhin e kohës për dardanët dhe propozohet që këta të shihen edhe si dardanë europianë, jo vetëm trojan, pasi që edhe dardanët europianë kanë qenë të njohur në kohën kur janë krijuar këto vepra.

“Arkeologjia dhe çështje të antropologjisë fizike në Kosovë” përmban të dhëna mbi rolin e patjetërsueshëm të antropologjisë fizike, studimet e paraluftës në Kosovë, kryesisht selektive, si dhe nevojën që ky aspekt i trashëgimisë kulturore të bëhet pjesë integrale e hulumtimeve arkeologjike.

Trajtesa “Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore: Atë Shtjefën Gjeçovi”, ofron analizën bashkëkohore të aktivitetit të gjithëmbarshtëm të Gjeçovit si arkeolog amator dhe, njëkohësisht, shërben për njohjen e qasjeve të nevojshme për fushën e arkeologjisë, por dhe të trashëgimisë kulturore në përgjithësi.

Studimi ka rreth 240 faqe dhe përmban literaturë të konsiderueshme dhe rezyme në gjuhën angleze për secilën trajtesë. Është i përcjellë me dokumentacion plotësues (foto, vizatime, harta).

Duke pasur parasysh vlerën e studimit, me qasje shumëdisiplinare dhe shpalosje të ndërlidhmërisë së proceseve të zhvilluara në territorin dardan në kohë të ndryshme, propozojmë botimin e tij.

Akademik Anton K. Berishaj

Emin RIZA, Arkitektura popullore e Gjakovës, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2017, f. 283.

Prof. dr. Emin Riza, autor i librit *Arkitektura popullore e Gjakovës* është padyshim njohësi më i mirë i trashëgimisë së kulturës ndërtimore në fushën e banesës popullore shqiptare përgjithësisht dhe të Kosovës veçanërisht. Ai me përgatitjen e tij të specializuar teorike e shkencore, si dhe me përvojën e begatë të praktikës në fushën e restaurimit të monumenteve të kulturës ia ka dalë me sukses të na jep një vepër të mirëfilltë shkencore, e cila do të plotësojë njohuritë e specialistëve të fushës si një kontribut i çmueshëm.

Studimi monografik i profesor Emin Rizës ka 278 faqe tekst. Në aspektin metodologjik autori, përveç hyrjes dhe të dhënave të bibliografisë së konsultuar, dorëshkrimin e ka ndarë në pesë kapituj me synim trajtimin e vlerave të kësaj trashëgimie.

Në kapitullin I trajton qëllimet e monografisë, krahas kriterëve studimore, për t'iu afruar sa më pranë problematikave për gjetjen e rrugëzgjidhjeve. Bëhet fjalë për tiparet e qendrës së banuar të Gjakovës, sa spontane, aq të mbështetura në kriterë praktike, për të siguruar funksionimin e kësaj qendre sipas rrethanave të kohës dhe interesave të bashkësisë qytetare; kapitulli II merr në shqyrtim tiparet urbanistike-arkitekturore të Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Është e rëndësishme të theksohet se qendra zejtare-tregtare e Gjakovës është zona e rëndësishme së përhershme për këtë qendër, e cila ashtu si shumë monumente të krijimtarisë shqiptare në Kosovë, u bë pre e vandalizmave serbe në vitin 1999; kapitulli III paraqet pjesën më të rëndësishme të monografisë. Aty bëhet fjalë për kriterin tipologjik. Paraqiten banesat më përfaqësuese të Gjakovës gjatë shek. XVIII-XIX, duke qenë tipologjikisht banesat me hajat dhe çardak të njohura qysh para pushtimit osman; kapitulli IV trajton vlerat e arkitekturës popullore të Gjakovës në rrafshin krahasues në hapësirën kosovare dhe më gjerë, në atë kombëtare. Këto krahasime shihen kryesisht në tiparin më thelbësor, atë tipologjik dhe në këndvështrime të tjera. Në kapitullin V vështrohet problematika lidhur me vlerat e pasurisë historike-kulturore, siç është arkitektura popullore e Gjakovës. Në

këtë kapitull të rëndësisë së veçantë, duke u nisur prej shkallës së sotme të vlerësimit të kësaj pasurie kulturore të papërsëritshme, shtrohen masat e ngutshme e të qëndrueshme në kohë për ta mundësuar që kjo trashëgimi t'iu kalohet brezave pasardhës. Me gjithë specifikat e tyre lëndore, kapitujt përbëjnë një tërësi unike, e cila është e mbarështruar mjeshtërisht nga autori.

Studimin monografik për banesën popullore të qytetit të Gjakovës, prof. Riza me të drejtë e ka vlerësuar në aspektin e tipareve të veçanta të këtij qyteti, aq sa edhe si pjesë integrale e mbarë trashëgimisë sonë ndërtimore në fushën e banimit. Edhe pse autori ndërtimet popullore të Gjakovës i ka cilësuar numerikisht të pakta, dukuria e përhapjes së gjerë të një tipologjie lejon që me analizën e këtyre shembujve të arrihet në përgjithësime të vlefshme e të drejta.

Përfundimet e nxjerra nga autori i dorëshkrimit janë të qëndrueshme në aspektin shkencor. Tipologjia e banesës gjakovare në rrafshin e gjerë mbarëshqiptar merr vlera të rëndësishme për faktin se ajo që në fillimet e veta, është mbi të gjitha, qendër zejtare-tregtare e mirëfilltë, e lidhur organikisht në rrjedhat e kohës me ekonominë bujqësore dhe blegtorale. Qëndrueshmëria e tipareve ekonomike-shoqërore në Gjakovë duhet kuptuar para së gjithash në lidhshmërinë e fortë me rrethinën e saj fshatare, e cila gjatë stuhive të kohës ka shërbyer si mjet i mbijetesës.

Qasja metodologjike, krahasimtare e autorit të studimit monografik “Arkitektura popullore e Gjakovës” dhe gjuha e pastër ia rrisin vlerat e këtij kontributi të vlefshëm shkencor. Po ashtu, një dimension tjetër të rëndësishëm në ngritjen e kualitetit të dorëshkrimit paraqesin një numër i konsiderueshëm i skicave, tabelave dhe fotografive si mjete ilustrimi e konkretizimi të kësaj problematike.

Akademik Jusuf Bajraktari

Muhamedin KULLASHI, Dy gjenealogji të modernitetit evropian, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 259.

Në opusin krijues të Muhamedin Kullashit gjithëherë gjejmë tematizimin dhe trajtimin e modernitetit, prej veprës *Kah metafizozofia* (1986) e deri te *Pushteti dhe dija te Michel Foucault* (2008). Natyrisht që gama e kompleksitetit që përfshinë moderniteti është e atillë që ende mbetet për t'u rigjetur të gjitha aspektet përmes të cilave do të mund ta mendonim në formën përmbledhëse këtë epokë – për disa ende të papërmbyllur (Habermas, Heinrich, Frank) e për disa mendimtarë tashmë të dekonstruktuar (Derrida, Deleuze, Lyotard). Debat i madh filozofik bashkëkohor ende silltet brenda përpjekjeve jo vetëm të të menduarit të premisave që thurin identitetin e modernitetit, por edhe rrjedhëve të mundshme të modernitetit me të cilat përvijohet aktualiteti i shoqërive evropiane. Në problematizimin e temave boshte të modernitetit mbi subjektin, arsyen, historinë dhe politikën na shpërfaqet një mozaik i pasur mendimesh që herë kryqëzohen, e herë konfrontohen, por që nxisin gjithherë impulse të reja reflektive kreative në të cilat sfidohet pandalshëm refleksioni filozofik.

Ky është një debat mjaft tundues filozofik në të cilin është angazhuar edhe Muhamedin Kullashi me veprën e tij *Dy gjenealogji të modernitetit evropian*.

Vepra e Muhamedin Kullashit *Dy gjenealogji të modernitetit evropian* është përpjekje për të trajtuar çështjen komplekse të gjenealogjisë së modernitetit, duke vënë në pah mundësitë e ndryshme të interpretimit të aspekteve esenciale të konsekuencave të gjetjeve formësuese të jetës politike evropiane te dy mendimtarë si Claude Lefort dhe Michel Foucault. Muhamedin Kullashi në veprën e tij tematizon çështjet esenciale përmes të cilave ata ndërtonin të kuptuarit e ndryshëm të modernitetit, me konsekuenca jo të parëndësishme sidomos për jetën politike të aktualitetit në shoqëritë evropiane. Në afirmimin problemor të asaj që ata konsideronin si të rëndësishme për gjetjet e modernitetit, mendimtarët si Lefort dhe Foucault për Kullashin mbesin tregues të rëndësishëm të kompleksitetit të

modernitetit, që na mundësojnë rimendimin e pozicioneve të prera teorike për atë se çka paraqet dhe cilat janë pasojat e modernitetit. Në kryqëzimin e dy mënyrave të mendimit të modernitetit, të cilën e bën Kullashi, nuk kemi vetëm një ‘analizë krahasimtare’, por më shumë një gjetje refleksive të mendimit të thelluar problemor që vë në pah rëndësinë e mendimit joreduktues mbi modernitetin.

Libri i Muhamedin Kullashit *Dy gjenealogji të modernitetit evropian*, për më shumë, nuk mbetet vetëm brenda kryqëzimit problemor të gjetjeve të këtyre mendimtarëve, por ai ato i pasuron po ashtu në kontekstualizim më të gjerë të debateve të zhvilluara të këtyre mendimtarëve mbi çështjet boshte të identifikuar prej tyre (qoftë në debatin Arendt-Lefort, qoftë në atë Habermas-Foucault). Në interpretimet e mëvetësishme të gjenealogjisë së modernitetit te këta dy mendimtarë, Kullashi gjen momentet veçuese të debatit që ka cilësuar të themi gjithë filozofinë bashkëkohore franceze, por edhe atë gjermane.

Vepra e Muhamedin Kullashit *Dy gjenealogji të modernitetit evropian* fillon me problematizimin deri më tanë më të përmbledhur të modernitetit nga ana e Habermasit në veprën e tij *Diskursi filozofik i modernitetit*, ku ai problematizon momentet kyçe të mendimtarëve si Hegeli, Nietzsche dhe Weberi. Në pjesën e parë Kullashi vendosë premisat për interpretimin gjenealogjik të modernitetit si koncept metodik i interpretimit, të cilin Foucault e shndërron në metodë të këtij mendimi, por edhe të kërkimit e cila del jashtë esencave të fiksuara identitare dhe kuptimore të ngjarjeve historike – ‘gjenezave lineare’. Pavarësisht dallimeve të mendimeve të Foucault dhe interpretimit të tij gjenealogjik, Kullashi identifikon edhe pikëtakimet e këtyre dy mendimtarëve pikërisht në konceptin e Lefort mbi ‘pikëvrojtimin gjithëpërfshirës’ dhe kritikën e tij të këtij koncepti të huazuar nga Merleau-Ponty. Ngjashëm me pikëpamjen gjenealogjike edhe kritika e pikëvrojtimit gjithëpërfshirës e Lefort-it është e drejtuar kah zhbërja e fiksioneve si presupozime sistematike që synojnë të kapin tërësinë e historisë dhe shoqërisë. Mbi këtë premisë gjenealogjike të të dy mendimtarëve Kullashi më pastaj identifikon trajtat e modernitetit të inerpretuar nga Lefort dhe Foucault.

Në dy kapitujt vijues: “**Moderniteti si zbulim i demokracisë**” dhe “**Zbulimi i pushtetit disiplinor në modernitet**», në mënyrë të përmbledhur vërejmë të paraqiten dallimet mbi presupozimet e formësimit dhe ndërtimit të modernitetit nga ana e këtyre dy mendimtarëve. Përderisa te Lefort-i moderniteti identifikohet ‘si epokë ku sajohet një konfiguracion i veçantë midis pushtetit, ligjit dhe

dijes’, konfigurim ky që ‘cilësohet me sintagmën zbulim i demokracisë’, te Foucault moderniteti si epokë identifikohet me gjetjet disiplinare të shoqërisë si teknologji e re e pushtetit, si dhe me shndërrimet në mekanikën e pushtetit kah ‘biopolitika’, shndërrime këto strategjike prej anatomo-politikës (në të cilat trupi është në shënjestër të pushtetit) kah biopolitika (ku në shënjestër të pushtetit është popullsia).

Në veprën e tij Muhamendin Kullashi orvatet që të vë në pah tendosjet e brendshme të modernitetit që kërcënojnë gjithherë shoqëritë aktuale me format e padëshiruara politike dhe të organizimit të pushtetit (në kundërtënie të brendshme të demokracisë që shpiejnë në totalitarizëm të Lefort, si dhe ato të gjetjeve të mekanizmave disiplinore të pushtetit i cili problematizon çështjen e lirisë të Foucault). Analizat e mendimit të Lefort dhe Foucault të Kullashi gjithherë kryqëzohen edhe me pikëpamjet e mendimtarëve të tjerë bashkëkohorë të kyçur në debatin e madh rreth modernitetit.

Vepra e Muhamedin Kullashit *Dy gjenealogji të modernitetit evropian* është një sintezë e avancuar e kërkimeve të tij të deritashme mbi mendimet e Lefort dhe Foucault. Ai në studimet paraprake mbi Lefort-in (si dhe në parathënien e përkthimit të veprës së tij *Demokracia dhe totalitarizmi*), por po ashtu edhe të atyre mbi Foucault (të përmbledhura në veprën voluminoze *Pushteti dhe dija të Michel Foucault*) kishte paraqitur disa aspekte të interpretimeve të modernitetit të këta dy mendimtarë. Me këtë vepër Kullashi përmyll një kërkim konceptual të thelluar për modernitetin në veprat e Lefort dhe Foucault. Vepra e tij, e cila tematizon fërkimet e mendimeve relevante për modernitetin në filozofinë bashkëkohore franceze dhe gjermane shpalos dyshimin e nevojshëm mendor për mendimin e kompleksitetit të modernitetit si dhe evitimit të ngushticave reduktuese teorike në interpretime përmyllëse të njëanshme.

Vepra *Dy gjenealogjitë e modernitetit evropian* plotëson dukshëm reliefin tonë kulturor e filozofik, duke begatuar debatin filozofik tashmë të inicuar në qarqet e kufizuara filozofike të ne. Kjo vepër do të mbetet po ashtu edhe një kontribut i çmueshëm për debatin e gjerë evropian filozofik.

Astrit Salihu

Blerim LATIFI, Metafizika e emancipimit. Ideja e emancipimit të njeriut në historinë e mendimit perëndimor, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 315.

Në librin me titullin *Metafizika e emancipimit. Ideja e emancipimit të njeriut në historinë e mendimit perëndimor*, i përbërë nga hyrja, përfundimi dhe tri pjesë, Blerim Latifi përkufizon synimin për të shpjeguar e ndriçuar ngjizjen, rritjen dhe krizën e idesë së çlirimit, gjegjësisht të emancipimit të njeriut përmes analizës së filleve mitike të kësaj ideje, botëkuptimeve religjioze dhe sekularizmit iluminist të saj në kohërat moderne. Autori e konsideron njohjen e kompleksitetit të kësaj problematike si një nga “rrugët më të mira për të kuptuar kompleksitetin e vetë modernitetit”. Duke u nisur nga analizat e Lyotard-it për qëllimin e fundit të historisë njerëzore, nën emrin e “emancipimit” si instancë legjitimuese e gjithë pluralitetit të praktikave të modernitetit, Latifi trajton krizën e modernitetit si rrjedhojë e krizës që shfaqet brenda kësaj instance.

Ky hulumtim i mirëfilltë filozofik shpaloset me një dialog kritik me tekste pertinente nga filozofia klasike, moderne e sidomos bashkëkohore, duke u nisur nga momenti i emancipimit të menduar brenda horizontit të transcendencës hyjnore në *Besëlidhjen e vjetër*, ku hapet interpretimi teleologjik i historisë, me finalitetin e historisë, në librin e *Eksodit*. Autori më pastaj ndjek transformimin dhe begatimin e kësaj ideje te krishterimi, në veçanti me dimensionin e universalizimit të emancipimit. Latifi më tutje trajton me luciditet procesin tejet kompleks historik të shndërrimit të transcendencës në imanencë, fillimisht në gnosticizëm e pastaj në modernitet. Ndërkaq, momenti i tretë i hulumtimit bën çështje konceptonet dhe përfytyrimet e historisë botërore si proces i emancipimit universal të njeriut, duke shkoqitur “zbrazëtinë e instancave të emancipimit”.

Ekskursioni shumë instruktiv etimologjiko-semantik i termave që lidhen me emancipimin, çel rrugën për tematizimin e ideve që trajtohen te mendimtarët e shquar nga tri periudhat e përzgjedhura. Autori përvijon hollësisht analizën e dimensioneve kyçe të emancipimit, që kanë lënë gjurmë të thella në imagjinaren politike

perëndimore gjatë shekujve, ku shquhen ato për dimensionet thelbësore të konceptit të emancipimit.

Në mbështetje të një literature shumë të pasur filozofike, autori zhvillon edhe kritikën e historicizmit si “*imanentizim i eskatonit*”, në veçanti pas përvojave katastrofike të shekullit XX, të dy luftërave botërore me gjithë kortezhin e pasojave, e veçmas botëkuptimin se historia e njerëzimit ka një kuptim dhe qëllim universal të cilin e realizon përmes ligjeve të pashmangshme të progresit, të kuptuara si ligje imanente të vetë procesit historik. Janë shumë pertinente po kështu analizat për simbolizmin trenetarian si “paradigmë dominuese në interpretimin e historisë përgjatë gjithë modernitetit”.

Në pjesën e dytë të dorëshkrimit me titull *Emancipimi si entelehi e historisë* autori problematizon një varg të intepetimeve të filozofëve evropian mbi këtë doktrinë, e cila del si një “modifikim sekularist i eskatologjisë judeo-kristiane”.

Brenda herezisë antiiluministe të Rusoit, autori heton anticipimet e pothuajse të të gjitha kritikave të mëvonshme që i bëhen iluminizmit dhe në veçanti doktrinës së progresit moral me anë të dijes dhe shkencës.

Kompleksiteti dhe begatia e analizave të Latifit, në pjesën e tretë të dorëshkrimit (*Zbrastësia e instancave*) shquhet edhe në trajtimin e emancipimit në horizontin e imanencës me sovranizimin e mendjes te iluminizmi francez dhe filozofia klasike gjermane, si dhe kritikën e filozofive të subjektit konstituues që nga filozofia posthegeliane e deri te kërkimet e Foucault-së mbi pushtetet disiplinore në shoqëritë moderne.

Muhamedin Kullashi

Shemsi KRASNIQI, Besimet dhe praktikat rituale shqiptare në Kosovë. Refleksione mbi një ekokulturë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2016, f. 319.

Libri i Shemsi Krasniqit *Besimet dhe praktikat rituale shqiptare në Kosovë. Refleksione mbi një ekokulturë* (319 faqe) zhvillon analiza të pasura dhe lucide mbi besimet dhe praktikat rituale të shqiptarëve të Kosovës në lidhje me natyrën. I ndarë në dhjetë kapituj, ky punim, në hyrje sjell analiza mbi kontekstin gjeografik, historik dhe socio-kulturor të Kosovës, si dhe refleksione mbi qasjen teorike e metodologjike të besimeve dhe praktikave rituale. Pastaj, Shemsi Krasniqi trajton elementet e kulturës tradicionale në kuadër të relacioneve ndërmjet njeriut dhe natyrës, siq është tema e gurit si memorie dhe eksperiencë njerëzore, analizat e simboleve parahistorike ose artit shkëmbor të Kosovës, ritet e kalimit, kultet dhe besimet në lidhje me malet, kulti i drunjëve dhe kafshëve, festat e ringjalljes së natyrës dhe analizat e disa figurave mitologjike shqiptare, si *Zana, Ora, Dragoni* etj.

Metodat dhe teknikat e përdorura për mbledhjen e të dhënave, si të vërejturit me pjesëmarrje, intervistat dhe videografia, i kanë mundësuar Shemsi Krasniqit të zotërojë një material të pasur në terren mbi reprezentimin social të natyrës tek shqiptarët.

Ky punim, i fokusuar mbi çështjet e reprezentimit social të natyrës, hapë një fushë të re studimi të kulturës shqiptare. Shumica e punimeve etnologjike mbi kulturën shqiptare kanë ka të bëjë me shpjegimin e zakoneve, folklorit, kostumeve, muzikës popullore dhe mitit të origjinës, duke lënë anash periudhat parahistorike ose par-etnike. Etnologët dhe historianët shqiptarë janë marrë shumë me mitin e origjinës me synim të krijimit të një identiteti substancialist kombëtar, « konstant nëpër shekuj » dhe krejtësisht i « ndryshëm » prej atyre të popujve fqinjë.

Për dallim prej kësaj, Z. Krasniqi në hulumtimet e tija, duke treguar gërshetimet e elementeve të kulturave të ndryshme (pagane, romane, otomane, ortodokse serbe ose ortodokse maqedone, muslimane, ortodokse dhe katolike shqiptare) në praktikat rituale të

lidhura me natyrën, vë në vështirësi reprezentimet substancialiste të kulturës.

Z. Krasniqi, në këtë libër mbi praktikat rituale dhe reprezentimet e natyrës orientohet duke u mbështetur në punimet e profesor Eric Navet, por gjithashtu edhe në ato të J.Rifkin, rreth problematizimit të paradigmes mekaniciste-racionaliste dhe antropocentrike (Newton, Descartes), si shkak i krizës ekologjike dhe çrregullimeve të ekosistemit. Ai përpiqet të gjejë forma tjera të relacionit me natyrën.

Gjithashtu, ai zgjeron përpjekjet për t'i shoqëruar hulumtimet shkencore mbi praktikat rituale me aspektin artistik të koncepteve të ekokulturës, si simulakrumi, mbishkrimet, sakraliteti. Lidhja ndërmjet këtyre dy aspekteve shfaqet sidomos në analizat mbi bekimin, mallkimin, simpatinë, empatinë, metamorfozën, metaforën, duke sjellë shembuj prej letërsisë artistike gojore.

Në analizat mbi *hirin*, *hatërin* sikurse edhe mbi legendat dhe besimet e lashta (Komaran, Bresalc), Z. Krasniqi rikthen fuqishëm lidhjen dhe respektin reciprok të njeriut me natyrën.

Ai i bënë një kritikë konceptit « vetëdije ekologjike » çfarë ka qenë i njohur në Kosovë prej viteve 70-ta, duke u nisur prej nocionit të ekokulturës që në vete përfshinë hapjen dhe të kuptuarit e mitikes, simbolikes, emocionale, e gjithashtu edhe të etikës dhe religjiozes në praktikat rituale.

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i këtyre hulumtimeve ka të bëjë me reprezentimet e sinkretizmit në ritualet, influencën reciproke ndërmjet religjioneve instiucionale dhe të sistemit të besimeve e praktikave rituale tradicionale të lidhura me natyrën.

Analizat mbi tipologjinë e simboleve të artit shkëmbor (sidomos atij në Zatriq ose skena e gjuetisë mbi gurin e Sharenicës, ose imazhet e kalendarit, ose ndarja ciklike e kohës, ideogramet dhe psikogramet e ndryshme), tregojnë luciditetin dhe pasurinë e këtij libri.

Qasja komparative dhe multidisiplinare mbi kultet e gurit, mbi varret e vjetra (megalitet në Aqarevë) të cilat përmbajnë shumë simbole apstrakte dhe gjeometrike, dhe ritet e kalimit si dhe praktikat e ceremonisë së dhuratës me të cilat shoqërohen, i japin një dimenzion të ri këtij hulumtimi.

Analiza e aspekteve të ndryshme të festave të ringjalljes së natyrës dhe rifillimit të ciklit të punëve bujqësore (sidomos në Opojë), krahasimi i pelegrinazheve në malet Lybeten dhe Pashtrik,


transformimet e këtyre ritualeve përgjat kohës, dëshmojnë origjinalitetin e hulumtimeve të autorit.

Në interpretimin e simboleve (spiralet, dreri, druri, vijat, rrjetat, rrathet etj.) studimi i Z. Krasniqit bashkon qasjen racionaliste me intuitën në « kthesat e pasigurta të besimit dhe ritualit ».

Shumësia e praktikave rituale dhe reprezentimeve të lidhura me natyrën, të studiuara në këtë libër, i lejojnë Z. Krasniqit t'i thellojë interpretimet e tij të simboleve dhe riteve.

Pasuria, koherenca dhe origjinaliteti thelbësor janë karakteristikat kryesore të tezës së Shemsi Krasniqit.

Muhamedin Kullashi



ROBERT ELSIE (1950-2017)

(In memoriam)

HUMBJE E MADHE PËR KULTURËN DHE SHKENCËN

Më 2 tetor 2017 në Bonn të Gjermanisë u nda nga jeta gjuhëtari, intelektuali, keltologu, poliglotti, albanologu, studiuesi frymëgjatë i gjuhës dhe i kulturës shqiptare, përhapësi i pashoq i vlerave të saj, prezantuesi i historisë së dokumentuar të popullit shqiptar, përkthyesi i zellshëm i letërsisë shqipe në gjuhët angleze dhe gjermane, përkthyesi i letërsisë greke në gjuhën gjermane, miku i madh i botës shqiptare, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut dr. Robert Elsie, pjesëmarrës në shumë aktivitete shkencore të Akademisë sonë dhe anëtar i redaksisë së revistës “Studime shoqërore”.

Ndryshe nga kohët kur me Robertin komunikonim nga larg lidhur me projektet e punës, shumë shpesh dhe lidhur me gjendjen që na kishte kapluar në vitet '90 të sh. XX, në kohë më të vona që bërë e zakonshme të komunikonim për projektet e radhës në fushën e studimeve shqiptare. Sapo mbaruam diskutimet për përkthimet e biblës nga Todhri, për botimin e origjinalit me transliterim dhe përkthim anglisht në vizitën e tij në nëntor 2016, Roberti më çonte dorëshkrimin për alfabetet e shqipes, libër që ndërkohë doli nga shtypi po ashtu. Javën që shkoi po komunikonim lidhur me programin e Konferencës së këtij muaji për studimet albanistike në botën ku flitet gjermanishtja, dhe po bënim llogari për bashkëpunime të mëtejme,

Roberti nuk përtoi të çonte mesazhin vlerësues për përgatitjet e konferencës, por njëherësh tregonte se ndodhej në spital dhe nuk e dinte nëse do të ishte në gjendje të vinte vetë. Vetëm tri ditë pas kësaj na erdhi kumti i zi krejt i papritur dhe në valën e aktivitetit të tij, në kulmin e pjekurisë intelektuale me horizont të pritjes reale për shumë vepra me vlerë që do të na sillte. Si gjithnjë, në takimet e fundit në nëntor që i qetë, i afërt, plot kërshtëri dhe bindje për punët në vijim.

Në Arkivin e Akademisë gjeta motivimin për pranimin e Robert Elsie-s anëtar të jashtëm të ASHAK-ut të fundit të tetorit të vitit 2000, ku, ndër të tjera shkruhej: “veprimtaria 2 e dr. Robert Elsie është e shumanshme dhe e gjerë. Ndhimesat e tij në fushën e albanologjisë janë të rëndësishme, sidomos në fushën e studimeve historiko-letrare, po edhe në fushën e historisë së kulturës. Informimet e shumta dhe shpesh depërtimet në institucione, biblioteka apo mjedise të tjera ku mund të gjenden vlera të shkruara jo mjaft të njohura për kulturën dhe historinë shqiptare ia shtojnë edhe më shumë peshën punës së tij tejet të frytshme... Për kulturën shqiptare rëndësi të veçantë ka dhe puna e tij në përkthimin, përhapjen dhe interpretimin e vlerave të letërsisë dhe të kulturës shqiptare nëpër botë, por nuk duhet të harrohet as ndihmesa e tij e drejtpërdrejtë për afirmimin e çështjes së Kosovës. Nuk ka dyshim se të gjithë punën e tij albanologjike e shquan një dashuri e jashtëzakonshme për kulturën dhe për popullin shqiptar”. Thelbi i këtij vlerësimi të bërë 17 vjet të shkuara në Kosovën e sapodalë nga lufta sot vjen e rritet ndjeshëm, për të na bërë më të rëndë ndjenjën e humbjes së tij të parakohshme.

Robert Elsie lindi në Vankuver të Kanadasë më 1950, ku bëri studime për filologji klasike dhe gjuhësi, për të vazhduar më tej paralelisht me studime për gjuhësinë e krahasuar dhe nxënien e gjuhëve të ndryshme, ku hynin frëngjishtja, spanjishtja, gjermanishtja, italishtja, rusishtja, gjuhët baltike, gjuhët keltike, greqishtja, më vonë dhe gjuhët e tjera të Ballkanit, përfshirë shqipen, që u bë përqendrimi i tij më frymëgjatë. Në Universitetet e Berlinit, të Bonit e të Parisit studioi dhe sanskritishten, bretonishten, apo gjuhët e zhdukura të Europës Jugore. Specializimin në gjuhësi të krahasuar e përfundoi me tezën e doktoratës për Raportet dialektore në goidelikeshte, studim në dialektologjinë kelte në Bonn, që u botua më 1986. Në Bonn studimet për gjuhësinë e krahasuar në atë kohë i drejtonte Johann Knobloch, gjuhëtar i shquar, ish-nxënës i N. Jokl-it. Kontaktet e tij me botën shqiptare në Tiranë e në Prishtinë i hapën Robertit një horizont të ri interesimesh - atë të gjuhës shqipe. Kështu keltologu mori udhën drejt

albanologjisë. Nga vitet 1978/79 Roberti, megjithë angazhimet e tjera, po zhytej gjithnjë e më shumë në studimet për shqipen dhe shqiptarët. Paralelisht ndërmerre vizita në Tiranë dhe në Prishtinë, sidomos në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, po edhe në veprimtari të tjera. Me kohë u specializua në fushën e përkthimeve, qoftë në veprimtari të konkrete, apo edhe gjithnjë e më shumë në fushën e letrave dhe të kulturës. Përkthimet simultane R. Elsie i ka ushtruar në kontaktet qeveritare gjermano-shqiptare, po më vonë sidomos për nevojat e Gjykatës së Hagës, të NATO-s, të BE-së e të Këshillit të Europës dhe të instancave të ngjashme të niveleve më të larta ndërkombëtare.

Profili i tij prej studiuesi është i gjerë, kështu që ndihmesat e tij në albanologji shtrihen në shumë aspekte, në radhë të parë në fushat e studimit të letërsisë, të studimit të kulturës, të folklorit dhe të mitologjisë shqiptare, në fushën e gjuhës, etj. Njihet si hulumtues këmbëngulës i dokumenteve dhe i dokumentimit të historisë shqiptare dhe i botimit të dokumentacionit në origjinalin e tij, po shpesh dhe me përkthime qoftë anglisht, qoftë shqip. Në fushën e studimeve letrare ai njihet me veprën e tij *Historia e letërsisë shqiptare* anglisht të botuar më 1995 në 2 vëllime te Boulder dhe të shpërndarë nga Columbia University press në New York. Kjo vepër u përkthi dhe u botua te “Dukagjini” më 1997 me përhapje në tërë hapësirën shqiptare. U përkthi polonisht për nevoja të studentëve të Universitetit të Torunjit. Mëtesa e autorit ka qenë të bënte një vepër gjithëpërfshirëse, nga fillimet e shkrimit shqip e deri sot, të paanshme, e mbi të gjitha me shënime sa më të plota e bibliografi shumë të pasur, në shumë aspekte shteruese. Tek i njëjti botues ai nxori më 1996 veprën *Studies in Modern Albanian Literature and Culture* me studime e recensione për letrat shqipe të botuara më parë në World Literature Today (ka një botim shqip te “Buzuku”, Prishtinë, 1995). Një version të shkurtë të *Albanian Literature A Short History* e botoi në Londër më 2005. Në këto vepra ai ka bërë sintezën e punës së tij shumëvjeçare me paraqitjen e letërsisë shqipe në botë.

Aspekt tjetër të studimeve të tij paraqesin hulumtimet për folklorin, kulturën popullore dhe mitologjinë, për çka po ashtu ka lënë vepra me vlerë. Te New York University Press ai më 2001 botoi veprën dyvëllimëshe *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture*, për të vazhduar me serinë e veprave të karakterit enciklopedik shumë të rëndësishme për përhapjen e dijes dhe të ideve për popullin, kulturën dhe gjuhën shqipe: *Historical Dictionary of*

Albania, Oxford 2004, *Historical Dictionary of Kosova*, Oxford 2004 me botime të zgjeruara më 2011, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, London, etj.

Një aspekt me shumë rëndësi në punën e Robert Elsie-s paraqet veprimtaria e tij shumë e gjerë në fushën e mbledhjes dhe të botimit të dokumentacionit për historinë dhe zhvillimet ndër shqiptarë, të paraqitur dhe në gjuhën angleze. Në këto hulumtime të tij mbisundon vështrimi gjithëshqiptar, trajtimi i botës shqiptare nga një vështrim i jashtëm, por si një tërësi. Në këtë fushë do të veçoja librin e vitit 1997 të botuar në Nju-Jork “*Kosovo in the Heart of the Powder Keg*”, ku botës iu paraqitën jo vetëm pikëpamjet e shqiptarëve, po edhe dokumentet e programet përmes të cilave dëshmohen zullumet gjenocidale ndaj shqiptarëve dhe projektimet nga instanca shtetërore të spastrimeve etnike, si ato të E. Durham, të Leo Freundlich, të Gj. Bisakut-Sh. Kurtit-L. Gashit, të V. Čubrilović-it e të I. Andrić-it. Pastaj veprën *Early Albania. A reader of Historical Texts 11th-17th Centuries*, Wiesbaden, 2003 dhe librin me dokumente për fatin e çamëve dhe të gjenocidit ndaj tyre, të përgatitur bashkë me B. Destanin “*The Cham Albanians of Greece*”, London 2013. Robert Elsie ka botuar dhe një varg veprash të tjera në këtë fushë dhe ka qenë vazhdimisht i angazhuar në përhapjen e së vërtetës së shqiptarëve edhe në kohët më të vështira për Kosovën. Në një prej reagimeve të tij publike për gjendjen në Kosovë në Londër e në New York më 1992, të parë nga Hotel Grand i Prishtinës, Elsie vlerësoi: “The spectre of nazi Germany arose before me as I watched the guests... I pictured myself in the 1930s in an elegant restaurant in Berlin... in a hotel recently made judenfrei” (Pamje të Gjermanisë naziste u shfaqën para meje derisa po shikoja mysafirët... E përfytyrova veten në vitet ’30 në një restorant elegant në Berlin... në një hotel që tani ishte bërë i lirë nga çifutët). Dhe nuk pushoi së ndihmuari gjithandej dhe me të gjitha fuqitë e tij për çlirimin nga gjendja ku ishte pllakosur Kosova. Informimi i drejtë, i plotë e i paanshëm dhe në instancat ku duhej ishte bërë punë e tij e ditës.

Një aspekt me shumë vlerë e punës së tij hulumtuese paraqet botimi i veprave më pak të njohura apo të mbetura dorëshkrim nga e kaluara, ndër të cilat do të shquaja botimin e Kujtimeve të Baron Nopçës, të Historisë së Shqipërisë të Faveyrial-it, etj. Më duket se me rëndësi jo të vogël janë ndihmesat e tij në gjurmimin dhe botimin e fotografive të hershme nga bota shqiptare, punë që deri tash ka mbetur unikale.

Si studiues Elsie ishte formuar për gjuhësi krahasuese indoeuropiane. Në fillimet e tij shqipen e shihte më parë në këto suaza, por shumë shpejt iu kthye një kuadri më të përgjithshëm të studimeve shqiptare. Rëndësi kanë studimet e tij për aspektet kulturore dhe të shkrimit të hershëm të shqipes, të dokumentimit të hershëm, por edhe studimet për emrat e lumenjve, apo ato për shqipen tek E. Çelebi. Pak para vdekjes ai na la dhe dy vepra për këto aspekte: *“Early Albanian Bible Translations in Todhri Script”*, London 2016, në të cilën sjell kopjen që ia doli ta gjente në arkivat për von Hahn, e që mendohej të ishte zhdukur. Ai kështu sjell një zbulim të rëndësishëm për shkrimin origjinal të sh. 18 nga Todhri, pastaj *“Albanian Alphabets: Borrowed and Invented”*, London, 2017, ku jep një pasqyrë të gjithanshme të alfabetëve me të cilat u shkrua shqipja. Është marrë dhe me leksikun e besimeve dhe të mitologjisë, etj. Këto kohët e fundit, në kuadër të punës së tij të gjerë për paraqitjen e kulturës dhe të botës shqiptare përmes internetit, ai hapi dhe një sajt *“Albanian Language”*, ku jepen shënime hyrjeje për gjuhën shqipe, me elemente të dëshmimeve historike. Aty ka dhe një nismë shumë të lavdërueshme lidhur me dialektet e shqipes: ai ka sjellë një material audio për të folme shqipe të mbi 150 pikave qoftë të vjela nga ai vetë, qoftë nga të tjerë.

Ndihmesat e Robert Elsie-s për njohjen ndërkombëtare të kulturës dhe të botës shqiptare kanë qenë të jashtëzakonshme dhe në drejtime të ndryshme. Do të përmendja me këtë rast përkthimet e tij gjermanisht të veprave të Migjenit, të tregimtarëve të sh. XX, por pastaj sidomos anglisht të veprave të Migjenit, të E. Koliqit, të F. Brovinës, të A. Podrimjes, të Gj. Fishtës, të këngëve kreshnike, të E. Bashës, të F. Kongolit, të tregimeve shqiptare, të V. Zhitit, të A. Shkrelit, të J. Nezirajt e të tjerë. Sukses më vete paraqet përkthimi i kryeveprës *“Lahuta e Malcís”*. Le të përmendim rrugës se ai ka përkthyer gjermanisht veprën 6 e plotë të poetit të madh grek Konstatntin Kavafis, ashtu si dhe poezinë sorabe. Përveç përkthimeve në vepra të veçanta, ai ka bërë shumë përkthime të tjera nëpër revista të ndryshme në Gjermani, në Amerikë, etj. Ka përhapur informacione për letërsinë shqiptare nëpër të gjitha hapësirat e mundshme ndërkombëtare, po edhe përmes internetit në sajtin e tij *“Albanian Literature in Translation”*, ku përfshihen shumë vepra që dalin për herë të parë anglisht. Kur jemi te sajtet, do të doja të përmend me këtë rast punën e tij jashtëzakonisht shumë të dobishme në sajtet *“Albanian Art, Texts and Documents of Albanian History, Early Photography in*

Albania”. Në këtë pikë ai ka qenë një hap më përpara se të gjithë ne që merremi me studime të këtij lloji, duke përfituar nga përparësitë e teknologjisë së kohës për përhapjen e pakonkurrencë të dijeve e të informacionit për kulturën, gjuhën, letërsinë dhe botën shqiptare.

Robert Elsie-n e njoha nga viti 1979, kryesisht nga Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nga konferencat e ndryshme shkencore ndër ne dhe në botë, nga takimet në vizitat e tij në Kosovë. Ishte njeri jashtëzakonisht i qetë, i vëmendshëm dhe i interesuar. Ishte i saktë dhe i përgjegjshëm për punën që bënte. Ishte dashamirës dhe kishte dëshirë të ndihmonte, prandaj dhe kishte zënë shumë miqësi me shqiptarët gjithandej. Gjatë ditës së djeshme kemi marrë telefonata nga studiues arbëreshë për të shprehur ngushëllimet e tyre (e dinin se ishte anëtar i jashtëm i Akademisë sonë) dhe keqardhjen për humbjen e një njeriu kaq të dashur edhe për arbëreshët.

Shuarja e tij është një humbje e madhe për albanologjinë në përmasat ndërkombëtare, është humbje e një miku të madh të botës shqiptare, e një dijetari të papërsëritshëm. Vepra e tij do të vazhdojë të rrezatojë dritë, dije e informacion për botën shqiptare. I qoftë i lehtë dheu që do ta mbajë.

Rexhep Ismajli



KRISTAQ PRIFTI (1932-2017)

(In memoriam)

Lajmi i kumtuar më 9 dhjetor 2017 për ndarjen nga jeta të intelektualit të mirënjohur, historianit brilant e pedagogut të paharruar, anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akademik Kristaq Priftit, mori jehonë të dhimbshme në Shqipëri, në Kosovë, në viset tjera shqiptare dhe gjithandej në mërgatë. Dhembja dhe pikëllimi i thellë i familjes Prifti për humbjen e më të dashurit të saj, miqve dhe kolegëve, studentëve të gjeneratave të tëra në Universitetin e Tiranës dhe Universitetin e Prishtinës (vitet '70-ta të shekullit të kaluar) që kishin privilegjin të ndjekin leksionet e këtij pedagogu të dalluar ndjejnë humbjen dhe mungesën e madhe të profesor Priftit. Modestia dhe shëmbëlltyra e tij perfekte na zvogëlojnë dhimbjen dhe na bëjnë krenarë që e patëm.

Nuk kishin kaluar më shumë se një muaj e disa ditë që kur në shoqërinë e mikut tim, z. Teki Kurti, ia kisha dorëzuar dëshminë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me të cilën ai nderohej si anëtar i jashtëm i saj, për meritat e tij shkencore në historiografinë shqiptare dhe në atë të Kosovës në veçanti. Kjo vizitë e gëzoi atë jashtë mase dhe me këtë rast na tha: “Se sot po ndihem më i lehtësuar edhe nga dhimbjet dhe po më shtohet forca që Kosova po më kujtuaka dhe po më nderon me këtë akt të pranimit në gjirin e kolegëve të Prishtinës”.

Kristaq Prifti lindi në Berat më 21 dhjetor të vitit 1932. Aty e kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet e larta i vijoi në Fakultetin e Historisë në Institutin Pedagogjik në Moskë (1951-1955). Për dy dekada (1955-1975) ka punuar si pedagog i lëndës së Historisë së përgjithshme dhe të Shqipërisë (periudha e Rilindjes) në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Profesor Prifti ushtroi funksione të rëndësishme brenda këtij fakulteti. Gjatë këtyre viteve kreu me përkushtim të lartë detyrën e përgjegjësit të katedrës së Historisë (1960-1975), zëvendësdekanit (1962) dhe dekanit (1969-1975) të fakultetit. Veprimtaria pedagogjike e profesor Priftit u shtri edhe jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. Ai realizoi një varg ligjëratash në ciklin e studimeve të magjistraturës në Universitetin e Prishtinës (1972-1980). Këtu profesor Prifti jo vetëm që rrezatonte dije të gjera shkencore e qasje pedagogjike, por shfaqti dashuri vëllazërore dhe aftësi profesionale në ligjëratat interesante, duke fituar kështu respektin maksimal të studentëve kosovarë.

Nga viti 1982 profesor Prifti vazhdoi punën e tij shkencore në Institutin e Historisë në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në vitet 1991-1993 ishte drejtor i Institutit të Historisë. Pikërisht në këtë kohë shumë të vështirë për veprimtarinë intelektuale në Kosovë, dashamirësia dhe vlerësimet më afirmative për përpjekjet dhe misionin e kolegëve të tij në Prishtinë gjetën derën e hapur të Institutit të Historisë në Tiranë, për një bashkëpunim përmbajtësor në projekte të përbashkëta. Kjo gatishmëri dhe bujari e tij nga ajo kohë nuk mund të harroheshin pa u vlerësuar me një falënderim të veçantë, sepse pikërisht në prillin e 1993-tës me përkrahjen e profesor Priftit, Instituti i Historisë në Tiranë dhe Instituti i Historisë në Prishtinë organizuan një simpozium të karakterit ndërkombëtar, që ishte më i madhi pas 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978), në të cilin morën pjesë studiues eminentë të huaj e shqiptarë me temën bosht **“Çështja e Kosovës - një problem historik dhe aktual”**. Fusha dhe periudha e interesimeve shkencore të tij u përqendrua në Historinë e Shqipërisë (Rilindja Kombëtare Shqiptare). Në qendër të kërkimeve dhe studimeve shkencore të profesor Priftit ishin ngjarjet dhe personalitetet e shquara historike, politike, shoqërore dhe kulturo-arsimore, si: Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), Lidhja Shqiptare e Pejës (1899-1900; Roli dhe kontributi i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk; Veprimtaria politike dhe kulturo-arsimore në Shqipëri (1908-1912); Kongresi i Manastirit (1908); Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës; Çështje

të historisë së Kosovës dhe të personaliteteve intelektuale, politike e kulturore-arsimore shqiptare, etj.

Pa dyshim, një prej veprave më kryesore të tij është monografia historike-demografike **“Popullsia e Kosovës 1831-1912”** (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), Tiranë, 2014. Në këtë vepër monumentale, të hartuar pas një pune të zellshme e të mundimshme me dekada të tëra, ai ka përdorur materiale të bollshme arkivore e bibliografike ballkanike e evropiane, nga të cilat spikasin materialet dokumentare osmane, që përbëjnë regjistrimet zyrtare osmane të popullsisë përgjatë asaj periudhe. Përmes kësaj vepre autori ka arritur të vërtetojë me objektivitet shkencor shqiptarësinë e Kosovës dhe të demaskojë tendencat e autorëve e studiuesve të ndryshëm ballkanikë (në mënyrë të veçantë atyre serbë) e evropianë për shtrembërimin e së vërtetës historike dhe shkencore.

Profesor Prifti ka botuar edhe vëllimin me dokumente **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878–1881 (Dokumente)”**, 1978. Është bashkautor në monografinë **“Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”** (1968, 1978, 2004), bashkëpërgatitës i vëllimit **“La Ligue Albanaise de Prizren” I** (1988), bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës **“Historia e Shqipërisë”** (vëll. II, 1984), ka drejtuar gjatë viteve 1998–2007 projektin **“Historia e popullit shqiptar”** në katër vëllime dhe është bashkautor e redaktor shkencor i vëll. II (2002) dhe i vëll. III (2007). Është bashkëpërgatitës dhe bashkëredaktor i disa vëllimeve me dokumente e studime të Akademisë së Shkencave, si: **“Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit”** (1972), Sami Frashëri, **“Vepra”** (vëll. I e II, 1988), **“E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”** (edhe anglisht: **“The Thruth on Kosova”**, 1993), **“Çështja e Kosovës - një problem historik dhe aktual”**, Tiranë, 1996; bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës **“Himara në shekuj”**, Tiranë, (2004).

Akademik Kristaq Prifti ka botuar një varg punimesh shkencore brenda e jashtë Shqipërisë; ka marrë pjesë me kumtesa interesante në shumë evenimente shkencore, konferenca, simpoziume, tryeza e akademi, duke u paraqitur me referate cilësore dhe përgjithësisht ekskluzive dhe në këtë mënyrë ka lartësuar mendimin shkencor shqiptar.

Krijimtaria shkencore e akademik Kristaq Priftit është vlerësuar edhe nga institucionet më të larta shtetërore në Shqipëri dhe në Kosovë. Ai për kontributin e dhënë në ndriçimin e të vërtetës historike

të viseve shqiptare është dekoruar me Urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës”, i klasit I dhe ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së dytë; ndërsa Presidenti i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova e ka nderuar me Dekoratën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me rastin e 125-vjetorit të kësaj ngjarjeje më 2003.

Trashëgimia dhe kultura shkencore e historiografike, që profesor Prifti i ka lënë historiografisë shqiptare, e radhitin atë në pedestalin e hulumtuesve dhe studiuesve më të spikatur të historisë së popullit shqiptar. Veprat dhe angazhimi i tij shkencor përbëjnë një gamë të frytshme, e cila e ka avancuar edhe më tej kërkimin dhe mendimin shkencor në historiografinë shqiptare.

Shuarja e akademik Kristaq Priftit është një humbje e madhe për historiografinë shqiptare, për kulturën kombëtare dhe afirmimin e qenies dhe vlerave të popullit shqiptar përgjithësisht. Sidoqoftë, na mbetet ngushëllimi që ai ishte një personalitet i cili rrezatonte forcë intelektuale, mirësi dhe ndershmëri, të cilat do t’i kujtojmë kurdoherë me respektin më të madh.

Jusuf Bajraktari

Udhëzime për autorët e punimeve të propozuara për botim

Për botim në revistën *Studime shoqërore* do të merren në konsideratë ndihmesat (trajesa, studime, artikuj, recensione, etj.) që nuk janë botuar më parë (pos në raste të veçanta) dhe që paraqesin rezultate hulumtimesh origjinale shkencore, profesionale apo të zbatuara nga ana e autorit në fushat e shkencave shoqërore, duke mos prekur të drejtat autoriale të të tjerëve. Për të gjitha punimet e paraqitura për rubrikën Artikuj – studime, Redaksia merr parasysht procedurën e vlerësimit, përkatësisht recensimit. Recensionin mbetet në Redaksi, ndërsa emrat e recensentëve nuk bëhen të njohur për autorin e punimit. Për të tjerat vendos Redaksia. Për origjinalitetin dhe cilësinë e ndihmesave përgjigjen vetë autorët.

Punimi shkencor i paraqitur duhet të përmbajë:

Emrin dhe mbiemrin e autorit, vendin ku jeton e vepron aktualisht dhe titullin e punimit. Pastaj vjen abstrakti me jo më shumë se 200 fjalë dhe në vijim, para punimit, shënohen deri në 10 fjalë çelës termat kryesorë. Punimi ose trajtesa shkencore mund të shtrihet më së shumti deri në 10 faqe të formatit A4 të radhitura me kompjuter Microsoft Word (210x297 mm), me margjina 20 mm, në fontin Times New Roman 12 pt me radhor normal. Në fund punimi artikulli duhet të ketë një rezymë në rreth 1 faqe. Nëse punimi është në një gjuhë zyrtare të Kosovës, rezymëja duhet të jetë në një prej gjuhëve me qarkullim të gjerë (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe e kundërta. Abstrakti, fjalët çelës, rezymëja dhe bibliografia duhen të jenë në Times New Roman 10 pt. Literatura e punimit jepet në fund, ndërsa fusnotat në tekstin me të cilin ndërliiden shënohen në fund të çdo faqeje. Figurat dhe tabelat jepen në tekst. Në literaturë dhe fusnota duhen të shënohen: mbiemri dhe emri i autorit, titulli i punimit të cituar, titulli i publikimit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqes (faqeve). Kur citohet shqip shënohet f. për një f. dhe ff. për më shumë faqe (në gjuhë tjetër: p. ose pp.).

Referimet në fusnotë zakonisht shënohen si vijon:

BUDA, Aleks (2006) “Studime historike”, ASHAK, Prishtinë, ff. 1-604.

SHULTZ P. Duane (1969) “A history of Modern Psychology”, Hercourt Brace College Publishers, ff. 1-511.

Citimi i një punimi në revistë:

ANDREA, Zhaneta (1997) Tuma e Cerujës (Rrethi i Gramshit) - Le tumulus de Ceruje, ILIRIA 1 - 2, Tiranë, pp. 85 - 93.

Ndihmesa e propozuar duhet të jetë korrektuar gjuhësisht sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes standarde ose të gjuhës në të cilën është shkruar. Redaksisë i dorëzohet versioni elektronik. Autorët që përdorin shenja të veçanta duhet t'i dorëzojnë edhe fontet përkatëse, ashtu si dhe një version në letër apo PDF për identifikim të shenjave të veçanta.

Dorëshkrimet nuk kthehen. Redaksia rezervon të drejtën për të mos dhënë shpjegime në rast se nuk botohet punimi, artikulli, trajtesa apo ndihmesa e paraqitur.

Redaksia

STUDIME SHOQËRORE

4

2018

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shfqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 20.62 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup